



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 108

27 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 75/2012
datë 26.7.2012

Për ratifikimin e akteve dhe të dokumenteve të Kongresit të
24-t të Bashkimit Postar të Përbotshëm (UPU), Gjenevë,
2008.....

Faqe

5987

LIGJ
Nr. 75/2012

**PËR RATIFIKIMIN E AKTEVE DHE TË DOKUMENTEVE TË KONGRESIT TË 24-T TË
BASHKIMIT POSTAR TË PËRBOTSHËM (UPU), GJENEVË, 2008**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen aktet dhe dokumentet e Kongresit të 24-të të Bashkimit Postar të Përbotshëm (UPU), Gjenevë, 2008.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2012

**Shpallur me dekretin nr.7738, datë 16.8.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

BASHKIMI POSTAR UNIVERSAL

Protokolli i tetë Shtesë i Kushtetutës së Unionit Postar Universal
Protokolli i parë Shtesë i Rregullores së Përgjithshme të Unionit Postar Universal
Rregullat e Procedurës së Kongreseve të Konventës Postare Universale
Marrëveshje e Shërbimit të pagesave me Postë
Deklaratat e bëra për nënshkrimin e Akteve
Kushtetuta e Unionit Postar Universal
Rregullore e Përgjithshme e Unionit Postar Universal
Vendime të Kongresit të 24-rt të ndryshme nga amendimi i akteve

**SHËNIME MBI PRINTIMIN E TEKSTEVE TË MIRATUARA NGA KONGRESI I 24^{RT} - 2008 TË
RIPRODHUARA NË KËTË VOLUM.**

Shkrimi “Bold” i përdorur në tekstet e Protokollit të Tetë Shtesë të Kushtetutës, Protokollit të parë shtesë të Rregullores së Përgjithshme, Rregullat e Procedurës së Kongreseve, Konventa, Kushtetuta dhe Rregullorja e Përgjithshme tregojnë amendimet e Akteve të miratuara nga Kongresi i Bukureshtit 2004.

Duke qenë se Marrëveshja e Shërbimit të Pagesave me Postë e paraqitur dhe miraturar në Kongresin e 24^{rt} është një version tërësisht i ripunuar i cili zëvendëson Marrëveshjen e mëparshme të Shërbimit të Pagesave me Postë, ky tekst është printuar me shkrim normal.



Deklaratat e bëra për nënshkrimin e Akteve, Kushtetuta e Unionit Postar Universal të miratuar në Vjenë në 1964 dhe amenduar në 1969 në Tokio, në 1974 në Lozanë, në 1984 në Hamburg, në 1989 në Uashington, në 1994 në Seul, në 1999 Pekin, në 2004 në Bukuresht dhe në Kongresin e 24^{rt} - 2008, Protokollet Shtesë dhe Rregullorja e Përgjithshme e miratuar në Bukuresht në 2004 dhe amenduar nga Protokollin e Parë Shtesë (Kongresi i 24^{rt} - 2008), janë riprodhuar në këtë volum për motive informacioni, por nuk janë pjesë e Akteve të nënshkuara në Gjenevë.

PROTOKOLLI I TETË SHITESË I KUSHTETUTËS SË UNIONIT POSTAR UNIVERSAL

PËRMBAJTJA

Neni

- | | |
|--|--|
| I. (Neni 1bis i amenduar) | Përkufizime |
| II. (Neni 4 i amenduar) | Marrëdhënie të jashtëzakonshme |
| III. (Neni 8 i amenduar) | Unione të kufizuara. Marrëveshje të posaçme |
| IV. (Neni 11 i amenduar) | Anëtarësimi ose pranimi në Union. Procedura |
| V. (Neni 22 i amenduar) | Akte të Unionit |
| VI. (Neni 25 i amenduar) | Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të Akteve të Unionit |
| VII. (Neni 29 i amenduar) | Prezantimi i propozimeve |
| VIII. Neni 32 i amenduar) | Arbitrazhi |
| IX. Hyrja në Protokollin Shtesë dhe Akte të tjera të Unionit | |
| X. Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Protokollit Shtesë të Kushtetutës së Unionit Postar Universal | |

PROTOKOLLI I TETË SHITESË I KUSHTETUTËS SË UNIONIT POSTAR UNIVERSAL

Të plotfuqishmit e qeverive të vendeve anëtare të Unionit Postar Universal, u takuan në Kongres në Gjenevë, sipas nenit 30.2 të Kushtetutës së Unionit Postar Universal përfunduar në Vjenë më 10 korrik 1964, kanë miratuar, ndryshimet e mëposhtme për këtë Kushtetutë, subjekt i ratifikimit.

Neni I (Neni 1bis i amenduar) Përkufizime

1 Për qëllimet e Akteve të Unionit Postar Universal, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e përcaktuara në vijim:

1.1 Shërbim postar: të gjitha shërbimet postare qëllimi i të cilave përcaktohet nga organet e Unionit. Detyrimet kryesore të shërbimeve postare janë të përmbushin disa objektiva të caktuara sociale dhe ekonomike të vendeve anëtare, duke siguruar, mbledhjen, klasifikimin, transmetimin, dhe shpërndarjen e dërgesave postare.

1.2 Shtet Anëtar: një shtet që përmbush kushtet e nenit 2 të Kushtetutës.

1.3 Territor i vetëm postar (një dhe i njëjti territor postar): detyrimi i palëve kontraktuese të Akteve të UPU për të ofruar për shkëmbimin reciprok të artikujve të letrave postare, duke përfshirë edhe lirinë e tranzitit, dhe trajtimin e dërgesave postare në transit nga vende të tjera njëjloj me artikujt e tyre postar, pa diskriminim.

1.4 Liria e transitit: detyrimi i një vendi anëtar të ndërmjetëm për të siguruar transportin e dërgesave postare për të kaluar transit në të, drejtuar në një tjetër vend anëtar, duke siguruar trajtim të ngjashëm me atë të dhënë për dërgesat e brendshme.

1.5 Artikull i letrave postare: artikujt e përshkruar në Konventë.

1.6 Shërbimi Ndërkombëtar postar: operacione postare ose shërbime të rregulluara nga këto Akte; vendosja e këtyre operacioneve ose shërbimeve.

1.7 Operatorë të caktuar: çdo ent shtetëror ose jo i caktuar zyrtarisht nga shteti anëtar për të kryer shërbimet postare në territorin e tij dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit.

1.8 Rezervimi: një klauzolë përjashtimi ku një vend anëtar pretendon të përjashtojë ose të modifikojë efektin ligjor të një klauzole të një Akti, të ndryshëm nga Kushtetuta dhe Rregulloret e përgjithshme, në zbatimin e tij në atë vend anëtar. Çdo rezervim do të jetë në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit siç përcaktohet në parathënie dhe në nenin 1 të Kushtetutës. Ajo duhet të justifikohet në mënyrë të rregullt dhe të miratohet nga shumica e kërkuar për miratimin e Aktit në fjalë, dhe të futet në Protokollin Përfundimtar.

Neni II

(Neni 4 i amenduar)

Marrëdhënie të jashtëzakonshme

Shtetet anëtare operatorët e caktuar të cilave ofrojnë një shërbim me territore që nuk përfshihen në Bashkim janë të detyruara të veprojnë si ndërmjetës për vendet e tjera anëtare. Dispozitat e Konventës dhe rregulloret e saj do të jenë të zbatueshme për marrëdhënie të tilla të jashtëzakonshme.

Neni III

(Neni 8 i amenduar)

Sindikata të kufizuara. Marrëveshje të Posaçme

1. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, nëse i lejohet legjislacioni i atyre vendeve anëtare, mund të themelojnë sindikata të kufizuara dhe të bëjnë marrëveshje të veçanta në lidhje me shërbimin postar ndërkombëtar, gjithmonë me kusht që ata nuk do të kenë dispozita më pak të favorshme për publikun se ato të parashikuara nga Aktet në të cilat shtetet anëtare në fjalë janë palë.

2. Sindikatat e kufizuara mund të dërgojë vëzhgues në Kongrese, konferenca dhe takime të Bashkimit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare.

3. Bashkimi mund të dërgojë vëzhgues në Kongreset, konferencat dhe mbledhjet e Sindikatave të Kufizuara

Neni IV

(Neni 11 i amenduar)

Aderimi ose pranimi në Bashkim. Procedura

1. Çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Bashkim.

2. Çdo shtet sovran i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aplikojë për pranim si një shtet anëtar i Bashkimit.

3. Aderimi ose kërkesa për pranim në Bashkimin duhet të përfshijë një deklaratë formale të pranimit të Kushtetutës dhe të Akteve të detyrueshme të Bashkimit. Ajo do të dërgohet nga qeveria e vendit të interesuar tek Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare, i cili do të njoftojë pranimin ose do të konsultohet me vendet anëtare në lidhje me aplikimin për pranim, sipas rastit.

4. Një vend i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara do të konsiderohet të pranohet si një vend anëtar nëse kërkesa e tij është miratuar nga të paktën dy të tretat e vendeve anëtare të Bashkimit. Vendet anëtare të cilat nuk i janë përgjigjur brenda një periudhe kohe prej katër muajsh të llogaritur nga data e konsultimeve do të konsiderohet se ka abstenuar.

5. Aderimi ose pranimi në anëtarësim do të njoftohet qeverive të vendeve anëtare nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare. Ai do të ketë efekt nga data e këtij njoftimi.

Neni V

(Neni 22 i amenduar)

Aktet e Bashkimit

1. Kushtetuta do të jetë Akti themelor i Bashkimit. Ajo do të përmbajë rregullat organike të Bashkimit dhe nuk do të jetë subjekt i rezervimeve.

2. Rregulloret e përgjithshme do të shprehin dispozitat të cilat sigurojnë zbatimin e Kushtetutës dhe punën e Bashkimit. Ato do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare dhe nuk do të jenë subjekt i rezervimeve.



3. Konventa Universale Postare, Rregullorja e Postës së Letrave dhe Rregullorja e Kolipostës do të shprehin rregullat e zbatueshme në të gjithë shërbimin ndërkombëtar postar dhe dispozitat në lidhje me shërbimet e postës së letrave dhe kolipostës. Këto Akte do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Konventa dhe Rregulloret e saj.

4. Marrëveshjet e Bashkimit, dhe Rregulloret e tyre, do të disiplinojnë shërbimet e ndryshme nga ato të postës së letrave dhe kolipostës ndërmjet shteteve anëtare, të cilat janë palë në to. Ato do të jenë të detyrueshme vetëm për këto shtete anëtare. Shtetet nënshkruese anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshjet dhe Rregulloret e tyre.

5. Rregulloret, të cilat do të përmbajnë rregullat e aplikimit të nevojshme për zbatimin e Konventës dhe të Marrëveshjeve, do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi.

6. Protokollet përfundimtare të bashkëlidhura me Aktet e Bashkimit referuar në paragrafët 3, 4 dhe 5 do të përmbajnë rezervimet në lidhje me këto Akte.

Neni VI

(Neni 25 i amenduar)

Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të akteve të Bashkimit

1. Aktet e Bashkimit që rrjedhin nga Kongresi duhet të nënshkruhen nga të plotfuqishmit e vendeve anëtare.

2. Rregulloret duhet të autentikohen nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Operacioneve Postare.

3. Kushtetuta do të ratifikohet sa më shpejt të jetë e mundur nga shtetet nënshkruese.

4. Miratimi i Akteve të Bashkimit të ndryshme nga Kushtetuta do të disiplinohen nga rregullat kushtetuese të secilit prej shteteve nënshkruese.

5. Kur një shtet anëtar nuk ratifikon Kushtetutën ose nuk i miraton aktet e tjera të cilat i ka nënshkruar, Kushtetuta dhe aktet tjera, do të jenë njëloj të vlefshme për shtetet e tjera anëtare që i kanë ratifikuar ose miratuar ato.

Neni VII

(Neni 29 i amenduar)

Paraqitja e propozimeve

1. Një shtet anëtar ka të drejtë të paraqesë, në Kongres ose midis Kongreseve, propozime në lidhje me Aktet e Bashkimit në të cilin ai është palë.

2. Megjithatë, propozimet në lidhje me Kushtetutën dhe Rregulloret e Përgjithshme mund të paraqiten vetëm në Kongres.

3. Për më tepër, propozimet në lidhje me Rregulloret duhet të paraqiten drejtpërsëdrejti në Këshillin e Operacioneve Postare, por së pari duhet të transmetohen nga Byroja Ndërkombëtare për të gjitha shtetet anëtare dhe të gjithë operatorët e caktuar.

Neni VIII

(Neni 32 i amenduar)

Arbitrazhi

Në rast të një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë shteteve anëtare në lidhje me interpretimin e Akteve të Bashkimit ose përgjegjësitë e vendosura mbi shtet anëtar nga zbatimi i këtyre Akteve, çështja në fjalë do të zgjidhet me arbitrazh.

Neni IX

Aderimi në Protokollin Shtesë dhe Akte të tjera të Bashkimit

1. Shtetet anëtare të cilat nuk kanë nënshkruar këtë Protokoll mund të aderojnë në të në çdo moment.
2. Shtetet anëtare të cilat janë palë e Akteve të përditësuara të Kongresit por që nuk i kanë nënshkruar ato duhet të aderojnë sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Instrumentet e aderimit në lidhje me rastet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 do ti dërgohen Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, i cili do të njoftojë qeveritë e shteteve anëtare për depozitimin e tyre.

Neni X

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Protokollit shtesë të Kushtetutës së Bashkimit Postar Universal

Ky Protokoll Shtesë hyn në fuqi më 1 Janar 2010 dhe do të jetë në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit të qeverive të shteteve anëtare kanë hartuar këtë Protokoll Shtesë, i cili do të ketë të njëjtën fuqi dhe të njëjtën vlefshmëri sikur dispozitat e saj ishin futur në tekstin e vetë Kushtetutës, dhe ata e kanë nënshkruar atë në një kopje të vetme origjinale e cila do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje e tij do t'i dërgohet secilës palë nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Gjenevë, 12 gusht 2008.

PROTOKOLLI I PARË SHITESË I RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL

Përmbajtja

Neni		
I.	(neni 10 bis i ri)	Funksionet e Kongresit
II.	(neni 102 i amenduar)	Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit Drejtues
III.	(neni 103 i amenduar)	Informacioni mbi veprimtaritë e Këshillit Drejtues
IV.	(neni 104 i amenduar)	Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare
V.	(neni 105 i amenduar)	Njohuri mbi aktivitetet e Këshillit të Operacioneve Postare
VI.	(neni 106 i amenduar)	Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Komitetit Këshillimor
VII.	(neni 107 i amenduar)	Njohuri mbi aktivitetet e Komitetit Këshillimor
VIII.	(neni 110 i amenduar)	Gjuha e përdorur për dokumentacionin, për debatet dhe për korrespondencën zyrtare
IX.	(neni 112 i amenduar)	Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm
X.	(neni 114 i amenduar)	Sekretariati i organeve të Bashkimit
XI.	(neni 116 i amenduar)	Informacioni. Opinionet. Kërkesat për interpretim dhe amendim të Akteve. Anketimet. Roli në likuidimin e llogarive
XII.	(neni 118 i amenduar)	Formularët e dhënë nga Byroja Ndërkombëtare
XIII.	(neni 119 i amenduar)	Aktet e Sindikatave të Kufizuara dhe Marrëveshjet e Posaçme
XIV.	(neni 121 i amenduar)	Raporti dyvjeçar mbi punën e Bashkimit
XV.	(neni 122 i amenduar)	Procedura për paraqitjen e propozimeve në Kongres
XVI.	(neni 123 i amenduar)	Procedura e paraqitjes në Këshillin e Operacioneve Postare të propozimeve që kanë të bëjnë me përgatitjen e Rregulloreve të reja nën vendimet e marra nga Kongresi
XVII.	(neni 124 i amenduar)	Procedura për paraqitjen e propozimeve në periudhën midis Kongreseve
XVIII.	(neni 125 i amenduar)	Shqyrtimi i propozimeve në periudhën midis Kongreseve
XIX.	(neni 126 i amenduar)	Njoftimi i vendimeve të marra në periudhën midis Kongreseve



XX.	(neni 128 i amenduar)	Fiksimi dhe rregullimi i shpenzimeve të Bashkimit
XXI.	(neni 130 i amenduar)	Klasat e kontributeve
XXII.	(neni 131 i amenduar)	Pagesa për furnizimet nga Byroja Ndërkombëtare
XXIII.	(neni 132 i amenduar)	Procedurat e arbitrazhit
XXIV.	(neni 135 i amenduar)	Amendimet, hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores së Përgjithshme
XXV.		Aderimi në Protokollin Shtesë
XXVI.		Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Protokollit Shtesë të Rregullores së Përgjithshme

PROTOKOLLI I PARË SHITESË I RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL

Të plotfuqishmit e qeverive të vendeve anëtare të Unionit Postar Universal, u takuan në Kongres në Gjenevë, sipas nenit 22.2 të Kushtetutës të përfunduar në Vjenë më 10 korrik 1964, kanë miratuar, me marrëveshje të përbashkët dhe subjekt të nenit 25.4 të Kushtetutës, ndryshimet e mëposhtme për Rregulloren e Përgjithshme.

Neni I (neni 101bis) Funksionet e Kongresit

1. Në bazë të propozimeve nga shtetet anëtare, Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, Kongresi:

1.1 të përcaktojë politikat e përgjithshme për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të Bashkimit të vendosur në Preambulë dhe në nenin 1 të Kushtetutës;

1.2 të konsiderojë dhe miratojë, nëse është e përshtatshme, propozimet për amendimet e Kushtetutës, Rregullores së Përgjithshme, Konventën dhe Marrëveshjet e paraqitura nga shtetet anëtare dhe Këshillat, në përputhje me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 122 të Rregullores së Përgjithshme;

1.3 të vendosë datën për hyrjen në fuqi të Akteve;

1.4 të miratojë Rregullat e tij të Procedurës dhe amendimet e këtyre Rregullave;

1.5 të konsiderojë raportet e përgjithshme mbi punën e Këshillit Drejtues, Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komitetit Këshillimor, që mbulojnë periudhën nga Kongresi i mëparshëm, të paraqitur nga organet përkatëse në përputhje me nenet 103, 105 dhe 107 të Rregullores së Përgjithshme;

1.6 të miratojë strategjinë e Bashkimit;

1.7 të vendosë shumën maksimale të shpenzimeve të Bashkimit në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës;

1.8 të zgjedhë shtetet anëtare në Këshillin Drejtues dhe në Këshillin e Operacioneve Postare;

1.9 të zgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm;

1.10 të vendosë kufirin e kostove që ka Bashkimi për prodhimin e dokumenteve në gjuhën Kineze, Gjermane, Portugeze dhe Ruse.

2. Kongresi, si organ suprem i Bashkimit, do të kujdeset për të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

Neni 102 Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit Drejtues (Kushtetuta 17)

1. Këshilli drejtues përbëhet nga dyzetë e një anëtarë, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës midis dy Kongreseve të njëpasnjëshme.

2. Presidenca i njihet si e drejtë shtetit anëtar pritës të kongresit. Nëse ky shtet anëtar heq dorë nga kjo e drejtë, ai do të konsiderohet si anëtar de jure, dhe për rrjedhojë, grupi gjeografik në të cilin ai bën pjesë, do të ketë në dispozicionin e tij një vend shtesë, ndaj të cilit nuk do të jenë të zbatueshme kufizimet e parashikuara në pikën 3. Në këtë rast, Këshilli drejtues do të zgjedhë për presidencë një nga shtetet anëtare pjesëtarë të grupit gjeografik në të cilin bën pjesë shteti anëtar pritës.

3. Të dyzetë (40) anëtarët e tjerë të Këshillit drejtues do të zgjidhen nga Kongresi mbi bazën e një shpërndarje gjeografike të barabartë. Të paktën gjysma e anëtarëve do të rinovohet në çdo kongres; asnjë vend anëtar nuk mund të zgjidhet nga tre Kongrese të njëpasnjëshme.

4. Çdo anëtar i Këshillit drejtues cakton përfaqësuesin e tij, i cili duhet të jetë kompetent në kuadrin postar.

5. Funksionet e anëtarit të Këshillit drejtues nuk do të jenë të paguara. Shpenzimet për funksionimin e këtij Këshilli i ngarkohen Bashkimit.

6. Këshilli drejtues do të ketë kompetencat e mëposhtme:

6.1 mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarive të Bashkimit midis Kongreseve, duke siguruar përputhjen me vendimet e Kongresit, duke shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me politikat qeverisëse mbi çështjet postare dhe duke konsideruar zhvillimet rregullatore ndërkombëtare si ato që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve dhe të konkurrencën;

6.2 shqyrtimin dhe miratimin, brenda kuadrit të kompetencave të tij, të çdo veprimi të gjykuar të nevojshëm, për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë dhe modernizimin e shërbimit postar ndërkombëtar;

6.3 promovimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha formave të asistencës teknike postare brenda kuadrit të bashkëpunimit teknik ndërkombëtar;

6.4 shqyrtimin dhe miratimin e Programit dyvjeçar dhe Buxhetit dhe llogarive të Bashkimit;

6.5 autorizimin e tejkalimit të kufirit të shpenzimeve, nëse e kërkojnë rrethanat, në përputhje me nenin 128.3 deri në 5;

6.6 formulimin e Rregullores Financiare të Bashkimit;

6.7 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Rezervë;

6.8 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Speciale;

6.9 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin e Veprimtarive Speciale;

6.10 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Vullnetar;

6.11 sigurimin e kontrollit mbi veprimtarinë e Byrosë Ndërkombëtare;

6.12 autorizimin e zgjedhjes së një klase kontributi më të ulët, nëse kjo kërkohe, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 130. 6;

6.13 autorizimin e ndryshimit të grupit gjeografik, nëse kjo kërkohe nga një shtet anëtar, duke konsideruar mendimet e shprehura nga shtetet anëtare të cilat janë pjesëtare të grupeve gjeografike në fjalë;

6.14 formulimin e Rregullores së Personelit dhe kushteve të shërbimit për funksionarët e zgjedhur;

6.15 krijimin ose shkurtimin e vendeve të punës në Byronë Ndërkombëtare, duke konsideruar kufizimet lidhur me tavanin e vendosur të shpenzimeve;

6.16 formulimin e Rregullores së Fondit Social;

6.17 miratimin e raportit 2-vjeçar mbi punën e Bashkimit dhe Raportit 2-vjeçar të Administrimit Financiar të përgatitura nga Byroja Ndërkombëtare, dhe nëse gjykohe e përshtatshme, paraqitjen e disa komenteve rreth tyre;

6.18 vendimin mbi kontaktet që duhet të vendosen me shtetet anëtare me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

6.19 Pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare, vendimin mbi kontaktet që duhet të vendosen me organizata të cilat nuk janë vëzhgues de jure, shqyrtimin dhe miratimin raporteve të Byrosë Ndërkombëtare mbi marrëdhëniet e UPU-t me organizma të tjera ndërkombëtare, vendime të cilat i gjykon si të përshtatshme për të drejtuar këto marrëdhënie dhe veprimet që duhet të ndërmerren për to; pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe Sekretariatit e Përgjithshëm, të caktojë në kohën e duhur organizmat ndërkombëtare, shoqatat, sipërmarrjet dhe personat e specializuar të cilët duhet të ftohen në seancat shkencore të Kongresit dhe të Komiteteve të tij, kur kjo është në interesin e Bashkimit ose të punimeve të Kongresit, dhe instruktimin e Drejtorit të Përgjithshëm të dërgojë ftesat e nevojshme;

6.20 krijojë parimet, në rastin kur e gjykon të nevojshme, për Këshillin e Operacioneve Postare duke konsideruar gjatë shqyrtimit të çështjeve me pasoja financiare të rëndësishme (tarifa, detyrime të fazës përfundimtare, shpenzime transiti, tarifa bazë të transportit ajror të postës dhe postimin jashtë shtetit për dërgesat e postës së letrave), ndjekjen nga afër të shqyrtimit të këtyre çështjeve dhe rishikimin dhe miratimin, për konformitet me parimet e lartpërmendura, propozimet e Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me këto çështje;

6.21 shqyrtimin, me kërkesë të Kongresit, të Këshillit të Operacioneve Postare ose të shteteve anëtare, probleme të llojit administrativ, legjislativ dhe juridik që kanë të bëjnë me Bashkimin ose shërbimin



postar ndërkombëtar; i takon Këshillit drejtues të vendosë për fushat e lartpërmendura, nëse është e dobishme të ndërmerren studimet e kërkuara nga shtetet anëtare midis Kongreseve;

6.22 formulimin e propozimeve që do të nënshtrohen miratimit të Kongresit ose të shteteve anëtare në përputhje me nenin 125;

6.23 miratimin, brenda kuadrit të kompetencave të veta, të rekomandimeve të Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me njohjen, nëse është e nevojshme, të rregulloreve ose të një praktike të re duke pritur që Kongresi të vendosë mbi çështjen;

6.24 shqyrtimin e raportit vjetor të përgatitur nga Këshilli i Operacioneve Postare dhe çdo propozim të paraqitur nga Këshilli;

6.25 paraqitjen në Këshillin e Operacioneve Postare të subjekteve të studimit sipas nenit 104.9.16;

6.26 caktimin e shtetit anëtar ku do të mbahet Kongresi i ardhshëm në rastin e parashikuar në nenin 101.4;

6.27 përcaktimin, në kohën e duhur dhe pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare, të numrit të Komisioneve të nevojshme për drejtimin sa më të mirë të punimeve të Kongresit dhe caktimin e kompetencave të tyre;

6.28 caktimin, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe subjekt i miratimit të Kongresit, shtetet anëtare të përgatitura:

- për të marrë përsipër nën-kryesinë e Kongresit dhe të presidencës dhe të nën-presidencës së Komiteteve, duke konsideruar sa më shumë që është e mundur shpërndarjen gjeografike të barabartë të shteteve anëtare;

- për të mbikëqyrur Komisionet e kufizuara të Kongresit;

6.29 vlerësimin dhe miratimin, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, projektin e Strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

6.30 miratimin e raportit katër vjeçar, të përgatitur nga Byroja Ndërkombëtare duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, mbi performancën e shteteve anëtare në lidhje me ekzekutimin e Strategjisë së Bashkimit të miratuar nga Kongresi i mëparshëm, për tu paraqitur në Kongresin e radhës;

6.31 krijimin e kuadrit për organizimin e Komitetit Këshillimor dhe kontributin në organizimin e Komitetit Këshillimor, në përputhje me dispozitat e nenit 106;

6.32 caktimin e kriterëve për anëtarësim në Komitetit Këshillimor dhe miratimin ose kundërshtimin e kërkesave për anëtarësim sipas këtyre kriterëve, duke u siguruar veprimi me kërkesat është përmbushur me anë të një procedure të përsheptuar ndërmjet mbledhjeve të Këshillit drejtues;

6.33 caktimin e atyre anëtarëve të tij të cilët do të jenë anëtarë të Komitetit Këshillimor;

6.34 marrjen dhe diskutimin e raporteve dhe rekomandimeve të Komitetit Këshillimor dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve nga Komiteti Këshillimor për paraqitje në Kongres;

7. Në mbledhjen e tij të parë, e cila do të thirret nga Kryetari i Kongresit, Këshilli drejtues zgjedh, ndër anëtarët e tij, katër nënkryetarë dhe harton Rregulloren e tij të Procedurës.

8. Me thirrje nga Kryetari i tij, Këshilli drejtues do të mbledhet në parim një herë në vit, në selinë e Bashkimit.

9. Kryetari, nënkryetarët dhe kryetari i Komisionit të Këshillit drejtues, do të përbëjnë Komitetin drejtues. Ky komitet do të përgatisë dhe drejtojë punët në çdo mbledhje të Këshillit drejtues. Ai miraton, në emër të Këshillit drejtues, raportin dy vjeçar të përpiluar nga Byroja Ndërkombëtare mbi punën e Bashkimit dhe merr përsipër çdo detyrë tjetër që Këshilli drejtues vendos t'ia besojë ose që lind gjatë procesit të planifikimit strategjik.

10. Shpenzimet e udhëtimit të përfaqësuesit të çdo anëtari të Këshillit drejtues pjesëmarrës në mbledhjet e këtij organi, do të mbulohen nga shteti i tij anëtar. Megjithatë, përfaqësuesi i çdo shteti anëtar të klasifikuar si në zhvillim ose shtete më pak të zhvilluara në përputhje me listën e hartuar nga Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mbledhjeve që janë mbajtur gjatë Kongresit, do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që kjo shumë të mos tejkalojë vlerën e një bilete avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik. E njëjta e drejtë i jepet edhe përfaqësuesit të çdo anëtari të komisioneve të tij, të grupeve të tij të punës ose organeve të tjera të tij kur këto të fundit mbledhen jashtë Kongresit dhe mbledhjeve të Këshillit.

11. Kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e Këshillit drejtues në rendin e ditës të cilave ka çështje të cilat janë me interes për organin që ai drejton.

12. Kryetari i Këshillit Këshillimor do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e Këshillit drejtues në rendin e ditës të cilave ka çështje të cilat janë me interes për Komitetit Këshillimor.

13. Me qëllim për të siguruar një lidhje efikase të punimeve të dy organeve, Këshilli i Operacioneve Postare mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues, me cilësinë e vëzhguesit.

14. Shteti anëtar ku mblidhet Këshilli drejtues do të jetë i ftuar të marrë pjesë në mbledhje me cilësinë e vëzhguesit, nëse ky shtet nuk është anëtar i Këshillit drejtues.

15. Këshilli drejtues mund të ftojë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote, çdo organizëm ndërkombëtar, çdo përfaqësues shoqate ose ndërmarrje, ose çdo individ të kualifikuar i cili dëshiron të bashkohet me punën e tij në këto mbledhje. Mund të ftohen me të njëjtat kushte një ose disa shtete anëtare të interesuara për çështje të parashikuara në rendin e ditës së mbledhjes.

16. Me kërkesën e tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e komisioneve të Këshillit drejtues:

16.1 anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare;

16.2 anëtarët i Këshillit Këshillimor;

16.3 organizma ndërqeveritare që interesohen për punimet e Këshillit drejtues;

16.4 të tjera vende anëtare të Bashkimit.

17. Për arsye logjistike, Këshilli drejtues mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

18. Anëtarët e Këshillit drejtues do të marrin pjesë efektivisht në punimet e mbledhjeve. Vëzhguesit munden, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë disa Grupe Pune dhe Ekiye Projektësh, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve bëhet pa shpenzime shtesë nga Bashkimi.

19. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Duhet e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

Neni III

(neni 103 i amenduar)

Informacion mbi aktivitetin e Këshillit drejtues

1. Pas çdo sesioni, Këshilli drejtues do të informojë shtetet anëtare të Bashkimit, operatorët e tyre të caktuar, Bashkimet e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor, mbi veprimtaritë e veta duke ju dërguar, *inter alia*, atyre një përmbledhje analitike për rezolutat dhe vendimet.

2. Këshilli drejtues do të bëjë një raport për gjithë aktivitetin e tij për Kongresin dhe ja dërgon atë shteteve anëtare, operatorëve të tyre të caktuar dhe anëtareve të Këshillit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni IV

(neni 104 i amenduar)

Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare (Kushtetuta 18)

1. Këshilli i Operacioneve Postare përbëhet nga dyzetë antarë të cilët do të ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës që ndan dy Kongrese të njëpasnjëshëm.

2. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të zgjidhen nga Kongresi sipas një ndarje specifike gjeografike. Njëzet e katër vende do të rezervohen për shtetet anëtare në zhvillim dhe gjashtëmbëdhjetë vende për shtetet anëtare të zhvilluara. Të paktën një e treta e anëtarëve do të rinovohet në çdo Kongres.



3. Çdo anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare cakton përfaqësuesin e tij i cili merr përsipër përgjegjësitë e përcaktuara në Aktet e Bashkimit në fushën e kryerjes së shërbimeve.

4. Shpenzimet për funksionimin e Këshillit të Operacioneve Postare do të mbulohen nga Bashkimi. Anëtarët e tij nuk marrin asnjë pagesë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të përfaqësuesve të shteteve anëtare pjesëmarrëse në Këshillin e Operacioneve Postare janë në ngarkim të këtyre shteteve anëtare. Megjithatë, përfaqësuesi i çdo vendi që konsiderohet i pafavorizuar sipas listave të hartuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që shumat të mos tejkalojë çmimin e një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik, me përjashtim të mbledhjeve që zhvillohen gjatë Kongresit.

5. Në mbledhjen e tij të parë, e cila është thirrur dhe hapur nga kryetari i Kongresit, Këshilli i Operacioneve Postare do të zgjedhë, ndërmjet anëtareve të tij një Kryetar, një Nënkryetar, dhe kryetarët e Komitetit.

6. Këshilli i Operacioneve Postare mban rregulloren e tij të brendshme.

7. Në parim, Këshilli i Operacioneve Postare mbledhet çdo vit në selinë e Bashkimit. Data dhe vendi i mbledhjes do të caktohen nga kryetari i tij, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

8. Kryetari, Nënkryetari, Kryetarët e Komisioneve të Këshillit të Operacioneve Postare do të përbëjnë Komitetin drejtues. Ky Komitet përgatit dhe drejton punët e çdo mbledhje të Këshillit të Operacioneve Postare dhe mbulon të gjitha detyrat që ky i fundit vendos t'ia besojë, ose për të cilat lind nevoja gjatë procesit për planifikim strategjik.

9. Kompetencat e Këshillit të Operacioneve Postare janë si më poshtë:

9.1 të drejtojë shqyrtimin e problemeve më të rëndësishme operacionale, tregtare, teknike, ekonomike dhe të bashkëpunimit teknik, që paraqesin interes për të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, duke përfshirë çështjet që kanë pasoja financiare të rëndësishme (tarifat, shpenzimet përfundimtare, tarifa të transimit, tarifa të transportit ajror për postën, tarifat për koltë postare dhe postimin jashtë shtetit të artikujve të postës së letrave), dhe të përgatisë informacionin dhe rekomandimeve për veprimin për to;

9.2 të rishikojë Rregulloret e Bashkimit brenda gjashtë muajve që pasojnë mbylljen e Kongresit, nëse Kongresi nuk vendos ndryshe; në rast të nevojave urgjente, Këshilli i Operacioneve Postare gjithashtu mund të ndryshojë Rregulloret e sipërpërmendura në sesione të tjera; në të dyja rastet, Këshilli i Operacioneve do të jetë subjekt i direktivave të Këshillit drejtues për sa i përket politikave dhe parimeve themelore;

9.3 të koordinojë masat praktike për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndërkombëtare postare;

9.4 të ndërmarrë, pas miratimit të Këshillit drejtues brenda kuadrit të kompetencave të këtij të fundit, çdo veprim të gjykuar të nevojshëm për të mbajtur rregullin dhe përforcuar cilësinë e shërbimit ndërkombëtar postar dhe për ta modernizuar atë;

9.5 të formulojë propozime që do t'i paraqiten për miratim Kongresit ose shteteve anëtare në përputhje me nenin 125; miratimi i Këshillit drejtues kërkohet kur këto propozime kanë të bëjnë me çështje brenda kompetencave të këtij të fundit;

9.6 të shqyrtojë, me kërkesën të një shteti anëtar, çdo propozim që ky shtet anëtar i transmeton Byrosë Ndërkombëtare sipas nenit 124, të përgatisë vërejtjet për to dhe të instruktojë Byronë Ndërkombëtare për aneksimin e këtyre vërejtjeve me propozimet para se ti paraqiten për miratim të shteteve anëtare;

9.7 të rekomandojë, nëse është e nevojshme, dhe kur është e arsyeshme pas miratimit nga Këshilli drejtues dhe këshillimit me të gjitha shtetet anëtare, miratimin përfundimtar të rregulloreve ose të një procedure të re deri në momentin që Kongresi të vendosë për këtë çështje;

9.8 të përpunojë dhe të paraqesë, në formë rekomandimesh para shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, standarde për procese teknologjike, operacionale dhe procese të tjera në kompetencën e tij, ku është e domosdoshme një praktikë e njëtrajtshme; ai do të paraqesë në mënyrë të ngjashme, sipas kërkesave, amendamente për standardet që ka vendosur;

9.9 ti sigurojë Këshillit drejtues të dhëna për zhvillimin e draftit të Strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

9.10 të miratojë ato pjesë të raportit dy vjeçar të Byrosë Ndërkombëtare mbi punën e Bashkimit që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe funksionet e Këshillit të Operacioneve Postare;

9.11 të vendosë mbi kontaktet që duhet të krijohen me shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

9.12 të studiojë problemet e edukimit dhe formimit profesional që i interesojnë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuara si e shteteve të reja dhe në zhvillim;

9.13 të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin dhe reklamimin e eksperimenteve dhe progresit të arritur nga disa shtete anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në fushën teknike, operacionale, ekonomike dhe të trajnimit profesional me interes për shërbimet postare;

9.14 të shqyrtojë situatën aktuale dhe nevojat e shërbimit postar në shtetet e reja dhe ato në zhvillim dhe të përpunojë rekomandimet e përshtatshme për mënyrat dhe mjetet për përmirësimin e shërbimeve postare në këto shtete;

9.15 të marrë, pas këshillimit me Këshillin drejtues, hapa të përshtatshme në fushën e bashkëpunimit teknik me gjithë shtetet anëtare të Bashkimit dhe operatorët e tyre të caktuar dhe në veçanti me vendet e reja dhe ato në zhvillim dhe operatorët e tyre të caktuar;

9.16 të shqyrtojë çdo çështje tjetër të paraqitur, nga një anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare, nga Këshilli drejtues ose nga çdo shtet anëtar ose operator i caktuar;

9.17 të marrë dhe diskutojë raportet si dhe rekomandimet e Komitetit Këshillimor, dhe, kur janë të përfshira çështje me interes për Këshillin e Operacioneve Postare, të shqyrtoj dhe komentojë rekomandimet e Komitetit Këshillimor që do të paraqiten në Kongres;

9.18 Të caktojë ata anëtarë të tij që do të bëjnë pjesë në Komitetin Këshillimor;

10. Bazuar në planin strategjik të Bashkimit të miratuar nga Kongresi dhe, në veçanti, të pjesës që lidhet me strategjitë e Organeve të Përhershme të Bashkimit, Këshilli i Operacioneve Postare, në sesionin e tij të parë pas Kongresit, do të përgatisë një program pune bazë që përmban një numër të caktuar taktikash me qëllim realizimin e strategjive. Ky program pune bazë, që do të përfshijë një numër të caktuar projektesh mbi subjekte kryesore dhe me interes të përbashkët, do të rishikohet çdo vit në funksion të realitetit dhe të prioriteteve të reja;

11. Me qëllimin sigurimin një lidhje midis punës së të dy organeve, Këshilli drejtues mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare me cilësinë e vëzhguesit.

12. Nëse kërkohet prej tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e Komisioneve të Këshillit të Operacioneve Postare:

12.1 anëtarët e Këshillit drejtues;

12.2 anëtarët e Komitetit Këshillimor;

12.3 organizma ndërqeveritare të interesuara për punimet e Këshillit të Operacioneve Postare;

12.4 shtete të tjera anëtare të Bashkimit;

13. Për arsye logjistike, Këshilli i Operacioneve Postare mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

14. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të marrin pjesë efektivisht në punimet e mbledhjeve. Vëzhguesit munden, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë disa Grupe Pune dhe Ekiye Projektësh, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve bëhet pa shpenzime shtesë nga Bashkimi.

15. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Duhet e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

16. Kryetari i Komitetit Këshillimor përfaqëson atë organ në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare kur rendi i ditës përmban çështje që i interesojnë Komitetit Këshillimor.

17. Këshilli i Operacioneve Postare mund të ftojë sa më poshtë në mbledhjet e saj, pa të drejtë vote:

17.1 çdo organizëm ndërkombëtar ose çdo person të kualifikuar i cili dëshiron të bashkohet me punimet e tij;

17.2 çdo shtet anëtar që nuk bëjnë pjesë në Këshillin e Operacioneve Postare;

17.3 çdo shoqatë apo sipërmarrje që dëshiron njihet konsultohet në lidhje me punimet e tij.



Neni V

(neni 105 i amenduar)

Informacion mbi veprimtarinë e Këshillit të Operacioneve Postare

1. Pas çdo sesioni, Këshilli i Operacioneve Postare do të njoftojë shtetet anëtare, operatorët e tyre të caktuar, Sindikatat e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor mbi veprimtarinë e tij duke i dërguar atyre, *inter alia*, një përmbledhje analitike dhe rezolutat dhe vendimet e tyre.

2. Këshilli i Operacioneve Postare do të përgatisë një raport vjetor mbi punën e tij për Këshillin drejtues.

3. Këshilli i Operacioneve Postare përpilon, për Kongresin, një raport përmbledhës për punën e tij dhe ja dërgon shteteve anëtare, operatorëve të tyre caktuar si dhe anëtarëve të Komitetit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni VI

(neni 106 i amenduar)

Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të përfaqësojë interesat e sektorit ndërkombëtar postar në kuptimin e gjerë dhe ofrojë një kuadër për një dialog efikas ndërmjet grupeve të interesuar. Ai përbëhet nga organizata joqeveritare që përfaqësojnë klientë, furnitorë të shërbimeve të shpërndarjes, organizata të punëtorëve, furnitorë të mallrave dhe të shërbimeve për sektorin dhe shërbimet postare, dhe disa organizma të ngjashme të personave dhe shoqërive të cilat kanë interes në mbështetjen e misionit dhe objektivave të Bashkimit. Nëse këto organizata janë të regjistruara, ato duhen të jenë të regjistruara në një shtet anëtar të Bashkimit. Këshilli drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare do të caktojë anëtarët e në Këshillat e tyre përkatës si anëtar të Komitetit Këshillimor. Përveç anëtarëve të caktuar nga Këshilli drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor do të përcaktohet me paraqitjen e kërkesës dhe të pranimit të kësaj të fundit, nga Këshilli drejtues dhe e realizuar në përputhje me nenin 102.6.31.

2. Çdo anëtar i Komitetit Këshillimor do të caktojë përfaqësuesin e tij.

3. Shpenzimet për funksionimin e Komitetit Këshillimor do të ndahen midis Bashkimit dhe anëtarëve të Komitetit, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Këshilli drejtues.

4. Anëtarët e Komitetit Këshillimor nuk do të marrin asnjë pagë apo shpërblim.

5. Komiteti Këshillimor do të riorganizohet pas çdo Kongresi, në përputhje me kuadrin e përpiluar nga Këshilli drejtues. Kryetari i Këshillit drejtues drejton mbledhjen për organizimin e Komitetit këshillimor, gjatë të cilës do të zgjidhet kryetari i Komitetit në fjalë.

6. Komiteti Këshillimor përcakton organizimin e vet të brendshëm dhe harton rregulloren e tij të brendshme, duke ju referuar parimeve bazë të Bashkimit dhe subjekt i miratimit të Këshillit drejtues, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare.

7. Komiteti Këshillimor do të mbledhet dy herë në vit. Në parim, mbledhjet do të zhvillohen në selinë e Bashkimit në të njëjtën kohë me sesionet e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Data dhe vendi i çdo mbledhje do të vendosen nga Kryetari i Komitetit këshillimor, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

8. Komiteti Këshillimor harton programin e tij brenda kuadrit të kompetencave si më poshtë:

8.1 të shqyrtojë dokumente dhe raporte të Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Në rrethana të jashtëzakonshme, e drejta për të marrë disa dokumente mund të jetë e kufizuar nëse konfidencialiteti i çështjes së mbledhjes ose i dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga organi i interesuar ose kryetari i tij. Situatat rast pas rasti do të raportohen në Këshillim drejtues, dhe në Këshillin e Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për Këshillin e Operacioneve Postare. Nëse e gjykon të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishikojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare;

8.2 të drejtojë studimin dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme për anëtarët e Komitetit Këshillimor;

8.3 të shqyrtojë çështje që prekin sektorin e shërbimeve postare dhe të paraqesë raporte mbi këto çështje;

8.4 të sigurojë të dhëna për punët e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare, duke përfshirë paraqitjen e raporteve dhe rekomandimeve dhe të japë opinione me kërkesën e dy Këshillave;

8.5 të bëjë rekomandime për Kongresin, subjekt i miratimit të Këshillit drejtues dhe, kur janë të përfshira çështje që i interesojnë Këshillit të Operacioneve Postare, subjekt i shqyrtimit dhe komenteve të Këshillit të Operacioneve Postare.

9. Kryetari i Këshillit Drejtues dhe Kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojnë këto organe në mbledhjet e Komitetit Këshillimor kur rendi i ditës së këtyre mbledhjeve përmban çështje që i interesojnë këtyre organeve.

10. Me qëllim sigurimin një lidhje ndërmjet organeve të Bashkimit, Komiteti Këshillimor mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Kongresit, Këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komiteteve përkatëse të tyre, me cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.

11. Nëse kjo kërkohet, anëtarët e Komitetit Këshillimor mund të marrin pjesë në sesionet plenare dhe mbledhjet e Komitetit të Këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare në përputhje me nenet 102.16 dhe 104.12. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në punimet e grupeve të punës sipas kushteve të vendosura nga nenet 102.18 dhe 104.14. Anëtarët e Këshillit Këshillimor mund të marrin pjesë në Kongres si vëzhgues pa të drejtë vote.

12. Nëse kërkohet prej tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e Komisionit Këshillimor:

12.1 anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare dhe Këshillit drejtues;

12.2 organizma ndërqeveritare të interesuara për punimet e Komitetit Këshillimor;

12.3 Sindikatat e Kufizuara;

12.4 shtete të tjera anëtare të Bashkimit;

13. Për arsye logjistike, Komiteti Këshillimor mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

14. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Kur e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

15. Byroja Ndërkombëtare, nën përgjegjësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, do të sigurojë sekretariatin e Komitetit Këshillimor.

Neni VII

(neni 107 i amenduar)

Informacione mbi veprimtarinë e Komitetit Këshillimor

1. Pas çdo mbledhje, Komiteti këshillimor njofton Këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare për veprimtarinë e tij duke i dërguar Kryetarëve të këtyre organeve, *inter alia*, një përmbledhje analitike të mbledhjeve të tij si dhe rekomandime dhe mendime.

2. Komiteti këshillimor i bën Këshillit drejtues një raport për veprimtarinë vjetore dhe i dërgon një kopje Këshillit të Operacioneve Postare. Ky raport do të përfshihet në dokumentacionin e Këshillit drejtues që u shpërndahet shteteve anëtare të Bashkimit, operatorëve të tyre të caktuar dhe Sindikatave të kufizuara, në përputhje me nenin 103.

3. Komiteti këshillimor bën për Kongresin një raport mbi gjithë aktivitetin e tij dhe ia dërgon atë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.



Neni VIII

(neni 110 i amenduar)

Gjuhët e përdorura për dokumentacionin, për debatet dhe korrespondencën zyrtare

1. Për dokumentacionin e Bashkimit do të përdoren gjuhët franceze, angleze, arabe dhe spanjolle. Përdoren gjithashtu gjuhët gjermane, kineze, portugeze dhe ruse, me kushtin që vetëm dokumentacioni më i rëndësishëm bazë të prodhohet në këto gjuhë. Mund të përdoren gjuhë të tjera, me kushtin që shtetet anëtare që kanë bërë kërkesën të mbulojnë të gjithë kostot e kësaj.

2. Shteti ose shtetet anëtare që kërkojnë një gjuhë të ndryshme nga ajo zyrtare formojnë një grup gjuhësor.

3. Dokumentacioni publikohet nga Byroja Ndërkombëtare në gjuhën zyrtare dhe në gjuhët e grupeve gjuhësore të formuara sipas rregullave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmjetësimit e zyrave rajonale të këtyre grupeve në përputhje me procedurat e rëna dakord me Byronë Ndërkombëtare. Publikimi në gjuhë të ndryshme bëhet sipas një standardi të përbashkët.

4. Dokumentacioni i publikuar drejtpërdrejt nga Byroja Ndërkombëtare, për sa është e mundur, do të shpërndahet në të njëjtën kohë në gjuhët e ndryshme të kërkuara.

5. Korrespondencat midis shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar dhe Byrosë Ndërkombëtare dhe midis kësaj të fundit dhe të tretëve mund të shkëmbehen në çdo gjuhë për të cilën Byroja Ndërkombëtare disponon një shërbim përkthimi.

6. Shpenzimet e përkthimit në çfarëdo gjuhë, duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga zbatimi i paragrafit 5, do të mbulohen nga grupi gjuhësor që ka kërkuar për atë gjuhë. Shtetet anëtare që përdorin gjuhën zyrtare do të paguajnë, për qëllimet e përkthimit të dokumenteve jo zyrtarë, një kontribut, shuma e të cilit për njësi kontribuimi të jetë e barabartë me atë shumë që mbulohet nga shtetet anëtare duke ju referuar gjuhës tjetër që përdoret nga Byroja Ndërkombëtare. Të gjitha shpenzimet e tjetra që kanë të bëjnë me dhënien e dokumenteve mbulohen nga Bashkimi. Tavani i shpenzimeve, që mbulohen nga Bashkimi për dokumentacionin në gjuhën kineze, gjermane, portugeze dhe ruse do të caktohet me një rezolutë të Kongresit.

7. Kostot që vijnë nga një grup gjuhësor do të ndahen midis anëtarëve të këtij grupi në proporcion me kontributin e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Këto kosto mund të ndahen midis anëtarëve të grupit gjuhësor sipas një baze tjetër ndarjeje, me kusht që shtetet anëtare të interesuara të bien dakord për këtë dhe të informojnë Byronë Ndërkombëtare për vendimin e tyre me anë të ndërmjetësimit të zëdhënësit të grupit.

8. Byroja Ndërkombëtare do të zbatojë çdo ndryshim në zgjedhjen e gjuhës së kërkuar nga një shtet anëtar pas një afati që nuk duhet të kalojë dy vjet.

9. Për diskutimet në mbledhjet e organeve të Bashkimit, do të jenë të pranueshme gjuhët franceze, angleze dhe ruse, me kushtin e prezencës së një sistemi interpretimi - me ose pa pajisje elektronike - zgjedhja e të cilës është lënë në vlerësimin e organizatorëve të mbledhjes pas këshillimit me Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe të shteteve anëtare të interesuara.

10. Për diskutimet dhe mbledhjet e përmendura në paragrafin 9 do të jenë të autorizuar edhe gjuhë të tjera.

11. Delegacionet që përdorin gjuhë të tjera sigurojnë përkthimin simultan në një nga gjuhët e përmendura në paragrafin 9, ose nëpërmjet sistemit të cituar në të njëjtin paragraf, kur mund të realizohen ndryshimet e nevojshme teknike, ose nga përkthyes të veçantë.

12. Kostot e shërbimeve të përkthimit do të ndahen midis shteteve anëtare që përdorin të njëjtën gjuhë në proporcion me kontributet e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Megjithatë, shpenzimet e instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve teknike do të mbulohen nga Bashkimi.

13. Shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar të tyre mund të bien dakord mbi çështjen e gjuhës që do të përdoret në korrespondencat zyrtare në marrëdhëniet e tyre reciproke. Kur kjo lloj marrëveshje nuk arrihet, gjuha që do të përdoret do të jetë gjuha frënge.

Neni IX

(neni 112 i amenduar)

Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm organizon, administron dhe drejton Byronë Ndërkombëtare, pra ai është përfaqësuesi i saj ligjor. Ai ka kompetencën për të renditur postet e gradës G 1 deri në D 2 dhe për të emëruar

dhe rritur në detyrë funksionarët e këtyre gradave. Për emërimet e gradave P 1 deri në D 2, ai duhen marrë në konsideratë kualifikimet profesionale të kandidatëve të rekomanduar nga shtetet anëtare shtetas të së cilëve ata janë ose në të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional, duke konsideruar një ndarje të barabartë gjeografike për kontinentet dhe gjuhët. Postet e gradës D 2 duhet, për sa është e mundur, të plotësohen nga kandidatë me prejardhje nga rajone të ndryshme nga ai i origjinës së Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, duke pasur parasysh konsiderimin suprem të efikasitetit të Byrosë Ndërkombëtare. Në rastin e posteve që kërkojnë kualifikime speciale, Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë aplikime në shtete të tjera. Në emërimin e një funksionari të ri, ai do të konsiderojë gjithashtu që, në parim, personat që zënë postet e gradave D 2, D 1 dhe P 5 të jenë shtetas nga shtete të ndryshme të Bashkimit. Në rritjen në detyrë të një funksionari në gradat D 2, D 1 dhe P 5, nuk do të jetë i detyruar të zbatojë të njëjtin parim. Për më tepër, kërkesat e një shpërndarje të barabartë gjeografike dhe të gjuhëve do të renditen pas meritës në procesin e rekrutimit. Drejtori i përgjithshëm njofton Këshillin drejtues një herë në vit për emërimet dhe rritjet në detyrë në gradat P 4 deri në D 2.

2. Drejtori i përgjithshëm ka kompetencat e mëposhtme:

2.1 të veprojë si depozitues i Akteve të Bashkimit dhe si ndërmjetës në procedurën e miratimit dhe të pranimit dhe të tërheqjes nga Bashkimi;

2.2 të njoftojë vendimet e marra nga Kongresi për gjithë qeveritë e shteteve anëtare;

2.3 të njoftojë të gjithë shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar mbi Rregulloret e shfuqizuara ose të rishikuara nga Këshilli i Operacioneve Postare;

2.4 të përgatisë projektin e buxhetit vjetor të Bashkimit në nivelin më të ulët të mundshëm në pajtim me nevojat e Bashkimit dhe ta paraqesë në kohën e duhur për shqyrtim në Këshillin drejtues; ti paraqesë buxhetin shteteve anëtare të Bashkimit pas miratimit nga Këshilli drejtues dhe ta realizojë atë;

2.5 të kryejë veprimtari të veçanta të kërkuara prej organeve të Bashkimit dhe ato që i janë caktuar me anë të Akteve;

2.6 të marrë iniciativat për realizimin e objektivave të caktuara nga organet e Bashkimit, brenda kuadrit të politikës së vendosur dhe të fondeve të disponueshme;

2.7 të japë sugjerime dhe propozime Këshillit drejtues ose Këshillit të Operacioneve Postare;

2.8 të paraqesë, në Këshillin e Operacioneve Postare, pas mbylljes së Kongresit, propozimet që kanë të bëjnë me ndryshimet e Rregulloreve sipas vendimeve të Kongresit, në përputhje me Rregullat e Procedurës së Këshillit të Operacioneve Postare;

2.9 të përgatisë, për Këshillin e Operacioneve Postare dhe mbi bazën e direktivave të dhëna nga Këshillat, projekt Strategjinë që do të paraqitet në Kongres;

2.10 të përgatisë, për miratim nga Këshilli Drejtues, një raport katër vjeçar mbi performancën e shteteve anëtare mbi Strategjinë e Bashkimit të miratuar nga Kongresi paraardhës, i cili do të paraqitet në Kongresin e radhës;

2.11 të sigurojë përfaqësimin e BASHKIMIT;

2.12 të veprojë si ndërmjetës në marrëdhëniet midis;

- UPU dhe Sindikatave të kufizuara;

- UPU dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

- UPU dhe organizatave ndërkombëtare, veprimtaritë e të cilave paraqesin interes për Bashkimin;

- UPU dhe organizmave ndërkombëtare, shoqatave ose sipërmarrjeve që organet e Bashkimit dëshirojnë ti konsultojnë ose të bashkëpunojnë;

2.13 të marrë përsipër funksionin e Sekretarit të përgjithshëm të organeve të Bashkimit, sipas dispozitave të posaçme të Rregullores së Përgjithshme, veçanërisht:

- në përgatitjen dhe organizimin e punës së organeve të Bashkimit;

- në shqyrtimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, raporteve dhe proces-verbaleve;

- në funksionimin e sekretariatit gjatë mbledhjeve të organeve të Bashkimit;

2.14 të ndihmojë në mbledhjet e organeve të Bashkimit dhe të marrë pjesë në diskutimet pa të drejtë vote, duke pasur mundësinë e përfaqësimit.



Neni X

(neni 114 i amenduar)

Sekretariati i organeve të Bashkimit (Kushtetuta 14, 15, 17, 18)

Sekretariati i organeve të Bashkimit do të realizohet nga Byroja Ndërkombëtare nën përgjegjësinë e Drejtorit të Përgjithshëm. Ai do të dërgojë të gjitha dokumentet e publikuar pas çdo sesiioni tek shtetet anëtare të organit dhe operatorët e tyre të caktuar, tek shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar të cilët, edhe pa qenë anëtarë të këtij organi, bashkëpunojnë në studimet e ndërmarra, tek sindikatat e Kufizuara si dhe tek shtetet e tjera anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar që bëjnë kërkesë për to.

Neni XI

(neni 116 i amenduar)

Informacioni. Opinionet. Kërkesat për interpretimin dhe amendim të Akteve. Anketimet. Roli në likuidimin e llogarive (Kushtetuta 20, Rregullore e përgjithshme 124, 125, 126)

1. Byroja Ndërkombëtare do të jetë në çdo kohë në dispozicion të Këshillit drejtues, të Këshillit të Operacioneve Postare dhe të shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar për qëllimet e dhënies së gjithë informacionit të nevojshëm rreth çështjeve që kanë të bëjnë me shërbimin.

2. Në veçanti ai do të mbledhë, koordinojë, publikojë dhe shpërndajë informacionet e çdo natyre në interes të shërbimit ndërkombëtar postar, të japë, me kërkesën e palëve të përfshira, një mendim mbi çështje në konflikt, të veprojë për kërkesat për interpretimin dhe amendimin e Akteve të Bashkimit dhe, në përgjithësi, të realizojë ato studime dhe punë dokumentare ose editoriale që i caktohen nga aktet në fuqi ose siç mund ti referohet në interes të Bashkimit.

3. Ai vepron gjithashtu mbi anketimet që kërkohen nga shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për përfitimin e pikëpamjeve të shteteve të tjera anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar mbi një çështje të caktuar. Rezultati i një ankete nuk merr karakterin e një vote dhe nuk do të jetë formalisht detyruese.

4. Ai mund të veprojë si zyrë qendrore për likuidimin e llogarive të çdo lloji në lidhje me shërbimin postar.

Neni XII

(neni 118 i amenduar)

Formularë të dhënë nga Byroja Ndërkombëtare

Byroja Ndërkombëtare do të jetë përgjegjëse për prodhimin e kuponave të përgjigjeve ndërkombëtare dhe të furnizimit, me çmim shitje, të shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar që i kanë porositur ato.

Neni XIII

(neni 119 i amenduar)

Aktet e Sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshje të Posaçme (Kushtetuta 8)

1. Dy kopje të Akteve të sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshjeve të posaçme të realizuara sipas nenit 8 të Kushtetutës duhet që t'i transmetohen Byrosë Ndërkombëtare nëpërmjet zyrave të këtyre Sindikatave ose, kur kjo nuk arrihet, nëpërmjet një pale kontraktuese.

2. Byroja Ndërkombëtare kujdesen që Aktet e sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshjet e posaçme të mos parashikojnë kushte më pak të favorshme për publikun se ato që janë parashikuar në Aktet e Bashkimit dhe informon shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për ekzistencën e Unioneve dhe Marrëveshjeve të mësipërme. Ai sinjalizon në Këshillin drejtues për çdo parregullsi të konstatuar gjatë zbatimit të kësaj dispozite.

Neni XIV

(neni 121 i amenduar)

Raporti dyvjeçar mbi punën e Bashkimit (Kushtetuta 20, Rreg. e përgjithshme 102.6.17)

Byroja Ndërkombëtare do të realizojë një raport dyvjeçar mbi veprimtarinë e Bashkimit i cili do të dërgohet, pas miratimit nga Këshilli drejtues, shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, Sindikatave të kufizuara dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni XV

(neni 122 i amenduar)

Procedura e paraqitjes së propozimeve në Kongres (Kushtetuta 29)

1. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara sipas paragrafëve 2 dhe 5, procedura e mëposhtme rregullon paraqitjen e propozimeve të çdo natyre në Kongres nga shtetet anëtare:

a) do të pranohen propozimet që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para datës së caktuar për Kongresin;

b) nuk do të pranohet asnjë propozim gjatë periudhës prej gjashtë muajsh para datës së caktuar për Kongresin;

c) nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet gjashtë dhe katër muajve para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur mbështeten nga të paktën dy shtete anëtare;

d) nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet katër dhe dy muaj para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur ato mbështeten nga të paktën nga tetë shtete anëtare; propozimet që mbërrijnë pas kësaj periudhe nuk do të pranohen;

e) deklaratat mbështetëse duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare brenda të njëjtën periudhë me propozimet të cilave i referohen.

2. Propozimet që kanë të bëjnë me Kushtetutën ose Rregulloren e Përgjithshme duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para hapjes së Kongresit; propozimet që mbërrijnë pas kësaj date por para hapjes së Kongresit mund të merren në konsideratë vetëm nëse Kongresi vendos me shumicë prej dy të tretash të shteteve të përfaqësuara në Kongres dhe me përjashtim të rastit kur janë përmbushur kushtet e parashikuara sipas paragrafit 1.

3. Si rregull, çdo propozim duhet të ketë vetëm një qëllim dhe të përmbajë vetëm ndryshimet e justifikuara nga ky qëllim. Në të njëjtën mënyrë, çdo propozim që mund të sjellë kosto të mëdha për Bashkimin do të shoqërohet nga indikacione të ndikimit të tij financiar, të përgatitur nga shteti anëtar që paraqet propozimin në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare, në mënyrë që të përcaktohen burimet financiare të nevojshme.

4. Hartimet e propozimeve do të titullohen «Draft Propozime» nga shtetet anëtare që i paraqesin dhe do të publikohen nga Byroja Ndërkombëtare me një numër të ndjekur nga shkronja R. Propozimet që nuk do të kenë këtë lloj shënimi por që, sipas mendimit të Byrosë Ndërkombëtare, prekin vetëm me hartimin e pikave do të publikohen me një shënim të posaçëm; Byroja Ndërkombëtare do të përpilojë një listë të këtyre propozimeve për Kongresin.

5. Procedura e përshkruar në paragrafët 1 dhe 4 nuk do të zbatohet për propozimet që kanë të bëjnë me Rregullat e Procedurës së Kongreseve ose për amendamentet e propozimeve të bëra.

Neni XVI

(neni 123 i amenduar)

Procedura e paraqitjes të propozimeve që kanë të bëjnë me përgatitjen e Rregulloreve të reja nën dritën e vendimeve të marra nga Kongresi në Këshillin e Operacioneve Postare

1. Rregullorja e Konventës Postare Universale dhe Marrëveshja e shërbimeve të pagesës postare do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi.

2. Propozimet që rrjedhin nga amendamentet e propozuara në Konventës ose të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesës Postare duhet ti kalohen Byrosë Ndërkombëtare në të njëjtën kohë me propozimet e Kongresit me të cilat ato kanë lidhje. Ato mund të paraqiten nga një shtet anëtar pa mbështetjen e shteteve të



tjera anëtare. Këto propozime duhet të shpërndahen në të gjithë vendet anëtare, jo më vonë se një muaj para Kongresit.

3. Propozimet e tjera që prekin Rregulloret, për tu shqyrtuar nga Këshilli i Operacioneve Postare për përpilimin e rregulloreve të reja brenda gjashtë muajve pas Kongresit duhet ti paraqiten në Byrosë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para Kongresit.

4. Propozimet për ndryshime në Rregulloret të kërkuara si rezultat i vendimeve të Kongresit, që janë paraqitur nga shtetet anëtare, duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare jo më vonë se dy muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare. Këto propozime duhet t'i shpërndahen të gjithë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, jo më vonë se një muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare.

Neni XVII

(neni 124 i amenduar)

Procedura e paraqitjes së propozimeve ndërmjet Kongreseve (Kushtetuta 29, Rreg. e Përgj. 116)

1. Çdo propozim në lidhje me Konventën ose Marrëveshjet i propozuar nga një shtet anëtar ndërmjet Kongreseve, që të merret në konsideratë duhet të mbështetet nga të paktën dy shtete të tjera anëtare. Këto propozime do të lihen mënjanë nëse Byroja Ndërkombëtare nuk merr, në të njëjtën kohë, numrin e duhur të deklaratave të mbështetjes.

2. Këto propozime i dërgohen shteteve të tjera anëtare nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare.

3. Propozimet që prekin Rregulloret nuk do të kenë nevojë për mbështetje, por nuk do të merren në konsideratë nga Këshilli i Operacioneve Postar, me përjashtim të rastit kur ky i fundit është dakord me nevojën urgjente.

Neni XVIII

(neni 125 i amenduar)

Shqyrtim i propozimeve ndërmjet Kongreseve (Kushtetuta 29, Rreg. e përgj. 116, 124)

1. Çdo propozim në lidhje me Konventën, Marrëveshjet dhe Protokollet finale i nënshtrohet procedurës së mëposhtme: kur një shtet anëtar ka dërguar një propozim në Byronë Ndërkombëtare, kjo e fundit ja transmeton atë të gjitha shteteve anëtare për shqyrtim. Ata kanë në dispozicion një afat prej dy muajsh për të shqyrtuar propozimet dhe, në rast nevojë, për të dërguar vërejtjet e tyre në Byronë Ndërkombëtare. Amendamentet nuk do të pranohen. Pas përfundimit të të këtij afati prej dy muajsh, Byroja Ndërkombëtare i transmeton shteteve anëtare gjithë vërejtjet që ka marrë dhe fton secilin prej shteteve anëtare me të drejtë vote të votojë pro ose kundër propozimit. Shtetet anëtare që nuk kanë dërguar votën e tyre brenda një afati prej dy muajsh do të konsiderohen si abstenuese. Afatet e mësipërme do të fillojnë nga data e qarkoreve të Byrosë Ndërkombëtare.

2. Propozimet për amendimin e Rregulloreve do të trajtohen nga Këshilli i Operacioneve Postare.

3. Nëse propozimi ka të bëjë me një Marrëveshje ose Protokollin përfundimtar të saj, vetëm shtetet anëtare që janë palë e asaj Marrëveshje mund të marrin pjesë në procedurën e përshkruar në paragrafin 1.

Neni XIX

(neni 126 i amenduar)

Njoftimi i vendimeve të marra ndërmjet Kongreseve (Kusht. 29; Rreg. e Përgj. 124, 125)

1. Amendamentet për Konventën, Marrëveshjet dhe Protokollet përfundimtare të këtyre Akteve, do të sanksionohen nëpërmjet një njoftimi të Drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare për Qeveritë e shteteve anëtare.

2. Amendamentet e realizuara nga Këshilli i Operacioneve Postare në Rregulloret dhe në Protokollet përfundimtare të tyre i njoftohen shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar nëpërmjet Byrosë ndërkombëtare. E njëjta procedurë do të zbatohet në interpretimet e referuara në nenin 36.3.2 të Konventës dhe në dispozitat përkatëse të Marrëveshjeve.

Neni XX

(neni 128 i amenduar)

Vendosja dhe rregullimi i shpenzimeve të Bashkimit (Kusht. 22)

1. Subjekt i dispozitave të paragrafëve 2 deri në 6, shpenzimet vjetore që lidhen me aktivitetet e organeve të Bashkimit nuk duhet të kalojnë shumat e mëposhtme për vitin 2009 dhe në vazhdim: 37,000,000 franga zvicerane për vitet 2009 dhe 2010 dhe 37,235,000 franga zvicerane për vitet 2011 dhe 2012. Kufiri bazë për 2012 do të zbatohet gjithashtu për vitet që e pasojnë në rast se Kongresi i planifikuar për 2012 shtyhet.

2. Shpenzimet që lidhen me thirrjen e Kongresit të ardhshëm (shpenzime të transportit të sekretariatit, shpenzime të transportit, shpenzime të instalimit të pajisjeve të përkthimit simultan, kosto të riprodhimit të dokumentacionit gjatë Kongresit, etj.) nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 2,900,000 franga zvicerane.

3. Këshilli drejtues është i autorizuar të tejkalojë kufirin e caktuar sipas paragrafëve 1 dhe 2, duke pasur parasysh rritjet e shkallëve të pagës, të kontributeve për pensionet apo shpërblimet, përfshirë aty dhe rregullimet e posteve, të miratuara nga Kombet e Bashkuara për zbatim ndaj personelit të tyre në Gjenevë.

4. Këshilli drejtues do të jetë gjithashtu i autorizuar për të paguar, çdo vit, shumën e shpenzimeve të ndryshme nga ato të personelit, sipas indeksit zviceran të çmimit të konsumimit.

5. Pavarësisht paragrafit 1, Këshilli drejtues, ose në rast urgjence ekstreme Drejtori i përgjithshëm, mund të autorizojë tejkalimin e kufijve të caktuar për të përballuar kostot e riparimeve të rëndësishme dhe të paparashikuara të ndërtesës të Byrosë Ndërkombëtare, megjithatë me kusht që shumat e tejkalimit të mos tejkalojnë shumën prej 125,000 franga zvicerane në vit.

6. Nëse krediti i parashikuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 janë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin e mirë të Bashkimit, këto nivele mund të tejkalohen me miratimin e shumicës së shteteve anëtare të Bashkimit. Çdo këshillim duhet të përfshijë një përshtkrim të plotë të plotë të fakteve që justifikojnë këtë kërkesë.

7. Shtetet që hyjnë në Bashkim ose që janë pranuar në cilësinë e anëtarit të Bashkimit, si dhe ato që dalin nga Bashkimi duhet të paguajnë kontributet e tyre për gjithë vitin gjatë të cilit pranimi ose dalja në Bashkim bëhet efektiv.

8. Shtetet anëtare do të paguajnë parapagim pjesën e tyre të kontributeve për shpenzimet vjetore të Bashkimit, në bazë të buxhetit të hartuar nga Këshilli drejtues. Këto kontribute duhet të jenë paguar jo më vonë se dita e parë e vitit financiar të cilit i referohet buxheti. Pas këtij afati, shumat e detyruara do të ngarkohen me interes në favor të Bashkimit me normë 6% në vit duke filluar nga muaji i katërt.

9. Kur kontributet e prapambetura dhe të detyrueshme, pa përfshirë interesin, që një shtet anëtar që i detyrohet Bashkimit, janë të barabarta ose më të larta se shumat e kontributeve të atij shteti anëtar për të dy vitet financiare të mëparshëm, ky shtet anëtar mund t'i transferojë në mënyrë të pakthyeshme Bashkimit të gjithë ose një pjesë të kredive të shteteve të tjera anëtare në zotërim të tij, në përputhje me marrëveshjet e caktuara nga Këshilli drejtues. Kushtet e transferimit të kredive do të përcaktohen sipas një marrëveshje ndërmjet shtetit anëtar, debitorëve/kreditorëve të tij dhe Bashkimit.

10. Një shtet anëtar i cili, për arsye ligjore ose arsye të tjera, nuk mund të realizojnë këtë transferim, duhet të angazhohen të realizojnë një plan për amortizimin e llogarive të tij të prapambetura.

11. Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, mbledhja e kontributeve të prapambetura të detyrueshme që i detyrohen Bashkimit nuk mund të shtrihen për më shumë se dhjetë vjet.

12. Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli drejtues mund të çlirojë një shtet anëtar nga e gjitha ose një pjesë e interesave që detyrohet nëse ai shtet ka shlyer tërësisht principalin e debitit të tij të prapambetur.

13. Një shtet anëtar gjithashtu mund të çlirohet, brenda kuadrit të një plani amortizimi për llogaritë e tij të prapambetura të miratuara nga Këshilli drejtues, nga i gjithë ose një pjesë e interesave të akumuluar ose të grumbulluara; ky çlirim do të jetë, megjithatë, i varur nga realizimi i plotë dhe i përpiktë i planit të amortizimit në një afat të rënë dakord për një maksimum prej dhjetë vjetësh.

14. Për të mbuluar pamjaftueshmëritë në financat e Bashkimit, është krijuar një Fond Rezervë shumat e të cilit do të vendoset nga Këshilli drejtues. Ky Fond do të mbahet kryesisht nga tepricat e buxhetit. Ai mund të përdoret gjithashtu edhe për të ekuilibruar buxhetin ose për të ulur shumën e kontributeve të shteteve anëtare.



15. Për sa i përket pamjaftueshmërisë së përkohshme të financave, Qeveria e Konfederatës zvicerane do të kryejë parapagimet e nevojshme afatshkurtra, sipas kushteve që do të caktohen me marrëveshje të përbashkët. Kjo Qeveri do të mbikëqyrë, pa pagesë, librat dhe kontabilitetin e Byrosë Ndërkombëtare brenda kufijve të kredive të caktuara nga Kongresi.

16. Dispozitat e paragrafëve 9, 10, 11, 12 dhe 13 do të zbatohen me analogji për kostot e përkthimit të faturuara nga Byroja Ndërkombëtare për shtetet anëtare që i përkasin grupeve gjuhësore.

Neni XXI

(neni 130 i amenduar)

Klasat e kontributeve (Kusht. 21, Rreg. e Përgj. 115, 128)

1. Shtetet anëtare kontribuojnë për mbulimin e shpenzimeve të Bashkimit sipas klasave të kontributeve të cilave i përkasin. Këto klasa janë si më poshtë:

- klasë me 50 njësi;
- klasë me 45 njësi;
- klasë me 40 njësi;
- klasë me 35 njësi;
- klasë me 30 njësi;
- klasë me 25 njësi;
- klasë me 20 njësi;
- klasë me 15 njësi;
- klasë me 10 njësi;
- klasë me 5 njësi;
- klasë me 3 njësi;
- klasë me 1 njësi;

- klasë me 0, 5 njësi, e rezervuar për shtetet më pak të përparuara siç janë renditur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe për shtete të tjera të caktuara nga Këshilli drejtues.

2. Pavarësisht nga klasat e kontributeve të renditura në paragrafin 1, çdo shtet anëtar mund të zgjedhë të kontribuojë me një numër më të madh njësisë se ai që i korrespondon klasës së kontributit të cilës ai i përket, për një afat minimal të barabartë me periudhën midis Kongreseve. Njoftimi i ndryshimit do të bëhet jo më vonë se në Kongres. Në përfundim të periudhës midis Kongreseve, shteti anëtar do të kthehet automatikisht në numrin fillestar të kontributeve të tij me përjashtim të rastit kur ai vendos të mbajë kontributin e tij në një numër më të lartë njësisë. Pagesa e kontributeve shtesë do të rrisë shpenzimet në mënyrë proporcionale.

3. Shtetet anëtare do të jenë të përfshira në një nga klasat e kontributeve si më sipër në momentin e pranimit të tyre ose të pjesëmarrjes së tyre në Bashkim, sipas procedurës së caktuar në nenin 21.4 të Kushtetutës.

4. Shtetet anëtare mund të vendosen në një moment të dytë në një klasë më të ulët të kontributit, me kusht që kërkesa për këtë ndryshim të jetë dërguar në Byroën Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Kongresi do të japë një mendim jo detyrues mbi këto kërkesa për ndryshim në klasën e kontributeve. Shteti anëtar do të jetë i lirë të vendosë nëse do të ndjekë mendimin e Kongresit apo jo. Vendimi përfundimtar i shtetit anëtar do të transmetohet në Sekretariatit e Byrosë Ndërkombëtare para përfundimit të Kongresit. Kjo kërkesë për ndryshim do të bëhet efektive në datën e hyrjes në fuqi të dispozitave financiare të hartuara nga Kongresi. Shtetet anëtare të cilat nuk kanë bërë të ditur dëshirën e tyre për të ndryshuar klasën e kontributit brenda afateve të kërkuara, do të qëndrojnë në klasën e kontributit të cilës i përkasin deri në atë kohë.

5. Shtetet anëtare nuk mund të insistojnë për tu ulur më shumë se një klasë njëherësh.

6. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë katastrofat natyrore që kërkojnë programe të ndihmës ndërkombëtare, Këshilli drejtues mund të autorizojë një reduktim të përkohshëm të klasës vetëm një herë midis dy Kongreseve kur kjo kërkohet nga një shtet anëtar, nëse ky anëtar provon që nuk mund të mbajë kontributin e vet sipas klasës të zgjedhur fillimisht. Në të njëjtat rrethana, Këshilli drejtues mund, gjithashtu, të autorizojë reduktimi, nga klasa me 1 njësi, në klasën me 0,5 njësi.

7. Në zbatimin e dispozitave të parashikuara sipas paragrafit 6, reduktimi i përkohshëm i klasës, mund të autorizohet nga Këshilli drejtues për një periudhë maksimale prej dy vjetësh ose deri në Kongresin e ardhshëm, cilado nga të dyja të jetë e para. Me mbarimin e periudhës së caktuar, shteti për të cilin bëhet fjalë rikthehet automatikisht në klasën e tij të mëparshme.

8. Pavarësisht nga paragrafët 4 dh 5, ndryshimet në një klasë më të lartë nuk do të jenë subjekt i kufizimeve.

Neni XXII

(neni 131 i amenduar)

Pagesa e furnizimeve nga Byroja Ndërkombëtare (Rreg. e Përgj. 118)

Furnizimet e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare për shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar kundrejt pagesës duhet të paguhet brenda afatit më të shkurtër të mundshëm dhe jo më vonë se gjashtë muaj duke filluar nga dita e parë e muajit që vjen pas muajit në të cilin llogaria është dërguar nga Byroja. Me kalimin e këtij afati, shumat që duhet të paguhet do të ngarkohen me interes në favor të Bashkimit me një normë prej 5 % në vit, të llogaritur nga dita e mbarimit të afatit të mësipërm.

Neni XXIII

(neni 132 i amenduar)

Procedurat e arbitrazhit (Kusht. 32)

1. Nëse një mosmarrëveshje që të zgjidhet me arbitrazh, secili nga shtetet anëtare palë e çështjes zgjedh një shtet anëtar jo të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mosmarrëveshje. Në rastin kur shumë shtete anëtare kanë një çështje të përbashkët, ata do të llogariten si një i vetëm për qëllimet e kësaj dispozite.

2. Në rastin kur një nga shtetet anëtare palë e çështjes nuk vepron për një propozim arbitrazhi brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data e dërgimit të tij, Byroja Ndërkombëtare, nëse i kërkohet, do të bëjë thirrje shtetit anëtar në gabim për emërimin e një arbitri ose do ta emërojë vetë atë, *ex officio*.

3. Palët në çështje mund të bien dakord për të emëruar një arbitër të vetëm, i cili mund të jetë Byroja Ndërkombëtare.

4. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash.

5. Në rast të barazisë së votave, arbitrat do të zgjedhin, për të zgjidhur mosmarrëveshjen, një shtet tjetër anëtar, të pa interesuar në këtë çështje. Nëse ata nuk e arrijnë një marrëveshje mbi zgjedhjen, ky shtet anëtar do të emërohet nga Byroja Ndërkombëtare ndërmjet shteteve anëtare që nuk janë propozuar nga arbitrat.

6. Nëse një mosmarrëveshje ka të bëjë me një nga Marrëveshjet, arbitrat mund të emërohen vetëm midis shteteve anëtare që janë palë e asaj Marrëveshje.

7. Nëse një mosmarrëveshje duhet të zgjidhet me arbitrazh ndërmjet operatorëve të caktuar, operatorët e interesuar do të kërkojnë shteteve të tyre anëtare të veprojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafët 1 deri në 6.

Neni XXIV

(neni 135 i amenduar)

Amendimi, hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores së Përgjithshme

Amendamentet e miratuara nga Kongresi do të jenë subjekt i një protokolli shtesë dhe, me përjashtim të rastit kur Kongresi vendos ndryshe, do të hyjë në fuqinë të njëjtën kohë me Aktet e tjera të përditësuara gjatë të njëjtit Kongres.

Rregullorja e përgjithshme do të jetë vënë në zbatim më 1 Janar 2006 dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Neni XXV

Aderimi në Protokollin Shtesë

Shtetet anëtare që nuk e kanë nënshkruar këtë Protokolli mund të aderojnë në të në çdo kohë. Instrumentet përkatëse të aderimit do të depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, i cili do të njoftojë qeveritë e shteteve anëtare për depozitimin e tyre.



Neni XXVI

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Protokollit Shtesë të Rregullores së Përgjithshme

Ky Protokoll Shtesë do të hyjë në fuqi më 1 Janar 2010 dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

Në dëshmi të sa më sipër, të Plotfuqishmit e Qeverive të shteteve anëtare kanë hartuar këtë Protokoll Shtesë, i cili do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri sikur dispozitat e tij të ishin vendosur në testin e vetë Rregullores së përgjithshme, dhe e kanë nënshkruar atë në një kopje origjinale e cila do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje e tij do të dorëzohet çdo Pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Gjenevë, 12 gusht 2008.

RREGULLAT E PROCEDURËS SË KONGRESEVE

Përmbajtja

Neni

- 1 Dispozita të Përgjithshme
- 2 Delegacionet
- 3 Kredencialet e delegatëve
- 4 Rregulli i vendeve
- 5 Vëzhguesit *de jure*
- 6 Të ftuarit
- 7 Dekani i Kongresit
- 8 Kryesitë dhe zëvendës-kryesitë i Kongresit dhe Komiteteve
- 9 Byroja e Kongresit
- 10 Anëtarësimi i Komiteteve
- 11 Grupet e punës
- 12 Sekretariati i Kongresit dhe Komiteteve
- 13 Gjuha e debateve
- 14 Gjuhët e përdorura për hartimin e dokumenteve të Kongresit
- 15 Propozimet
- 16 Shqyrtimi i propozimeve në Kongres dhe në Komitete
- 17 Debatet
- 18 Mocionet për pikat e rendit dhe mocionet procedurale
- 19 Kuorumi
- 20 Parimi dhe procedura e votimit
- 21 Kushtet për miratimin e propozimeve
- 22 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit drejtues ose Këshillit të Operacioneve Postare
- 23 Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare
- 24 Raportet
- 25 Apeli i vendimeve të marra nga Komitetet dhe nga Kongresi
- 26 Miratimi i draft vendimeve nga Kongresi (Akte, rezoluta, etj.)
- 27 Caktimi i studimeve për Këshillin Drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare
- 28 Rezervimi për Aktet
- 29 Nënshkrimi i Akteve
- 30 Amendimi i Rregullave

RREGULLAT E PROCEDURËS SË KONGRESEVE

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Këto Rregulla të Procedurës, në vijim të quajtura «Rregullat», janë hartuar në bazë të Akteve të BASHKIMIT dhe janë të varura prej tyre. Në rast të mospërputhjeve midis njërës nga këto dispozita dhe një dispozite të Akteve, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 2

Delegacionet

1. Termi «delegacion» përfshin personin ose tërësinë e personave të caktuar nga shtetet anëtare për të marrë pjesë në Kongres. Delegacioni përbëhet nga një Kryetar delegacioni dhe, nëse është e arsyeshme, nga zëvendësi i tij, një ose më shumë të deleguar, dhe brenda mundësive, nga një ose më shumë funksionarë të atashuar (duke përfshirë ekspertë, sekretarë etj.).

2. Kryetarët e delegacioneve, zëvendësit e tyre, dhe të deleguarit do të jenë përfaqësues të shteteve anëtare, sipas nenit 14.2 të Kushtetutës, nëse ata kanë kredencialet sipas kushteve të nenit 3, të kësaj Rregulloreje.

3. Funksionarët e atashuar do të pranohen në seanca dhe do të kenë të drejtën të marrin pjesë në shqyrtime dhe diskutime, por ata zakonisht nuk do të kenë të drejtën e votës. Megjithatë, ata mund të autorizohen nga kryetari i delegacionit të tyre të votojnë në emër të shtetit të tyre në mbledhjet e Komisioneve. Këto autorizime, me shkrim, duhet ti dorëzohen, para fillimit të mbledhjes, Kryetarit të Komisionit të interesuar.

Neni 3

Kredencialet e të deleguarve

1. Kredencialet e të deleguarve duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Shtetit, Kryetari i Qeverisë ose nga Ministri i Punëve të Jashtme i shtetit të interesuar. Ato duhet të hartohen në formën e duhur dhe të përshtatshme. Kredencialet e të deleguarve me të drejtë për të nënshkruar Aktet (të plotfuqishëm), duhet të specifikojnë qëllimin e këtij nënshkrimi (nënshkrim subjekt i ratifikimit ose miratimit, nënshkrim *ad referendum*, nënshkrim përfundimtar). Në mungesë të një këtij informacioni specifik, nënshkrimi do të konsiderohet si subjekt i Aktet, do të përfshijnë edhe të drejtën e fjalës dhe të votës. Të deleguarit të cilëve autoritetet kompetente ju kanë dhënë të drejta të plota, pa specifikuar qëllimin e tyre do të kenë të drejtë të debatojnë, të votojnë dhe të nënshkruajnë Aktet, me përjashtim kur hartimi i kredencialeve është shprehimisht kundër kësaj.

2. Kredencialet do të depozitohen në hapje të Kongresit, pranë autoritetit të caktuar për këtë.

3. Të deleguarit që nuk disponojnë kredencialet, dhe ata që nuk i kanë depozituar kredencialet e tyre mund të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë që nga momenti i pjesëmarrjes së tyre në punimet e Kongresit, me kusht që emrat e tyre të jenë komunikuar nga Qeveritë e tyre tek Qeveria e Shtetit pritës. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për ata, kredencialet e të cilëve kanë parregullsi. Këta të deleguar nuk do të jenë të autorizuar të votojnë derisa Kongresi të miratojë raportin e fundit të Komitetit të Kredencialeve duke vendosur se kredencialet e tyre nuk janë marrë ose nuk janë të rregullta dhe deri sa situata e tyre të rregullohet. Raporti i fundit duhet të miratohet nga Kongresi para çfarëdo zgjedhje të ndryshme nga ajo e Kryetarit të Kongresit dhe para miratimit të projekt - Akteve.

4. Kredencialet e një shteti anëtar që përfaqësohet në Kongres nga delegacioni i një shteti tjetër anëtar (me prokurë) duhet të kenë të njëjtën formë si ato të përshkruara në paragrafin 1.

5. Kredencialet dhe prokurat e dërguara me telegram nuk do të pranohen. Megjithatë, do të pranohen telegramet e dërguara si përgjigje të një kërkesë për informacion në lidhje me kredencialet.

6. Një delegacion i cili, pasi ka depozituar kredencialet e tij, pengohet të marrë pjesë në një ose në disa seanca, mund të përfaqësohet nga një delegacion i një shteti tjetër anëtar, me kusht që të njoftojë me shkrim Kryetarin e mbledhjes në fjalë. Megjithatë, një delegacion mund të përfaqësojë vetëm një shtet tjetër, përveç shtetit të tij.



7. Të deleguarit e shteteve anëtare që nuk janë palë në një Marrëveshje mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e Kongresit, në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4
Rregulli i vendeve

1. Në mbledhjet e Kongresit dhe të Komisioneve, delegacionet do të vendosen sipas rendit alfabetik francez të shteteve anëtare të përfaqësuara.

2. Kryetari i këshillit drejtues tërheq me short, në kohën e duhur, emrin e shtetit që do jetë në krye, pranë tribunës së Kryesisë, gjatë seancave të Kongresit dhe të Komisioneve.

Neni 5
Vëzhguesit *de jure*

1. Përfaqësuesit e OKB do të pranohen si të ftuar, në cilësinë e vëzhguesit, për të marrë pjesë dhe asistuar në diskutimet e Kongresit.

2. Sindikatat e kufizuara do të pranohen në Kongres dhe në Komisionet e tij, në cilësinë e vëzhguesve.

3. Liga e Shteteve arabe dhe Unioni Afrikan (UA) do të pranohen në Kongres dhe në Komisionet e tij, në cilësinë e vëzhguesve.

4. Anëtarët e Komitetit Këshillimor do të pranohen në Kongres dhe në Komisionet e tij, në cilësinë e vëzhguesve.

5. Vëzhguesit, për të cilët flitet nga pika 1 deri në pikën 4, nuk do të kenë të drejtën e votës, por mund të marrin fjalën me autorizimin e Kryetarit të mbledhjes.

6. Në rrethana të jashtëzakonshme, mund të kufizohen të drejtat e vëzhguesve të referuar në pikën 4, për të marrë pjesë në disa mbledhje ose në disa pjesë mbledhjeje, nëse konfidencialiteti i çështjes së trajtuar e kërkon këtë. Ata duhet të informohen sa më shpejt të jetë e mundur. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti, nga organi i interesuar ose Kryetari. Këto vendime do të ekzaminohen nga Byroja e Kongresit, e cila do të ketë të drejtën të konfirmojë ose kundërshtojë me një shumicë të thjeshtë të votave.

Neni 6
Të ftuarit

1. Përfaqësuesit e institucioneve të specializuara të OKB dhe të organizmave ndër-qeveritare do të caktohen nga Këshilli drejtues për të asistuar në mbledhje specifike të Kongresit ose të Komisioneve të tij, kur diskutohen çështje me interes për këto organizata.

2. Përfaqësues të çdo organizmi ndërkombëtar dhe të çdo shoqate ose sipërmarrjeje, të çdo personi të kualifikuar, të caktuar sipas rregullave nga Këshilli drejtues, do të pranohen në mbledhje të veçanta të Kongresit ose të Komisioneve të tij.

3. Të ftuarit e referuar në pikat 1 dhe 2, nuk do të kenë të drejtën e votës, por mund të marrin fjalën me autorizimin e Kryetarit të mbledhjes.

Neni 7
Dekani i Kongresit

1. Shteti anëtar pritës të Kongresit, do të sugjerojë personin që do të emërohet si Dekan i Kongresit në marrëveshje me Byronë Ndërkombëtare. Këshilli drejtues do të miratojë, në një kohë të përshtatshme, këtë propozim.

2. Me hapjen e seancës së parë plenare të çdo Kongresi, Dekani do të veprojë si Kryetar i Kongresit, deri sa Kongresi të zgjedhë Presidentin e tij. Ai do të ushtrojë gjithashtu edhe funksionet që i atribuohen nga kjo rregullore.

Neni 8

Kryesitë dhe nën-kryesitë e Kongresit dhe të Komisioneve

1. Në seancën e tij të parë plenare, Kongresi zgjedh, me propozim të Dekanit, Kryetarin e Kongresit dhe pastaj miraton, me propozim të Këshillit drejtues, emërimin e shteteve anëtare që do të marrin nën-kryesimin e Kongresit, si edhe kryesimin dhe nën-kryesimin e Komisioneve. Këto poste jepen duke marrë parasysh, për sa është e mundur, një ndarje gjeografike të barabartë mes shteteve anëtare.

2. Kryetarët hapin dhe mbyllin seancat që ata kryesojnë, drejtojnë diskutimet, u japin fjalën oratorëve, vendosin votimin e propozimeve dhe bëjnë të ditur shumicën që duhet për miratimin e tyre, shpallin vendimet dhe, subjekt i miratimit të Kongresit, interpretojnë këto vendime nëse është e nevojshme.

3. Kryetarët do të kujdesen që kjo Rregullore të respektohet dhe mbajnë rregullin gjatë seancave.

4. Çdo delegacion mund të apelojë, para Kongresit ose Komisionit, kundër një vendimi të marrë nga Kryetari, sipas një dispozite ose interpretimi të Rregullores. Pavarësisht nga kjo, vendimi i Kryetarit do të jetë i vlefshëm, me përjashtim të rastit kur shfuqizohet vota e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

5. Nëse shteti anëtar i ngarkuar për kryesimin nuk është më në gjendje të përmbushë këtë funksion, një nga nën-kryetarët do të caktohet nga Kongresi ose nga Komisioni për ta zëvendësuar atë.

Neni 9

Byroja e Kongresit

1. Byroja do të jetë organi qendror i ngarkuar për të drejtuar punimet e Kongresit. Byroja përbëhet nga Kryetari dhe nën-Kryetarët e Kongresit dhe nga Kryetarët e Komiteteve. Ajo mblidhet rregullisht për të ekzaminuar zhvillimin e punimeve të Kongresit dhe të Komiteteve dhe për të formuluar rekomandimet që favorizojnë këtë zhvillim. Ajo ndihmon kryetarin në hartimin e rendit të ditës të çdo seance plenare dhe në koordinimin e punimeve të Komiteteve. Ajo bën rekomandime në lidhje me mbylljen e Kongresit.

2. Sekretari i përgjithshëm i Kongresit dhe Asistent Sekretari i përgjithshëm të përmendur në nenin 12.1, do të marrin pjesë në mbledhjet e Byrosë.

Neni 10

Anëtarët e Komiteteve

1. Shtetet anëtare të përfaqësuara në Kongres, sipas të drejtës, do të jenë anëtarë të Komiteteve përgjegjëse për ekzaminimin e propozimeve në lidhje me Kushtetutën, Rregulloren e Përgjithshme dhe Konventën.

2. Shtetet anëtare të përfaqësuara në Kongres që janë palë e një ose më shumë Marrëveshjeve fakultative, do të jenë anëtarë të një ose disa Komiteteve të ngarkuara me rishikimin e këtyre Marrëveshjeve. E drejta e votës të anëtarëve të këtij ose të këtyre Komiteteve do të kufizohet në Marrëveshjen ose Marrëveshjet në të cilat ata janë palë.

3. Delegacionet që nuk janë anëtare të Komiteteve që merren me Marrëveshjet mund të marrin pjesë në seancat e këtyre Komiteteve dhe të marrin pjesë në diskutime, pa të drejtë vote.

Neni 11

Grupet e punës

Kongresi dhe çdo Komitet mund të organizojnë Grupe pune për studimin e çështjeve speciale.

Neni 12

Sekretariati i Kongresit dhe i Komiteteve

1. Drejtori i përgjithshëm dhe zëvendës drejtori i përgjithshëm i Byrosë ndërkombëtare kryejnë edhe funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Asistentit të sekretarit të përgjithshëm të Kongresit.

2. Sekretari i përgjithshëm dhe Asistenti i sekretarit të përgjithshëm marrin pjesë në seancat e Kongresit dhe të zyrës së Kongresit, dhe marrin pjesë edhe në debatet pa të drejtë vote. Ata mund të marrin pjesë, me të njëjtat kushte, në seancat e Komiteteve ose të përfaqësohen nga një funksionar tjetër i Byrosë ndërkombëtare.



3. Punimet e Sekretariatit të Kongresit, Byrosë ndërkombëtare dhe të Komiteteve bëhen nga personeli i Byrosë ndërkombëtare, në bashkëpunim me shtetin anëtar pritës.

4. Funkionarët e lartë të Byrosë ndërkombëtare kanë edhe funksionet e Sekretarëve të Kongresit, Byrosë së Kongresit dhe të Komiteteve. Ata ndihmojnë Kryetarin gjatë seancave dhe janë përgjegjës për hartimin e raporteve.

5. Sekretarët e Kongresit dhe Komisioneve do të asistohen nga asistentët e Sekretarëve.

Neni 13

Gjuha e diskutimeve

1. Subjekt i paragrafit 2, gjuha franceze, angleze, spanjolle dhe ruse mund të përdoren gjatë diskutimeve, me anë të një sistemi të përkthimit simultan ose konsektiv.

2. Debatet e Komitetit të hartimit do të bëhen në gjuhën franceze.

3. Gjuhë të tjera mund të përdoren në diskutimet e përmendura në paragrafin 1. Gjuha e shtetit pritës do të ketë një të drejtë prioritare. Delegacionet përdorin gjuhë të tjera, duhet të marrin akorde për përkthimin simultan në një nga gjuhët e përmendura në paragrafin 1, qoftë me anë të sistemit të përkthimit simultan, kur bëhet fjalë për ndryshime teknike, ose me përkthyes të veçantë.

4. Shpenzimet e instalimit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve teknike janë në ngarkim të Bashkimit.

5. Shpenzimet e shërbimeve të përkthimit do të ndahen midis shteteve anëtare, që përdorin të njëjtën gjuhë, në proporcion me kontributin e tyre në shpenzimet e Bashkimit.

Neni 14

Gjuha e përdorur për hartimin e dokumenteve të Kongresit

1. Dokumentet e përgatitura gjatë Kongresit, duke përfshirë edhe projekt vendimet e paraqitura për miratim në Kongres, do të publikohen në gjuhën franceze nga sekretariati i Kongresit.

2. Për këtë qëllim, dokumentet që vijnë nga delegacionet e shteteve anëtare, duhet të paraqiten pranë sekretariatit të Kongresit në gjuhën frënge, qoftë direkt, qoftë me ndërmjetësinë e shërbimeve të përkthimit.

3. Shërbimet e mësipërme, të organizuara me shpenzimet e vetë grupeve gjuhësore të krijuara sipas dispozitave korresponduese të Rregullores së përgjithshme, mund të përkthejnë gjithashtu dokumente të Kongresit në gjuhët e tyre përkatëse.

Neni 15

Propozimet

1. Të gjitha çështjet e paraqitura para Kongresit, do të konsiderohen si propozime.

2. Të gjitha propozimet e publikuara nga Byroja ndërkombëtare para hapjes së Kongresit do të konsiderohen si të paraqitura në Kongres.

3. Dy muaj para hapjes së punimeve të Kongresit, nuk do të merret në konsideratë asnjë propozim, me përjashtim të atyre që amendojnë propozime të mëparshme.

4. Sa në vijim do të konsiderohet si amendament: çdo propozim i cili, pa ndryshuar thelbin e propozimit origjinal, përfshin një fshirje, një shtesë në një pjesë të propozimit origjinal ose rishikimin e këtij propozimi. Asnjë nga ndryshimet e propozuara nuk do të konsiderohet si një amendament nëse ai është i papajtueshëm me kuptimin ose qëllimin e propozimit origjinal. Në raste të dyshimta, i takon Kongresit ose Komitetit të vendosë për këtë çështje.

5. Amendamentet e paraqitura në Kongres, në lidhje me propozimet e bëra duhet të dorëzohen në Sekretariat me shkrim, në gjuhën franceze, para mesditës, një ditë para diskutimit, në mënyrë që tu shpërndahet në të njëjtën ditë delegatëve. Ky afat nuk zbatohet për amendamentet që vijnë drejtpërdrejt nga diskutimet në Kongres ose në një Komitet. Në rastin e fundit, nëse kjo kërkohet, autori i amendamentit duhet të paraqesë tekstin e tij me shkrim në gjuhën franceze, ose në rast vështirësie, në çdo gjuhë tjetër të përdorur për debate. Kryetari duhet ta lexojë me zë të lartë ose ta japë për lexim me zë të lartë.

6. Procedura e parashikuar në paragrafin 5 do të zbatohet gjithashtu për paraqitjen e propozimeve, që nuk kanë si qëllim mendimin e tekstit të Akteve (projekt-rezoluta, projekt rekomandime, projekte të opinioneve formale) kur këto propozime rezultojnë nga puna e Kongresit.

7. Çdo propozim ose amendament duhet të ketë formën përfundimtare të tekstit, që duhet të integrohet në Aktet e Bashkimit, subjekt, sigurisht, i rishikimit nga Komiteti i hartimit.

Neni 16

Shqyrtimi i propozimeve në Kongres dhe në Komitete

1. Hartimi i propozimeve (numri i të cilave do të ndiqet nga shkronja R), do ti atribuohen Komisionit të hartimit, qoftë direkt, nëse Byroja ndërkombëtare nuk ka dyshime për natyrën e tyre (një listë e këtyre propozimeve hartohet nga Byroja ndërkombëtare për Komisionin e hartimit), ose, nëse Byroja ndërkombëtare ka dyshime mbi natyrën e tyre, pasi Komitetet e tjera e kanë konfirmuar se ato kanë karakter thjesht hartues (një listë e këtyre propozimeve do të hartohet për Komitetet e interesuara). Megjithatë, nëse këto propozime janë të lidhura me propozime të tjera që do të trajtohen nga Kongresi ose nga Komitetet e tjera, Komiteti i hartimit do të shtyjë marrjen në konsideratë të tyre deri sa Kongresi ose Komitetet e tjera të kenë marrë një vendim mbi propozimet përkatëse të përmbajtjes. Propozimet, numri i të cilave nuk ndiqet nga shkronja R, por të cilat sipas mendimit të Byrosë ndërkombëtare janë propozime hartuese, i kalohen menjëherë Komisioneve të interesuara së bashku me propozimet që i korrespondojnë. Kur këto Komitete fillojnë punën, ato do të vendosin cilat nga këto propozime do t'i jepen Komitetit të hartimit. Një listë e këtyre propozimeve hartohet nga Byroja ndërkombëtare Komiteteve të interesuara.

2. Nëse e njëjta çështje është objekt i shumë propozimeve, Kryetari do të vendosë për rendin në të cilin ato do të diskutohen, duke filluar si rregull me propozimin që largohet më shumë nga teksti bazë dhe që përmban ndryshimet më të mëdha në raport me *status quo*-në.

3. Nëse një propozim mund të ndahet në shumë pjesë, secila prej tyre, me pëlqimin e autorit të propozimit ose të asamblesë, mund të ekzaminohet dhe të shprehet veçmas.

4. Çdo propozim i tërhequr në Kongres ose Komitet nga autori i saj mund të paraqitet sërish nga delegacioni i një shteti tjetër anëtar. Në mënyrë të ngjashme, nëse një amendament për një propozim pranohet nga autori i propozimit, një delegacion tjetër mund të paraqesë sërish propozimin origjinal të amenduar.

5. Çdo amendament për një propozim, i cili është pranuar nga delegacioni që e ka paraqitur këtë propozim, do të përfshihet menjëherë në tekstin e propozimit. Nëse autori i propozimit origjinal nuk e pranon amendamentin, Kryetari do të vendosë nëse do të votohet më parë amendamenti apo propozimi, duke u nisur nga ai që largohet më shumë nga kuptimi ose qëllimi i tekstit bazë dhe që sjell ndryshimin më të thellë në raport me *status quo*-në.

6. Procedura e përshkruar në paragrafin 5 do të zbatohet edhe kur janë paraqitur më shumë se një amendament për një propozim.

7. Kryetari i Kongresit dhe Kryetarët e Komiteteve kujdesen që Komiteti i hartimit, të marrë me shkrim, pas çdo seance, tekstin e shkruar të propozimeve, amendamenteve ose vendimeve të miratuara.

Neni 17

Diskutime

1. Të deleguarit nuk mund ta marrin fjalën deri sa të lejohen nga Kryetari i mbledhjes. Ata do të rekomandohen të flasin pa nxitim dhe qartë. Kryetari duhet t'ju sigurojë të deleguarve mundësinë e shprehjes së lirë dhe të plotë të mendimit të tyre mbi subjektin në diskutim, për sa është e pajtueshme me zhvillimin normal të diskutimeve.

2. Me përjashtim të rastit kur shumica e anëtarëve të pranishëm dhe votues vendosin ndryshe, fjalimet nuk mund të jenë më të gjata se 5 minuta. Kryetari do të jetë i autorizuar të ndërpresë çdo orator që tejkalon kohën e diskutimit. Ai, gjithashtu, mund ti kërkojë të deleguarit të mos largohet nga tema.

3. Gjatë një debati, Kryetari, me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, mund të deklarojë të mbyllur listën e diskutantëve, pas leximit të saj me zë të lartë. Kur lista ezaurohet, ai shpall mbylljen e debatit, megjithatë edhe pas mbylljes së listës ai mund t'i japë autorit të propozimit në diskutim të drejtën të përgjigjet ndaj çdo fjalimi të mbajtur.

4. Kryetari, me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, mund, gjithashtu, të kufizojë numrin e ndërhyrjeve të të njëjtit delegacion mbi një propozim ose një grup propozimesh të caktuar; por autorit të propozimit do ti jepet mundësia të paraqesë propozimin dhe, nëse e kërkon, të flasë më pas për të sjellë elementë të rinj në përgjigje të fjalës së delegacioneve të tjera, pra, nëse ai dëshiron, mund të jetë folësi i fundit.



5. Me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, Kryetari mund të kufizojë numrin e ndërhyrjeve mbi një propozim ose një grup propozimesh të caktuar; por, ky kufizim nuk mund të jetë më pak se 5 pro dhe 5 kundër propozimit në fjalë.

Neni 18

Mocionet mbi rendin e ditës dhe mocionet e procedurës

1. Gjatë diskutimit të çdo çështjeje, edhe, kur gjykohet e përshtatshme, pas mbylljes së debatit, një delegacion mund të ngrejë një mocion mbi rendin e ditës për qëllime të kërkimit të:

- shpjegimeve për drejtimin e debateve;
- respektimin e Rregullave të Procedurës;
- ndryshimin e rendit të bisedimeve dhe propozimet e sugjeruara nga Kryetari.

Mocioni për rendin e ditës ka prioritet mbi të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe mocionet e procedurës të përcaktuara në paragrafin 3.

2. Kryetari do të japë menjëherë shpjegimet e dëshiruara ose do të marrë vendimin që ai e gjykon të arsyeshëm për çështjen e mocionit mbi rendin e ditës. Në rast të kundërshtimeve, vendimi i Kryetarit do të vihet menjëherë në votim.

3. Përveç kësaj, gjatë diskutimit të një çështjeje, një delegacion mund të propozojë një mocion procedure për propozimin e:

- a) ndërprerjes së mbledhjes,
- b) mbyllja së mbledhjes,
- c) shtyrjen e debatit për çështjen në diskutim,
- d) mbylljen e debatit për çështjen në diskutim.

Mocionet e procedurës do të kenë prioritet, në rendin e përcaktuar më sipër, mbi të gjitha propozimet, me përjashtim të rastit të mocioneve mbi rendin e ditës të referuara në paragrafin 1.

4. Mocionet për ndërprerjen ose mbylljen e mbledhjes nuk do të diskutohen, por do të vendosen menjëherë në votë.

5. Kur një delegacion propozon shtyrjen ose mbylljen e debatit mbi çështje në diskutim, fjala ju jepet vetëm dy oratorëve që kundërshtojnë shtyrjen ose mbylljen e debatit, më pas mocioni vihet në votë.

6. Delegacioni që paraqet një mocion mbi rendin e ditës ose procedurën, gjatë ndërhyrjes së tij, nuk mund të trajtojë përmbajtjen e çështjes në diskutim. Autori i një mocioni të procedurës mund ta tërheqë atë para se ajo të votohet dhe çdo mocion i këtij lloji, i amenduar ose jo, i cili është tërhequr, mund të paraqitet përsëri nga një delegacion tjetër.

Neni 19

Kuorumi

1. Subjekt i paragrafëve 2 dhe 3, kuorumi i nevojshëm për hapjen e mbledhjeve dhe votimin përbëhet nga gjysma e shteteve anëtare, të përfaqësuara në Kongres dhe që ka në të drejtën e votës.

2. Për votimin e amendimeve të Kushtetutës dhe të Rregullores së përgjithshme, kuorumi i kërkuar përbëhet nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës.

3. Në rastin e Marrëveshjeve, kuorumi i kërkuar për hapjen e mbledhjeve dhe për votimin përbëhet nga gjysma e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, të cilat janë palë e Marrëveshjes për të cilën bëhet fjalë dhe që kanë të drejtën e votës.

4. Delegacionet të cilat janë të pranishme por që nuk marrin pjesë në një votim të caktuar ose që deklarojnë se nuk duan të marrin pjesë, do të konsiderohen si të pranishëm për qëllimet e përcaktimit të kuorumit të kërkuar sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3.

Neni 20

Parimi dhe procedura e votës

1. Çështjet që nuk mund të rregullohen me një pëlqim të përbashkët, hidhen në votë.

2. Votimet bëhen me sistemin tradicional ose me anë të mjeteve elektronike të votimit. Normalisht ato do të bëhen me mjete elektronike, kur ky sistem është i disponueshëm në Asamble. Megjithatë, në rast të një

votimi të fshehtë, mund të përdoret sistemi tradicional, nëse një delegacion, i mbështetur nga shumica e delegacioneve të pranishme dhe votuese, e kërkon këtë.

3. Për sistemin tradicional, procedurat e votimit do të jenë si më poshtë:

a) me ngritje dore. Nëse ka ndonjë dyshim për rezultatin e këtij votimi, Kryetari, me vullnetin e tij ose kërkesën e një delegacioni, mund të procedojë menjëherë në një votim me apel për të njëjtën çështje

b) me apel, me kërkesë të një delegacioni ose nëse kështu vendoset nga Kryetari; apeli do të bëhet duke ndjekur rendin alfabetik francez të shteteve të përfaqësuara, duke filluar nga shteti emri i të cilit tërhiqet me short nga Kryetari; rezultati i votimit, së bashku me listën e shteteve të grupuara sipas mënyrës në të cilën ata kanë votuar, do të përfshihet në raportin e mbledhjes.

c) me votim të fshehtë: duke përdorur fletët e votimit, nëse kërkohet nga dy delegacione; Kryetari i mbledhjes përcakton në këtë rast tre numërues votash, duke pasur parasysh përfaqësimin në ndarje të barabartë gjeografike dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të shteteve anëtare, dhe do të marrë masat e nevojshme për të zhvillimin e votimit të fshehtë.

4. Për sistemin elektronik, metodat e votimit janë si më poshtë:

a) votim i paregjistruar, zëvendëson votimin me ngritje dore;

b) votim i regjistruar: zëvendëson votimin me apel; megjithatë, nuk procedohet me apelin e emrave të shteteve, me përjashtim të rastit kur kërkohet nga një delegacion me mbështetjen e pjesës më të madhe të delegacioneve të pranishme dhe votuese.

c) Votim sekret: zëvendëson votimin e fshehtë me fletë votimi.

5. Pavarësisht nga sistemi i përdorur, votimi i fshehtë do të ketë prioritet mbi çdo procedurë tjetër votimi.

6. Pasi ka filluar një votim, asnjë delegacion nuk mund ta ndërpresë atë, me përjashtim të ngritjes së një mocioni të rendit të ditës në lidhje me mënyrën me të cilën kryhet votimi.

7. Pas votimit, Kryetari mund të lejojë të deleguarit të shpjegojnë përse kanë votuar siç kanë votuar.

Neni 21

Kushtet e miratimit të propozimeve

1. Për tu miratuar, propozimet që përfshijnë amendimin e Akteve duhet:

a) në rastin e Kushtetutës: do të miratohen nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës;

b) në rastin e Rregullores së përgjithshme: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, që kanë të drejtën e votës;

c) në rastin e Konventës: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese, që kanë të drejtën e votës;

d) në rastin e Marrëveshjeve: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votues, që janë palë në Marrëveshjet dhe që kanë të drejtën e votës.

2. Çështjet procedurale të cilat nuk mund të zgjidhen me një marrëveshje do të vendosen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese, që kanë të drejtën e votës. E njëjta procedurë do të ndiqet edhe për vendimet që nuk kanë të bëjnë me ndryshimet e Akteve, me përjashtim të rastit kur Kongresi vendos ndryshe me shumicë të shteteve anëtare të pranishëm dhe votues, që kanë të drejtën e votës.

3. Subjekt i paragrafit 5, “shtetet anëtare të pranishme dhe votuese” do të nënkuptojnë shtetet të cilat kanë të drejtën e votës “pro” ose “kundër”, abstenimet nuk do të merren në konsideratë në numrin e votave të nevojshme për të formuar shumicën, dhe fletët e votimit të bardha ose të pavlefshme, në rastin e votimit të fshehtë.

4. Në rast barazimi, propozimi do të konsiderohet i refuzuar

5. Kur numri i abstenimeve dhe fletëve të votimit të bardha ose të pavlefshme e kalon gjysmën e numrit të votave të shprehura (pro, kundër, abstenime) ekzaminimi i çështjes shtyhet në një seancë të mëvonshme gjatë së cilës abstenimet dhe fletët e votimit të bardha ose të pavlefshme, nuk merren në konsideratë.



Neni 22

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve postare

Me qëllim për të vendosur midis vendeve që kanë marrë të njëjtin numër votash në zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare, Kryetari procedon me zgjedhjen me short.

Neni 23

Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm dhe e Zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare

1. Zgjedhja e Drejtorit të përgjithshëm dhe e Zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare do të realizohet me votim të fshehtë, pas një ose disa mbledhjeve që mbahen në të njëjtën ditë. Do të zgjidhet kandidati që merr shumicën e votave të dhëna nga shtetet anëtare të pranishme dhe votuese. Procedohet me aq votime sa bëhet e nevojshme që një kandidat të mund të marrë shumicën.

2. “Shtete anëtare të pranishme dhe votuese” do të konsiderohen ato shtete anëtare që votojnë për një nga kandidatët aplikimi i të cilëve është shpallur në formën e duhur dhe të përshtatshme, abstenimet dhe fletët e bardha dhe të pavlefshme nuk merren në konsideratë në numërimin e votave të nevojshme për të llogaritur shumicën.

3. Nëse numri i abstenimeve dhe i fletëve të bardha apo të pavlefshme e kalon gjysmën e numrit të votave të dhëna në përputhje me dispozitat e parashikuara në paragrafin 2, zgjedhja do të shtyhet në një seancë tjetër gjatë së cilës abstenimet, fletët e bardha, votat e pavlefshme nuk merren në konsideratë.

4. Kandidati që në një raund të zgjedhjeve ka marrë më pak vota, eliminohet.

5. Në rast të një barazimi të votave, procedohet në një votim shtesë, dhe më pas, nëse është e nevojshme, edhe me një votim të dytë, në përpjekje për të vendosur midis dy kandidatëve në barazim, me votë vetëm në lidhje me këta kandidatë. Nëse rezultati është negativ, zgjedhja do të vendoset me short. Shorti do të hidhet nga Presidenti.

6. Kandidatët për Drejtor të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtor të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare, me kërkesën e tyre, mund të përfaqësohen në numërimin e votave.

Neni 24

Raportet

1. Raportet e seancave plenare të Kongresit, do të regjistrojnë zhvillimin e seancave, përmbledhin shkurt fjalimet dhe përmendin propozimet dhe rezultatin e debateve.

2. Debatet e mbledhjeve të Komiteteve do të jenë subjekt i raporteve për Kongres. Si rregull i përgjithshëm, Grupet e punës do të përgatisin një raport për organet që i kanë krijuar ato.

3. Megjithatë, çdo i deleguar ka të drejtë të kërkojë që çdo deklaratë e bërë prej tij të përfshihet në raporte, tekstualisht ose në formë të përmbledhur, me kusht që teksti në gjuhën frënge ose angleze të dorëzohet në Sekretariat jo më vonë se dy orë pas fundit të mbledhjes.

4. Të deleguarit do të kenë një afat prej 24 orësh, nga momenti kur shpërndaheft draft raporti, për vëzhgimet e tyre në Sekretariat, që, nëse është e nevojshme, të veprojnë si ndërmjetës midis palës së interesuar dhe Kryetarit të mbledhjes në fjalë.

5. Si rregull i përgjithshëm dhe subjekt i dispozitave të paragrafit 4, në fillim të çdo seance të Kongresit, Kryetari do të paraqesë për miratim raportin e seancës së mëparshme. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për raportet e Komisioneve. Raportet e seancave të fundit për të cilat nuk ka qenë e mundur të miratoheshin në Kongres ose në Komision, do të miratohen nga kryetarët përkatës të këtyre mbledhjeve. Byroja ndërkombëtare do të marrë gjithashtu parasysh edhe komentet e marra nga të deleguarit e shteteve anëtare brenda një afati prej 40 ditësh pas dërgimit të raporteve.

6. Byroja ndërkombëtare do të jetë e autorizuar të korrigjojë gabimet materiale në raportet e seancave të Kongresit dhe të Komiteteve, të cilat nuk janë zbuluar kur janë miratuar procesverbalet në përputhje me paragrafin 5.

Neni 25

Apeli kundër vendimeve të marra nga Komitetet dhe nga Kongresi

1. Çdo delegacion mund apelojë kundër një vendimi në lidhje me propozimet (Aktet, rezolutat etj.) të cilat janë miratuar ose hedhur poshtë në Komitet. Kryetari i Kongresit duhet të informohet me shkrim për apelin, brenda një afati prej 48 orësh pas mbylljes së seancës së Komitetit ku propozimi është miratuar ose hedhur poshtë. Apeli ekzaminohet në seancën e ardhshme plenare.

2. Kur një propozim është miratuar ose hedhur poshtë nga Kongresi, nuk mund të ekzaminohet përsëri nga ai, me përjashtim të rastit kur apeli mbështetet nga të paktën 10 delegacione. Ky apel duhet të miratohet nga shumica prej dy të tretash e anëtarëve të pranishëm dhe votues, që kanë të drejtën e votës. Kjo mundësi do të kufizohet tek propozimet që paraqiten drejtpërdrejt në seancat plenare, duke marrë parasysh se për një çështje nuk mund të ketë më shumë se një apel.

Neni 26

Miratimi nga Kongresi i projekt vendimeve (Aktet, rezolutat, etj.)

1. Si rregull i përgjithshëm, çdo projekt Akt i paraqitur nga Komiteti i hartimit do të ekzaminohet nën për nen. Kryetari, me pëlqimin e shumicës, mund të ndjekë një procedurë më të shpejtë, p. sh. kapitull për kapitull. Çdo Akt mund të konsiderohet i miratuar vetëm pas një votimi të përgjithshëm të favorshëm. Për këtë votim do të zbatohet Neni 21.1.

2. Byroja ndërkombëtare do të jetë e autorizuar të korrigjojë në Aktet përfundimtare gabimet materiale që nuk janë zbuluar gjatë ekzaminimit të projekt Akteve, numërtimin e neneve dhe të paragrafëve, si edhe referencat.

3. Si rregull i përgjithshëm, projekt vendimet e ndryshme nga ato që amendojnë Aktet, të paraqitura nga Komiteti i hartimit, do të ekzaminohen në bllok. Dispozitat e paragrafit 2, do të zbatohen edhe për këto projekt vendime.

Neni 27

Caktimi i studimeve për Këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare

Me rekomandim të Byrosë, Kongresi do të caktojë studimet për Këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare, në përputhje me përbërjet dhe përgjegjësitë e këtyre dy organeve siç janë vendosur në nenet 102 dhe 104 të Rregullores së përgjithshme.

Neni 28

Rezervimi për Aktet

1. Rezervimet duhet të paraqiten në Sekretariat në formën e një propozimi me shkrim, në një nga gjuhët e punës së Byrosë ndërkombëtare (propozimet në lidhje me Protokollin përfundimtar) sa më shpejt të jetë e mundur pas miratimit të propozimit në lidhje me nenin të cilit i referohet rezervimi.

2. Në mënyrë që të ketë mundësi të shpërndajë propozimet në lidhje me rezervimin tek të gjithë shtetet anëtare para miratimit të protokollit përfundimtar nga Kongresi, Sekretariati i Kongresit do të vendosë një afat për paraqitjen e rezervimeve dhe do të njoftojë shtetet anëtare për të.

3. Rezervimet për Aktet e Bashkimit të paraqitura pas afatit të vendosur nga Sekretariati nuk do të konsiderohen nga Sekretariati dhe as nga Kongresi.

Neni 29

Nënshkrimi i akteve

Aktet e miratuara përfundimisht nga Kongresi do ti paraqiten të plotfuqishmëve për nënshkrim.



Neni 30
Amendimi i Rregullave

1. Secili Kongres mund të amendojë Rregullat e Procedurës. Me qëllim që të pranohen për diskutim, propozimet për amendim të këtyre Rregullave, duhet të mbështeten nga të paktën 10 delegacione në Kongres, me përjashtim të rastit kur ato paraqiten nga organ i Bashkimit Postar Universal.

2. Miratimi i propozimeve për amendim të këtyre Rregullave duhet të bëhet me të paktën dy të tretat e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres dhe që kanë të drejtën e votës.

KONVENTA POSTARE UNIVERSALE

Pasqyra e lëndës

PJESA E PARË

Rregulla të përbashkëta të aplikueshme për shërbimin postar ndërkombëtar

KAPITULL I VEÇANTË

Dispozita të përgjithshme

Neni

- 1 Përkufizime
- 2 Përcaktimi i njësisë ose i njësive përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga aderimi në këtë Konventë
- 3 Shërbimi postar universal
- 4 Liria e transitit
- 5 Pronësia e artikujve postarë. Tërheqja nga posta. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës. Ri-adresimi. Kthimi tek dërguesi i artikujve të pashpërndarë
- 6 Tarifat
- 7 Përjashtimi nga tarifat postare
- 8 Pullat e postës
- 9 Siguria postare
- 10 Zhvillimi i qëndrueshëm
- 11 Shkeljet

PJESA E DYTË

Rregullat e aplikueshëm për postën e letrave dhe për kolipostën

KAPITULLI I

Ofrimi i shërbimeve

- 12 Shërbimet bazë
- 13 Shërbimet plotësuese
- 14 Posta elektronike, EMS, logjistika e integruar dhe shërbimet e reja
- 15 Dërgesat e papranuara. Ndalimet
- 16 Materialet radioaktive dhe lëndët infektuese të pranueshme
- 17 Ankesat
- 18 Kontrolli doganor. Detyrimet doganore dhe tarifa të tjera
- 19 Shkëmbime të postës së mbyllur me njësitë ushtarake
- 20 Standardet dhe objektivat e cilësisë së shërbimit

KAPITULLI II

Përgjegjësia

- 21 Përgjegjësia e operatorëve të caktuar. Dëmshpërblimet
- 22 Mungesa e përgjegjësisë së shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar
- 23 Përgjegjësia e dërguesit
- 24 Pagesa e dëmshpërblimeve
- 25 Rigjenerimi i mundshëm i dëmshpërblimit nga dërguesi ose nga marrësi.

KAPITULLI III

Dispozita specifike për postën e letrave

- 26 Postimi i artikujve të postës së letrave jashtë shtetit

PJESA E TRETË

Pagesat

KAPITULLI I

Dispozita të veçanta për postën e letrave

- 27 Detyrime përfundimtare. Dispozita të përgjithshme.
- 28 Detyrime përfundimtare. Dispozita të zbatueshme për fluksin e postës midis operatorëve të caktuar të shteteve në sistemin e objektivit
- 29 Detyrime përfundimtare. Dispozita të zbatueshme për fluksin e letrave drejt, nga dhe midis operatorëve të caktuar të sistemit transit
- 30 Fonde për cilësinë e shërbimit.
- 31 Shpenzime të transitit

KAPITULLI II

Dispozita të tjera

- 32 Çmimet bazë dhe dispozita për shpenzimet e transportit ajror
- 33 Kuotat territoriale dhe detare për kolipostën
- 34 Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për të përcaktuar tarifat dhe çmimet

PJESA E KATËRT

Dispozita përfundimtare

- 35 Kushtet e miratimit të propozimeve në lidhje me Konventën dhe Rregulloret
- 36 Rezervat në Kongres
- 37 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Konventës

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I KONVENTËS POSTARE UNIVERSALE

Neni

- I Pronësia e artikujve postarë. Tërheqja nga posta. Ndryshimi dhe korrigjimi i adresës
- II Tarifat
- III Përrjashtim nga taksat postare e literaturës për të verbrit
- IV Shërbimet bazë
- V Njoftimi i dërgimit
- VI Shërbimi i përgjigjes së biznesit ndërkombëtar (IBRS)
- VII Ndalimet (për postën e letrave)
- VIII Ndalimet (për koltë postare)
- IX Materiale radioaktive dhe materiale biologjike të pranueshme



X	Artikuj subjekt i detyrimeve doganore
XI	Ankesat
XII	Tarifa e paraqitjes në doganë
XIII	Postimi i artikujve të postës së letrave jashtë vendit
XIV	Kuotat territoriale të veçanta
XV	Tarifa speciale

KONVENTA POSTARE UNIVERSALE

Ne nënshkruesit, të Plotfuqishëm të Qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, në bazë të nenit 22.3 të Konventës të Bashkimit Postar Universal të miratuar në Vjenë më 10 korrik 1964, me një marrëveshje të përbashkët, dhe subjekt të nenit 25.4 të Kushtetutës, kemi miratuar në këtë Marrëveshje rregullat e zbatueshme për të gjithë shërbimin postar ndërkombëtar.

PJESA I

RREGULLAT E PËRBASHKËTA TË ZBATUESHME PËR SHËRBIMIN POSTAR NDËRKOMBËTAR KREU I VETËM DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e Konventës Postare Universale, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar më poshtë:

1.1 Koli: artikull i transportuar sipas kushteve të Konventës dhe Rregullores së Kolipostës;

1.2 postë e mbyllur: një ose disa çanta ose të tjera pako të etiketuara, të mbyllura me dyllë, që përmbajnë artikuj postar;

1.3 Postë e humbur: pako të mbërritura në një zyrë shkëmbimi të ndryshme nga ajo e shënuar në etiketën (çantë);

1.4 Artikuj të dërguar gabim: artikuj të marra në një zyrë shkëmbimi por që duhet të mbërrinin në një zyrë shkëmbimi të një shteti tjetër anëtar;

1.5 Artikull postare: term i përgjithshëm që i referohet secilit prej artikujve të dërguar nga zyra postare (postë e letrave, postë e kolisë, urdhër-pagesa);

1.6 Tarifa transiti: pagesa për shërbimet e bëra nga një organizëm transportues i vendit nga i cili kalon (operatori i caktuar, ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), për transit tokësor, detar dhe/ose ajror të postës;

1.7 Tarifa përfundimtare: pagesa që duhet ti bëhet operatorit të caktuar të shtetit të destinacionit nga operatori i caktuar i shtetit dërgues si kompensim për kostot e përballuara në shtetin e destinacionit për artikujt e postës së letrave të marra;

1.8 Operator i caktuar: çdo njësi shtetërore ose jo e emëruar zyrtarisht nga shteti anëtar për të kryer shërbimet postare dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit në territorin e tij;

1.9 Pako e vogël: artikuj të transportuar sipas kushteve të Konventës dhe të Rregullores së Postës së Letrave;

1.10 Taksa e drejtimit tokësor: pagesa që duhet ti paguhet operatorit të caktuar të shtetit të destinacionit nga operatori i caktuar i shtetit dërgues, si kompensim i kostove të trajtimit të një pakoje në vendin e destinacionit;

1.11 Taksa e transiti tokësor: pagesa për shërbimet e kryera nga transportuesi i shtetit nga i cili kalohet (operatori i caktuar; ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), lidhur me transitin tokësor dhe/ose ajror të një pakoje postare në territorin e këtij shteti;

1.12 Taksa detare: pagesa për shërbimet e kryera nga transportuesi i shtetit nga i cili kalohet (operatori i caktuar; ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), që marrin pjesë në transportin e pakove;

1.13 Shërbimi universal postar: ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve themelore postare në të gjitha pikat e territorit të një shteti anëtar, të gjitha doganat, me çmimin e përballueshëm;

1.14 Transit *à découvert* (i hapur): transit i hapur në një shtet ndërmjetës i artikujve, numri ose pesha e të cilëve nuk justifikon postën e mbyllur për në shtetin e destinacionit.

Neni 2

Caktimi i një ose disa njësive përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga aderimi në Konventë

1. Shtetet anëtare do të bëjnë me dije Byronë Ndërkombëtare, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e punimeve të Kongresit, emërtimin dhe adresën e organit qeveritar të ngarkuar me mbikëqyrjen e çështjeve postare. Gjithashtu, shtetet anëtare i transmetojnë Byrosë Ndërkombëtare, në 6 muajt pas mbylljes së punimeve të Kongresit, emërtimin dhe adresën e operatorit ose operatorëve të caktuar zyrtarisht për të siguruar kryerjen e shërbimeve postare, dhe që do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit në territorin e tyre. Midis dy Kongreseve, për çdo ndryshim që ka të bëjë me organet qeveritare dhe operatorët e caktuar zyrtarisht, duhet të bëhet me dije sa më shpejt të jetë e mundur Byroja ndërkombëtare.

Neni 3

Shërbimi postar universal

1. Me qëllim mbështetjen e konceptit të një territori të vetëm postar të Bashkimit, shtetet anëtare duhet të sigurohen që të gjithë përdoruesit/klientët do të gëzojnë të drejtën e shërbimit postar universal që përfshin një ofertë shërbimesh postare bazë me cilësi në çdo pikë të territorit të tyre, me çmime të arsyeshme.

2. Për këtë qëllim, shtetet anëtare do të vendosin, në kuadrin e legjislacionit postar kombëtar ose me mjete të tjera, qëllimin e shërbimeve postare të ofruara si dhe kushtet për cilësinë dhe çmimet e arsyeshme, duke pasur parasysh në të njëjtën kohë nevojat e popullsisë si dhe kushtet kombëtare.

3. Shtetet anëtare duhet të kujdesen që shërbimet postare dhe normat e cilësisë do të respektohen nga operatorët përgjegjës për dhënien e shërbimeve postare universale.

4. Shtetet anëtare duhet të kujdesen që shërbimi postar universal të sigurohet në baza të zbatueshme duke garantuar qëndrueshmërinë e tij.

Neni 4

Liria e transitit

1. Parimi i lirisë së transitit është cituar në nenin 1 të Kushtetutës. Ai shpreh detyrimin, për çdo shtet anëtar, të sigurojë që operatorët e tij të caktuar do të dërgojnë me rrugët më të shpejta dhe mjetet më të sigurta që ata përdorin për artikujt e tyre, postën e mbyllur dhe artikujt e postës së letrave të hapura që i dërgohen nga operatorët e tjerë të caktuar. Ky parim zbatohet gjithashtu për artikujt e dërguar gabim ose postën e devijuar.

2. Shtetet anëtare që nuk bëjnë pjesë në shkëmbimin e letrave që përmbajnë substanca të infektuara ose lëndë radioaktive, kanë të drejtën të mos i pranojnë këto artikuj në transitin e hapur në territorin e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për artikujt e postës së letrave të ndryshme nga letrat, kartolinat dhe cekogrameve (letrat dhe pakot për të verbrit). Kjo zbatohet gjithashtu për letrat e shtypura, gazetatat, revistat, pakot e vogla dhe thasët M përmbajtja e të cilave nuk i përmbush kërkesat ligjore që rregullojnë kushtet e publikimit ose të qarkullimit të tyre në shtetin ku ato kalojnë.

3. Liria e transitit të kolive postare që dërgohen nëpër rrugët tokësore dhe detare i rezervohet vendeve që marrin pjesë në këtë shërbim.

4. Liria e transitit për pakot e transportuar me rrugë ajrore është e garantuar në gjithë territorin e Bashkimit. Megjithatë, shtetet anëtare që nuk marrin pjesë në shërbimin e pakove postare nuk janë të detyruara të sigurojnë udhëtimin, me rrugë tokësore, të pakove ajrore.

5. Nëse një shtet anëtar nuk respekton dispozitat që kanë lidhje me lirinë e transitit, shtetet e tjera anëtare kanë të drejtën të ndërpresin shërbimin postar me këtë shtet anëtar.



Neni 5

Pronësia e dërgesave postare. Tërheqja. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës. Ri-adresimi. Kthimi i postës së pashpërndarë te dërguesi.

1. Çdo artikull postar do të mbetet në pronësi të dërguesit për aq kohë sa nuk është dorëzuar atij që i përket, me përjashtim të rastit kur artikulli është konfiskuar në zbatim të legjislacionit të vendit të origjinës ose të destinacionit dhe, në rast të zbatimit të nenit 15.2.1.1 ose 15.3 sipas legjislacionit të shtetit të transitit.

2. Dërguesi i një artikulli postar mund ta tërheqë atë nga shërbimi ose ti modifikojë ose ti korrigjojë adresën. Tarifat dhe kushtet e tjera janë të përcaktuara në Rregullore.

3. Shtetet anëtare do të sigurojnë se operatorët e tyre të caktuar do të ri-adresojnë artikujt postare, në rast se marrësi ka ndryshuar adresën e tij, dhe do të kthejnë artikujt e pashpërndarë. Tarifat dhe kushtet e tjera janë të përcaktuara në Rregullore.

Neni 6

Tarifat

1. Tarifat e shërbimeve të ndryshme postare ndërkombëtare dhe specifike do të vendosen nga shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, në përputhje me Konventën dhe Rregulloret e saj. Në parim, ato duhet të jenë të lidhura me kostot e kryerjes së këtyre shërbimeve.

2. Shteti anëtar i origjinës ose operatori i tij i caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, do të caktojë tarifat postare për transportin e artikujve të postës së letrave dhe kolive postare. Tarifat postare do të mbulojnë dërgimin e artikujve në adresën e marrësve, me kusht që shërbimi i shpërndarjes të jetë i organizuar në shtetet e destinacionit për artikujt në fjalë.

3. Tarifat e mbledhura, duke përfshirë edhe ato të përmendura si shembull në Akte, duhet të jenë të paktën të barabarta me ato që zbatohen për artikujt e shërbimit të brendshëm që kanë të njëjtat karakteristika (kategori, sasi, afati të trajtimit etj) .

4. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, do të jenë të autorizuar të tejkalojnë tarifat indikative që figurojnë në Akte.

5. Përtej kufirit minimal të tarifave të vendosura në pikën 3, shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar kanë të drejtën të reduktojnë tarifën në bazë të legjislacionit të tyre kombëtar për artikujt e postës dhe kolive postare të dërguara në territorin e shtetit anëtar. Ato, për shembull, mund të akordojnë tarifa preferenciale për klientët më të mëdhenj të postës.

6. Është e ndaluar të merren nga klientët tarifa postare të çfarëdo natyre përveç atyre që janë të parashikuara në Akte.

7. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në Akte, çdo operator i caktuar do të mbajë tarifën që ka vjelë.

Neni 7

Përjashtimi nga tarifa postare

1. Parimi

1.1. Rastet e përjashtimit nga tarifën postare, sipas kuptimit të përjashtimit nga parapagesa postare, janë parashikuar shprehimisht në Konventë. Megjithatë, Rregulloret mund të caktojnë dispozita që parashikojnë si përjashtimin nga parapagesa postare dhe nga pagesa e tarifave të transitit, të kostove përfundimtare si dhe të kuotave të mbërritjes për artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të lidhura me shërbimin postar, të dërguara nga shtetet anëtare, operatorët e caktuar dhe Sindikatat e kufizuara. Përveç kësaj, artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të dërguara nga Zyra Ndërkombëtare e UPU me destinacion Sindikatat e kufizuara, shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar, do të konsiderohen si artikuj të lidhur me shërbimin postar dhe do të jenë të përjashtuara nga çdo tarifë postare. Megjithatë, shteti anëtar i origjinës ose operatori i tij i caktuar ka të drejtën e marrjes së taksave shtesë ajrore për dërgesat e mësipërme.

2. Të burgosurit e luftës dhe të internuarit civilë

2.1 Artikujt e postës së letrave, kolitë postare dhe artikujt e shërbimeve postare financiare të drejtuar ose dërguar nga të burgosurit e luftës, qoftë drejtpërdrejtë apo nëpërmjet zyrave të përmendura në Rregulloren e Konventës dhe në Marrëveshjen e Shërbimeve të Pagesave Postare, do të përjashtohen nga të gjitha tarifat postare, me përjashtim të shpenzimit të transportit ajror. Palët kundërshtare në luftë të kapur dhe internuar në një vend neutral, do të klasifikohen me të burgosurit e luftës për aq sa i përket zbatimit të dispozitave të mësipërme.

2.2 Dispozitat e parashikuara në pikën 2. 1 do të zbatohen edhe për artikujt e postës së letrave, kolitë postare dhe artikujt e shërbimeve financiare postare që vijnë nga shtete të tjera dhe që u drejtohen personave civilë të internuar siç përkufizuar nga Marrëveshja e Gjenevës, datë 12 gusht 1949 në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte, ose të dërguara nga këta të fundit në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me ndërmjetësinë e zyrave të përmendura në Rregulloren e Konventës dhe Rregulloren e Shërbimit të pagesave postare.

2.3 Zyrat e përmendura në Rregulloren e konventës dhe Rregulloren e Shërbimit të pagesave postare do të përfitojnë gjithashtu nga përjashtimi nga tarifat postare për artikujt e postës së letrave, kolive postare dhe artikujt e shërbimeve financiare postare për personat e parashikuar në pikat 2.1 dhe 2.2 në rastin kur dërgojnë ose marrin, qoftë direkt qoftë me ndërmjetësi.

2.4 Kolitë do të pranohen të përjashtuara nga tarifat postare deri në peshën 5 kg. Kufizimi i peshës do të rritet deri në 10 kg për artikujt përmbajtja e të cilave është e pa ndashme dhe për ato që i dërgohen një kampi ose njerëzve të besuar për t'ju shpërndarë të burgosurve.

2.5 Në kuadrin e rregullimit të llogarive midis operatorëve të caktuar, shërbimi i kolive dhe pakot e të burgosurve të luftës ose të internuarve civilë nuk i lënë vend dhënies së asnjë çmimi, me përjashtim të shpenzimeve të transportit ajror të aplikuara për kolitë e transportuara me rrugë ajrore.

3. Cekogramet (literatura për të verbrit)

3.1 Cekogramet janë të përjashtuara nga të gjitha tarifat postare, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror.

Neni 8

Pullat e postës

1. Emërtimi "pullë poste" është i mbrojtur nga kjo Konventë dhe i rezervuar ekskluzivisht për pullat që plotësojnë kushtet e këtij neni dhe të Rregulloreve.

2. Pulla e postës

2.1 do të nxirret dhe vihet në qarkullim ekskluzivisht nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar ose territori, në përputhje me Aktet e UPU;

2.2 është një atribut sovraniteti dhe përbën provë të parapagimit të tarifës së postës që i korrespondo vlerës së caktuar atyre kur vendosen në artikuj postarë, në përputhje me Aktet e Bashkimit;

2.3 duhet të jetë në qarkullim në territorin e shtetit anëtar ose territorit që e nxjerr me qëllim përdorimin për parapagimin e shpenzimeve postare ose filatelie, në përputhje me legjislacionin kombëtar

2.4 duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë shtetasit brenda shtetit anëtar ose territorit që e emeton.

3. Pulla e postës mund të përmbajë :

3.1 emrin e shteteve anëtare ose të territorit emetues, me shkronja romake¹;

3.2 vlerën nominale, të shprehur:

3.2.1 në parim, në monedhën zyrtare të shtetit ose territorit emetues, ose si shkronjë ose simbol;

3.2.2 nëpërmjet karaktereve të tjera identifikuese;

4. Emblemat e shtetit, shenjat zyrtare të kontrollit si dhe logot e organizatave ndërqeveritare që figurojnë në pullat e postës do të jenë të mbrojtura, në kuptimin e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

5. Temat dhe motivet e pullave të postës duhet:

5.1 të jenë në përputhje me frymën e parathënies së Kushtetutës së UPU dhe vendimeve të marra nga organet e Bashkimit;

¹ Do të bëhet një përjashtim për Britaninë e Madhe, shtetin që shpiku pullën e postës.



5.2 të jetë në marrëdhënie të ngushtë me identitetin kulturor të shtetit anëtar ose territorit, ose të kontribuojë në promovimin e kulturës ose të ruajtjes së paqes;

5.3 të ketë, në rast kremtimi të personaliteteve ose ngjarjeve të huaja për shtetin anëtar ose territorin, një lidhje të ngushtë me shtetin ose territorin në fjalë;

5.4 të jetë e zhveshur nga karakteri politik ose nga çështje me natyrë fyese për një personalitet ose një shteti;

5.5 të ketë një kuptim të madh për një shtet anëtar ose territor.

6. Vulat e pagimit të shpenzimeve postare, vulat e makinave të pullave, vulat e bëra me shtyp ose të tjera procedura printimi ose shtypi në përputhje me Aktet e UPU-t mund të përdoren vetëm me autorizimin e shtetit anëtar ose territorit.

Neni 9 Siguria postare

1. Shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar do të miratojnë dhe zbatojnë një strategji sigurie në të gjitha nivelet e operacioneve postare dhe do të ruajnë dhe rrisin besimin e publikut të gjerë në shërbimet postare, në interesin e të gjithë zyrtarëve të përfshirë. Një strategji e tillë do të sjellë shkëmbimin e informacioneve që kanë lidhje me ruajtjen e sigurisë së transportit dhe të transitit të dërgesave midis shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar.

Neni 10 Zhvillimi i qëndrueshëm

Shtetet anëtare dhe/ose operatorët e tyre të caktuar do të miratojnë dhe zbatojnë një strategji proaktive të zhvillimit të qëndrueshëm duke u përqendruar tek veprimi mjedisor, social dhe ekonomik në të gjitha nivelet e operacioneve postare dhe do të promovojnë ndërgjegjësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në shërbimet postare.

Neni 11 Shkeljet

1. Artikujt postarë

1.1 Shtetet anëtare do të angazhohen të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar, ndjekur dhe ndëshkuar autorët e gjetur fajtorë për veprimet e mëposhtme:

1.1.1 futja në dërgesat postare e drogave, substancave psikotrope si edhe e lëndëve plasëse, të djegshme ose substanca të tjera të rrezikshme kur futja e tyre nuk autorizohet shprehimisht nga Marrëveshjet;

1.1.2 futja në dërgesat postare e objekteve me karakter pedofilie ose pornografike që reklamojnë fëmijë.

2. mjete të parapagimit postar dhe vetë pagesën postare

2.1 Shtetet anëtare angazhohen për të marrë të gjithë masat e nevojshme për të parandaluar, ndjekur dhe ndëshkuar çdo shkelje që ka të bëjë me mjetet e parapagimeve postare të parashikuara nga kjo Konventë të tilla si:

2.1.1 pullat e postës, në qarkullim ose të tërhequra nga qarkullimi;

2.1.2 vulat e parapagimit;

2.1.3 vulat e makinerive të pullave ose të shtypit;

2.1.4 kupona të përgjigjes ndërkombëtare.

2.2 në këtë Konventë, një shkelje që ka të bëjë me mjetet e parapagesës së shpenzimeve postare i referohet secilit nga aktet e mëposhtme, të kryera me qëllimin e përfitimit për vete ose për palë të tretë. Aktet vijuese do të dënohen:

2.2.1 çdo akt falsifikimi, imitimi ose ndryshimi i mjeteve të parapagesës postare, ose çdo veprim i paligjshëm ose i dënueshëm i lidhur me prodhimin e pa autorizuar të këtyre artikujve;

2.2.2 çdo akt përdorimi, hedhje në qarkullim, tregtie, shpërndarje, përhapje, transporti, paraqitja ose ekspozimi, reklamimit të çdo mjeti të parapagesës të cilat janë të falsifikuara, imituara, ose të ndryshuara;

2.2.3 çdo akt përdorimi ose hedhje në qarkullim me qëllime postare të mjeteve të parapagesës të cilat kanë qenë të përdorura më parë;

2.2.4 çdo tentativë që ka për qëllim kryerjen e një nga shkeljet e lartpërmendura.

3. Reciprociteti

3.1 Për sa i përket sanksioneve, nuk do të bëhet asnjë dallim midis akteve të parashikuara nga pika 2, qoftë për mjetet e parapagesës postare kombëtare ose të huaja; kjo dispozitë nuk do të nënshtrohet asnjë kushti ligjor ose konvencional të reciprocitetit.

PJESA E DYTË RREGULLAT QË ZBATOHEN NË POSTËN E LETRAVE DHE KOLIVE POSTARE

KAPITULLI I DHËNIA E SHËRBIMEVE

Neni 12 Shërbimet bazë

1. Shtetet anëtare do të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të pranojnë, përpunojnë, transportojnë dhe shpërndajnë artikujt e postës së letrave.

2. Artikujt e postës së letrave janë:

2.1 artikujt prioritarë dhe të zakonshëm deri në 2 kilogramë;

2.2 letrat, kartolinat, letrat e shtypura dhe pakot e vogla deri në 2 kilogramë;

2.3 cekogramet (literatura për të verbër) deri në 7 kilogramë;

2.4 thasë speciale që përmbajnë gazeta, shkrime periodike, libra dhe dokumente të printuar për të njëjtin marrës dhe në të njëjtën adresë, të quajtura «thasë M», deri në 30 kilogramë.

3. Artikujt e postës së letrave klasifikohen sipas shpejtësisë së trajtimit të tyre ose sipas përmbajtjes së tyre në përputhje me Rregulloren e postës së letrave.

4. Limite më të larta të peshës se ato të caktuara në pikën 2, do të aplikohen në mënyrë fakultative në disa kategori të artikujve të postës së letrave, sipas kushteve të caktuara në Rregulloren e postës së letrave.

5. Subjekt i paragrafit 8, shtetet anëtare do të sigurohen edhe se operatorët e tyre të caktuar do të pranojnë, përpunojnë, transportojnë dhe shpërndajnë koltë postare deri në 20 kg, sipas përcaktimeve të dispozitave të Konventës, ose në rastin e pakove në dalje dhe pas një marrëveshje dypalëshe, duke përdorur çdo mjet tjetër më të favorshëm për klientin.

6. Limitet e peshës më të mëdha se 20 kg do të aplikohen në mënyrë fakultative për disa kategori të kolive postare, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren për kolipostën.

7. Çdo shtet anëtar, operatori i caktuar i të cilit nuk merr përsipër transportin e kolive, mund të kërkojë zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes nga shoqëritë e transportit. Ai, në të njëjtën kohë, mund ta kufizojë këtë shërbim vetëm për koltë postare që vijnë ose që kanë si destinacion shtete të cilat ku këto shoqëri ofrojnë shërbimin.

8. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikën 5, shtetet anëtare që para datës 1 janar 2001, nuk ishin palë e Marrëveshjes së kolipostës, nuk do të jenë të detyruara të sigurojnë shërbimin e kolive postare.

Neni 13 Shërbimet plotësuese

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve plotësuese të detyrueshme vijuese:

1.1 shërbimet rekomande për artikujt në dalje prioritare dhe të postës së letrave;

1.2 shërbimet rekomande për artikujt në dalje jo- prioritarë dhe tokësorë për destinacione në të cilat një shërbim prioritar ose postë ajrore nuk ofrohet.

1.3 shërbimet rekomande për të gjithë artikujt e postës së letrave në hyrje.

2. Ofrimin e një shërbimi rekomande për artikujt e postës së letrave në dalje jo-prioritare dhe tokësore, për destinacione për të cilat shërbimi prioritar ose i postës ajrore jepet në mënyrë fakultative.



3. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar mund të ofrojnë shërbimet fakultative plotësuese të mëposhtme në marrëdhëniet mes atyre operatorëve të caktuar që kanë rënë dakord t'i ofrojnë këto shërbime:

- 3.1 sigurimin për artikujt e postës së letrave dhe kolive;
- 3.2 artikujt e postës së letrave me dorëzim të regjistruar;
- 3.3 shërbime me pagesë nga marrësi për artikujt e postës së letrave dhe kolive;
- 3.4 shërbime të dorëzimit ekspres për artikujt e postës së letrave dhe kolive;
- 3.5 dorëzimi tek marrësi personalisht të artikujve rekomande, me dorëzim të regjistruar dhe të postës së letrave;
- 3.6 shërbimi i artikujve të postës së letrave dhe kolive pa tarifë dhe taksë;
- 3.7 shërbimi i kolive delikate dhe kolive të rënda;
- 3.8 shërbimi i dorëzimit për artikujt kolektivë me një dërgues të vetëm, të destinuara për jashtë vendit.

4. tre shërbimet plotësuese në vijim kanë pjesë të detyruar dhe pjesë fakultative:

4.1 shërbimi i përgjigjes ndërkombëtare të biznesit (IBRS), i cili është kryesisht fakultativ. Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të jenë të detyruara të kryejnë shërbimin e "kthimit" për IBRS;

4.2 kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të cilët mund të shkëmbehen në të gjitha shtetet anëtare. Shitja e kuponave të përgjigjes ndërkombëtare është, megjithatë, fakultative;

4.3 njoftimi i dërgimit për artikujt rekomande ose më dërgim të regjistruar të postës së letrave, kolive ose artikujve të siguar. Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të pranojnë njoftimet e dërgimit hyrëse. Ofrimi i shërbimit të njoftimit të dërgimit dalës është, megjithatë, fakultativ.

5. Përshkrimi i këtyre shërbimeve dhe tarifave të tyre janë vendosur në Rregullore.

6. Kur karakteristikat e shërbimit në vijim janë subjekt i tarifave të posaçme në regjimin e brendshëm, operatorët e caktuar janë të autorizuar të marrin të njëjtat tarifa për artikujt ndërkombëtarë, sipas kushteve të përcaktuara në Rregullore;

- 6.1 shpërndarja e pakove të vogla me peshë më të madhe se 500 gramë;
- 6.2 postimi i artikujve të postës së letrave pas orarit të postimit;
- 6.3 postimi i artikujve jashtë orëve normale të funksionimit të sporteleve;
- 6.4 marrja në adresën e dërguesit;
- 6.5 tërheqja e një artikulli të postës së letrave jashtë orëve normale të funksionimit të sporteleve;
- 6.6 postë restante;
- 6.7 magazinimi i artikujve të postës së letrave të cilët peshojnë mbi 500 grame dhe të kolive postare;
- 6.8 dërgimi i pakove me përgjigje në momentin e mbërritjes;
- 6.9 mbulimi ndaj rreziqeve nga forcat madhore.

Neni 14

Posta elektronike, EMS, logjistika e integruar dhe shërbimet e reja

1. Shtetet anëtare ose operatorët e caktuar mund të bien dakort mes tyre për të marrë pjesë në shërbimet e mëposhtme të cilat janë përshkruar në Rregullore.

1.1 posta elektronike, e cila është një shërbim që lidhet me transmetimin elektronik të mesazheve; operatorët e caktuar mund të rrisin postën elektronike duke ofruar postë elektronike të regjistruar, që do të plotësojnë duke ofruar një provë të dërgimit dhe një kanal të sigurt komunikimi ndërmjet përdoruesve të autentikuar;

1.2 EMS, i cili është një shërbim postar ekspres për dokumentet dhe mallrat dhe sa herë të ketë mundësi, do të jetë shërbim i më i shpejtë postar me mjete fizike. Ky shërbim mund të ofrohet mbi bazën e një Marrëveshje Standarde Shumëpalëshe EMS ose të marrëveshjeve dypalëshe;

1.3 logjistika e integruar, e cila është një shërbim që i përgjigjet plotësisht kërkesave logjistike të klientelës dhe përfshin etapat që paraprijnë dhe ndjekin transmetimin fizik të mallrave dhe të dokumenteve;

1.4 marka elektronike e certifikimit postar, e cila jep prova vërtetuese të një fakti elektronik, në një formë të dhënë, në një moment të caktuar, në të cilën kanë marrë pjesë një ose disa palë.

2. Shtetet anëtare ose operatorët e caktuar, me marrëveshje të përbashkët, mund të krijojnë një shërbim të ri, i paparashikuar shprehimisht në Aktet e Bashkimit. Tarifat për shërbimin e ri janë të përcaktuara për çdo operator të caktuar, duke marrë parasysh shpenzimet e realizimit të shërbimit.

Neni 15
Artikuj që nuk pranohen. Ndalimet.

1. Të përgjithshme

1.1 Artikujt që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Konventa dhe Rregullorja, nuk do të pranohen. Artikujt e dërguar në mbështetje të një akti të paligjshëm ose me qëllim për të evituar pagesën e plotë të tarifave të përshtatshme nuk do të pranohen.

1.2 Përjashtimet nga ndalimet e caktuara në këtë nen janë të përcaktuara në Rregullore.

1.3 Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të kenë mundësinë të zgjerojnë ndalimet e caktuara në këtë nen, të cilat mund të jenë të aplikueshme menjëherë pas përfshirjes së tyre në përmbledhje.

2. Ndalimet në të gjithë llojet e artikujve

2.1 Futja e objekteve të referuara në vijim do të ndalohen në të gjitha kategoritë e artikujve;

2.1.1 drogat dhe substancat psikotrope, siç janë përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve, ose droga të tjera të paligjshme të cilat ndalohen në shtetin e destinacionit;

2.1.2 objekte të pamoralshme;

2.1.3 objekte të falsifikuara ose piraterike

2.1.4 objekte të tjera, importi ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar në shtetin e destinacionit.

2.1.5 objektet që, për shkak të natyrës ose ambalazhimit të tyre, mund të ekspozojë agjentët ose publikun e gjerë, ose token ose të dëmtojnë artikujt e tjerë, pajisjet postare ose të mirat që ju përkasin të tretëve;

2.1.6 dokumentet që kanë një karakter të korrespondencës aktuale dhe personale të shkëmbyer mes personave që nuk janë as dërgues dhe as pritës, ose që banojnë me ta;

3. Lëndët që shpërthejnë, marrin flakë, ose materialet radioaktive dhe mallra të tjera të rrezikshme

3.1 Futja e mallrave që shpërthejnë, marrin flakë ose mallra të tjera të rrezikshme, si edhe materialet radioaktive, do të jenë të ndaluara për çdo kategori artikujsh.

3.2 Futja e pajisjeve të lëndëve plasëse inerte dhe mjeteve ushtarake dhe imitimeve, duke përfshirë granatat inerte dhe imitimet e tyre, predhat inerte dhe të ngjashme, do të jenë të ndaluara për çdo kategori artikujsh.

3.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, do të pranohen mallrat e rrezikshme si më poshtë:

3.3.1 materialet radioaktive të dërguara me artikujt e postës së letrave dhe koltë postare të përmendura në nenin 16.1;

3.3.2 substancat infektuese të dërguara me artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të përmendura në nenin 16.2.

4. Kafshët e gjalla

4.1 Futja e kafshëve të gjalla është e ndaluar në të gjitha kategoritë e artikujve;

4.2 Në mënyrë të jashtëzakonshme, do të pranohen në artikujt e postës së letrave të ndryshme nga artikujt e siguruar, kafshët si më poshtë;

4.2.1 bletët, shushunjat dhe krimbat e mëndafshit.

4.2.2 parazitët dhe shkatërruesit e insekteve të dëmshme të destinuara për kontrollin e këtyre insekteve dhe të shkëmbyer mes institucioneve zyrtarisht të njohura;

4.2.3 mizat e familjes së Drosophilidae të përdorur për kërkime bio-mjekësore, të shkëmbyera mes institucioneve zyrtarisht të njohura.

4.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, do të pranohen kafshët e përmendura më poshtë:

4.3.1 kafshët e gjalla, transporti me postë i të cilave është i autorizuar nga rregullorja e postave të shteteve të interesuara.

5. Futja e korrespondencave në koli

5.1 Është e ndaluar futja e objekteve të përmendura më poshtë në kutitë postare:

5.1.1 korrespondenca, me përjashtim të materialeve të arkivuara, të shkëmbyera midis personave të ndryshëm nga dërguesi dhe marrësi ose personat që jetojnë me ta;

6. Monedha, kartëmonedha, dhe objekte të tjera me vlerë;

6.1 Është e ndaluar futja e monedhave, kartëmonedhave, valutë ose letra me vlerë të çfarëdolloj të pagueshme prurësit, çeqeve të udhëtimit, platini, ari, argjendi, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjerë të me vlerë;



- 6.1.1 në artikujt e postës së letrave të pasiguruara;
 - 6.1.1.1 megjithatë, nëse legjislacioni i brendshëm i shteteve të origjinës dhe të destinacionit e lejon, këto objekte mund të dërgohen me zarf të mbyllur si dërgesa rekomande.
- 6.1.2 në pakot e pasiguruara, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i brendshëm i shteteve të origjinës dhe të destinacionit e lejon;
- 6.1.3 në pakot e pasiguruara, të shkëmbyera mes shteteve që pranojnë deklarimin e vlerës;
 - 6.1.3.1 për më shumë, çdo shtet anëtar ose operator i caktuar mund të ndalojë përfshirjen e shufrave të arit në kolitë e siguruara ose të pasiguruara që nisen ose i adresohen territorit të tij ose janë dërguar në transit à découvert nëpër territorin e tij; ai mund ta kufizojë vlerën reale të këtyre artikujve.
- 7. Letra të printuara dhe cekograma (posta e të verbërve)
 - 7.1 Letrat e printuara dhe cekogramat
 - 7.1.1 nuk mund të përmbajnë asnjë mbishkrim ose artikull korrespondence;
 - 7.1.2 nuk do të mbajnë asnjë pullë-poste ose formular parapagimi, të anuluar ose jo, ose ndonjë letër që përfaqëson ndonjë vlerë, me përjashtim të rasteve kur artikulli përfshin si shtojcë një kartolinë, zarf ose ambalazh që ka adresën e printuar të dërguesit të artikullit ose agjentit të tij në shtetin e postimit ose të destinacionit të artikullit origjinal, kthimi i të cilit është parapaguar.
- 8. Trajtimi i artikujve të pranuar gabim
 - 8.1 Trajtimi i artikujve të pranuar gabimisht përcaktohet në Rregullore. Megjithatë, artikujt që përmbajnë objektet e caktuara në pikat 2.1.1, 2.1.2 dhe 3.1 dhe 3.2 nuk do të dërgohen në asnjë rrethanë në destinacionin e tyre, nuk do të dorëzohen marrësit, ose kthehen në origjinë. Nëse objektet e përcaktuara në pikat 2.1.1, 3.1 dhe 3.2 janë zbuluar në transit, këto artikuj do të trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të transitit.

Neni 16

Materiale radioaktive dhe substanca infektuese të lejueshme:

- 1. Materialet radioaktive do të lejohen në artikujt e postës së letrave dhe në kolitë postare në marrëdhëniet mes shteteve anëtare që kanë deklaruar vullnetin e tyre për të pranuar këto dërgesa, qoftë në marrëdhëniet reciproke, qoftë në një drejtim të vetëm, sipas kushteve të mëposhtme:
 - 1.1 materialet radioaktive do të përgatiten dhe paketohen në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores;
 - 1.2 kur ato dërgohen në artikujt e postës së letrave, ato do të nënshtrohen tarifës së artikujve prioritarë ose tarifës të letrave rekomande;
 - 1.3 materialet radioaktive të përfshira në artikujt e postës së letrave ose të kolitë postare duhet të dërgohen me anë të rrugës më të shkurtër, normalisht me avion, subjekt i pagesës së tarifave ajrore shtesë përkatëse;
 - 1.4 materialet radioaktive mund të dërgohen vetëm nga dërgues të autorizuar rregullisht.
- 2. Substancat infektuese, me përjashtim të substancave infektuese të kategorisë A që prekin njerëzit (UN 2814) dhe kafshët (UN 2900) do të pranohen në artikujt e postës së letrave dhe kolitë postare sipas kushteve të mëposhtme:
 - 2.1 Substancat infektuese të kategorisë B (UN 3373) mund të shkëmbehen me dërgesë vetëm ndërmjet dërguesve të njohur zyrtarisht, sipas përcaktimeve të autoriteteve të tyre kompetente. Këto mallra të rrezikshme mund të pranohen në dërgesa, subjekt i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi dhe botimit aktual të Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, siç botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).
 - 2.2 Substancat infektuese të kategorisë B (UN 3373) duhet të përpunohen, paketohen dhe etiketohen në përputhje me dispozitat e renditura në Rregulloren e Postës së letrave dhe Rregulloren e Kolipostës. Këto artikuj do të jenë subjekt i tarifave të artikujve prioritarë ose tarifave të artikujve rekomande. Do të lejohet një tarifë shtesë për përpunimin e këtyre artikujve.
 - 2.3 Kampionët e marrë nga pacientët (njerëz ose kafshë) mund të shkëmbehen me postë vetëm ndërmjet dërguesve të njohur zyrtarisht të përcaktuar nga autoritetet kompetente. Këto materiale të rrezikshme mund të pranohen në dërgesa, subjekt i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi dhe botimit aktual të Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, siç botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).

2.4 Kampionët e marrë nga pacientët (njerëz ose kafshë) duhet të përpunohen, pakëtohen dhe etiketohen në përputhje me dispozitat e renditura në Rregulloren e Postës së Letrave. Këta artikuj do të jenë subjekt i tarifave të artikujve prioritarë ose tarifës për letrat rekomande. Do të lejohet një tarifë shtesë për përpunimin e këtyre artikujve.

2.5 Pranimi i substancave infektuese dhe kampionëve të marrë nga pacientët (njerëz ose kafshë) do të kufizohen në shtetet anëtare që kanë deklaruar vullnetin e tyre për të pranuar këta artikuj, në mënyrë reciproke ose vetëm në një drejtim.

2.6 Substancat infektuese dhe kampionët e marrë nga pacientët (njerëz ose kafshë) do të dërgohen me anë të rrugës më të shpejtë, zakonisht me transport ajror, subjekt i pagesës së shtesës përkatëse të tarifës së transportit ajror dhe do të kenë prioritet në dërgim.

Neni 17 Reklamimet

1. Çdo operator i caktuar duhet të pranojë reklamimet në lidhje me koltë ose artikujt rekomande, të siguruar ose me dërgim të regjistruar të postuara në shërbimin e tij ose në atë të një operatori tjetër të caktuar, me kusht që këto reklamime të paraqiten në një periudhë prej gjashtë muajsh, duke nisur nga e nesërmja e ditës së postimit të artikullit. Transmetimi i reklamimeve mund të kryhet me postë prioritare, EMS ose me mjete elektronike. Periudha prej 6 muajsh ka të bëjë me marrëdhëniet mes reklamuesve dhe operatorëve të caktuar dhe nuk do të përfshijë transmetimin e reklamimeve ndërmjet operatorëve të caktuar.

2. Reklamimet do të pranohen sipas kushteve të parashikuara në Rregullore.

3. Trajtimi i reklamimeve do të bëhet falas. Megjithatë, shpenzimet shtesë që rrjedhin nga kërkesa e transmetimit me anë të shërbimit EMS, në parim, do të jenë në ngarkim të personit që bën kërkesën.

Neni 18 Kontrolli doganor. Detyrimet doganore dhe tarifa të tjera

1. Operatorët e caktuar të shteteve të origjinës dhe të destinacionit do të jenë të autorizuar të nënshtrojnë artikujt ndaj kontrollit doganor, sipas legjislacionit të këtyre shteteve.

2. Artikujt që i nënshtrohen kontrollit doganor mund të jenë subjekt i tarifës së paraqitjes në doganë, shuma e udhëzuar e së cilës është e përcaktuar në Rregullore. Kjo taksë merret vetëm për paraqitjen në doganë dhe zhdoganimin e artikujve që i nënshtrohen të pagesave doganore ose të çdo pagese tjetër të këtij lloji.

3. Operatorët e caktuar që kanë marrë autorizimin për të bërë zhdoganimin në emër të klientëve, do të jenë të autorizuar të marrin nga klientët një tarifë bazë të kostos reale. Kjo tarifë mund të vihet për të gjithë artikujt e deklaruar në Doganë sipas legjislacionit kombëtar, duke përfshirë ato të përjashtuara nga detyrimet doganore. Klientët do të informohen në mënyrë të qartë dhe paraprakisht për tarifën e kërkuar.

4. Operatorët e caktuar do të jenë të autorizuar të marrin nga dërguesit ose marrësit e artikujve, sipas rastit, tarifat doganore ose çdo të pagesë tjetër të mundshme.

Neni 19 Shkëmbimi i dërgesave të mbyllura, me njësitë ushtarake

1. Dërgesat e mbyllura mund të shkëmbehen me ndërmjetësinë e shërbimeve territoriale, detare, ajrore të shteteve të tjera:

1.1 ndërmjet zyrave të postës të çdonjërit prej shteteve anëtare dhe oficerëve të komandës të njëjësive ushtarake në dispozicion të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

1.2 ndërmjet oficerëve të komandës të njëjësive ushtarake;

1.3 ndërmjet zyrave të postës të çdonjërit prej shteteve anëtare dhe oficerëve të komandës së njëjësive detare, ajrore ose tokësore, anijeve të luftës ose avionëve të të njëjtit shtet, të vendosura në vend të huaj.

1.4 ndërmjet oficerëve të komandës të njëjësive detare, ajrore ose tokësore, anijeve të luftës ose avionëve ushtarakë të të njëjtit shtet.

2. Artikujt e postës së letrave të përfshira në dërgesat e referuara në pikën 1, do të kufizohen në artikujt të adresuar ose dërguar anëtarëve të njëjësive ushtarake ose oficerëve dhe ekuipazhit të anijeve ose të avionëve, për ose nga të cilët janë dërguar artikujt. Kushtet dhe tarifat e dërgimit të aplikueshme për to do të



vendosen nga operatori i caktuar i shtetit anëtar që ka vënë në dispozicion njësinë ushtarake ose të cilit i përket anijet apo avionët, në përputhje me rregulloret e tij.

3. Me përjashtim të rastit kur ka një marrëveshje, operatori i caktuar i shtetit anëtar që ka vënë në dispozicion njësinë ushtarake ose të cilit i përket anijet e luftës ose avionët ushtarakë, do të jetë përgjegjës kundrejt operatorëve të caktuar të interesuar për shpenzimet e transimit, shpenzimet përfundimtare dhe shpenzimet e transportit ajror të dërgesave.

Neni 20

Standardet dhe objektivat në lidhje me cilësinë e shërbimit

1. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të përcaktojnë dhe të publikojnë standardet dhe objektivat e tyre në lidhje me shpërndarjen e artikujve të postës së letrave dhe koltë postare që mbërrijnë.

2. Këto standarde dhe objektiva, të shtuar me kohën normale për procedurave e zhdoganimit, nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato të aplikuara për artikujt e krahasueshëm në shërbimin e tyre të brendshëm.

3. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të përcaktojnë dhe publikojnë plotësisht standardet për artikujt prioritarë dhe për artikujt e transportuar me rrugë ajrore, si edhe për koltë ekonomike / tokësore.

4. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të vlerësojnë zbatimin e standardeve të cilësisë së shërbimit.

KAPITULLI II PËRGJEGJËSIA

Neni 21

Përgjegjësia e operatorëve të caktuar. Dëmshpërblimet

1. Të përgjithshme

1.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 22, operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës:

1.1.1 për humbjen, vjedhjen ose dëmtimet e artikujve rekomandë, të kolive të zakonshme dhe të artikujve të siguruar.

1.1.2 për humbjen e artikujve me dërgim të regjistruar;

1.1.3 për kthimin e artikujve rekomandë, artikujve të siguruar dhe kolive të zakonshme për të cilat nuk është dhënë arsyeja e mos-dërgimit;

1.2 Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës për artikuj të ndryshëm nga ata të treguar në pikat 1.1.1 dhe 1.1.2.

1.3 Në çdo rast tjetër të parashikuar në këtë Konventë, operatorët e caktuar nuk do të mbajnë përgjegjësi;

1.4 Kur humbja ose dëmtimi total i një artikulli rekomandë, një kolie të zakonshme ose të një artikulli të siguruar, ndodh për shkak të një force madhore për të cilin nuk aplikohen dëmshpërblime dërguesi do të ketë drejtën e kthimit të tarifave të paguara për postimin e artikullit me përjashtim të tarifës së sigurimit;

1.5 Shumat e dëmshpërblimit për tu paguar nuk mund të jenë më të larta se shumat e treguara në Rregulloren e postës së letrave dhe në Rregulloren e kolipostës;

1.6 Në rast të përgjegjësisë, humbja ose humbjet e fitimeve nuk do të merren në konsideratë në shumën e dëmshpërblimit që do të paguhet.

1.7 Të gjitha dispozitat në lidhje me përgjegjësinë e operatorëve të caktuar do të jenë të sakta, të detyrueshme dhe të plota. Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës në asnjë rast jashtë kufizimeve të përcaktuara në Konventë dhe Rregullore, edhe në rast të gabimit të rëndë.

2. Artikujt rekomandë

2.1 Në rast humbje, vjedhje ose dëmtimi total të një artikulli rekomandë, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi të përcaktuar në Rregulloren e Postës së Letrave. Nëse dërguesi kërkon një shumë më të vogël se shumata e përcaktuar në Rregulloren e Postës së Letrave, operatorët e caktuar kanë lirinë të paguajnë këtë shumë më të vogël, dhe të rimbursohen mbi këtë bazë, nga operatorët e tjerë të përfshirë;

2. 2 Në rast të vjedhjes së pjesshme ose të dëmtimit të pjesshëm të një artikulli rekomande, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi që, në parim, korrespondon, me vlerën reale të vjedhjes ose dëmit.

3. Artikuj me dërgim të regjistruar:

3.1 Në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit total të një artikulli me dërgim të regjistruar, dërguesi do të ketë të drejtën e kthimit vetëm për tarifat e paguara për postimin e artikullit.

4. Kollitë e zakonshme

4.1 Në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit total të një kolie, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi të përcaktuar në Rregulloren e kolipostës. Nëse dërguesi kërkon një shumë më të vogël se shuma e përcaktuar në Rregulloren e kolipostës, operatorët e caktuar mund të paguajnë këtë shumë më të vogël dhe të rimbursohen mbi këtë bazë nga operatorët e tjerë të caktuar të interesuar.

4.2 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi që korrespondon, në parim, me shumën reale të vjedhjes ose të dëmit.

4.3 Operatorët e caktuar mund të bien dakord të aplikojnë në marrëdhëniet e tyre reciproke shumën e përcaktuar në Rregulloren e Postës së Letrave, në lidhje me kollitë postare, pavarësisht nga pesha e kollisë.

5 Artikujt e siguruar

5.1 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie të siguruar, dërguesi do të ketë të drejtën të marrë dëmshpërblimin që korrespondon, në parim, me shumën në SDR, të vlerës së siguruar;

5.2 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie të siguruar, dërguesi do të ketë të drejtën të marrë një dëmshpërblim që korrespondon, në parim, me shumën reale të vjedhjes ose të dëmit. Ajo nuk mund ta kalojë shumën në SDR, të vlerës së siguruar;

6. Nëse një artikull i postës së letrave rekomande ose i siguruar kthehet dhe arsyeja e mosdërgimit nuk jepet, dërguesi do të ketë të drejtën e rimbursimit vetëm për tarifën e paguar për postimin e artikullit.

7. Nëse një koli kthehet dhe arsyeja e mosdërgimit nuk jepet, dërguesi do të ketë të drejtën e rimbursimit vetëm për tarifën e paguar për postimin e kollisë në shtetin e origjinës dhe shpenzimet e shkaktuara nga kthimi i kollisë nga shteti i destinacionit.

8. Në rastet e përmendura në pikat 2, 4 dhe 5, dëmshpërblimi do të llogaritet në bazë të çmimit real, të konvertuar në SDR, të artikujve dhe mallrave të të njëjtit lloj, në vendin dhe në kohën në të cilën artikulli është pranuar për transport. Kur mungon ky çmim, dëmshpërblimi do të llogaritet sipas vlerës së zakonshme të artikujve dhe mallrave të vlerësuar me të njëjtat baza.

9. Kur jepet një dëmshpërblim për humbjen, vjedhjen ose dëmtimin total të një artikulli rekomande, një kolie të zakonshme ose artikulli të siguruar, dërguesi, ose, sipas rastit, marrësi do të ketë të drejtën e kthimit të tarifave të paguara për postimin e tyre, me përjashtim tarifës së rekomandesë ose sigurimit. E njëjta gjë është do të zbatohet për artikujt rekomande, kollitë e zakonshme dhe artikujt e siguruar, të refuzuar nga ana e marrësve, për shkak të gjendjes së tyre të keqe, nëse kjo është për faj të shërbimit postar dhe sjell përgjegjësinë e tij;

10. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikat 2, 4, dhe 5, marrësi do të ketë të drejtën e dëmshpërblimit pas dorëzimit të një artikulli rekomande, një kolie të zakonshme ose një kolie të siguruar, të vjedhur ose të dëmtuar;

11. Operatori i caktuar i origjinës do të ketë të drejtën e pagesës së dërguesve në shtetin e tij, dëmshpërblimet e parashikuara nga legjislacioni kombëtar për artikujt rekomande dhe kollitë e pasiguruara, me kusht që të mos jenë më të ulëta se ato të caktuara në pikat 2.1 dhe 4.1. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për operatorin e caktuar të destinacionit, kur dëmshpërblimi i paguhet marrësit. Megjithatë do të mbeten të aplikueshme shumat e caktuara në pikat 2.1 dhe 4.1.

11.1 në rast ankese ndaj operatorit të caktuar përgjegjës; ose

11.2 nëse dërguesi heq dorë nga të drejtat e tij në favor të marrësit ose e kundërta.

12. Për këtë nen nuk do të aplikohet asnjë rezervë që ka të bëjë me tejkalimin e afateve për reklamimet dhe pagesat e dëmshpërblimeve ndaj operatorëve të caktuar, duke përfshirë periudhat dhe kushtet e vendosura në Rregullore, me përjashtim të rastit të marrëveshjeve dypalëshe.



Neni 22

Mungesa e përgjegjësisë së shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar

1. Operatorët e caktuar nuk do të kenë më përgjegjësi për artikujt rekomande, artikujt me dërgim të regjistruar, kolitë dhe artikujt e siguar, të cilat janë dërguar në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloret e tyre për artikujt të të njëjtit lloj. Megjithatë do të mbetet përgjegjësia:

1.1 kur konstatohet një vjedhje ose dëmtim para ose gjatë dërgimit të artikullit;

1.2 kur, nëse lejohet nga rregullorja e brendshme, marrësi ose dërguesi, nëse ka ri-dërgim në origjinë, ka rezerva për marrjen e në dorëzim të një artikulli të vjedhur ose të dëmtuar;

1.3 kur, nëse lejohet nga rregullorja e brendshme, artikulli rekomande është shpërndarë në një kuti postare private dhe marrësi deklaron se nuk e ka marrë artikullin;

1.4 kur marrësi ose dërguesi, në rast të ri-dërgimit në origjinë, i një kolie ose një artikulli të siguar, pavarësisht se ka dhënë shkarkimin nga përgjegjësia, njofton pa vonesa operatorin e caktuar që ka dërguar artikullin se ka konstatuar vjedhje ose dëmtim. Ai duhet të japë provën se kjo vjedhje ose dëmtim nuk është bërë pas dorëzimit. Termi “pa vonesë” duhet të interpretohet në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës:

2.1 në rastet e forcës madhore, subjekt i nenit 13.6.9;

2.2 kur ata nuk mund të llogarisin artikujt për shkak të shkatërrimit të dokumentacionit të shërbimit si rezultat i forcës madhore, me kusht që të mos jetë dhënë ndonjë provë tjetër për përgjegjësinë e tyre;

2.3 kur humbja, vjedhja ose dëmi është shkaktuar nga një gabim ose neglizhencë e dërguesit ose rrjedh nga natyra e përmbajtjes;

2.4 kur artikujt bëjnë pjesë në ndalimet e parashikuara në nenin 15;

2.5 kur artikujt janë sekuestruar sipas legjislacionit të shtetit të destinacionit, sipas njoftimit të shtetit anëtar ose operatorit të caktuar të këtij shteti;

2.6 në rastin e artikujve të siguar të cilët janë siguar në mënyrë të paligjshme për një vlerë më të madhe se vlera reale e përmbajtjes;

2.7 kur dërguesi nuk ka bërë asnjë reklamim brenda 6 muajve, duke filluar nga e dita e nesërme e ditës së postimit të artikullit;

2.8 kur bëhet fjalë për koli të të burgosurve ose të internuarve civilë;

2.9 kur veprimet e dërguesit dyshohen të kenë qëllim të paligjshëm me qëllim marrjen e dëmshpërblimit.

3. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar nuk do të pranojnë asnjë përgjegjësi për deklaratat doganore, pavarësisht nga forma e tyre ose për vendime të marra nga shërbimet e doganës gjatë verifikimit të artikujve që i nënshtrohen kontrollit doganor.

Neni 23

Përgjegjësia e dërguesit

1. Dërguesi i një artikulli është përgjegjës për dëmtimet fizike që i shkaktohen punonjësve të postës dhe çdo dëmtim tjetër që i shkaktohet artikujve të tjerë postarë si edhe të pajisjeve postare, si rezultat i dërgimit të një objekti të papranueshëm për transport ose nga mos respektimi i kushteve të pranimit;

2. Në rast të dëmtimit të artikujve të tjerë postarë, dërguesi është përgjegjës në të njëjtët nivel si edhe operatorët e caktuar, për çdo artikull;

3. Dërguesi do të mbetet përgjegjës edhe nëse zyra e postimit e pranon këtë artikull.

4. Megjithatë, kur kushtet e pranimit janë respektuar nga dërguesi, ky nuk do të jetë përgjegjës, deri sa ka një gabim ose neglizhencë nga operatorët e caktuar ose të transportuesit në përpunimin e artikullit pas pranimit të tyre.

Neni 24

Pagesa e dëmshpërblimit

1. Me përjashtim të rastit kur ka një ankesë ndaj operatorit të caktuar përgjegjës, detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit dhe të kthimit të tarifave dhe pagesave do të jetë, sipas rastit, i operatorit të caktuar të origjinës ose operatorit të caktuar të destinacionit;

2. Dërguesi mund të heqë dorë nga të drejtat e tij për tu dëmshpërblyer, në favor të marrësit. Nga ana tjetër, marrësi mund të heqë dorë nga e drejta e dëmshpërblimit në favor të dërguesit. Dërguesi ose marrësi mund të autorizojnë një person të tretë të marrë dëmshpërblimin nëse legjislacioni i brendshëm e lejon këtë.

Neni 25

Rikuperimi i mundshëm i dëmshpërblimit nga dërguesi ose marrësi

1. Nëse, pas pagimit të dëmshpërblimit, një artikull rekomandë, një koli ose një artikull i siguruar ose një pjesë e përmbajtjes të konsideruar më parë si e humbur është gjetur, dërguesi ose marrësi, sipas rastit, do të njoftohen se artikulli do të mbahet në dispozicion të tij për një periudhë prej tre muajsh pas rimbursimit paguar më parë si dëmshpërblim. Në të njëjtën kohë ai do të pyetet se kujt do ti dërgohet artikulli. Në rast të refuzimit ose mos kthimit të përgjigjes brenda afatit të caktuar, e njëjta përjasje do të bëhet për marrësin ose dërguesin, sipas rastit, duke i dhënë të njëjtin afat për përgjigje;

2. Nëse dërguesi dhe marrësi refuzojnë të marrin në dorëzim artikullin ose nuk përgjigjen në afatet e caktuara në pikën 1, artikulli do të bëhet pronë e operatorit të caktuar, ose sipas rastit, e operatorëve të caktuar që kanë përballur humbjen;

3. Në rast se pas gjetjes së një artikulli të siguruar, konstatohet se përmbajtja e tij ka një vlerë më të vogël se pagesa e dëmshpërblimit, dërguesi ose pritësi, sipas rastit, duhet të rimbursojë shumën e këtij dëmshpërblimi kundrejt dhënies së artikullit, pa cenuar pasojat që mund të rrjedhin nga sigurimi i paligjshëm.

KAPITULLI 3

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POSTËN E LETRAVE

Neni 26

Postimi i artikujve të postës së letrave jashtë shtetit

1. Asnjë operator i caktuar nuk është i detyruar të dërgojë ose shpërndajë për marrësit artikujt e postës së letrave që dërguesit që jetojnë në territorin e shtetit të tij anëtar postojnë ose shkaktojnë postimin në një shtet të huaj me qëllim përfitimin e kushteve më të favorshme të tarifave që zbatohen atje;

2. Dispozitat e parashikuara në pikën 1, do të zbatohen pa dallim, si për artikujt e postës së letrave të përgatitura në shtetin e rezidencës së dërguesit dhe të transportuara pastaj nëpërmjet kufijve, edhe për artikujt e postës së letrave të përgatitura në një shtet të huaj;

3. Operatori i caktuar i destinacionit ka të drejtë të kërkojë nga dërguesi, dhe në mungesë të tij, nga operatori i caktuar dërgues, pagesën e çmimeve të brendshme. Nëse as dërguesi as operatori i caktuar dërgues nuk pranojnë të paguajnë këto tarifa brenda afatit të caktuar nga operatori i caktuar i destinacionit, ky i fundit mund ti kthejë artikujt tek operatori i caktuar dërgues dhe do të ketë të drejtën për tu rimbursuar për kostot e ri-adresimit, ose t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar;

4. Një operator i caktuar nuk do të jetë i detyruar të dërgojë ose shpërndajë tek marrësi, artikujt e postës së letrave që dërguesit kanë postuar ose për të cilat kanë shkaktuar postimin në një sasi të madhe në një shtet të ndryshëm nga ai ku jetojnë, nëse shumë e shpenzimeve përfundimtare për tu marrë është më e vogël se shumë që do të kishte marrë nëse dërgesa do të ishte postuar në shtetin ku jeton dërguesi. Operatori i caktuar i destinacionit do të ketë të drejtën të kërkojë nga operatori i caktuar e origjinës pagesa në përputhje me shpenzimet e shkaktuara dhe të cilat nuk mund të kalojnë më të lartën prej dy shumave të mëposhtme: 80% e tarifës së brendshme të aplikueshme për artikujt të ngjashëm, ose tarifat e zbatueshme sipas neneve 28.3 deri në 28.7 ose 29.7, sipas rastit. Nëse operatori i caktuar i origjinës nuk pranon të paguajë shumën e reklamuar brenda afatit të përcaktuar nga operatori i caktuar i destinacionit, operatori i caktuar i destinacionit mund t'i kthejë artikujt tek operatori i caktuar i origjinës, duke pasur të drejtën të rimbursohet për shpenzimet e ri-adresimit, ose t'i trajtojë ata në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.



PJESA E TRETË DËMSHPËRBLIMET

KAPITULLI I DISPOZITA SPECIFIKE PËR POSTËN E LETRAVE

Neni 27

Shpenzimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

1. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara nga Rregullorja, çdo operator i caktuar që merr nga një tjetër operator i caktuar artikuj të postës së letrave, do të ketë të drejtën të marrë nga operatori i caktuar dërgues një pagesë për kostot e shkaktuara nga posta ndërkombëtare e marrë;

2. Për aplikimin e dispozitave në lidhje me pagesën e shpenzimeve përfundimtare nga operatorët e tyre të caktuar, shtetet dhe territoret do të klasifikohen në përputhje me listat e hartuara për këtë qëllim nga Kongresi në rezolutën e tij C 18/2008 si në vijim:

2.1 shtetet dhe territoret në sistemin objektiv para 2010;

2.2 shtetet dhe territoret në sistemin objektiv midis 2010 dhe 2012 (shtete të reja të sistemit objektiv);

2.3 shtete dhe territore në sistemin e tranzicionit.

3. Dispozitat e kësaj Konvente në lidhje me pagesat e shpenzimeve përfundimtare përbëjnë masa tranzitore që çojnë në përshtatjen e një sistemi që merr parasysh elementë në lidhje me çdo shtet në përfundim të periudhës së tranzicionit.

4. Aksesit në shërbimet e brendshme. Aksesit i drejtpërdrejtë

4.1 Në parim, çdo operator i caktuar do të vendosë në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar të gjitha çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tij të brendshëm me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët vendas. I takon operatorit të caktuar të destinacionit të vendosë nëse operatori i caktuar i origjinës ka përmblusur afatet dhe kushtet e aksesit të drejtpërdrejtë.

4.2 Operatorët e caktuar të shteteve në sistemin objektiv do të vendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e tyre.

4.3 Operatorët e caktuar të shteteve të reja të sistemit objektiv mund të zgjedhin të mos vendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e shtetit të tyre. Këta operatorë të caktuar, megjithatë, mund të zgjedhin të vendosin në dispozicion të një numri të limituar të operatorëve të caktuar aplikimin e kushteve të brendshme, në bazë të reciprocitetit, për një periudhë prove prej dy vjetësh. Pas kësaj periudhe, ata duhet të zgjedhin të pushojnë disponibilitetin e kushteve të brendshme ose të vazhdojnë të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të tjerë të caktuar kushtet e brendshme. Megjithatë, nëse operatorët e caktuar të shteteve të reja të sistemit objektiv u kërkojnë operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit objektiv aplikimin e kushteve të brendshme, ata duhet të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e tyre.

4.4 Operatorët e caktuar të shteteve në sistemin e tranzicionit mund të zgjedhin të mos vendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e shtetit të tyre. Këta operatorë të caktuar, megjithatë, mund të zgjedhin të vendosin në dispozicion të një numri të limituar të operatorëve të caktuar aplikimin e kushteve të brendshme, në bazë të reciprocitetit, për një periudhë prove prej dy vjetësh. Pas kësaj periudhe, ata duhet të zgjedhin të pushojnë disponibilitetin e kushteve të brendshme ose të vazhdojnë të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të tjerë të caktuar kushtet e brendshme.

5. Shpërblimi për shpenzimet përfundimtare do të bazohet në cilësinë e performancës së shërbimit në shtetin e destinacionit. Këshilli i Operacioneve Postare do të jetë i autorizuar të shtojë shpërblimin e neneve 28 dhe 29 për të inkurajuar pjesëmarrjen në sistemet e monitorimit dhe për të shpërblyer operatorët e caktuar për arritjen e objektivave të tyre të cilësisë. Këshilli i Operacioneve Postare gjithashtu mund të vendosë gjoba në rast të cilësisë së pamjaftueshme, por shpërblimi nuk do të jetë më i ulët se shpërblimi minimal në përputhje me nenet 28 dhe 29.

6. Çdo operator i caktuar mund të heqë dorë totalisht ose pjesërisht nga pagesën e parashikuar në pikën 1.

7. Për thasët M, çmimi i detyrimeve përfundimtare që do të aplikohen do të jetë 0.793 SDR për kilogram. Thasët M që peshojnë më pak se 5 kilogramë do të konsiderohen me peshë 5 kilogramë për qëllimet e pagesës së detyrimeve përfundimtare.

8. Për artikujt rekomandë do të ketë një pagesë shtesë prej 0.55 SDR për artikull për vitin 2010 dhe 2011 dhe 0.6 SDR për vitin 2012 dhe 2013. Për artikujt e siguruar do të ketë një pagesë shtesë prej 1.1 SDR për artikull për vitin 2010 dhe 2011 dhe 1.2 SDR për vitin 2012 dhe 2013. Këshilli i Operacioneve Postare do të jetë i autorizuar të plotësojë shpërblimin për këtë dhe për shërbime të tjera shtesë kur shërbimet e ofruara përmbajnë karakteristika shtesë që duhet të specifikohen në Rregulloren e Postës së Letrave.

9. Çdo operator i caktuar, me një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, mund të aplikojnë sisteme të tjerë pagese për shlyerjen e çmimit të detyrimeve përfundimtare.

10. Operatorët e caktuar mund të shkëmbejnë postë jo – prioritare në bazë fakultative duke aplikuar një zbritje prej 10% në çmimin e detyrimeve përfundimtare prioritare.

11. Operatorët e caktuar mund të shkëmbejnë postë me format të veçuar në baza fakultative me çmim të reduktuar të detyrimeve përfundimtare.

12. Dispozitat e aplikueshme ndërmjet operatorëve të caktuar të shteteve në sistemin objektiv do të aplikohen edhe për operatorët e caktuar të një shteti në sistemin e tranzicionit i cili deklaron se dëshiron të anëtarësohet në sistemin objektiv. Këshilli i Operacioneve Postare mund të vendosë masa tranzicioni në Rregulloren e Postës së Letrave. Dispozitat e plota të sistemit objektiv mund të zbatohen për operatorin e ri objektiv të caktuar i cili deklaron se dëshiron të aplikojë këto dispozita të plota pa masa tranzicioni.

Neni 28

Shpenzimet përfundimtare. Dispozitat e aplikueshme për flukset e postës midis operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit objektiv

1. Pagesat për artikujt e postës së letrave, duke përfshirë edhe postën me sasi, por duke përjashtuar thasët M dhe artikujt IBRS, do të vendoset në bazë të aplikimit të çmimeve për artikull ose për kilogram, duke reflektuar kostot e përpunimit në shtetin e destinacionit; këto kosto duhet përshtaten me tarifat e brendshme. Llogaritja e çmimeve do të bëhet në përputhje me kushtet e parashikuara në Rregulloren e Postës së Letrave.

2. Pagesat për artikujt IBRS do të jetë ajo e përshkruar në Rregulloren e Postës së Letrave.

3. Çmimet për artikull dhe për kilogram do të llogariten sipas përqindjes së tarifës së një letre prioritare prej 20 gramësh në regjimin e brendshëm, e cila do të jetë 70% për shtetet në sistemin objektiv përpara vitit 2010 dhe 100% për shtetet që hyjnë në sistemin objektiv nga 2010 ose 2012 (shtete të reja të sistemit objektiv).

4. Këshilli i Operacioneve Postare do të kryejë një studim për koston e përpunimit të postës në hyrje gjatë 2009 dhe 2010. Nëse studimi tregon një përqindje të ndryshme nga 70% i vendosur në paragrafin 3, POC do të konsiderojë nëse do të ndryshojë përqindjen e tarifës për letrën prioritare 20-gram për vitet 2012 dhe 2013.

5. Për tarifën e përdorur për llogaritjes në paragrafin 3 të mësipërm, 50% e TVSH-së ose taksa të tjera do të përjashtohen për vitet 2010 dhe 2011, dhe 100% për vitet 2012 dhe 2013.

6. Çmimet e aplikuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010 nuk duhet të jenë më të larta se:

6.1 për vitin 2010, 0.253 SDR për artikull dhe 1.980 SDR për kilogram;

6.2 për vitin 2011, 0.263 SDR për artikull dhe 2.059 SDR për kilogram;

6.3 për vitin 2012, 0.274 SDR për artikull dhe 2.141 SDR për kilogram;

6.4 për vitin 2013, 0.285 SDR për artikull dhe 2.227 SDR për kilogram.

7. Çmimet e aplikuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010 nuk mund të jenë më të ulëta çmimet në 2009, para aplikimit të lidhjes së cilësisë së shërbimit. Çmimet, gjithashtu nuk do të jenë më të ulëta se:

7.1 për vitin 2010, 0.165 SDR për artikull dhe 1.669 SDR për kilogram;

7.2 për vitin 2011, 0.169 SDR për artikull dhe 1.709 SDR për kilogram;

7.3 për vitin 2012, 0.173 SDR për artikull dhe 1.750 SDR për kilogram;

7.4 për vitin 2013, 0.177 SDR për artikull dhe 1.792 SDR për kilogram.



8. Çmimet e aplikuara për flukset për, nga ose ndërmjet shteteve të reja të sistemit objektiv, të ndryshme nga posta në sasi do të jenë:

8.1 për vitin 2010: 0.155 SDR për artikull dhe 1.562 SDR për kilogram;

8.2 për vitin 2011: 0.159 SDR për artikull dhe 1.610 SDR për kilogram;

8.3 për vitin 2012: 0.164 SDR për artikull dhe 1.648 SDR për kilogram;

8.4 për vitin 2013: 0.168 SDR për artikull dhe 1.702 SDR për kilogram.

9. Pagesa për postën në sasi do të vendoset duke aplikuar çmimet për njësi dhe për kilogramë të përcaktuara në nenin 28, paragrafët 3 deri në 7.

10. Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe për artikujt rekomandë dhe të siguruar që nuk kanë një identifikues me barkod ose kanë një identifikues me barkod që nuk përputhet me Standardin Teknik S10 të UPU, do të ketë një pagesë shtesë prej 0.5 SDR për artikull.

11. Me përjashtim të rasteve brenda këtij kuadri ose të marrëveshjes dypalëshe nuk do të bëhet asnjë rezervë për këtë nen.

Neni 29

Shpenzimet përfundimtare. Dispozita të aplikueshme për fluksin e letrave për, nga dhe midis operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit të tranzicionit

1. Në përgatitjen për të hyrë në sistemin objektiv të operatorëve të caktuar të shteteve në sistemin e tranzicionit të shpenzimeve përfundimtare, pagesat për postën e letrave, duke përfshirë postën në sasi por duke përjashtuar thasët M dhe artikujt IBRS, do të vendosen në bazë të rritjes vjetore prej 2.8% në korrigjim të çmimeve të vitit 2009, duke përdorur mesataren botërore prej 14.64 artikuj për kilogramë.

2. Pagesat për artikujt IBRS do të përshkruhen në Rregulloren e Postës së Letrave.

3. Çmimet e aplikuara për flukset për, nga dhe ndërmjet shteteve në sistemin e tranzicionit do të jenë:

3.1 për vitin 2010: 0.155 SDR për artikull dhe 1.562 SDR për kilogram;

3.2 për vitin 2011: 0.159 SDR për artikull dhe 1.610 SDR për kilogram;

3.3 për vitin 2012: 0.164 SDR për artikull dhe 1.648 SDR për kilogram;

3.4 për vitin 2013: 0.168 SDR për artikull dhe 1.702 SDR për kilogram.

4. Për flukset nën 100 ton për vit, elementët për kilogramë dhe artikuj do të konvertohen në çmimin total për kilogramë në bazë të mesatares botërore prej 14.64 artikuj për kilogramë. Do të aplikohen çmimet e mëposhtme:

4.1 për vitin 2010: 3.831 SDR për kilogram;

4.2 për vitin 2011: 3.938 SDR për kilogram;

4.3 për vitin 2012: 4.049 SDR për kilogram;

4.4 për vitin 2013: 4.162 SDR për kilogram.

5. Për flukset e postës mbi 100 tonë për vit, do të aplikohet çmimi i fiksuar për kilogramë siç renditur më sipër nëse as operatori i caktuar i origjinës dhe as operatori i caktuar i destinacionit nuk kërkojnë mekanizmin e rishikimit me qëllim rishikimin e çmimit në bazë të numrit real të artikujve për kilogramë, të ndryshëm nga mesatarja vjetore. Marrja e kampionëve për mekanizmin e rishikimit do të zbatohet në përputhje me kushtet e caktuara në Rregulloren e Postës së Letrave.

6. Nuk mund të kërkojë rishikimi në rënie i çmimit total të paragrafit 4 nga një shtet në sistemin objektiv ndaj një shteti në sistemin e tranzicionit me përjashtim të rastit kur ky i fundit kërkon një rishikimin në drejtim të kundërt.

7. Pagesa për postën në sasi për operatorët e caktuar në shtetet në sistemin objektiv do të vendoset duke aplikuar çmimet për artikuj dhe për kilogramë të dhëna në nenin 28. Për postën në sasi të marrë, operatorët e caktuar në sistemin e tranzicionit mund të kërkojnë pagesën në përputhje me paragrafin 3.

8. Me përjashtim të rasteve të marrëveshjeve dypalëshe, nuk do të zbatohet asnjë rezervë për këtë nen.

Neni 30

Fondi për Cilësinë e Shërbimit

1. Me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, shpenzimet përfundimtare të pagueshme nga të gjitha shtetet dhe territoret e shteteve të klasifikuara nga Kongresi në

grupin e 5 të shteteve për shpenzimet përfundimtare dhe Fondit për Cilësinë e Shërbimit, do të rriten me 20% të çmimeve të dhëna në nenin 29 për pagesën në Fondin për cilësinë e shërbimit (QSF) në shtetet e grupit të 5-të. Kjo pagesë nuk do të kryhet nga një shtet i grupit të 5-të për një shtet tjetër të grupit të 5-të.

2. Shpenzimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 1 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 4 do të shtohen me 10% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 4.

3. Që nga 1 Janari 2012, detyrimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 2 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 4 do të shtohen me 10% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 4.

4. Shpenzimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 1 të cilat ishin në sistemin objektiv para vitit 2010 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 3 do të shtohen me 8% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 3.

5. Shpenzimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 1 të cilat ishin në sistemin objektiv në vitin 2010 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 3 do të shtohen me 4% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 3.

6. Që nga 1 Janari 2012, detyrimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 2 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 3 do të shtohen me 4% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 3.

7. Shpenzimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 1 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 2 të cilat kanë përfutur nga një rritje prej 8% para vitit 2010, do të rriten në 2010 dhe 2011 me 4% të çmimeve të dhëna në nenin 29, dhe në 2012 dhe 2013 me 2% të çmimeve të dhëna në nenin 28.8, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 2.

8. Shpenzimet përfundimtare, me përjashtim të thasëve M, artikujve IBRS dhe artikujve të postës në sasi, të pagueshme nga shtetet dhe territoret e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 1 për shtetet e klasifikuara nga Kongresi si shtete të grupit 2 të cilat kanë përfutur nga një rritje prej 1% para vitit 2010, do të rriten në 2010 dhe 2011 me 1% të çmimeve të dhëna në nenin 29, për pagesë në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupit 2.

9. Shpenzimet përfundimtare të kombinuara të pagueshme në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shtetet e grupeve 2, 3, 4 dhe 5 do të jenë subjekt i një minimumi prej 12,565 SDR për vit për secilin prej shteteve përfituese. Fondet shtesë të nevojshme për arritjen e shumës minimale do të faturohen në proporcion me vëllimet e shkëmbyera, shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010.

10. Projektet rajonale duhet të promovojnë në veçanti zbatimin e programeve të përmirësimit të cilësisë së shërbimit të UPU, dhe të vendosjes së sistemit të kontabilitetit të kostos në shtetet në zhvillim. Këshilli i Operacioneve Postare do të miratojë, maksimumi në 2010, procedurat e përshtatshme për financimin e këtyre projekteve.

Neni 31

Tarifat e transitit

1. Dërgesat e mbyllura dhe artikujt në transit à découvert të shkëmbyera mes dy operatorëve të caktuar ose dy zyrave të të njëjtit shtet anëtar me anë të shërbimeve të një ose të shumë operatorëve të tjerë të caktuar (shërbimet nga palë të treta) i nënshtrohen pagesës së tarifave të transitit. Këto do të përbëjnë shpërblimin për shërbimet e dhëna në lidhje me transitin tokësor, detar dhe ajror. Ky parim do të aplikohet edhe për artikuj e dërguar gabim dhe të devijuar.



KAPITULLI II DISPOZITA TË TJERA

Neni 32

Çmimet bazë dhe dispozitat në lidhje me detyrimet e transportit ajror

1. Çmimi bazë e zbatueshëm për shlyerjen e llogarive ndërmjet operatorëve të caktuar për transportet ajrore do të miratohet nga Këshilli i Operacioneve Postare. Ai do të llogaritet nga Byroja Ndërkombëtare sipas formulës së specifikuar në Rregulloren e Postës së Letrave.

2. Llogaritja e detyrimeve të transportit ajror për dërgesat e mbyllura, artikujt prioritarë dhe artikujt e postës ajrore të dërguara në transit à *découvert*, artikujve të dërguar gabim dhe dërgesave të devijuara, si edhe mënyrat përkatëse të kontabilizimit do të përcaktohen në Rregulloren e Postës së letrave dhe në Rregulloren e kolipostës.

3. Detyrimet e transportit ajror për të gjithë distancën do të paguhën:

3.1 në rastin e dërgesave të mbyllura, nga operatorët e caktuar të shtetit të origjinës, duke përfshirë edhe rastin kur dërgesat tranzitojnë në një ose më shumë operatorëve të caktuar ndërmjetës;

3.2 në rastin e dërgesave prioritare dhe dërgesave me rrugë ajrore në transit à *découvert*, nga operatorët e caktuar të cilët dërgojnë artikujt tek një operator tjetër i caktuar.

4. Këto rregullore do të jenë të aplikueshme edhe për artikujt e përjashtuar nga tarifat e transitit tokësor dhe detar, nëse ata janë transportuar me rrugë ajrore.

5. Çdo operator i caktuar i destinacionit që ofron transportin ajror të postës ndërkombëtare brenda shtetit të tij, do të ketë të drejtën të rimbursohet për kostot shtesë të transportit, edhe pse mesatarja e ponderuar e udhëtimeve të bëra i kalon të 300 kilometra. Këshilli i Operacioneve postare mund të zëvendësojë distancën mesatare të ponderuar me një kriter tjetër të qëndrueshëm. Me përjashtim të rastit të marrëveshjeve që parashikojnë shërbimin falas, shpenzimet duhet jenë të njëjta për të gjitha dërgesat prioritare dhe për dërgesat me avion, që vijnë nga jashtë shtetit, pavarësisht nëse ato dërgohen me transport ajror ose jo.

6. Megjithatë, kur detyrimet përfundimtare të vëna nga operatori i caktuar i destinacionit bazohet specifikisht mbi kostot ose çmimet e brendshme, nuk do të bëhet asnjë rimbursim plotësues për shpenzimet e transportit ajror.

7. Operatorët e caktuar të destinacionit do të përjashtojnë, për qëllimet e llogaritjes së distancës mesatare të ponderuar, peshën e të gjithë dërgesave për të cilat llogaritja e shpenzimeve përfundimtare bazohet specifikisht në kostot ose në çmimet e brendshme të operatorit të caktuar të destinacionit.

Neni 33

Çmimet e kolipostës tokësore dhe detare

1. Kollitë e shkëmbyera ndërmjet dy operatorëve të caktuar, do të jenë subjekt i çmimeve tokësore në hyrje të llogaritura duke kombinuar çmimin bazë për koli dhe çmimin bazë për kilogram të përcaktuar nga Rregullorja.

1.1 Duke pasur parasysh çmimet bazë të mësipërme, operatorët e caktuar mund të jenë të autorizuar të kërkojnë çmime shtesë për koli dhe për kilogramë, sipas dispozitave të parashikuara në Rregullore.

1.2 Çmimet e përmendura në pikën 1 dhe 1.1, do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur Rregullorja e Kolipostës parashikon përjashtime për këtë parim.

1.3 Çmimet tokësore për kollitë në hyrje, duhet të jenë të njëjta për të gjithë territorin e çdo shteti.

2. Kollitë e shkëmbyera ndërmjet dy operatorëve të caktuar ose ndërmjet dy zyrave të të njëjtit shtet me anë të mjeteve të shërbimit tokësor të një ose të disa operatorëve të caktuar, do të jenë subjekt i çmimeve të transitit tokësor, të pagueshme operatorëve të caktuar të cilët marrin pjesë në transportin në tokë, të caktuara nga Rregullorja në përputhje me hapin e distancës të aplikueshëm.

2.1 Për kollitë në transit à *découvert*, operatorët e caktuar ndërmjetës do të jenë të autorizuar të kërkojnë çmimin unik për artikull të caktuar në Rregullore.

2.2 Pagesat tokësore të transitit do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur Rregullorja kolipostës parashikon përjashtime për këtë parim.

3. Çdo operator i caktuar i cili merr pjesë në transportin detar të kolive do të jetë i autorizuar të kërkojë çmimin e transportit detar. Këto çmime do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur Rregullorja e Kolipostës parashikon përjashtime për këtë parim.

3.1 Për çdo transport detar të përdorur, çmimi detar do të caktohet nga Rregullorja e Kolipostës sipas hapit të distancës të aplikueshëm.

3.2 Operatorët e caktuar mund të rrisin me maksimumi 50% çmimin detar të llogaritur sipas pikës 3.1. Nga ana tjetër, ato mund ta reduktojnë atë sipas vullnetit të tyre.

Neni 34

Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për të caktuar tarifat dhe çmimet

1 Këshilli i Operacioneve Postare do të ketë autoritetin të caktojë çmimet dhe tarifat e mëposhtme, të cilat janë të pagueshme nga operatorët e caktuar sipas kushteve të caktuara në Rregullore:

1.1 tarifat e transitit për përpunimin dhe transportin e dërgesave të letrave nëpërmjet një ose më shumë shteteve ndërmjetëse,

1.2 çmimet bazë dhe detyrimet e transportit ajror të zbatueshme për postën me rrugë ajrore;

1.3 çmimet tokësore të postës në hyrje për përpunimin e kolive të mbërritura;

1.4 çmimet tokësore të kolive të mbërritura për përpunimin dhe transportin e kolive nga një shtet ndërmjetës;

1.5 çmimet detare për transportin detar të kolive.

2. Çdo rishikim që mund të bëhet, në përputhje me metodologji që siguron shpërblim të barabartë për operatorët e caktuar që kryejnë këto shërbime, duhet të mbështeten mbi të dhënat ekonomike dhe financiare të besueshme dhe përfaqësuese. Ndryshimi i mundshëm që mund të vendoset, do të hyjë në fuqi në një datë të caktuar nga Këshilli i Operacioneve Postare.

PJESA E KATËRT DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me Konventën dhe Rregulloren

1. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura në Kongres në lidhje me këtë Konventë, duhet të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë duke pasur të drejtën e votës. Të paktën gjysma e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, që kanë të drejtën e votës, duhet të jenë të pranishëm në momentin e votimit.

2. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet në lidhje me Rregulloren e postës së Letrave dhe Rregulloren e Kolipostës duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Operacioneve Postare, që kanë të drejtën e votës.

3. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura midis dy Kongreseve në lidhje me këtë Konventë dhe protokollin përfundimtar të saj duhet të marrë:

3.1 dy të tretat e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës, nëse përfshihen amendime;

3.2 shumicë të votave, nëse përfshihen interpretime të dispozitave.

4. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikën 3.1, çdo shtet anëtar, legjislacioni i brendshëm i të cilit është ende i papajtueshëm me amendimin e propozuar, mund të bëjë një deklaramë me shkrim për Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare duke deklaruar pamundësinë për të pranuar këtë amendim, brenda 90 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të tij.

Neni 36

Rezerva të paraqitura në Kongresit

1. Nuk do të lejohen rezervat që nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit.

2. Si rregull i përgjithshëm, çdo shtet anëtar pikëpamjet e të cilit nuk janë të njëjta me ato të shteteve të tjera, duhet të bëjë përpjekje, brenda mundësive, të përputhet me opinionin e shumicës. Rezervat do të bëhen vetëm në rast të nevojës absolute dhe duhen të jepet një motiv i përshtatshëm për to.



3. Rezervat për ndonjë nen të kësaj Konvente duhet të paraqiten në Kongres, në formën e propozimit për Kongres të shkruar në një gjuhë pune të Byrosë ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat e Rregullave të Procedurës së Kongresit.

4. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet që kanë të bëjnë me rezervat duhet të miratohen nga shumica e kërkuar për amendimin e nenit me të cilin lidhet rezerva.

5. Në parim, rezerva do të zbatohet në bazën e një reciprociteti midis shtetit anëtar që e paraqet atë dhe shteteve të tjera anëtare.

6. Rezervat e këtij Kongresi, do të përfshihen në Protokollin përfundimtar të kësaj Konvente, mbi bazën e propozimeve të miratuara nga Kongresi.

Neni 37

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Konventës

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2010, dhe do të jetë në fuqi deri në ardhjen në fuqi të Akteve të Kongresit të ardhshëm.

Në dëshmi të sa më sipër të plotfuqishmit e Qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë Konventë në një kopje, e cila do të depozitohet pranë Drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare. Një kopje do ti jepet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Gjenevë, 12 gusht 2008

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I KONVENTËS POSTARE UNIVERSALE

Në momentin e nënshkrimit të Konventës Postare Universale të përfunduar në këtë ditë, të Plotfuqishmit ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Pronësia e artikujve postarë. Tërheqja nga posta. Ndryshimet ose korrigjimi i adresave

1. Dispozitat e nenit 5.1 dhe 2, nuk do të zbatohen në Antigua dhe Barbuda, Bahrein, Barbada, Belize, Bostvana, Brunei Darusalam, Kanada, Hong Kong, Kinë, Domenika, Egjipt, Fixhi, Gambia, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Territoret e varura jashtë Mbretërisë së Bashkuar, Grenada, Guajanë, Irlandë, Xhamajkë, Kenia, Kiribati, Kuvait, Lesoto, Malavi, Malejzi, Mauricius, Noru, Zelandë e Re, Nigeri, Ugandë, Guine e Re, Shën Kristof dhe Nevis, Shën Lucia, Shën Vinsent dhe Grenadine, Samoa, Seishel, Siera Leone, Singapor, Ishujt Solomon, Svaziland, (Republika e Bashkuar e) Tanzani, Trinidad dhe Tobago, Tuvalu, Ugandë, Vanuatu, Zambia.

2. Dispozitat e nenit 5.1 dhe 2 nuk do të zbatohen në Austri, Danimarkë, (Republika Islamike) Iran, legjislacionet e të cilit nuk lejojnë tërheqjen nga Posta ose ndryshimin e adresave të korrespondencës sipas kërkesës të dërguesit, duke filluar nga momenti kur marrësi është informuar për mbërritjen e një artikulli në adresën e tij.

3. Neni 5.1 nuk do të zbatohet në Australi, Ganë dhe Zimbabve.

4. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Bahamas, Belgjikë, Irak, në Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Mianmar legjislacioni i të cilave nuk lejojnë tërheqjen nga posta ose ndryshimin e adresës të artikujve të postës së letrave, sipas kërkesës së dërguesit.

5. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

6. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Australi vetëm për atë që ky nen është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm.

7. Pavarësisht nga neni 5.2, El Salvadori, Panamaja, Filipinet, Republika Demokratike e Kongos, Venezuela, do të jenë të autorizuar të mos kthejnë kolutë pasi marrësi të ketë kërkuar zhdoganimin e tyre, duke qenë se legjislacioni doganor i vendit e kundërshton këtë.

Neni II Tarifat

1. Pavarësisht nga neni 6, Australia, Kanadaja dhe Zelanda e Re, do të jenë të autorizuar të marrin tarifa postare të ndryshme nga ato të parashikuara në Rregullore, kur këto tarifa janë në përputhje me legjislacionin e shtetit të tyre.

Neni III Përfshirje nga përjashtimi nga tarifat postare të literaturës për të verbrit

1. Pavarësisht nga neni 7, Indonezia, Shën Vinsent dhe Grenadine, Turqia, të cilat nuk lejojnë përfshirjen nga tarifat postare të cekogrameve në shërbimin e tyre të brendshëm, mund të marrin tarifa postare dhe tarifa për shërbime speciale të cilat nuk do të tejkalojnë tarifat e aplikuara në shërbimin e tyre të brendshëm.

2. Pavarësisht nga neni 7, Australia, Austria, Kanadaja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Japonia, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të mbledhin tarifa për shërbimet special të cilat zbatohen për literaturën për të verbrit në shërbimin e tyre të brendshëm.

Neni IV Shërbimet bazë

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 12, Australia nuk miraton që shtrirja e shërbimeve bazë të përfshijë edhe koltë postare.

2. Dispozitat e nenit 12.2.4, nuk do të zbatohen në Britaninë e Madhe, legjislacioni kombëtar i së cilës kërkon një limit më të ulët të peshës. Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë në Britaninë e Madhe kufizon peshën e thasëve të postës deri në 20 kilogramë.

3. Pavarësisht nga neni 12.2.4, Kazakistani dhe Uzbekistani do të jenë të autorizuar të kufizojnë në 20 kilogramë peshën maksimale të thasëve M në hyrje dhe në dalje.

Neni V Njoftimi i dërgimit

1. Kanadaja do të jetë e autorizuar të mos zbatojë nenin 13.4.3, për sa i përket kolive, me kusht që të mos ofrojë shërbimin e njoftimit të dërgimit për koltë në shërbimin e saj të brendshëm.

Neni VI Shërbimi i përgjigjes ndërkombëtare të biznesit (IBRS)

1. Pavarësisht nga neni 13.4.1, (Republika) Bullgaria do të ofrojë shërbimin e përgjigjes ndërkombëtare të biznesit pas negociatave me shtetin anëtar të interesuar.

Neni VII Ndalimet (posta e letrave)

1. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Republika Popullore Demokratike e Koresë dhe Libani nuk do të pranojnë artikuj rekomandë që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdolloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë. Ato nuk do të jenë rreptësisht të detyruara nga dispozitat e Rregullores së Postës së Letrave, për sa i përket përgjegjësisë së tyre në rast vjedhje dhe dëmtimi të artikujve rekomandë, ose të artikujve që përmbajnë objekte prej qelqi ose delikatë.

2. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Bolivia, (Republika Popullore) e Kinës, me përjashtim të krahinës administrative speciale të Hong Kongut, Iraku, Nepali, Pakistani, Arabia Saudite, Sudani dhe Vietnami nuk do të pranojnë artikuj rekomandë që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdolloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë.



3. Mianmar rezervon të drejtën të mos pranojë artikujt e siguruar që përmbajnë objektet e çmuara të renditura në nenin 15.5, sepse kjo është në kundërshtim me legjislacionin e saj të brendshëm.

4. Nepali rezervon të drejtën të mos pranojë artikujt rekomandë ose të siguruara që përmbajnë kartëmonedha ose monedha, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje të posaçme për këtë.

5. Uzbekistani nuk do të pranojë artikujt rekomandë ose të siguruar që përmbajnë monedha, kartëmonedha, çeqe, pulla të postës dhe monedha të huaja dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

6. Irani (Republika islamike) nuk do të pranojë dërgesat që përmbajnë objekte në kundërshtim me fenë Islame.

7. Filipinet rezervojnë të drejtën të mos pranojë dërgesat e postës së letrave (të zakonshme, rekomandë ose të siguruara), monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar ose objekte të tjera me vlerë.

8. Australia nuk do të pranojë asnjë artikull postar që përmban lingota ose kartëmonedha. Përveç kësaj, ajo nuk do të pranojë artikujt rekomandë me destinacion Australinë, as dërgesat në transit *a decouvert* që përmbajnë objekte me vlerë, si bizhuteri, metale të çmuara, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, kartëmonedha ose objekte të tjera financiare të negociueshme. Ajo largon çdo përgjegjësi në lidhje me artikujt e postuar, të cilat janë në kundërshtim me këtë rezervë.

9. Kina (Republika Popullore), me përjashtim të Krahinës Speciale Administrative të Hongkongut, nuk do të pranojë artikujt të siguruar, që përmbajnë monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi në përputhje me rregulloret e saj të brendshme.

10. Letonia dhe Mongolia, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, rezervojnë të drejtën të mos pranojnë postë të zakonshme, rekomandë, ose të siguruar, që përmbajnë monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

11. Brazili rezervon të drejtën të mos pranojë postë të zakonshme, rekomandë ose të siguruar, që përmban monedha, kartëmonedha në qarkullim ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit.

12. Vietnami rezervon të drejtën të mos pranojë letra që përmbajnë objekte ose mallra.

13. Indonezia nuk do të pranojë artikujt rekomandë ose të siguruar që përmbajnë monedha, kartëmonedha, çeqe, pulla postare, monedha të huaja, ose çfarëdo lloj letrash me vlerë të pagueshme prurësit për tu dorëzuar në Indonezi, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rastet e humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

14. Kirgistani rezervon të drejtën të mos pranojë artikujt të postës së letrave (të zakonshëm, rekomandë, të siguruar, pako të vogla) që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

15. Kazakistani nuk do të pranojë artikujt rekomandë ose të siguruar që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqe, metale të çmuara, të përpunuara ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

16. Moldavia dhe Federata Ruse nuk do të pranojnë artikujt rekomandë ose të siguruar që përmbajnë kartëmonedha në qarkullim, letra me vlerë (çeqe) të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedhë të huaj, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

Neni VIII

Ndalimet (kolitë postare)

1. Mianmari dhe të Zambia do të jenë të autorizuar të mos pranojnë kolinë të siguruara që përmbajnë objekte të çmuar të përmendura në nenin 15.6.1.3.1, duke qenë se është në kundërshtim me rregulloren e brendshme.

2. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Libani dhe Sudani nuk do të pranojnë kolinë, që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara, ose që përmbajnë lëndë të lëngëta ose elementë të tjerë të lehtësisht të lëngëzueshëm, ose objekte prej qelqi ose të ngjashme delikate. Ato nuk do të jenë të detyruara të respektojnë dispozitat përkatëse të Rregullores së Kolipostës.

3. Brazili do të jetë i autorizuar të mos pranojë kolitë e siguruara që përmbajnë monedha dhe kartëmonedha në qarkullim, si edhe çfarëdolloj letre me vlerë të pagueshme prurësit, duke qenë se kjo është në kundërshtim me rregulloren e tij të brendshme.

4. Gana do të jetë e autorizuar të mos pranojë kolitë e siguruara që përmbajnë monedha dhe kartëmonedha në qarkullim, duke qenë se kjo është në kundërshtim me rregulloren e saj të brendshme.

5. Përveç objekteve të përcaktuara në nenin 15, Arabia Saudite do të jetë e autorizuar të mos pranojë kolitë që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara. Ajo nuk do të pranojë edhe kolitë që përmbajnë ilaçe të çdo lloji, me përjashtim të rastit kur shoqërohen me një recetë mjekësore të lëshuar nga një autoritet zyrtar kompetent, produkte të destinuara për fikjen e zjarreve, lëngje kimike ose objekte të tjerë, kundër parimeve të fesë Islame.

6. Përveç objekteve të referuara në nenin 15, Oman-i nuk pranon artikujt që përmbajnë:

6.1 ilaçe të çdo lloji me përjashtim të rastit kur shoqërohen me një recetë mjekësore, e lëshuar nga një autoritet zyrtar kompetent;

6.2 produkte të destinuara për fikjen e zjarrit dhe lëngje kimike;

6.3 objekte që janë në kundërshtim me parimet e fesë Islame;

7. Përveç objekteve të cituara në nenin 15, Irani (Republika Islamike) do të jetë e autorizuar të mos pranojë kolitë që përmbajnë artikuj në kundërshtim me parimet e fesë Islame.

8. Filipinet do të jenë të autorizuar të mos pranojnë koli që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara, ose që përmbajnë lëngje dhe elementë lehtësisht të lëngëzueshëm, apo objekte prej qelqi ose të ngjashme ose delikate.

9. Australia nuk pranon asnjë artikuj postarë që përmbajnë lingota apo kartëmonedha.

10. Kina (Republika Popullore) nuk do të pranojë pakot e zakonshme që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara. Përveç kësaj, vetëm me përjashtim të Krahinës Speciale Administrative të Hong Kongut, nuk do të pranohen kolitë e siguruara që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

11. Mongolia rezervon të drejtën të mos pranojë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, kolitë që përmbajnë kartëmonedha, letra me vlerë të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

12. Letonia nuk pranon kolitë e zakonshme dhe të siguruara që përmbajnë kartëmonedha, letra me vlerë (çeqe)të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast humbjeje ose dëmtimi të këtyre artikujve.

13. Moldavia, Federata Ruse Ukraina dhe Uzbekistani nuk pranojnë koli të zakonshme ose të siguruara që përmbajnë kartëmonedha në qarkullim, letra me vlerë (çeqe) të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedhë të huaj, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

14. Kazakistani nuk do të pranojë koli të zakonshme ose të siguruara që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqe, metale të çmuara, të përpunuara ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

Neni IX

Materiale të lejueshme radioaktive dhe substanca infektuese

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 16, Mongolia rezervon të drejtën të mos pranojë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, artikuj postarë që përmbajnë material radioaktive ose substance infektuese.

Neni X

Objekte subjekt i detyrimeve doganore

1. Duke iu referuar nenit 15, Bangladeshi dhe El Salvadori nuk pranojnë artikuj të siguar që përmbajnë objekte që ju nënshtrohen detyrimeve doganore.



2. Duke iu referuar nenit 15, Afganistani, Shqipëria, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kamboxhia, Kili, Kolumbia, Kuba, Republika popullore Demokratike e Koresë, El Salvadori, Estonia, Italia, Kazakistani, Letonia, Moldavia, Nepali, Peruja, Federata Ruse, San Marino, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani, Venezuela nuk pranojnë letrat e zakonshme dhe rekomande që përmbajnë objekte që ju nënshtrohen detyrimeve doganore.

3. Duke iu referuar nenit 15, Benini, Burkina Faso, (Republika) Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Mali dhe Mauritania nuk pranojnë letra të zakonshme që ju nënshtrohen detyrimeve doganore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikat 1 deri tek 3, dërgimi i serumeve, vaksinave, si edhe ilaçeve të kërkuara urgjent, të cilat është e vështirë të gjenden në vend, do të lejohen në të gjitha rastet.

Neni XI Reklamimet

1. Pavarësisht nga neni 17.3, Bullgaria (Republika), Kepi i gjelbër, Çadi, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Egjipti, Gaboni, Territoret jashtë vendit të varura nga Mbretëria e Bashkuar, Greqia, Irani, Kirgistani, Mongolia, Mianimari, Filipinet, Arabia Saudite, Sudani, Republika Arabe e Sirisë, Turkmenistani, Ukraina Uzbekistani dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët tarifa mbi reklamimet e bëra në lidhje me artikujt e postës së letrave.

2. Pavarësisht nga neni 17.3, Argjentina, Austria, Azerbajxhani, Lituania, Moldavia dhe Sllovakia, rezervojnë të drejtën të marrin një taksë speciale kur, pas hetimit të kryer në përgjigje të reklamimit, kjo e fundit konstatohet se ky i fundit nuk ishte i justifikuar.

3. Afganistani, Bullgaria (Republika), Kepi i Gjelbër, Kongo (Republika), Egjipti, Gaboni, Iranit (Republika Islamike), Kirgistani, Mongolia, Mianmari, Arabia Saudite, Sudani, Surinami, Republika Arabe e Sirisë, Ukraina, Uzbekistani dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë reklamimi në lidhje me koltë.

4. Pavarësisht nga neni 17.3, Brazili, Panamaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë për reklamimet e bëra në lidhje me artikujt e postës së letrave dhe koltë e postuara në shtetet që aplikojnë këtë lloj tarife, në përputhje me paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni.

Neni XII Tarifa e paraqitjes në Doganë

1. Gaboni rezervon të drejtën të marrë nga klientët e saj një tarifë të paraqitjes në doganë në lidhje me koltë.

2. Kongo (Republika) dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë për paraqitjen në doganë në lidhje me koltë.

Neni XIII Postimi jashtë shtetit i artikujve të postës së letrave

1. Australia, Austria, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Greqia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rezervojnë të drejtën të marrin një tarifë, të barabartë me koston e punës që kërkohet, ndaj çdo operator të caktuar, i cili sipas dispozitave të nenit 26.4, i dërgojnë artikuj që nuk janë dërguar si artikuj postarë nga shërbimet e tyre.

2. Pavarësisht nga neni 26.4, Kanadaja rezervon të drejtën të marrë nga operatorët e caktuar të origjinës një shumë që do të sigurojë të paktën mbulimin e e kostove të përballura nga ajo për përpunimin e këtyre artikujve.

3. Neni 26.4 autorizon operatorët e caktuar të destinacionit të kërkojnë nga operatori i caktuar dërgues, një shpërblim të përshtatshëm për dërgesën e artikujve të postës së letrave jashtë shtetit në sasi të mëdha. Australia dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut rezervojnë të drejtën të kufizojnë këtë pagesë në shumën korresponduese me tarifën e brendshme për artikuj të ngjashëm në shtetin e destinacionit.

4. Neni 26.4 autorizon operatorin e caktuar të destinacionit të kërkojë nga operatori i caktuar dërgues një shpërblim e përshtatshëm për shpërndarjen e artikujve të postës së letrave të postuara jashtë shtetit në sasi të mëdha. Shtetet anëtare e mëposhtme rezervojnë të drejtën për të kufizuar këtë pagesë në limitet e autorizuara në Rregullore për postën në sasi: Bahamas, Barbados, Brunei Darusalam, Kina (Republika Popullore), Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Territoret jashtë shtetit të varura nga Mbretëria e Bashkuar, Grenada, Gujana, India, Malajzia, Nepali, Zelanda e Re, Holanda, Antilet e Hollandës dhe Aruba, Shën Lucia, Shën Vinsent dhe Grenadina, Singapori, Sri Lanka, Surinami, Tajlanda dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

5. Pavarësisht nga rezervat e pikës 4, shtetet anëtare të mëposhtme kanë të drejtën në të zbatojnë të plota dispozitat e nenit 26 të Konventës për postën që marrin nga shtetet anëtare të Bashkimit; Argjentina, Austria, Benin, Brazili, Burkina Faso, Kameruni, Qipro, Bregu i Fildishtë (Republika), Qipro, Danimarka, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Guineja, Izraeli, Italia, Japonia, Jordania, Libani, Luksemburgu, Mali, Mauricius, Monako, Maroku, Norvegjia, Portugalia, Senegali, Republika Arabe e Sirisë dhe Togo.

6. Në zbatim të nenit 26.4, Gjermania rezervon të drejtën të kërkojë nga shteti dërgues pagesën e një shume që është ekuivalente e asaj që do merrej nga shteti ku është rezident dërguesi.

7. Pavarësisht nga rezervat e bëra në nenin XIII, Kina (Republika Popullore) rezervon të drejtën të kufizojë çdo pagesë për shpërndarjen e artikujve të postës së letrave të postuara jashtë shtetit në sasi të mëdha nga limitet e autorizuara në Konventën e UPU dhe Rregulloren e postës së letrave për postën në sasi.

Neni XIV

Çmime tokësore të jashtëzakonshme për postën në hyrje

1. Pavarësisht nga neni 33, Afganistani rezervon të drejtën të marrë një çmim tokësor të jashtëzakonshëm shtesë prej 7. 50 SDR për koli.

Neni XV

Tarifa të posaçme

1. Belgjika, Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të marrin për kolitë ajrore çmime më të larta se për kolitë tokësore.

2. Libani do të jetë i autorizuar të marrë për kolitë deri në 1 kilogram tarifën e aplikueshme për kolitë mbi 1 dhe deri në 3 kilogramë.

3. Panamaja (Republika), do të jetë e autorizuar të marrë 0.20 SDR për kilogramë, për kolitë e transportuara me rrugë ajrore (S.A.L) në transit.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit si më poshtë, kanë hartuar këtë protokoll që do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri që do të kishin sikur këto dispozita të ishin përfshirë në tekstin e Konventës, dhe ata kanë nënshkruar në një kopje të vetme, e cila është dorëzuar pranë Drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje do t'i jepet çdo Pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Gjenevë, 12 gusht 2008.



MARRËVESHJE E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE POSTARE

Pasqyra e lëndës

PJESA I

Parime të përbashkëta që aplikohen për shërbimet e pagesave postare

Kapitulli I

Dispozita të përgjithshme

Neni

- 1 Qëllimi i Marrëveshjes
- 2 Përkufizime
- 3 Caktimi i operatorit
- 4 Funksionet e shteteve anëtare
- 5 Funksione operative
- 6 Pronësia e fondeve të shërbimeve të pagesave postare
- 7 Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik
- 8 Konfidencialiteti
- 9 Neutraliteti teknologjik

KAPITULLI II

Parime të përgjithshme dhe cilësia e shërbimit

- 10 Parime të Përgjithshme
- 11 Cilësia e shërbimit

KAPITULLI III

Parime për shkëmbimin e të dhënave elektronike

- 12 Ndërveprueshmëria
- 13 Garantimi i sigurisë së shkëmbimeve elektronike
- 14 Gjurmimi dhe gjetja

PJESA II

Rregullat që disiplinojnë shërbimet e pagesave postare

KAPITULLI I

Përpunimi i urdhër – pagesave postare

- 15 Depozitimi, regjistrimi dhe transmetimi i urdhër-pagesave postare
- 16 Kontrolli dhe lëshimi i fondeve
- 17 Shuma maksimale
- 18 Rimbursimi

KAPITULLI II

Reklamimet dhe përgjegjësitë

- 19 Reklamimet
- 20 Përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj përdoruesve
- 21 Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të caktuar ndaj njëri-tjetrit
- 22 Mungesa e përgjegjësisë së operatorëve të caktuar
- 23 Rezerva në lidhje me përgjegjësinë

KAPITULLI III

Marrëdhënie financiare

- 24 Rregullat e kontabilitetit dhe ato financiare
- 25 Shlyerja dhe kompensimi

PJESA III

Dispozita tranzitore dhe përfundimtare

- 26 Rezerva të paraqitura në Kongres
- 27 Dispozita përfundimtare
- 28 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare

MARRËVESHJE E SHËRBIMIT TË PAGESAVE POSTARE

Të nënshkruarit, të plotfuqishmit e Qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, në përputhje me nenin 22.4 të Kushtetutës së Bashkimit Universal Postar të realizuar në Vjenë më 10 Korrik 1964, me miratim të përbashkët dhe subjekt i nenit 25.4 të Kushtetutës, kanë hartuar Marrëveshjen vijuese, e cila është në përputhje me parimet e Kushtetutës për zbatimin e një shërbimi të pagesave postare të sigurt dhe të arritshme nga numri më i lartë i përdoruesve në bazë të një sistemi që mundëson ndërveprueshmërinë e rrjeteve të operatorëve të caktuar.

PJESA I

PARIME TË PËRBASHKËTA QË APLIKOHEN PËR SHËRBIMET E PAGESAVE POSTARE

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Çdo shtet do të garantojë në bazë të përpjekjeve më të mira se do të ofrojë të paktën një nga shërbimet e mëposhtme në territorin e tij:

1.1 Mandat-pagesë në cash: dërguesi dorëzon fondet në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar dhe kërkon që e gjithë shuma ti paguhet marrësit të pagesës në cash, pa asnjë mbajtje.

1.2 Pagesë me urdhër-pagesë postare: dërguesi jep udhëzime që llogaria e tij e mbajtur nga operatori i caktuar të debitohet dhe kërkon që marrësi i pagesës të paguhet për shumën e plotë në cash, pa asnjë mbajtje.

1.3 Derdhje me urdhër-pagesë postare: dërguesi dorëzon fondet në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar dhe kërkon që e gjithë shuma të paguhet në llogarinë e marrësit të pagesës, pa asnjë mbajtje.

1.4 Transfertë postare: dërguesi jep udhëzime që llogaria e tij e mbajtur nga operatori i caktuar të debitohet dhe kërkon që llogaria e marrësit të pagesës me operatorin e caktuar pagues të kreditohet me shumë ekuivalente, pa asnjë mbajtje.

2. Rregullorja do të përcaktojë procedurat për ekzekutimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Përkufizime

1. Autoriteti kompetent - çdo autoritet kombëtar i një shteti anëtar i cili, në bazë të kompetencave të dhëna nga ligji ose rregullore, mbikëqyr aktivitetet e operatorit të caktuar ose të personave të referuar në këtë nen. Autoriteti kompetent mund të kontaktojë autoritetet administrative ose ligjore të angazhuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe në veçanti çdo njësi kombëtare të inteligjencës financiare dhe autoritetet e mbikëqyrjes



2. Këst – pagesë e pjesshme paraprake e kryer nga operatori i caktuar lëshues për të lehtësuar situatën e cash të shërbimeve të pagesave postare të operatorit të caktuar pages.

3. Pastrimi i parave – konvertimi ose transferimi i fondeve në dijeni se këto fonde rrjedhin nga një veprimtari kriminale ose pjesëmarrja në këtë lloj veprimtarie, me qëllim fshehjen ose mbulimin e paligjshëm të origjinës së fondeve apo për të ndihmuar ndonjë person që ka marrë pjesë në të tilla aktivitete për t'i shpëtuar pasojave ligjore të veprimit të tij; pastrimi i parave do të konsiderohet si i tillë kur aktivitetet që prodhojnë fondet që do të pastrohen janë të subjekt i ndjekjes penale në territorin e një shteti tjetër anëtar të UPU ose në një shtet të tretë.

4. Kufizim – ndarja e detyruar e fondeve të përdoruesit nga ato të operatorit të caktuar që ndalon përdorimin e fondeve të përdoruesit për qëllime të ndryshme nga ekzekutimi i operacioneve të shërbimit të pagesave postare.

5. Zyrë kompensimi – brenda kuadrit të shkëmbimeve shumëpalëshe, një zyrë kompensimi menaxhon debitë dhe kërkesat reciproke që rrjedhin nga shërbimet e ofruara nga një operatori një operatori tjetër. Roli i saj është të konsiderojë shkëmbimet ndërmjet operatorëve janë shlyer me anë të bankës dhe të marrë hapat e nevojshme në rast të parregullsive në shlyerje.

6. Kompensim – një sistem që mundëson mbajtja në minimum i numrit të pagesave që do të kryhen duke hartuar një bilanc periodik debi – kredi për palët e përfshira. Kompensimi përfshin dy faza: përcaktimin e bilanceve bilaterale dhe, duke shtuar këto bilance, llogaritjen e pozicionit të përgjithshëm të çdo njësie duke konsideruar të gjithë komunitetin me qëllim për të kryer vetëm një shlyerje në bazë të pozicionit debitor ose kreditor të njësisë në fjalë.

7. Llogari e përqendrimit – një agregat i fondeve nga burime të ndryshme të kombinuara në një llogari.

8. Llogari Ndërlidhëse – Llogari rrjedhëse e hapur reciprokisht nga operatorët e caktuar si pjesë e marrëdhënieve dypalëshe, me anë të të cilës shlyhen debitë dhe kreditë e përbashkëta janë të vendosur

9. Veprimtari kriminale – çdo lloj pjesëmarrje, ose kryerje e një krimi ose keqbërje, sipas përkufizimit në legjislacionin kombëtar.

10. Depozita e sigurisë – shuma e depozituar, në formë cash ose të letrave me vlerë, për të garantuar pagesat ndërmjet operatorëve të caktuar.

11. Marrësi i pagesës – person fizik ose juridik i caktuar nga dërguesi si përfitues i urdhër pagesave ose transfertave të llogarive rrjedhëse postare.

12. Monedhë e tretë – monedhë e ndërmjetme e përdorur në raste të pamundësisë të konvertimit ndërmjet dy monedhave ose për kompensimin / shlyerjen e llogarive.

13. Due diligence në lidhje me përdoruesit - detyrim i përgjithshëm nga ana e operatorëve të caktuar, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- identifikimin e përdoruesve;
- marrjen e informacionit mbi qëllimin e urdhër pagesës postare;
- monitorimin e urdhër pagesave postare;
- kontrollin për përditësimin e informacionit në lidhje me përdoruesit;
- raportimin e transaksioneve të dyshimta tek autoritetet kompetente.

14. Të dhëna elektronike në lidhje me urdhër pagesat postare - të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, nga një operator i caktuar tek një tjetër, në lidhje me ekzekutimin e urdhrave, kërkesat për të dhëna, ndryshimin ose korrigjimin e adresave apo rimbursimin, të cilat janë të aktivizuar ose nga operatorët e caktuar, ose janë gjeneruar automatikisht nga sistemi i tyre i informacionit, dhe të cilat tregojnë një ndryshim ose kërkesë për statusin e urdhrit.

15. Të dhëna personale – të dhëna të identifikimit personal që i referohen dërguesit ose marrësit të pagesës, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin ato janë marrë.

16. Të dhëna postare – të dhëna që nevojiten për itinerarin dhe gjurmimin e urdhër-pagesës ose për qëllime statistikore, si edhe për sistemin e centralizuar të kompensimit.

17. Shkëmbim i të dhënave elektronike (EDI) – shkëmbime të dhënash në lidhje me operacionet nga kompjuteri në kompjuter, me anë të rrjeteve dhe formateve standard të përputhshme me sistemin e Bashkimit.

18. Dërgues – person fizik ose juridik që i jep operatorit të caktuar urdhrin për të ekzekutuar një shërbim të pagesave postare në përputhje me Aktet e Bashkimit.

19. Financimi i terrorizmi - mbulon financimin e akteve të terrorizmit, të terroristëve dhe të organizatave terroriste.

20. Fonde të përdoruesit – shuma të dërguara nga dërguesi tek operatori i caktuar lëshues në cash ose të debituar në llogarinë e dërguesit të shkruar në librat e operatorit të caktuar lëshues ose me anë të ndonjë metode tjetër të sigurt të veprimeve bankare elektronike, të vëna në dispozicion të operatorit të caktuar lëshues ose ndonjë operatori tjetër financiar nga dërguesi, që ti paguhen marrësit të pagesës të specifikuar nga dërguesi në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Rregulloren e saj.

21. Monedha e emetimit – monedha e shtetit të destinacionit ose një monedhë e tretë e autorizuar nga shteti i destinacionit në të cilët lëshohet urdhër-pagesa postare.

22. Operator i caktuar lëshues – operatori i caktuar i cili transmeton një urdhër-pagesë postare tek operatori i caktuar pages, në përputhje me Aktet e Bashkimit.

23. Operator i caktuar pages – operatori i caktuar përgjegjës për ekzekutimin e urdhër-pagesës postare në shtetin e destinacionit, në përputhje me Aktet e Bashkimit.

24. Periudha e vlefshmërisë – periudha e kohës gjatë së cilës mund të ekzekutohet ose të anulohet një urdhër-pagesë postare

25. Pikë aksesi e shërbimit – vend fizik ose virtual ku përdoruesi mund të depozitojë ose marrë një urdhër-pagesë postare

26. Shpërblim- shumë që duhet ti paguhet operatorit të caktuar pages nga operatori i caktuar lëshues për pagesën e marrësit të pagesës

27. Revokueshmëria – aftësia e dërguesit për të tërhequr urdhrin e tij të pagesës postare (mandate pagesë ose transfertë) deri në momentin e pagesës ose në përfundim të periudhës së vlefshmërisë nëse nuk është bërë pagesa.

28. Risku i palës tjetër – risku që një nga palët e një kontrate të dështojë, të çojë në humbje apo risk të likuiditetit.

29. Risk i likuiditetit - risk që një sistem shlyerje pjesëmarrës ose një palë të jetë përkohësisht e paafte të përmbushë një detyrim në tërësi në momentin e kërkuar.

30. Raportimi i transaksioneve të dyshimta - detyrimi i operatorit të caktuar, në bazë të legjislacionit kombëtar dhe vendimeve të UPU, për tu siguruar autoriteteve të tyre kompetente kombëtare informacion mbi transaksionet e dyshimta.

31. Gjurmim dhe gjetje - sistem që mundëson monitorimin e progresit të urdhër-pagesës postare dhe identifikimin e vendndodhjes dhe statusit të saj në çdo moment.

32. Çmimi – shuma e paguar nga dërguesi për operatorin e caktuar lëshues për një shërbim të pagesave postare.

33. Transaksion i dyshimtë – një urdhër-pagesë postare ose e përsëritur ose kërkesë për rimbursim për një pagesë postare të lidhura me një vepër të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.

34. Përdorues – një person fizik ose juridik, dërgues ose marrës i pagesës, i cili përdor shërbimet e pagesave postare në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 3

Caktimi i operatorit

1. Shtetet anëtare do të njoftojnë Byrosë Ndërkombëtare për emrin dhe adresën e organit shtetëror kompetent për mbikëqyrjen e shërbimeve të pagesave postare brenda gjashtë muajve nga përfundimi i Kongresit. Brenda gjashtë muajve nga përfundimi i Kongresit shtetet anëtare, gjithashtu, do të japin Byrosë Ndërkombëtare emrin dhe adresën e operatorit / operatorëve të emëruar për të kryer shërbimet e pagesave postare me anë të rrjetit të tij / tyre dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit në territorin e tij / tyre. Ndërmjet Kongreseve, ndryshimet në lidhje me organet shtetërore dhe operatorët e caktuar zyrtarisht do të bëhen të ditura Byrosë Ndërkombëtare sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Operatorët e caktuar do të ofrojnë shërbimet e pagesave postare në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Funksionet e shteteve anëtare

1. Shtetet anëtare do të ndërmarrin hapat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të pagesave postare në rast të dështimit të operatorit / operatorëve të tyre të caktuar, pa cenuar përgjegjësinë e atij / atyre operatorëve ndaj operatorëve të tjerë të caktuar sipas Akteve të Bashkimit.



2. Në rast të dështimit të operatorit të tij të caktuar, një shtet anëtar do të informojë, me anë të Byrosë Ndërkombëtare, shtetet e tjera anëtare palë të Marrëveshjes:

2.1 për ndërprerjen e shërbimeve të tij të pagesave postare, që nga data e treguar dhe deri në njoftimin tjetër;

2.2 për masat e marra për të rifilluar shërbimet e tij nën përgjegjësinë e një operatori të ri të caktuar.

Neni 5

Funksione operative

1. Operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës ndaj operatorëve të tjerë dhe përdoruesve për ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare.

2. Ata do të jenë përgjegjës për risqe si risqet operationale, risqet e likuiditetit dhe të palës tjetër në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Me qëllim zbatimin e shërbimeve të pagesave postare dhënia e të cilave u është besuar nga shteti përkatës anëtar, operatori i caktuar do të lidhë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me operatorët e caktuar të zgjedhur prej tij.

Neni 6

Pronësia e fondeve të shërbimeve të pagesave postare

1. Çdo shumë të hollash, e dërguar në cash ose e debituar në llogari për ekzekutimin e një urdhër-pagese postare, do ti përkasë dërguesit deri në momentin kur i paguhet marrësit të pagesës ose kreditohet në llogarinë e marrësit të pagesës.

2. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së urdhër-pagesës postare, dërguesi mund ta tërheqë atë deri në momentin e pagesës së tij marrësit të pagesës ose kreditimit në llogarinë e tij.

Neni 7

Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik

1. Operatorët e caktuar do të ndërmarrin të gjitha hapat për të përmbushur detyrimet e tyre që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për qëllimet e luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik.

2. Ata duhet të informojnë autoritetet kompetente të shtetit të tyre për transaksionet e dyshimta, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare.

3. Rregullorja do të përcaktojë detyrimet e detajuara të operatorëve të caktuar në lidhje me identifikimin e përdoruesit, due diligencën dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik.

Neni 8

Konfidencialiteti

1. Operatorët e caktuar do të sigurojnë konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe të detyrimeve ndërkombëtare, kur ato janë të zbatueshme, dhe të Rregullores. Dispozitat e këtij neni nuk do të kufizojnë dhënien e të dhënave personale me kërkesë të bazuar në ligjet kombëtare të çdo shteti anëtar.

2. Të dhënat e kërkuara për ekzekutimin e një urdhër-pagese postare do të jenë konfidenciale.

3. Për qëllime statistikore, dhe ndoshta edhe për qëllime të matjes së cilësisë së shërbimit dhe shlyerjes së centralizuar, operatorëve të caktuar do tu kërkohet ti japin të paktën një herë në vit të dhënat postare Byrosë Ndërkombëtare të Bashkimit Postar Universal. Byroja Ndërkombëtare do të trajtojë të gjitha të dhënat individuale postare në mënyrë konfidenciale.

Neni 9
Neutraliteti teknologjik

1. Shkëmbimi i të dhënave të nevojshme për dhënien e shërbimeve të përkufizuara në këtë Marrëveshje do të disiplinohet nga parimi i neutralitetit teknologjik, çka domethënë se dhënia e këtyre shpenzimeve nuk varet nga përdorimi i një teknologjie të veçantë.

2. Procedurat për ekzekutimin e urdhër-pagesave postare, duke përfshirë kushtet për depozitimin, regjistrimin, dërgimin, urdhrat e pagesës dhe rimbursimit dhe për përpunimin e reklamimeve, si dhe afatet për bërjen e fondeve të disponueshme për marrësin e pagesës, mund të ndryshojnë në bazë të teknologjisë së përdorur për transmetimin e urdhrit.

3. Shërbimet e pagesave postare mund të ofrohen në bazë të kombinimit të teknologjive të ndryshme.

KAPITULLI II
PARIME TË PËRGJITHSHME DHE CILËSIA E SHËRBIMIT

Neni 10
Parime të përgjithshme

1. Akses i me anë të rrjetit

1.1 Shërbimet e pagesave postare do të ofrohen nga operatorët e caktuar me anë të rrjetit / rrjeteve të tyre ose me anë të rrjetit të një partneri me qëllim garantimin e aksesit për numrin më të madh të klientëve në këto shërbime.

1.2 Të gjithë përdoruesit do të kenë akses në shërbimet e pagesave postare pavarësisht nga marrëdhëniet kontraktore ose tregtare që ekziston me operatorin e caktuar.

2. Ndarja e fondeve

2.1 Fondet e përdoruesve do të jenë të ndara. Këto fonde dhe flukset që ato gjenerojnë do të ndahen nga fondet dhe flukset e tjera të operatorëve, veçanërisht nga fondet e vetë operatorëve.

2.2 Shlyerjet në lidhje me shpërblimin ndërmjet operatorëve të caktuar janë të ndara nga shlyerjet që lidhen me fondet e përdoruesve.

3. Monedha e lëshimit dhe monedha e pagesës në lidhje me urdhër-pagesat postare

3.1 Shuma e urdhër-pagesës postare do të shprehet dhe paguhet në monedhën e shtetit të destinacionit ose në ndonjë monedhë tjetër të autorizuar nga shteti i destinacionit.

4. Pranimi

4.1 Transmetimi i urdhër-pagesave postare me anë të mjeteve elektronike do të jetë subjekt i parimit të pranimit, në kuptimin që operatori i caktuar lëshues nuk do të verë në dyshim këto urdhra dhe operatori i caktuar pages nuk do të mohojë marrjen e urdhrit, për sa kohë që mesazhi përputhet me standardet teknike të aplikueshme.

4.2 Pranimi i urdhër-pagesave postare do të garantohet me mjete teknologjike, pavarësisht nga sistemi i përdorur nga operatorët e caktuar.

5. Ekzekutimi i urdhër-pagesave postare

5.1 Urdhër-pagesat postare të transmetuara ndërmjet operatorëve të caktuar duhet të ekzekutohen, subjekt i dispozitave të kësaj Marrëveshje dhe legjislacionit kombëtar.

5.2 Në rrjetin e operatorëve të caktuar, shumën e dërguar nga dërguesi tek operatori i caktuar lëshues do të jetë e njëjtë me shumën e paguar marrësit të pagesës nga operatori i caktuar pages.

5.3 Pagesa e marrësit të pagesës nuk do të jetë e kushtëzuar nga marrja e fondeve përkatëse të dërguesit nga operatori i caktuar pages. Ajo do të jetë subjekt i përmbushjes së detyrimeve të tij nga operatori i caktuar lëshues ndaj operatorit të caktuar pages në lidhje me kështet ose një llogari lidhëse.

6. Shlyerja e çmimeve

6.1 Operatori i caktuar lëshues do të vendosë çmimin e shërbimeve të pagesave postare.

6.2 Këtë çmim mund ti shtohen tarifa për çdo shërbim shtesë ose plotësues të kërkuar nga dërguesi.

7. Përfshirja nga tarifat

7.1. Dispozitat e Konventës Universale Postare në lidhje me përfshirjen nga tarifat postare për të burgosurit e luftës dhe të internuarit civilë do të aplikohen për artikujt e shërbimeve të pagesave postare për këtë kategori të marrësve të pagesës.



8. Shpërblimi i operatorit të caktuar pages

8.1 Operatori i caktuar pages do të shpërblehet nga operatori i caktuar lëshues për ekzekutimin e urdhër-pagesave postare.

9. Intervalet për shlyerjen ndërmjet operatorëve të caktuar

9.1 Frekuenca e shlyerjeve ndërmjet operatorëve të caktuar e shumave të paguara ose të kredituara marrësve të pagesave në emër të dërguesve mund të jetë e ndryshme nga ajo në lidhje me shlyerjen e shpërblimeve ndërmjet operatorëve të caktuar. Shumat e paguara ose të kredituara duhet të shlyhen të paktën një herë në muaj.

10. Detyrimi për të informuar përdoruesit

10.1 Përdoruesit do të kenë të drejtë për të marrë informacionin vijues, i cili do të publikohet ose të vihet në dispozicion të të gjithë dërguesve: kushtet që mbulojnë dhënien e shërbimeve të pagesave postare, çmimet, tarifat, kurset e këmbimit dhe marrëveshjet, kushtet e zbatimit të përgjegjësisë dhe adresat e shërbimeve të informacionit dhe reklamimit.

10.2 Aksesit në këtë informacion do të sigurohet pa pagesë.

Neni 11

Cilësia e shërbimit

1. Operatorët e caktuar mund të vendosin të identifikojnë shërbimet e pagesave postare me anë të një marke kolektive.

KAPITULLI III

PARIMET PËR SHKËMBIMET E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

Neni 12

Ndërveprueshmëria

1. Rrjetet

1.1 Me qëllim për të shkëmbyer të dhënat e nevojshme për të ekzekutuar shërbimet e pagesave postare ndërmjet të gjithë operatorëve të caktuar dhe për të monitoruar cilësinë e shërbimit, operatorët e caktuar do të përdorin sistemin e shkëmbimit të të dhënave elektronike të Bashkimit (EDI) ose ndonjë system tjetër që garanton ndërveprueshmërinë e shërbimeve të pagesave postare në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 13

Garantimi i sigurtisë së shkëmbimeve elektronike

1. Operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës për funksionimin e mirë të pajisjeve të tyre.

2. Transmetimi elektronik i të dhënave do të bëhet i sigurt me qëllim garantimin e autenticitetit dhe integritetit të të dhënave të transmetuara.

3. Operatorët e caktuar do të bëjnë transaksionet të sigurta sipas standardeve ndërkombëtare.

Neni 14

Gjurmimi dhe gjetja

1. Sistemet e përdorura nga operatorët e caktuar do të mundësojnë monitorimin e procedimit të urdhrit dhe revokimin e tij nga dërguesi, deri në momentin kur shuma përkatëse i paguhet marrësit të pagesës ose kreditohet në llogarinë e tij, ose, nëse është rasti, i rimbursohet dërguesit.

PJESA II
RREGULLAT QË DISIPLINOJNË SHËRBIMET E PAGESAVE POSTARE

KAPITULLI I
PËRPUNIMI I URDHËR-PAGESAVE POSTARE

Neni 15

Depozitimi, regjistrimi dhe transmetimi i urdhër-pagesave postare

1. Kushtet për depozitimin, regjistrimin dhe transmetimin e urdhër-pagesave postare janë vendosur në Rregullore.
2. Periudha e vlefshmërisë për urdhër-pagesat postare nuk mund të zgjatet dhe është vendosur në Rregullore.

Neni 16

Kontrolli dhe lëshimi i fondeve

1. Pas konfirmimit të identitetit të marrësit të pagesës në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe saktësinë e informacionit që ai ka dhënë, operatori i caktuar do të bëjë pagesën në cash. Për një urdhër derdhje ose transferte, kjo pagesë do të kreditohet në llogarinë e marrësit të pagesës.
2. Limitet kohore për lëshimin e fondeve do të vendosen në marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet operatorëve të caktuar.

Neni 17

Shuma maksimale

1. Operatorët e caktuar do të informojnë Byronë Ndërkombëtare të Bashkimit Postar Universal për shumat maksimale për dërgimin ose marrjen të vendosura në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 18

Rimbursimi

1. Shtrirja e rimbursimit
 - 1.1 Rimbursimi brenda kuadrit të shërbimeve të pagesave postare do të mbulojë shumën e plotë të urdhër-pagesave postare në monedhën e shtetit lëshues. Shuma që do të rimbursohet do të jetë e njëjtë me shumën e paguar nga dërguesi ose shumën e ngarkuar në llogarinë e tij. Çmimi i shërbimit të pagesës postare do të shtohet në shumën e rimbursuar në rast të një gabimi nga operatori i caktuar.

KAPITULLI II
REKLAMIMET DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 19

Reklamimet

1. Reklamimet do të merren brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga dita pas asaj në të cilën është pranuar urdhër-pagesa postare.
2. Operatorët e caktuar, subjekt i legjislacionit të tyre kombëtar, do të kenë të drejtën e marrjes së tarifave mbi reklamimet në lidhje me urdhër-pagesat postare nga klientët.

Neni 20

Përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj përdoruesve

1. Trajtimi i fondeve
 - 1.1 Operatori i caktuar lëshues do të jetë përgjegjës ndaj dërguesit për shumat e dorëzuara në arkë ose të debituar në llogarinë e dërguesit deri në momentin kur urdhër-pagesa postare është paguar sipas rregullave ose



është kredituar në llogarinë e marrësit të pagesës, ose deri sa fondet ti jenë rimbursuar dërguesit në formë të cash ose si kredi në llogarinë e tij.

Neni 21

Detyrimet dhe përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj njëri tjetrit

1. Çdo operator i caktuar do të jetë përgjegjës për gabimet e tij.
2. Kushtet dhe kohëzgjatja e përgjegjësisë janë vendosur në Rregullore.

Neni 22

Mungesa e përgjegjësisë së operatorëve të caktuar

1. Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës:
 - 1.1 në rast të vonësës në ekzekutimin e shërbimit;
 - 1.2 kur ata nuk mund të shpjegojnë në lidhje me ekzekutimin e një urdhër-pagese për shkak të shkatërrimit të të dhënave të shërbimit të pagesave postare nga forca madhore, me përjashtim të rastit kur është dhënë ndonjë provë tjetër e përgjegjësisë së tyre;
 - 1.3 kur dëmtimi është shkaktuar nga gabimi ose neglizhenca e dërguesit, veçanërisht për sa i përket përgjegjësisë së tij për të dhënë informacion të saktë në mbështetje të urdhrit të tij të pagesës, duke përfshirë faktin se fondet e dërguara janë nga një burim legjitim dhe se urdhër-pagesa postare ka një qëllim legjitim;
 - 1.4 nëse fondet e dërguara janë sekuestruar;
 - 1.5 në rastin e fondeve të të burgosurve të luftës ose të internuarve civilë;
 - 1.6 kur përdoruesi nuk ka paraqitur reklamim brenda periudhës së vendosur në Rregullore;
 - 1.7 kur ka përfunduar koha e lejuar për rekurs në lidhje me shërbimet e pagesave postare në shtetin e lëshimit.

Neni 23

Rezerva në lidhje me përgjegjësinë

1. Përveç rasteve të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, nuk mund të bëhen rezerva për dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë të përshkruara në nenet 20 deri në 22.

KAPITULLI III MARRËDHËNIE FINANCIARE

Neni 24

Rregullat e kontabilitetit dhe ato financiare

1. Rregulla të kontabilitetit
 - 1.1 Operatorët e caktuar do të përputhen me rregullat e kontabilitetit të vendosura në Rregullore.
2. Përgatitja e llogarive mujore dhe të përgjithshme
 - 2.1 Operatori i caktuar pages do të përgatisë për çdo operator të caktuar lëshues një llogari mujore duke treguar shumat e paguara për urdhër-pagesat postare. Llogaritë mujore do të përfshihen, me intervale të njëjta, në një llogari kompensimi duke përfshirë këstet dhe duke krijuar një bilanc.
3. Kësti
 - 3.1 Në rast të mosbalancimit në shkëmbimet midis operatorëve të caktuar, të paktën një herë në muaj, në fillim të periudhës së shlyerjes, do të paguhet një këst nga operatori i caktuar lëshues tek operatori i caktuar pages. Në rastet kur rritja e frekuencës së shkëmbimeve redukton periudhën në më pak se një javë, operatorët mund të bien dakord të heqin dorë nga ky këst.
4. Llogari të përqendruar
 - 4.1 Në parim, çdo operator i caktuar do të ketë një llogari të përqendruar për fondet e përdoruesve. Këto fonde do të përdoren vetëm për shlyerjen e urdhrave të paguara marrësve të pagesës ose për rimbursimin e dërguesve për urdhrat e pa ekzekutuar.

4.2 Çdo kësht i paguar nga operatori i caktuar lëshues do të kreditohet në llogarinë e përqendrimit për operatorin e caktuar pages. Këto kështe do të përdoren ekskluzivisht për pagesat e marrësve.

5. Depozita e sigurisë

5.1 Pagesa e një depozite të sigurisë mund të kërkohet në përputhje me kushtet e parashikuara në Rregullore.

Neni 25

Shlyerja dhe kompensimi

1. Shlyerja e centralizuar

1.1 Shlyerjet ndërmjet operatorëve të caktuar mund të kalojnë nëpërmjet një zyre qendrore të kompensimit, në përputhje me procedurat e vendosura në Rregullore dhe do të kryhen nga llogaritë e përqendruara të operatorëve të caktuar.

2. Shlyerje dypalëshe

2.1 Faturimi në bazë të bilancit të llogarisë së përgjithshme

2.1.1 Në përgjithësi, operatorët e caktuar që nuk janë anëtarë të një sistemi të përqendruar të kompensimit do të shlyejnë llogaritë në bazë të bilancit të llogarisë së përgjithshme.

2.2 Llogaria ndërlidhëse

2.2.1 Kur operatorët e caktuar kanë një institucion të llogarive rrjedhëse, secili prej tyre mund të hapë një llogari ndërlidhëse me anë të së cilës të shlyejnë debitë dhe kërkesat përkatëse që rrjedhin nga shërbimet e pagesave postare.

2.2.2 Kur operatori i caktuar pages nuk ka një sistem të llogarive rrjedhëse, llogaria ndërlidhëse mund të hapet në një institucion tjetër financiar.

2.3 Monedha e shlyerjes

2.3.1 Shlyerjet do të kryhen në monedhën e shtetit të destinacionit ose në një monedhë të tretë të rënë dakord midis operatorëve të caktuar.

PJESA III

DISPOZITA TRANZITORE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Rezerva të paraqitura në Kongres

1. Nuk do të lejohet asnjë rezervë që nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit.

2. Si rregull i përgjithshëm, çdo shtet anëtar pikëpamjet e të cilit nuk janë të njëjta me ato të shteteve të tjera, duhet të bëjë përpjekje, brenda mundësive, të përputhet me opinionin e shumicës. Rezervat do të bëhen vetëm në rast të nevojës absolute dhe duhen të jepet një motiv i përshtatshëm për to.

3. Rezervat për ndonjë nen të kësaj marrëveshje duhet të paraqiten në Kongres, në formën e propozimit për Kongres të shkruar në një gjuhë pune të Byrosë Ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullave të Procedurës së Kongresit.

4. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet që kanë të bëjnë me rezervat duhet të miratohen nga shumica e kërkuar për amendimin e nenit me të cilin lidhet rezerva.

5. Në parim, rezerva do të zbatohet në bazën e një reciprociteti midis shtetit anëtar që e paraqet atë dhe shteteve të tjera anëtare.

6. Rezervat e kësaj Marrëveshje, do të përfshihen në Protokollin e saj përfundimtar, mbi bazën e propozimeve të miratuara nga Kongresi.

Neni 27

Dispozita përfundimtare

1. Konventa do të jetë e zbatueshme, sipas rastit, me analogji, në të gjitha rastet e pa disiplinuar shprehimisht nga kjo Marrëveshje.

2. Neni 4 i Kushtetutës nuk do të zbatohet për këtë Marrëveshje.

3. Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me këtë Marrëveshje dhe Rregulloren



3.1 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura në Kongres në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese të cilat janë palë e kësaj Marrëveshje dhe që kanë të drejtën e votës. Të paktën gjysma e këtyre shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres dhe që kanë të drejtën e votës duhet të jenë të pranishme në momentin e votimit.

3.2 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet në lidhje me Rregulloren e kësaj Marrëveshje duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Operacioneve Postare të cilët janë palë e Marrëveshjes dhe kanë të drejtën e votës.

3.3 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura midis dy Kongreseve në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të marrin:

3.3.1 dy të tretat e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të cilat janë palë e Marrëveshjes, që kanë të drejtën e votës, nëse ato përfshijnë shtesën e dispozitave të reja;

3.3.2 të paktën shumicën e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të cilat janë palë e Marrëveshjes dhe që kanë të drejtën e votës, nëse ato përfshijnë amendimin e dispozitave të Marrëveshjes;

3.3.3 shumicë të votave, nëse përfshihen interpretime të dispozitave të kësaj Marrëveshje.

3.4 Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikën 3.3.1, çdo shtet anëtar, legjislacioni i brendshëm i të cilit është ende i papajtueshëm me amendimin e propozuar, mund të bëjë një deklaramë me shkrim për Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare duke deklaruar pamundësinë për të pranuar këtë amendim, brenda 90 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të tij.

Neni 28

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi më 1 Janar 2010 dhe do të mbeten në fuqi deri në hyrjen në fuqi të akteve të Kongresit të ardhshëm.

Në dëshmi të sa më sipër të plotfuqishmit e Qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në një kopje, e cila do të depozitohet pranë Drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare. Një kopje do ti jepet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Gjenevë, 12 gusht 2008

DEKLARATAT PËR NËNSHKRIMIN E AKTEVE

I

Për llogari të Republikës Arabe e Sirisë:

"Republika Arabe e Sirisë deklaron se nënshkrimi i saj i Akteve nuk do të nënkuptojë një detyrim për të vepruar ose pranuar ndonjë transaksion me administratën postare të Izraelit."

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 1)

II

Për llogari të Republikës së Argjentinës

"Republika e Argjentinës kujton rezervimin e bërë në ratifikimin e Kushtetutës së Bashkimit Universal Postar të nënshkruar në Vjenë, Austri, më 10 Korrik 1964, dhe rikonfirmon sovranitetin e saj ndaj Ishujve të Malvinas, Gjeorgjisë së Jugut, dhe Ishujve Jugorë Sandwich dhe sektorit të Antarktikës së Argjentinës që janë pjesë përbërëse e territorit të saj kombëtar.

"Ajo gjithashtu kujton, në lidhje me 'Çështjen e Ishujve Falkland (Malvinas), se Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka përshtatur rezolutën 2065 (XX), 3160 (XXVIII), 31/49, 37/9, 38/12, 39/6, 40/21, 41/40, 42/19 dhe 43/25, me anë të së cilës ajo njeh ekzistencën e mosmarrëveshjeve të sovranitetit dhe i kërkon Qeverisë së Republikës së Argjentinës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të rifillojnë negociatat për të zgjidhur këto mosmarrëveshje.

"Republika e Argjentinës thekson gjithashtu se Komiteti i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Shkolonizimin ka paraqitur në mënyrë të përsëritur gjykimin në të njëjtin kuptim, së fundmi me anë të rezolutës së miratuar më 12 Qershor 2008, dhe se Asambleja e Përgjithshme e Organizimit të Shteteve të Amerikës ka miratuar një vendim të ri në dhënien e kushteve të ngjashme më 3 Qershor 2008."

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 2)

III

Për llogari të Republikës Socialiste të Vietnamit

"Republika Socialiste e Vietnamit deklaroi se:

i) Ajo rezervon të drejtën e Qeverisë Vietnameze për të ndërmarrë çdo veprim ose masë të menduar të nevojshme për të ruajtur interesat kombëtare nëse ndonjë administratë tjetër postare dështon në përmbushjen e Akteve të Kongresit UPU ose nëse rezervimet nga administrata të tjera postare rrezikojnë shërbimin ose sovranitetin e saj.

ii) Vietnamit rezervon të drejtën për Qeverinë e tij për të bërë, nëse është e nevojshme, rezervime të tjera rreth ratifikimit të Akteve të Kongresit të UPU"

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 3)

IV

Për llogari të Republikës së Indonezisë

"Delegacioni i Republikës së Indonezisë deklaroi se Indonezia do të zbatojë Aktet e përshtatura nga Kongresi i 24-^{ri} i Bashkimit Universal Postar, në përputhje me Kushtetutën, Ligjet dhe Rregulloret e Republikës së Indonezisë dhe sipas detyrimeve të saj si pjesë e këtyre traktateve, konventave dhe çdo parim të ligjit ndërkombëtar.

"Delegacioni i Republikës së Indonezisë rezervon të drejtën e Qeverisë së saj për të ndërmarrë çdo veprim ose masë që i gjykon të nevojshme për të ruajtur interesin e saj kombëtar, nëse ndonjë akt i miratuar nga ky Kongres që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikon në sovranitetin e saj ose shkel Kushtetutën, Ligjet ose Rregulloret e Indonezisë, nëse ndonjë Anëtar në ndonjë mënyrë dështon në përmbushjen e Kushtetutës, Konventës ose Akteve të Bashkimit Universal Postar, ose nëse pasojat e rezervimit të ndonjë Anëtarit do të dëmtojnë shërbimin e tij postar ose do të sjellë një rritje të papranueshme në pjesën e saj të kontributit për mbulimin e shpenzimeve të Bashkimit."

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 4)

V

Për llogari të Republikës së Austrisë, Mbretërisë së Belgjikës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Qipros, Republikës Çeke, Mbretërisë së Danimarkës, Republikës së Estonisë, Republikës së Finlandës, Republikës Franceze, Republikës Federale të Gjermanisë, Republikës Greke, Republikës së Hungarisë, Republikës Italiane, Republikës së Letonisë, Republikës së Lituanisë, Dukatit të Madh të Luksemburgut, Republikës së Maltës, Mbretërisë së Holandës, Republikës Polake, Republikës Portugeze, Rumanisë, Republikës së Sllovakisë, Republikës së Sllovenisë, Mbretërisë së Spanjës, Mbretërisë së Suedisë, Republikës së Sllovenisë, dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore.

"Delegacionet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian deklarojnë që shtetet e tyre do të aplikojnë Aktet e miratuara nga Kongresi në përputhje me detyrimet e tyre sipas Marrëveshjes themeluese të Komunitetit Evropian dhe Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë."

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 5)



VI

Për llogari të Islandës, Principatës e Lihtenshtajnit, dhe Norvegjisë

"Delegacionet e Islandës, Principatës e Lihtenshtajnit, dhe Norvegjisë deklarojnë se shtetet e tyre do të aplikojnë Aktet e miratuara nga Kongresi në përputhje me detyrimet e tyre kundrejt marrëveshjes themeluese të Zonës Ekonomike Evropiane dhe Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 6)

VII

Për llogari të Mbretërisë së Tailandës

"Në nënshkrimin e Akteve Përfundimtare të Kongresit të 24-të të Bashkimit Universal Postar (Gjenevë, 2008), delegacioni i Tailandës deklaroi se:

1. Mbretëria e Tajlandës nuk do të jetë e detyruar në asnjë mënyrë nga dispozitat e këtyre akteve që shkelin sovranitetin e saj ose në kundërshtim me legjislacionin e saj kombëtar.

2. Nënshkrimi i këtyre akteve nuk duhet të interpretohet si një vendim nga Mbretëria e Tajlandës për të ndryshuar ndonjë prej të drejtave që ka apo që mund të pretendohen sipas ndonjë marrëveshje ose instrumenti tjetër ndërkombëtar në të cilat ajo është palë.

3. Mbretëria e Tajlandës rezervon të drejtën për të marrë çdo veprim ose masë që gjykon të nevojshme për të mbrojtur interesat e saj kombëtare, nëse pasojat e rezervave të ndonjë anëtar i rrezikojnë shërbimet e saj postare ose të ndikojnë në sovranitetin e saj.

4. Mbretëria e Tajlandës rezervon të drejtën për të bërë rezervime, nëse është e nevojshme, pas ratifikimit të këtyre Akteve "

(KONGRESI - Dok 41. Shtojca 7)

VIII

Për llogari të Republikës së Gjeorgjisë

"Delegacioni i Gjeorgjisë deklaroi se Gjeorgjia do të zbatojë Aktet, ndryshimet dhe plotësimet e miratuara nga ky Kongres vetëm në përputhje me Kushtetutën e Gjeorgjisë dhe legjislacionin e saj kombëtar dhe normat universale, dhe me kusht që të mos çënohet sovraniteti i shtetit dhe interesat e veta kombëtare.

"Delegacioni i Gjeorgjisë do të mbrojë të drejtat e Qeverisë së tij nga:

- Bërja e deklaratave të mëtejshme me interes kombëtar, në rast se Aktet, amendamentet dhe shtesat e miratuara nga ky Kongres në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bien në kundërshtim me Kushtetutën e Gjeorgjisë dhe/ose legjislacionin e saj dhe aktet normative kombëtare, dhe nëse ka ndonjë vend anëtar të UPU që dështon në respektimin e Konventës, të Kushtetutës ose Akteve të UPU;

- Marrja e çfarëdo mase të nevojshme për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e komunitetit postar dhe emetimin e pullave postare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe aktet normative në të gjithë territorin e Gjeorgjisë, duke konsideruar të paligjshëm çdo veprim tjetër të këtij lloji;

- Ndërmarrja e çdo veprim për të mbrojtur interesat e saj kombëtare në rast se çdo vend anëtar UPU ndërmerr një veprim që rrezikon funksionimin normal të shërbimeve postare në të gjithë në territorin e Gjeorgjisë".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 8)

IX

Për llogari të Republikës së Boliviane të Venezuelës

Republika Bolivariane e Venezuelës, me nënshkrimin e akteve, deklaroi se rezervon të drejtën për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e saj kombëtare në rast se shtetet e tjera anëtare të Unionit Postar Universal (UPU), do të ndërmarrin veprime që bien ndesh me Aktet apo që mund të ndikojnë direkt ose indirekt në sovranitetin ose legjislacionin e saj kombëtar. Për më tepër, nënshkrimi i Akteve të UPU-t në asnjë rrethanë nuk duhet të interpretohet si heqje dorë nga të drejtat e Republikës Boliviane të Venezuelës si shtet Sovran ose nga parimet e ligjit ndërkombëtar që janë specifike për atë si shtet Sovran.

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 9)

X

Për llogari të Mbretërisë së Lesotos

"Delegacioni i Mbretërisë së Lesotos deklaroi se Lesoto do të zbatojë aktet e miratuara nga Kongresi i 24-të i Bashkimit Postar Universal, në përputhje me ligjet, Kushtetutën dhe Rregulloret e Mbretërisë së Lesotos dhe në përputhje me detyrimet e tij si një palë e traktateve të tjera dhe çdo parimi të së drejtës ndërkombëtare".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 10)

XI

Për llogari të Zelandës së Re

"Zelanda e Re do të zbatojë Aktet dhe vendimet e tjera të miratuara nga ky Kongres vetëm për aq sa ato janë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të saj dhe në veçanti, me Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 11)

XII

Për llogari të Kanadasë

"Kanadaja do të zbatojë Aktet dhe vendimet e tjera të miratuara nga ky Kongres në përputhje të plotë me të drejtat dhe detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë, dhe në veçanti Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 12)

XIII

Për llogari të Togos

"Në nënshkrimin e akteve përfundimtare të Kongresit të 24 Postar Universal të mbajtur në Gjenevë (Zvicër) nga 23 korrik deri 12 gusht 2008, delegacioni i Togos deklaroi se Republika e Togos rezervon të drejtën të mos aplikojë asnjë dispozitë që është në kundërshtim me legjislacionin e saj ose të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat ajo është palë. "Republika e Togo gjithashtu rezervon të drejtën për të bërë ndonjë rezervë që ajo e konsideron të nevojshme për të mbrojtur rendin e saj ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare të marra para ratifikimit të Akteve".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 13)



XIV

Për llogari të një grupi shtetesh

"Administrata postare e Republikës Arabe të Sirisë përsërit deklaratën e bërë në Kongresin e vitit 2004 në Bukuresht nga Mbretëria e Bahreinit, Republika Islamike e Iranit, Republika e Irakut, Republika Arabe Popullore Socialiste Libiane, Republika e Libanisë, Republika Islamike e Pakistanit, Mbretëria e Arabisë Saudite, Republika e Tunizisë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Republika e Jemenit, dhe deklarën se nënshkrimi prej tyre i të gjithë akteve të Bashkimit Postar Universal (Kongresi i 24-të - 2008), dhe çdo ratifikimin vijues i këtyre Akteve nga qeveritë e tyre përkatëse, nuk do të jetë i vlefshëm ndaj anëtarit të regjistruar me emrin e Izraelit dhe në asnjë mënyrë nuk do të nënkuptojnë njohjen e tij".

(KONGRES-Dok 41. Shtojca14)

XV

Për llogari të Republikës së Turqisë

"Delegacioni i Republikës së Turqisë e bën deklaratën e mëposhtme në lidhje me pjesëmarrjen e delegacionit të Administratës Qipriote Greke të Qipros Jugore në Kongresin e 24-të të Bashkimit Postar Universal të supozuar në emër të 'Republikës së Qipros':

"Nuk ka asnjë autoritet të vetëm, ligjor ose faktik, që është kompetent për të përfaqësuar së bashku me Qipriotët Turq dhe Qipriotët Grekë dhe, rrjedhimisht, Qipron si një e tërë. Administrata Qipriote Greke që nga viti 1963, ka përfaqësuar ekskluzivisht Qipriotët Grekë dhe interesat e tyre. Prandaj, si një fuqi garantuese sipas Traktatit të Garancive të vitit 1960, Turqia nuk e njeh këtë administratë apo cilëndo prej pretendimeve të saj paligjshme.

"Duke pasur parasysh sa më sipër, Turqia dhe pjesëmarrja në punimet e Bashkimit Postar Universal dhe nënshkrimin prej saj i Akteve Përfundimtare në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si njohje nga Turqia e të ashtu-quajturës 'Republikë e Qipros', as nuk duhet të nënkuptojnë ndonjë detyrim nga ana e Turqisë për të hyrë në ndonjë marrëveshje që ka të bëjë me ashtu-quajturën 'Republikë të Qipros' në kuadër të aktiviteteve të Bashkimit Postar Universal".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 15)

XVI

Për llogari të Izraelit

"Delegacioni i Izraelit në Kongresin e 24-të të Bashkimit Postar Universal përsërit deklaratat dhe rezervime të cilat ai ka bërë në Kongreset e mëparshme të UPU-t, dhe refuzon pa rezerva çdo deklaratë ose rezervë të bërë nga çdo vend tjetër i Bashkimit, në këtë Kongres të 24-të (Gjenevë), qëllimi i të cilave është që të shpërfilli të drejtat e Izraelit dhe statusin si anëtar i UPU-t. Për më tepër, çdo deklaratë apo rezervim i tillë është në kundërshtim me si me dokumentin ashtu dhe frymën e Kushtetutës, Konventës dhe Marrëveshjeve. Delegacioni i Izraelit në përputhje me rrethanat e konsideron çdo deklaratë apo rezervë të tillë si të paligjshme dhe të pavlefshme, dhe rezervon të drejtat e saj në përputhje me rrethanat".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 16)

XVII

Për llogari të Republikës së Azerbajxhanit

"Edhe pse Nagorno Karabakh dhe shtatë rrethe të tjera fqinjë janë pjesë integrale e Azerbajxhanit, ata vazhdojnë të jenë të pushtuar nga Armenia. "E ashtuquajtura 'Republika Nagorni Karabah' është një njësi artificiale, e paligjshme dhe e panjohur që rezulton nga pushtimi ilegal i rrethit të Karabak Nagorni dhe rretheve fqinje të Azerbajxhanit nga ana e forcave të armatosura të Armenisë në vitin 1992 dhe 1993. Armeni a kryer spastrim etnik i Azerbajxhanit në këto territore të pushtuara.

"Si rezultat, më shumë se një milion Azerbajxhanas të shpërngulur nga vendet e tyre të përhershme të qëndrimit u bënë refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit të tyre vetëm për shkak se ata ishin Azerbajxhanas. Shumë prej tyre ende jetojnë në strehime të përkohshme në zonat e banuara dhe presin me padurim dhe vendosmëri deri në ditën kur ata mund të kthehen në shtëpitë tyre.

Komuniteti ndërkombëtar ka marrë një pozicion të qartë dhe të pakundërshtueshëm në lidhje me Politikën Agresive të Armenisë ndaj Azerbajxhanit. Megjithatë katër rezoluta të Këshillit të Sigurimit (822 e 30 prillit 1993, 853 të 29 korrikut 1993, 874 të 14 tetorit 1993 dhe 884 e 12 Nëntorit 1993) kërkuar tërheqjen e plotë, të menjëhershme dhe të pakushtëzuar të forcave pushtuese nga territoret e pushtuara të Azerbajxhanit, asnjë nga këto rezoluta nuk është zbatuar nga agresori.

"Në rezolutën e saj me titull "Gjendja në territoret e pushtuara të Azerbajxhanit", e miratuar gjatë sesionit të 62-të të saj më 14 mars 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB edhe konfirmoi një herë respektin dhe mbështetjen e sovranitetit dhe integritetit territorial në kufijtë e njohura botërisht të Republikës së Azerbajxhanit dhe kërkoi 'tërheqjen e menjëhershme, të plotë dhe të pakushtëzuar të të gjitha forcave armene nga të gjitha territoret e Azerbajxhanit që janë nën pushtim'. Edhe njëherë, Armenia e ka injoruar këtë thirrje nga komuniteti ndërkombëtar.

"Si rezultat i pushtimit të vazhdueshëm të 20 % të territorit të Azerbajxhanit nga Armenia, i janë shkaktuar dëmtime të mëdha ekonomisë së Azerbajxhanit".

"Në territoret e Republikës së Azerbajxhanit pushtuar nga Armenia, është bërë e pamundur zbatimi i dispozitave të Konventës Universale Postare në lidhje me qarkullimin e pullave postare (neni 8). Me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Armenisë, regjimi kukull i të ashtu-quajturës 'Republika Nagorni Karabakh' ka shtypur pulla postare të paligjshme, në kundërshtim flagrant të dispozitave të Konventës Universale Postare, dhe nxitjen e qarkullimit të tyre të paligjshëm.

"Ne mendojmë se Bashkimi Universal Postar nuk mund të mbetet indiferent ndaj një aktiviteti të tillë dhe që, në bazë të akteve të veta, si dhe të Kartës së OKB-së dhe rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me konfliktin mes Armenisë, Nagorni Karabakh dhe Azerbajxhanit, ajo duhet në mënyrë efektive të parandalojë përhapjen e pullave postare të paligjshëm nga subjekte të paligjshme dhe të panjohura dhe të marrë masat e nevojshme në lidhje me shtetin e tij anëtar, Armeninë, e cila mbështet këtë lloj veprimtarie, në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar. Ne gjithashtu përfitojmë nga kjo mundësi për ti kërkuar shteteve anëtare të UPU dhe shoqërive Operative që veprojnë nën autoritetin ligjor të tyre që të tërhiqen nga çdo marrëdhënie apo komunikim postar me të ashtu-quajturën "Republika e 'Nagorni Karabakh'".

"Ne besojmë se në veprimet e ardhshme të Unionit Universal Postar, ky lloj i aktivitetit do të mbahet nën kontroll dhe se, kur është e nevojshme, do të merren masat përkatëse.

"Qeveria e Azerbajxhanit vazhdon të deklarojë se administrata postare e Republikës së Azerbajxhanit është i vetmi autoritet përkatës postar në territorin e saj i njohur nga komuniteti botëror dhe organizatat ndërkombëtare.

"Qeveria e Azerbajxhanit konsideron çdo përpjekje për të njohur të ashtuquajturën "Republikë të Nagorni Karabakh" jo legjitime si një shtet të pavarur që të jetë në shkelje flagrante të integritetit territorial dhe sovranitetit të Republikës së Azerbajxhanit dhe në kundërshtim me të gjitha standardet ligjore ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën për të ofruar shërbime postare.

"Qeveria e Azerbajxhanit, deklaroi se, në pikëpamjen e pushtimit të Nagorni Karabakh të Azerbajxhanit dhe të rrethëve fqinje nga ana e forcave të armatosura të Armenisë, Republika e Azerbajxhanit rezervon të drejtën të mos aplikojë dispozitat e Konventës Universale Postare në lidhje me Armeninë".

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 17)

XVIII

Për llogari të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore

"Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore nuk ka dyshim në lidhje me sovranitetin e Mbretërisë së Bashkuar mbi Ishujt Falkland, Gjeorgjinë Jugore, Ishujt Jugore Sandwich dhe zonat detare përreth tyre, dhe refuzon kërkesën nga Qeveria e Argjentinës për sovranitetin mbi këto ishuj dhe zona detare.

"Parimi i vetëvendosjes, i sanksionuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, nënvizon pozicionin tonë në sovranitetin e Ishujve Falkland. Nuk mund të ketë negociime mbi Sigurimit të sovranitetit nga



Ishujt Falkland, përveç dhe deri në atë kohë kur Ishujt Falkland e dëshirojnë këtë. Ishujt rregullisht bëjnë të qartë se ata dëshirojnë që Ishujt Falkland të mbetet nën sovranitetin Britanik.

“Mbretëria e Bashkuar deklaroi shpesh qëndrimin e saj për Ishujt Falkland të njohur për komunitetin ndërkombëtar. Qëndrimi ynë ishte përcaktuar së fundmi në detaje nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Mbretërisë së Bashkuar në Kombet e Bashkuara, Sir Xhon Sauers, me një të drejtë të përgjigjes me shkrim ndaj deklaratës datë 1 tetor 2007 (A/62/469) nga Presidenti Nestor Kirchner Carlos i Republikës së Argjentinës në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2007. Ky mbetet qëndrimi i Mbretërisë së Bashkuar.

Mbretëria e Bashkuar nuk ka asnjë dyshim në lidhje me sovranitetin e saj mbi Territorin Britanik Antarktik dhe në këtë kontekst tërheq vëmendjen në Nenin IV të Traktatit të Antarktikës, në të cilën Britania e Madhe dhe Argjentina janë palë”.

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 18)

XIX

Për llogari të Republikës së Qipros

“Delegacioni i Republikës së Qipros në Kongresin e 24-të të Bashkimit Postar Universal përsërit deklaratën që ka bërë në Kongreset e mëparshme të UPU-t, dhe refuzon pa rezerva deklaratën dhe rezervën e bërë nga Republika e Turqisë më 11 gusht 2008 (KONGRESI Dok 41. Shtojcë 15) në Kongresin e 24-të në Gjenevë në lidhje me të drejtat e pjesëmarrjes dhe statusin e Republikës së Qipros si anëtare e UPU-t.

“Pozicionet turke janë krejtësisht në kundërshtim me dispozitat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat specifike të rezolutave të detyrueshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Qipron. Duhet theksuar se, në rezolutat e saj të 541 (1983) dhe 550 (1984), ndër të tjerash, Këshilli i Sigurimit UN dënoi shkëputjen e pjesës së Republikës së Qipros, duke e konsideruar “Deklaratën e njëanshme të pavarësisë” si ‘juridikisht të pavlefshme’ dhe bëri thirrje për tërheqjen e saj. Ai gjithashtu u bëri thirrje të gjitha shteteve të mos njohin asnjë shtet tjetër Qipriot të ndryshëm nga ai i Republikës së Qipros dhe ‘të mos lehtësojnë apo të ndihmojnë në ndonjë mënyrë subjektin e sipërpërmendur separatist’. Së fundi, ajo i bëri thirrje të gjithë shteteve që të respektojnë sovranitetin, pavarësinë, integritetin territorial dhe unitetin e Republikës së Qipros.

“Republika e Qipros ka qenë një shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara që nga pavarësia e saj në 1960, dhe një shtet anëtar të Bashkimit Evropian nga 1 maj 2004. Ajo ka qenë gjithashtu një anëtare e Bashkimit Postar Universal që nga nëntori i vitit 1961 dhe, në këtë cilësi, merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizatës. Qeveria e Republikës së Qipros është qeveri e njohur botërisht në Qipro, me kompetencën dhe autoritetin për të përfaqësuar shtetin, pavarësisht ndarjes *de facto* të ishullit si rezultat i Pushtimit Turk të vitit 1974.

“Që nga 1 maj 2004, Republika e Qipros ka qenë një anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian, duke nënvizuar faktin se ka është vetëm një shtet në Qipro. Në njohjen e problemeve të shkaktuara nga pushtimi i një pjese të territorit të saj në zbatimin e ligjeve të Komunitetit, Protokollin 10 i Aktit të Aderimit të Republikës së Qipros në Bashkimin Evropian siguron se zbatimi i *acquis communautaire* do të pezullohet në zonën e Republikës së Qipros mbi të cilat Qeveria e saj nuk ushtron kontroll efektiv.

“Duke pasur parasysh sa më sipër, deklarata dhe rezervat e bëra nga Republika e Turqisë në kundërshtim të të dyjave, dokumenteve dhe frymës së Kushtetutës UPU, Konventës dhe marrëveshjes. Delegacioni i Republikës së Qipros prandaj e konsideron çdo deklaratë apo rezervë të tillë si të paligjshme dhe pavlefshme, si dhe rezervon të drejtat e veta në përputhje me rrethanat”.

(KONGRESI-Dok 41. Shtojca 19)

KUSHTETUTA E BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL

(e ndryshuar me protokollet shtesë të Tokios më 1969, të Lozanës 1974, të Hamburgut 1984, të Uashingtonit 1989, të Seulit 1994, të Pekinit 1999, të Bukureshtit 2004 dhe të Kongresit të 24rt - 2008)

Pasqyra e lëndës

HYRJE

SEKSIONI I

Dispozita organike

KAPITULLI I

Të përgjithshme

Neni

- 1 Qëllimi dhe objektivat e Bashkimit
- 1bis Përkufizime
- 2 Anëtarët e Bashkimit
- 3 Juridiksioni i Bashkimit
- 4 Marrëdhënie të jashtëzakonshme
- 5 Selia e Bashkimit
- 6 Gjuha zyrtare e Bashkimit
- 7 Njësia monetare
- 8 Sindikata të kufizuara. Marrëveshje të posaçme
- 9 Marrëdhëniet me Kombet e Bashkuara
- 10 Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare

KAPITULLI II

Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim. Tërheqja nga Bashkimi

- 11 Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim. Procedura
- 12 Tërheqja nga Bashkimi. Procedura

KAPITULLI III

Organizimi i Bashkimit

- 13 Organet e Bashkimit
- 14 Kongresi
- 15 Kongrese të jashtëzakonshme
- 16 Konferencat administrative
- 17 Këshilli drejtues
- 18 Këshilli i Operacioneve Postare
- 19 Komitetet speciale
- 20 Byroja Ndërkombëtare

KAPITULLI IV

Financat e Bashkimit

- 21 Shpenzimet e Bashkimit. Kontributet e shteteve anëtare

SEKSIONI II

Aktet e Bashkimit

KAPITULLI I

Të përgjithshme

- 22 Aktet e Bashkimit



- 23 Zbatimi i Akteve të Bashkimit në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një shtet anëtar
- 24 Legjislacioni kombëtar

KAPITULLI II

Pranimi dhe denoncimi i akteve të Bashkimit

- 25 Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të akteve të Bashkimit
- 26 Njoftimi i ratifikimeve dhe metodat e tjera të miratimit të Akteve të Bashkimit
- 27 Aderimi në Marrëveshje
- 28 Denoncimi i një Marrëveshje

KAPITULLI III

Amendimet e Akteve të Bashkimit

- 29 Paraqitja e propozimeve
- 30 Amendimi i Kushtetutës
- 31 Amendimi i Rregullores së përgjithshme, Konventës dhe Rregulloreve

KAPITULLI IV

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 32 Arbitrazhi
- 33 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Kushtetutës

KUSHTETUTA E BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL

(e ndryshuar me protokollet shtesë të Tokios më 1969, të Lozanës 1974, të Hamburgut 1984, të Uashingtonit 1989, të Seulit 1994, të Pekinit 1999, të Bukureshtit 2004 dhe të Kongresit të 24rt - 2008)

Neni 1bis² Përkufizime

1. Për qëllimet e Akteve të Unionit Postar Universal, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e përcaktuara në vijim:

1.1 Shërbim postar: të gjitha shërbimet postare qëllimi i të cilave përcaktohet nga organet e Unionit. Detyrimet kryesore të shërbimeve postare janë të përmbushin disa objektiva të caktuara sociale dhe ekonomike të vendeve anëtare, duke siguruar, mbledhjen, klasifikimin, transmetimin, dhe shpërndarjen e dërgesave postare.

1.2 Shtet Anëtar: një shtet që përmbush kushtet e nenit 2 të Kushtetutës.

1.3 Territor i vetëm postar (një dhe i njëjti territor postar): detyrimi i palëve kontraktuese të Akteve të UPU për të ofruar për shkëmbimin reciprok të artikujve të letrave postare, duke përfshirë edhe lirinë e transitit, dhe trajtimin e dërgesave postare në transit nga vende të tjera njëjloj me artikujt e tyre postar, pa diskriminim.

1.4 Liria e transitit: detyrimi i një vendi anëtar të ndërmjetëm për të siguruar transportin e dërgesave postare për të kaluar transit në të, drejtuar në një tjetër vend anëtar, duke siguruar trajtim të ngjashëm me atë të dhënë për dërgesat e brendshme.

1.5 Artikull i letrave postare: artikujt e përshkruar në Konventë.

1.6 Shërbimi Ndërkombëtar postar: operacione postare ose shërbime të rregulluara nga këto Akte; vendosja e këtyre operacioneve ose shërbimeve.

1.6bis Operator i caktuar: çdo ent shtetëror ose jo, i caktuar zyrtarisht nga shteti anëtar për të kryer shërbimet postare dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit në territorin e tij³.

² Realizuar në Kongresin e Bukureshtit në vitin 2004.

³ Amenduar nga kongresi i 24-rt - 2008

1.6ter Rezervimi: një klauzolë përjashtimi ku një vend anëtar pretendon të përjashtojë ose të modifikojë efektin ligjor të një klauzole të një Akti, të ndryshëm nga Kushtetuta dhe Rregulloret e përgjithshme, në zbatimin e tij në atë vend anëtar. Çdo rezervim do të jetë në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit siç përcaktohet në parathënie dhe në nenin 1 të Kushtetutës. Ajo duhet të justifikohet në mënyrë të rregullt dhe të miratohet nga shumica e kërkuar për miratimin e Aktit në fjalë, dhe të futet në Protokollin Përfundimtar të tij⁴.

Neni 2 Anëtarët e Bashkimit

Do të jenë shtete anëtare të Bashkimit:

- a) shtetet që kanë statusin e anëtarit në datën kur hyn në fuqi Kushtetuta;
- b) shtetet e pranuar në përputhje me nenin 11.

Neni 3 Juridiksioni i Bashkimit

Bashkimi do të ketë në juridiksionin e tij:

- a) territoret e shteteve anëtare;
- b) zyrat e postës të krijuara nga shtetet anëtare në territoret që nuk bëjnë pjesë në Bashkim;
- c) territoret që nuk janë anëtare të Bashkimit, por përfshihen në të, pasi nga pikëpamja postare ato varen nga shtetet anëtare.

Neni 4 Marrëdhënie të jashtëzakonshme

Shtetet anëtare operatorët e caktuar të të cilave ofrojnë një shërbim me territore që nuk përfshihen në Bashkim janë të detyruara të veprojnë si ndërmjetës për shtetet e tjera anëtare⁵. Dispozitat e Konventës dhe rregulloret e saj do të jenë të zbatueshme për marrëdhënie të tilla të jashtëzakonshme.

Neni 5 Selia e Bashkimit

Selia e Bashkimit dhe e organeve të përhershme të tij është caktuar në Bernë.

Neni 6 Gjuha zyrtare e Bashkimit

Gjuha zyrtare e Bashkimit është gjuha franceze.

Neni 7⁶ Njësia monetare

Njësia monetare e përdorur në Aktet e Bashkimit do të jetë njësia e kontabilitetit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Neni 8 Sindikata të kufizuara. Marrëveshje të Posaçme

1. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, nëse i lejohet legjisllacioni i atyre shteteve anëtare⁷, mund të themelojnë sindikata të kufizuara dhe të bëjnë marrëveshje të veçanta në lidhje me shërbimin postar

⁴ Amenduar nga Kongresi i 24rt – 2008.

⁵ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në vitin 1989.

⁶ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989.

⁷ Amenduar nga Kongresi i 24rt - 2008



ndërkombëtar, gjithmonë me kusht që ata nuk do të kenë dispozita më pak të favorshme për publikun se ato të parashikuara nga Aktet në të cilat shtetet anëtare në fjalë janë palë.

2. Sindikatat e kufizuara mund të dërgojë vëzhgues në Kongrese, konferenca dhe takime të Bashkimit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare⁸.

3. Bashkimi mund të dërgojë vëzhgues në Kongreset, konferencat dhe mbledhjet e Sindikatave të Kufizuara

Neni 9

Marrëdhëniet me Kombet e Bashkuara

Marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit dhe Kombeve të Bashkuara do të disiplinoohen nga Marrëveshjet, tekstat e të cilave i bashkëlidhen Kushtetutës.

Neni 10

Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare

Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit të ngushtë në fushën postare ndërkombëtare, Bashkimi mund të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare që kanë interesa dhe veprimtari të lidhura me të.

KAPITULLI II

ANËTARËSIMI OSE PRANIMI NË BASHKIM. TËRHEQJA NGA BASHKIMI

Neni 11⁹

Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim. Procedura

1. Çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Bashkim.

2. Çdo shtet sovran i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aplikojë për pranim si një shtet anëtar i Bashkimit.

3. Aderimi ose kërkesa për pranim në Bashkimin duhet të përfshijë një deklaratë formale të pranimit të Kushtetutës dhe të Akteve të detyrueshme të Bashkimit. Ajo do të dërgohet nga qeveria e vendit të interesuar tek Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare, i cili do të njoftojë pranimin ose do të konsultohet me vendet anëtare në lidhje me aplikimin për pranim, sipas rastit.

4. Një vend i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara do të konsiderohet të pranohet si një vend anëtar nëse kërkesa e tij është miratuar nga të paktën dy të tretat e vendeve anëtare të Bashkimit. Vendet anëtare të cilat nuk i janë përgjigjur brenda një periudhe kohe prej katër muajsh të llogaritur nga data e konsultimeve¹⁰ do të konsiderohet se ka abstenuar.

5. Aderimi ose pranimi në anëtarësim do të njoftohet qeverive të vendeve anëtare nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare. Ai do të ketë efekt nga data e këtij njoftimi.

Neni 12¹¹

Tërheqja nga Bashkimi. Procedura

1. Çdo shtet anëtar mund të tërhiqet nga Bashkimi me anë të një njoftimi të denoncimit për Kushtetutë, të dhënë nga Qeveria e shtetit të interesuar për Drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe nëpërmjet tij, qeverive të shteteve anëtare.

2. Tërheqja nga Bashkimi do të bëhet efektive një vit pas ditës në të cilën njoftimi i denoncimit të dhënë në paragrafin 1 është marrë nga Drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

⁸ Amenduar nga kongreset e Tokios në 1969 dhe Seulit në 1994

⁹ Amenduar nga Kongreset e Tokios 1969 dhe Uashingtonit 1989.

¹⁰ Amenduar nga Kongresi i 24rt - 2008

¹¹ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989.

KAPITULLI III ORGANIZIMI I BASHKIMIT

Neni 13¹² Organet e Bashkimit

1. Organet e Bashkimit janë Kongresi, Këshilli drejtues, Këshilli i Operacioneve Postare dhe Byroja Ndërkombëtare.

2. Organet e përhershme të Bashkimit janë Këshilli drejtues, Këshilli i Operacioneve Postare, dhe Byroja Ndërkombëtare.

Neni 14 Kongresi

1. Kongresi është organi më i lartë i Bashkimit.
2. Kongresi përbëhet nga përfaqësues të shteteve anëtare.

Neni 15 Kongrese të jashtëzakonshme

Një Kongres i jashtëzakonshëm mund të mbledhet me kërkesë ose me miratimin e dy të tretave të shteteve anëtare të Bashkimit.

Neni 16 Konferencat administrative

(I fshirë)¹³

Neni 17¹⁴ Këshilli drejtues

1. Ndërmjet dy Kongreseve, Këshilli Drejtues (CA) siguron vazhdimësinë e punëve të Bashkimit, në përputhje me dispozitat e Akteve të Bashkimit.

2. Anëtarët e Këshillit drejtues ushtrojnë funksionet e tyre në emër dhe në interesin e Bashkimit.

Neni 18¹⁵ Këshilli i Operacioneve Postare

Këshilli i Operacioneve Postare (POC) do të jetë përgjegjës për çështjet operacionale, tregtare, teknike dhe ekonomike që kanë të bëjnë me shërbimin postar.

Neni 19 Komitetet speciale

(I fshirë)¹⁶

¹² Amenduar nga Kongreset e Tokios 1969, Hamburgut 1994 dhe Seulit 1994.

¹³ Nga Kongresi i Hamburgut në 1984.

¹⁴ Amenduar nga Kongresi i Seulit në 1994.

¹⁵ Amenduar nga Kongreset e Tokios në 1969 dhe të Seulit në 1994.

¹⁶ Amenduar nga Kongresi i Hamburgut në 1984.



Neni 20¹⁷
Byroja Ndërkombëtare

Një zyrë qendrore, që funksionon në selinë e Bashkimit me emrin Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal, e drejtuar nga një Drejtor i Përgjithshëm dhe nën kontrollin e Këshillit Drejtues, do të shërbejë si organ ekzekutiv, mbështetës, ndërlidhës, informimi dhe konsultimi.

KAPITULLI IV
FINANCAT E BASHKIMIT

Neni 21¹⁸
Shpenzimet e Bashkimit. Kontributet e shteteve anëtare

1. Çdo Kongres cakton shumën maksimale të shpenzimeve të cilën:
 - a) mund të arrijnë çdo vit shpenzimet e Bashkimit;
 - b) mund të arrijnë shpenzimet në lidhje me mbledhjen e Kongresit të ardhshëm.
2. Shuma maksimale për tu shpenzuar e parashikuar në pikën 1, mund të tejkalohet, nëse kërkohet nga rrethanat, me kushtin që të respektohen dispozitat përkatëse në lidhje me Rregulloren e përgjithshme.
3. Shpenzimet e Bashkimit, duke përfshirë eventualisht shpenzimet e parashikuara në pikën 2, do të mbështeten bashkërisht nga shtetet anëtare të Bashkimit. Me këtë rast, çdo shtet anëtar zgjedh klasën e kontributit në të cilën ai do të përfshihet. Klasat e kontributit janë të caktuara në Rregulloren e përgjithshme.
4. Në rast të aderimit ose pranimit në Bashkim, sipas nenit 11, shteti i interesuar do të zgjedhë lirisht klasën e kontributit në të cilën ai dëshiron të vendoset për shpërndarjen e shpenzimeve të Bashkimit.

SEKSIONI II
AKTET E BASHKIMIT

KAPITULLI I
TË PËRGJITHSHME

Neni 22
Aktet e Bashkimit

1. Kushtetuta do të jetë Akti themelor i Bashkimit. Ajo do të përmbajë rregullat organike të Bashkimit dhe nuk do të jetë subjekt i rezervave¹⁹.
2. Rregulloret e përgjithshme do të shprehin dispozitat të cilat sigurojnë zbatimin e Kushtetutës dhe punën e Bashkimit. Ato do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare dhe nuk do të jenë subjekt i rezervave²⁰.
3. Konventa Universale Postare, Rregullorja e Postës së Letrave dhe Rregullorja e Kolipostës do të shprehin rregullat e zbatueshme në të gjithë shërbimin ndërkombëtar postar dhe dispozitat në lidhje me shërbimet e postës së letrave dhe kolipostës. Këto Akte do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare²¹. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Konventa dhe Rregulloret e saj²².
4. Marrëveshjet e Bashkimit, dhe Rregulloret e tyre, do të disiplinojnë shërbimet e ndryshme nga ato të postës së letrave dhe kolipostës ndërmjet shteteve anëtare, të cilat janë palë në to. Ato do të jenë të detyrueshme vetëm për këto shtete anëtare. Shtetet nënshkruese anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshjet dhe Rregulloret e tyre²³.

¹⁷ Amenduar nga Kongreset e Hamburgut në 1984 dhe Seulit në 1994.

¹⁸ Amenduar nga Kongreset e Tokios në 1969, Lozanës në 1974 dhe Uashingtonit në 1989.

¹⁹ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit në 2004.

²⁰ Amenduar nga Kongresi i Pekinit në 1999.

²¹ Amenduar nga kongresi i 24rt - 2008

²² Amenduar nga Kongreset e Uashingtonit në 1989, Seulit në 1994 dhe Pekin në 1999.

²³ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989

5. Rregulloret, të cilat do të përmbajnë rregullat e aplikimit të nevojshme për zbatimin e Konventës dhe të Marrëveshjeve, do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi²⁴.

6. Protokollet përfundimtare të bashkëlidhura me Aktet e Bashkimit referuar në paragrafët 3, 4 dhe 5 do të përmbajnë rezervimet në lidhje me këto Akte.

Neni 23²⁵

Zbatimi i Akteve të Bashkimit në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një shtet anëtar

1. Çdo shtet mund të deklarojë në çdo moment që pranimi i Akteve të Bashkimit nga ai do të përfshijë të gjitha territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ose disa prej tyre është përgjegjës.

2. Deklarata e parashikuar në paragrafin 1, duhet t'i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

3. Çdo shtet anëtar mund t'i drejtojë në çdo kohë Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare një njoftim për të kundërshtuar zbatimin e Akteve të Bashkimit, për të cilat ai ka bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 1. Ky njoftim do të fillojë efektet e saj, një vit pas datës së marrjes së tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

4. Deklaratat dhe njoftimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 3, do ti komunikohen shteteve anëtare nga Drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

5. Paragrafët 1 deri në 4, nuk do të zbatohen në territoret që kanë cilësinë e anëtarit të Bashkimit dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës një shtet anëtar.

Neni 24

Legjislacioni kombëtar

Dispozitat e Akteve të Bashkimit nuk do të devijojnë nga legjislacioni i secilit prej shteteve anëtare në lidhje me çka nuk është parashikuar në këto Akte.

KAPITULLI II

PRANIMI DHE DENONCIMI I AKTEVE TË BASHKIMIT

Neni 25²⁶

Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të akteve të Bashkimit

1. Aktet e Bashkimit që rrjedhin nga Kongresi duhet të nënshkruhen nga të plotfuqishmit e vendeve anëtare.

2. Rregulloret duhet të autentikohen nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Operacioneve Postare²⁷.

3. Kushtetuta do të ratifikohet sa më shpejt të jetë e mundur nga shtetet nënshkruese.

4. Miratimi i Akteve të Bashkimit të ndryshme nga Kushtetuta do të disiplinohen nga rregullat kushtetuese të secilit prej shteteve nënshkruese.

5. Kur një shtet anëtar²⁸ nuk ratifikon Kushtetutën ose nuk i miraton aktet e tjera të cilat i ka nënshkruar, Kushtetuta dhe aktet tjera, do të jenë njëloj të vlefshme për shtetet e tjera anëtare²⁹ që i kanë ratifikuar ose miratuar ato.

²⁴ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989

²⁵ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989.

²⁶ Amenduar nga Kongreset e Uashingtonit në 1989 dhe Seulit në 1994.

²⁷ Amenduar nga Kongresi i Pekinit në 1999.

²⁸ Amenduar nga Kongresi i 24rt – 2008.

²⁹ Amenduar nga Kongresi i 24rt – 2008.



Neni 26³⁰

Njoftimi i ratifikimeve dhe metodat e tjera të miratimit të Akteve të Bashkimit

Instrumentet e ratifikimit të Kushtetutës dhe të Protokolleve shtesë të saj dhe, kur është rasti, të miratimit të akteve të tjera të Bashkimit do të depozitohen në afatin më të shkurtër pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare cila do të njoftojë qeveritë e shteteve anëtare për këto depozitime.

Neni 27

Aderimi në Marrëveshje

1. Shtetet anëtare mund të aderojnë në çdo kohë në një ose në disa Marrëveshje të parashikuara në nenin 22.4.
2. Aderimi i shteteve anëtare në Marrëveshje do të njoftohet në përputhje me nenin 11.3.

Neni 28

Denoncimi i një Marrëveshje

Çdo shtet anëtar mund të vendosë për të pushuar pjesëmarrjen në një ose disa Marrëveshje, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 12.

KAPITULLI III AMENDIMET E AKTEVE TË BASHKIMIT

Neni 29

Paraqitja e propozimeve

1. Një shtet anëtar ka të drejtë të paraqesë, në Kongres ose midis Kongreseve, propozime në lidhje me Aktet e Bashkimit në të cilin ai është palë.
2. Megjithatë, propozimet në lidhje me Kushtetutën dhe Rregulloret e Përgjithshme mund të paraqiten vetëm në Kongres.
3. Për më tepër, propozimet në lidhje me Rregulloret duhet të paraqiten drejtpërsëdrejti në Këshillin e Operacioneve Postare, por së pari duhet të transmetohen nga Byroja Ndërkombëtare për të gjitha shtetet anëtare dhe të gjithë operatorët e caktuar^{31,32}.

Neni 30

Amendimi i Kushtetutës

1. Për miratimin e propozimeve të paraqitura në Kongres dhe që kanë të bëjnë me këtë Kushtetutë, është i nevojshëm miratimi nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës³³.
2. Amendimet e miratuara nga një Kongres do të jenë subjekt i një protokollit shtesë dhe, me përjashtim të rastit kur është vendosur ndryshe nga Kongresi, do të hyjnë në fuqi në të njëjtën kohë me Aktet e përditësuara gjatë të njëjtit Kongres. Ato do të ratifikohen sa më shpejt të jetë e mundur nga shtetet anëtare dhe instrumentet e këtij ratifikimi do të trajtohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 26.

Neni 31³⁴

Amendimi i Rregulloreve të Përgjithshme, Konventës dhe Rregulloreve

1. Rregullorja e përgjithshme, konventa dhe Rregulloret do të përcaktojnë kushtet që duhet të përmbushen për miratimin e propozimeve në lidhje me to.

³⁰ Amenduar nga Kongreset e Tokios në 1969 dhe Uashingtonit në 1989.

³¹ Amenduar nga Kongresi i 24rt – 2008.

³² Amenduar nga Kongresi i Pekinit në 1999 dhe nga Kongresi i 24rt – 2008.

³³ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit në 2004.

³⁴ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit në 2004.

2. Konventa dhe Marrëveshjet e referuara në paragrafin 1 do të hyjnë në fuqi njëkohësisht dhe do të kenë të njëjtën kohëzgjatje. Që nga dita e vendosur nga Kongresi për hyrjen në fuqi të këtyre akteve, Aktet përkatëse të kongresit të mëparshëm do të abrogohen³⁵.

KAPITULLI IV ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 32 Arbitrazhi

Në rast të një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë shteteve anëtare³⁶ në lidhje me interpretimin e Akteve të Bashkimit ose përgjegjësitë e vendosura mbi shtet anëtar nga zbatimi i këtyre Akteve, çështja në fjalë do të zgjidhet me arbitrazh.

SEKSIONI III DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Kushtetutës

Kjo Kushtetutë do të hyjë në fuqi duke filluar nga data 1 janar 1996 dhe do të jetë në fuqi për një kohë të papërcaktuar.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit të qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë Kushtetutë, në një kopje të vetme origjinale e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së shtetit në të cilin është vendosur selia e Bashkimit. Një kopje e tij do t'i dërgohet secilës palë nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal³⁷.

Realizuar në Vjenë, 10 korrik 1964.

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL (amenduar nga Protokolli i Parë shtesë i Kongresit të 24rt - 2008)

Tabela e lëndës

KAPITULLI I Funksionimi i organeve të Bashkimit

Neni

- 101 Organizimi dhe mbledhja e Kongreseve dhe Kongreseve të Jashtëzakonshëm
- 101bis Funksionet e Kongresit
- 102 Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit Drejtues
- 103 Informacioni mbi veprimtaritë e Këshillit Drejtues
- 104 Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare
- 105 Informacioni mbi veprimtaritë e Këshillit të Operacioneve Postare
- 106 Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Komitetit Këshillimor
- 107 Informacioni mbi veprimtaritë e Komitetit Këshillimor
- 108 Rregullat e procedurës së Kongreseve
- 109 Gjuha e punës së Byrosë Ndërkombëtare
- 110 Gjuhët e përdorura për dokumentacionin, debatet dhe për korrespondencën zyrtare

³⁵ Amenduar nga Kongresi i Hamburgut në 1984.

³⁶ Amenduar nga Kongresi i 2rt - 2008

³⁷ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit në 2004.



KAPITULLI II

Byroja Ndërkombëtare

- 111 Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare
- 112 Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm
- 113 Detyrat e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm
- 114 Sekretariati i organeve të Bashkimit
- 115 Lista e shteteve anëtare
- 116 Informacioni. Opinionet. Kërkesat për interpretim dhe amendim të Akteve. Reklamimet. Roli në shlyerjen e llogarive.
- 117 Bashkëpunimi teknik
- 118 Formularët e dhënë nga Byroja Ndërkombëtare
- 119 Aktet e Sindikatave të Kufizuara dhe Marrëveshje të Posaçme
- 120 Botimet periodike të Bashkimit
- 121 Raporti dyvjeçar për punën e Bashkimit

KAPITULLI III

Procedura për paraqitjen dhe shqyrtimin e propozimeve

- 122 Procedura për paraqitjen e propozimeve në Kongres
- 123 Procedura për paraqitjen e propozimeve në Këshillin e Operacioneve Postare në lidhje me përgatitjen e Rregulloreve të reja në kuadrin e vendimeve të marra nga Kongresi
- 124 Procedura për paraqitjen e propozimeve ndërmjet Kongreseve
- 125 Shqyrtimi i propozimeve ndërmjet Kongreseve
- 126 Njoftimi i vendimeve të miratuara ndërmjet Kongreseve
- 127 Hyrja në fuqi e Rregulloreve dhe vendimeve të tjera të miratuara ndërmjet Kongreseve

KAPITULLI IV

Financa

- 128 Vendosi dhe rregullomi i shpenzimeve të Bashkimit
- 129 Sanksione automatike
- 130 Klasat e kontributeve
- 131 Pagesa për furnizime nga Byroja Ndërkombëtare

KAPITULLI V

Arbitrazhi

- 132 Procedura e arbitrazhit

KAPITULLI VI

Dispozita përfundimtare

- 133 Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me Rregulloren e Përgjithshme
- 134 Propozimet në lidhje me Marrëveshjet me Kombet e Bashkuara
- 135 Amendimi, hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores së Përgjithshme

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL
(amenduar nga Protokolli i Parë shtesë i Kongresit të 24rt - 2008)

Të nënshkruarit, të plotfuqishmit e Qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, duke pasur parasysh nenin 22.2 të Kushtetutës së Bashkimit Postar Universal të përfunduar në Vjenë, më datë 10 Korrik 1964, me marrëveshje të përbashkët dhe subjekt i nenit 25.4 të Kushtetutës, kanë hartuar në këtë Rregullore të Përgjithshme dispozitat e mëposhtme, duke siguruar zbatimin e Kushtetutës dhe funksionimin e Bashkimit.

KAPITULLI I
FUNKSIONIMI I ORGANEVE TË BASHKIMIT

Neni 101

Organizimi dhe mbledhja e Kongreseve dhe Kongreseve të Jashtëzakonshëm (Kushtetuta 14, 15)

1. Përfaqësuesit e shteteve anëtare do të mblidhen në kongres jo më vonë se katër vjet nga fundi i vitit në të cilin është mbledhur Kongresi i mëparshëm.

2. Çdo shtet anëtar do të përfaqësohet në Kongres nga një ose disa delegatë të cilët do të kenë kompetencat e nevojshme nga Qeveria e tyre. Në rast nevojë, mund të bihet dakord për tu përfaqësuar nga një shtet tjetër anëtar. Megjithatë duhet të kuptohet që një delegacion nuk mund të përfaqësojë më shumë se një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti i tij.

3. Në debate, çdo shtet anëtar disponon një votë, subjekt i kufizimeve kufizimet të parashikuara në nenin 129.

4. Në parim, çdo kongres cakton vendin ku do të zhvillohet Kongresi i ardhshëm. Nëse kjo zgjidhje bëhet e pazbatueshme, Këshilli drejtues është i autorizuar të caktojë vendin ku Kongresi do të mbajë mbledhjet e tij, por pasi të ketë konsultimit me vendin e pa pranuar më parë.

5. Në marrëveshje me Byronë Ndërkombëtare, qeveria pritëse cakton datën definitive dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet Kongresi. Në parim, një vit para kësaj date, qeveria pritëse do ti dërgojë një ftesë secilës prej qeverive të shteteve anëtare. Kjo ftesë mund të dërgohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me ndërmjetësim të një qeverie tjetër, ose nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

6. Kur nuk ka një shtet pritës për Kongresin, Byroja Ndërkombëtare, në marrëveshje me Këshillin drejtues dhe pas konsultimit me qeverinë e Konfederatës së Zvicrës, do të marrë masat e nevojshme për thirrjen dhe organizimin e Kongresit në vendin ku ndodhet selia e Bashkimit. Në këtë rast, Byroja Ndërkombëtare do të ushtrojë funksionet e qeverisë ftuese.

7. Vendi për mbledhjen e një Kongresi të Jashtëzakonshëm përcaktohet nga shtetet anëtare që kanë marrë iniciativën për këtë Kongres, pas konsultimit me Byronë Ndërkombëtare.

8. Dispozitat e parashikuara në pikat 2 deri në 6 do të jenë të zbatueshme për analogji dhe për Kongreset e jashtëzakonshme.

Neni 101bis

Funksionet e Kongresit

1. Në bazë të propozimeve nga shtetet anëtare, Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, Kongresi:

1.1 të përcaktojë politikat e përgjithshme për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të Bashkimit të vendosur në Preambulë dhe në nenin 1 të Kushtetutës;

1.2 të konsiderojë dhe miratojë, nëse është e përshtatshme, propozimet për amendimet e Kushtetutës, Rregullores së Përgjithshme, Konventën dhe Marrëveshjet e paraqitura nga shtetet anëtare dhe Këshillat, në përputhje me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 122 të Rregullores së Përgjithshme;

1.3 të vendosë datën për hyrjen në fuqi të Akteve;

1.4 të miratojë Rregullat e tij të Procedurës dhe amendimet e këtyre Rregullave;

1.5 të konsiderojë raportet e përgjithshme mbi punën e Këshillit Drejtues, Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komitetit Këshillimor, që mbulojnë periudhën nga Kongresi i mëparshëm, të paraqitur nga organet përkatëse në përputhje me nenet 103, 105 dhe 107 të Rregullores së Përgjithshme;



- 1.6 të miratojë strategjinë e Bashkimit;
- 1.7 të vendosë shumën maksimale të shpenzimeve të Bashkimit në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës;
- 1.8 të zgjedhë shtetet anëtare në Këshillin Drejtues dhe në Këshillin e Operacioneve Postare;
- 1.9 të zgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm;
- 1.10 të vendosë kufirin e kostove që ka Bashkimi për prodhimin e dokumenteve në gjuhën Kineze, Gjermane, Portugeze dhe Ruse.
2. Kongresi, si organ suprem i Bashkimit, do të kujdeset për të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

Neni 102

Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit Drejtues (Kushtetuta 17)

1. Këshilli drejtues përbëhet nga dyzetë e një anëtarë, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës midis dy Kongreseve konsektivë.
2. Presidenca i njihet si e drejtë shtetit anëtar pritës të kongresit. Nëse ky shtet anëtar heq dorë nga kjo e drejtë, ai do të konsiderohet si anëtar de jure, dhe për rrjedhojë, grupi gjeografik në të cilin ai bën pjesë, do të ketë në dispozicionin e tij një vend shtesë, ndaj të cilit nuk do të jenë të zbatueshme kufizimet e parashikuara në pikën 3. Në këtë rast, Këshilli drejtues do të zgjedhë për presidencë një nga shtetet anëtare pjesëtarë të grupit gjeografik në të cilin bën pjesë shteti anëtar pritës.
3. Të dyzetë (40) anëtarët e tjerë të Këshillit drejtues do të zgjidhen nga Kongresi mbi bazën e një shpërndarje gjeografike të barabartë. Të paktën gjysma e anëtarëve do të rinovohet në çdo kongres; asnjë vend anëtar nuk mund të zgjidhet nga tre Kongrese të njëpasnjëshme.
4. Çdo anëtar i Këshillit drejtues cakton përfaqësuesin e tij, i cili duhet të jetë kompetent në kuadrin postar.
5. Funksionet e anëtarit të Këshillit drejtues nuk do të jenë të paguara. Shpenzimet për funksionimin e këtij Këshilli i ngarkohen Bashkimit.
6. Këshilli drejtues do të ketë kompetencat e mëposhtme:
 - 6.1 mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarive të Bashkimit midis Kongreseve, duke siguruar përputhjen me vendimet e Kongresit, duke shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me politikat qeverisëse mbi çështjet postare dhe duke konsideruar zhvillimet rregullatore ndërkombëtare si ato që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve dhe të konkurrencën;
 - 6.2 shqyrtimin dhe miratimin, brenda kuadrit të kompetencave të tij, të çdo veprimi të gjykuar të nevojshëm, për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë dhe modernizimin e shërbimit postar ndërkombëtar;
 - 6.3 promovimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha formave të asistencës teknike postare brenda kuadrit të bashkëpunimit teknik ndërkombëtar;
 - 6.4 shqyrtimin dhe miratimin e Programit dyvjeçar dhe Buxhetit dhe llogarive të Bashkimit;
 - 6.5 autorizimin e tejkallimit të kufirit të shpenzimeve, nëse e kërkojnë rrethanat, në përputhje me nenin 128.3 deri në 5;
 - 6.6 formulimin e Rregullores Financiare të Bashkimit;
 - 6.7 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Rezervë;
 - 6.8 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Speciale;
 - 6.9 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin e Veprimtarive Speciale;
 - 6.10 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Vullnetar;
 - 6.11 sigurimin e kontrollit mbi veprimtarinë e Byrosë Ndërkombëtare;
 - 6.12 autorizimin e zgjedhjes së një klase kontributi më të ulët, nëse kjo kërkohet, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 130. 6;
 - 6.13 autorizimin e ndryshimit të grupit gjeografik, nëse kjo kërkohet nga një shtet anëtar, duke konsideruar mendimet e shprehura nga shtetet anëtare të cilat janë pjesëtarë të grupeve gjeografike në fjalë;
 - 6.14 formulimin e Rregullores së Personelit dhe kushteve të shërbimit për funksionarët e zgjedhur;
 - 6.15 krijimin ose shkurtimin e vendeve të punës në Byronë Ndërkombëtare, duke konsideruar kufizimet lidhur me tavanin e vendosur të shpenzimeve;
 - 6.16 formulimin e Rregullores së Fondit Social;

6.17 miratimin e raportit 2-vjeçar mbi punën e Bashkimit dhe Raportit 2-vjeçar të Administrimit Financiar të përgatitura nga Byroja Ndërkombëtare, dhe nëse gjykohet e përshtatshme, paraqitjen e disa komenteve rreth tyre;

6.18 vendimin mbi kontaktet që duhet të vendosen me shtetet anëtare me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

6.19 Pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare, vendimin mbi kontaktet që duhet të vendosen me organizata të cilat nuk janë vëzhgues de jure, shqyrtimin dhe miratimin raporteve të Byrosë Ndërkombëtare mbi marrëdhëniet e UPU-t me organizma të tjera ndërkombëtare, vendime të cilat i gjykon si të përshtatshme për të drejtuar këto marrëdhënie dhe veprimet që duhet të ndërmerren për to; pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe Sekretariatin e Përgjithshëm, të caktojë në kohën e duhur organizmat ndërkombëtare, shoqatat, sipërmarrjet dhe personat e specializuar të cilët duhet të ftohen në seancat shkencore të Kongresit dhe të Komiteteve të tij, kur kjo është në interesin e Bashkimit ose të punimeve të Kongresit, dhe instruktimin e Drejtorit të Përgjithshëm të dërgojë ftesat e nevojshme;

6.20 krijojë parimet, në rastin kur e gjykon të nevojshme, për Këshillin e Operacioneve Postare duke konsideruar gjatë shqyrtimit të çështjeve me pasoja financiare të rëndësishme (tarifa, detyrime të fazës përfundimtare, shpenzime transiti, tarifa bazë të transportit ajror të postës dhe postimin jashtë shtetit për dërgesat e postës së letrave), ndjekjen nga afër të shqyrtimit të këtyre çështjeve dhe rishikimin dhe miratimin, për konformitet me parimet e lartpërmendura, propozimet e Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me këto çështje;

6.21 shqyrtimin, me kërkesë të Kongresit, të Këshillit të Operacioneve Postare ose të shteteve anëtare, probleme të llojit administrativ, legjislativ dhe juridik që kanë të bëjnë me Bashkimin ose shërbimin postar ndërkombëtar; i takon Këshillit drejtues të vendosë për fushat e lartpërmendura, nëse është e dobishme të ndërmerren studimet e kërkuara nga shtetet anëtare midis Kongreseve;

6.22 formulimin e propozimeve që do të nënshtrohen miratimit të Kongresit ose të shteteve anëtare në përputhje me nenin 125;

6.23 miratimin, brenda kuadrit të kompetencave të veta, të rekomandimeve të Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me njohjen, nëse është e nevojshme, të rregulloreve ose të një praktike të re duke pritur që Kongresi të vendosë mbi çështjen;

6.24 shqyrtimin e raportit vjetor të përgatitur nga Këshilli i Operacioneve Postare dhe çdo propozim të paraqitur nga Këshilli;

6.25 paraqitjen në Këshillin e Operacioneve Postare të subjekteve të studimit sipas nenit 104.9.16;

6.26 caktimin e shtetit anëtar ku do të mbahet Kongresi i ardhshëm në rastin e parashikuar në nenin 101.4;

6.27 përcaktimin, në kohën e duhur dhe pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare, të numrit të Komisioneve të nevojshme për drejtimin sa më të mirë të punimeve të Kongresit dhe caktimin e kompetencave të tyre;

6.28 caktimin, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe subjekt i miratimit të Kongresit, shtetet anëtare të përgatitura:

- për të marrë përsipër nën-kryesinë e Kongresit dhe të presidencës dhe të nën-presidencës së Komiteteve, duke konsideruar sa më shumë që është e mundur shpërndarjen gjeografike të barabartë të shteteve anëtare;

- për të mbikëqyrur Komisionet e kufizuara të Kongresit;

6.29 vlerësimin dhe miratimin, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, projektin e Strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

6.30 miratimin e raportit katër vjeçar, të përgatitur nga Byroja Ndërkombëtare duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, mbi performancën e shteteve anëtare në lidhje me ekzekutimin e Strategjisë së Bashkimit të miratuar nga Kongresi i mëparshëm, për tu paraqitur në Kongresin e radhës;

6.31 krijimin e kuadrit për organizimin e Komitetit Këshillimor dhe kontribuimin në organizimin e Komitetit Këshillimor, në përputhje me dispozitat e nenit 106;

6.32 caktimin e kriterëve për anëtarësim në Komitetit Këshillimor dhe miratimin ose kundërshtimin e kërkesave për anëtarësim sipas këtyre kriterëve, duke u siguruar veprimi me kërkesat është përmbushur me anë të një procedure të përsheptuar ndërmjet mbledhjeve të Këshillit drejtues;

6.33 caktimin e atyre anëtarëve të tij të cilët do të jenë anëtarë të Komitetit Këshillimor;



6.34 marrjen dhe diskutimin e raporteve dhe rekomandimeve të Komitetit Këshillimor dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve nga Komiteti Këshillimor për paraqitje në Kongres;

7. Në mbledhjen e tij të parë, e cila do të thirret nga Kryetari i Kongresit, Këshilli drejtues zgjedh, ndër anëtarët e tij, katër nënkryetarë dhe harton Rregulloren e tij të Procedurës.

8. Me thirrje nga Kryetari i tij, Këshilli drejtues do të mbledhet në parim një herë në vit, në selinë e Bashkimit.

9. Kryetari, nënkryetarët dhe kryetari i Komisionit të Këshillit drejtues, do të përbëjnë Komitetin drejtues. Ky komitet do të përgatisë dhe drejtojë punët në çdo mbledhje të Këshillit drejtues. Ai miraton, në emër të Këshillit drejtues, raportin dy vjeçar të përpiluar nga Byroja Ndërkombëtare mbi punën e Bashkimit dhe merr përsipër çdo detyrë tjetër që Këshilli drejtues vendos t'ia besojë ose që lind gjatë procesit të planifikimit strategjik.

10. Shpenzimet e udhëtimit të përfaqësuesit të çdo anëtari të Këshillit drejtues pjesëmarrës në mbledhjet e këtij organi, do të mbulohen nga shteti i tij anëtar. Megjithatë, përfaqësuesi i çdo shteti anëtar të klasifikuar si në zhvillim ose shtete më pak të zhvilluara në përputhje me listën e hartuar nga Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mbledhjeve që janë mbajtur gjatë Kongresit, do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që kjo shumë të mos tejkalojë vlerën e një bilete avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik. E njëjta e drejtë i jepet edhe përfaqësuesit të çdo anëtari të komisioneve të tij, të grupeve të tij të punës ose organeve të tjera të tij kur këto të fundit mbledhen jashtë Kongresit dhe mbledhjeve të Këshillit.

11. Kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e Këshillit drejtues në rendin e ditës të të cilave ka çështje të cilat janë me interes për organin që ai drejton.

12. Kryetari i Këshillit Këshillimor do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e Këshillit drejtues në rendin e ditës të të cilave ka çështje të cilat janë me interes për Komitetin Këshillimor.

13. Me qëllim për të siguruar një lidhje efikase të punimeve të dy organeve, Këshilli i Operacioneve Postare mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues, me cilësinë e vëzhguesit.

14. Shteti anëtar ku mbledhet Këshilli drejtues do të jetë i ftuar të marrë pjesë në mbledhje me cilësinë e vëzhguesit, nëse ky shtet nuk është anëtar i Këshillit drejtues.

15. Këshilli drejtues mund të ftojë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote, çdo organizëm ndërkombëtar, çdo përfaqësues shoqate ose ndërmarrje, ose çdo individ të kualifikuar i cili dëshiron të bashkohet me punën e tij në këto mbledhje. Mund të ftohen me të njëjtat kushte një ose disa shtete anëtare të interesuara për çështje të parashikuara në rendin e ditës së mbledhjes.

16. Me kërkesën e tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e komisioneve të Këshillit drejtues:

16.1 anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare;

16.2 anëtarët i Këshillit Këshillimor;

16.3 organizma ndërqeveritare që interesohen për punimet e Këshillit drejtues;

16.4 të tjera vende anëtare të Bashkimit.

17. Për arsye logjistike, Këshilli drejtues mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

18. Anëtarët e Këshillit drejtues do të marrin pjesë efektivisht në punimet e mbledhjeve. Vëzhguesit munden, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë disa Grupe Pune dhe Ekiye Projektesh, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve bëhet pa shpenzime shtesë nga Bashkimi.

19. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Duhet e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

Neni 103

Informacion mbi aktivitetin e Këshillit drejtues

1. Pas çdo sesioni, Këshilli drejtues do të informojë shtetet anëtare të Bashkimit, operatorët e tyre të caktuar, Bashkimet e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor, mbi veprimtaritë e veta duke ju dërguar, *inter alia*, atyre një përmbledhje analitike për rezolutat dhe vendimet.

2. Këshilli drejtues do të bëjë një raport për gjithë aktivitetin e tij për Kongresin dhe ja dërgon atë shteteve anëtare, operatorëve të tyre të caktuar dhe anëtareve të Këshillit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni 104

Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare (Kushtetuta 18)

1. Këshilli i Operacioneve Postare përbëhet nga dyzetë anëtarë të cilët do të ushtrjnë funksionet e tyre gjatë periudhës që ndan dy Kongrese të njëpasnjëshme.

2. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të zgjidhen nga Kongresi sipas një ndarje specifike gjeografike. Njëzet e katër vende do të rezervohen për shtetet anëtare në zhvillim dhe gjashtëmbëdhjetë vende për shtetet anëtare të zhvilluara. Të paktën një e treta e anëtarëve do të rinovohet në çdo Kongres.

3. Çdo anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare cakton përfaqësuesin e tij i cili merr përsipër përgjegjësitë e përcaktuara në Aktet e Bashkimit në fushën e kryerjes së shërbimeve.

4. Shpenzimet për funksionimin e Këshillit të Operacioneve Postare do të mbulohen nga Bashkimi. Anëtarët e tij nuk marrin asnjë pagesë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të përfaqësuesve të shteteve anëtare pjesëmarrëse në Këshillin e Operacioneve Postare janë në ngarkim të këtyre shteteve anëtare. Megjithatë, përfaqësuesi i çdo vendi që konsiderohet i pa favorizuar sipas listave të hartuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që shuma të mos tejkalojë çmimin e një bilete avioni vajtje- ardhje të klasit ekonomik, me përjashtim të mbledhjeve që zhvillohen gjatë Kongresit.

5. Në mbledhjen e tij të parë, e cila është thirrur dhe hapur nga kryetari i Kongresit, Këshilli i Operacioneve Postare do të zgjedhë, ndërmjet anëtareve të tij një Kryetar, një Nënkryetar, dhe kryetarët e Komitetit.

6. Këshilli i Operacioneve Postare mban rregulloren e tij të brendshme.

7. Në parim, Këshilli i Operacioneve Postare mbledhet çdo vit në selinë e Bashkimit. Data dhe vendi i mbledhjes do të caktohen nga kryetari i tij, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

8. Kryetari, Nënkryetari, Kryetarët e Komisioneve të Këshillit të Operacioneve Postare do të përbëjnë Komitetin drejtues. Ky Komitet përgatit dhe drejton punët e çdo mbledhje të Këshillit të Operacioneve Postare dhe mbulon të gjitha detyrat që ky i fundit vendos t'ia besojë, ose për të cilat lind nevoja gjatë procesit për planifikim strategjik.

9. Kompetencat e Këshillit të Operacioneve Postare janë si më poshtë:

9.1 të drejtojë shqyrtimin e problemeve më të rëndësishme operacionale, tregtare, teknike, ekonomike dhe të bashkëpunimit teknik, që paraqesin interes për të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, duke përfshirë çështjet që kanë pasoja financiare të rëndësishme (tarifat, shpenzimet përfundimtare, tarifa të transimit, tarifa të transportit ajror për postën, tarifat për koltë postare dhe postimin jashtë shtetit të artikujve të postës së letrave), dhe të përgatisë informacionin dhe rekomandimeve për veprimin për to;

9.2 të rishikojë Rregulloret e Bashkimit brenda gjashtë muajve që pasojnë mbylljen e Kongresit, nëse Kongresi nuk vendos ndryshe; në rast të nevojave urgjente, Këshilli i Operacioneve Postare gjithashtu mund të ndryshojë Rregulloret e sipërpërmendura në sesione të tjera; në të dyja rastet, Këshilli i Operacioneve do të jetë subjekt i direktivave të Këshillit drejtues për sa i përket politikave dhe parimeve themelore;

9.3 të koordinojë masat praktike për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndërkombëtare postare;

9.4 të ndërmarrë, pas miratimit të Këshillit drejtues brenda kuadrit të kompetencave të këtij të fundit, çdo veprim të gjykuar të nevojshëm për të mbajtur rregullin dhe përforcuar cilësinë e shërbimit ndërkombëtar postar dhe për ta modernizuar atë;



9.5 të formulojë propozime që do t'i paraqiten për miratim Kongresit ose shteteve anëtare në përputhje me nenin 125; miratimi i Këshillit drejtues kërkohet kur këto propozime kanë të bëjnë me çështje brenda kompetencave e këtij të fundit;

9.6 të shqyrtojë, me kërkesën të një shteti anëtar, çdo propozim që ky shtet anëtar i transmeton Byrosë Ndërkombëtare sipas nenit 124, të përgatisë vërejtjet për to dhe të instruktojë Byronë Ndërkombëtare për aneksimin e këtyre vërejtjeve me propozimet para se ti paraqiten për miratim të shteteve anëtare;

9.7 të rekomandojë, nëse është e nevojshme, dhe kur është e arsyeshme pas miratimit nga Këshilli drejtues dhe këshillimit me të gjitha shtetet anëtare, miratimin përfundimtar të rregulloreve ose të një procedure të re deri në momentin që Kongresi të vendosë për këtë çështje;

9.8 të përpunojë dhe të paraqesë, në formë rekomandimesh para shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, standarde për procese teknologjike, operacionale dhe procese të tjera në kompetencën e tij, ku është e domosdoshme një praktikë e njëtrajtshme; ai do të paraqesë në mënyrë të ngjashme, sipas kërkesave, amendamente për standardet që ka vendosur;

9.9 ti sigurojë Këshillit drejtues të dhëna për zhvillimin e draftit të Strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

9.10 të miratojë ato pjesë të raportit dy vjeçar të Byrosë Ndërkombëtare mbi punën e Bashkimit që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe funksionet e Këshillit të Operacioneve Postare;

9.11 të vendosë mbi kontaktet që duhet të krijohen me shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

9.12 të studiojë problemet e edukimit dhe formimit profesional që i interesojnë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuara si e shteteve të reja dhe në zhvillim;

9.13 të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin dhe reklamimin e eksperimenteve dhe progresit të arritur nga disa shtete anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në fushën teknike, operacionale, ekonomike dhe të trajnimit profesional me interes për shërbimet postare;

9.14 të shqyrtojë situatën aktuale dhe nevojat e shërbimit postar në shtetet e reja dhe ato në zhvillim dhe të përpunojë rekomandimet e përshtatshme për mënyrat dhe mjetet për përmirësimin e shërbimeve postare në këto shtete;

9.15 të marrë, pas këshillimit me Këshillin drejtues, hapa të përshtatshme në fushën e bashkëpunimit teknik me gjithë shtetet anëtare të Bashkimit dhe operatorët e tyre të caktuar dhe në veçanti me vendet e reja dhe ato në zhvillim dhe operatorët e tyre të caktuar;

9.16 të shqyrtojë çdo çështje tjetër të paraqitur, nga një anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare, nga Këshilli drejtues ose nga çdo shtet anëtar ose operator i caktuar;

9.17 të marrë dhe diskutojë raportet si dhe rekomandimet e Komitetit Këshillimor, dhe, kur janë të përfshira çështje me interes për Këshillin e Operacioneve Postare, të shqyrtoj dhe komentojë rekomandimet e Komitetit Këshillimor që do të paraqiten në Kongres;

9.18 Të caktojë ata anëtarë të tij që do të bëjnë pjesë në Komitetin Këshillimor;

10. Bazuar në planin strategjik të Bashkimit të miratuar nga Kongresi dhe, në veçanti, të pjesës që lidhet me strategjitë e Organeve të Përhershme të Bashkimit, Këshilli i Operacioneve Postare, në sesionin e tij të parë pas Kongresit, do të përgatisë një program pune bazë që përmban një numër të caktuar taktikash me qëllim realizimin e strategjive. Ky program pune bazë, që do të përfshijë një numër të caktuar projektesh mbi subjekte kryesore dhe me interes të përbashkët, do të rishikohet çdo vit në funksion të realitetit dhe të prioritetëve të reja;

11. Me qëllimin sigurimin një lidhje midis punës së të dy organeve, Këshilli drejtues mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare me cilësinë e vëzhguesit.

12. Nëse kërkohet prej tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e Komisioneve të Këshillit të Operacioneve Postare:

12.1 anëtarët e Këshillit drejtues;

12.2 anëtarët e Komitetit Këshillimor;

12.3 organizma ndërqeveritare të interesuara për punimet e Këshillit të Operacioneve Postare;

12.4 shtete të tjera anëtare të Bashkimit;

13. Për arsye logjistike, Këshilli i Operacioneve Postare mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

14. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të marrin pjesë efektivisht në punimet e mbledhjeve. Vëzhguesit munden, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë disa Grupe Pune dhe Ekiye Projektesh, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve bëhet pa shpenzime shtesë nga Bashkimi.

15. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Duhet e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

16. Kryetari i Komitetit Këshillimor përfaqëson atë organ në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare kur rendi i ditës përmban çështje që i interesojnë Komitetit Këshillimor.

17. Këshilli i Operacioneve Postare mund të ftojë sa më poshtë në mbledhjet e saj, pa të drejtë vote:

17.1 çdo organizëm ndërkombëtar ose çdo person të kualifikuar i cili dëshiron të bashkohet me punimet e tij;

17.2 çdo shtet anëtar që nuk bëjnë pjesë në Këshillin e Operacioneve Postare;

17.3 çdo shoqatë apo sipërmarrje që dëshiron njihet konsultohet në lidhje me punimet e tij.

Neni 105

Informacion mbi veprimtarinë e Këshillit të Operacioneve Postare

1. Pas çdo sesioni, Këshilli i Operacioneve Postare do të njoftojë shtetet anëtare, operatorët e tyre të caktuar, Sindikatat e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor mbi veprimtarinë e tij duke i dërguar atyre, *inter alia*, një përmbledhje analitike dhe rezolutat dhe vendimet e tyre.

2. Këshilli i Operacioneve Postare do të përgatisë një raport vjetor mbi punën e tij për Këshillin drejtues.

3. Këshilli i Operacioneve Postare përpilon, për Kongresin, një raport përmbledhës për punën e tij dhe ja dërgon shteteve anëtare, operatorëve të tyre caktuar si dhe anëtarëve të Komitetit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni 106

Përbërja, funksionimi dhe mbledhjet e Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të përfaqësojë interesat e sektorit ndërkombëtar postar në kuptimin e gjerë dhe ofrojë një kuadër për një dialog efikas ndërmjet grupeve të interesuar. Ai përbëhet nga organizata joqeveritare që përfaqësojnë klientë, furnitorë të shërbimeve të shpërndarjes, organizata të punëtorëve, furnitorë të mallrave dhe të shërbimeve për sektorin dhe shërbimet postare, dhe disa organizma të ngjashme të personave dhe shoqërive të cilat kanë interes në mbështetjen e misionit dhe objektivave të Bashkimit. Nëse këto organizata janë të regjistruara, ato duhen të jenë të regjistruara në një shtet anëtar të Bashkimit. Këshilli drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare do të caktojë anëtarët e në Këshillat e tyre përkatës si anëtar të Komitetit Këshillimor. Përveç anëtarëve të caktuar nga Këshilli drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor do të përcaktohet me paraqitjen e kërkesës dhe të pranimit të kësaj të fundit, nga Këshilli drejtues dhe e realizuar në përputhje me nenin 102.6.31.

2. Çdo anëtar i Komitetit Këshillimor do të caktojë përfaqësuesin e tij.

3. Shpenzimet për funksionimin e Komitetit Këshillimor do të ndahen midis Bashkimit dhe anëtarëve të Komitetit, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Këshilli drejtues.

4. Anëtarët e Komitetit Këshillimor nuk do të marrin asnjë pagë apo shpërblim.

5. Komiteti Këshillimor do të riorganizohet pas çdo Kongresi, në përputhje me kuadrin e përpiluar nga Këshilli drejtues. Kryetari i Këshillit drejtues drejton mbledhjen për organizimin e Komitetit këshillimor, gjatë të cilës do të zgjidhet kryetari i Komitetit në fjalë.

6. Komiteti Këshillimor përcakton organizimin e vet të brendshëm dhe harton rregulloren e tij të brendshme, duke ju referuar parimeve bazë të Bashkimit dhe subjekt i miratimit të Këshillit drejtues, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare.



7. Komiteti Këshillimor do të mbledhet dy herë në vit. Në parim, mbledhjet do të zhvillohen në selinë e Bashkimit në të njëjtën kohë me sesionet e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Data dhe vendi i çdo mbledhje do të vendosen nga Kryetari i Komitetit këshillimor, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

8. Komiteti Këshillimor harton programin e tij brenda kuadrit të kompetencave si më poshtë:

8.1 të shqyrtojë dokumente dhe raporte të Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Në rrethana të jashtëzakonshme, e drejta për të marrë disa dokumente mund të jetë e kufizuar nëse konfidencialiteti i çështjes së mbledhjes ose i dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga organi i interesuar ose kryetari i tij. Situatat rast pas rasti do të raportohen në Këshillim drejtues, dhe në Këshillin e Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për Këshillin e Operacioneve Postare. Nëse e gjykon të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishikojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare;

8.2 të drejtojë studimin dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme për anëtarët e Komitetit Këshillimor;

8.3 të shqyrtojë çështje që prekin sektorin e shërbimeve postare dhe të paraqesë raporte mbi këto çështje;

8.4 të sigurojë të dhëna për punët e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare, duke përfshirë paraqitjen e raporteve dhe rekomandimeve dhe të japë opinione me kërkesën e dy Këshillave;

8.5 të bëjë rekomandime për Kongresin, subjekt i miratimit të Këshillit drejtues dhe, kur janë të përfshira çështje që i interesojnë Këshillit të Operacioneve Postare, subjekt i shqyrtimit dhe komenteve të Këshillit të Operacioneve Postare.

9. Kryetari i Këshillit Drejtues dhe Kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojnë këto organe në mbledhjet e Komitetit Këshillimor kur rendi i ditës së këtyre mbledhjeve përmban çështje që i interesojnë këtyre organeve.

10. Me qëllim sigurimin një lidhje ndërmjet organeve të Bashkimit, Komiteti Këshillimor mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Kongresit, Këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komiteteve përkatëse të tyre, me cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.

11. Nëse kjo kërkohet, anëtarët e Komitetit Këshillimor mund të marrin pjesë në sesionet plenare dhe mbledhjet e Komitetit të Këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare në përputhje me nenet 102.16 dhe 104.12. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në punimet e grupeve të punës sipas kushteve të vendosura nga nenet 102.18 dhe 104.14. Anëtarët e Këshillit Këshillimor mund të marrin pjesë në Kongres si vëzhgues pa të drejtë vote.

12. Nëse kërkohet prej tyre, vëzhguesit e mëposhtëm mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e Komisionit Këshillimor:

12.1 anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare dhe Këshillit drejtues;

12.2 organizma ndërqeveritare të interesuara për punimet e Komitetit Këshillimor;

12.3 Sindikatat e Kufizuara;

12.4 shtete të tjera anëtare të Bashkimit;

13. Për arsye logjistike, Komiteti Këshillimor mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

14. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situata rast pas rasti duhet të raportohen tek Këshilli drejtues, dhe tek Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Kur e konsideron si të nevojshme, Këshilli drejtues mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

15. Byroja Ndërkombëtare, nën përgjegjësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, do të sigurojë sekretariatin e Komitetit Këshillimor.

Neni 107

Informacione mbi veprimtarinë e Komitetit Këshillimor

1. Pas çdo mbledhje, Komiteti këshillimor njofton Këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare për veprimtarinë e tij duke i dërguar Kryetarëve të këtyre organeve, *inter alia*, një përmbledhje analitike të mbledhjeve të tij si dhe rekomandime dhe mendime.

2. Komiteti këshillimor i bën Këshillit drejtues një raport për veprimtarinë vjetore dhe i dërgon një kopje Këshillit të Operacioneve Postare. Ky raport do të përfshihet në dokumentacionin e Këshillit drejtues që u shpërndahet shteteve anëtare të Bashkimit, operatorëve të tyre të caktuar dhe Sindikatave të kufizuara, në përputhje me nenin 103.

3. Komiteti këshillimor bën për Kongresin një raport mbi gjithë aktivitetin e tij dhe ia dërgon atë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni 108

Rregulla të procedurës së Kongreseve (Kushtetuta 14)

1. Për organizimin e punimeve të tij dhe mënyrën e diskutimeve, Kongresi do të zbatojë Rregullat e Procedurës së Kongreseve.

2. Çdo Kongres mund të modifikojë këtë rregullore sipas kushteve të caktuara në vetë Rregullat e Procedurës së Kongreseve.

Neni 109

Gjuhët e punës të Byrosë Ndërkombëtare

Gjuhët e punës të Byrosë Ndërkombëtare janë gjuha Frënge dhe gjuha angleze.

Neni 110

Gjuhët e përdorura për dokumentacionin, për debatet dhe korrespondencën zyrtare

1. Për dokumentacionin e Bashkimit do të përdoren gjuhët franceze, angleze, arabe dhe spanjolle. Përdoren gjithashtu gjuhët gjermane, kineze, portugeze dhe ruse, me kushtin që vetëm dokumentacioni më i rëndësishëm bazë të prodhohet në këto gjuhë. Mund të përdoren gjuhë të tjera, me kushtin që shtetet anëtare që kanë bërë kërkesën të mbulojnë të gjithë kostot e kësaj.

2. Shteti ose shtetet anëtare që kërkojnë një gjuhë të ndryshme nga ajo zyrtare formojnë një grup gjuhësor.

3. Dokumentacioni publikohet nga Byroja Ndërkombëtare në gjuhën zyrtare dhe në gjuhët e grupeve gjuhësore të formuara sipas rregullave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmjetësimit e zyrave rajonale të këtyre grupeve në përputhje me procedurat e rëna dakord me Byronë Ndërkombëtare. Publikimi në gjuhë të ndryshme bëhet sipas një standardi të përbashkët.

4. Dokumentacioni i publikuar drejtpërdrejt nga Byroja Ndërkombëtare, për sa është e mundur, do të shpërndahet në të njëjtën kohë në gjuhët e ndryshme të kërkuara.

5. Korrespondencat midis shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar dhe Byrosë Ndërkombëtare dhe midis kësaj të fundit dhe të tretëve mund të shkëmbehen në çdo gjuhë për të cilën Byroja Ndërkombëtare disponon një shërbim përkthimi.

6. Shpenzimet e përkthimit në çfarëdo gjuhë, duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga zbatimi i paragrafit 5, do të mbulohen nga grupi gjuhësor që ka kërkuar për atë gjuhë. Shtetet anëtare që përdorin gjuhën zyrtare do të paguajnë, për qëllimet e përkthimit të dokumenteve jo zyrtarë, një kontribut, shuma e të cilit për njësi kontribuimi të jetë e barabartë me atë shumë që mbulohet nga shtetet anëtare duke ju referuar gjuhës tjetër që përdoret nga Byroja Ndërkombëtare. Të gjitha shpenzimet e tjetra që kanë të bëjnë me dhënien e dokumenteve mbulohen nga Bashkimi. Tavani i shpenzimeve, që mbulohen nga Bashkimi për dokumentacionin në gjuhën kineze, gjermane, portugeze dhe ruse do të caktohet me një rezolutë të Kongresit.

7. Kostot që vijnë nga një grup gjuhësor do të ndahen midis anëtarëve të këtij grupi në proporcion me kontributin e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Këto kosto mund të ndahen midis anëtarëve të grupit gjuhësor sipas një baze tjetër ndarjeje, me kusht që shtetet anëtare të interesuara të bien dakord për këtë dhe të informojnë Byronë Ndërkombëtare për vendimin e tyre me anë të ndërmjetësimit të zëdhënësit të grupit.



8. Byroja Ndërkombëtare do të zbatojë çdo ndryshim në zgjedhjen e gjuhës së kërkuar nga një shtet anëtar pas një afati që nuk duhet të kalojë dy vjet.

9. Për diskutimet në mbledhjet e organeve të Bashkimit, do të jenë të pranueshme gjuhët franceze, angleze dhe ruse, me kushtin e pranisë së një sistemi interpretimi - me ose pa pajisje elektronike - zgjedhja e të cilës është lënë në vlerësimin e organizatorëve të mbledhjes pas këshillimit me Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe të shteteve anëtare të interesuara.

10. Për diskutimet dhe mbledhjet e përmendura në paragrafin 9 do të jenë të autorizuar edhe gjuhë të tjera.

11. Delegacionet që përdorin gjuhë të tjera sigurojnë përkthimin simultan në një nga gjuhët e përmendura në paragrafin 9, ose nëpërmjet sistemit të cituar në të njëjtin paragraf, kur mund të realizohen ndryshimet e nevojshme teknike, ose nga përkthyes të veçantë.

12. Kostot e shërbimeve të përkthimit do të ndahen midis shteteve anëtare që përdorin të njëjtën gjuhë në proporcion me kontributet e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Megjithatë, shpenzimet e instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve teknike do të mbulohen nga Bashkimi.

13. Shtetet anëtare dhe/ose operatorët e caktuar të tyre mund të bien dakord mbi çështjen e gjuhës që do të përdoret në korrespondencat zyrtare në marrëdhëniet e tyre reciproke. Kur kjo lloj marrëveshje nuk arrihet, gjuha që do të përdoret do të jetë gjuha frënge.

KAPITULLI II BYROJA NDËRKOMBËTARE

Neni 111

Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare

1. Drejtori i përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare zgjidhen nga Kongresi për periudhën që ndan dy kongrese të njëpasnjëshme, me kohëzgjatje minimale të mandatit të tyre prej katër vjetësh. Mandati i tyre është i përsëritshëm vetëm njëherë. Me përjashtim të vendimit të kundërt të Kongresit, data e fillimit të funksionit të tyre është caktuar 1 Janari i vitit që vjen pas Kongresit.

2. Të paktën shtatë muaj para hapjes së Kongresit, Drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare do ti dërgojë një shkresë Qeverive të shteteve anëtare duke i ftuar të paraqesin kandidaturat e mundshme për postin e Drejtorit të përgjithshëm dhe të zëvendësdrejtorit të përgjithshëm dhe duke treguar në të njëjtën kohë nëse Drejtori i përgjithshëm ose zëvendësdrejtori i përgjithshëm në funksion janë të interesuar për rinovimin e mundshëm të mandatit të tyre të parë. Kandidaturat, të shoqëruara me një *curriculum vitae*, duhet të mbërrijnë në zyrën e Byrosë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Kandidatët duhet të jenë shtetas të shteteve anëtare që i paraqesin. Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë dokumentacionin e zgjedhjeve për Kongresin. Zgjedhja e Drejtorit të përgjithshëm dhe e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm bëhet me votim të fshehtë, duke u zgjedhur në fillim Drejtori i përgjithshëm.

3. Nëse posti i Drejtorit të përgjithshëm është vakant, zëvendësdrejtori i përgjithshëm merr përsipër funksionet e Drejtorit të përgjithshëm deri në fund të mandatit të parashikuar për atë vetë; ai do të jetë i zgjedhshëm në këtë post dhe do të pranohet automatikisht si kandidat, me kusht që afati fillestar i detyrës si Zëvendës Drejtor i përgjithshëm nuk është i rinovuar një herë nga Kongresi i mëparshëm dhe ai të deklarojë interesin e tij për tu konsideruar si kandidat për postin e Drejtorit të përgjithshëm.

4. Në rastin posti i Drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorit të përgjithshëm janë njëkohësisht vakantë, Këshilli drejtues do të zgjedhë, mbi bazën e aplikimeve të marra pas njoftimit të posteve vakante, një zëvendës Drejtor të përgjithshëm për periudhën deri në Kongresin e ardhshëm. Për sa i përket paraqitjes së aplikimeve, do të zbatohet për analogji paragrafi 2.

5. Nëse postit i Zëvendës Drejtorit të përgjithshëm është vakant, Këshilli drejtues, me propozim të Drejtorit të përgjithshëm, ngarkon një nga Drejtorët e gradës D 2 të Byrosë Ndërkombëtare të marrë përsipër, deri në Kongresin e ardhshëm, funksionet e Zëvendës Drejtorit të përgjithshëm.

Neni 112
Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm organizon, administron dhe drejton Byronë Ndërkombëtare, pra ai është përfaqësuesi i saj ligjor. Ai ka kompetencën për të renditur postet e gradës G 1 deri në D 2 dhe për të emëruar dhe rritur në detyrë funksionarët e këtyre gradave. Për emërimet e gradave P 1 deri në D 2, ai duhen marrë në konsideratë kualifikimet profesionale të kandidatëve të rekomanduar nga shtetet anëtare shtetas të së cilëve ata janë ose në të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional, duke konsideruar një ndarje të barabartë gjeografike për kontinentet dhe gjuhët. Postet e gradës D 2 duhet, për sa është e mundur, të plotësohen nga kandidatë me prejardhje nga rajone të ndryshme nga ai i origjinës së Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, duke pasur parasysh konsiderimin suprem të efikasitetit të Byrosë Ndërkombëtare. Në rastin e posteve që kërkojnë kualifikime speciale, Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë aplikime në shtete të tjera. Në emërimin e një funksionari të ri, ai do të konsiderojë gjithashtu që, në parim, personat që zënë postet e gradave D 2, D 1 dhe P 5 të jenë shtetas nga shtete të ndryshme të Bashkimit. Në rritjen në detyrë të një funksionari në gradat D 2, D 1 dhe P 5, nuk do të jetë i detyruar të zbatohet të njëjtin parim. Për më tepër, kërkesat e një shpërndarje të barabartë gjeografike dhe të gjuhëve do të renditen pas meritës në procesin e rekrutimit. Drejtori i përgjithshëm njofton Këshillin drejtues një herë në vit për emërimet dhe rritjet në detyrë në gradat P 4 deri në D 2.

2. Drejtori i përgjithshëm ka kompetencat e mëposhtme:

2.1 të veprojë si depozitues i Akteve të Bashkimit dhe si ndërmjetës në procedurën e miratimit dhe të pranimit dhe të tërheqjes nga Bashkimi;

2.2 të njoftojë vendimet e marra nga Kongresi për gjithë qeveritë e shteteve anëtare;

2.3 të njoftojë të gjithë shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar mbi Rregulloret e shfuqizuara ose të rishikuara nga Këshilli i Operacioneve Postare;

2.4 të përgatisë projektin e buxhetit vjetor të Bashkimit në nivelin më të ulët të mundshëm në pajtim me nevojat e Bashkimit dhe ta paraqesë në kohën e duhur për shqyrtim në Këshillin drejtues; ti paraqesë buxhetin shteteve anëtare të Bashkimit pas miratimit nga Këshilli drejtues dhe ta realizojë atë;

2.5 të kryejë veprimtari të veçanta të kërkuara prej organeve të Bashkimit dhe ato që i janë caktuar me anë të Akteve;

2.6 të marrë iniciativat për realizimin e objektivave të caktuara nga organet e Bashkimit, brenda kuadrit të politikës së vendosur dhe të fondeve të disponueshme;

2.7 të japë sugjerime dhe propozime Këshillit drejtues ose Këshillit të Operacioneve Postare;

2.8 të paraqesë, në Këshillin e Operacioneve Postare, pas mbylljes së Kongresit, propozimet që kanë të bëjnë me ndryshimet e Rregulloreve sipas vendimeve të Kongresit, në përputhje me Rregullat e Procedurës së Këshillit të Operacioneve Postare;

2.9 të përgatisë, për Këshillin e Operacioneve Postare dhe mbi bazën e direktivave të dhëna nga Këshillat, projekt Strategjinë që do të paraqitet në Kongres;

2.10 të përgatisë, për miratim nga Këshilli Drejtues, një raport katër vjeçar mbi performancën e shteteve anëtare mbi Strategjinë e Bashkimit të miratuar nga Kongresi paraardhës, i cili do të paraqitet në Kongresin e radhës;

2.11 të sigurojë përfaqësimin e BASHKIMIT;

2.12 të veprojë si ndërmjetës në marrëdhëniet midis;

- UPU dhe Sindikatave të kufizuara;

- UPU dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

- UPU dhe organizatave ndërkombëtare, veprimtaritë e të cilave paraqesin interes për Bashkimin;

- UPU dhe organizmave ndërkombëtare, shoqatave ose sipërmarrjeve që organet e Bashkimit dëshirojnë ti konsultojnë ose të bashkëpunojnë;

2.13 të marrë përsipër funksionin e Sekretarit të përgjithshëm të organeve të Bashkimit, sipas dispozitave të posaçme të Rregullores së Përgjithshme, veçanërisht:

- në përgatitjen dhe organizimin e punës së organeve të Bashkimit;

- në shqyrtimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, raporteve dhe proces-verbaleve;

- në funksionimin e sekretariatit gjatë mbledhjeve të organeve të Bashkimit;

2.14 të ndihmojë në mbledhjet e organeve të Bashkimit dhe të marrë pjesë në diskutimet pa të drejtë vote, duke pasur mundësinë e përfaqësimit.



Neni 113

Funksionet e zëvendës drejtorit të përgjithshëm

1. Zëvendës drejtori i përgjithshëm do të asistojë Drejtorin e përgjithshëm dhe është nën varësinë e tij.
2. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm mungon ose nuk mund të ushtrojë detyrat e tij, funksionet e tij do të ushtrohen nga zëvendës drejtori i përgjithshëm. E njëjta gjë do të zbatohet në rastin kur posti i Drejtorit të përgjithshëm është vakant sipas nenit 111.3.

Neni 114

Sekretariati i organeve të Bashkimit (Kushtetuta 14, 15, 17, 18)

Sekretariati i organeve të Bashkimit do të realizohet nga Byroja Ndërkombëtare nën përgjegjësinë e Drejtorit të Përgjithshëm. Ai do të dërgojë të gjitha dokumentet e publikuar pas çdo sesiioni tek shtetet anëtare të organit dhe operatorët e tyre të caktuar, tek shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar të cilët, edhe pa qenë anëtarë të këtij organi, bashkëpunojnë në studimet e ndërmarra, tek sindikatat e Kufizuara si dhe tek shtetet e tjera anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar që bëjnë kërkesë për to.

Neni 115

Lista e shteteve anëtare (Kushtetuta 2)

Byroja ndërkombëtare përpilon dhe përditëson listën e shteteve anëtare të Bashkimit duke përcaktuar aty klasën e kontributit, grupin e tyre gjeografik dhe pozicionin e tyre në raport ndaj Akteve të Bashkimit.

Neni 116

Informacioni. Opinionet. Kërkesat për interpretimin dhe amendim të Akteve. Reklamimet. Roli në likuidimin e llogarive (Kushtetuta 20, Rregullore e përgjithshme 124, 125, 126)

1. Byroja Ndërkombëtare do të jetë në çdo kohë në dispozicion të Këshillit drejtues, të Këshillit të Operacioneve Postare dhe të shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar për qëllimet e dhënies së gjithë informacionit të nevojshëm rreth çështjeve që kanë të bëjnë me shërbimin.

2. Në veçanti ai do të mbledhë, koordinojë, publikojë dhe shpërndajë informacionet e çdo natyre në interes të shërbimit ndërkombëtar postar, të japë, me kërkesën e palëve të përfshira, një mendim mbi çështje në konflikt, të veprojë për kërkesat për interpretimin dhe amendimin e Akteve të Bashkimit dhe, në përgjithësi, të realizojë ato studime dhe punë dokumentare ose editoriale që i caktohen nga aktet në fuqi ose siç mund ti referohet në interes të Bashkimit.

3. Ai vepron gjithashtu mbi anketimet që kërkohen nga shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për përfitimin e pikëpamjeve të shteteve të tjera anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar mbi një çështje të caktuar. Rezultati i një ankete nuk merr karakterin e një vote dhe nuk do të jetë formalisht detyruese.

4. Ai mund të veprojë si zyrë qendrore për likuidimin e llogarive të çdo lloji në lidhje me shërbimin postar.

Neni 117

Bashkëpunimi teknik (Kushtetuta 1)

Byroja ndërkombëtare do të zhvillojë asistencën e teknikave postare në të gjitha format e saj brenda kuadrit për bashkëpunim teknik ndërkombëtar.

Neni 118

Formularë të dhënë nga Byroja Ndërkombëtare

Byroja Ndërkombëtare do të jetë përgjegjëse për prodhimin e kuponave të përgjigjeve ndërkombëtare dhe të furnizimit, me çmim shitje, të shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar që i kanë porositur ato.

Neni 119

Aktet e Sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshje të Posaçme (Kushtetuta 8)

1. Dy kopje të Akteve të sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshjeve të posaçme të realizuara sipas nenit 8 të Kushtetutës duhet që t'i transmetohen Byrosë Ndërkombëtare nëpërmjet zyrave të këtyre Sindikatave ose, kur kjo nuk arrihet, nëpërmjet një pale kontraktuese.

2. Byroja Ndërkombëtare kujdesen që Aktet e sindikatave të kufizuara dhe Marrëveshjet e posaçme të mos parashikojnë kushte më pak të favorshme për publikun se ato që janë parashikuar në Aktet e Bashkimit dhe informon shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për ekzistencën e Unioneve dhe Marrëveshjeve të mësipërme. Ai sinjalizon në Këshillin drejtues për çdo parregullsi të konstatuar gjatë zbatimit të kësaj dispozite.

Neni 120

Botimet periodike të Bashkimit

Byroja ndërkombëtare, me ndihmën e dokumenteve që i janë vënë në dispozicion, do të botojë një revistë në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, gjermane, ruse dhe spanjolle.

Neni 121

Raporti dyvjeçar mbi punën e Bashkimit (Kushtetuta 20, Rreg. e përgjithshme 102.6.17)

Byroja Ndërkombëtare do të realizojë një raport dyvjeçar mbi veprimtarinë e Bashkimit i cili do të dërgohet, pas miratimit nga Këshilli drejtues, shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, Sindikatave të kufizuara dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

KAPITULLI III

PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT TË PROPOZIMEVE

Neni 122

Procedura e paraqitjes së propozimeve në Kongres (Kushtetuta 29)

1. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara sipas paragrafëve 2 dhe 5, procedura e mëposhtme rregullon paraqitjen e propozimeve të çdo natyre në Kongres nga shtetet anëtare:

a) do të pranohen propozimet që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para datës së caktuar për Kongresin;

b) nuk do të pranohet asnjë propozim gjatë periudhës prej gjashtë muajsh para datës së caktuar për Kongresin;

c) nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet gjashtë dhe katër muajve para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur mbështeten nga të paktën dy shtete anëtare;

d) nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet katër dhe dy muaj para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur ato mbështeten nga të paktën nga tetë shtete anëtare; propozimet që mbërrijnë pas kësaj periudhe nuk do të pranohen;

e) deklaratat mbështetëse duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare brenda të njëjtën periudhë me propozimet të cilave i referohen.

2. Propozimet që kanë të bëjnë me Kushtetutën ose Rregulloren e Përgjithshme duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para hapjes së Kongresit; propozimet që mbërrijnë pas kësaj date por para hapjes së Kongresit mund të merren në konsideratë vetëm nëse Kongresi vendos me shumicë prej dy të tretash të shteteve të përfaqësuara në Kongres dhe me përjashtim të rastit kur janë përmbushur kushtet e parashikuara sipas paragrafit 1.

3. Si rregull, çdo propozim duhet të ketë vetëm një qëllim dhe të përmbajë vetëm ndryshimet e justifikuara nga ky qëllim. Në të njëjtën mënyrë, çdo propozim që mund të sjellë kosto të mëdha për Bashkimin do të shoqërohet nga indikacione të ndikimit të tij financiar, të përgatitur nga shteti anëtar që paraqet propozimin në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare, në mënyrë që të përcaktohen burimet financiare të nevojshme.



4. Hartimet e propozimeve do të titullohen «Draft Propozime» nga shtetet anëtare që i paraqesin dhe do të publikohen nga Byroja Ndërkombëtare me një numër të ndjekur nga shkronja R. Propozimet që nuk do të kenë këtë lloj shënimi por që, sipas mendimit të Byrosë Ndërkombëtare, prekin vetëm me hartimin e pikave do të publikohen me një shënim të posaçëm; Byroja Ndërkombëtare do të përpilojë një listë të këtyre propozimeve për Kongresin.

5. Procedura e përshkruar në paragrafët 1 dhe 4 nuk do të zbatohet për propozimet që kanë të bëjnë me Rregullat e Procedurës së Kongreseve ose për amendamentet e propozimeve të bëra.

Neni 123

Procedura e paraqitjes të propozimeve që kanë të bëjnë me përgatitjen e Rregulloreve të reja nën dritën e vendimeve të marra nga Kongresi në Këshillin e Operacioneve Postare

1. Rregullorja e Konventës Postare Universale dhe Marrëveshja e shërbimeve të pagesës postare do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi.

2. Propozimet që rrjedhin nga amendamentet e propozuara në Konventës ose të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesës Postare duhet ti kalohen Byrosë Ndërkombëtare në të njëjtën kohë me propozimet e Kongresit me të cilat ato kanë lidhje. Ato mund të paraqiten nga një shtet anëtar pa mbështetjen e shteteve të tjera anëtare. Këto propozime duhet të shpërndahen në të gjithë vendet anëtare, jo më vonë se një muaj para Kongresit.

3. Propozimet e tjera që prekin Rregulloret, për tu shqyrtuar nga Këshilli i Operacioneve Postare për përpilimin e rregulloreve të reja brenda gjashtë muajve pas Kongresit duhet ti paraqiten në Byrosë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para Kongresit.

4. Propozimet për ndryshime në Rregullore të kërkuara si rezultat i vendimeve të Kongresit, që janë paraqitur nga shtetet anëtare, duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare jo më vonë se dy muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare. Këto propozime duhet t'i shpërndahen të gjithë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, jo më vonë se një muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare.

Neni 124

Procedura e paraqitjes së propozimeve ndërmjet Kongreseve (Kushtetuta 29, Rreg. e Përgj. 116)

1. Çdo propozim në lidhje me Konventën ose Marrëveshjet i propozuar nga një shtet anëtar ndërmjet Kongreseve, që të merret në konsideratë duhet të mbështetet nga të paktën dy shtete të tjera anëtare. Këto propozime do të lihen mënjandëse Byroja Ndërkombëtare nuk merr, në të njëjtën kohë, numrin e duhur të deklaratave të mbështetjes.

2. Këto propozime i dërgohen shteteve të tjera anëtare nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare.

3. Propozimet që prekin Rregulloret nuk do të kenë nevojë për mbështetje, por nuk do të merren në konsideratë nga Këshilli i Operacioneve Postar, me përjashtim të rastit kur ky i fundit është dakord me nevojën urgjente.

Neni 125

Shqyrtimi i propozimeve ndërmjet Kongreseve (Kushtetuta 29, Rreg. e përgj. 116, 124)

treta të besuara në botën e komunikimeve elektronike, ashtu siç janë në atë të komunikimit fizike,

i gjithashtu kërkon

Qeverive të shteteve anëtare të inkurajojnë operatorët e caktuar për të ndërmarrë veprimtari që
synojnë:

- zhvillimin e shërbimeve elektronike postare si në shkallë kombëtare ashtu edhe në atë
ndërkombëtare, si një mjetet që sjell përfitime ekonomike dhe zgjerimin e tregut, dhe përmirësimin e fluksit të
artikujve postarë dhe financiarë përtej kufijve;

- Rritjen e përdorimit të ICT-ve për modernizimin e proceseve postare, për shembull, sisteme të
automatizimit të numërimit, makineri të ndarjes dhe të dërgimit, sistemet kompjuterike për planifikimin e
burimeve të sipërmarrjeve, sistemet e menaxhimit të informacionit dhe administrimit të përgjithshëm;

- eksplorimin përdorimin e ICT-ve për të përmbushur detyrimet e shërbimit universal;

- punën së bashku me Byronë Ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin e mundësive të postës në
shtetin e tyre, të cilat mund të lidhin të gjitha zyrat postare në një rrjet global, për përmirësimin e sigurisë dhe
shërbimin ndaj klientit;

- përmirësimin e njohurive të ndikimit të ICT-së dhe shërbimeve elektronike në tregun lokal dhe
mjeteve për të monitoruar zhvillimin dhe rritjen e vëllimit dhe të cilësisë;

- përdorimin e zyrave postare si qendra të komunikimit,

Udhëzon

organet e Bashkimit:

- Të krijojnë, me përkrahjen e duhur nga Byroja Ndërkombëtare, një grup të shërbimeve elektronike
për të mundësuar zbatimin e planit të veprimit të përcaktuar në KONGRES-Dok 27b;

- Të sigurojnë një kuadër të përshtatshëm për të mbështetur mobilizimin e burimeve të jashtme, të
llojit fizik, financiar dhe teknik, për të ndihmuar në zhvillimin e shërbimeve elektronike në kuadër të
Bashkimit dhe industrisë ICT;

- Të zhvillojnë faktorët kritik të suksesit dhe të krijojnë një aftësi përkatëse kërkimore për të monitoruar progresin me vendosjen e shërbimeve elektronike dhe ICT dhe të sigurojnë krahasimin dhe praktikatat më të mira të informacionit;
- Të zhvillojnë një program komunikimi për të informuar sektorin e shërbimeve elektronike, përfitimet e tyre dhe praktikatat më të mira të industrisë;
- Të punojnë me qeveritë dhe palët e interesuara kyçe për ti ndihmuar të zhvillojnë një strategji të shërbimeve elektronike dhe planin e veprimit për shtetin e tyre;
- Të studiojnë implikimet dhe potencialin e përdorimit të shërbimeve elektronike postare për të përmbushur detyrimet e shërbimit universal;
- Të zhvillojnë politikën dhe rregulloret e nevojshme në lidhje me produktet dhe shërbimet elektronike në Aktet e Bashkimit;
- Të vazhdojnë të përcaktojnë standardet e Bashkimit dhe / ose të vazhdojnë bashkëpunimin me standardet e tjera të organeve në fushat që ndikojnë në ICT dhe shërbimet elektronike, të tilla si postat hibride, elektronike, postat rekomande, shërbimet e sigurta elektronike postare, posta, tregtinë elektronike, dhe shërbime të tjera elektronike postare;
- Të realizojnë një raport i cili shqyrton nevojat përkatëse të shërbimeve elektronike standarde, dhe të propozojnë standardet që do të zhvillohen dhe prioritetin e tyre përkatës;
- të promovojnë cilësinë e shërbimit dhe ndërveprueshmërinë globale të shërbimeve postare që lidhen me rritjen e tregtisë elektronike, të tilla si koltë ndërkombëtare dhe me postë ekspres, pagesat dhe tregjet elektronike, dhe nevoja e adresave të tregtisë elektronike si nga pikëpamja e blerësit ashtu dhe nga ajo e shitësit;
- Të zbatojnë fleksibilitet më të madh në modelet e financimit jashtëbuxhetore për zhvillimet e postës ICT dhe shërbimeve elektronike;
- Të lehtësojnë dhe të përmirësojnë fluksin ndërkombëtar dhe ndërkufitar të artikujve postarë nëpërmjet rritjes së theksit mbi aktivitetet elektronike të caktuara për këtë qëllim;
- Të nxisin krijimin e fondeve vullnetare për të financuar regjistrimin, qeverisjen dhe mirëmbajtjen e markave të besuara globale për shërbimet postare elektronike;
- Të krijojnë një grup për të përmirësuar lidhjen e rrjetit të zyrave postare, që lidhin rrjete të sektorëve të tjerë si Dogana dhe linjat ajrore, dhe gjithashtu për të qeverisur postën dhe të jetë përgjegjës për financimin dhe implementimin e saj.

(Propozimi 16, Komiteti 7, mbledhja e 2-të)

REZOLUTA C 34/2008 PUNIME PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Kongresi,
në kuadrin e
rezultateve pozitive të punës së Grupit të Projektit për Zhvillim të Qëndrueshëm,
Duke pasur parasysh
se zhvillimi i qëndrueshëm është bërë një element i domosdoshëm i zhvillimit postar,
Duke pasur parasysh
se ka nevojë për përpjekje të vazhdueshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale në sektorin postar, duke kryer fushata për ndërgjegjësimin për çështjet e mjedisit, zhvillimin e veprimeve për të inkurajuar dialogun social dhe për të mbrojtur shëndetin e personelit postar, dhe mbrojtur miratimin e praktikave vepruese në përputhje me etikën dhe se aktivitetet e rrjetit të korrespondentëve kombëtare duhet të ruhen,
i ndërgjegjshëm
se bashkëpunimi me agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, të tilla si Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV / AIDS është i rëndësishëm së dorës së parë për arritjen e objektivave të vendosura në fushën në fjalë,



I bindur

për nevojën për të forcuar marrëdhëniet me Sindikatat e kufizuara, dhe në veçanti me *PostEurop*, në mënyrë që të promovojnë përgjegjësinë sociale të sektorit postar,

Duke pranuar

rëndësinë e miratimit të një programi për sektorin postar për të ulur emetimet e gazit, në përputhje me frymën dhe parimet e Kuadrit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike (UNFCCC) dhe Protokollin e Kiotos, me qëllim fillestar të shënimit në hartë të emetimeve të CO₂, sipas të cilit do të maten rezultatet e veprimeve të vendosura për të ulur këto emetime,

duke pranuar gjithashtu

nevojën për t'u kujdesur për shëndetin e punonjësve postare, në veçanti duke zbatuar një fushatë për të rritur ndërgjegjësimin e mënyrave të transmetimit të AIDS,

duke pasur në konsideratë

nevojën urgjente për të përmirësuar ndjeshëm menaxhimin e shërbimeve postare dhe për të forcuar punën dhe funksionimin e rrjetit postar në shtetet më pak të zhvilluara,

Udhëzon

Këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare të marrin masat e nevojshme për të arritur objektivat e sipërpërmendura.

(Propozimi 30. Rishikimi 1, Komiteti 7, mbledhja e 3-të)

REZOLUTA C 35/2008 MARRËDHËNIET ME SEKTORIN E BOTIMIT

Kongresi,

Duke vënë në dukje

aktivitetet e ndërmarra gjatë periudhës 2005-2008 me synim përmirësimin e marrëdhënieve midis Bashkimit dhe sektorit të botimit,

Duke pasur parasysh

ndryshimet në tregjet e botimeve elektronike në vitet e fundit dhe rëndësinë e marrëdhënieve të mira mes Postës dhe klientëve të tyre në sektorin e botimit,

duke pasur gjithashtu parasysh

- se botimet elektronike paraqesin një mundësi për arritjen e vëllime postare të rregullta dhe periodike;
- se Bashkimi përbën një forum të përshtatshëm për mbledhjen dhe ofrimin e njohurive mbi tregun e botimeve elektronike,

Duke pranuar

përfitimet ekonomike të shteteve anëtare, operatorëve të tyre të caktuar dhe aktorëve të tjerë të industrisë në nxitjen e rritjes së botimeve elektronike për përhapjen e lajmeve, informacioneve dhe literaturës,

I bindur

për vlerën e forcimit të marrëdhënieve me këto grupe të interesit për përfitim reciprok,

Ngarkon

Këshillin e Operacioneve Postare, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare:

- Të sigurojë një kuadër të përshtatshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve ndërmjet Postës dhe klientëve të tyre në sektorin e botimit;

- Të vazhdojë të garantojë ndërveprimin dhe bashkërendimin me partnerët në industrinë botuese nëpërmjet përhapjen së praktikave më të mira;

- Të inkurajojë zhvillimin e tregjeve të botimeve elektronike si një burim të ardhurash për operatorët e caktuar;

- Të zhvillojë aktivitete të lidhura në bazë të fondeve jashtëbuxhetore,

ngarkon gjithashtu

Byronë Ndërkombëtare të asistojë në menaxhimin dhe zbatimin e aktiviteteve të mbuluara nga kjo rezolutë.

(Propozimi 34, Komiteti 7, mbledhja e 2-të)

REZOLUTA C 36/2008
ZHVILLIMI I FILATELISË

Kongresi,
Duke vënë në dukje
se shitja e pullave postare dhe produkteve filatelike gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme për shumë autoritete postare, veçanërisht ato në shtetet në zhvillim,
Duke vënë gjithashtu në dukje
se mbështetja dhe përfshirja e partnerëve të sektorit filatelik dhe bashkëpunimi i ngushtë mes tyre janë pjesë përbërëse të suksesit të filatelisë,
Duke kujtuar
se Kongresi e Bukureshtit, në rezolutën C 50/2004, ka krijuar një plan veprimi për zhvillimin e filatelisë sepse:
- Filatelia përbën një pjesë të rëndësishme të biznesit të Postës dhe ofron mbështetje të madhe për Postën dhe për zhvillimin postar në përgjithësi;
- Pulla postare dhe produktet filatelike të vazhdojnë të përfaqësojnë një burim të konsiderueshëm të të ardhurave të Postës, si kur përdoren për qëllime normale postare, dhe nga pikëpamja tregtare dhe filatelike;
- Pullat postare paraqesin një markë të veçantë imazhi që dallon shërbimin postar nga shërbimet e dërgimit të sektorit privat;
- Pulla postare vazhdon të shërbejë si ambasadore e shteteve dhe shërbimeve të tyre postare, si kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Rritja në përdorimin e pullave postare nga sektori privat, veçanërisht nga sektori i marketingut të drejtpërdrejtë, si dhe përdorimi i pullave të personalizuar përfaqësojnë përparësi shtesë për promovimin e shërbimit postar,
i ndërgjegjshëm
se shumë qeveri po transformojnë operatorët e tyre të caktuar në subjekte tregtare, dhe po fusin konkurrencën në tregun e postës së letrave, por pak prej tyre kanë konsideruar çështjen e filatelisë gjatë këtij procesi,
Duke pasur parasysh
se përvojat e ndërmarrjeve postare qeveritë e të cilave kanë lëvizur tashmë në këtë drejtim mund të japin mësim të vlefshme për të tjerët,
Duke pranuar
se emetimi i pullave postare, si simbolet dhe imazhe të markës së shtetit dhe autoriteti postar emetues bën thirrje për vëmendje të veçantë dhe caktimin e një autoriteti të vetëm zyrtar për këtë qëllim,
Duke vënë në dukje me kënaqësi
futjen dhe zhvillimin e sistemit botëror të numërtimit të pullave (WNS) si një mjet për regjistrimin dhe verifikimin e emetimit ligjor të pullave,
i kërkon
- Qeverive të shteteve anëtare:
• tu kërkojnë autoriteteve postare emetuese, që gjatë emetimit të pullave të konsiderojnë nevojat e konsumatorëve të shërbimeve postare bazë dhe koleksionistëve, si dhe vlerën sociale dhe kulturore të pullave;
• ti kushtojnë vëmendjen e duhur çështjeve rregullatore që lidhen me emetimin e pullave dhe filatelisë, duke përfshirë të drejtën e autorit dhe ligjet e pronësisë intelektuale;
• të vënë në funksion mekanizmat ligjore për të garantuar të drejtën e operatorëve të caktuar për të emetuar pulla postare në përputhje me Konventën e UPU;
• të kontribuojnë në ruajtjen e kontributeve të lidhura për zhvillimin e filatelisë me qëllim për të përmbushur nevojat urgjente, kryesisht në fushën e trajnimit,
- autoriteteve postare emetuese:
• të marrin pjesë plotësisht në sistemin botëror të numërtimit të pullave postare (WNS);
• të monitorojnë tregun filatelik për të siguruar përputhjen me ligjet kombëtare për emetimin e pullave dhe të bëjnë të pamundurën për të eliminuar ose parandaluar abuzimet;
• ti japin UPU-t informacion në diskrecionin e tyre mbi zhvillimin e tregut;
• të miratojnë dhe të zbatojnë praktikën më të mirë për të siguruar pjesëmarrjen e industrisë në nivel kombëtar dhe të bashkëpunimit dhe mbështetjes së tyre në nivel ndërkombëtar;



- të marrin pjesë më shumë në aktivitete rinore filatelike,

Udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare:

- të ndjekë e dialogun me partnerët në sektorin filatelik dhe të koordinojë zhvillimin e aktiviteteve filatelike;
- të vazhdojë punën e tij në përcaktimin e mjeteve më efektive dhe efikase të informimit të anëtarëve dhe industrisë filatelike rreth pullave postare të emetuara zyrtarisht nga autoritetet postare emetuese;
- të vazhdojë të promovojë zbatimin e praktikave më të mira dhe parimeve të shëndosha të biznesit në sektorin filatelik përmes aktiviteteve të synuara dhe trajnimeve;
- të ndjekë zbatimin e programeve të trajnimit për autoritetet postare emetuese, duke përfshirë risitë, teknikat për zhvillimin e tregut filatelik, përdorimin e teknologjive të reja dhe përmirësimin e teknikave të sigurisë për çështjen e pullave postare;
- të reflektojë mbi krijimin e një baze të dhënash model për shitjen në internet të pullave postare për shtetet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara;
- të përcaktojë një strategji të përbashkët me Federatën Ndërkombëtare Filatelike (FIP) për të ndihmuar autoritetet postare emetuese për të zbatuar programe që synojnë veçanërisht të afrojnë të rinjtë;
- të zbatojë një strategji për të nxitur shtetet anëtare të UPU për të përfshirë në programet e tyre filatelike vjetore tema globale të kërkuara nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara;
- të përcaktojë një politikë fleksibël dhe të qëndrueshme në kuadër të zhvillimit të planit filatelik, në mënyrë që të ruajë karakteristikat unike të pullës postare, mbrojtjen vlerave që ato përfshijnë si pjesë koleksioni dhe atributet që e dallojnë atë nga format e tjera të parapagimit postar;
- të miraton përjasje fleksibël dhe inovative për pozicionimin e marketingut të produkteve filatelike, në përputhje me profilin unik të pullës postare si produkt kryesor filatelik.

(Propozimi 35, Komiteti 7, mbledhja e 2-të)

REZOLUTA C 37/2008

ARTIKUJ TË FALSIFIKUAR DHE TË PIRATERISË DËRGUAR ME ANË TË POSTËS

Kongresi,

Duke vënë në dukje

se kanali postar është përdorur, së bashku me kanale e tjera të shpërndarjes, për dërgimin e artikujve të falsifikuar dhe piratë,

pavarësisht

nga puna mbi pronësinë intelektuale në proces në organizata të tjera ndërkombëtare kompetente,

Duke vënë gjithashtu në dukje

se komiteti 3 i POC Grupi i Projektit të mbështetjes Doganore ka kryer një studim mbi doganat dhe çështjet që lidhen me sigurinë në lidhje me çështjet e pronësisë intelektuale të Bashkimit,

duke pranuar

se rezultatet e studimit zbuluan se operatorët e caktuar nuk kanë kompetencë ligjore për të përcaktuar nëse një artikull është i falsifikuar apo nëse një deklaratë doganore ka përfunduar në mënyrë të pavërtetë,

Duke pasur parasysh

se është përgjegjësi e autoriteteve kompetente kombëtare për të përcaktuar sende të falsifikuara, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar,

duke pranuar gjithashtu

se legjislacioni i shteteve anëtare për trajtimin e artikujve të falsifikuar dhe piratë ndryshon nga shteti në shtet,

i ndërgjegjshëm

se problemet e mësipërme shkaktojnë vështirësi operative dhe probleme ligjore për shtetet në fjalë,

I kërkon

Shteteve anëtare të UPU, në kontekstin e legjislacionit të tyre kombëtar, të inkurajojnë operatorët e tyre të caktuar:

- Të marrin të gjitha masat e arsyeshme dhe praktike për të mbështetur doganat në rolin e tyre në identifikimin e artikujve të falsifikuar dhe piratë në rrjetin postar;
- Të bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare në maksimumin e masës së mundur në ngritjen e nismave të vetëdijes që synojnë parandalimin e qarkullimit të paligjshëm të mallrave të falsifikuara, veçanërisht përmes shërbimeve postare.

(Propozimi 40, Komiteti 4, mbledhja e 3-të)

REZOLUTA C 38/2008 ROLI I SEKTORIT POSTAR NË SHOQËRINË E INFORMACIONIT

Kongresi,

Duke vënë në dukje

angazhimin e qeverive në Samitin Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit (WSIS) në përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) për të arritur qëllimet e zhvillimit të miratuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë ato të Deklaratës së Mijëvjeçarit,

duke vënë gjithashtu në dukje

angazhimet brenda dokumenteve që rezultojnë nga WSIS në lidhje me rrjetin postar botëror:

- angazhimin e aktorëve të WSIS për të "ndërtuar kapacitete të ICT për të përmirësuar të drejtën e hyrjes dhe përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve postare" (paragrafi 90h i dokumentit përfundimtar të WSIS);

- nevojën për të "krijuar pika aksesit të qëndrueshme të komunitetit publik, duke siguruar akses të përbalueshëm apo pa- pagesë në burimet e ndryshme të komunikimit, sidomos të Internetit, të cilat duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të siguruar ndihmë për përdoruesit në zyrat postare, duke theksuar veçanërisht zonat rurale dhe me pak shërbime" (paragrafi 10d i dokumentit përfundimtar të WSIS);

- nevojën për "hartimin e programeve specifike për trajnim në përdorimin e ICT në mënyrë që të përmbushen nevojat arsimore të profesionistëve të informacionit të tillë si punëtorë postare" (paragrafi 11k i dokumentit përfundimtar të WSIS)

- se "në zonat e pafavorizuara, vendosja e pikave të aksesit publik të ICT në vende të tilla si zyrat postare mund të sigurojë mjete efektive për sigurimin e aksesit universal në infrastrukturën dhe shërbimet e Shoqërisë së Informacionit" (paragrafi 23 i dokumentit përfundimtar të WSIS);

- se "në kuadrin e strategjive elektronike kombëtare, lidhjet ICT duhet të sigurohen dhe përmirësohen për të gjitha zyrat postare deri në vitin 2015" (paragrafët 6d dhe 9c të dokumentit përfundimtar të WSIS),

i ndërgjegjshëm

për rolin e sektorit postar dhe Bashkimit si lehtësues të biznesit elektronik siç është përcaktuar në dokumentin përfundimtar të WSIS (Linja e veprimit C7),

Duke pasur parasysh

se Objektivi 2 i draftit të Strategjisë Postare të Nairobit përfshin një program që synon rritjen e ndërgjegjësimin për rolin e sektorit postar në Shoqërinë e Informacionit,

Duke pranuar

aktivitetet rritjen e bashkëpunimit të Bashkimit me organizata të tilla si Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Organizata Ndërkombëtare të Punës (ILO), Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) dhe Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) që kanë rezultuar nga pjesëmarrja e Bashkimit në WSIS

duke vënë gjithashtu në dukje

pjesëmarrjen e Bashkimit në iniciativën e ITU "Lidh Botën", Samitin e Lidhjes së Afrikës dhe takime të tjera përkatëse të OKB-së,

Duke pasur në konsideratë

Rolin e luajtur nga ana e sektorit postar në lehtësimin e qeverisë elektronike në shumë shtete dhe rolin e saj potencial në projekte dhe politika të shëndetit elektronik dhe mësimin elektronik,

Duke vënë në dukje

rëndësinë e modernizimit të rrjeteve postare - me më pak se gjysmën e zyrave postare në të gjithë botën ende të pa lidhura me internetin,

duke respektuar

ndikimin transformues të ICT për sektorin postar,



fton

të gjitha shtetet anëtare të Bashkimi:

- të përfshijnë përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve postare kur formulojnë politikat kombëtare ICT;
- Të marrin në konsideratë kontributin e rrjetit postar në zhvillimin e politikave dhe strategjive në zonat e bizneseve elektronike dhe qeverisjes elektronike;
- të kenë parasysh dimensionin elektronik të shërbimeve postare, kur krijojnë legjislacionin e sektorit postar;
- të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet operatorëve postarë dhe partnerëve të jashtëm për ti mundësuar shteteve në zhvillim të pajisen me anë infrastrukturën e nevojshme, teknologjinë e know - how dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në uljen e ndarjes digjitale,

Udhëzon

Organet e Bashkimit:

- të mbështesin pjesëmarrjen e Bashkimit në ngjarjet përkatëse të Shoqërisë së Informacionit;
- të inkurajojnë krijimin e një fondi të modernizimit postar që synon të ndihmojë Bashkimin dhe sektorin postar për të përmbushur mandatin e dhënë nga WSIS;
- të zhvillojë politika për pjesëmarrjen e Bashkimit në Shoqërinë e Informacionit

Ngarkon

Byronë Ndërkombëtare:

- të monitorojë zhvillimin e ICT të lidhur me produktet dhe shërbimet nga operatorët postar dhe të krijojnë një bazë të plotë të dhënash në lidhje me këtë;
- të zhvillojë programe trajnimi për të edukuar punonjësit e sektorit postar në përdorimin e ICT;
- të përgatisë pikat e referimit dhe të ndajë praktikat më të mira në fushën e teknologjive të reja;
- të zhvillojë lidhje më të ngushta me Aleancën Globale për ICT dhe bashkime të tjera dhe organizata të zhvillimit, si dhe me donatorët për të mobilizuar burimet në zbatimin e projekteve të ndërtimit të kapaciteteve të Shoqërisë së Informacionit në rrjetet postare;
- të mbështesë rolin e sektorit postar në Shoqërinë e Informacionit.

(Propozimi 14, mbledhja plenare e 6-të)

REZOLUTA C 39/2008
AKTIVITETET E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Kongresi,

Duke kujtuar

krijimin progresiv të një procesi të planifikimit strategjik brenda Bashkimit, duke filluar nga Deklarata e Hamburgut në vitin 1984, dhe duke vazhduar me Planin e Veprimit të Përgjithshëm të Uashingtonit, Strategjinë Postare të Seulit, Strategjinë Postare e Pekinit dhe Strategjinë Postare Botërore të Bukureshtit në Kongrese të njëpasnjëshme,

Duke pasur parasysh

Raportin mbi zbatimin e Strategjisë Postare Botërore të Bukureshtit (KONGRESI-Dok 16) dhe paraqitjen e Strategjisë Postare të Nairobis (KONGRESI-Dok 38),

i ndërgjegjshëm

për nevojën për planifikim strategjik fleksibël në mënyrë që të drejtojë aktivitetet e Bashkimit në një mjedis postar në ndryshim,

Duke pranuar

se planifikimi strategjik ndihmon shërbimet postare të shteteve anëtare për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve të tyre,

Duke vënë në dukje me kënaqësi:

- Përparimin e qëndrueshëm të bërë drejt zbatimit të procesit të planifikimit strategjik në Bashkim të bazuar në rezultatet e arritura;
- Përmirësimet e vazhdueshme të bëra për Programin dhe Buxhetin e Bashkimit, i cili lejon një planifikim të mirë dhe më transparent të aktiviteteve të Bashkimit, në përputhje me burimet në dispozicion,

Duke pranuar
punën e kombinuar të CA dhe Grupit të Planifikimit Strategjik të POC, veçanërisht në fushën e krijimit të udhëzimeve për vendosjen e prioriteteve për implementimin e Strategjisë Postare të Nairobi, zhvillimin e skenarëve të ardhshëm për sektorin postar, dhe menaxhimin e bazuar në rezultate,

i kërkon

shteteve anëtare të miratojnë një proces të planifikimit strategjik, si një mënyrë për të ofruar shërbime të përmirësuara postare për qytetarët e tyre,

fton

shtetet anëtare për të marrë pjesë plotësisht në procesin e planifikimit strategjik të Bashkimit nëpërmjet raportimit të rregullt të rezultateve të përfituara në arritjen e objektivave të Strategjisë Postare të Nairobi,

ngarkon

Këshillin Drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit, dhe, sipas rastit, në konsultim me Komitetin Këshillimor:

- të ofrojnë këshilla mbi metodologjitë aktuale planifikimit strategjik;
- koordinojnë punën analitike, ose grumbullimin analizave ekzistuese, në mjedisin postar, me qëllimin për të integruar gjetjet në procesin e planifikimit strategjik të Bashkimit vazhdojnë të zhvillojnë, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare, informacionet kuantitative të verifikueshme dhe të pavarura, në mënyrë ideale në formën e kartave të raportit vjetor rreth arritjeve të objektivave të Strategjisë Postare të Nairobi nga shtetet anëtare;

- të përditësojnë rregullisht në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare Programin dhe Buxhetin në bazë të rezultateve të marra, të përcaktojnë prioritetet, financimet në dispozicion dhe ndryshimet në mjedisin postar;

- të vazhdojnë zhvillimin e konceptit të menaxhimit të bazuar në rezultate në procesin e saj të planifikimit strategjik;

- të zhvillojnë dhe kryejnë, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare, metodologjitë, duke përfshirë anketat vjetore ose dyvjeçare, për të kërkuar pikëpamjet e shteteve anëtare në prioritetet për planin strategjik të Kongresit të vitit 2012 dhe të gjitha projektet, programet dhe aktivitetet që do të përfshihen Programin dhe Buxhetin e Bashkimit në 2011-2012 dhe 2013-2014;

- të zhvillojnë dhe zbatojnë një metodologji për ridërgimin e Programit të Bashkimit dhe Prioriteteve të Buxhetit, siç janë shprehur nga shtetet anëtare,

Udhëzon

Byronë Ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Përgjithshme të Bashkimit:

- të kryejë monitorimin e rregullt dhe shpërndarjen e rezultateve të marra nëpërmjet zbatimit të NPS, dhe të realizojë një raport vjetor për Këshillin, dhe një raport përfundimtar për Kongresin e vitit 2012, që të përqendrohet në rezultatet e matshme;

- të përdorë analizat e mjedisit postar në mënyrë që të bëjë propozime për Këshillat mbi përmbajtjen e planit strategjik;

- të përgatisë për Këshillin Drejtues dhe në bazë të direktivave të lëshuara nga Këshillat, draftin e Strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

- të zhvillojë dhe rekomandojë rregullime të Programit dhe të Buxhetit.

(Propozimi 75 i ndryshuar nga propozimi 83, mbledhja plenare e 6-të)

REZOLUTA C 40/2008

E DREJTA NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E TREGTISË SË SHËRBIMEVE. MARRËDHËNIET WTO-UPU

Kongresi,

i ndërgjegjshëm

Për ndikimin që do të vazhdojnë të kenë në politikën postare të bërë në Bashkim dhe në nivel kombëtar zhvillimet në Organizatën Botërore të Tregtisë,

i ndërgjegjshëm

për faktin se rregullat e caktuara në fushën e tregtisë në shërbime në kuadër të WTO-së tashmë mund të zbatohen për shërbimet postare përderisa këto shërbime nuk janë dhënë në ushtrimin e autoritetit qeveritar të përcaktuar në nenin I.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS),



Duke vënë në dukje

se negociatat e shërbimeve sipas Axhendës së Zhvillimit të Doha kanë sjellë diskutime mbi rregullat e reja që mund të lidhen me shërbimet postare, dhe se rezultatet e këtyre diskutimeve mund të pasqyrohen në tekstin përfundimtar të marrëveshjes,

Duke pranuar

se bashkëpunimi mes Bashkimit dhe WTO është i nevojshëm për të siguruar koherencë ndërmjet veprimtarive të tyre, dhe se, për këtë qëllim, Bashkimi u bë vëzhgues *ad hoc* i Këshillit të WTO-së për Tregtinë në shërbime (CTS) në prill të vitit 2006,

I bindur

- për nevojën e Bashkimit për të informuar shtetet e tij anëtare mbi implikimet e marrëveshjeve të Organizatës Botërore të Tregtisë për sektorin postar, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar;

- përfitimin e harmonizimit të interesave të sektorit postar me rregullat e zbatueshme të organizatave të tjera ndërkombëtare,

Udhëzon

Këshillin Drejtues, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare, si dhe në kontekstin e statusit të vëzhguesit *ad hoc* të Bashkimit në CTS:

- të monitorojë zhvillimet në negociatat e shërbimeve të WTO-së në kuadër të Mbledhjes së Dohas lidhur me shërbimet postare dhe të mbajë anëtarët e Bashkimit të informuar për zhvillimet në këtë fushë;

- të sigurojë informacion, sipas rastit, për anëtarët e Bashkimit në lidhje me përputhshmërinë midis rregullave të Bashkimit dhe ato të Organizatës Botërore të Tregtisë.

(Propozimi 47. Rishikimi 1, Komiteti 3, Mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 41/2008

PROMOVIMI I EKSPERIENCAVE TË “PRAKTIKËS MË TË MIRË” NË ÇËSHTJET RREGULLATORE POSTARE

Kongresi,

Duke pasur parasysh

se, me ndryshimin e shpejtë të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm, reforma postare në shtetet anëtare është përsheptuar në vitet e fundit, dhe gjithnjë e më shumë shtete anëtare kanë ndarë funksionet rregullatore dhe operacionale, që nënkupton se duke garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimit postar në mjedisin e ri është bërë një çështje e rëndësishme për Bashkimin,

Duke pranuar

se reforma postare e shteteve anëtare ka për qëllim të promovojë zhvillimin postar dhe të garantojë zbatimin e shërbimit universal postar efikas dhe të arritshëm, në mënyrë që të rrisë më mirë funksionet rregullatore dhe funksionale dhe të përshtatë më mirë shërbimin universal ndaj kërkesave të publikut dhe zhvillimit social-ekonomik,

duke pranuar gjithashtu

që, në kontekstin e hapjes së tregjeve postare, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve është bërë një shqetësim i përbashkët për qeveritë dhe rregullatorët, do të thotë se është e rëndësishme të shkëmbehen përvoja rregullatore mes rregullatorëve postare në shtete të ndryshme në mbarë botën,

Udhëzon

Këshillin Drejtues, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare:

- të organizojë forume ose seminare të rregulloreve postare gjatë takimeve vjetore të Këshillit Drejtues;

- të mbledhë dhe botojë çdo informacion vjetor në lidhje me shërbimin universal, reformën postare dhe legjisllacionin, si dhe rregullimin e tregut të shteteve anëtare.

(Propozimi 66, Komiteti 3, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 42/2008
STUDIMI PËR KRIJIMIN E KONVENTËS POSTARE UNIVERSALE DHE MARRËVESHJES SË
SHËRBIMIT TË PAGESAVE POSTARE TË PËRHERSHME

Kongresi,
Duke pasur parasysh
përfitim e garantimit të stabilitetit ligjor të shërbimit postar ndërkombëtar ndërmjet shteteve anëtare duke krijuar një Konventë Postare Universale dhe Marrëveshje të Shërbimeve të Pagesave Postare të përhershme (në vijim referuar përkatësisht si "Konventa" dhe "Marrëveshja"),
Duke pranuar
Punën e shteteve anëtare, për shkak të kësaj procedure për Konventën dhe Marrëveshjen, e cila kërkon që Konventa dhe Marrëveshja ekzistuese të zëvendësohen tërësisht me aktet e reja të miratuara në çdo Kongres,
duke pasur gjithashtu parasysh
kohën e nevojshme për shtetet anëtare për të konsideruar efektin e të pasurit një Konventë dhe një Marrëveshjen të përhershme,
Udhëzon
Këshillin Drejtues, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare:
- të ndërmarrë një studim me qëllim të përcaktimit e dobishmërisë së krijimit të një Konvente dhe Marrëveshje të përhershme;
- të hartojë propozimet që janë të nevojshme si rezultat i studimit dhe t'i paraqesë ato Kongresit të 25të;
- të sigurohet se të gjitha shtetet anëtare të interesuara të kenë mundësi të marrin pjesë në Studimin e lartpërmendur.

(Propozimi 87. Rishikim 1, Komiteti 3, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 43/2008
PUNA E ARDHSHE PËR SISTEMET E SHPËRBLIMIT PËR ARTIKUJT E POSTËS SË LETRAVE TË
SHKËMBYER MIDIS OPERATORËVE TË CAKTUAR TË SHTETEVE ANËTARE TË UPU.
KOORDINIMI I PUNËS MBI SHPËRBLIMIN PËR LLOJE TË TJERA TË ARTIKUJVE

Kongresi,
Duke pasur parasysh
mandatet e dhëna nga Kongresi e Bukureshtit për të siguruar që sistemet e shpërblimit që do të propozohet në Kongresin e 24 të promovojnë përmbushjen e detyrimit për të siguruar shërbimin universal dhe ruajtjen integritetin e rrjetit postar,
Duke kujtuar
se dispozitat e Konventës së Bukureshtit në lidhje me detyrimet përfundimtare përmbajnë marrëveshje kalimtare që çojnë në miratimin e një sistemi shpërblimi të bazuar në koston specifike të një shteti
Duke pranuar
se marrëdhëniet financiare mes operatorëve të caktuar duhet të disiplinohen nga parimet dhe objektivat ekzistuese (p.sh. mbështetur në elemente specifike të çdo shteti dhe të lidhura me cilësinë e shërbimeve të ofruara), dhe duhet të marrë në konsideratë mjedisin në të cilin vepron Posta, veçanërisht për sa i përket hapjes së tregjeve postare ndaj konkurrencës,
Duke vënë në dukje
rezultatet e studimeve të gjera mbi kushtet e tregut, klasifikimin e shteteve, nevojave të konsumatorëve, cilësisë së shërbimit dhe shpërblimeve t3ë kryer nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare deri në Kongresin e 24rt,
Duke pranuar
ndikimin pozitiv të lidhjes së detyrimeve përfundimtare me cilësinë e shërbimit, me një sistem matje që filloi në vitin 2005 dhe tani ka 29 pjesëmarrës si nga shtetet objektiv dhe nga ato të tranzicionit,
duke pranuar gjithashtu
se Fondi i Cilësisë së Shërbimit të Bashkimit është një burim i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimit së postës së letrave në shtetet në zhvillim,



duke marrë parasysh
kërkesat rregullatore dhe interesat e klientëve,
i ndërgjegjshëm
për nevojën për të kërkuar përputhshmëri midis aspekteve të shpërblimeve të shërbimeve të postës së letrave dhe rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë,
Duke pranuar edhe
nevojën për të shqyrtuar gjendjen e shërbimeve të ndryshme të postës së letrave (duke përfshirë letra, pako të vogla, akses të drejtpërdrejtë dhe shërbime plotësuese) dhe zhvillim të produkteve / rritja e mundësive të bazuar në mundësitë e pozicionimit të tregut,
duke pranuar gjithashtu
se, në mënyrë që të zhvillohet një treg i orientuar i shërbimeve të postës së letrave që janë subjekt i sistemeve të shpërblimit specifike të shteteve, të bazuara në kosto para përfundimit të periudhës së tranzicionit, të gjitha shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar duhet të kenë, dhe të japin, informacione të rëndësishme dhe të besueshme për:
- Tregun e tyre të brendshëm, kushtet e tarifave dhe koston, me ndihmën e vazhdueshme të Byrosë Ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të kontabilitetit të koston për shtetet në zhvillim;
- Të dhënat statistikore të përdorura për klasifikimin e shteteve anëtare,
duke pasur gjithashtu parasysh
modifikimet në sistemin e shpërblimit të detyrimeve përfundimtare të miratuara nga Kongresi i 24rt,
Duke marrë parasysh edhe
që këto modifikime përfaqësojnë një hap shtesë në procesin e sjelljes së sistemit të shteteve specifike të bazuar në kosto në përdorimin e përgjithshëm,
Duke besuar
se pavarësisht dispozitave të miratuara nga Kongresi i 24rt, ka ende shumë për të bërë për të siguruar shërbime të postës së letrave të orientuara sipas tregut, të cilat janë subjekt i pagesës specifike për shtetin dhe të bazuar në kosto,
Duke pranuar gjithashtu
se objektivi për të sjellë të gjitha shtetet anëtare në një sistemi të bazuar në kosto specifike për shtetet në afatit të rekomanduar, 31 dhjetor 2013 nuk mund të arrihet pa vënë një barrë të rëndë financiare mbi disa shtete në zhvillim,
duke besuar gjithashtu
se pyetjet në lidhje me nivelet e shpërblimit të aplikuar për llojet e ndryshme të dërgesave postare të shkëmbyera ndërmjet shteteve anëtare (letra, pako, artikuj EMS) janë një shqetësim i Bashkimit dhe se koordinimi efektiv do të çojë në qëndrueshmëri më të madhe të trajtimit,
Duke pasur gjithashtu parasysh
se puna e Bashkimit në sistemet e shpërblimit duhet të organizohet sipas kushteve që do të ndihmojnë për të kontrolluar kostot shoqëruese,
Udhëzon
Këshillin Drejtues:
- të garantojë se janë ruajtur shërbimi universal i përballueshëm dhe integriteti i rrjetit postar;
- të garantojë se, duke lejuar përjashtime, zbatimi i sistemit të shpërblimit të bazuar në kosto specifike për shtetet do të jetë universal deri më 31 dhjetor 2017;
- të garantojë se, në masën më të madhe të mundshme, ka një tranzicion gradual të të gjitha shteteve që aktualisht nuk aplikojnë shpërblimin e bazuar në kosto specifike për shtetet për këtë shtet gjatë periudhës 2014-2017, për këtë qëllim, duhet të paraqitet një propozim për marrjen parasysh nga Kongresi i 25të:
ndryshimeve në treg, duke përfshirë mjedisin rregullator dhe postar, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
përvojën e fituar nga shtetet e tranzicionit në vitin 2010 dhe 2012, dhe ndikimet e tregut, klientëve dhe ato financiare të përfshira;
- të formalizojë procesin e mbledhjes së të dhënave e mëposhtme kombëtare:
tarifat e aplikueshme;
të dhënat statistikore të përdorura për klasifikimin;
standardet e ofrimit për postën në hyrje dhe objektivat përkatëse të cilësisë;

- të miratojë termat e referencës së një studimi të Këshillit të Operacioneve Postare për të krijuar një marrëdhënie midis tarifave lokale dhe kostos së përpunimit të postës ndërkombëtare në hyrje,

udhëzon gjithashtu

Këshillin e Operacioneve Postare për të kryer punët e mëposhtme:

- Tregu i postës së letrave dhe sistemet e shpërblimit:

të kryejë një studim për të shqyrtuar kushtet e tregut, duke përfshirë edhe studimet përkatëse ekonomike si nivelet e çmimeve krahasuese dhe elasticiteti i çmimeve, me fokus të veçantë në segmentimin të produktit; rezultatet e studimit duhet të jetë në dispozicion deri në fund të vitit të parë të ciklit;

vlerësimin e ndikimit të çmimeve të reja të detyrimeve përfundimtare të vendosura nga Kongresi i 24rt në tregje dhe tek operatorët e caktuar;

identifikimi i përmirësimeve të nevojshme në sistemin aktual të shpërblimeve në mënyrë që të plotësohen nevojat e tregut dhe të shteteve anëtare;

propozimin e shpërblimit për shërbimet plotësuese të tjera (p.sh. letra rekomande dhe e siguruar);

kryerjen e një studimi për modelimin e marrëdhëniet midis tarifave lokale dhe kostos së përpunimit të postës ndërkombëtare në hyrje, si dhe propozimin në Kongresin e vitit 2012 të një metodologjie për të zbatuar çmimin që rezultojnë në nivel kombëtar, rajonal apo në mbarë botën;

përcaktimin, nëse është e përshtatshme, për të gjetur një formulë për konvertimin e tarifave vendore të shtetit të destinacionit në normat e detyrimeve përfundimtare dhe nëse është e mundur, gjetjen e kësaj formule, duke marrë parasysh:

- Një sistem reference të tarifës së shumëfishtë në mënyrë që të zhvillojnë një metodologji lineare dhe rregulla të biznesit për të prodhuar çmimet e detyrimeve përfundimtare që janë më afër kostove aktuale dhe

- situatën e veçantë të shteteve tarifave lokale të cilëve janë vendosur në një bazë sociale dhe nuk mbulojnë kostot e ofrimit të shërbimeve të dorëzimit të postës së letrave në hyrje;

të shqyrtojë dhe përditësojë treguesin e zhvillimit postar të zhvillimit për të gjithë shtetet anëtare;

të kryejë një studim të kostos së trajtimit të dërgesave në hyrje gjatë vitit 2009 dhe 2010, nëse ky studim zbulon një përqindje të ndryshme nga 70 % i përcaktuar në nenin 29.2 të Konventës, POC mund të marrë parasysh rishikimin e përqindjes së aplikuar për vitin 2012 dhe 2013;

të shqyrtojë, nëse është e përshtatshme, rregullimin e pragut prej 100-tonësh për zbatimin e mekanizmit të rishikimit, siç përcaktohet në nenin 30 të Konventës dhe, nëse është rasti, të bëjë një rekomandim për këtë rregullim;

- Statistikat, kontabiliteti dhe operacionet:

zhvillimin dhe promovimin e sistemeve të automatizuar statistikore, të kontabilitetit dhe operative që mund të çojnë në përmirësime ekonomike dhe tregtare të sistemeve të shpërblimit;

zhvillimin e mëtejshëm të procedurave statistikore, të kontabilitetit dhe operative për përjasje të drejtpërdrejtë;

- Hallka e cilësisë së shërbimit:

të vazhdojë të zbatojë lidhjen midis cilësisë së shërbimit dhe detyrimeve përfundimtare në bazë të parimeve të vendosura nga Kongresi dhe të garantojë se janë në dispozicion sistemet të përshtatshme dhe të përballueshme të monitorimit;

të propozojë mjetet për të vlerësuar performancën e sistemeve matëse të cilësisë së shërbimit kundrejt objektivave të fiksuara (kosto, besueshmëri, kthimi i investimit);

të propozojë një afat kohor për pjesëmarrjen e operatorëve të caktuar në sistemin e matjes, bazuar në vendimet e Kongresit që kanë të bëjnë me klasifikimin;

- Aksesin i drejtpërdrejtë:

Rishikimin e kushteve për ofrimin e këtij shërbimi;

- Detyrime të transportit ajror të brendshëm:

të shqyrtojë nëse është e përshtatshme dhe, nëse po, si të përfshijë detyrimet e transportit ajror të brendshëm në shpërblimin bazë të postës së letrave, për të lejuar që ky sistem shpërblimi të eliminohet;

të raportojë rezultatet e studimit në Kongresin e ardhshëm dhe të rekomandojë ndonjë ndryshim të nevojshëm;

- Fondi i Cilësisë së Shërbimit:

të sigurojë që shteteve më në nevojë ti jenë caktuar nivelet e duhura të kontributit;



- Të raportojë në Këshillin Drejtues për progresin me punën e detyrimeve përfundimtare.

(Propozimi 25. Rishikimi 1, Komiteti 5, mbledhja e 4-rt)

REZOLUTA C 44/2008

VAZHDIMI I AKTIVITETEVE TË SHËRBIMIT POSTAR UNIVERSAL PAS KONGRESIT TË 24

Kongresi,

Duke ri-afirmuar

se misioni i Bashkimit është të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve postare universale cilësore, të efektshme dhe të arritshme, në mënyrë për të lehtësuar komunikimin për çdo qytetar në botë,

Duke pranuar

se një nga objektivat më të rëndësishme të Strategjisë Postare UPU të Nairobit është që të promovojë një shërbim postar universal të përshtatur me ambientin social, ekonomik dhe teknologjik,

Duke pasur parasysh

se veprimet për të lehtësuar aksesin në shërbimin postar mbështet përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të trajtuar varfërinë, pasi ato japin më shumë mundësi, më shumë pavarësi dhe më shumë siguri për të varfrit,

Duke pranuar

Rolin e Bashkimit si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për zhvillimin aktiv të aktivitete të ndryshme me në kuadrin e ndarjes së përgjegjësisë për arritjen e Qëllimeve të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim deri në 2015,

duke pranuar gjithashtu

se Posta luan një rol kryesor në zhvillimin ekonomik të një kombi, duke siguruar një infrastrukturë bazë për komunikimin dhe shpërndarjen e mallrave, duke kontribuar kështu në zhvillimin e ekonomisë botërore,

Udhëzon

Këshillin Drejtues, në bashkëpunim me Këshillin e Operacioneve Postare dhe Byronë Ndërkombëtare, të vazhdojë pas Kongresit të 24rt aktivitetet e mëposhtme në lidhje me shërbimin postar universal:

- të kryejë studime me synimin për të kuptuar zgjidhjet për financimin e shërbimeve postare universale, veçanërisht në një mjedis të karakterizuar nga liberalizimi gradual i tregut postar, dhe ti komunikojë rezultatet e studimit të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit;

- të promovojë përvojat e "praktikave më të mira" të fituara nga shtetet anëtare në dhënien e shërbimeve postare të qëndrueshme, në aspektin e qeverisjes dhe sidomos duke kombinuar teknologjitë e reja me rrjetin postar dhe shërbimet;

- të zhvillojë projekte për të ndihmuar shtetet anëtare apo grupe regjionale të përcaktojnë një shërbim postar universal të qëndrueshëm duke marrë në konsideratë tregues të ndryshëm;

- të vazhdojë të monitorojë, në baza vjetore, progresin e bërë nga shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në ofrimin e shërbimit postar universal, duke përdorur një sisteme të monitorimit / matjes për zbatimin e standardeve në pesë fushat kryesore të shërbimit postar universal, si dhe të informojë rregullisht shtetet anëtare të Bashkimit për progresin e shërbimit postar universal në rajone të ndryshme të Bashkimit.

(Propozimi 02, Komiteti 3, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 45/2008

SISTEMI GLOBAL UPU PËR MONITORIMIN (GMS)

Kongresi,

i sigurt

se përmirësimi i cilësisë së shërbimit postar ndërkombëtar është i një rëndësie primare për Bashkimin Postar Universal,

Duke pasur parasysh

- Vendimin e Kongresit të Pekinit për të zhvilluar një plan operacional dhe zbatimin për lidhjen e cilësisë së shërbimit me detyrimet përfundimtare, në përputhje me kushtet e secilit operator të caktuar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit postar ndërkombëtar;

- Vendimin e Kongresit të Bukureshtit për të zbatuar lidhjen midis cilësisë së shërbimit dhe detyrimeve përfundimtare, dhe në veçanti për të parë në të se janë vënë në dispozicion sistemet e përshtatshme të monitorimit;

- Vendimin e Kongresit të Bukureshtit për të vlerësuar sistemet e matjes së cilësisë së shërbimit dhe për të propozuar përmirësimet e nevojshme për të mundësuar pjesëmarrjen e numrit maksimal të shteteve,

I bindur

se rezultatet e sistemit për monitorimin e cilësisë së shërbimit, të cilat do të formojnë bazën për dhënien e detyrimeve përfundimtare, duhet të jenë uniforme, të besueshme dhe të arritshme për të gjithë operatorët e caktuar të shteteve anëtare të Bashkimit,

Duke pranuar

se ky sistem do të bazohet në matjet e jashtme, me testim të pavarur të operatorëve të caktuar,

I ndërgjegjshëm

se rezultatet e sistemit të monitorimit do të mundësojnë operatorëve të caktuar të ndërmarrin veprimet e duhura për të korrigjuar mangësitë e identifikuara në operacionet e tyre për të përmirësuar cilësinë,

duke pranuar gjithashtu

nevojën për të vlerësuar arritjet e operatorëve të caktuar në projektet e zbatimit të financuara me anë të Fondit të Cilësisë së Shërbimit,

Duke vënë në dukje

nevojën për të plotësuar dispozitat e Rregullores së Postës së Letrave, veçanërisht pjesën që ka të bëjë me treguesit e performancës dhe sistemin e monitorimit,

Duke marrë parasysh

Sistemin e Monitorimit Global të UPU (GMS) të projektuar sipas specifikimeve teknike të vendosura nga Këshilli i Operacioneve Postare të Bukureshtit,

Duke pranuar gjithashtu

se parimet kryesore të GMS janë se sistemi duhet të jetë:

- i drejtuar nga klienti;
- i zbatueshëm globalisht;
- i përbalueshëm;
- transparent;
- mjaft i saktë dhe i besueshëm;
- i jashtëm ndaj anëtarëve të UPU;
- diagnostikues;
- në nivelin lokal;
- i vazhdueshëm,

duke vënë re gjithashtu

se GMS mund të përdoret nga operatorët e caktuar si sistem bazë për monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe cilësisë së shërbimit të lidhur me detyrimet përfundimtare, dhe mund të shërbejë gjithashtu si një mjet për vlerësimin e arritjeve të operatorëve të caktuar në projektet e zbatimit të financuara me anë të Fondit të Cilësisë së Shërbimit,

Udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare:

- të zhvillojë dhe të ndjekë një program pilot për GSM në mënyrë që të testojë specifikimet teknike dhe të bëjë ndryshimet e duhura, në përputhje me zbulimet dhe kontributin e operatorëve të caktuar anëtarë;

- të koordinojë marrëveshje mbi GMS gati për zbatim, duke marrë parasysh Vendimet e Kongresit për shtetet e tranzicionit në sistemin objektiv;

- të vazhdojë rifiniturën dhe zhvillimin e projektimit teknik, marrëveshjeve të financimit, strukturën qeverisëse, çështjet ligjore dhe elemente të tjera të nevojshme për zbatimin e GMS;

- të sigurojë se GMS mund të përdoret për lidhjen e detyrimeve përfundimtare të cilësisë së shërbimit;

- të zbatojë GMS si një sistem global të Bashkimit,



Udhëzon gjithashtu
Byronë Ndërkombëtare të japë mbështetje të plotë për zbatimin efektiv të GMS,
inkurajon
operatorët e caktuar të marrin pjesë në zbatimin e GMS.

(Propozimi 45, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 46/2008
ANKETA MBI CILËSINË E PROGRAMEVE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE

Kongresi,
Duke pasur parasysh
se Byroja Ndërkombëtare, nëpërmjet Njesisë së saj të Cilësisë së Shërbimit, shërben si një burim i rëndësishëm për shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të tyre,
Duke vënë në dukje
se suksesi i programeve të cilësisë së shërbimeve të kryera nga Njësia e Cilësisë së Shërbimit varet nga burimet në dispozicion të saj, të cilat janë të kufizuara,
i ndërgjegjshëm
se Sistemi Global i Monitorimit, si dhe programet e reja të cilësisë së shërbimeve që kanë të bëjnë me koltitë, do të kërkojë burime të konsiderueshme për të planifikuar, zbatuar dhe për të ruajtur,
Duke pasur parasysh
që programet aktuale të cilësisë së shërbimeve mbulojnë një gamë të gjerë projektesh që përfshijnë testimin e vazhdueshëm, testimin vijues, misione konsulence, certifikimin e cilësisë dhe projekte pilot,
i vënë në dijeni
se të dhënat në dispozicion tregojnë se shtetet anëtare nuk përfitojnë plotësisht nga rezultatet e performancës të dhëna nga Byroja Ndërkombëtare lidhur me matjen e cilësisë së shërbimit *end-to-end*,
Duke pasur parasysh
se deri tani objektivi më i rëndësishëm i Strategjisë Postare të Nairobi është "rritja e cilësisë së shërbimit dhe efikasitetit të rrjetit postar",
I bindur
se zbatimi dhe menaxhimi i suksesshëm i Sistemit Global të Monitorimit do të kërkojë ti jepet prioritet urgjent burimeve në dispozicion,
Duke pranuar
se aftësitë e Sistemit Global të Monitorimit mund të zëvendësojnë ato të programeve aktuale të testimit të cilësisë së shërbimit,
Udhëzon
Byronë Ndërkombëtare:
- Të nisë një studim për të kërkuar pikëpamjet e shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar nëse programet aktuale të cilësisë së shërbimeve të menaxhuara nga Byroja Ndërkombëtare përmbushin nevojat e tyre dhe cilat programe janë më të dobishme;
- Të bëjë rekomandime në Këshillin e Operacioneve Postare të vitit 2009, duke u bazuar në rezultatet e studimit, për zgjedhjen e programeve të cilësisë së shërbimeve që duhet të mbahen dhe si do ti jepet përparësi atyre që do të mbahen.

(Propozimi 53. Rishikimi 1, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 47/2008
BASHKËPUNIMI ME INDUSTRIJËN E FLUTURIMEVE

Kongresi,
Duke kujtuar
se bashkëpunimi mes Bashkimit Postar Universal dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA), e cila ka ekzistuar për më shumë se gjysmë shekulli, është në interesin më të mirë të të dyja organizatave,
i ndërgjegjshëm
se Bashkimi ka nënshkruar një Memorandum të ri të Mirëkuptimit (MM) me IATA-n në mars të vitit 2007, duke vendosur një partneritet strategjik dhe të qëndrueshëm midis dy organizatave,
Duke vënë në dukje
se një Plan gjithëpërfshirës i Punës së Postës ajrore ka qenë i projektuar nga Komiteti i Kontaktit IATA-UPU në dritën e MM-së së mësipërme,
Duke vënë në dukje edhe
se Komiteti i Kontaktit IATA-UPU është duke kryer studime nga për realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Punës të Postës ajrore,
Duke pasur parasysh
se duhet të vazhdojnë përpjekjet për të përsheptuar dhe lehtësuar transmetimin dhe trajtimin e postës ajrore,
duke kujtuar
se linjat e fluturimeve dhe operatorët e caktuar duhet të përqendrohen më shumë në standardizimin dhe përdorimin më të madh të shkëmbim të të dhënave elektronike (EDI) për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e postës ndërkombëtare,
Duke pranuar
se lëvizja e shpejtë dhe e besueshme e postës dhe raportimit të qëndrueshëm dhe të saktë të statusit të lëvizjes të postës janë në interes të përbashkët si të operatorëve të caktuar dhe të linjave të fluturimit,
i sigurt
se puna e rëndësishme që është ndërmarrë nga Komiteti i Kontaktit IATA-UPU do të japë rezultate të dobishme për të dyja organizatat, duke sjellë ndryshime cilësore në sektorin e postës ajrore,
ngarkon
Këshillin e Operacioneve Postare të vazhdojë bashkëpunimin me industrinë e linjave të fluturimit, për të gjetur mundësi të përbashkëta për përmirësim dhe për të ndërmarrë iniciativa të reja.

(Propozimi 55, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 48/2008
KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË MATJES SË CILËSISË SË SHËRBIMIT SHITETIVE ANËTARE

Kongresi,
Duke pasur parasysh
punën e kryer nga Grupi i Planifikimit Strategjik për realizuar raporte që tregojnë në çfarë shkalle janë arritur objektivat e Strategjisë Postare të Nairobit nga shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar,
Duke pasur parasysh
faktin që qëllimi kryesor i këtyre raporteve është të tregojnë, në terma sasiorë, progresin e bërë nga shtetet anëtare të veçanta në zbatimin e Strategjisë Postare të Nairobit, dhe se matja e cilësisë së shërbimit e arritur nga operatorët të caktuar të destinacionit në dorëzimin e postës së letrave në hyrje dhe artikujve të kolipostës janë tregues kyç për këtë qëllim,
Duke pranuar
se matjet e cilësisë së shërbimeve, përbën pjesërisht, bazën për pagesat e detyrimeve përfundimtare të artikujve të postës së letrave të parashikuara në Konventën Postare Universale,
i ndërgjegjshëm
se janë duke u bërë përpjekje serioze për të zhvilluar metodologji për të lidhur rezultatet e matjeve të cilësisë së shërbimeve dhe çmimeve të kolive tokësore në hyrje,



Duke vënë në dukje
burimet e konsiderueshme financiare dhe menaxhuese të investuara nga Bashkimi për të zhvilluar dhe
vendosur sisteme të matjes së cilësisë së shërbimit,

I bindur

se publikimi i rezultateve të matjes është thelbësor për të siguruar transparencë dhe për të prodhuar
dëshmi të prekshme se investimet e bëra për matjen e cilësisë së shërbimit kontribuojnë në përmirësimin e
përgjithshëm të cilësisë,

Udhëzon

Këshilli Drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare:

- Të përcaktojnë mënyrën më të përshtatshme për të publikuar rezultatet e matjeve të cilësisë së
shërbimit të postës së letrave dhe kolipostës të arritura nga secili prej operatorëve të caktuar të destinacionit në
përputhje me dispozitat e Konventës Postare Universale; dhe

- Të vendosin nëse këto rezultate duhet të publikohen në raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë
Postare të Nairobit.

(Propozimi 57. Rishikimi 1, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 49/2008 KONTROLI NË KUFİ

Kongresi,

Duke vënë në dukje

se jo vetëm doganat, por edhe agjenci të tjera kufitare mund të përfshihen në kontrollin e artikujve në
kufijtë e një shteti,

Duke pasur parasysh

se fjala "Doganë", siç përdoret në nenin 18 të Konventës Postare Universale, si dhe në Rregulloret e
Postës së Letrave dhe Kolipostës duhet të interpretohet në një kuptim të gjerë dhe do të mbulojë të gjitha
agjencitë e kufirit të autorizuar zyrtarisht që lidhen me kontrollin e artikujve postarë në kufijtë e një shteti, në
përputhje me legjislacionin kombëtar të çdo shteti,

Duke pranuar

nevojën për të identifikuar këto agjenci dhe kompetencat e tyre siç është specifikuar në legjislacionin
kombëtar të çdo shteti,

fton

shtetet anëtare ti japin Byrosë Ndërkombëtare informacion në lidhje me kompetencat e agjencive të tyre kufitare,

Udhëzon

Byronë Ndërkombëtare

- Për të mbajtur një regjistër global të agjencive përgjegjëse të çdo shteti;

- Për të përfshirë komentet e duhura sipas nenit 18 të Konventës dhe sipas neneve përkatëse të
Rregulloreve.

(Propozimi 68, komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 50/2008 PËRDORIMI I SOFTWARE TË PROCESIMIT TË REKLAMIMEVE TË POSTËS SË LETRAVE TË BAZUAR NË INTERNET

Kongresi,

i ndërgjegjshëm

për nevojën e procedimit të reklamimeve të postës së letrave me shpejtësinë e kërkuar nga klientët,

pasi vuri në dukje

se mjetet standarde të transmetimit të reklamimeve të klientëve nuk përmbushin nevojat ekzistuese në
aspektin e shpejtësisë,

Duke marrë parasysh

se interneti përdoret gjerësisht si një mjet pune në të gjitha nivelet, në mbarë botën,

Udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare:

- të kryejë një studim me qëllim për të përfshirë një software të procedimit të reklamimeve të postës së letrave i cili përfshin formularët CN 08 të siguruara nga shtetet (e origjinës dhe të destinacionit) dhe gjeneron raporte dhe statistika periodike që do të lejojnë matjen e kohës së përpunimit të reklamimeve nga operatorët e caktuar;

- të konstatojë nëse software i ri duhet të zhvillohet, apo nëse platforma teknologjike mund të ndahet me sistemin ekzistues;

- të propozojë një zgjidhje për operatorët e caktuar të cilët dëshirojnë të përdorin një sistem me karakteristikat e sipërpërmendura,

Sistemi i përdorur duhet të lejojë:

a) shkurtimin e kohës së procedimit të reklamimit;

b) monitorimin e kohës së përgjigjes së reklamimit ndërmjet operatorëve të caktuar, çka do të parandalojë pagesa e shumave të tepërta në kompensim vetëm për shkak të përmbushjes së afateve, por pa zgjidhur reklamimin;

c) monitorimin e rekurseve të panevojshme për kompensim, dhe mbajtjen e regjistrimit të individëve /institucioneve që përdorin në mënyrë abuzive mekanizmin e kompensimit.

(Propozimi 78, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 51/ 2008
KOOPERATIVA EMS

Kongresi,

Duke pranuar

- se EMS është ofruar, në bazë të nenit 14 të Konventës Postare Universale, dhe Marrëveshja Standard për EMS (Kongresi - Dok 26), nga shumica e operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve anëtare, njihet si një element përbërës e ofertës postare duke plotësuar në mënyrë efektive gamën tradicionale të shërbimeve të postës së letrave dhe kolipostës;

- se EMS ka rëndësi të konsiderueshme tregtare dhe strategjik për shërbimet postare dhe për klientët e tyre;

- Se në shumicën e shteteve dhe territoreve anëtare EMS është mjeti i vetëm praktik dhe i përballueshëm për dhënien e aksesit universal të shërbimeve ndërkombëtare ekspres për klientët privat dhe për shumë ndërmarrje të vogla,

Duke vënë në dukje

progresin dhe arritjet e kooperativës EMS, si një strukturë brenda POC, që siguron një fokus global për të lejuar rrjetin botëror EMS të përmbushë më mirë nevojat e klientëve postarë,

duke pranuar

nevojën e Bashkimit për të vazhduar mbështetjen e aktiviteteve të vazhdueshme EMS, veçanërisht për ata anëtarë të Bashkimit që nuk janë anëtarë të kooperativës EMS,

Duke pranuar

se Kooperativa EMS financohet nga anëtarët e saj dhe se paguan nga buxheti i vet të gjitha programet dhe aktivitetet EMS, duke përfshirë të gjitha kostot e drejtpërdrejta të personelit,

duke pranuar gjithashtu

se jo- anëtarët e Kooperativës EMS përfitojnë gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë nga programet dhe zhvillimet e Kooperativës EMS,

vendos

të vazhdojë të financojë, me anë të buxhetit të Bashkimit, shpenzimet institucionale dhe kosto të tjera mbështetëse për mbajtjen e Njesisë EMS në Byronë Ndërkombëtare. Kostot që do të mbështeten do të përfshijnë ato për akomodimin e Njesisë EMS (në nivelin aktual të personelit të saj); zyra e saj dhe shërbimet IT; mbështetja logjistike, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve; përkthimi dhe interpretimi në takimet e Bashkimit; personeli dhe menaxhim të mbështetjes financiare, këshilla ligjore, dhe çdo kosto të



tjera të paguara nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Njësine EMS, të cilat nuk janë ndarë aktualisht në zërin EMS në Programin dhe buxhetin e Bashkimit,

ngarkon

- Kooperativën EMS, të varur nga POC:

a) të mbajë, në kuadër të strategjisë së UPU, përgjegjësitë e veta për të gjitha çështjet operacionale, tregtare, teknike dhe ekonomike që kanë të bëjnë me EMS, duke pasur kompetencën për të bërë dhe ndryshuar rekomandimet EMS dhe për të vendosur standarde EMS në të gjitha këto fusha, duke marrë në konsideratë direktivat nga organet e Bashkimit;

b) ti paraqesë një raport vjetor POC dhe, sipas rastit, AK;

- POC për të paraqitur një raport për Kongresin e ardhshëm mbi progresin e aktiviteteve EMS dhe financimin e tyre,

Udhëzon

Byronë Ndërkombëtare:

a) të vazhdojë ti ofrojë Njesisë EMS (në nivelin e stafit të tij të vitit 2003) me akomodim zyrash, mobilie dhe pajisje, pa ndonjë qira ose detyrimeve të tjera akomoduuese;

b) të vazhdojë të ofrojë mbështetje për Kooperativën EMS duke i mbuluar të gjitha kostot e saj institucionale dhe të tjera siç është specifikuar në këtë rezolutë, pa kosto për Kooperativën;

c) të garantojë që operatorët e caktuar që nuk janë anëtarë të Kooperativës EMS të vazhdojnë të përfitojnë nga programet dhe publikimeve EMS të krijuara;

d) të vazhdojë të promovojë aktivitetet EMS për ata operatorë të caktuar që nuk janë anëtarë të kooperativës.

I kërkon

shteteve dhe territoret anëtare operatorët e caktuar të të cilëve nuk janë anëtarë të Kooperativës EMS ti bashkohen kooperativës në bazë të rezultateve të shkëlqyera të arritura (shih KONGRES-Dok 26).

(Propozimi 84, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 52/2008

PROGRAMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT 2009 – 2012

Kongresi,

Duke pasur parasysh

Përmirësimin e cilësisë së shërbimit postar ndërkombëtar si një objektiv kyç për Bashkimin,

Duke pasur parasysh

- Rezultatet inkurajuese të arritura duke zbatuar Programin e Cilësisë së Shërbimit 2005 – 2008;

- Një sërë problemesh të vërejtura me rezultatet e zbatimit të rezolutës C 29/2004, duke përfshirë faktin se rezultatet në mbarë botën për standardin J + 5 dhe objektivin e performancës 65% ishin çorientuese (paqëndrueshmëria e lidhjeve duhet të testohet), dhe mospërputhjet në numrin e ditëve të kërkuar nga rrjetet e ndryshme postare të shpërndarjes për transmetimin e postës nga nisja në mbërritje);

- nevojën për të vendosur një standard të shërbimit dhe objektiv të cilësisë në fushën ndërkombëtare të cilësisë së shërbimit;

- fakti që fokusi kryesor i konsumatorit është në besueshmëri,

Duke vënë në dukje

Nevojën që Bashkimi të vazhdojë punën e tij në lidhje me përmirësimin e cilësisë,

Vendos

- të zbatojë një Program të Cilësisë së Shërbimit për periudhën 2009-2012, siç është përcaktuar në KONGRES-Dok 21a;

- të vendosë standardin e cilësisë globale të shërbimit në J + 5 (ditën e pestë të punës pas ditës së postimit) dhe objektivin për arritjen e këtij standardi në 80 %, i cili duhet të arrihet deri në 2012 me rritjen progresive të objektivit vjetor;

- se ky standard dhe objektiv do të zbatohet për postën ndërkombëtare të letrave prioritare midis atyre zonave dhe / apo qyteteve që janë më të rëndësishme në terma të shkëmbimeve ndërkombëtare postare në çdo shtet anëtar,

Udhëzon

Operacionet e Këshillit postare, në bashkëpunim me Këshillin e Administrimit, i Komitetit Konsultativ dhe Byroja Ndërkombëtare, në:

- Të marrë masat e nevojshme për të arritur rezultate të rëndësishme në fusha të ndryshme të mbuluara nga Programi i Cilësisë së Shërbimit dhe të paraqesë një raport mbi zbatimin e tij në Kongresin e ardhshëm;

- Të krijojë një përjasje nga poshtë-lart në bazë të proces të përfshirjes në hartë me qëllim vendosjen e standardeve dypalëshe dhe rajonale të shërbimit për të gjithë shtetet anëtare në mënyrë që të maksimizohet përfshirja dhe të angazhohet në punën e nevojshme për të arritur standardet dhe objektivat e rëna dakord;

- matjen dhe agregimin e standardeve bilaterale dhe rajonale të shërbimit, objektivat e cilësisë dhe rezultatet e matjeve për të reflektuar realisht performancën e lidhjeve dypalëshe brenda rajonit si edhe performancën globale të Bashkimit;

- të organizojë dhe koordinojë matje të vazhdueshme të pajtueshmërisë me standardet e shërbimeve dhe objektivate të cilësisë,

- të vendosë objektiva të përshtatshme për 2009, 2010 dhe 2011 me synimin për të arritur 80 % deri në vitin 2012,

I kërkon

qeverive dhe rregullatorëve:

- të sigurojnë mbështetje aktive për zbatimin e Programit të Cilësisë së Shërbimit;
- të vendosin standardet kombëtare të cilësisë;
- të sigurojnë përputhjen me këto standarde nga ana e operatorit të caktuar postar;
- të përcaktojnë kushtet për pajtimin me standardet botërore të cilësisë;
- të marrin pjesë në aktivitetet e Bashkimit dhe Sindikatave të kufizuara në fushën e cilësisë së shërbimit,

b) operatorët caktuar postarë:

- të marrin pjesë aktive në zbatimin e Programit të Cilësisë së Shërbimit;
- të bëjnë të pamundurën për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve postare të ofruara;
- të vendosin standardet dypalëshe dhe rajonale të shërbimit dhe objektivat e cilësisë;
- të masin vazhdimisht përputhjen me këto standarde të shërbimeve dypalëshe dhe rajonale dhe objektivat e cilësisë, të paktën me anë të një nga testet e organizuar nga Bashkimi ose nga Sindikatat e kufizuara, ose në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- të analizojnë vazhdimisht rezultatet e këtyre testeve dhe të marrin masa për të ndihmuar arritjen e objektivate të përputhjes me këto standarde të shërbimeve dypalëshe dhe rajonale dhe objektivat e cilësisë;
- Përdorë raportimin e matjeve specifik për shtetin dhe rajonin si një mjet për analizimin dhe përmirësimin e cilësisë

c) Sindikatat e kufizuara:

- të marrin pjesë në aktivitetet e nisura në kuadrin e Programit të cilësisë së shërbimit;
- të koordinojnë vendosjen e standardeve dypalëshe dhe rajonale të shërbimeve dhe të objektivate të cilësisë;
- të japin mbështetjen e tyre ndaj veprimeve rajonale për të përmirësuar pajtueshmërinë me këto standarde bilaterale dhe rajonale të shërbimit dhe objektivat e cilësisë.

(Propozimi 85, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 53/2008

STRATEGJIA DHE VEPRIMTARITË E ARDHSHEME TË KOOPERATIVËS TELEMATIKE DHE FINANCIMI I SAJ

Kongresi,

Duke kujtuar:

- rezolutën C 27 të Kongresit të vitit 1994, Seul, rezolutën C 52 të Kongresit të vitit 1999, Pekin dhe rezolutën C 66 të Kongresit të vitit 2004, Bukuresht, në lidhje me aktivitetet e Bashkimit në fushën e shkëmbimeve EDI nga viti 1995 deri në vitin 2008;

- suksesin e veprimtarive telematike që nga viti 1994;



- miratimi përgjithshëm të software të Qendrës së Teknologjisë Postare (PTC) nga të gjithë anëtarët, nga shtetet më pak të zhvilluara në shtetet e industrializuara,

Duke pasur parasysh

Raportin e Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me aktivitetet telepatike të Bashkimit (KONGRES-Dok 25a),

I ndërgjegjshëm:

- për rëndësinë strategjike të aktiviteteve telematike të Bashkimit për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit;

- se infrastruktura dhe aktivitetet e rrjetit telematik janë vendimtare për të përmirësuar më tej produktet dhe shërbimet postare, për ruajtjen e detyrimit të cilësisë të shërbimit universal, për zhvillime të mëtejshme postare në shoqërinë e informacionit, për reduktimin e ndarjes digjitale ndërmjet anëtarëve dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e disa problemeve të rëndësishme të tilla si shërbimi i ardhshëm universal dhe çështja e remitancave për punëtorët emigrantë;

- se, për të qenë më efektiv, përdorimi i teknologjisë duhet të përfshihet në një përqsasje të përbashkët të biznesit, masave operacionale dhe teknike të kombinuara me një cikël vlerësimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm,

Duke vënë në dukje:

- se është krijuar një Kooperativë Telematike në kuadër të POC me qëllim të zhvillimit të sinergjisë midis Postës dhe stimulimin e zhvillimit të shërbimit postar me anë të përdorimit të teknologjive moderne;

- se një infrastrukturë të rrjetit elektronik dhe zgjidhjeve IT të kohëve të fundit në pronësi të Bashkimit dhe të përballueshme për të gjithë anëtarët, siguron aftësinë elektronike të shkëmbimit midis të gjithë anëtarëve dhe automatizimin e proceseve postare, operative, të rëndësishme pavarësisht statusit të tyre të zhvillimit postar, dhe duke ofruar kështu mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm cilësisë dhe shërbimit të shërbimeve postare që përndryshe nuk do të ishin të mundur;

- se për të gjitha të dhënat e transportuara nëpërmjet rrjetit elektronik të Bashkimit dhe të përpunuara nga zgjidhjet e saj për kushtet paraprake, konfidencialitetin dhe mbrojtjen janë të garantuara;

- Se infrastruktura e rrjetit elektronik të Bashkimit dhe zgjidhjet e software të ketë ndërfaqe të hapur për të garantuar ndërveprimin me rrjetet dhe sistemet e tjera postare;

- Se Kooperativa Telematike po kryen punë të rëndësishme për të mbështetur anëtarët jo vetëm në fushat e lidhura ngushtë me përdorimin e software PTC, por edhe në fushën këshillimit operativ dhe monitorimin EDI për të ruajtur dhe përmirësuar infrastrukturën elektronike, paralajmërimit të anëtarëve për problemet e shkëmbimit, si dhe përmirësimin e proceseve operacionale, cilësinë e shërbimit dhe performancën e operacioneve postare, kryesisht në shtetet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara;

- se puna në fushën e shërbimeve të avancuara elektronike (AES) siguron gjithashtu transferim të know-how, i cili promovon disponueshmërinë e teknologjive të reja për të gjithë anëtarët, të tilla si standardet S43, EPCM dhe RFID, blerjet elektronike, posta globale hibride dhe infrastruktura elektronike që mundëson dërgimin elektronik të shërbimeve universale;

- se Kooperativa Telematike është duke mbështetur IB në fusha strategjike si zhvillimi i standardeve EDI, marrëdhëniet me partnerë të rëndësishëm postare si linjat e fluturimit (IATA), doganat dhe organizata të tjera ndërkombëtare, dhe përfshirjen e Bashkimit në shoqërinë e informacionit

duke vënë gjithashtu në dukje:

- Pamundësinë e Kooperativës telematike për të financuar detyrat të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me zhvillimin, dislokimin, funksionimin dhe mbështetjen e zgjidhjeve të software PTC nga tarifat e marra për mirëmbajtjen e produkteve, shërbimeve të rrjetit, misionëve të asistencës, zhvillimit të produkteve ose kontributeve të anëtarëve;

- tërheqjen e tregut postar për kapitale dhe mekanizma të tjera të financimit të tregut për investime në shërbimet globale postare;

- se mund të lindë nevoja që fondet e nevojshme për të mundësuar kërkimin shkencor, zhvillimin dhe tregtimin e produkteve të reja me potencial të lartë dhe shërbimet postare të vijnë nga burime të jashtme,

Duke pasur parasysh:

- ndarjen digjitale në drejtim të zhvillimit operacional dhe diferencat në nivelet e zhvillimit të anëtarëve;

- numrin e madh të operatorëve të caktuar që janë bashkuar vullnetarisht me Kooperativën telematike,

Duke pranuar:

- arritjet e Kooperativës deri më sot dhe përpjekjet e saj që synojnë përmirësimin dhe shërbimet postare në zhvillim (KONGRES-Dok 25a);

- se strategjia e Kooperativës telematike (KONGRES-Dok 25b) është e lidhur ngushtë me Strategjinë Postare të Nairobi dhe se aktivitetet e Kooperativës Telematike janë thelbësore për zbatimin e Strategjisë Postare të Nairobi,

I bindur:

- Se hendeku i zhvillimit mund të reduktohet:

• duke bërë që të njëjtat zgjidhje IT të kohëve të fundit dhe infrastrukture, të përdoren dhe të jenë të përballueshme nga të gjithë anëtarët;

• duke siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe këshilla mbi çështjet e biznesit dhe ato operacionale;

• duke siguruar një infrastrukturë elektronike botërore të tillë si posta për t'i dhënë çdo qytetari dhe biznesit të vogël, të mesëm ose të madh mundësinë për të marrë pjesë në tregtinë botërore pa diskriminim dhe në një mjedis të besuar, të verifikuar nga operatorët e caktuar anëtarë të Bashkimit;

- Se Kooperativa Telematike do të bëjë gjithçka mundet për të shpejtuar në mënyrë të konsiderueshme futjen e telematikës dhe teknologjive të tjera të projektuara për të përmirësuar komunikimin ndërmjet operatorëve të caktuar dhe partnerëve e tyre, për të ngushtuar hendekun e teknologjisë mes tyre dhe me lojtarët e tjerë të tregut, për të rritur cilësinë e shërbimit postar ndërkombëtar dhe për të lehtësuar zgjerimin e shërbimeve aktuale dhe zhvillimin e atyre të reja,

Vendos:

- të miratojë strategjinë e Kooperativës telematike 2009-2012 (KONGRES-Dok 25);

- Të vazhdojë të financojë, me anë të buxhetit të Bashkimit, kostot institucionale që kanë të bëjnë me ruajtjen e PTC në Byronë Ndërkombëtare (IB), i cili mbulon përdorimin e ambienteve të PTC-së, shërbimet administrative dhe logjistike të PTC, duke përfshirë shërbime të përkthimit, shërbime të përkthimit gjatë takimeve UPU, prodhimin dhe dërgimin e dokumenteve, menaxhimin e stafit dhe menaxhimin financiar, dhe shërbimet ligjore;

- të financojë aktivitetet e Kooperativës Telematike jo të lidhura ngushtë me përdorimin e software standard PTC por duke mbështetur zhvillimin e biznesit, përmirësimin e procesit operativ, iniciativën e cilësisë, përdorimin e teknologjive të reja, zhvillimin e produkteve postare, standardeve dhe detyrat tjera të mbështetjes për IB,

Ngarkon

- POC:

• për marrjen e kompetencës për të gjitha çështjet strategjike, operacionale dhe teknike në lidhje me aktivitetet e kooperativës Telematike;

• për paraqitjen e një raport për Kongresin e ardhshëm mbi përparimin e aktiviteteve telematike;

- Kooperativën Telematike me marrjen e kompetencave për zbatimin e strategjisë, aspektet operacionale, teknike dhe ekonomike të telematikës, duke i dhënë autoritetin për të bërë dhe ndryshuar rekomandimet e telematikës,

Ngarkon gjithashtu

- CA me mbikëqyrjen e financave të Kooperativës Telematike me anë të shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit të IB dhe llogarive vjetore;

- CA me paraqitjen e një raporti në Kongresin e ardhshëm mbi financimin e Kooperativës telematike;

- Kooperativën telematike për paraqitjen e një raporti vjetor për POC dhe CA;

- CA me marrëveshjet mbështetëse që do ti lejojnë Kooperativës Telematike për të financuar projekte të zhvillimit të tilla si posta, PREM (e-mail i regjistruar postar), etj,

Udhëzon

Byronë Ndërkombëtare:

• të mbajë Qendrën Postare Teknologjike si një provider i shërbimit me përgjegjësi për zbatimin e strategjive të miratuara nga Kongresi dhe nga Kooperativa Telematike në fushën e telematikës dhe teknologjisë;

• të vazhdojë të sigurojë mbështetje financiare për Kooperativën Telematike në përputhje me Rezolutën C 66/2004;

• të mbështesë zhvillimet politike dhe marrëveshjet e nevojshme për të mundësuar përdorimin e financimeve të jashtme të zhvillimeve në fushën e shërbimeve elektronike



- të sigurojë bashkëpunimin e duhur ndërmjet aktiviteteve të Kooperativës Telematike dhe proceset dhe programet e IB-së;
- të vazhdojë të promovojë aktivitetet e Kooperativës Telematike dhe të inkurajojë operatorët e caktuar për t'u bashkuar me të dhe për të kontribuar aktivisht në aktivitetet e saj,
- Kooperativën Telematike:
- të bashkëpunojë ngushtë me Byronë Ndërkombëtare në mënyrë që të bëjë më efikas përdorimin e burimeve dhe ekspertizës së disponueshme,

Fton

CA për të bashkë-financuar Kooperativën Telematike duke mbuluar kostot e Kooperativës Telematike të cilat janë të lidhura me aktivitetet në mbështetje të Byrosë Ndërkombëtare.

(Propozimi 44, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 54/2008 NUMRAT E FATURAVE SHOQËRUESE TË POSTËS AJRORE

Kongresi,

Duke përsëritur

konsideratat e tij dhe vullnetin e tij të shprehura në rezolutën C 33/2004,

i ndërgjegjshëm

se zhvillimet e teknologjisë së informacionit të kombinuara me procese të sakta operationale tani mundësojnë gjurmueshmërinë e pakove postare gjatë transportit të tyre ndërkombëtar nga nisja në mbërritje,

Duke theksuar

faktin që gjurmueshmëria pakove postare e gjatë transportit të tyre ndërkombëtar nga nisja në mbërritje është një faktor përcaktues në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe të sigurisë së dërgesave postare,

Duke vënë në dukje

- se Komiteti i Kontaktit IATA-UPU ka miratuar përdorimin e numrave të faturave shoqëruese të dërgesave ajrore të kombinuara me kodin e produktit duke mundësuar identifikimin e dërgesave postare dhe aplikimin e proceseve që janë specifike për to;

- se puna e Grupit IATA-UPU për çështjet EDI ka çuar në miratimin e standardit M39 për mesazhet EDI të shkëmbyera ndërmjet operatorëve të caktuar dhe midis këtyre operatorëve dhe transportuesve ajrorë nga Këshilli i Standardeve;

- se standardi M39 lejon shkëmbimin e numrave të faturave shoqëruese të dërgesave postare ndërmjet palëve të interesuara;

- se operatorët e caktuar të cilët kanë modifikuar sistemin e tyre CARDIT për të përfshirë numrin e faturës shoqëruese të dërgesave ajrore dhe kodin e produktit për të mundësuar identifikimin e dërgesave postare mund të marrin të dhënat përkatëse të gjurmimit mbi pikat e lartpërmendura nga linjat e fluturimeve në fjalë,

Duke vënë gjithashtu në dukje

- se përdorimi i numrave të faturave shoqëruese të dërgesave ajrore i kombinuar me kodin e produktit postar duke mundësuar identifikimin e dërgesave postare dhe aplikimin e proceseve që janë specifike për to është një element i dobishëm në ndërvëprimin e sistemeve të transportit ajror;

- se ai siguron gjurmueshmërinë e pandërprerë në rastet kur janë përdorur fluturimet të njëpasnjëshme të linjave të njëjtat fluturimit ose të linjave të ndryshme të fluturimit;

- se ai mundëson gjithashtu rezervimin e kapaciteteve me transportuesit ajror, duke kontribuar kështu në disponueshmërinë e qëndrueshme të kapacitetit të transportit që mundëson besueshmërinë e flukseve postare;

- se ai do të ndihmojë gjithashtu për të sjellë, në të ardhmen, transportin e dërgesave postare pa letër. Në përpjekje për të realizuar transportin e dërgesave postare pa letër në të ardhmen, është i domosdoshëm sigurimi i një regjistrimi të qartë për secilën dërgesë,

I bindur

- se përdorimi i numrave të faturave shoqëruese të dërgesave ajrore i kombinuar me kodin postar të produktit do të sjellë përfitime të plota vetëm në qoftë se të gjithë aktorët në zinxhirin ndërkombëtar të përpunimit të fluksit postar do të jenë në gjendje të përdorin këtë numër dhe këtë kod për të identifikuar

dërgesat postare si të tilla me qëllim që të zbatojnë proceset e kërkuara dhe nëse autoritetet e ndryshme të interesuara do të lehtësojnë këtë përdorim;

- se operatorët e caktuar, në kontaktet e tyre me autoritetet doganore dhe kufitare ose ndonjë agjenci tjetër, që marrin pjesë në zinxhirin e përpunimit postar në shtetet përkatëse, do të përfitojnë nga rezolutat e miratuara nga organizatat kryesore ndërkombëtare të përfshira në transportin ndërkombëtar ajror,

Miraton

rezultatet e punës së Komitetit të kontaktit IATA-UPU, të Grupit IATA-UPU mbi çështjet EDI dhe të Këshillit të Standardeve në lidhje me përdorimin e numrave të faturave shoqëruese të dërgesave ajrore të kombinuara me kodin e produktit postar,

Fton

operatorët e caktuar për të përdorur numrat e faturave shoqëruese të dërgesave ajrore të kombinuara me kodin postar të produktit me qëllim përmirësimin e gjurmueshmërisë së flukseve postare

U kërkon

Shteteve anëtare:

- të informojnë autoritetet e tyre përkatëse të përfshira në zinxhirin e përpunimit të fluksit postar për përdorimin e numrave të faturave shoqëruese të dërgesave ajrore të kombinuara me kodin postar të produktit dhe ti kërkojnë atyre të bëjnë rregullimet e nevojshme për të lehtësuar këtë përdorim;

- Të inkurajojnë organizatat ndërkombëtare, me mbulim rajonal apo botërore, në të cilën ata janë të përfshirë, të pranojnë përdorimin e numrave të faturave shoqëruese të dërgesave postare të kombinuara me kodin postar të produktit dhe të lehtësojnë këtë përdorim nga të gjithë operatorët e interesuar,

Udhëzon

- Këshillin e Operacioneve Postare:

- në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Kontaktit IATA-UPU dhe Komitetin e Kontaktit WCO – UPU, dhe me mbështetjen e Byrosë Ndërkombëtare, të ndërmarrë të gjitha diskutimet e nevojshme me Organizatën Botërore të Doganave (WCO), me synimin për të marrë nga kjo e fundit njohjen e përdorimit të numrit të faturave shoqëruese të dërgesave postare të kombinuara me kodin postar të produktit, dhe, sipas rastit, për praktikatat e zakonshme të identifikimit dhe përpunimit postar, pa shkaktuar ky përdorim ndonjë ndryshim në procedurat doganore në fuqi;

- në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Kontaktit IATA-UPU, dhe me mbështetjen e Byrosë Ndërkombëtare, të ndërmarrë të gjitha diskutimet e nevojshme me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), me synimin për të marrë nga kjo organizatë njohjen e përdorimit të numrit të faturës shoqëruese të dërgesave ajrore të kombinuara me kodin postar të produktit, dhe, sipas rastit, për praktikatat e zakonshme të identifikimit dhe të përpunimit të dërgesave postare, duke siguruar se ky përdorim nuk ndërhyjnë me statusin postar ligjor;

- Komitetin e Kontaktit IATA-UPU:

- në bashkëpunim të ngushtë me Byronë Ndërkombëtare, dhe në dritën e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar midis UPU dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA), të ndërmarrë të gjitha diskutimet e nevojshme me IATA-n, me qëllim shpërndarjen e informacionit në lidhje me numrin e faturave shoqëruese të dërgesave postare të kombinuara me kodin postar të produktit tek anëtarët e saj dhe duke promovuar përdorimin e tij prej tyre,

Vendos

se çdo ndryshim në Rregulloret e UPU lidhur me shkëmbimin e flukseve ndërkombëtare postare duhet të çojë në eliminimin gradual të përdorimit të dokumentacionit shkresor dhe të promovojë procedurat e bazuara në marrjen e të dhënave elektronike dhe të dhënave elektronike të shkëmbimit (EDI),

Si rrjedhim udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare të garantojë vënien në jetë të vendimit të sipërpërmendur.

(Propozimi 62. Rishikimi 1, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)



REKOMANDIM C 55/2008

ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE MË TË NGUSHTA ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE,
RAJONALE DHE KOMBËTARE PËR PROJEKTE TË BASHKËPUNIMIT PRAKTIK NË ZHVILLIMIN E
SEKTORIT POSTAR NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKACIONIT
(ICT)

Kongresi,

Duke miratuar

punën e bërë nga Grupi i Produkteve dhe Shërbimeve Elektronike të POC në studimin dhe analizimin në detaje të përfitimeve të zgjerimit të ofertës së produkteve postare nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe duke përgatitur një raport për Kongresin mbi aktivitetet e ardhshme që duhet të merren në konsideratë,

Duke vënë në dukje

progresin e bërë nga Grupi i Përdoruesve të avancuar të Shërbimeve Elektronike të Kooperativës Telematike në zhvillimin e mjeteve të reja të teknologjisë, duke përfshirë një sektor standard për komunikimin e sigurt në internet dhe një infrastrukturë elektronike për shërbime të vërtetuara postare, për të ndihmuar në modernizimin e operatorëve të caktuar,

Duke përshëndetur

përpjekjet e bëra nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare në përpjekjet e tilla si Prokurimi elektronik, Shëndeti elektronik dhe Pjesëmarrja elektronike, të cilat theksojnë rëndësinë e miratimit të teknologjive të reja për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sektorit postar,

Duke pasur parasysh

se nëse realizohet një bashkëpunim më i madh, shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar mund të përfitojnë nga zbatimi i programeve të veçanta nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare në fushën e teknologjive të reja, dhe të kenë një efekt më të madh në një shkallë më të gjerë për të gjitha shkëmbimet postare (letra, pako, shërbimet financiare, shërbimet postar digjital) midis shteteve anëtare,

Duke pranuar

burimet e kufizuara financiare dhe njerëzore në dispozicion të Bashkimit për projekte të specializuara digjitale postare,

duke pranuar gjithashtu

burimet të konsiderueshme njerëzore dhe financiare në dispozicion të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për zhvillimin dhe modernizimin e tregjeve postare,

Rekomandon

që organet e Bashkimit, me ndihmën e Byrosë Ndërkombëtare:

- të studiojnë mënyra për të përmirësuar bashkëpunimin me organizata të ndryshme, ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare, duke përfshirë krijimin e mundshëm të një lidhje të përhershme midis tyre dhe Bashkimit;

- të angazhohen në diskutime praktike mbi aktivitetet e bashkëpunimit për zhvillimin e tregut në fusha të shërbimeve elektronike që shihen si prioritet nga shtetet anëtare me organizata të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.

(Propozimi 90, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 56/2008
PËRDORIMI I ZGJERUAR I SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE (EDI)

Kongresi,
Duke pasur parasysh
se zhdoganimi i shpejtë i dërgesave postare është thelbësor për cilësinë e përgjithshme të shërbimeve ndërkombëtare postare,
Duke pasur parasysh
faktin se paraqitja paraprake e informacionit rreth dërgesave postare në formë elektronike tek autoritetet doganore për dërgesat mund të përshpejtojë në mënyrë të konsiderueshme zhdoganimin e dërgesave postare,
i ndërgjegjshëm
se mund të arrihen përmirësime të shërbimeve dhe efikasitetit nëse operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit transmetojnë të dhënat para marrjes ose dërgimit të sendeve për artikujt ndërkombëtarë postarë në hyrje dhe në dalje, për qëllime të zhdoganimit,
i ndërgjegjshëm
se qeveritë e shumë shteteve anëtare të Bashkimit janë duke liberalizuar tregjet e tyre postare, dhe si rezultat i kësaj mund të ketë diferenca midis procedurave të zhdoganimit për operatorët e caktuar dhe organizimet bashkëvepruese mund të kenë hetim në rritje,
Duke pranuar
se në tregjet e liberalizuara, operatorët e caktuar mund të gjejnë të favorshme të bashkëpunojnë dhe të përdorin shërbimet e sektorit të operatorëve tregtarë privatë për dorëzimin e dërgesave postare,
duke kuptuar
se përdorimi i zgjeruar i mesazheve EDI për ti transmetuar doganave të dhëna mbi pikat postare mund të krijojë kushtet në të cilat rregulloret e zhdoganimit të mallit zbatohen në mënyrë të njëjtë për dërgesat postare dhe për ngarkesa të ngjashme të kryera nga shoqëritë e sektorit privat të dërgimit,
duke vënë re
se zhvillimet e shpejta të teknologjisë në sektorin postar janë të duke ushtruar presion në rritje mbi operatorët e caktuar për të zbatuar transmetimin e të dhënave doganore për artikujt postarë ndërkombëtarë,
I bindur
se përdorimi në rritje i transmetimeve elektronike të informacionit doganor mbi dërgesat postare nga operatorët të caktuar tek autoritetet doganore, jo vetëm që mund të bëhet një mjet i vlefshëm për luftën kundër terrorizmit dhe kërcënimeve tjera të sigurisë dhe sigurinë e shkëmbimeve postare ndërkombëtare, por gjithashtu mund të përmirësojë operacionet, të ulë shpenzimet administrative dhe të lehtësojë procedurat e vlerësimit,
i ndërgjegjshëm
për bashkëpunimin e ngushtë mes Bashkimit Postar Universal dhe Organizatës Botërore të Doganave për të lidhur me importin dhe eksportin e postës me udhëzimet e përcaktuara në Kornizën e standardeve për të Siguruar dhe Lehtësuar Tregtinë Globale,
i kënaqur
të theksojë se Këshilli i Operacioneve Postare, nëpërmjet punës së Kooperativës EMS, Grupit të Kolve, Kooperativës Telematike dhe Grupit të Veprimit të Sigurisë Postare, ka zhvilluar, vendosur dhe promovuar kërkesat dhe veprimet për të zgjeruar transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me shkëmbimet ndërkombëtare të postës,
Duke kuptuar
se operatorët e caktuar kanë nivele të pabarabarta të burimeve, ekspertizës, hardware, dhe fuqisë punëtore në lidhje me zbatimin e proceseve doganore elektronike
i ndërgjegjshëm gjithashtu
për misionin e UPU "për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, afatgjatë të shërbimeve cilësore postare universale efikase dhe të arritshme, në mënyrë që të lehtësojë komunikimin midis banorëve të botës",
i ndërgjegjshëm gjithashtu
për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë në funksion të reputacionit hershëm të Postës si mbrojtës të integritetit të dërgesave,
Udhëzon
Këshillin e Operacioneve Postare:



- të zhvillojë dhe mbajë standarde në përputhje me praktikën më të mira dhe detyrimet e fshehtësisë ose legjislacionit kombëtar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe sekretit postar për Mesazhet EDI UPU - Doganë, me anë të Këshillit të Standardeve, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Doganave,
- të nxisë, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Doganave, përdorimin e transmetimeve EDI ndërmjet operatorëve të caktuar dhe nga operatorët e caktuar për autoritetet lokale doganore për zhdoganimin e dërgesave postare,
- të hartojë një plan që përfshin grupet përkatëse POC dhe në konsultim me Komitetin e Kontaktit UPU-WCO për zbatimin e transmetimit të mesazheve doganore EDI mbi dërgesat postare në mënyrë me faza, që do të përcaktohet pas një studimi të përshtatshëm, duke përfshirë produktet identifikuese, llojet e postës që ndikohen, aftësitë e klientëve dhe operatorëve, ndikimet operacionale dhe matjet e performancës.

(Propozimi 91, Komiteti 7, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 57/2008

KOMITETI KËSHILLIMOR – PËRMIRËSIMI I INTEGRIMIT TË ANËTARËVE TË CC DHE PËRFORCIMI I ROLIT TË TYRE NË VEPRIMTARITË E UPU

- Kongresi,
Duke kujtuar
se Kongresi e Bukureshtit krijoi Komitetin Këshillimor me qëllim të pajisjes së UPU-t me një kornizë për dialog efektiv midis palëve të interesuara,
Duke vënë në dukje
se Komiteti Këshillimor ka dhënë një kontribut të shquar në fusha të ndryshme të aktiviteteve të UPU - rregullatore, operacionale, teknike dhe strategjike,
Duke pranuar
se ekziston një vullnet i fortë i anëtarëve të CC për të marrë pjesë dhe kontribuar në punën e UPU-t, duke kontribuar kështu në arritjen e qëllimeve dhe misionit të UPU-t,
I bindur
se UPU, si një e tërë, do të përfitojnë nga pjesëmarrja e rritur nga përfaqësues nga sektori postar më i gjerë,
I bindur gjithashtu
se do të ishte e dobishme për UPU të përforconte konceptin e partneritetit publik / privat në kuadër të aktiviteteve të Bashkimit,
Duke pranuar
nevojën për të përmirësuar integrimin e anëtarëve të CC dhe forcimin e mëtejshëm të rolit të tyre në të gjitha aktivitetet UPU,
Duke pasur parasysh
rezultatet e studimeve mbi reformën e UPU-t, veçanërisht në lidhje me Komitetin Këshillimor, të kryera nga Grupi i Projektit të Bashkimit për Strukturën dhe Mbështetjen dhe Komitetin 1 të CA-së, me mbështetjen e Zyrës Ndërkombëtare,
Udhëzon
Këshillin Drejtues, në bashkëpunim me Komitetin Këshillimor dhe me mbështetjen e Këshillit të Operacioneve Postare dhe Byrosë Ndërkombëtare:
– të studiojë mënyra për të forcuar rolin dhe kontributin e Komitetit Këshillimor në Aktivitetet e UPU, veçanërisht në lidhje me çështjet e mëposhtme:
a) të zgjerojë më tej anëtarësimin në CC, me qëllim për të lejuar një përfaqësim më të gjerë në të gjithë sektorin postar dhe përfaqësim më të mirë gjeografik të mbarë botës;
b) të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e të tre anëtarëve që përfaqësojnë secili nga Këshillat (CA, POC), në lidhje me CC dhe Këshillin që ata përfaqësojnë;
c) të inkurajojë kontributet vullnetare shtesë nga anëtarët e CC, në natyrë ose financiare, për kryerjen e një projekti ose studimi të veçantë;
d) të rrisë më tej nivelin e kontributeve financiare të anëtarëve të CC-së në buxhetin e UPU-t;

e) të krijojë një sistem të koordinimit midis CC-së dhe Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare, me mbështetjen e Byrosë Ndërkombëtare, i cili promovon dhe forcon pjesëmarrjen e anëtarëve të CC-së në të gjitha aktivitetet e UPU-t, veçanërisht në fillim të një cikli të ri,

- të formulojnë propozime të bazuara në rezultatet e studimit për ti paraqitur në Kongresin e ardhshëm dhe

- të vendosë në funksion, kur e nevojshme dhe e mundur, disa masa para Kongresit të ardhshëm.

(Propozimi 19. Rishikimi 1, Komiteti 3, mbledhja e 6-të)

REZOLUTA C 58/2008

LLOGARI POSTARE – ZGJIDHJA E DEBIVE TË SHPESHTA OSE TË ZGJATURA

Kongresi,

duke kuptuar

se operatorët e caktuar dërgues të shteteve anëtare të UPU-t kanë shpenzime të rënda në kryerjen e detyrimeve të tyre sipas Akteve të UPU-t për të përpunuar, transportuar dhe dërguar artikujt e postës së letrave dhe koltitë postare në hyrje, si dhe llojet e tjera të dërgesave postare që ata të marrin (të tilla si EMS),

Duke pranuar

se dispozita të veçanta të Konventës së UPU-t, Rregullores së Postës së Letrave dhe Rregullores së Kolipostës përmbajnë urdhra të detyrueshme në lidhje me, për shembull, shumat për t'u paguar nga operatori i caktuar dërgues ndaj operatorit të caktuar marrës për dërgesat postare të marra, si dhe përgatitjen dhe shlyerjen përkatëse të llogarive postare,

Duke vënë në dukje

se Rregullorja e Postës së Letrave dhe Rregullorja e Kolipostës të UPU-t përmbajnë dispozita që lidhen me interesin që duhet paguar nga ana operatorit të caktuar dërgues (debitori) tek operatori i caktuar dorëzues (kreditore) në rastet e pagesave të vonuara në lidhje me ato llogari postare,

duke kuptuar gjithashtu

se, pavarësisht këtyre dispozitave që lidhen me interesin e pagueshëm, ka një situatë të vazhdueshme debiti, në të cilën shumë operatorë të caktuar debitorë kanë debi të konsiderueshme me shumë operatorë të caktuar kreditorë, me shumë llogari në vonesë për një apo dy vjet dhe shpesh për periudha më të gjata,

i shqetësuar

se aktualisht nuk ka mjete ligjore të përshkruara në Aktet e UPU-t për ti mundësuar operatorët e caktuar kreditorë të marrin masa efektive për të siguruar që operatorët e caktuar debitorë të likuadojnë plotësisht debitë e pashlyera, nëse do të jetë e nevojshme, nëpërmjet një plani të pagesës të pranueshëm për operatorin e caktuar kreditor në fjalë,

i ndërgjegjshëm

megjithatë, se në shumë nga programet e tij, UPU merr parasysh shtete të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose në situata të veçanta,

Udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare të ndërmarrë sa më shpejtë një studim të kësaj situatë me qëllim që:

- të dokumentojë dhe vlerësojë situatën aktuale të përgjithshme në lidhje me debitë në llogaritë postare ndërmjet operatorëve të caktuar të shteteve anëtare të UPU-t për sa i përket artikujve postarë të shkëmbyer midis tyre në zbatim të Akteve të UPU-t (sidomos artikujt e postës së letrave dhe kolipostës, por edhe artikujt të tjerë të tillë si EMS);

- të identifikojë dhe rekomandojë, sipas kërkesës, ndryshime në Rregulloren e Postës së Letrave dhe në Rregulloren e Kolipostës të UPU-t, të cilat do të krijojnë një mekanizëm për ti mundësuar operatorëve të caktuar kreditorë të ndërmarrin veprime të rëndësishme dhe në kohën e duhur për të marrë shumat në vonesë (duke përfshirë edhe interesin e zbatueshëm);

- të shqyrtojë nevojën për të siguruar një mekanizëm bashkëveprues me anë të të cilit operatori i caktuar kreditor, në raste të tilla, ti japë Byrosë Ndërkombëtare të UPU prova të debisë dhe një kopje të njoftimit që operatori i caktuar kreditor ka dërguar për tek operatori postar debitori lidhur me veprimin që do të ndërmarrë;



- Vë në fuqi, sa më shpejt të jetë e mundur pas miratimit të tyre nga Këshilli pas përfundimit të studimit, ndryshimet e rekomanduara që janë brenda objektit të përgjegjësisë të Këshillit, në mënyrën që ai gjykon të jetë më e përshtatshme;

- të hartojë, nëse është e aplikueshme, një ose më shumë propozime që rrjedhin nga ky studim për Kongresin, për tu paraqitur në Kongresin Postar Universal të vitit 2012;

- të sigurojë megjithatë se janë marrë në konsideratë, në një mënyrën e përcaktuar gjatë studimit, shtetet e prekura nga fatkeqësitë natyrore ose në situata të veçanta që nuk janë në pozicionin për të shlyer menjëherë debitë e tyre financiare në lidhje me llogaritë postare,

gjithashtu udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare të përcaktojë mënyrën më efektive për kryerjen e studimit të propozuar dhe cili grup apo organ do të jetë i ngarkuar me drejtimin e punës,

fton

Këshillin Drejtues të marrë në konsideratë, nëse e zbatueshme, rekomandimet e mundshme që rezultojnë nga ky studim i Këshillit të Operacioneve Postare që janë në përgjegjësinë e tij.

(Propozimi 74, Komiteti 5, mbledhja e 5-të)

REZOLUTA C 59/2008

BËRJA MË E QARTË E SHPREHJES SË REZERVAVE

Kongresi,

Duke marrë parasysh

se paqartësitë në tekstin e rezervave mund të shkaktojnë keqkuptime,

i ndërgjegjshëm

për rëndësinë e parandalimit të ndonjë anësie në interpretimin e Akteve dhe protokolleve përkatëse,

fton

të gjitha shtetet anëtare të UPU-t të përdorin formulim të qartë të teksteve të rezervave të tyre për Aktet e ndryshme të Bashkimit.

(Propozimi 76, Komiteti i 4, mbledhja e 5-të)

REKOMANDIM C 60/2008

MANGËSIA E DOKUMENTACIONIT NË DORËZIMIN E POSTËS AJRORE DHE DËRGESAVE S.A.L.

Kongresi,

Duke vënë në dukje

se gjithmonë e më shpesh dërgesat në hyrje nuk janë të shoqëruara nga formularët CN 37, CN 38 dhe CN 41,

duke vënë gjithashtu në dukje

se duhet të realizohen një numër i madh i shënimeve verifikimit si rrjedhojë e formularëve të zhdukur,

duke vënë gjithashtu në dukje

se duhet të përgatiten faturat zëvendësuese të dërgimit, dhe më pas të miratohen dhe nënshkruhen nga linjat e fluturimit dhe se aktualisht është e vështirë të monitorohet se çfarë është dërguar realisht. Si rezultat i këtij fakti shpesh janë humbur dhe / ose janë dërguar gabim thasët. Kjo situatë krijon pasiguri dhe gjeneron shpenzime në drejtim të njerëzve – orëve të punës dhe materialeve operacionale,

Duke pasur parasysh

se neni RL 190 i Rregullores së Postës së Letrave dhe neni RC 178 të Rregullores së Kolipostës kanë dispozita të qarta për formën e dorëzimit të njoftimeve dhe gjenerimin e numrit të duhur të kopjeve të formularëve përkatës,

gjithashtu duke pasur parasysh

se disa operatorë të caktuar nuk po i përmbushin këto nene,

Rekomandon

Që tu kërkohet shteteve të përmbushin dispozitat ekzistuese dhe të ndërmarrin hapat e nevojshme për të korrigjuar situatën në lidhje me dërgesat në hyrje.

(Propozimi 77, Komiteti 4, mbledhja e 5-të)

REKOMANDIM C 61/2008
KËSHILLI DREJTUES DHE KËSHILLI I OPERACIONEVE POSTARE – STRUKTURAT E
KOMITETEVE

Kongresi,

Me synimin

për të përmirësuar më tej cilësinë dhe efikasitetin e punës së Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare, pas Kongresit të vitit 2008,

Duke vënë në dukje

se ka pasur një konsensus të përgjithshëm në ciklin e fundit që struktura POC ishte shumë e rëndë që POC të organizojë punën e tij në një mënyrë efikase,

Duke pasur parasysh

nevojën për të zvogëluar numrin e organeve të POC dhe të bëjë më efikas procesin e vendimmarrjes së Këshillave dhe shpërndarjen më të ekuilibruar të punës ndërmjet Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare, duke marrë parasysh natyrën e punës,

duke pasur gjithashtu parasysh

nevojën për aktivitetet e planifikimit strategjik që do të kryhen nën kompetencat e Këshillit Drejtues, me anë të krijimit të një Komiteti të përbashkët të CA dhe POC nën strukturën e CA,

Duke vlerësuar

punën e kryer nga struktura dhe Grupi i Projektit të Bashkimit për Strukturën dhe Mbështetjes dhe Komitetit 1 të Këshillit Drejtues për sa i përket reformës së vazhdueshme të Bashkimit,


fton

Këshillin Drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare në mbledhjet e tyre përkatëse themeluese të marrin në konsideratë KONGRES-Dok 11, për atë që ata e gjykojnë të arsyeshme, dhe të përputhen me pikëpamjet e Këshillave të përcaktuara në Aneksin 1 të këtij dokumenti në lidhje me përbërjen dhe funksionet e Komisioneve.

(Propozimi 54, Komiteti 3, mbledhja e 6-të)




STRUKTURA E KOMITETEVE



STRUKTURA E KOMITETEVE

Struktura e Komiteteve





REKOMANDIM C 62/2008
PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSIVE BRENDA KËSHILLIT DREJTUES DHE KËSHILLIT
TË OPERACIONEVE POSTARE – KODI I SJELLJES

Kongresi,
Duke pranuar
nevojën për të krijuar një kod sjelljeje për ndarjen e përgjegjësive brenda Këshillave, i cili do tu mundësojë kandidatëve më në gjendje për të kryer funksione të ndryshme në kuadër të organeve të Këshillave të zgjidhen, në një mënyrë transparente dhe të barabartë, nga radhët e anëtarëve të zgjedhur këtyre Këshillave,
Duke konfirmuar
se i takon çdo Këshilli të ri të organizojë punën e tij, të hartojë Rregullat e veta të Procedurës dhe më pas të miratojë strukturën e vet,
Rekomandon
Që Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare të ndjekin parimet vijuese të vendosura për ndarjen e përgjegjësive brenda Këshillave.

(Propozimi 92, Komiteti 3, mbledhja e 6-të)

ANEKSI 1
PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSIVE BRENDA KËSHILLIT DREJTUES DHE KËSHILLIT
TË OPERACIONEVE POSTARE – KODI I SJELLJES

Krijimi i Komitetit ad hoc

1. Misioni i Komitetit do të jetë të shqyrtojë kandidaturat për zëvendës kryesinë së CA, dhe Kryetarin ose zëvendëskryetarët e Komiteteve dhe/ose Grupeve të Projektit të këshillave, si dhe të paraqesë një rekomandim mbi këtë temë në CA dhe POC përkatësisht në mbledhjet e tyre themeluese.

Përbërja e komisionit ad hoc

2. Komiteti do të përbëhet nga:

- Drejtorët e Përgjithshëm the IB në hyrje dhe në ikje, me një rol këshillues;
- Kryetarët në hyrje dhe në dalje të CA dhe POC;
- nga çdo Këshill, pesë përfaqësues, një për secili grup gjeografik.

Komiteti do të zgjedhë Kryetarin e tij nga radhët e anëtarëve të tij

3. Komiteti *ad hoc* do të ndihmohet në punën e tij nga Sekretariati Ndërkombëtar. Ai, në qoftë se e konsideron të nevojshme, mund të ftojë Kryetarin e Komitetit Këshillimor për të marrë pjesë si vëzhgues.

Procesi i përzgjedhjes

4. Të gjitha shteteve anëtare të zgjedhura në CA dhe POC do ti dërgohet, brenda një kohë të caktuar, një thirrje për kandidaturat dhe një formular duke u kërkuar atyre që të japin informacionin e mëposhtëm:

- Fushat prioritare në të cilat vendi anëtar dëshiron të punojë;
- Angazhimet që mund të marrë shteti anëtar në mënyrë që të kryejë përgjegjësitë në fjalë;
- Burimet logjistike apo njerëzore mbështetëse që do të sigurojë në mënyrë që të realizojë përgjegjësitë.

5. Në dokumentin e thirrjes për kandidatët, do të jenë vendosur përgjegjësitë që do të ketë Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Komitetit ose i Grupit të projektit. Do të vendoset një afat për kthimin e formularëve në Sekretariat.

6. Do të shqyrtohen kandidaturat e marra.

7. Kryetari dhe Zëvendës kryetari i CA dhe Komisionet e POC dhe grupet e punës do të përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme, të cilat duhet të zbatohen me fleksibilitet në mënyrë që të ofrojnë inkurajim për ato shtete anëtare që dëshirojnë të investojnë në kryesinë e Komitetit të apo Grupi i projektit. Kriteret nuk të jenë kumulative:

- Kapacitetet e burimeve logjistike dhe njerëzore të shtetit anëtar kandidat për përgjegjësinë e dhënë;
- Përvoja në bazë të përgjegjësive të mëparshme të marra në shtetin anëtar, rajon ose Bashkim. Kjo përvojë do të bazohet në veçanti në një sistem të vlerësimit nga rezultatet e projekteve të menaxhuara dhe në

nivelin e frekuencimit të rregullt të mbledhjeve gjatë ciklit të mëparshëm. Ky kriter nuk do të zbatohet në mënyrë të tillë që të diskriminojë një shtet që dëshiron të investojë në një kryesi ose zëvendës-kryesi të Komiteteve ose Grupeve të Projektit për herë të parë;

- shpërndarja e barabartë gjeografike midis shteteve të industrializuara dhe atyre në zhvillim, të lidhura në nivelin e zhvillimit ekonomik. Kjo shpërndarje duhet të bazohet në parimet që zbatohen në kuadër të Këshillit të Operacioneve Postare;

- Ndarja e barabartë të funksioneve ndërmjet Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare;

- Rezultatet e zgjedhjeve të anëtarësimit të Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare.

8. Në parim, Komiteti duhet të paraqesë vetëm një kandidat të vetëm për çdo post, i cili do të caktohet me konsensus.

- Kur është paraqitur më shumë se një shtet anëtar për një post, do të mbahen zgjedhjet për të përzgjedhur shtetin anëtar për atë post.

- Një shtet anëtar, kandidatura e të cilit për një post nuk është miratuar nga Komiteti, ka të drejtë të paraqesë dhe të mbrojë atë kandidaturën para se Këshillit të interesuar. Në këtë rast, do të mbahen zgjedhje.

REZOLUTA C 63/2008

ZYRAT EKSTRA TERRITORIALE TË SHKËMBIMIT (ETOE) DHE QENDRAT NDËRKOMBËTARE TË PROCESIMIT TË POSTËS (IMPC)

Kongresi,

Duke vënë në dukje

efektin stabilizues të Rezolutës C 44/2004 të Kongresit të Bukureshtit mbi rritjen e ETOE dhe numrin e shteteve në të cilat ato operojnë, kryesisht për shkak të:

- kërkesës që shteti anëtar i UPU-t në të cilin është vendosur një ETOE duhet të japë marrëveshjen e tij për krijimin e një ETOE, në përputhje me politikën e tij kombëtare;

- dhënien e një zgjedhje shtetit anëtar të destinacionit të UPU-t në përcaktimin se si të trajtojë artikujt e marrë nga një ETOE, në përputhje me politikën e tij kombëtare;

- kërkesat më të mira të njoftim për regjistrimin në UPU si një qendër e përpunimit të postës ndërkombëtare (IMPC);

- rekomandimin që shtetet anëtare të UPU të shpallin politikat e tyre në lidhje me ETOE, dhe publikimin e mëvonshëm të këtyre politikave nga Byroja Ndërkombëtare,

Duke pasur parasysh

Nenin 2 i Konventës, të miratuar në Kongresin e Bukureshtit, e cila u kërkon shteteve anëtare të UPU-t të njoftojnë subjektin ose subjektet (njësitë qeveritare dhe operatorët e caktuar) përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Aktet e Bashkimit në territorin e tyre,

Duke pranuar

se politikat kombëtare të shteteve anëtare të UPU mund të ndryshojnë në çështjen e ETOE,

Duke vënë në dukje edhe

se qendrat e përpunimit të postës ndërkombëtare (IMPC) janë regjistruar në shoqëri private,

duke pasur gjithashtu parasysh

se UPU është përpjekur të arrijë përputhshmërinë midis Akteve e Bashkimit dhe disiplinave të WTO të tilla si statusi të kombit më të favorizuar, mos diskriminimi dhe e drejta e barabartë e hyrjes,

i ndërgjegjshëm

për faktin se ka ende shqetësime legjitime operative në lidhje me trajtimin e sendeve të marra nga ETOE dhe IMPC të regjistruara në shoqëri private në fushat e:

- aplikimit të procedurave të UPU-t dhe formularët për doganat dhe linjat e fluturimit;

- çështjet e sigurisë në lidhje me identitetin e dërguesit të vërtetë të postës;

- kthimin e shënimeve të verifikimit;

- artikujt e padorëzueshëm;

- mungesa e informacionit operativ dhe kontakti për shtetin e destinacionit;

- shpërblimi i saktë për dorëzimin e sendeve të marra

Duke marrë parasysh

se formularët e UPU-t janë elementë themelorë të Akteve të UPU-t,

Duke pasur parasysh



punën tashmë të nisur nga POC (Këshilli i standardeve) për të shqyrtuar standardet teknike të tilla si S10, e S34 dhe S35, me qëllim për të lehtësuar identifikimin e operatorëve dërgues, vendos

i) se operatori i caktuar nga një vend anëtar UPU sipas nenit 2 të Konventës mund të vazhdojë të kërkojë regjistrimin e IMPC të krijuar për qëllimet e veta dhe në territorin e tij kombëtar;

ii) se njësia qeveritare të shtetit anëtar të UPU e dhënë në nenin 2 të Konventës do të bëjë kërkesën e regjistrimit ose do të japë autorizim me shkrim për të gjitha IMPC e tjera që do të vendosen në territorin e saj;

iii) të vazhdojë pezullimin e kërkesave për regjistrimin e IMPC të shoqërive private, duke dhënë në Këshillin Drejtues një vendim për këtë çështje dhe rezultatin e studimit të saj,

fton

Shtetet anëtare të UPU

- Të shqyrtojnë dhe të njoftojnë Byronë Ndërkombëtare për politikën e tyre kombëtare për ETOE dhe IMPC të regjistruar për shoqëritë private, duke marrë në konsideratë politikën e tjera kombëtare dhe nevojën për të përdorur standarde dhe procedura të miratuara;

- Të respektojnë kushtet e parashtuara në rezolutën C 44/2004;

- të respektojnë politikën kombëtare të përcaktuara nga anëtarët e tjerë të UPU-t,

Udhëzon

Këshillin Drejtues, në konsultim me Këshillin e Operacioneve Postare, të realizojë një studim të ETOE dhe IMPC, për të përfshirë organizimin e tregjeve të brendshme postare dhe efektin e politikave kombëtare ose rajonale të UPU dhe të Akteve të UPU-t (Konventa, Rregullore, formularë të UPU, duke përfshirë edhe implikimet e një deklarate të operatorëve të shumëfishta nëpërmjet nenit 2 të Konventës dhe regjistrimin e IMPCs të shoqërive private), si dhe marrëveshje të tjera të arritura në nivelin UPU (Linjat e fluturimit dhe trajtimi doganor, matja e cilësisë së shërbimit në mbarë botën, Fondi i Cilësisë së Shërbimit, etj),

gjithashtu udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare:

- të studiojë dhe korrigjojë, apo rekomandojnë korrigjimin e, kërkesave informative në standardin S34 dhe formularët shkresorë të UPU-t në mënyrë të tillë që origjina dhe operatori i dërgesës të jenë qartësisht të identifikueshëm për operatorin e destinacionit, si dhe linjat ajrore dhe Autoritetet doganore që përpunojnë dërgesat, në mënyrë që të sjellë kërkesat e informacionit për ETOE dhe IMPC të regjistruara në shoqëritë private, në përputhje me kërkesat e zyrave të tjera të shkëmbimit të themeluara nga operatorët e caktuar të UPU-t;

- të studiojë çështjet operacionale të përfshira në një situatë ku më shumë se një operator i të njëjtit shtet dërgon ose pranon artikuj ndërkombëtarë, duke përfshirë ndikimin në strukturën e barkorit, në sistemet e gjurmimit dhe gjetjes, në sistemet e matjes së cilësisë, etj;

- të shqyrtojë politikën aktuale dhe të bëjë rekomandime për referenca e standardeve teknike në Rregulloret e UPU-t,

Udhëzon gjithashtu

Byronë Ndërkombëtare, në bashkëpunim me POC:

- të menaxhojë procesin e regjistrimit, të mbajë dhe të publikojë listat e IMPC aktive, sipas llojit dhe vendit, dhe ti bëjnë ato menjëherë të disponueshme dhe të arritshme; kjo do të përfshijë IMPC:

• e regjistruara nga operatorët e caktuar për të përmbushur Aktet e Bashkimit, për qëllimet e tyre dhe në territorin e tyre;

• të regjistruara si ETOE;

• të regjistruara si IMPC nga shoqëritë private;

• të regjistruar si IMPC ushtarake;

- të mbledhë dhe të ndajë me shtetet e tjera anëtare dhe operatorët e caktuar:

• informacion mbi politikën e shteteve anëtare të UPU (subjekte të njoftuara sipas nenit 2 të Konventës, politikën dhe kushtet për vendosjen e ETOE në territorin e tyre dhe për marrjen e artikujve ETOE, etj);

• informacione operative mbi ETOE dhe IMPC të regjistruara në shoqëritë private.

(Propozimi 23, Komiteti 3, mbledhja e 7-të)

REZOLUTA C 64/2008
BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E STATISTIKAVE POSTARE

Kongresi,
Duke marrë parasysh
se Bashkimi Postar Universal (UPU), si agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara që ka të bëjë me fushën postare, është përgjegjës për marrjen e informatave përkatëse dhe analizave mbi zhvillimin e sektorit në dispozicion të anëtarëve të saj,
Duke vënë në dukje
roli i UPU si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara e kualifikuar për të mbledhur, analizuar, publikuar, harmonizuar dhe përmirësuar statistikat postare,
i ndërgjegjshëm
se statistikat postare të publikuara nga Byroja Ndërkombëtare përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm pune për shtetet anëtare, dhe duhet t'u përgjigjen pritshmërive dhe nevojave të informimit të të gjithë lojtarëve të sektorit postar,
Duke pasur parasysh
rëndësinë e të dhënave statistikore që janë të besueshme, të qëndrueshme dhe relevante për studimet makro-ekonomike të kryera nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, si dhe për zbatimin e metodologjisë për klasifikimin e shteteve dhe territoreve për pjesëmarrje në sistemin objektiv të detyrimeve përfundimtare dhe në Fondin e Cilësisë së Shërbimit,
i ndërgjegjshëm gjithashtu
për nevojën për të garantuar konfidencialitetin e informatave të dhëna nëse shtetet anëtare e dëshirojnë këtë,
inkurajon
Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar për ti japin Byrosë Ndërkombëtare:
- të dhëna statistikore të besueshme, të qëndrueshme dhe të përshtatshme, dhe veçanërisht të dhëna në lidhje me:
a) infrastrukturën postar,
b) vëllime e postës së letrave, kolive postare dhe artikujve ekspres,
- të dhëna statistikore që janë të besueshme, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për klasifikimin e shteteve për qëllimet e sistemit të detyrimeve përfundimtare dhe Fondit të Cilësisë së Shërbimit;
- informacione të tjera statistikore të nevojshme për studimet makro-ekonomike të kryera brenda Këshilli Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare,
I bën thirrje
shoqatave të cilat janë pjesë e sektorit postar, dhe në veçanti anëtarëve të Komitetit Këshillimor, që japin të dhëna të besueshme, të qëndrueshme dhe të përshtatshme që lidhen me infrastrukturën e përdorur dhe vëllimet e veprimtarisë së anëtarëve të tyre, në mënyrë që treguesit për sektorin në tërësi të mund të vendosen në nivel botëror,
Udhëzon
Byronë Ndërkombëtare:
- Të publikojë vjetarin *Postal Statistics* në bazë të informacionit të dhënë nga shtetet anëtare, autoritetet rregullatore, operatorët e caktuar dhe shoqatat e sektorit privat;
- Të organizojë përpunimin e të dhënave të papërpunuara në bazë të parimeve themelore të statistikave zyrtare, dhe për të kufizuar të drejtën e hyrjes në të dhënat e papërpunuara tek personat e ngarkuar nga Byroja Ndërkombëtare me përpunimin e të dhënave;
- të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në qoftë se shtetet anëtare e dëshirojnë këtë. Kur kërkohet përpunimi konfidencial, të dhënat e transmetuara duhet të përdoren vetëm për të llogaritur totalët e nevojshme për analizën e situatës në mbarë botën dhe në nivel rajonal dhe nuk do të publikohet individualisht në asnjë rast;
- të kontribuojë në krijimin dhe përmirësimin e një përmbledhje të statistikave;
- të vazhdojë aktivitetet e trajnimit në fushën e statistikave postare me qëllim përmirësimin e disponueshmërisë, cilësisë, dhe besueshmërisë së informacionit statistikor.

(Propozimi 26, Komiteti 3, mbledhja e 7-të)



REZOLUTA C 65/2008
NDIKIMI I TEKNOLOGJIVE TË REJA MBI AKTIVITETET E BASHKIMIT

Kongresi,
Duke pasur parasysh
raportet mbi punën e Këshillit Drejtues dhe Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me të dhënat postare elektronike dhe sistemet e ndryshme të menaxhimit të të dhënave postare elektronike të futura brenda kuadrit të aktiviteteve të UPU-t,
Duke pasur parasysh
ndikimin e teknologjive të reja mbi aktivitetet e UPU-t, shteteve të saj anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, dhe në hierarkinë ligjore të Akteve dhe vendimeve të UPU-t,
Duke vënë në dukje
se zbatimi i një sistemi të menaxhimit të të dhënave postare elektronike mund të përfshijë:

- përdorimin e mjeteve të veçanta teknologjike për transmetimin e të dhënave nga operatorët e caktuar dhe mbrojtjen e këtyre të dhënave;
- të drejtën e hyrjes së operatorëve të caktuar në një bazë të dhënash të përbashkët dhe mbrojtjen e të dhënave të regjistruara në atë bazë të dhënash,
- përfundimi i marrëveshjeve specifike midis operatorëve të caktuar dhe zhvillimin e një udhëzuesi operativ për çdo sistem;
- menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kësaj baze të dhënash të përbashkët,
- përgatitjen e raporteve të bazuara mbi këtë bazë të dhënash dhe dorëzimin e këtyre raporteve në Organet e UPU-t dhe operatorët e caktuar në fjalë;
- krijimin e një strukture operacionale të menaxhimit për çdo sistem,

Duke kujtuar
nevojën për të vepruar në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik në Aktet dhe vendimet e UPU-t,

Duke pranuar
nevojën për të harmonizuar rregulloren në lidhje me të dhënat elektronike postare në Akte,
Duke vënë në dukje edhe
se këto sisteme, të paraqitura në kuadër të aktiviteteve të UPU-t, duhet të respektojnë parimet themeluese të UPU-t, dhe në veçanti të jenë të arritshme për të gjithë operatorët e caktuar të shteteve anëtare të UPU-t, pa diskriminim,

Duke pranuar edhe
se menaxhimi dhe mirëmbajtja e këtyre sistemeve duhet të jetë në përputhje me vendimet e UPU-t,

Duke pranuar
se janë të nevojshme dy lloje marrëveshjeje, që përmbajnë thjesht dispozita operacionale dhe teknike, për çdo sistem të futur në kuadër të aktiviteteve të UPU-t, domethënë një konventë të shërbimit jo specifik për mjetin që do të përdoret dhe një marrëveshje specifike EDI për mjetin që do të përdoret,

Duke theksuar
nevojën për të siguruar që këto konventa të shërbimeve dhe marrëveshjeve EDI të jenë në përputhje me aktet e Bashkimit në lidhje me këto sisteme,
duke pranuar gjithashtu
se kjo pajtueshmëri mund të jetë e garantuar nga miratimi e konventës së shërbimeve dhe marrëveshjes EDI nga UPU, apo edhe futja e procesit të certifikimit dhe auditimit nga UPU,

Duke pranuar
diversitetin e strukturave menaxhuese operacionale që lidhen me sistemet e menaxhimit të të dhënave postare elektronike në kuadër të aktiviteteve të UPU-t, dhe i rregullave të tyre të procedurës,
duke vënë gjithashtu në dukje
që aktivitetet e Sekretariatit të lidhura me menaxhimin operacional të këtyre sistemeve janë detyrat e reja në kuadër të UPU,

duke pranuar gjithashtu
që këto zhvillime të reja ka mundësi që të kenë një ndikim në strukturën dhe funksionimin e organeve të përhershme të UPU-t,

Udhëzon

- Këshilli Drejtues:

- të studiojë:

- çështjet e qeverisjes në lidhje me sistemet e menaxhimit të të dhënave postare elektronike të futura në aktivitetet e UPU-t dhe për mbrojtjen e të dhënave;

- ndikimin e këtyre çështjeve në Akte, në strukturat e UPU-t dhe në financimin e aktiviteteve të UPU-t;

- të vendosë parimet që duhet të merren në konsideratë nga Këshilli i Operacioneve Postare në punën që ai kryen në përputhje me këtë rezolutë;

- të raportojë në kongresin e ardhshëm mbi këto çështje,

- Këshillin e Operacioneve Postare:

- të studiojë, duke pasur parasysh parimet e miratuara nga Këshilli Drejtues:

- çështjet operative, teknike dhe ekonomike të lidhura me transmetimin e të dhënave dhe me sistemet e menaxhimit të të dhënave postare elektronike të futura në aktivitetet e UPU-t;

- formalizimin, harmonizimin dhe standardizimin e rregullave të procedurës të organeve përgjegjëse për menaxhimin e këtyre sistemeve.

(Propozimi 22, Komiteti 3, mbledhja e 7-të)

VENDIMI C 66/2008

STUDIMI I ASPEKTEVE LIGJORE DHE ORGANIZATIVE NË LIDHJE ME VEPRIMTARITË EKSTRA BUXHETORE TË BASHKIMIT

Kongresi,

Duke pranuar

Kontributet e mëdha të aktiviteteve jashtëbuxhetore të UPU-t në arritjen e misionit, objektivave dhe strategjisë së UPU-së,

duke njohur gjithashtu

Nevojën për një studim të thelluar mbi aspektet ligjore dhe organizative që lidhen me aktivitetet jashtë-buxhetore të Bashkimit,

Vendos

ti referohet propozimeve 15.131.91. rishikimi 4, 15.102.5. rishikimi 1, 15.104.3. rishikimi 1, 15.112.3. rishikimi 1. 15.112.4. rishikimi 2 dhe 15.128.2. rishikimi 1 të Këshillit Drejtues, në mënyrë që ajo të mundë:

- ti studiojë ato si pjesë e aktiviteteve reformuese të UPU-t;

- të paraqesë propozime në Kongresin e ardhshëm në bazë të rezultateve të studimit.

(Komiteti 3, mbledhja e 7-të)

REZOLUTA C 67/2008

KOSTO MBËSHTETËSE PËR VEPRIMTARITË JASHTË-BUXHETORE

Kongresi,

i ndërgjegjshëm

se rimbursimi i kostove të mbështetjes në buxhetin e rregullt të Bashkimit duhet të bazohet në veçanti në të dhëna të besueshme në lidhje me kostot aktuale të aktiviteteve jashtë-buxhetore,

Duke pranuar

Rëndësinë e fondeve jashtë-buxhetore në arritjen e misionit të UPU-t,



duke vënë në dukje
rekomandimet e Njësisë së Përbashkët të Inspektimit të Kombeve të Bashkuara (JIU) në identifikimin e kostove të mbështetjes të aktiviteteve jashtë-buxhetore brenda sistemit të OKB-së, dhe politikat e ndryshme të rimbursimit të miratuara nga agjencitë individuale,

Duke vënë në dukje me kënaqësi
punën e kryer nga ana e Grupit të Punës, përgjegjës për studimin e çështjes së shpenzimeve të mbështetjes për aktivitetet jashtë-buxhetore,

Vendos

se politika për mbulimin e shpenzimeve mbështetëse për aktivitetet jashtë-buxhetore, në përgjithësi, duhet të bazohet në dy parimet e mëposhtme:

- të gjitha kostot e drejtpërdrejta që lidhen me projekte jashtë-buxhetore duhet ti ngarkohen direkt këtyre projekteve;

- kostot variabile indirekte (shpenzimet mbështetëse) duhet të mbulohen sipas një baze të qartë, të kuptuar mirë dhe të pranuar, duhet të tregohen si tarifë e projektit / aktivitetit, dhe duhet të zbritet nga shpenzimet operative të Byrosë Ndërkombëtare për periudhën financiare në fjalë,

Udhëzon

Këshillin Drejtues, në konsultim me Këshillin e Operacioneve Postare dhe Byronë Ndërkombëtare, për të krijuar parimet dhe metodologjinë e përbashkët për ndarjen e kostove direkte dhe kostove indirekte të ndryshueshme në aktivitetet jashtë-buxhetore,

Udhëzon gjithashtu

këto organe që të shqyrtojnë, rast pas rasti, natyrën dhe qëllimin e aktiviteteve të financuara nga fondet jashtë-buxhetore dhe efektin e mbulimit të kostove mbështetëse, dhe të vendosë metodën më të përshtatshme për mbulimin e kostove dhe shumën që duhet të mbulohet.

(Propozimi 41, Komiteti i 2, mbledhja e 2-të)

VENDIMI C 68/2008

MIRATIMI I LLOGARIVE TË BUXHETIT TË RREGULLT TË BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 2003-2006

Kongresi,

Duke pasur parasysh

a) raportin mbi financat e Bashkimit (KONGRES-Dok 15);

b) raportin e Komitetit të tij të Financave (KONGRES-Dok 36),

miraton

llogaritë e Bashkimit Postar Universal për periudhën 2003-2006.

(KONGRES-Dok 15. Aneksi 1, Komisioni 2, mbledhja e 2-të)

VENDIMI C 69/2008

MIRATIMI I LLOGARIVE VJETORE TË LIDHURA DHE EKSTRA BUXHETORE TË BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 2004-2007

Kongresi,

Duke pasur parasysh

a) raportin mbi financat e Bashkimit (KONGRES-Dok 15);

b) raportin e Komitetit të tij të Financave (KONGRES-Dok 36),

miraton

llogaritë jashtë-buxhetore të Bashkimit Postar Universal për periudhën 2004-2007.

(KONGRES-Dok 15. Aneksi 2, Komisioni 2, mbledhja e 2-të)

VENDIMI C 70/2008
NDIHMA E DHËNË NGA QEVERIA E KONFEDERATËS ZVICERANE NË FUSHËN E FINANCAVE
TË BASHKIMIT

Kongresi,
pasi ka shqyrtuar
raportin mbi financat e Bashkimit (KONGRES-Dok 15)
shpreh
Mirënjohjen e tij për Qeverinë e Konfederatës së Zvicrës për:
i) ndihmën bujare që ajo i ka ofruar Bashkimit në fushën e financave duke mbikëqyrur mbajtjen e llogarive nga Byroja Ndërkombëtare dhe duke vepruar si auditor të jashtëm i llogarive të Bashkimit;
ii) gatishmërinë e tij për të mbuluar mungesat e përkohshme financiare duke e bërë gjitha parapagimet e nevojshme afatshkurtra, me kushtet të cilat duhet të vendosen në marrëveshje të përbashkëta.

(KONGRES-Dok 15. Aneksi 3, Komiteti 2, mbledhja e 2-të)

VENDIMI C 71/2008
PERIUDHA E MBULUAR NGA VENDIMET FINANCIARE TË MARRA NGA KONGRESI I 24RT

Kongresi,
Pasi ka shqyrtuar
raportin mbi financat e Bashkimit (KONGRES-Dok 15),
Duke pasur parasysh faktin
se burimet financiare duhet të ndahen në bazë të Programit dhe të Buxhetit që rrjedhin nga Strategjia Postare e Nairobit që mbulon periudhën nga 2009 në 2012,
vendos
se sistemi financiar do të mbulojë periudhën e ekzekutimit të Planit Strategjik 2009-2012.

(KONGRES-Dok 15. Aneks 4, Komiteti 2, mbledhja e 2-të)

REZOLUTA C 72/2008
RRJETI ELEKTRONIK I BASHKIMIT POSTAR UNIVERSAL

Kongresi,
duke uruar
Forcimin e mëtejshëm të rolit efektiv të rrjetit elektronik UPU, i cili përbëhet nga lehtësimi i transmetimit dhe shkëmbimin e informacionit, dhe në përputhje me rezolutat C 66/2004, C 52/2004 dhe C 35/2004 të miratuar nga Kongresi i vitit 2004 në Bukuresht,
Duke besuar
se përkthimi i faqes së internetit të UPU-t në gjuhë të tjera është një objektiv i arritshëm, duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha teknologjike që aktualisht janë duke u zhvilluar në shërbimet postare - veçanërisht në rrjetin elektronik, dhe do të lehtësojë qasjen në të dhënat operative të publikuara në faqen e internetit,
Udhëzon
Këshilli Drejtues, në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare, të zgjerojë fushën e rrjetit elektronik të UPU-t duke përfshirë faqen e tij të internetit (www.upu.int) - duke futur gjuhë të tjera (arabe, spanjolle, gjermane, kineze, portugeze dhe ruse) , me kusht që analiza kosto-përfitim ta justifikojë atë.

(Propozimi 72, mbledhja e 10-të plenare)



REZOLUTA C 73/2008
PËRDITËSIMI I FJALËKALIMEVE TË LISTËS SË MBROJTUR TË ADRESAVE TË EMAILEVE TË
DISPONUESHME NËPËRMJET FAQES SË INTERNETIT TË UPU

Kongresi,
i ndërgjegjshëm
për nevojat aktuale të komunikimit në përgjigje të emergjencave dhe / ose biznesit midis zyrtarëve të
lartë të rregullatorëve dhe të operatorëve të caktuar,
i kërkon
shteteve të kenë adresat e tyre të e-mail të përfshira në listën e fjalëkalimeve të mbrojtura në
dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të UPU-t, dhe të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për çdo ndryshimi të
tyre,
kërkon
Që Byroja Ndërkombëtare:
- Të bëjë çdo përpjekje për të përditësuar listën e adresave të e-mail të zyrtarëve të lartë të organeve
rregullatore dhe operatorëve të caktuar;
- Që lista të jetë më e arritshme, në faqen e internetit të UPU-t dhe fjalëkalimi mbrojtur siç është
aktualisht rasti, por më afër faqen kryesore.

(Propozimi 81, mbledhja e 10-të plenare)

REZOLUTA C 74/2008
ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE FINANCIARE POSTARE

Kongresi,
Duke pasur parasysh
rezultatet inkurajuese të marra nga zbatimi i një numri të projekteve të ndërmarra në kuadër të
rezolutës C 47/2004 të Kongresit të Bukureshtit për të zhvilluar shërbimet postare financiare,
Duke pasur parasysh se
- Ofrimi i shërbimeve bazë financiare nëpërmjet rrjetit të zyrave postare kontribuon shumë për
zhvillimin global ekonomik dhe social dhe luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e standardeve të
jetesës;
- rrjeti postar, nëpërmjet mbulimit të saj në mbarë botën dhe kombinimin e dimensioneve elektronike,
financiare dhe fizike, siguron që të gjithë qytetarët e botës kanë të drejtë hyrje në shërbimet e pagesave
elektronike të efektshme, të besueshme, të sigurt dhe të përballueshme;
- shërbimet postare financiare luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e Objektivave për Zhvillimin e
Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht në luftën kundër varfërisë, në veçanti për shkak të pranisë
së tyre në zonat rurale;
- rrjeti postar ndihmon zhvillimin e tregtisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
në nivel lokal dhe ndërkombëtar;
- zhvillimi i shërbimeve të pagesave elektronike postare është veçanërisht i përshtatshëm për
bashkëpunim me një numër në rritje të organizatave ndërkombëtare,
Duke vënë në dukje
- se me krijimin e rrjetit botëror të pagesave postare elektronike të UPU është bërë progres i
rëndësishëm që nga Kongresi i Bukureshtit;
- Se Këshilli Drejtues i vitit 2007 ka ftuar operatorët e caktuar postarë të kalojnë shërbimet e tyre të
pagesave postare me bazë shkresore në shërbimet postare të pagesës elektronike deri në 2010;
- Avantazhet e shërbimeve postare financiare për operatorët e caktuar, dhe në veçanti rritjen e të
ardhurave që shton qëndrueshmërinë e rrjetit postar;
- Tregu i sotëm botëror po pëson ndryshime të shpejta dhe të thella dhe përdoruesit janë duke kërkuar
shërbime cilësore, të shpejta, të sigurt,

Duke vënë në dukje edhe

- Se sistemi financiar ndërkombëtar i UPU-t (IFS) mundëson që urdhrat e pagesës postare e transmetuara në formë shkresë ose me rrugë telegrafike ose faks të zëvendësohen nga urdhër-pagesat postare të transmetuara me anë të rrjetit elektronik të UPU-t;

- Se rrjeti postar mund të përdoret gjithashtu për të ofruar shërbime financiare të bazuara në llogari, në veçanti për të lehtësuar përfshirjen financiare të zonave rurale;

Duke pranuar

nevojën e UPU-t për të vazhduar dhe forcuar punën e saj në zhvillimin e shërbimeve të pagesave postare dhe shërbimeve financiare postare në mbarë botën,

Udhëzon

Këshillin e Operacioneve Postare dhe Byronë Ndërkombëtare për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zhvillimin e shërbimeve të pagesave postare dhe shërbimeve financiare postare për të përmbushur kërkesat e mjedisit në ndryshim, në veçanti:

- duke inkurajuar shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar për t'i dhënë prioritet shërbimeve të pagesës postare;

- duke zgjeruar e rrjetit elektronik të pagesave të UPU-t në të gjitha pjesët e botës dhe duke ndihmuar gjithë operatorët e caktuar të shteteve anëtare të UPU-t të hyjnë në këtë rrjet;

- duke krijuar brenda kuadrit të POC, një organ të menaxhimit për rrjetin e pagesave të ndërlidhur, global, elektronik të UPU-t;

- duke kryer aktivitete të tregut dhe promovuar shërbimet postare elektronike të pagesave;

- duke modernizuar shërbimet e pagesave postare elektronike nëpërmjet teknologjive të reja (telefonat celular etj);

- duke inkurajuar bashkëpunimin midis operatorëve të caktuar;

- duke përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të pagesave elektronike postare të UPU-t;

- duke përmirësuar sigurinë e shërbimeve dhe promovimin e veprimtarive kundër pastrimit të parave, për të qenë në përputhje me rekomandimet e Task Force të Veprimit Financiar;

- duke u siguruar operatorëve të caktuar ndihmën e nevojshme për menaxhimin financiar të shërbimeve;

- duke promovuar futjen dhe zhvillimin e shërbimeve postare financiare në bazë të llogarisë, të tilla si shërbimet e kursimeve, në shtetet anëtare të Bashkimit;

- duke rekomanduar futjen e shërbimeve të reja financiare, të cilat mund të ofrohen nëpërmjet rrjetit postar në mbarë botën;

- duke forcuar dhe nxitur bashkëpunimin me partnerët nga sektorët publik dhe privat me synim zhvillimin e rrjetit të pagesave elektronike të UPU-t në të gjithë botën;

- duke i dhënë prioritet të bashkëpunimit dhe koordinimit efikas me lojtarë të tillë si Banka Botërore, bankat rajonale të zhvillimit dhe IFAD, IOM dhe WSBI, në fushën e shërbimeve të pagesave postare elektronike,

Fton

Shtetet anëtare të UPU-t dhe operatorët e tyre të caktuar të marrin masat e nevojshme për të zhvilluar shërbimet e pagesave postare elektronike,

udhëzon gjithashtu

Byronë Ndërkombëtare të monitorojë këtë punë dhe të ndihmojë Këshillin e Operacioneve Postare me ndonjë ndryshim në veprimet të cilat konsiderohen të nevojshme.

(Propozimi 10, Komiteti 6, mbledhja e 3-të)

REZOLUTA C 75/2008

ZHVILLIMI I KUADRIT MULTILATERAL TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE POSTARE

Kongresi,

Duke pasur parasysh

nevojën për të përshtatur shërbimet e pagesave postare me ndryshimeve rregullatore, shoqërore dhe teknologjike,

Duke pasur parasysh

Nevojën për ndarjen e qartë të roleve midis shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar në mënyrë që të sigurojë një qeverisje të mirë brenda kuadrit të Strategjisë Postare të Nairobi,



Duke vënë në dukje

Rezolutën C 47 të Kongresit të Bukureshtit në lidhje me krijimin e një rrjeti mbarë botëror të shërbimeve të pagesave postare, dhe nevojën për të ndihmuar të gjitha shtetet anëtare të hyjnë në të dhe për të përgatitur procedurat e nevojshme për ekzekutimin e urdhër-pagesave,

duke pasur gjithashtu parasysht

se përveç zhvillimit të parimeve dhe rregullave të përbashkëta që do të përfshihen në projektin e Marrëveshjes dhe Rregullores së PPS, zhvillimi i një rrjeti shkëmbimi, të ndërlidhur, shumëpalësh dhe dypalësh kërkon mjete të përbashkëta, procedura dhe standarde, për zhvillimin e të cilave është përgjegjësi UPU,

Duke vënë në dukje edhe

se parimet dhe rregullat e përbashkëta janë përfshirë në Projekt Marrëveshjen dhe Rregulloren e PPS dhe se qëllimi i lirisë kontraktuale të operatorëve të caktuar, si edhe kuadri për këtë liri, janë përcaktuar në këto tekste,

Duke vënë gjithashtu në dukje

se një përmbledhje elektronike që përfshin informacionin e operacioneve të ofruara nga operatorët e caktuar për ekzekutimin e urdhër-pagesave është thelbësore për shkëmbimet elektronike midis operatorëve të caktuar dhe kërkohet nga projekt Rregulloren e re,

Duke pranuar

se parimi i ndërveprimit do të thotë që çdo rrjet në gjendje të kryejë shërbime të pagesave postare në përputhje me Aktet e Bashkimit mund të përdoret nga operatorët e caktuar për të ofruar shërbimeve,

Duke pasur parasysht

punën e kryer në seminarët shumëpalëshe rajonale të zhvillimit të shkëmbimit mbi procedurat operacionale dhe të kontabilitetit dhe marrëveshjet standarde midis operatorëve të caktuar që mundësojnë zhvillimin e shkëmbimeve shumëpalëshe dhe lidhjen e rajoneve me anë të korridoreve,

duke shuar

nevojën për të përditësuar dhe zhvilluar vazhdimisht elemente të reja të kuadrit shumëpalësh në funksion të zhvillimeve të jashtme dhe numrit në rritje të shkëmbimeve për shkak të rritjes së rrjetit të ndërlidhur të UPU-t,

duke vënë re

nevojën për menaxhimin e rrjetit, harmonizimin e vazhdueshëm të praktikave dhe arbitrazh në rastet e mos përputhjeve me Aktet e Bashkimit,

Udhëzon

POC:

- të përcaktojë marrëveshje shërbimi midis operatorëve të caktuar për të kërkuar ekzekutimin e urdhër-pagesave postare elektronike, të cilat do të përshtaten vazhdimisht për të përmbushur nevojat që lindin;

- të përcaktojë një marrëveshje model për shkëmbimin e të dhënave elektronike midis operatorëve të caktuar;

- të krijojë një përmbledhje të shërbimeve të pagesave postare elektronike;

- të standardizojë procedurat dhe mesazhet për ekzekutimin e urdhër-pagesave postare dhe të përditësojë periodikisht standardeve interkonjeksionit;

- të vendosë në funksion një mekanizëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet operatorëve të caktuar gjatë ekzekutimit të marrëveshjes së shërbimit;

- të lehtësojë të drejtën e hyrjes në shërbimet e pagesave nëpërmjet teknologjive të reja, të tilla si telefonat celularë ose Interneti, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e përdoruesve,

gjithashtu udhëzon

CA dhe POC të vazhdojnë të rishikojnë Aktet për sa i përket shërbimeve të pagesave postare, dhe në veçanti për zhvillimin e shërbimeve të pagesave postare në kuadrin shumëpalësh,

Fton

Shtetet anëtare:

- të aderojnë në Marrëveshjen e Shërbimeve të Pagesave Postare;

- të inkurajojnë operatorët postarë të aderojnë në marrëveshjen e shërbimit dhe të përdorin modelin e marrëveshjes për shkëmbimin e të dhënave elektronike në kuadër të marrëdhënieve të tyre reciproke.

(Propozimi 11, Komiteti 6, mbledhja e 3-të)

REZOLUTA C 76/2008
KRIJIMI I SISTEMIT TË UPU PËR KOMPENSIMIN DHE SHLYERJEN

Kongresi,
i ndërgjegjshëm

se futja e një sistemi të UPU-t për kompensimin dhe shlyerjen do të shërbejë për të bërë shlyerjen e shërbimeve të pagesave postare midis operatorëve të caktuar më të sigurta, duke siguruar zbatimin e tyre të qetë, dhe duke lehtësuar hyrjen në këto shërbime nga të gjithë qytetarët, si dhe zbatimin e Objektivave të Mijëvjeçarit,

Duke marrë parasysh faktin

se rezoluta C 47/2004 e Kongresit të Bukureshtit kishte për qëllim në veçanti krijimin e një rrjeti të pagesave elektronike UPU në mbarë botën dhe të ndihmojë të gjitha shtetet anëtare të kenë të drejtë hyrje në të, si edhe në përmirësimin e metodave të shlyerjes ndërmjet operatorëve të caktuar për ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare dhe metodave të kompensimit,

Duke vënë në dukje

se POC ka përcaktuar qartë nevojën e një sistemi të UPU-t për shlyerjen dhe kompensimin në dispozicion të operatorëve të caktuar, në mënyrë që të përmirësohen metodat e shlyerjes për shërbimet e pagesave postare,

Duke kujtuar

që në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme, Byroja Ndërkombëtare mund të veprojë si një zyrë qendrore e kompensimit të llogarive të të gjitha llojeve që lidhen me shërbimin postar,

duke marrë parasysh faktin

se një sistem kompensimi kërkon përdorimin e një sistemi të centralizuar elektronik (rrjet)

duke marrë parasysh gjithashtu faktin

se një sistemi i shlyerjes kërkon rekursin e një ose më shumë partnerëve financiarë për shlyerjen ndërmjet operatorëve të caktuar,

duke vënë në dukje edhe

se faturimi i shërbimeve të pagesave postare kryhet në monedhën e këmbimit të rënë dakord midis dy operatorëve të caktuar, në parim në monedhën e shtetit të destinacionit

Duke marrë parasysh

se një sistem i shlyerjes dhe kompensimit mund të funksionojë vetëm me një numër të kufizuar të monedhave në mënyrë që të reduktohen risqet dhe kostot që lidhen me konvertim në sistemin e kompensimit dhe shlyerjes,

Duke vënë gjithashtu në dukje

se kur janë krijuar sisteme rajonale të kompensimit nga operatorët e caktuar, ato duhet të jenë të ndërlidhura me sistemin e kompensimit botëror të UPU-t,

Duke pranuar

se një interkonjeksion i tillë kërkon harmonizimin e rregullave të funksionimit të çdo zyre qendrore rajonale të kompensimit,

Udhëzon

POC:

- të shqyrtojë raportin në lidhje me mekanizmin për futjen e sistemit të kompensimit dhe shlyerjes të përgatitur nga grupi i përkohshëm për shërbimet e pagesave postare;

- të sigurojë vazhdimësinë e punës dhe të ndërmarrë hapat e nevojshme për të zbatuar një sistem të centralizuar të kompensimit / shlyerjes,

udhëzon gjithashtu

Byronë Ndërkombëtare të asistojë POC në zbatimin e një sistemi të centralizuar të kompensimit / shlyerjes në përputhje me vendimet e marra,

Fton

shtetet anëtare të inkurajojnë operatorët e tyre të caktuar:

- për të marrë në konsideratë pjesëmarrjen në sistemin e UPU-t për kompensimin dhe shlyerjen;

- për të harmonizuar rregullat e funksionimit të zyrave qendrore rajonale të kompensimit për të lejuar krijimin e një sistemi botëror UPU të kompensimit.

(Propozimi 12, Komiteti 6, mbledhja e 3-të)



REZOLUTA C 77/2008
MARKAT E SHËRBIMEVE UPU TË PAGESAVE ELEKTRONIKE POSTARE

Kongresi,
i ndërgjegjshëm
për veprimet e ndërmarra nga organet e përhershme të UPU-t në zhvillimin e shërbimeve postare
financiare në mënyrë që të plotësojnë nevojat e një mjedisi në ndryshim,
Duke marrë parasysh
se shërbimet e pagesave postare elektronike UPU të shpejta, të sigurta, të cilësisë së lartë do të
ndihmojnë që të përputhen me pritshmërinë e klientëve dhe do të përmbushur kërkesat e tregut,
i ndërgjegjshëm
se marka mund të ndihmojë klientët për të identifikuar shërbimin elektronik me këto attribute të
cilësisë,
i ndërgjegjshëm edhe
se një markë kolektive UPU do të përforcojë njohjen ndërkombëtare të shërbimeve të pagesave postare
elektronike UPU,
I bindur
se marka kolektive e lidhur me një shërbim me cilësi të lartë do të shërbejë për të nxitur njohjen e
shërbimeve të pagesave postare elektronike UPU, dhe veçanërisht të tërheqin ata që janë të përjashtuar
financiarisht dhe aktualisht duhet të gjejnë mënyra më pak të sigurta informale të transferimit të parave,
i bindur edhe
se përmirësimi i dukshëm i shërbimit të pagesave postare do të ndihmojë operatorët e caktuar që të
zhvillojë shërbimin,
duke miratuar
parimet kryesore të markës së shërbimeve të pagesave postare elektronike UPU e cila mbart vlerat e
UPU-t:
- Përballueshmërinë;
- Besueshmërinë;
- Shpejtësinë;
- Besimin;
- Njohjen;
- Integritetin;
- Transparencën dhe
- Konfidencialitetin,
Duke vënë në dukje
se operatorët e caktuar të shteteve pjesëmarrëse mund të jenë në gjendje të lidhin logot dhe markat e
tyre me atë të markës kolektive si një markë për produktet e pagesës postare të cilat ata ofrojnë për klientët e
tyre,
Duke vënë në dukje edhe
se marka globale nënkupton harmonizimin dhe standardizimin e dokumentacionit të marketingut të
operatorëve të caktuar,
Duke dëshiruar
që kjo markë kolektive të regjistrohet nga UPU para se marrëveshja e Shërbimeve të Pagesës Postare
e Nairobit të hyjë në fuqi në vitin 2010,
i ndërgjegjshëm gjithashtu
për krijimin e një fondi vullnetar për regjistrimin dhe menaxhimin e markës,
Udhëzon
- Këshillin e Operacioneve Postare për të ngritur një organ për zhvillimin dhe menaxhimin e markës
kolektive dhe dokumentacioni e markës globale;
- Këshilli Drejtues të vendosë mbi parimet e zbatueshme për vendosjen e tarifave të licencës për
markën kolektive,
udhëzon gjithashtu
Byronë Ndërkombëtare:

- të marrë hapat e nevojshme për regjistrimin e markës kolektive;
- të kryejë funksionet e mbështetjes dhe sekretarisë për organin e markës,

Fton

shtetet anëtare të inkurajojnë operatorët e tyre të caktuar për të përdorur markën e shërbimeve të pagesave postare elektronike të UPU-t.

(Propozimi 13. Rishikimi 1, Komiteti 6, mbledhja e 3të)

REZOLUTA C 78/2008

SISTEMI I SHPËRBLIMIT I LIDHUR ME CILËSINË PËR SHËRBIMET E PAGESAVE POSTARE

Kongresi,

Duke pasur parasysh

Kërkesën e përdoruesve për shërbime të pagesave postare të shpejta, të besueshme dhe të sigurta dhe integrimi i këtyre kërkesave në Rregulloren e Bukureshtit (nenet 5, 9, 13 dhe 17),

Duke vënë në dukje

Rezolutën C 47/2004 të Kongresit të Bukureshtit që ka të bëjë me krijimin e standardeve të cilësisë dhe monitorimin e tyre, si dhe nevojën për të përmirësuar sistemin e shpërblimeve

Duke marrë parasysh

projektet pilot të realizuara nga një numër i shteteve anëtare që nga Kongresi i Bukureshtit në lidhje me shpërblimin bazë dhe elementët e lidhura me performancën, ndër të tjera, mbi:

- Përditësimin e bazës së të dhënave të urdhër-pagesave;
- Kohën e përpunimit të urdhrit;
- Kohën e pagesës;
- Kohën e nevojshme për të anuluar urdhrat;
- Përqindjen e reklamimeve të trajtuara dhe
- Përqindjen e reklamimeve,

Duke vënë në dukje edhe

se Projekt Rregulloret të cilat rrjedhin nga projekt Marrëveshja e re PPS plotëson këto elementë të cilësisë dhe lidhje të shpërblimit për cilësinë e shërbimit e ofruara në mënyrë elektronike,

Duke vënë në dukje më tej

se është në funksion një sistem i kontrollit të cilësisë (QCS) i cili mat elemente të caktuara të performancës të tilla si:

- kohët përpunimit nga nisja në përfundim të kërkesave e urdhrave ose tërheqjes të kryera nga operatorët e caktuar lëshues dhe pages; dhe

- kohën e nevojshme për të dërguar njoftimet e pagesës dhe të urdhrave të parapërgatitur që janë lëshuar dhe marrë,

dhe që gjeneron raporte vjetore, mujore dhe ditore sipas llojit të shkëmbimit, operatorit të caktuar dhe produktit (ekspres ose të shpejtë),

Udhëzon

POC për të zhvilluar një sistem të shpërblimit të lidhur me cilësinë për shërbimet e pagesave postare,

Fton

shtetet anëtare për të inkurajuar operatorët e tyre të caktuar për t'u bashkuar me sistemin e shpërblimit të lidhur me cilësinë.

(Propozimi 17, Komiteti 6, mbledhja e 3-të)



REZOLUTA C 79/2008

STUDIMI I NDIKIMIT FINANCIAR TË SHPËRNDARJES SË DOKUMENTACIONIT TË UPU NGA
BYROJA NDËRKOMBËTARE TEK SHTETET ANËTARE DHE OPERATORËT E CAKTUAR

Kongresi,
përgëzuar
Grupin e Projektit të Akteve të Bashkimit dhe Komitetin 2 të Këshillit Drejtues për arritjet e tyre gjatë
ciklit të katër-vjeçar nga viti 2005 deri 2008,
duke vërejtur
se Grupi i Projektit të Akteve të Bashkimit ka ndërmarrë për të studiuar zëvendësimin e termit
"administratë postare" me termin nga "shtet anëtar" dhe / ose "operator i caktuar" në Akte,
Duke pasur parasysh
se Kongresi ka miratuar propozimet (15.103.1, 15.105.1, 15.107.1, 15.112.1, 15.114.1, 15.116.1,
15.121.1, 15.123.1, 15.126.1 dhe 10.29.1) që kanë të bëjnë me shpërndarjen e dokumentacioneve të ndryshme
UPU për shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar,
Duke pranuar
se operatorët e caktuar dhe shtetet anëtare të dy kanë një interes në marrjen e dokumentacionit të UPU-t,
Duke vënë në dukje
se nuk është specifikuar numri i kopjeve të shpërndara pa pagesë shtesë, si dhe subjekti i saktë që ka të
drejtë për të marrë dokumentacionin,
duke parashikuar
se kjo shpërndarje do të ketë një ndikim financiar në buxhetin e Bashkimit,

Udhëzon

Këshilli Drejtues, me mbështetjen e Byrosë Ndërkombëtare, për të studiuar ndikimin financiar dhe
çështje të tjera të ngjashme në lidhje me vendimet e mësipërme dhe realizimin e rekomandimeve, në sesionin e tij
të vitit 2010.

(KONGRES C 3-Raporti 3. Aneksi 1, Komiteti 3, mbledhja e 3-të)

VENDIMI C 80/2008

KRYESIA E KËSHILLIT DREJTUES QË DO TË ZGJIDHET NGA KONGRESI POSTAR UNIVERSAL I
24RT

Kongresi,
Duke pasur parasysh
se, sipas nenit 102.2 të Rregullores së Përgjithshme, Kryesia e Këshillit Drejtues i përket shtetit pritës të
Kongresit, e cila është edhe *de jure* anëtar i Këshillit Drejtues,
Duke vënë në dukje
se Rregullorja e Përgjithshme nuk përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me çështjen e kryesimit të
Këshillit Drejtues, kur Kongresi është organizuar në Zvicër nga Byroja Ndërkombëtare pa një shtet pritës,
Duke pranuar
përpjekjet e mëdha të bëra nga Kenia për organizimin e Kongresit
Vendos
Ti japë Kenias kryesimin e Këshillit Drejtues

(Propozimi 52, mbledhja e 7të plenare)

VENDIMI C 81/2008

ÇËSHTJE NË REFERIM TË KËSHILLIT TË OPERACIONEVE POSTARE PËR TU SHQYRTUAR

Kongresi,

Duke vendosur

që të mos miratojë propozimet 20.7.2. Rishikimi 1, 20.4.2, 20.12.2 dhe 20.15.5,

Duke marrë parasysh

që këto propozime megjithatë përmbajnë ide që meritojnë të studiohen,

Udhëzon

Këshilli i Operacioneve Postare:

- të studiojë çështjet e ngritura në këto propozime;

- të paraqesë propozimet e duhura për Kongresin e ardhshëm, në qoftë se kjo do të bëhet e nevojshme.

(KONGRESI C 5-Raporti 5, Komiteti 5, mbledhja e 5-të)

VENDIMI C 82/2008

PJESËMARRJA E ARMENISË NË PUNIMET E KËSHILLIT DREJTUES

Kongresi,

Duke marrë parasysh

2008, zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit drejtues të realizuar gjatë seancës plenare të Kongresit të 6 Gushtit

Duke konfirmuar

se kjo zgjedhje dhe procesi i votimit i lidhur me të u zhvilluan në transparencë të plotë dhe në zbatim të Rregullores së Përgjithshme dhe Rregullat e Procedurës të Kongreseve,

Duke pranuar

the rrethanat fatkeqe nën të cilat, për shkak të komunikimit të nxituar të rezultateve, Armenia është shpallur momentalisht dhe gabimisht si një nga anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues, ky njoftim është tërhequr në mënyrë të rregullt nga ana e Kongresit pas shtyrjen e seancën e tij të mëngjesit dhe konfirmimin se një shtet tjetër anëtar kishte marrë të njëjtin numër votash në atë ditë,

Duke marrë parasysh

se, pasi të konfirmuar që ata kishin fituar të njëjtin numër votash, të dy shtetet në fjalë, Armenia dhe Kazakistani, pranuan kërkesën për shkak të Rregullores së Procedurës së Kongreseve, sidomos sa i përket nenit 22 të saj nga të cilat, në mënyrë që të vendosë midis shteteve që kanë marrë të njëjtin numër votash, kryetari do të hedhë short,

Duke vënë në dukje

simpatinë dhe vullnetin e shteteve anëtare për shqetësimet e Armenisë në dritën e shpalljes së gabuar të Armenisë si një anëtar i sapo zgjedhur i Këshillit Drejtues,

vendos

të japë Armeninë, në kushte të jashtëzakonshme dhe në mënyrë rigoroze për periudhën ndërmjet Kongresit të 24rt dhe Kongresit të 25të, statusin e vëzhguesit të privilegjuar për mbledhjet e Këshillit Drejtues, duke përfshirë të drejtën për t'u ulur midis anëtarëve të Këshillit Drejtues, sipas të rendit alfabetik francez.

(KONGRESI-Raporti 8. Aneksi 1, mbledhja e 10-të plenare)



RREGULLORJA E POSTËS SË LETRAVE

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR BERNË 2008

RREGULLORJA E POSTËS SË LETRAVE

Tabela e përmbajtjes

KAPITULLI 1

Dispozita të Përgjithshme

Nenet

- RL 101 Zbatimi i lirisë së transitit
- RL 102 Moszbatimi i lirisë së transitit
- RL 103 Njësia monetare
- RL 104 Siguria Postare

KAPITULLI 2

Tarifat, tarifat shtesë ajrore dhe përjashtimi nga tarifat

- RL 105 Tarifat Postare
- RL 106 Tarifa të veçanta
- RL 107 Kushte të zbatimit të tarifave postare
- RL 108 Llogaritja e tarifave shtesë për artikujt e postës ajrore
- RL 109 Ekuivalente
- RL 110 Përjashtimet nga tarifat postare për artikujt e shërbimeve postare
- RL 111 Zbatimi i përjashtimeve të tarifave postare për organet që lidhen me të burgosur të luftës dhe të internuar civilë
- RL 112 Shënimi i artikujve të dërguar pa tarifa postare

KAPITULLI 3

Pullat Postare. Mënyrat e shënimit të pagesave

- RL 113 Pulla Postare. Njoftime të lëshimit dhe shkëmbimi midis operatorëve të caktuar
- RL 114 Parapagime. Mënyrat e shënimit të parapagimeve
- RL 115 Karakteristika të pullave postare dhe parapagesave postare ose vendosja e pullave
- RL 116 Dyshimi i përdorimit për mashtrim i pullave postare ose parapagesave postare ose vulave të postimeve
- RL 117 Vendosja e vulës datare
- RL 118 Artikujt e papaguar ose të nën paguar
- RL 119 Parapagesa dhe vulosja e artikujve të postuar me rrugë detare

KAPITULLI 4

Kategori të artikujve dhe kushtet e pranimi

- RL 120 Shërbime bazë
- RL 121 Veçori që lidhen me kufijtë e peshës
- RL 122 Limitet e përmasave
- RL 123 Kushte të pranimi të artikujve. Përgatitja. Paketimi
- RL 124 Dispozita të veçanta të zbatueshme për çdo kategori të artikujve
- RL 125 Shënimi i prioritetit ose mënyrave të transportit
- RL 126 Paketime të veçanta

- RL 127 Artikuj në zarfe me panel
- RL 128 Artikuj të standardizuar
- RL 129 Kushte të pranimit dhe shënimit të artikujve që përmbajnë substanca biologjike që prishen (duke përfshirë kampionët e diagnostikimit)
- RL 130 Kushte të pranimit dhe shënimit të artikujve që përmbajnë substanca infektuese
- RL 131 Kushte të pranimit dhe shënimit të artikujve që përmbajnë materiale radioaktive

KAPITULLI 5

Shërbime shtesë

- RL 132 Artikuj të regjistruar
- RL 133 Dorëzimi i regjistruar i artikujve
- RL 134 Artikuj të siguruar
- RL 135 Artikuj me pagesë nga marrësi
- RL 136 Artikuj ekspres
- RL 137 Lajmërim marrja
- RL 138 Dorëzimi personalisht tek marrësi
- RL 139 Artikuj për tu dërguar pa pagesa dhe tarifa
- RL 140 Shërbimi ndërkombëtar i përgjigjes së biznesit (IBRS)
- RL 141 Shërbimi ndërkombëtar i përgjigjes së biznesit – përgjigje lokale
- RL 142 Kupona të përgjigjes ndërkombëtare
- RL 143 Shërbimi i dorëzimit

KAPITULLI 6

Ndalimi i futjes së substancave të rrezikshme në artikujt e postës së letrave. Artikuj të pranuar gabim. Ri-adresimi. Kthimi tek dërguesi. Tërheqja e artikujve nga posta. Reklamimi

- RL 144 Ndalimi për të futur të mira të rrezikshme në artikujt e postës së letrave
- RL 145 Trajtimi i artikujve të pranuar gabim
- RL 146 Ri-adresimi
- RL 147 Artikuj që nuk mund të dorëzohen. Kthimi në shtetin e origjinës ose tek dërguesi dhe periudha e mbajtjes.
- RL 148 Trajtimi i kërkesave për tërheqje të artikujve nga posta ose për ndryshime ose korrigjime të adresës
- RL 149 Tërheqja nga posta. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës. Artikuj të postuar në një shtet të ndryshëm nga ai që merr kërkesën
- RL 150 Reklamime
- RL 151 Reklamime që lidhen me artikujt e postuar në një shtet tjetër

KAPITULLI 7

Çështje doganore

- RL 152 Artikuj subjekt i kontrollit doganor
- RL 153 Tarifa për paraqitjen në doganë
- RL 154 Fshirja e detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera

KAPITULLI 8

Përgjegjësi të operatorëve të caktuar

- RL 155 Zbatimi i përgjegjësisë së operatorëve të caktuar
- RL 156 Dorëzimi i artikujve të siguruar të dëmtuar ose të shkatërruar
- RL 157 Përcaktimi i përgjegjësisë të dërguesit
- RL 158 Pagesa e dëmshpërblimit



- RL 159 Periudha për pagesën e dëmshpërblimit
- RL 160 Pagesa automatike e dëmshpërblimeve
- RL 161 Përcaktimi i përgjegjësisë midis operatorëve të caktuar
- RL 162 Procedurat për përcaktimin e përgjegjësive të operatorëve të caktuar
- RL 163 Rikuperimi i dëmshpërblimeve të paguara nga transportuesit ajrorë
- RL 164 Rimbursimi i dëmshpërblimit për operatorët e caktuar pagues
- RL 165 Shlyerja e dëmshpërblimeve midis operatorëve të caktuar
- RL 166 Kontabilizimi i shumave të detyruara për dëmshpërblimet e artikujve të postës së letrave

KAPITULLI 9

Procedurat në lidhje me transmetimin, itinerarin dhe marrjen e dërgesave / artikujve

- RL 167 Shkëmbimi i artikujve
- RL 168 Trajtimi prioritar i artikujve me prioritet dhe artikujve me postë ajrore
- RL 169 Dërgesat
- RL 170 Shkëmbime në postë të mbyllur
- RL 171 Transiti à découvert (i hapur)
- RL 172 Itineraret dhe mënyrat e transmetimit të artikujve të siguruar
- RL 173 Përgatitja e dërgesave
- RL 174 Faturat
- RL 175 Transmetimi i artikujve rekomande
- RL 176 Transmetimi i artikujve rekomande të dorëzuar
- RL 177 Transmetimi i artikujve të siguruar
- RL 178 Transmetimi i mandat pagesave dhe artikujve të zakonshëm COD
- RL 179 Transmetimi i artikujve ekspres
- RL 180 Transmetimi i artikujve IBRS
- RL 181 Transmetimi i thasëve M
- RL 182 Transmetimi i artikujve në sasi të mëdha
- RL 183 Transmetimi i artikujve të destinuar për akses të drejtpërdrejtë në regjimin e brendshëm
- RL 184 Etiketimi i dërgesës
- RL 185 Përdorimi i barkodeve
- RL 186 Itinerari i dërgesave
- RL 187 Transporti i postës ajrore dhe i postës ajrore brenda vendit (S.A.L.)
- RL 188 Hapat që do të ndërmerren kur transporti i drejtpërdrejtë i postës ajrore nuk mund të realizohet sipas planit
- RL 189 Përgatitja e njoftimeve të provës
- RL 190 Transferimi i dërgesave
- RL 191 Përgatitja dhe kontrolli i faturave të dorëzimit CN 37, CN 38 ose CN 41
- RL 192 Mungesa e faturave të dorëzimit të CN 37, CN 38 ose CN 41
- RL 193 Verifikimi i dërgesave
- RL 194 Shënimi i verifikimit
- RL 195 Artikuj të dërguar gabim
- RL 196 Hapat që duhen marrë në rast aksidenti
- RL 197 Hapat që duhen marrë në rast të fluturimit të ndërprerë, ose devijimit ose dërgimit të gabuar të postës ajrore
- RL 198 Hapat që duhen marrë në rast të fluturimit të ndërprerë, ose të devijimit ose të dërgimit të gabuar të postës ajrore brenda vendit (S.A.L.)
- RL 199 Hapat që duhen marrë në rast të ndërprerjes së përkohshme dhe rifillimi i shërbimeve
- RL 200 Kthimi i thasëve bosh
- RL 201 Dërgesa të shkëmbyera me njësitë ushtarake

KAPITULLI 10

Cilësia e shërbimeve

RL 202 Objektivat e cilësisë së shërbimeve

KAPITULLI 11

Tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare

RL 203 Tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

A. Tarifat e transitit

RL 204 Zbatimi i pagesave të transitit

RL 205 Tarifat e transitit

RL 206 Distanca kilometrike

RL 207 Shërbime të jashtëzakonshme. Transporti me shumë modalitete

RL 208 Llogaritja dhe kontabilizimi për tarifat e artikujve të dërguar gabim dhe artikujve në transit à découvert (të hapura) të dërguar me rrugë tokësore

RL 209 Tarifa të transitit për posta të devijuara ose të dërguara gabim

RL 210 Posta ajrore dhe posta S.A.L. në transit tokësor

RL 211 Pagesa e tarifave të transitit për transportin e thasëve bosh

B. Detyrimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

RL 212 Anëtarësimi vullnetar në sistemin objektiv me anë të sistemit të tranzicionit në shtetet anëtare

RL 213 Akses i drejtpërdrejtë në shërbimet e brendshme

RL 214 Llogaritja e çmimeve të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për shtetet dhe territoret që zbatojnë nenet 29.2 deri 4 të Konventës

RL 215 Cilësia e shërbimeve e lidhur me pagesat e detyrimeve përfundimtare midis operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin objektiv

RL 216 Cilësia e shërbimeve e lidhur me pagesat e detyrimeve përfundimtare të aplikueshme për flukset e dërgesave në, nga dhe midis operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin e tranzicionit

RL 217 Mekanizmat e rishikimit të çmimeve të detyrimeve përfundimtare

RL 218 Kërkesa për pagesa specifike për dërgesat në sasi të mëdha

RL 219 Dërgesa të mbyllura të shkëmbyera me njësi ushtarake

C. Shembuj të veprimeve

RL 220 Parime të përgjithshme për kampionët statistikorë dhe vlerësimin e numrit mesatar të artikujve për kilogram

RL 221 Njehsime statistikore për shkëmbimet e dërgesave midis shteteve anëtare në sistemin objektiv

RL 222 Metodë alternative statistikore për shkëmbimet e postës ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv

RL 223 Njehsimi specifik statistikor për zbatimin e mekanizmit të rishikimit

D. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i ekstrakteve, faturave dhe llogarive që lidhen me pagesat e transitit dhe tarifave përfundimtare

RL 224 Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54 për shkëmbimet e postës midis shteteve anëtare të sistemit objektiv

RL 225 Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54 për mekanizmin e rishikimit.

RL 226 Përgatitja e situacioneve të dërgesave CN 55 dhe CN 56

RL 227 Transmetimi dhe pranimi i situacioneve të dërgesave CN 55 dhe CN 56

RL 228 Kontabiliteti i postës në sasi të mëdha



- RL 229 Kontabiliteti i postës së destinuar për hyrje direkte në sistemin e brendshëm
- RL 230 Përgatitja, transmetimi dhe miratimi i tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare
- RL 231 Adresa të veçanta për transmetimin e formularëve që kanë të bëjnë me tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare
- RL 232 Pranimi i tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare
- RL 233 Pagesat provizore të tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare
- RL 234 Pagesa e shumave për tu paguar si Fonde për financimin e përmirësimit të cilësisë së shërbimit në vendet në zhvillim

KAPITULLI 12

Shpenzimet e transportit ajror

- RL 235 Formula për llogaritjen e taksës bazë dhe llogaritja e detyrimeve të transportit ajror për dërgesat e mbyllura
- RL 236 Llogaritja dhe kontabilizimi i tarifave për artikujt e dërguar gabim dhe artikujt në transit à découvert të dërguara me rrugë ajrore
- RL 237 Kontabilizimi i detyrimeve të transportit ajror
- RL 238 Përgatitja e situacioneve të peshës CN 66 dhe CN 67
- RL 239 Përgatitja e llogarive të detajuara CN 51 dhe llogarive të përgjithshme CN 52
- RL 240 Paraqitja dhe pranimi i situacioneve CN 55, CN 66 dhe CN 67, llogarive të detajuara CN 51 dhe llogarive të përgjithshme CN 52
- RL 241 Ndryshimi i detyrimeve të transportit ajror
- RL 242 Pagesa për detyrimet të transportit ajror
- RL 243 Pagesa e detyrimeve të transportit ajror për transportin e thasëve bosh
- RL 244 Tarifat e transportit ajror të dërgesave ose thasëve të devijuara apo të dërguara gabim
- RL 245 Detyrimet e transportit ajror të dërgesave të humbura apo të shkatërruara

KAPITULLI 13

Shlyerja e llogarive. Pagesa

- RL 246 Transferta elektronike e situacioneve dhe llogarive
- RL 247 Përgatitja dhe shlyerja e llogarive
- RL 248 Likuidimi i llogarive me anë të Byrosë Ndërkombëtare
- RL 249 Pagesa të debive të shprehura në SDR. Dispozita të përgjithshme
- RL 250 Rregullat për pagesën e llogarive të pushlyera me anë të Byrosë Ndërkombëtare

KAPITULLI 14

Shërbimet EMS

- RL 251 Shërbimet EMS
- RL 252 Veprime të EMS

KAPITULLI 15

Posta elektronike. Lidhjet telematike

- RL 253 Posta hibride
- RL 254 Shërbime i faksit
- RL 255 Shërbime të bazuara në Tekst
- RL 256bis Marka e certifikimit të elektronik postar
- RL 257 Lidhje Telematike. Dispozita të përgjithshme
- RL 258 Dispozita të veçanta të lidhura me lidhjet telematike
- RL 259 Rregullat e pagesës së lidhjeve telematike

KAPITULLI 16

Shërbime logjistike të integruara

RL 260 Shërbime logjistike të integruara

KAPITULLI 17

Dispozita të ndryshme

RL 261 Informacione që do të jepet nga operatorët e caktuar

RL 262 Publikimet e Byrosë Ndërkombëtare

RL 263 Adresa Telegrafike

RL 264 Periudha e mbajtjes së dokumenteve

RL 265 Formularët

RL 266 Formularë në përdorim të publikut

RL 267 Zbatimi i standardeve

RL 268 Aspekte mjedisore

KAPITULLI 18

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

RL 269 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores së Postës së Letrave

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR PËR RREGULLOREN E POSTËS SË LETRAVE

Neni.

RL I Letra të printuara. Pesha maksimale

RL II Dispozita të posaçme të zbatueshme për çdo kategori të artikujve

RL III Artikuj të standardizuar

RL IV Kushtet e zbatimit të tarifave postare

RL V Thasët M rekomande

RL VI Kufijtë maksimal për artikujt e siguruar

RL VII Artikuj të siguruar

RL VIII Kontabilizimi i tarifave IBRS

RL IX Trajtimi i artikujve të pranuar gabimisht

RL Ixbis Ri-adresimi

RL X Trajtimi i reklamimeve

RL XI Artikuj subjekt i kontrollit doganor

RL XII (i fshirë)

RL XIII Thasët

RL XIV Itinerari i dërgesave

RL XV Tarifa të posaçme të transitit

RL XVI Njehsime statistikore për shkëmbimet e dërgesave ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv

RL XVII Kontabilizimi për postën në sasi të mëdha

RL XVIII (i fshirë)

RL XIX Paraqitja dhe pranimi i situacioneve CN 55, CN 66 dhe CN 67, llogarive të detajuara CN 51 dhe llogarive të përgjithshme CN 52

RL XX Kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të lëshuar para datës 1 Janar 2002

RL XXI Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive me anë të llogarisë përfundimtare të likuidimit për kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të shpërndara para 1 Janarit 2002

RL XXII Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi para 1 Janarit 2001

RL XXIII Formularë



LISTË E FORMULARËVE

Nr	Titulli ose lloji i formularëve	Referenca
CN 01	Kupona ndërkombëtarë të përgjigjes	RL 142.5
CN 02bis	Deklarata të detajuara. Kupona të përgjigjes	RL XXII.4
CN 03	Deklarata të detajuara. Kupona të përgjigjes të shkëmbyera	RL 142.9
CN 03bis	Deklarata përmbledhëse. Kupona të përgjigjes	RL XXII.6
CN 04	Etiketa "R" për artikuj të regjistruar	RL 132.5.2
CN 05	Etiketa për artikuj të regjistruar të dorëzuar	RL 133.4.1
CN 06	Etiketa "V" për artikuj të siguruar	RL 134.6.1
CN 07	Njoftimi i marrjes/ dërgimit/ pagesës/ hyrjes	RL 137.2.2
CN 08	Reklamimi	RL 150.2.1
CN 08	Marrja	RL 150.2.8
CN 09	Deklarata e artikujve IBRS të dërguar	RL 140.5.1
CN 10	Deklaratë përmbledhëse e artikujve IBRS	RL 140.5.1
CN 11	Shënimi i vendosjes së pullave	RL 139.4.2
CN 12	Llogari të detajuara mujore. Dogana, etj, tarifa	RL 139.6.1
CN 13	Raporte. Informacion për artikujt postar sekuestruar	RL 145.5
CN 14	Zarfet përmbledhës. Ri-adresimi i artikujve të postës së letrave	RL 1456.8.1
CN 15	Etiketa "Kthim"	RL 147.8.2
CN 16	Listë e dërgimit. Artikuj të siguruar	RL 177.1
CN 17	Kërkesa	RL 148.3.1
	– për tërheqje nga posta	
	– për ndryshime ose korrigjime të adresës	
	– për fshirje ose ndryshime të shumës COD	
CN 18	Deklarata në lidhje me mos marrjen (ose marrjen) e artikujve postarë	RL 150.2.6
CN 19	Llogari të detajuara. Tarifa IBRS	RL 140.5.3.2
CN 20	Deklarata. Tarifa IBRS	RL 140.5.4.1
CN 21	Njoftimi. Ri-adresimi i një formulari CN 08	RL 150.4.6
CN 22	Deklarime të doganës	RL 152.1
CN 23	Deklarime të doganës	RL 152.3
CN 24	Raport (parregullsi në lidhje me artikujt e siguruar të postës së letrave dhe kolitë postare)	RL 156.1
CN 25	Etiketat e pakove	RL 171.5.1
CN 26	Etiketat e pakove	RL 171.5.2
CN 27	Tabela. Itinerare dhe mënyra të transportimit të artikujve të siguruar	RL 172.1
CN 28	Zarfa për përgatitjen e postës ajrore	RL 173.3.4
CN 29	Etiketa "COD"	RL 135.4.2
CN 29bis	Etiketa për artikujt COD	RL 135.4.1
CN 30	Etiketa "R" e kombinuar me emrin e zyrës së origjinës , numrin e artikujve dhe trekëndëshin që mban shënimin "COD"	RL 135.4.2
CN 31	Fatura. Shkëmbimi i postës	RL 174.1
CN 32	Fatura. Postë në sasi të mëdha	RL 182
CN 33	Listë e veçantë . Artikuj të regjistruar	RL 175.1
CN 34	Etiketat e thasëve për postën tokësore	RL 184.1.1
CN 35	Etiketat e thasëve për postën ajrore	RL 184.1.2
CN 36	Etiketat e thasëve për postën S.A.L.	RL 184.1.3
CN 37	Faturat të dorëzimit. Posta tokësore	RL 190.1.1
CN 38	Fatura të dorëzimit. Postë ajrore	RL 190.2.1
CN 41	Fatura të dorëzimit. Posta e transportit ajror të brenda vendit (S.A.L.)	RL 190.2.1
CN 42	Etiketa e transportit të drejtpërdrejtë	RL 187.3
CN 43	Njoftimi i verifikimit. Shkëmbimi i postës	RL 194.1

CN 44	Shënimi i testimit	RL 189.
CN45	Zarfi i transmetimit për faturat CN 38, CN 41 dhe CN 47	RL 190.2.4
CN 46	Fatura zëvendësuese e dorëzimit	RL 192.3
CN 47	Fatura e dorëzimit. Posta të kutive bosh	RL 200.3
CN 48	Deklarata. Shuma të detyrueshme për dëmtshpërblimet	RL 166.1
CN 51	Llogari e detajuar. Posta ajrore	RL 241
CN 52	Llogari të përgjithshme	RL 241
CN 53	Deklarata me postë . Numri i artikujve dhe pesha e kutive	RL 225.1.1
CN 54	Deklarata përmbledhëse e artikujve	RL 225.1.2
CN 54bis	Deklarata përmbledhëse vjetore	RL 225.2.1
CN 55	Deklarata e postës	RL 228.1
CN 56	Deklarata përmbledhëse e postës	RL 228.2
CN 57	Llogari. Postë në sasi të mëdha e marrë	RL 230.2.1
CN 58	Deklaratë përmbledhëse. Llogaritë e detyrimeve përfundimtare për postën në sasi të mëdha	RL 230.2.3
CN 61	Llogari e detajuar. Detyrime përfundimtare	RL 232.2.2
CN 62	Llogari të detajuara. Tarifa të tranzitit	RL 232.2.1
CN 63	Deklarata. Tarifa të tranzitit	RL 234.1
CN 64	Deklarata. Detyrime përfundimtare	RL 234.1
CN 64bis	Deklarata të detajuara. Fondi i Cilësisë së Shërbimit	RL 236.1
CN 64ter	Deklarata të detajuara. Fondi i Cilësisë së Shërbimit	RL 236.3
CN 65	Fatura. Pesha e artikujve me përparësi à découvert (të hapur)/ postës ajrore	RL 208.3
CN 66	Deklarata e peshës. Posta ajrore dhe posta S.A.L.	RL 240.1
CN 67	Deklarata e peshës. Artikuj À découvert me përparësi/ postë ajrore	RL 240.2
CN 68	Lista e përgjithshme e shërbimeve të postës ajrore	RL 263.2.11

RREGULLORE E POSTËS SË LETRAVE

Duke pasur parasysh nenin 22, paragrafin 5, të Kushtetutës së Bashkimit Postar Universal të përfunduar në Vienë më datë 10 Korrik 1964, Këshilli i Operacioneve Postare ka hartuar masat e mëposhtme për sigurimin dhe zbatimin e rregullave të aplikueshme në mënyrë të përbashkët në të gjitha shërbimet postare ndërkombëtare dhe dispozitat e Postës së Letrave.

KAPITULLI 1 KUSHTE TË PËRGJITHSME

Neni RL 101 Zbatimi i lirisë së transitit

1. Shtetet anëtare që nuk ofrojnë shërbimet e artikujve të siguruar ose që nuk pranojnë përgjegjësi për letrat e siguruar të transportuara me anë të shërbimit të tyre detar ose ajror, do të jenë të detyruara të dërgojnë me anë të rrugës më të shpejtë dhe me mjetet më të sigurta, postën e mbyllur që u është kaluar atyre nga shtetet e tjera anëtare.

Neni RL 102 Moszbatimi i lirisë së transitit

Ndërprerja e shërbimit postar me një shtet anëtar i cili dështon në respektimin e lirisë së transportit do ti njoftohet paraprakisht operatorëve të caktuar të interesuar me anë të e-mail-it ose ndonjë mjeti telekomunikimi. Byroja Ndërkombëtare duhet të informohet për faktin.



Neni RL 103
Njësia Monetare

1. Njësia monetare e caktuar në nenin 7 të Kushtetutës dhe e përdorur në Konventë dhe Aktet e tjera të Bashkimit do të jetë e Drejta e Posaçme e Tërheqjes (SDR).

2. Shtetet anëtare të bashkimit, me marrëveshje të përbashkët, mund të zgjedhin një njësi të ndryshme nga SDR ose një nga monedhat e tyre kombëtare për përgatitjen dhe shlyerjen e llogarive.

Neni RL 104
Siguria Postare

1. Strategjia e sigurisë postare e zbatuar nga shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar do të kenë si qëllim:

- 1.1 Rritjen e cilësisë së shërbimeve në tërësi;
- 1.2 Rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve për rëndësinë e sigurisë;
- 1.3 Krijimin ose përf forcimin e njësive të sigurisë;
- 1.4 Ndarjen e informacioneve operacionale, të sigurisë dhe hetimeve me baza periodike; dhe
- 1.5 Propozimin tek organet ligjvënëse, kurdo që është e nevojshme, të ligjeve specifike, rregulloreve dhe masave për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve postare botërore.

KAPITULLI 2
TARIFAT, TARIFAT SHITESË AJRORE DHE PËRJASHTIMI NGA TARIFAT

Neni RL 105
Tarifat Postare

1. Tarifat postare të udhëzuara janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Kategoria	Pesha	Direktiva të pagesave për artikuj për zonën gjeografike më të lirë	Direktiva të pagesave Për artikuj për zonën gjeografike më të shtrenjtë
1	2	3	4

1.1 Tarifa në sistemin e bazuar në shpejtësi:

		SDR	SDR
Artikuj	deri 20 g	0.43	0.62
me prioritet	më shumë se 20 g deri 100 g	0.96	1.53
	Më shumë se 100 g deri 250 g	1.80	3.14
	Më shumë se 250 g deri 500 g	3.54	6.22
	Më shumë se 500 g deri 1000 g	5.99	10.83
	Më shumë se 1000 g deri 2000 g	9.55	19.33
	Për më shumë se 1000 g	5.66 (fakultativ)	8.67 (fakultativ)

Artikuj jo	deri 20 g	0.37	0.43
me prioritet	më shumë se 20 g deri 100 g	0.67	0.99
	Më shumë se 100 g deri 250 g	1.33	1.71
	Më shumë se 250 g deri 500 g	2.60	3.43
	Më shumë se 500 g deri 1000 g	4.33	5.68
	Më shumë se 1000 g deri 2000 g	6.99	10.43
	Për më shumë se 1000 g	3.86 (fakultativ)	5.42 (fakultativ)

1.2 Tarifa në sistemin e bazuar në përmbajtje:

Letra		deri 20 g	0.34	0.51
		më shumë se 20 g deri 100 g	0.83	1.42
		Më shumë se 100 g deri 250 g	1.97	3.26
		Më shumë se 250 g deri 500 g	3.71	5.97
		Më shumë se 500 g deri 1000 g	6.62	11.31
		above 1000 g up to 2000 g	11.53	20.15
		Për më shumë se 1000 g	6.02 (fakultativ)	7.75 (fakultativ)
Kartolina			0.27	0.38
Letra të Printuara		më shumë se 20 g	0.23	0.36
		më shumë se 20 g deri 100 g	0.60	1.05
		Më shumë se 100 g deri 250 g	1.29	2.52
		Më shumë se 250 g deri 500 g	2.33	4.82
		Më shumë se 500 g deri 1000 g	4.44	9.05
		Më shumë se 1000 g deri 2000 g	7.52	14.58
		Për më shumë se 1000	3.44	5.10

Pako të vogla		më shumë se 100 g	0.70	1.16
		Më shumë se 100 g deri 250 g	1.40	2.52
		Më shumë se 250 g deri 500 g	2.52	4.73
		Më shumë se 500 g deri 1000 g	4.29	7.85
		Më shumë se 1000 g deri 2000 g	6.36	13.16
		Për më shumë se 1000 1000 g	4.80 (fakultativ)	10.40(fakultativ)

2. Këshilli i Operacioneve Postare do të jetë i autorizuar të rishikojë dhe të amendojë tarifat e udhëzimit të dhëna sipas pikës 1 ndërmjet dy Kongreseve. Tarifat e rishikuara do të bazohen në vlerën mesatare të pagesave të caktuara nga anëtarët e Bashkimit për artikujt ndërkombëtarë nga shtetet e tyre.

3. Tarifa e aplikueshme për thasët M do të llogaritet me njësi të peshës prej 1 Kg deri në peshën totale të çdo thesi. Operatorët e caktuar të orgjinës mund të lejojnë një reduktim për këto thasë deri 20% të tarifës së pagueshme të përdorur për kategorinë e artikullit. Ky reduktim mund të jetë i pavarur nga reduktimi i siguruar sipas nenit RL 107.7.

4. Në sistemin e bazuar në përmbajtje, kombinimi i një njësie të artikujve për të cilët janë zbatuar tarifa të ndryshme pagese, do të autorizohet me një kusht që vlera totale të mos kalojë peshën maksimale të kategorisë limiti i peshës të së cilës është më i lartë. Tarifa e zbatuar për një artikull të tillë, sipas mendimit të operatorëve të caktuar të origjinës, do të jetë ajo e kategorisë me çmim më të lartë, ose shuma e tarifave të zbatueshme të ndara për çdo artikull të njësisë. Një artikull i tillë do të mbartë shënimin "Envois mixtes" ("Postë e Kombinuar").

Neni RL 106
Tarifa të veçanta

1. Asnjë tarifë dërgese nuk mund të mblidhet nga marrësi për sa i përket pakove të vogla me peshë më të ulët se 500 gram. Kur pakot e vogla të brendshme peshojnë më shumë se 500 gram ato do të jenë subjekt i tarifave të dorëzimit, e njëjta pagesë mund të mblidhet në lidhje me pakot e vogla ndërkombëtare hyrëse.

2. Operatorët e caktuar në rastet e përmendura më poshtë do të jenë të autorizuar të marrin të njëjtat tarifa si në shërbimet e brendshme.

2.1 Tarifa për artikujt e postës së letrave të postuara pas afatit të fundit për postim, të mbledhura nga dërguesi.

2.2 Tarifa për artikujt e postuar jashtë orëve normale të punës, të mbledhura nga dërguesi.

2.3 Tarifa për mbledhjen në adresën e dërguesit, të mbledhura nga dërguesi.



2.4 Tarifa për dorëzimin e artikujve të postës së letrave jashtë orëve normale të punës, të mbledhura nga marrësi.

2.5 Tarifat e postës restante të mbledhura nga marrësi;

2.6 Një pagesë për magazinimin e çdo artikulli të postës së letrave që peshon më shumë se 500 gram për të cilat marrësi nuk ka marrë dorëzimin në periudhën e përshkruar. Kjo pagesë nuk do të zbatohet për cekogramën (literaturën për të verbërit).

3. Operatorët e caktuar të përgatitur për tu mbrojtur nga rreziku i forcave madhore do të jenë të autorizuar për të mbledhur pagesat për mbrojtjen nga risku i forcave madhore, shuma e udhëzimit për të cilat do të jetë 0.13 SDR për çdo artikull të regjistruar.

Neni RL 107

Kushte të zbatimit të tarifave postare

1. Shtetet anëtare të cilat për arsye të sistemit të tyre të brendshëm nuk janë në gjendje të përdorin sistemin metrik dhjetëshifror të peshës mund të përdorin ekuivalentin zëvendësues të sistemit të tyre të brendshëm.

2. Shtetet anëtare mund të ndryshojnë strukturën e njësive të peshës të paraqitur në nenin RL 105.

2.1 Për çdo kategori, njësia e fundit i peshës nuk duhet të kalojë maksimumin e peshës së treguar në nenin RL 121.

3. Shtetet anëtare që kanë shfuqizuar kartolinat, letrat e printuara ose pakot e vogla si kategori të ndara të artikujve në shërbimin e tyre të brendshëm mund të bëjnë të njëjtën gjë në lidhje me postën për jashtë vendit.

4. Tarifat e aplikueshme për artikujt e postës së letrave me prioritet do të përfshijnë koston shtesë të transportit të shpejtë.

5. Operatorët e caktuar që zbatojnë sistemin e bazuar në përmbajtjen e artikujve të postës së letrave do të jenë të autorizuar:

5.1 të mbledhin pagesat shtesë për artikujt e postës së letrave me transport ajror;

5.2 të mbledhin pagesat shtesë më të ulëta se ato që mbledhin për artikujt me transport ajror për artikujt e transportit ajror brenda vendit "S.A.L." me prioritet të reduktuar;

5.3 të përcaktojnë tarifën e kombinuara për pagesat e artikujve të postës ajrore dhe artikujt S.A.L., duke llogaritur koston e shërbimeve postare të kryera nga ata dhe koston e transportit ajror.

6. Tarifat shtesë do të jenë të lidhura me tarifën e transportit ajror dhe do të jenë uniforme të paktën për të gjithë territorin e çdo shteti të destinacionit pavarësisht nga itinerari i përdorur; në llogaritjen e tarifave ajrore shtesë për një artikull të postës së letrave me transport ajror, operatorët e caktuar do të jenë të autorizuar të konsiderojnë peshën e çdo formulari të përdorur nga publiku e cila mund të jetë e bashkëlidhur me artikullin.

7. Operatorët e caktuar të origjinës mund të lejojnë, për artikujt e postës së letrave që përmbajnë:

7.1 gazeta dhe publikime periodike të botuara në shtetet e tyre, një zbritje jo më shumë se 50% në parim të tarifës së aplikueshme për kategorinë e artikullit të përdorur;

7.2 libra dhe broshura, disqe dhe harta, me kusht që ato nuk përmbajnë materiale publicitare ose reklama të ndryshme nga ajo që paraqitet në kapak ose në fletë palosje, e njëjta zbritje si ajo e ofruar sipas 7.1.

8. Operatorët e caktuar kanë të drejtën të kufizojnë zbritjen e parashikuar në pikën 7 për gazetën dhe publikimet periodike që përmbushin kushtet e kërkuara nga rregullorja e brendshme për transportimin për tarifën e gazetave. Ky reduktim nuk duhet të kalojë atë të letrave të printuara për tregtim si katalogët, reklamën, listat e çmimeve etj., pavarësisht nga mënyrë e rregullt në të cilën ato janë lëshuar. E njëjta do të aplikohet për njoftimet e printuara në fletë të bashkëlidhura me gazetën dhe publikimet periodike. Megjithatë zbritja do të jetë e mundshme në rastet e inserteve publicitare të veçuara që do të konsiderohen si pjesë e pandashme e gazetës ose e periodikeve.

9. Operatorët e caktuar të origjinës mund të aplikojnë për artikujt e pa standartizuar tarifën të ndryshme nga ato të aplikueshme për artikujt e standartizuar të përcaktuar në nenin RL 128.

10. Zbritja në pagesa sipas pikës 7 do të aplikohet gjithashtu për artikujt e dërguar në rrugë ajrore, por nuk do të akordohet asnjë zbritje në përpjestim të tarifës të caktuar për të mbuluar kostot e këtij transporti.

Neni RL 108

Llogaritja e tarifave shtesë për artikujt e postës ajrore

1. Operatorët e caktuar do të jenë të autorizuar të përdorin njësi peshe më të vogla se ato të paraqitura në nenin RL 105.1, për llogaritjen e tarifave shtesë për artikujt e postës ajrore.

Neni RL 109

Ekuivalente

1. Operatorët e caktuar do të caktojnë ekuivalenten e tarifave postare të përshkruara në Konventë dhe Aktet e tjera të Bashkimit dhe çmimin e shitjes së kuponave ndërkombëtare të përgjigjes. Ata do t'ia komunikojnë ato Byrosë Ndërkombëtare për t'iu njoftuar operatorëve të caktuar. Për këtë qëllim çdo operatori të caktuar do ti kërkohet të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për vlerën mesatare të konvertimit të SDR në monedhën e atij shteti.

2. Vlera mesatare e SDR e cila do të jetë operative nga 1 Janari i çdo viti, për qëllimin e vetëm të vendosjes së tarifave, do të përcaktohet, në katër shifra të dhjetëshes, në bazë të të dhënave të publikuara nga IMF për një periudhë prej të paktën 12 muaj të përfunduar në 30 Shtatorin e mëparshëm.

3. Për një monedhë, kursi i këmbimit të ditës me SDR nuk është publikuar nga IMF, llogaritja do të realizohet me anë të mesatares së një monedhe të kuotuar.

4. Shteteve anëtare të bashkimit, kursi i këmbimit të monedhës së të cilave në lidhje me SDR nuk janë llogaritur nga IMF ose të cilat nuk janë anëtare të agjencisë së specializuar, do tu kërkohet të deklarojnë në mënyrë të njëanshme një ekuivalente midis monedhës së tyre dhe SDR.

5. Operatorët e caktuar do ti komunikojnë Byrosë Ndërkombëtare ekuivalenten ose ndryshimet e ekuivalentes të tarifave postare sa më shpejtë të jetë e mundur, duke dhënë datën e hyrjes në fuqi.

6. Byroja Ndërkombëtare do të publikojë një përmbledhje duke treguar, për çdo shtet anëtar, ekuivalenten e tarifave, vlerën mesatare të SDR-së dhe çmimin e shitjes së kuponave ndërkombëtare të përgjigjes të përmendur sipas pikës 1.

7. Çdo operator i caktuar duhet të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për ekuivalenten që ai ka përshtatur për dëmshpërblimet e parashikuara në rast humbje të një artikulli të regjistruar ose të një thesi M të regjistruar.

Neni RL 110

Përfshirja nga pagesat postare për artikujt e shërbimeve postare

1. Artikujt e postës së letrave në lidhje me shërbimet postare të dërguara nga operatorët e caktuar ose zyrat e tyre, qoftë me rrugë ajrore, ose me transportim të brendshëm ajror (S.A.L.), do të përfshihen nga të gjitha tarifat postare.

2. Artikujt e postës së letrave që lidhen me shërbimet postare do të përfshihen nga të gjitha tarifat postare, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror, nëse ato janë:

2.1 Shkëmbimet midis organeve të Bashkimit Postar Universal dhe organe të Sindikatave të Kufizuara;

2.2 shkëmbime midis organeve të këtyre Sindikatave;

2.3 dërguar nga këto organe për shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar ose zyrat e tyre.

Neni RL 111

Zbatimi i përjashtimeve nga tarifat postare për organe që lidhen me të burgosur të luftës dhe të internuar civilë

1. Sa në vijim do të gëzojnë përjashtimin nga tarifat postare sipas kuptimit të nenit 7.2 të Konventës:

1.1 Zyra e Informacionit sipas kushteve të nenit 122 të konventës së Gjenevës datë 12 Gusht 1949 lidhur me trajtimin e të burgosurve të luftës;

1.2 Agjencia Qendrore e Informacionit të të Burgosurve të Luftës sipas kushteve të nenit 123 të kësaj Konvente;



1.3 Zyra e Informacionit sipas kushteve të nenit 136 të Konventës së Gjenevës, datë 12 Gusht 1949, në lidhje me mbrojtjen e personave civil në kohë lufte;

1.4 Agjencia e Përgjithshme e Informacionit sipas kushteve të nenit 140 të Konventës së fundit.

Neni RL 112

Shënimi i artikujve të dërguar pa tarifa postare

1. Artikujt e përjashtuar nga tarifat postare do të mbartin, në anën e adresës në krye të cepit të djathtë, të dhënat e mëposhtme, të cilat mund të ndiqen nga një përkthim:

1.1 "Service des postes" (Shërbimi Postar) ose një e dhënë e ngjashme për artikujt e përmendur në nenin 7.1 të Konventës dhe nenit RL 110;

1.2 "Service des prisonniers de guerre" (Shërbime të të burgosurve të luftës) ose "Service des internés civils" (Shërbime të të internuarve civilë) për artikujt e përmendur në nenin 7.2 të Konventës dhe nenin RL 111 dhe format që lidhen me to;

1.3 "Cécogrammes" (Literaturë për të verbër) për artikujt e shënuar në nenin 7.3 të Konventës.

KAPITULLI 3

PULLAT POSTARE. MËNYRAT E SHËNIMIT TË PAGESAVE

Neni RL 113

Pullat Postare. Njoftimi i lëshimit dhe shkëmbimi midis operatorëve të caktuar

1. Çdo emetim i ri i një pulle postare do të njoftohet nga operatorët e caktuar, për të gjithë operatorët e caktuar, me të gjitha informacionet e nevojshme, me anë ndërmjetësinë e Byrosë Ndërkombëtare.

2. Operatorët e caktuar do të shkëmbejnë, me ndërmjetësinë e Byrosë Ndërkombëtare, një set të secilës prej emetimeve të reja të pullave postare dhe do të dërgojë Byrosë Ndërkombëtare 15 sete. Këto përfaqësojnë një total prej 235 pullash që do të shpërndahen për çdo emetim të ri.

Neni RL 114

Parapagime. Mënyrat e shënimit të parapagimeve

1. Parime

1.1 Si një rregull i zakonshëm, artikujt do të parapagohen nga dërguesi.

2. Mënyrat e shënimit të parapagimeve

2.1 Parapagimet do të shënohen me anë të secilës prej mënyrave të mëposhtme:

2.1.1 Pullat postare të printuara ose të ngjitura tek artikujt dhe të vlefshme në shtetin anëtar të origjinës;

2.1.2 Parapagesat postare me vulë të vlefshme në shtetet anëtare të origjinës dhe të shpërndara automatikisht në makineritë e shitjes të instaluara nga operatorët e caktuar të origjinës;

2.1.3 Vulë të makinerive shpërndarëse të miratuara zyrtarisht të vlefshme në shtetin e origjinës, vepruese nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të operatorëve të caktuar të origjinës;

2.1.4 Vula të realizuara nga një makinë shtypi ose nga procese të tjera printimi dhe stampimi kur një sistem i tillë është i autorizuar nga rregullat e operatorit të caktuar të origjinës.

2.2 Artikujt gjithashtu mund të pajisen me një shënim që tarifa e plotë postare është parapaguar, për shembull, "Taxe perçue" ("Tarifa e postës e paguar"). Ky shënim do të paraqitet në qendër të krahut të djathtë në anë të adresës dhe do të vërtetohet me anë të një vule datare të zyrës së origjinës. Në rastin e artikujve të papaguar ose të nënpaguar, vula e zyrës që përgatit artikullin ose përgatit postën, do të ketë këtë shënim në krah të kundërt.

Neni RL 115

Karakteristika të pullave postare dhe parapagesave postare ose vendosja e pullave

1. Pullat postare dhe vulat e parapagesave postare

1.1 Pullat postare dhe vulat e parapagesave postare mund të jenë të çdo forme të cilat, në parim, nuk kanë përmasa vertikale dhe horizontale më të vogla se 15 mm dhe më të mëdha se 50 mm.

1.2 Ato mund të jenë në mënyrë dalluese të shënuara me shpues vrimash ose stampues të prodhuar sipas një vule stampuese, subjekt i kushteve të paraqitura më poshtë nga operatorët e caktuar të cilët i kanë emetuar ato, me kusht që këto procese të mos ndërhyjnë me qartësinë e veçantive të parashikuara në nenin 8 të Konventës.

1.3 Pullat postare përkujtime ose të bamirësisë mund të mbartin një të dhënë të vitit të emetimit në numra arab. Në mënyrë të ngjashme ato mund të mbartin një mbishkrim në çfarëdo gjuhë për të treguar rastin për të cilin ato janë emetuar. Kur është e pagueshme një tarifë shtesë në përputhje me vlerën e tyre postare, ato do të caktohen në një mënyrë të tillë, që të mos lenë dyshime për këtë vlerë.

2. Makineritë e vendosjes së pullave

2.1 Operatorët e caktuar mund të përdorin vetë ose të autorizojnë përdorimin e makinerive të vendosjes së pullave postare duke riprodhuar në artikuj emrin e shtetit anëtar të origjinës dhe vlerën postare, si dhe emrin e vendit të origjinës dhe datën e postimit. Megjithatë, dy artikujt e fundit të informacionit nuk duhet të jenë të detyrueshëm. Për makineritë e vendosjes së pullave postare të përdorura nga vetë operatorët e caktuar, vlera e postimit mund të zëvendësohet nga një e dhënë se postimi është parapaguar, për shembull në formën: "Taxe perçue" (Taksa e paguar).

2.2 Vulat e prodhuara nga makineritë e vendosjes së pullave, në parim duhet të jenë me ngjyrë të kuqe të shndritshme. Megjithatë operatorët e caktuar mund të lejojnë që vula e prodhuar nga makineritë e vendosjes së pullave të jetë me një ngjyrë të ndryshme nga ajo e kuqe e shndritshme. Vula e çdo sloganeve publicitare e përdorur me makineritë e vendosjes së pullave gjithashtu mund të vendosen në një ngjyrë të ndryshme nga e kuqja.

2.3 Emrat e shteteve anëtare dhe vendeve të origjinës do të vendoset në shkronja romake, të cilat mund të plotësohen nga i njëjti informacion në shkronja të tjera. Vlera e postimit duhet të shënohet me shifra arabe.

3 Vulat e postimit

3.1 Vulat e postimit të realizuara nga një makinë shtypi ose nga ndonjë makineri tjetër printimi apo stampimi duhet të mbartin emrin e shtetit anëtar të origjinës dhe, nëse është e përshtatshme, të zyrës së postimit në shkronja romake, çka mund të plotësohet nga i njëjti informacion me shkronja të tjera. Ato gjithashtu do të mbartin një të dhënë që postimi është parapaguar, për shembull në formën e "Taxe perçue" (Taksa e paguar). Në çdo rast, fraza e përdorur do të tregohet me shkronja të zeza në një hapësirë, zona e së cilës nuk duhet të jetë më e vogël se 300 mm². Vula datare, nëse është përdorur, nuk duhet të vendoset në këtë hapësirë.

3.1bis Vulat e postimit të realizuara nga një makinë elektronike shtypi mund të vendoset sipër zonës së adresës, e ndarë nga ajo me një distancë vertikale midis 2.5 dhe 5 mm, pavarësisht vendosjes së adresës. Kjo vulë e postimit mund të vendoset drejtpërdrejtë në zarf ose në kapakun e zarfit. Në rastin e fundit, printimi dhe pozicionimi i artikujve brenda zarfit do të jetë e këshëzuar në mënyrë që asnjë pjesë e vulës së postimit të mos jetë më e vogël se 5 mm nga ana e kapakut të zarfit. Për këtë lloj vule do të zbatohen dispozitat e paragrafit 3.1. Kur vula e postimit përfshin ose mbështetet nga të dhëna të koduara në një simbol dy – dimensional, kjo do të përputhet me standardin S28 të UPU.

Neni RL 116

Dyshimi i përdorimit për mashtrim i pullave postare ose parapagesave postare ose vulave të postimeve

1. Subjekt i krimit kombëtar ose dispozitave të një veprimi kriminal, do të respektohen procedurat e mëposhtme në rast të një dyshimi të një shkelje të qëllimshme në lidhje me mjetet e parapagesave postare.

1.1 Kur, në postën në dalje, dyshohet për një shkelje të qëllimshme në lidhje me mjetet e parapagesave postare dhe dërguesi nuk njihet, pulla ose vula nuk do të preken në asnjë mënyrë. Artikulli, i shoqëruar nga një njoftim, do të përcillet në zyrën e dërgimeve në një zarf të regjistruar zyrtarisht. Një kopje e njoftimit do të dërgohet, për informacion, operatorëve të caktuar të shteteve anëtare të origjinës dhe të destinacionit. Çdo operator i caktuar mund të kërkojë, me anë të njoftimit të Byrosë Ndërkombëtare, për këto njoftime në lidhje me shërbimet për ti dërguar administratës së tyre qëndrore ose një zyre të caktuar posaçërisht.



1.2 Marrësi do të ftohet për të parë këtë provë. Artikulli do ti dërgohet atij vetëm nëse ai paguan vlerën e duhur, zbulon emrin dhe adresën e dërguesit dhe vendos në dispozicion të shërbimeve postare, pasi është njohur me përmbajtjen, subjektin e shkeljes së dyshuar. Kjo mund të jetë i gjithë artikulli, nëse është i pandashëm nga corpus delicti, ose një pjesë e artikullit, (zarf, amballazh, një pjesë letre, etj.) që përmban adresën dhe vulën ose pullën e raportuar si e dyshimtë. Rezultati i intervistës do të vendoset në një raport zyrtar të nëshkruar nga zyrtari i postës dhe marrësi. Nëse marrësi refuzon, kjo do të regjistrohet në dokument.

2. Raporti zyrtar do të dërgohet së bashku me dokumentet mbështetëse, te operatori i caktuar i shtetit anëtar të origjinës, i cili do të veprojë në përputhje me legjislacionin e tij.

3. Operatorët e caktuar, legjislacioni i të cilëve nuk lejon procedurën e paraqitur në pikat 1.1 dhe 1.2 do të informojë Byronë Ndërkombëtare për këtë në mënyrë që operatorët e tjerë të caktuar të mund të njoftohen.

Neni RL 117

Vendosja e vulës datare

1. Vendosja e vulës datare e cila tregon, me shkronja romake, emrin e zyrës përgjegjëse për fshirjen dhe data e operacionit, do të vendoset në anën e adresës së artikujve. Mund të shtohen veçanti ekuivalente me shkronjat e shtetit të origjinës.

2. Vendosja e vulës datare nuk do të jetë e detyrueshme:

2.1 për artikujt e postimit pa pagesë me anë të makinerive të vulosjes së postimit pa pagesë nëse emri i vendit të origjinës dhe data e postimit paraqitet në këtë vulë;

2.2 për artikujt e postuar sipas vulës së përfutur nga një makinë shtypi ose me anë të një mënyre tjetër printimi ose stampimi;

2.3 për artikujt e pa regjistruar me tarifë të reduktuar, me kusht që vendi i origjinës të tregohet në këta artikuj;

2.4 Për artikujt e postës së letrave që lidhen me shërbimet postare të renditura në nenin 7.1 të Konventës dhe nenit RL 110.

3. Të gjitha vulat postare të vlefshme për parapagesat do të fshihen.

4. Me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar kanë përshkruar fshirjen sipas një vule të veçantë, vula postare e pa fshirë për shkak të një gabimi ose mos veprimi në shërbimin e origjinës do të fshihet nga zyra që zbulon parregullsinë, duke përdorur një prej mënyrave të mëposhtme:

4.1 me një vijë të trashë boje ose laps që nuk fshihet;

4.2 duke përdorur skajin e vulës datare në mënyrë të tillë që emri i zyrës postare të mos jetë i identifikueshëm.

5. Artikujt e dërguar gabim, me përjashtim të artikujve të paregjistruar me tarifë të reduktuar, do të vulosen me një vulë datare të zyrës së cilës ato i kanë vajtur gabimisht. Ajo do të aplikohet në të dyja zyrat, dhe nëse është e mundur, në zyrat e udhëtimit. Vula duhet të realizohet pas artikullit me përparësi në zarf dhe letra dhe në pjesën e përparme të kartolinave.

Neni RL 118

Artikujt e papaguar ose të nën paguar

1. Operatorët e caktuar të origjinës mund ti kthejnë dërguesit artikuj të papaguar ose të nënpaguar në mënyrë që ky i fundit të kryejë postimin në vijim. Dërguesi i artikujve të pa paguar ose të nën paguar do të identifikohet me anë të mënyrave të siguruara për këtë sipas rregullores së brendshme të shteteve anëtare të origjinës, duke përfshirë ato të zbatueshme për artikujt e pa dërgueshëm.

2. Operatorët e caktuar e origjinës, gjithashtu mund të marrin përsipër të parapagujnë artikuj të pa paguar të postës së letrave ose të realizojnë postimin për artikujt e nën paguar dhe të mbledhin shumat që mungojnë nga dërguesi. Në këtë rast, ata do të jenë të autorizuar që gjithashtu të mbledhin një tarifë përpunimi prej 0.33 SDR.

3. Nëse operatorët e caktuar të origjinës nuk zbatojnë asnjë prej opsioneve të parashikuara në 1 dhe 2 ose nëse postimi nuk mund të realizohet nga dërguesi, artikujt prioritarë të papaguar ose të nën paguar, letrat dhe kartolinat do të dërgohen në vendet e destinacionit. Gjithashtu, mund të dërgohen edhe artikuj të tjerë të papaguar ose të nën paguar.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 3, operatorët e caktuar të origjinës nuk do të jenë të detyruar të dërgojnë në vendet e destinacionit kategoritë vijuese të artikujve kur ata kanë postuar në kutitë postare ose pajisje të tjera të operatorëve të caktuar:

4.1 artikujt e papaguar ose të nën paguar në të cilat dërguesi nuk është shënuar ose dërguesi i të cilave nuk mund të identifikohet;

4.2 kartolina të papaguara që mbartin etiketat ose shënime që pretendojnë të vërtetojnë se postimi është paguar.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 9, operatorët e caktuar të origjinës nuk do të jenë të detyruar të dërgojnë në vendet e destinacionit kartolina të papaguara që kanë etiketën ose shënimet për të vërtetuar që pagesa është realizuar, kur kartolina të tilla janë postuar në kutitë postare ose pajisje të tjera të operatorëve të caktuar.

6. Operatorët e caktuar të origjinës do të përcaktojnë kriteret për kthimin e artikujve të papaguar ose të nënpaguar në shtetin e destinacionit. Megjithatë, operatorët e caktuar, si rregull i përgjithshëm, duhet të shpërndajnë me mënyrën e shpejtë (ajrore ose tokësore) artikujt e shënuar nga dërguesi për tu dërguar si artikuj me prioritet ose artikujt me postë ajrore.

7. Një operator i caktuar i origjinës i cili dëshiron që një postim të humbur të merret nga marrësi do të ndjekë procedurën e përshkruar në pikat 8 dhe 10. Artikujt e papaguar ose të nënpaguar që i nështrohen kësaj procedure do të ngarkohen me një tarifë të veçantë, llogaritja e së cilës është përcaktuar në pikën 11, të pagueshme nga marrësi ose, në rastin e artikujve të kthyer, nga dërguesi.

8. Përpara se të dërgohen në shtetin e destinacionit, artikujt e papaguar ose të nën paguar do të shënohen me vulën T (detyrim për tarifën) në mes të pjesës së sipërme të faqes. Pranë vendosjes së vulës operatorët e caktuar të origjinës do të shkruajnë në mënyrë shumë të lexueshme, në monedhën e shtetit të tij, shumën e nën pagesave dhe, poshtë një vije thyesore, atë të minimumit të tarifës së parëdaktuar të vlefshme për njësinë e parë të peshës për artikujt me prioritet ose letrat e shpërndara në gjithë botën.

9. Operatorët e caktuar të origjinës do të jenë përgjegjës për të kontrolluar nëse artikujt ndërkombëtar të postuar në shtetet e tyre janë përgatitur në mënyrë e duhur. Në mbërritje në vendin e destinacionit, çdo artikull që nuk ka vulën T në përputhje me dispozitat sipas pikës 8, do të konsiderohet se është parapaguar në mënyrën e duhur dhe do të trajtohet si i tillë.

10. Kur një operator i caktuar i destinacionit të parë kërkon që postimet e munguara të mbledhen nga marrësi (artikujt e ridërguar) ose nga dërguesi (artikujt e kthyer), objektivi i aplikimit të vulës T dhe dhënies së shumës në formën e një fraksioni do të jetë përgjegjësi e këtyre operatorëve të caktuar. E njëjta procedurë do të aplikohet në rastin e artikujve me origjinë nga shtetet që aplikojnë tarifa të reduktuara për shërbimet me operatorët e caktuar të ridërgimit. Në një rast të tillë, fraksioni do të vendoset në përputhje me tarifat e paraqitura në këtë Rregullore dhe të vlefshme në shtetet e origjinës së artikujve.

11. Operatorët e caktuar dërgues që dëshirojnë të mbledhin postimet e munguara do të shënojnë artikullin me tarifat për tu mbledhur. Ai do të përcaktojë këto tarifa duke shumëzuar fraksionin që rezulton nga të dhënat e përmendura sipas pikës 8 me shumën, në monedhën e tij kombëtare, e tarifave të aplikuara në shërbimet ndërkombëtare për njësinë e parë të peshës ose letrat e shpërndara jashtë shtetit. Kësaj tarife, ai do ti shtojë shpenzimet shtesë të përshkruara në pikën 2. Operatorët e caktuar dërgues, nëse dëshirojnë, të mbledhin vetëm tarifën e përpunimit.

12. Nëse thyesa e përcaktuar sipas pikës 8 nuk është paraqitur pranë vulës T nga operatorët e caktuar të origjinës ose operatorët e caktuar të ri-dërgimit në rastin e mos-dërgimit, operatorët e caktuar të destinacionit mund të dorëzojnë artikujt e nën paguar pa mbledhur tarifën.

13. Vulat postare dhe vendosja e pullave jo të vlefshme për parapagesa të postimeve nuk do të merren në konsideratë. Në këtë rast, pranë kësaj pulle postimi ose vule do të shënohet me rreth me laps shifra me vlerë zero (0).

14. Artikujt e regjistruar dhe artikujt e pasiguruar do të konsiderohen në mbërritje si të parapaguar në mënyrë të duhur.

Neni RL 119

Parapagesa dhe vulosja e artikujve të postuar me rrugë detare

1. Artikujt e postuar me rrugë detare, në dy pikat përfundimtare të udhëtimit ose në çdo port ndërmjetës të caktuar, do të përgatiten me anë të vulave të postimit dhe sipas çmimeve të shtetit në ujrat e të cilat qëndron anija.



2. Nëse artikujt janë postuar me rrugë detare në det të hapur, ato mund të parapaguhen, në mungesë të një marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, me anë të vulës postare dhe në përputhje me çmimet e shtetit të cilit i përket anija ose me të cilin ka lidhur kontratë. Artikujt e parapaguar në këtë mënyrë mund ti dorëzohen zyrës postare të portit sa më shpejtë të jetë e mundur pas mbërritjes së anijes.

3. Vulosja e artikujve të postuar në anije do të jetë përgjegjësi e oficerit të postës ose punonjësit në bord të ngarkuar me këtë detyrë, ose në mungesë të tyre, të zyrës postare në portin e mbërritjes në të cilin këto artikuj dorëzohen. Në këtë rast, punonjësi do të vulosë korrespondencën me vulën e tij datare dhe të shtojë fjalën "Navire" (anije), "Paquebot" (varkë) ose ndonjë shënim tjetër të ngjashëm.

KAPITULLI 4 KATEGORITË E ARTIKUJVE DHE KUSHTET E PRANIMIT

Neni RL 120
Shërbime bazë

1. Çdo operator i caktuar do të jetë i lirë të zgjedhë sistemin që do të zbatojë në trafikun e tij të jashtëm të bazuar në shpejtësinë e trajtimit të artikujve ose të bazuar në përmbajtjen e artikujve.

2. Në sistemin e klasifikimit të bazuar në shpejtësinë e trajtimit të artikujve, këto të fundit janë të ndara në:

2.1 artikuj prioritar, p.sh artikuj të transportuar me anë të itinerareve më të shpejta (rrugë ajrore ose tokësore) me prioritet;

2.2 Artikuj jo me prioritet, p.sh. artikuj për të cilët dërguesi ka zgjedhur një tarifë më të ulët, duke implikuar një kohë më të gjatë dërgimi.

3. Në sistemin e klasifikimit të bazuar në përmbajtje:

3.1 artikujt e transportuar me postë ajrore me prioritet do të quhen "artikuj me postë ajrore";

3.2 artikujt e postës tokësore të transportuara në rrugë ajrore me prioritet të reduktuar do të quhen artikuj "S.A.L. ".

4. Çdo operator i caktuar mund të pranojë artikuj me prioritet dhe artikuj me postë ajrore që konsistojnë në një fletë letrë të pakeluar në mënyrë të përshtatshme dhe të ngjitur në të gjitha anët. Artikuj të tillë do të quhen "aerograme". Në sistemin e klasifikimit të bazuar në përmbajtje "Aerogramet" do të konsiderohen si të ngjashëm me letrat e postës ajrore.

5. Posta që konsiston në artikuj të postuar në sasi të madhe nga i njëjti dërgues dhe i marrë në të njëjtën pikë shpërndarje ose në shpërndarës të ndryshëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet RL 124.8, do të quhen "postë në sasi të madhe".

Neni RL 121
Veçori që lidhen me kufijtë e peshës.

1.1 Artikuj me prioritet dhe jo prioritet mund të peshojnë deri në 5 kilogram:

1.1.1 Në lidhjen midis operatorëve të caktuar kur të dy pranojnë artikuj të tillë nga klientët e tyre.

1.1.2 Për artikujt që përmbajnë libra dhe broshura, dhe operatorët e caktuar të origjinës që kanë alternativën e pranimit të artikujve të tillë.

1.2 Në sistemin e bazuar në përmbajtje:

1.2.1 Letrat dhe pakot e vogla mund të peshojnë deri në 5 kilogram në marrëdhëniet midis operatorëve të caktuar kur të dy pranojnë artikuj të tillë nga klientët e tyre.

1.2.2 Letrat e printuara mund të peshojnë deri në 5 kilogram, dhe operatorët e caktuar të origjinës kanë alternativën e pranimit të artikujve të tillë.

2. Kufiri i peshës së artikujve që përmbajnë libra ose broshura mund të rritet deri në 10 kilogram me marrëveshje midis operatorëve të caktuar të interesuar.

3. Artikujt e dërguar me anë të shërbimeve postare të përmendura në nenet 7.1 të Konventës dhe nenit RL 110 nuk do të jenë subjekt i limiteve të peshës të përcaktuara në nenin 12 të Konventës dhe në pikat 1 dhe 2 më sipër. Megjithatë, ata nuk do të kalojnë peshën prej 30 kilogram për thes.

4. Operatorët e caktuar mund të aplikojnë, për artikujt e postës së letrave të postuar në vendet e tyre, maksimumin e limitit të peshës të paraqitur për nenet për të njëjtin lloj në shërbimin e tyre të brendshëm me kusht që këta artikuj të mos kalojnë limitin e peshës të përmendur në nenet 12 e Konventës dhe në pikat 1 dhe 2 të mësipërme.

Neni RL 122 Limitet e përmasave

1. Limitet e përmasave për artikujt e ndryshëm nga kartolinat dhe aerogramet paraqiten më poshtë:
 - 1.1 Maksimumi: gjatësi, gjerësi dhe thellësi të kombinuara: 900 mm, por përmasa më e madhe nuk duhet të kalojë 600 mm, me një tolerancë prej 2 mm; në formë të rrumbullakët: gjatësia plus dyfishin diametrit: 1,040 mm, por përmasa më e madhe nuk duhet të kalojë 900 mm, me një tolerancë prej 2 mm;
 - 1.2 minimumi: të ketë një sipërfaqe me përmasë jo më të vogël se 90 x 140 mm, me një tolerancë prej 2 mm; në formë rrumbullake: gjatësi plus dyfishin e diametrit: 170 mm: por përmasa më e madhe nuk duhet të jenë më të vogla se 100 mm.
2. Limitet e përmasave të kartolinave do të jenë si më poshtë vijon:
 - 2.1 maksimumi: 120 x 235 mm, me një tolerancë prej 2 mm, nëse ato janë mjaftueshmërisht të sërta për të përballuar procesin pa vështirësi;
 - 2.2 minimumi: 90 x 140 mm, me një tolerancë prej 2 mm. Gjatësia do të jetë të paktën e barabartë me gjerësinë shumëzuar me $\sqrt{2}$ (vlera e përafërt 1.4).
3. Limitet e përmasës së aerogrameve do të jenë si më poshtë vijon:
 - 3.1 maksimumi: 110 x 220 mm, me një tolerancë prej 2 mm;
 - 3.2 minimumi: 90 x 140 mm, me një tolerancë prej 2 mm. Gjatësia do të jetë të paktën e barabartë me gjerësinë shumëzuar me $\sqrt{2}$ (vlera e përafërt 1.4).
- 3bis. Limitet e përmasave në këtë nen nuk do të aplikohen për shërbimet e artikujve postar të përmendur në nenin 7.1 të Konventës dhe nenit RL 110.

Neni RL 123 Kushte të pranimit të artikujve. Përgatitja. Paketimi

1. Artikujt do të përgatiten në mënyrë të sigurt dhe në një mënyrë të tillë që të mos ekzistojë risku që artikujt të tjerë të ngecin te ata. Paketimi do të përshtatet me formën dhe llojin e artikullit dhe kushtet e transportit. Në rastin e letrave dhe pakove të vogla, ai duhet të sigurojë paprekshmërinë e përmbajtjes gjatë transportit. Çdo artikull do të përgatitet në një mënyrë të tillë që të mos rrezikojë shëndetin e nënpunësve. Përgatitja do të pengojë çdo dëmtim nëse artikulli përmban materiale që sipas të gjitha gjasave mund të dëmtojnë nënpunësit e ngarkuar për ti përpunuar ato që ndotin ose dëmtojnë artikujt e tjerë ose pajisjet postare. Kapëset metalike të përdorura për mbylljen e artikujve nuk duhet të ketë skaje të mprehta, dhe as nuk duhet të pengojnë realizimin e shërbimit postar .
 - 1.1 Operatorët e caktuar mund të bien dakord të shkëmbejnë artikuj në sasi të mëdha, që nuk janë ambalazhuar ose pakëtuar. Operatorët e caktuar të shpërndarjes dhe operatorët e caktuar të destinacionit duhet të vendosin me një marrëveshje të përbashkët kushtet e postimit të këtyre artikujve.
2. Kodi i identifikimit UPU, siç është përcaktuar në Standartet S18 në Manualin e Standardeve Teknike, mund të zbatohet për artikujt e postës së letrave për të lehtësuar procesin e dërgimit në të dyja vendet atë të origjinës dhe atë të destinacionit dhe të përballojë procesin e shkëmbimit të informacionit midis operatorëve të caktuar të interesuar. Kodi i identifikimit do të aplikohet, nën autoritetin e operatorëve të caktuar, në përputhje me specifikimet e miratuara nga Këshilli Drejtues dhe dispozitat e Standardeve S18 dhe S19 në Manualin e Standardeve Teknike UPU. Për të maksimizuar lexueshmërinë e Kodit të identifikimit, operatorët e caktuar:
 - 2.1 mund të kodojnë informacionin në zonën R1, siç është përcaktuar në Standartet S19, vetëm në përputhje me dispozitat teknike të Standardeve S18 dhe S19;
 - 2.2 mund të nxisin njoftimin kundër përdorimit të zonës R1 për qëllime që mund të ndërhyjnë, ose për qëllime që mund të ngatërrohet, me qëllimin e synuar përdorur për kodin e identifikimit.
3. Operatorët e caktuar do të rekomandojnë në mënyrë të fuqishme klientët e tyre që të përmbushin rregullat e mëposhtme:



3.1 Të paktën gjysma e krahut të djathtë të adresës do të rezervohet për adresën e marrësve dhe për pullat postare, për vulat e postimit dhe vulat ose të dhënat në vend të saj. Ky i fundit do të aplikohet, nëse është e mundur, në qendër të cepit të krahut të djathtë. I takon operatorëve të caktuar në vendin e origjinës të trajtojnë artikujt pagesa e të cilëve nuk është konform me këtë kusht dhe në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3.2 Adresa e marrësit do të shkruhet në gjuhën e artikullit dhe nëse artikulli është një zarf, në anën që nuk është parashikuar për kapakun e mbylljes. Për artikujt që kalojnë kufijtë e përmasave për artikujt e standardizuar të përcaktuar në nenin RL 128, adresa mund të shkruhet në paralel me gjuhën e artikullit.

3.3 Adresa e marrësit do të shkruhet në një mënyrë të saktë dhe të plotë. Ajo do të shkruhet në mënyrë shumë të lexueshme me shkronja romake dhe numra arabë. Nëse përdoren shkronja të tjera dhe numrat të tjerë në vendin e destinacionit, do të rekomandohet që adresa e dhënë të shkruhet edhe në këto shkronja dhe numra. Emri dhe vendi i destinacionit dhe emri i shtetit të destinacionit do të shkruhet me shkronja të mëdha së bashku me numrat e kodit të rregullt postar ose numrin e zonës së dorëzimit ose numrin e zyrës postare, nëse ka një të tillë. Emri i vendit të destinacionit është mirë të shkruhet në gjuhën e vendit të origjinës. Për të shmangur çdo vështirësi në vendet e tranzitit, është e preferueshme që emri i vendit të destinacionit të shtohet në një gjuhë të njohur ndërkombëtare. Operatorët e caktuar mund të rekomandojnë, që në artikujt e adresuar për vendet ku pozicioni i rekomanduar për vendosjen e kodit postar është krye të emrit të vendit të destinacionit, kodi postar do të paraprihet nga kodi i shtetit EN ISO 3166-1 Alpha 2 i ndjekur nga një vijë ndarëse. Kjo nuk do të shmangë në asnjë mënyrë kërkesën për vendosjen e plotë të emrit të vendit të destinacionit.

3.4 Letra e zarfit do të jetë e përbërë nga një material që mund të përpunohet në mënyrë mekanike.

3.5 Për të lehtësuar leximin automatik, adresa e marrësit do të shkruhet në mënyrë kompakte, pa lënë hapësira midis shkronjave dhe pa vija të zeza midis vijave që përmbajnë vendin e destinacionit dhe elementëve të tjerë të adresës. Vendi dhe shteti i destinacionit dhe numri i kodit postar, nëse ka një të tillë duhet të nënvizohet.

3.6 Emri dhe adresa e dërguesit do të paraqitet në artikull me numër kodi postar ose numrin të zonës së dorëzimit, nëse ka një të tillë. Kur ata vendosen në krahun e adresës së zarfit, këto të dhëna do të vendosen në qendër të cepit të krahut të majtë dhe do të jenë të ndara në mënyrë të mjaftueshme nga adresa e marrësit për të shmangur çdo keqkuptim.

3.7 Adresat e dërguesit dhe marrësit do të paraqiten në mënyrën e duhur brenda artikullit dhe nëse është e mundur në përmbajtje. Kjo aplikohet veçanërisht për artikujt e hapur.

3.8 Klientëve që postojnë artikuj në sasi të mëdha me të njejtën formë dhe peshë mund tu kërkohej të paketojnë ato sipas kodeve postare ose numrit të zonave të dorëzimit në mënyrë të tillë që ato mund të përpunohen sa më shpejtë të jetë e mundur në shtetin e destinacionit. Operatorët e caktuar të destinacionit mund të kërkojnë këtë gradë të klasifikimit sipas një marrëveshje me operatorët e caktuar të origjinës.

4. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këto Rregullore, instruksionet e shërbimit dhe etiketat do të vendosen në anën e adresës së artikullit. Ato do të vendosen sa më larg të jetë mundur në qendër të cepit të krahut të djathtë, poshtë emrit të dërguesit dhe adresës kur këto janë dhënë. Instruksionet e shërbimit do të shkruhen në gjuhën Franceze ose në një gjuhë tjetër të njohur në vendin e destinacionit. Gjithashtu do të vendoset një përkthim i instruksioneve në gjuhën e vendit të origjinës.

Sender's address	Postage stamps, franking marks or impressions
Service instructions	
Addressee's address	

5. Vulat jo postare dhe ato të bamirësisë dhe etiketa të tjera si edhe dizenjot, të cilat mund të merren për pulla postare ose shërbime të etiketave, nuk duhet të vendosen ose printohen në krahun e adresës. Kjo do të zbatohet gjithashtu për vulat që gabimisht mund të jenë marrë për vula të postimit pa pagesë.

6. Në të gjitha rastet në të cilat artikulli është ri-ambalazhuar, adresa e marrësit do të shënohet në ambalazhin e sipërm.

7. Zarfet, cepat e të cilëve janë pajisur me shirita me ngjyrë do të rezervohen ekskluzivisht për artikujt me postë ajrore.

8. Adresa e artikujve të dërguar me postë restante do të paraqesin emrin e marrësit, qytetin, shtetin e destinacionit dhe nëse është e mundur, zyrën postare në të cilën do të dorëzohet artikulli. Shenja "Postë restante" do të shkruhet me shkronja të zeza dhe në anën e adresës. Përdorimi i inicialeve, figurave, vetëm i emrave të pagëzimit, emrave të rremë ose kode të markave të çfarëdo lloji nuk do të lejohen për këto artikuj.

9. Në letrat e printuara, emri i marrësit mund që, në mënyrë të veçantë, të ndiqet nga shenjat "ose titullar", në gjuhën Franceze ose një gjuhë të pranuar nga vendi i destinacionit.

10. Zarfë ose ambalazhimi duhet të mbartë vetëm adresën e një dërguesi, dhe një adresë të marrësit. Në rastin e postave në sasi të mëdha, adresa e dërguesit duhet të jetë e dukshme në pjesën e jashtme të artikullit dhe të ndodhur në shtetin e postimit të artikullit.

11. Nuk do të pranohet asnjë lloj artikulli, kur një pjesë e anës së adresës ose e gjithë ana e adresës të së cilit është shënuar në disa vija ndarëse për të vendosur adresa të tjera.

Neni RL 124

Dispozita të veçanta të zbatueshme për çdo kategori të artikujve

1. Artikuj dhe letra me prioritet / jo - prioritet

1.1 Subjekt i dispozitave që lidhen me artikut e standardizuar dhe artikujt e pakeluar, nuk do të përcaktohet asnjë kusht për formën ose mbylljen e artikujve ose letrave me prioritet / jo - prioritet. Megjithatë, artikuj të tillë në zarfe duhet të jenë drejtëkëndor për të siguruar që ata nuk do të shkaktojnë vështirësi gjatë transportimit të tyre. Artikuj me trashësi, por jo me formë, të kartolinave gjithashtu do të vendosen në zarfe drejtëkëndor. Zarfet do të jenë me ngjyrë të lehtë. Rekomandohet që fjala "Prioritet" ose "letër" të shtohet në anën e adresës të artikujve, të cilët për arsye të volumit të tyre ose përgatitjes, mund të ngatërrohen me artikuj të parapaguar me një tarifë të reduktuar.

2. Aerogrami

2.1 Aerogramet mund të jenë drejtëkëndor dhe të jenë përgatitur në mënyrë që të bëjnë të mundur mos pengimin e trajtimit të postës.

2.2 Pamja frontale e aerogramit do të rezervohet për adresën, parapagesën dhe shërbimin e shënimeve ose etiketave. Ajo do të mbartë shënimin e printuar "Aerogram" dhe mund të ketë gjithashtu një shënim ekuivalent në gjuhën e vendit të origjinës. Një aerogram nuk duhet të përmbajë asnjë shtojcë. Ajo mund të regjistrohet nëse rregullat e shtetit të origjinës e lejojnë këtë.



2.3 Çdo shtet anëtar ose operator i caktuar do të caktojë, brenda limiteve të përcaktuara në nenin RL 122.3, kushtet e lëshimit, prodhimit dhe shitjes së aerogramit.

3. Kartolinat

3.1 Kartolinat do të jenë drejtkëndore dhe të përbëra nga kartoni ose letër mjaftueshëm e sertë për mos të bërë të vështirë lëvizjen e postës. Ato nuk do të kenë pjesë të projektuara ose pjesë me relief dhe do të plotësojnë kushtet e paraqitura nga shtetet anëtare ose operatorët e caktuar të origjinës.

3.2 Kartolinat do të kenë në pjesën e përparme shënimin "Carte postale" (Kartolinë) në gjuhën frënge ose ekuivalenten në një gjuhë tjetër. Ky titull nuk do të jetë i detyrueshëm për kartolinat me figura.

3.3 Kartolinat do të dërgohen të pa mbyllura, që do të thotë pa ambalazh ose zarf.

3.4 Gjysma e anës së majtë të anës së përparme do të rezervohet për adresën e marrësit, për parapagime dhe për shënime udhëzimesh ose etiketa. Dërguesi mund të përdorë pjesën e pasme dhe gjysmën e anës së majtë të pjesës së përparme.

3.5 Kartolinat që nuk përputhen me rregullat për këtë kategori do të trajtohen si letra, me përjashtim kur parregullsia rrjedh vetëm nga tregimi i parapagimit në pjesën e pasme. Kartolina të tilla do të konsiderohen si të papaguara dhe do të trajtohen në përputhje me rrethanat.

4. Letrat e Printuara

4.1 Riprodhime në letër, karton ose materiale të tjera të përdorura në mënyrë të zakonshme në printime të prodhuar në disa kopje të njëjta me anë të një procesi të autorizuar nga shtetet anëtare ose operatorët e caktuar të origjinës mund të dërgohen si letra të printuara. Letra të printuara që nuk përmbushin këtë përkufizim gjithashtu mund të pranohen në shërbimet ndërkombëtare nëse ato pranohen në shërbimin e brendshëm të shtetit të origjinës.

4.2 Letrat e printuara do të mbartin me shkronja të zeza në anën e adresës, nëse është e mundur në krye të cepit të majtë, poshtë emrit të dërguesit dhe adresës së tij, nëse këto janë shënuar, shprehjen "Imprime" (e shtypur) ose "Imprimé à taxe réduite" (e shtypur me taksë të reduktuar) sipas rastit ose ekuivalenten në një gjuhë të njohur në shtetin e destinacionit. Këto shënime do të përbëjnë të dhënë se artikulli përmban vetëm letra të printuara.

4.3 Letrat e printuara që plotësojnë njëkohësisht kushtet e përgjithshme të aplikueshme për letrat e printuara dhe ato të aplikueshme për kartolinat do të pranohen të pa mbyllura me tarifën e letrave të printuara, edhe nëse ato mbajnë shënimin "Carte postale" (Kartolinë) ose ekuivalenten e titullit të saj në çdo gjuhë tjetër.

4.4 Disa letra të printuara mund të dërgohen së bashku në një artikull të vetëm duke u siguruar që ato nuk kanë emra dhe adresa të marrësve të ndryshëm. Operatorët e caktuar të origjinës mund të kufizojnë letrat e printuara të dërguara në këtë mënyrë me ato të dërguara nga një dërgues i vetëm.

4.5 Do të lejohet të gjitha letrat e printuara të përfshihen një kartelë, zarf ose ambalazh që mbart adresën e printuar të dërguesit të artikullit ose agjentit të tij në shtetin e postimit ose destinacionin e artikullit origjinal; mbyllja mund të parapërgatitet për kthim me anë të vulës postare ose vulave të parapagimeve të shtetit të destinacionit të artikullit të origjinës.

4.6 Operatorët e caktuar të të origjinës mund të autorizojnë shënime ose mbyllje në bazë të legjislacionit kombëtar.

4.7 Letrat e printuara do të përgatiten në mënyrë të tillë që përmbajtja e tyre të jetë mjaftueshmërisht e mbrojtur për të mundësuar verifikimin e shpejtë dhe të lehtë. Kushtet do të përcaktohen nga operatorët e caktuar të origjinës.

4.8 Operatorët e caktuar mund të autorizojnë mbylljen e letrave të printuara në sasi të mëdha, duke përdorur për këtë qëllim një leje për përdoruesit të cilët bëjnë kërkesën për një të tillë. Në një rast të tillë, numri i lejuar do të paraqitet poshtë shënimit "Imprimé" (Letër e printuar) ose "Imprimé à taxe réduite" (letra të printuara me taksë të reduktuar).

4.9 Në mënyrë alternative, operatorët e caktuar të origjinës do të lejohen të mundësojnë mbylljen e letrave të printuara pa autorizim nëse në shërbimin e tyre të brendshëm nuk kërkohet ndonjë kusht specifik për mbylljen.

4.10 Letrat e printuar mund të futen në mbështjellje plastike të mbyllura, transparente ose jo, në kushtet e përcaktuara nga shtetet anëtare ose operatorët e caktuar të origjinës.

4.11 Letrat e Printuara të mbyllura mund të hapen për verifikim të përmbajtjes së tyre.

5. Literatura për të verbër (cekograma)


5.1 Letrat që kanë shkrimin e përdorur nga të verbrit, të postuara pa u vulosur, dhe fletët e ilustruara që mbartin karakteristikat e shkrimit të përdorur nga të verbrit mund të dërgohen si literaturë për të verbër. E njëjta gjë do të aplikohet për regjistrimet muzikore dhe letrat e veçanta që janë përcaktuar vetëm për përdorim nga të verbërit, duke u siguruar që ato janë dërguar ose i adresuar një instituti për të verbër të njohur zyrtarisht.

5.2 Operatorët e caktuar të origjinës do të kenë të drejtën e pranimi si literaturë për të verbër të regjistrimeve muzikore të dërguara nga një person i verbër ose adresuar një personi të verbër nëse kjo e drejtë ekziston në shërbimin e tyre të brendshëm.

5.3 Operatorët e caktuar të origjinës do të lejohen të pranojnë si literaturë për të verbër artikujt e pranueshëm si të tillë në shërbimin e tyre të brendshëm.

5.4 Literatura për të verbrit duhet të përgatitet në një mënyrë të tillë që përmbajtja e saj të jetë mjaftueshmërisht e mbrojtur nëse kërkohet një verifikim i shpejt dhe i lehtë.

5.5 Operatorët e caktuar do të rekomandojnë që klientët e tyre të pajisin literaturën e tyre për të verbër, në anën në të cilën vendoset adresa e marrësit, me një etiketë të bardhë me simbolet në vijim:



6. Pako të vogla

6.1 Pakot e vogla do të mbartin, me shkronja të zeza në anën e adresës, nëse është e mundur në krye të cepit të majtë, nëse është e mundur poshtë emrit dhe adresës së dërguesit shprehjen "petit paquet" (pako e vogël) ose ekuivalenten e saj në një gjuhë të njohur nga shteti i destinacionit. Shënimi i adresës së dërguesit jashtë artikullit do të jetë e detyrueshme.

6.2 Gjithashtu do të lejohet të përfshihet çdo dokument tjetër që ka karakteristikat e një korrespondence të zakonshme dhe personale. Megjithatë, dokumenta të tillë mund të mos i jenë adresuar një marrësi dhe as të jenë dërguar nga një dërgues i ndryshëm nga ata të shënuar në pakon e vogël. Për më tepër rregulloret e brendshme të shtetit anëtar ose operatorit të caktuar mund të autorizojnë këtë përfshirje. Operatori i caktuar i origjinës do të vendosë nëse dokumenti ose dokumentet e përfshira përbushin këto kushte. Ai duhet të përcaktojë kushte të tjera të tilla që të jenë të përshtashme në lidhje me autorizimin e përfshirjes.

6.3 Nuk do të kërkohet asnjë kusht i veçantë për mbylljen e pakove të vogla; artikujt e caktuar si të tillë mund të hapen për verifikimin e përmbajtjes së tyre.

7. Thasët M

7.1 Disa artikujt të tjerë gjithashtu mund të pranohen në thasët M, me kusht që plotësohen kushtet e mëposhtme:

7.1.1 artikujt (disqe, kaseta; kampione tregtarë të dërguar nga prodhuesi dhe shpërndarësit; ose artikujt të tjerë tregtarë të pa taksueshëm ose materiale informuese që nuk janë subjekt rishitje) janë caktuar ose të kombinuar ndryshe me letra të printuara shoqëruese;



- 7.1.2 Artikujt e lidhur me letrat e printuara me të cilat ato janë dërguar;
- 7.1.3 pesha e çdo artikulli që përmban artikujt e përmendur në pikën 7.1.1 të kombinuara me letrat e printuara nuk i kalon dy kilogram;
- 7.1.4 Thasët M shoqërohen nga një formular dogane CN 22 ose CN 23 i përgatitur nga dërguesi në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin RL 152.4.
- 7.2 Adresa e marrësit do të vendoset në çdo paketim me letër të printuar që përfshihet në një thes të veçantë, dhe të dërgohet tek i njëjti marrës dhe tek e njëjta adresë.
- 7.3 Çdo thes M do të pajiset me një etiketë të rregullt adrese të dhënë nga dërguesi dhe që përfshin të gjitha informacionet në lidhje me marrësin. Etiketa e adresës duhet të jetë prej bezeje mjaftueshmërisht e sertë, kartoni të fortë, plastike, pergamene, ose letre të ngjitur në dru dhe do të ketë një syçkë. Ajo nuk do të jetë më e vogël se 90 x 140 mm me një tolerancë prej 2 mm.
- 7.4 Shuma totale e parapagimit për thasët M do të tregohet në etiketën e adresës në thes.
- 7.5 Me marrëveshjen midis operatorëve të caktuar të destinacionit, paketimet e letrave të printuara gjithashtu mund të pranohen si thasë M kur ato nuk janë pakëtuar në një thes. Paketime të tilla do të shënohen në mënyrë shumë të qartë me një shkronjë M afër adresës së marrësit. Lloji i përmbajtjes do të shënohet drejtpërdrejtë në artikull (CN 22/CN 23).
8. Postat në sasi të mëdha
- 8.1 Artikujt në sasi të mëdha do të karakterizohen nga:
- 8.1.1 fatura, në të njëjtin postim ose në një datë kur postime të ndryshme janë realizuar në ditë, prej 1,500 ose më shumë artikuj të postuar nga i njëjti dërgues;
- 8.1.2 fatura, në një periudhë prej dy javësh i 5,000 artikujve ose më shumë të postuar nga i njëjti dërgues.
- 8.2 Sipas kushteve të këtij neni, dërguesi i postës së madhe do të konsiderohet se është personi ose shoqëria që aktualisht i ka postuar artikujt.
- 8.3 Nëse është e nevojshme, dërguesi mund të identifikohet nga një karakteristikë e përbashkët e artikujve ose ndonjë e dhënë e shënuar në artikuj (për shembull, adresa e kthimit, emri, vula ose pulla e dërguesit, numri i autorizimit postar etj.)

Neni RL 125

Shënimi i prioritetit ose mënyrave të transportit

1. Në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, artikujt që do të trajtohen si artikuj me prioritet ose artikuj të postës ajrore në shtetet e tranzitit dhe të destinacionit do të mbartin një etiketë të veçantë blu ose vulë të postimit me të njëjtën ngjyrë, ose me të zezë, nëse rregullat e shpërndarjes së operatorëve të caktuar e lejojnë këtë gjë, duke mbartur fjalët "Prioritaire" (Prioritet) ose "Par avion" (Me postë ajrore). Nëse është e nevojshme, këto shënime me shkronja të mëdha mund të shkruhen me dorë ose me makinë shkrimi, me një përkthim të saktë në gjuhën e shtetit të origjinës. Kjo etiketë "Prioritaire" (Prioritet) ose "Par avion" (Me postë ajrore), vula ose shënimi do të vendoset në anën e adresës, për sa është e mundur në qendër të cepit të majtë, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit, kur këto janë dhënë.
2. Fjalët "Prioritaire" (Prioritet) ose "Par avion" (Me postë ajrore) dhe çdo shënim që lidhet me prioritetin ose transportin ajror do të shënohen me vija horizontale të trasha kur artikulli nuk është dërguar me rrugën më të shpejtë.
3. Operatori i caktuar i origjinës gjithashtu mund të kërkojë shënimin e mungesës së prioritetit dhe sipërfaqen e artikujve.

Neni RL 126

Paketime të veçanta

1. Artikujt prej qelqi ose objekte të tjera delikate do të paketohen në një kuti të fortë të mbushur me një material mbrojtës të përshtatshëm. Duhet të parandalohet çdo fërkim ose goditje gjatë transportit edhe midis vetë objekteve ose midis objekteve dhe anës së kutisë.
2. Lëngjet dhe substanca që lëngëzohen lehtë do të mbyllen në kontenier perfekt kundër rrjedhjeve. Çdo kontenier do të vendoset në një kuti të posaçme të fortë me materil mbrojtës të përshtatshëm për të përthithur lëngjet nëse kontenieri do të thyhej. Kapaku i kutisë do të fiksohet në mënyrë që ai të mos pësojë lehtësisht humbje.

3. Substancat e yndyrshme që nuk lëngëzohen lehtësisht, të tilla si pomada, sapun i butë, rrëshirë, etj., dhe vezë të krimbit të mëndafshit, transporti i të cilave paraqet disa vështirësi, do të mbyllën në një paketim të parë (kuti, thasë prej robe, plastike, etj.) i cili është vendosur në një kuti mjaftueshmërisht të fortë për të parandaluar rrjedhjen e përmbajtjes.

4. Pluhurat e thata ngjyruese, të tilla si anilina blu, etj., do të pranohen vetëm në kuti metalike të siguruara në mënyrë perfekte nga rrjedhjet, të vendosura në kuti të forta me një përthithës të përshtatshëm dhe material mbrojtës midis dy kontenierëve.

5. Pluhurat e thata jo ngjyruese do të vendosen në kontenierë të fortë (kuti, çanta). Këta kontenierë do të jenë të mbyllur në një kuti të fortë.

6. Bletët e gjalla, miza të familjes Drosophilide, shushunjat dhe parazitët do të mbyllën në kuti të ndërtuara në mënyrë të tillë që të shmangin çdo rrezik.

7. (i fshirë)

8. Nuk do të kërkohej paketim për artikuj në një pjesë, të tilla si copa druri, metali etj., që nuk janë të zakonshme e tregtohen në pako. Në këtë rast, adresa e marrësit do të jepet në këtë artikull.

Neni RL 127


Artikuj në zarfe me panel

1. Artikujt në zarfe me panel transparent të adresës do të pranohen sipas kushteve të mëposhtme:

1.1 Paneli do të vendoset në anën e njëtrajtshme të zarfit e cila nuk ka shiritin e mbylljes.

1.2 Paneli do të bëhet nga një material i tillë dhe në mënyrë të tillë që adresa të mund të lexohet lehtësisht nëpërmjet saj.

1.3 Paneli do të jetë drejtkëndor. Përmasat e tij më të mëdha do të jenë paralel me gjatësinë e zarfit. Adresa e marrësit do të shfaqet në të njëjtin drejtim. Megjithatë në lidhje me artikujt e formatit C 4 (229 x 324 mm) ose formate të ngjashme, operatorët e caktuar mund të lejojnë që panelet transparente të vendosen në mënyrë të tërthortë në mënyrë të tillë që përmasa e tij më e madhe të jetë paralele me gjerësinë e zarfit



1.4 Të gjithë skajet e panelit do të jenë palosur në mënyrë të saktë në skajet e brendshme të hapjes së zarfit. Për këtë qëllim do të ketë një hapësirë të përshtatshme midis anës dhe skajeve të poshtme të zarfit dhe ato të panelit.

1.5 Adresa e marrësit do të jetë e vetmja gjë e dukshme nëpërmjet panelit, ose të paktën, do të jetë e evidentuar në mënyrë të qartë nga çdo shënim tjetër i dukshëm nëpërmjet panelit.

1.6 Paneli do të vendoset në mënyrë të tillë që të lerë hapsirë të mjaftueshme për vendosjen e vulës datare.

1.7 Përmbajtja e artikullit do të mbështillet në mënyrë të tillë që adresa të mbetet plotësisht e dukshme nëpërmjet panelit edhe nëse përmbajtja zhvendoset brenda zarfit.

2. Artikujt në zarfa që janë plotësisht transparent mund të pranohen nëse sipërfaqja e zarfeve është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos krijojë vështirësi në trajtimin e postës. Një etiketë që ka hapsirë të mjaftueshme për paraqitjen e adresës së marrësit, parapagimit dhe instruksioneve të shërbimit mund të bashkëlidhet në mënyrë të qëndrueshme me sipërfaqen e jashtme të artikullit. Nuk do të pranohen artikujt në zarfe që kanë një panel të hapur.



3. Operatorët e caktuar e origjinës mund të pranojnë zarfe që kanë dy ose më shumë panele transparent. Paneli i rezervuar për adresën e marrësit do të përmbushë kushtet e përcaktuara sipas pikës 1. Për panelet e tjerë do të zbatohen kushtet e paraqitura sipas 1.2, 1.4, 1.6 dhe 1.7.

Neni RL 128
Artikuj të standardizuar

1. Artikujt drejtkëndorë do të konsiderohen të standardizuar nëse gjatësia e tyre nuk është më e vogël se gjerësia e tyre e shumëzuar me $\sqrt{2}$ (vlera e përafërt 1.4). Këto artikuj duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1.1 Përmasat minimale: 90 x 140 mm, me një tolerancë prej 2 mm.

1.2 Përmasat maksimale: Maksimumi i përmasave: 120 x 235 mm, me një tolerancë prej 2 mm. Maksimumi i përmasave si më poshtë vijon do të pranohet kur zarfet e interesuara përdoren gjerësisht në shtetin e dhënë:

– 150 x 245 mm, me një tolerancë prej 2 mm;

– 165 x 235 mm, me një tolerancë prej 2 mm.

1.3 Peshë maksimale: 20 g.

1.4 Trashësia maksimale: 5 mm.

1.5 Letrat do të mbyllen plotësisht me shirit ngjitës në pjesën e hapur të zarfit dhe adresa do të shkruhet në pjesën e sheshtë të zarfit që nuk është zënë me shirit ngjitës.

1.6 Adresat do të shkruhen në një zonë drejtkëndore që vendoset të paktën:


– 40 mm nga skajit i sipërm i zarfit (toleranca 2 mm);

– 15 mm nga skaji i djathtë;

– 15 mm nga skaji i poshtëm;

Dhe jo më shumë se 140 mm nga skaji i djathtë.

1.7 Në krahun e adresës, një zonë drejtkëndore 40 mm (– 2 mm) larg nga skaji i sipërm dhe 74 mm në gjerësinë nga krahu i djathtë do të rezervohet për vendosjen e pullave ose vulave dhe pullave të postimit pa pagesë. Brenda kësaj zone vulat postare ose pulla e postimit do të vendosen në cepin në të djathtë.



2. Dispozitat sipas pikës 1 do të zbatohen gjithashtu për artikujt në zarfe transparente, kushtet e përgjithshme të pranimi të të cilave janë përcaktuar në nenin RL 127. Paneli transparent për adresën e marrësit duhet të jetë të paktën :

- 40 mm nga skaji i sipërm i zarfit (toleranca 2 mm);
- 15 mm nga skaji i djathtë;
- 15 mm nga skaji i majtë;
- 15 mm nga skaji i poshtëm.

2.1 Kuadrati mund të mos jetë i kufizuar nga një vijë ose kornizë me ngjyrë. Të dhënat e shërbimit mund të vendosen menjëherë sipër adresës së marrësit.

3. Megjithatë nuk mund të shfaqet asnjë shprehje ose çështje e huaj:

3.1 poshtë adresës;

3.2 Në të djathtë të adresës, nga zona e vendosjes së pullës dhe anulimit deri në skajin e poshtëm të artikullit;

3.3 në të majtë të adresës, në një zonë të paktën prej 15 mm gjerësi dhe që shtrihet nga vija e parë e adresës deri në skajin e poshtëm të artikullit;

3.4 Në një zonë 15 mm lart nga skaji i poshtëm i artikullit dhe 140 mm gjatësi nga skaji i djathtë i artikullit; kjo zonë mund të jetë pjesërisht e ngjashme me ato të përcaktuara mësipër.

4. Operatorët e caktuar që pranojnë artikuj në zarfe gjerësia e të cilëve nuk e kalon 162 mm, me një tolerancë prej 2 mm, si artikuj të standardizuar në shërbimin e tyre të brendshëm mund gjithashtu të pranojnë këto artikuj edhe në shërbimin ndërkombëtar.

5. Artikujt në kartona në përmasa 120 x 235 mm mund të pranohen si artikuj të standardizuar me kusht që të jenë të përbërë nga karton mjaftueshmërisht i fortë për të përballuar përpunimin pa vështirësi.

6. Artikujt e mëposhtëm nuk do të konsiderohen të standardizuar:

6.1 Letrat e palosura (broshura);

6.2 Artikujt e mbyllur me anë të kapseve, kapse metalike ose trajtimesh mekanike;

6.3 Letrat e shpuara të dërguara të pa mbyllura (pa një zarf);

6.4 artikujt, zarfat e të cilëve janë bërë prej materiali i cili ka karakteristika themelore fizike të ndryshme nga letra (me përjashtim të materialeve të përdorura për kornizën e pjesës së hapur të zarfave);

6.5 artikuj që përmbajnë njësi që shkaktojnë zgjatje;

6.6 artikuj të mbështjellë të dërguar të pa mbyllur (pa zarf) të cilat nuk mbyllen në të gjitha anët dhe të cilat nuk janë mjaftueshmërisht të sertë për përpunimin mekanik.

Neni RL 129

Kushte të pranimi dhe shënimit të artikujve që përmbajnë substanca biologjike që prishen (duke përfshirë kampionët e diagnostikimit)

1. Substancat biologjike që prishen, duke përfshirë edhe kampionët e diagnostikimit, të cilat nuk përfshihen në përkufizimin e substancave infektuese, do të pranohen sipas kushteve të mëposhtme.

1.1 Dërguesit duhet të sigurohen që dërgesat të jenë përgatitur në një mënyrë të tillë që të mbërrijnë në destinacionin e tyre në gjendje të mirë. Artikujt nuk duhet të paraqesin rrezik për personat ose kafshët gjatë transportit.

1.2 Paketimi duhet të përfshijë:

1.2.1 paketimin e brendshëm i cili përfshin:

1.2.1.1 Kontenier kryesor të pa përshkrueshëm nga uji;

1.2.1.2 Një paketim dytësor të pa përshkrueshëm nga uji;

1.2.1.3 përveç substancave të ngurta, një material absorbent në një sasi të mjaftueshme për të thithur të gjithë përmbajtjen, që do të vendoset midis kontenirëve kryesor dhe dytësor. Nëse në një paketim të vetëm të dytë janë vendosur disa kontenierë kryesorë, ata do të mbështillen në mënyrë individuale;

1.2.2 një paketim i jashtëm me fortësi të përshtatshme për kapacitetin, masën dhe qëllimin e përdorimit të tij. Paketimet do të jenë të paktën 100 mm në përmasat e përgjithshme më të vogla të jashtme.

1.3 Paketimi i përfunduar do të jetë në gjendje të kalojë sukseshëm testin e goditjeve si është paraqitur në Instruksionet Teknike ICAO, me përjashtim të faktit që lartësia e hedhjes nuk duhet të jetë më e vogël se 1.2 m.



1.4 Një listë e përmbajtjes sipas artikujve do të përfshihet midis paketimit dytësor dhe atij të jashtëm.

1.5 Ambalazhimi do të realizohet në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

1.5.1 Substanca Liofile.

1.5.1.1 Kontenierët kryesor duhet të jenë ampula qelqi të vulosura me flakë ose flakona gome të mbyllura hermetikisht me tapë qelqi dhe të pajisur me vule metalike.

1.5.2 Substanca të ngurta ose të lëngshme.


1.5.2.1 Substancat e transportuara në temperaturat e ambientit ose temperatura më të larta. Kontenierët kryesorë mund të jenë vetëm prej qelqi, metali ose plastike. Do të merren masat e duhura për vendosjen e një vule për kundër rrjedhjeve, si vulat e nxehtësisë, vulat anësore ose kapsula metalike. Nëse do të përdoren kapakët e vidhosur, ato do të forcohen me tapa adezive.

1.5.2.2 Substancat e transportuara të ngrira ose të ftohta. Akulli ose ftohës të tjerë, të cilët nuk janë të rrezikshëm sipas Instruksioneve Teknike ICAO, do të vendosen jashtë paketimit dytësor. Do të vendosen mbështetje të brendshme për të siguruar paketimin dytësor. Nëse përdoret akulli, paketimi i jashtëm do të jetë kundër rrjedhjeve. Kontenieri kryesor dhe paketimi dytësor do të ruajnë integritetin e tyre në temperaturën e ftohësit të përdorur si në temperaturën dhe në tryninë e transportit ajror ndaj të cilave do të jetë subjekt kontenieri kryesor dhe paketimi dytësor nëse ftohësi do të humbte.

1.6 Kontenieri kryesor ose paketimi dytësor të përdorur për substancat biologjike që prishen duke përfshirë kampionët e diagnostikimit do të jetë në gjendje të përballojnë temperaturat duke filluar nga e -40°C deri $+55^{\circ}\text{C}$ dhe për lëngjet të jetë në gjendje të rezistojnë pa rrjedhje, ndaj një trysnie të brendshme të ndryshëm nga ose jo më të ulët se 95 kPa.

1.7 Sasia maksimale në një kontenier kryesor nuk duhet të kalojë 500 ml dhe sasia maksimale në paketimin e jashtëm nuk duhet të kalojë 4 litra.

1.8 Paketimi i jashtëm, si dhe mbështjellja e jashtme e artikujve, do të shënohet "Kampionë të diagnostikimit" dhe do të pajisen, me një etiketë me ngjyrë vjollcë, me tekstin dhe simbolet në vijim, në anën e të cilës do të vendosen adresat e laboratorëve që dërgojnë dhe marrin atë:



(Size 62 x 44 mm)

Neni RL 130

Kushtet e pranimit dhe shënimit të artikujve që përmbajnë substanca infektuese

1. Substancat të cilat janë të infektuara apo të dyshuara në mënyrë të arsyeshme që të jetë infektive për njerëzit apo kafshët dhe që plotësojnë kriteret e substancave infektive të kategorisë B (UN 3373) do të deklarohen si "Substance biologjike, kategoria B".

2. Dërguesit e substancave infektive të caktuara të UN 3373 do të sigurohen se dërgesat janë përgatitur në mënyrë të tillë që ato të arrijnë në destinacionin e tyre në gjendje të mirë dhe se substancat janë të paketuara sipas udhëzimit të Paketimi 650, siç tregohet në edicionin aktual të Udhëzimeve Teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme nga Ajri (Udhëzimet teknike) të publikuar nga Organizata Civile Ndërkombëtare e Aviacionit (ICAO), ose në edicionin e fundit të Rregullores së Mallrave të Rrezikshme (DGR) të publikuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA). Për më shumë informacion, teksti i Udhëzimit të Paketimit 650, siç tregohet në edicionin 2007/2008 të udhëzimeve të Teknike ICAO, është dhënë më poshtë. Dërguesit duhet të konsultojnë edicionin më të fundit të Udhëzimeve Teknike ICAO për verifikimin e tekstit aktual të Udhëzimit të Paketimit 650 para përdorimit.

3. Paketimi duhet të jetë me cilësi të mirë, i fortë mjaftueshëm për t'i bërë ballë goditjeve dhe ngarkesave të ndeshura normalisht gjatë transportit, duke përfshirë edhe transferimin ndërmjet njësive të transportit dhe magazinave, si dhe çdo heqje nga një paletë ose mbi-paketim për trajtim manual ose mekanik të mëpasshëm. Paketimi duhet të ndërtohet dhe të mbyllet për të parandaluar çdo humbje të përmbajtjes që mund të shkaktohen në kushtet normale të transportit nga dridhjet ose nga ndryshimet e temperaturës, lagështisë apo trysnisë.

4. Paketimi do të konsistojë në tre element:

4.1 Një kontenier kryesor;

4.2 një paketim dytësor; dhe

4.3 dhe një paketim i jashtëm i sertë.

5. Kontenierët kryesorë do të jenë të pakeluar në paketimin dytësor në një mënyrë të tillë që, në kushte normale të transportit, ato nuk do të mund të thyhen, shpohen apo rrjedhin përmbajtjen e tyre në paketimin dytësor. Paketimi dytësor do të sigurohet me një paketimin të jashtëm me material amortizues të përshtatshëm. Çdo rrjedhje e përmbajtjes nuk do të kompromentojë integritetin e materialit amortizues ose paketimin e jashtëm.

6. Për transportin, etiketa e ilustruar më poshtë do të shfaqet në sipërfaqen e jashtme të paketimit të jashtëm në një sfond të një ngjyrë të kundërt dhe do të jenë qartësisht e dukshme dhe të lexueshme. Shenja do të jetë në formën e një katrori të vendosur në një kënd prej 45% (formë diamanti) çdo anë me një gjatësi prej të paktën 50 mm, gjerësia e vijës do të jetë të paktën 2 mm, dhe shkronjat dhe numrat do të jetë të paktën 6 mm të larta. Emri i duhur i transportit "Substancë biologjike, kategoria B", "Kampion diagnostik" ose "Model Klinike" me shkronja të paktën 6 mm të larta do të shënohet në paketimin e jashtëm ngjitur me shenjën në formë diamanti.



7. Të paktën një nga sipërfaqet e paketimit të jashtëm duhet të ketë përmasa minimale 100 mm x 100 mm.

8. Paketimi i kompletuar do të jetë në gjendje të kalojë suksesshëm testin e rënies siç përcaktohet në Udhëzimet Teknike të ICAO, me kusht që lartësia e rënies nuk do të jetë më pak se 1.2 m.

9. Për substancat e lëngshme

9.1 Kontenieri Kryesor do të jetë kundër rrjedhjes dhe nuk duhet të mbajnë më shumë se një litër substancë të lëngshme.

9.2 Paketimi dytësor do të jetë kundër rrjedhjes..

9.3 Nëse në paketimin dytësor janë vendosur disa enë parësore delikate, ata ose do të mbështillen secila më vete ose do të ndahen për të parandaluar kontaktin mes tyre.

9.4 Materiale thithëse do të vendoset material absorbues. Materiali absorbues do të jetë në sasi të mjaftueshme për të absorbuar të gjithë përmbajtjen e enës parësore në mënyrë që çdo lëshim i substancave të lëngëta nuk do të rrezikojë integritetin e materialit amortizues ose paketimin e jashtëm.

9.5 kontenieri kryesor ose paketimi dytësor do të jetë i aftë të durojë, pa derdhje, një trysni të brendshme prej 95 kPa.



9.6 Paketimi i jashtëm nuk duhet të përmbajë më shumë se katër litra të substancës së lëngshme. Kjo sasi përjashton akullin ose akullin e thatë kur përdoret për të mbajtur kampionet e ftohta.

10. Për substancat e ngurta:

10.1 Paketimi/ et kryesorë/ e duhet të kalojë provën e shqyrtimit dhe nuk duhet të tejkalojnë limitin e masës së paketimit të jashtëm.

10.2 Paketimi dytësor duhet të kalojë provën e shqyrtimit.

10.3 Nëse në paketimin dytësor janë vendosur disa enë parësore delikate, ata ose do të mbështillen secila më vete ose do të ndahen për të parandaluar kontaktin mes tyre.

10.4 Me përjashtim të paketimeve që përmbajnë pjesë të trupit, organe ose trupa, paketimi i jashtëm nuk duhet të përmbajë më shumë se katër kilogramë substanca të ngurta. Nga kjo sasi përjashtohet akull ose akulli i thatë që përdoret për të mbajtur kampionet e ftohtë.

10.5 Nëse ka ndonjë dyshim që mbetje të lëngshme mund të jenë të pranishme apo jo në ambalazhin parësor gjatë transportit, atëherë duhet të përdoret një paketim i përshtatshëm për lëngje, duke përfshirë materialet absorbues.

11. Për kampionë të ftohur ose të ngrirë (akull, akull i thatë dhe azot i lëngshëm):

11.1 Në rastet kur është përdorur akull i thatë ose azoti i lëngshëm për të mbajtur kampionë të ftohtë, do të përmbushen të gjitha kërkesat e zbatueshme të Udhëzimeve teknike të ICAO. Kur përdoret, akulli ose akull i thatë do të vendoset jashtë paketimit dytësor ose në paketimin e jashtëm ose ambalazhin shtesë. Pasi vendoset akulli ose akulli i thatë do të jepet mbështetje e brendshme për të siguruar paketimin dytësor në pozicionin fillestar. Nëse është përdorur akulli, jashtë paketimit ose në ambalazhin shtesë do duhet të jenë kundër rrjedhjes. Në qoftë se është përdorur dioksidi i karbonit (akull i thatë), paketimi duhet të projektohet dhe ndërtohet për të lejuar lirimin e gazit të dioksidit të karbonit për të parandaluar një rritje të presionit që mund të prishë paketimin.

11.2 Kontenieri kryesor dhe paketimi dytësor duhet të jenë në gjendje të ruajnë integritetin e tyre në temperaturën e ftohjes përdoret si dhe temperaturës dhe presionit që mund të rezultojë në qoftë se humbet ftohja.

12. Kur paketimet vendosen në një ambalazh shtesë, shënjat e paketimet të kërkuara nga ky udhëzim për paketimin do të jenë qartësisht të dukshme ose do të riprodhohen në pjesën e jashtme të ambalazhit shtesë.

13. Substancat infektive të caktuar në UN 3373 të cilat janë paketuar dhe shënuar në përputhje me këtë udhëzim për paketimin nuk janë subjekt i kërkesave të tjera sipas këtij neni, përveç sa më poshtë vijon:

13.1 Duhet të jepen në një dokument me shkrim (si fatura e dërgimit 38 CN), ose në paketë, emri i duhur i transportit, numri UN dhe emri dhe adresë dhe numri i telefonit të një personi përgjegjës;

13.2 klasifikimi duhet të jetë në përputhje me dispozitat 2;6.3.2 të Instruksioneve Teknike ICAO;

13.3 duhet të plotësohen kërkesat e raportimit të incidentit të dispozitës 7; 4.4 të Udhëzimeve Teknike të ICAO; dhe

13.4 duhet të zbatohen kërkesat për inspektimin e dëmit ose kërkesat e rrjedhjes të dispozitave 7;3.1.3 dhe 7;3.1.4 të Udhëzimeve Teknike të ICAO-s.

14. Prodhuesit e paketimit dhe distributorët e mëvonshëm për dërguesit ose personi i cili përgatit paketimin (p.sh. pacienti) do të sigurojnë udhëzime të qarta për mbushjen dhe mbylljen e këtyre paketimeve për të mundësuar që çdo paketim i vetëm të përgatitet si duhet për transport.

15. Mallrat e tjera të rrezikshme nuk duhet të jenë të paketuara në të njëjtin paketim me Sektorin 6.2 Substanca infektive, me përjashtim të rastit kur ato janë të nevojshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë, stabilizimin ose parandalimin e degradimit ose neutralizimin e rreziqeve të substancave infektive. Një sasi prej 30 ml ose më pak e mallrave të rrezikshme të përfshira në klasat 3, 8 ose 9 mund të paktohen në secilën prej enëve parësore që përmban substanca infektive. Kur këto sasi të vogla të mallrave të rrezikshme janë të paketuara me substancat infektive, në përputhje me këtë udhëzim të paketimit, nuk duhet të plotësohen kërkesat e tjera të këtij neni.

16. Dioksidi i karbonit i ngurtë (akull i thatë) i përdorur si ftohës

16.1 Në qoftë se dioksidi i ngurtë i karbonit (akulli i thatë), është përdorur si ftohës, duhet të plotësohen kërkesat e paketimit të Udhëzimit të Paketimit 904 siç është përcaktuar në edicionin aktual të Udhëzimeve Teknike të ICAO-s ose të Rregullores së Mallrave të Rrezikshme IATA. Përveç kërkesave që janë të zbatueshme për Udhëzimin e Paketimit 650, dërguesi duhet gjithashtu të përmbushë kërkesat e shënimit dhe etiketimit të zbatueshme për koltë që përmbajnë dioksid të ngurtë karboni (akull i thatë).

16.2 Për transportin ajror, duhet të paraqitet një dokument transporti në pajtim me Udhëzimet Teknike të ICAO-s ose Rregullores së Mallrave të Rrezikshme IATA. Përveç kësaj, fatura e dërgimit CN 38 që mbulon këtë dërgesë duhet të përmbajë deklaratën e mëposhtme: "Mallra të rrezikshme sipas deklaratës së transportuesit bashkangjitur".


16.3 Thasë që përmbajnë vetëm substanca infektive dhe të identifikuara nga etiketat speciale "UN 3373" duhet të dorëzohen nga autoritetet postare tek linjat ajrore në çanta poste të pavulosura

Neni RL 131

Kushte të pranimit dhe shënimit të artikujve që përmbajnë materiale radioaktive.

1. Artikujt që përmbajnë materiale radioaktive do të pranohen për transportim me postë subjekt i pëlqimit paraprak nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe me kusht që veprimtaria nuk i kalon një të dhjetën e lejimit nga Tabela 3 - Kufijtë e Veprimtarisë për Paketime të Pranuara, sipas listës në botimin aktual të IAEATS_R_1.

2. Paketimin i jashtëm i artikujve që përmbajnë materiale radioaktive duhet të jetë shënuar nga dërguesi me një etiketë me numrin e UN të zbatueshëm të treguar më poshtë. Ajo gjithashtu do të ketë, përveç emrit dhe adresës së dërguesit, një kërkesë me shkronja të theksuara për kthimin e artikujve në rast të mos-dorëzimit.



3. Dërguesi do të japë emrin e tij dhe adresën dhe përmbajtjen e artikullit në mbështjelljen e brendshme.

4. Etiketa duhet të shënohet qartë me kryq në rast se pako bosh kthehet në vendin e origjinës.

5. (i fshirë.)

KAPITULLI 5 SHËRBIME SHITESË

Neni RL 132 Artikujt rekomande

1. Artikujt e postës së letrave mund të dërgohen si artikuj rekomande, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.1, 1.2 dhe 2 të nenit 13 të Konventës.

2. Tarifa për artikujt rekomande do të paguhet paraprakisht. Ajo do të jetë e përbërë prej tarifës postare dhe një tarife fikse për rekomande, shuma maksimale e së cilës sipas udhëzuesit do të jetë 1.31 SDR. Për çdo thes M, operatorët e caktuar do të mbledhin, në vend të tarifës për artikull, një tarifë për artikuj në sasi të mëdha e cila nuk do të jetë më e lartë se pesë herë tarifën për artikull.



3. Në rastet kur kërkohen masa të jashtëzakonshme të sigurisë, operatorët e caktuar mund të mbledhin nga dërguesi ose nga marrësi, si shtesë të tarifës së përmendur në pikën 2, tarifën e veçantë të caktuar nga legjislacioni i tyre i brendshëm.

4. Pranimi

4.1 Nuk do të përshkruhet asnjë formular, mbyllje ose metodë adrese për artikujt rekomandë.

4.2 Artikujt që kanë adresën të shkruar me laps ose ndonjë format tjetër që fshihet ose përbëhet nga inicialet nuk do të pranohen për regjistrim. Megjithatë, adresa e artikujve të ndryshëm nga ato të dërguara në një zarf me etiketë transparente mund të shkruhet me laps me bojë të kopjueshme.

4.3 Dërguesit të artikullit rekomandë do ti lëshohet pa pagesë një faturë për në momentin e postimit.

5. Shënimi dhe trajtimi i artikujve

5.1 Artikujt rekomandë do të mbartin në mënyrë të qartë dhe me shkronja të zeza titullin "Recommandé" (rekomandë), të shoqëruar, nëse është e nevojshme, me një të dhënë të ngjashme në gjuhën e shtetit të origjinës. Përdorimi i këtij titulli nuk është i detyrueshëm nëse artikulli rekomandë mbart një etiketë CN 04 që përmban shkronjën e madhe "R".

5.2 Të gjithë operatorët e caktuar, që nga data 1 Janar 2008, do të aplikojnë një bar - kod në të gjithë artikujt e jashtëm rekomandë (Ajrore, S.A.L., tokësore). Specifikimi do të jetë si më poshtë vijon:

5.2.1 Çdo artikull rekomandë mund të identifikohet nga një etiketë e vetme CN 04 1 me një identifikues të vetëm të artikullit në përputhje me specifikimet e identifikimit 13-shifror të Standardeve S10 (Identifikim i artikujve postarë) dhe të Standardeve S46-1 (Bar - kode Lineare përfaqësues të të dhënave të artikujve postar, etiketa dhe formularë), siç është publikuar në Standardized Teknike UPU.

5.2.2 Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme për të përdorur identifikuesit e vetëm të artikujve dhe bar - kodet të cilat janë në përdorim për artikujt ndërkombëtar rekomandë.

5.2bis Në periudhën para datës 1 Janar 2008, operatorët e caktuar nxiten të bëjnë përpjekjet më të mira për të aplikuar bar - kodin e artikujve rekomandë, në linjë me specifikimet e paragrafit 5.2 të mësipërm.

5.3 Në periudhën para datës 1 Janar 2008 operatorët e caktuar të cilët e kanë të pa mundur të përgatisin etiketat CN 04 me një identifikues të vetëm të artikullit ose etiketën standarde CN 04 mund të përdorin etiketat e përshtatura me përmasat e modeleve CN 04 në të cilat është printuar vetëm shkronja R. Të dhënat e tjera të modelit mund të shtohen, në formë të qartë dhe që nuk mund të fshihen nga ndonjë mënyrë.

5.4 Etiketa dhe shënimi "Recommandé" (Rekomandë) do të vendoset në anë të adresës, nëse është e mundur në krye të cepit të majtë, poshtë adresës dhe emrit të dërguesit nëse ato janë dhënë. Në rastin e artikujve në formën e kartonëve, këto shënime do të vendosen poshtë adresës në mënyrë të tillë që që mos të ndikojë lexueshmërinë. Në rastin e thasëve M rekomandë, etiketa CN 04 do të bashkëlidhet në mënyrën e përshtatshme në etiketën e adresës të paraqitur nga dërguesi.

5.5 Në periudhën para datës 1 Janar 2008, operatorët e caktuar që kanë miratuar në shërbimin e tyre të brendshëm sistemin e pranimit mekanik të artikujve rekomandë, në vend të përdorin etiketat CN 04, mund të printojnë direkt në këto artikuj, në anën e adresës, të njëjtat shënime të shërbimit si paraqitet në etiketën e sipërpërmendur. Nëse është e aplikueshme ata mund të vendosin në të njëjtin vend vijën e printuar të makinës me të njëjtat shënime .

5.6 Në periudhën para datës 1 Janar 2008, me autorizimin e operatorëve të caktuar të shtetit të origjinës, përdoruesit mund të përdorin për artikujt e tyre rekomandë zarfe që mbartin, në vendin e caktuar për vendosjen e etiketës CN 04, një faksimile të paraprintuar të kësaj table, përmasat e së cilës nuk do të jenë më të vogla se ato të etiketës CN 04. Nëse është e nevojshme, numri serial mund të paraqitet këtu me çfarëdolloj procesi, megjithatë, për sa kohë që është shtuar në mënyrë të qartë dhe që nuk mund të fshihet. Një faksimile i etiketës CN 04 gjithashtu mund të printohet në etiketën e adresës ose direkt në përmbajtjen e artikujve të vendosur në zarfe me etiketa transparente, për sa kohë që ky faksimile vendoset, në të gjitha rastet, në anën e majtë të panelit.

5.7 Operatorët e caktuar të shtetit të orgjinës duhet të sigurojnë që artikujt rekomandë të jenë konform dispozitave të mësipërme. Do të kërkohet të korrigjohet çdo mangësi e vënë re përpara dërgimit të artikujve në shtetet e destinacionit.

5.8 Operatorët e caktuar ndërmjetës nuk do të vendosin asnjë etiketë ose numër serial në krye të artikujve rekomandë.


5.9 Operatorët e caktuar dërgues do të marrin firmën e pranimit ose ndonjë formë tjetër evidentimi të vërtetimit të marrjes nga marrësi kur dorëzojnë ose japin në dorëzim një artikull rekomandë. Në shtesë të

firmës do të vendoset emri me shkronja të mëdha ose çdo shënim të qartë dhe të lexueshëm që lejon identifikimin e qartë të personit që nënshkruan.

5.10 Për më shumë operatorët e caktuar rekomandohen të krijojnë sistemet që gjenerojnë të dhëna të konfirmimit elektronik të dërgimit, dhe bien dakord të shkëmbejnë të dhëna të tilla me operatorët e caktuar të shtetit të origjinës të artikujve.

5.10bis Operatorët e caktuar që kanë vendosur sisteme që gjenerojnë konfirmim elektronik do të kenë të drejtën për të përdorur firma që vendosen elektronikisht nga ky sistem, të sigurojnë prova të dërgimit të artikujve individual për operatorët e caktuar dërgues, subjekt i reklamimit CN -08 nga operatorët e caktuar për dërgimin. Të dhënat e konfirmimit elektronik të dorëzimit mund të sigurohen në mënyrë elektronike (e-mail) ose në formën e kopjes së shtypur sipas zgjedhjes së operatorëve postar të caktuar për dorëzimin.

CN 04



Size 37 x 13 mm, with capital R in red or black, if the regulations of the administration designated operator of origin allow

CN 04



Size 74 x 26 mm, with capital R and line under serial number in red or black, if the regulations of the administration designated operator of origin allow

Neni RL 133

Dorëzimi i regjistruar i artikujve

1. Artikujt e postës së letrave mund të dorëzohen me anë të shërbimit të dorëzimit të regjistruar të artikujve në lidhje midis operatorëve të caktuar të cilët bien dakord të sigurojnë këtë shërbim.

2. Tarifa në dorëzimin e regjistruar të artikujve do të paguhet paraprakisht. Do të përbëhet nga tarifa postare dhe një tarifë e dorëzimit të regjistruar të caktuar nga shteti anëtar ose operatorët e caktuar të origjinës. Kjo tarifë do të jetë më e vogël se tarifa e rekomandësë.

3. Pranimi

3.1 Nuk do të përshkruhet asnjë kusht i veçantë ose mënyrë e mbylljes ose e vendosjes së adresës.

3.2 Do të lëshohet pa pagesë një faturë për dërguesin në momentin e postimit.

4. Shenimi i artikujve

4.1 Artikujt do të mbartin një etiketë CN 05 që ngjitet në mënyrën e përshtatshme.

4.2 Etiketa do të vendoset në anën e adresës, nëse është e mundur në krye të cepit të majtë, pranë emrit dhe adresës së dërguesit kur këto jepen. Në rastin e artikujve në formë letre, etiketa do të vendoset sipër adresës në mënyrë të tillë që të mos ndikojë lexueshmërinë e tij.

4.3 Me autorizimin e operatorëve të caktuar të origjinës, përdoruesit mund të përdorin për artikujt e tyre zarfe që mbartin, në vendin e caktuar për vendosjen e etiketës CN 05, një faksimile të parapërgatitur të kësaj tabele, përmasat e të cilit nuk duhet të jenë më të vogla se ato të etiketës CN 05. Nëse është e nevojshme, numri serial mund të vendoset këtu me çfarëdolloj mënyrë, për sa kohë që shtohet në mënyrë të qartë dhe që nuk mund të fshihet. Një faksimile i etiketës CN 05 mund të printohet gjithashtu në etiketën e adresës ose direkt në përmbajtjen e artikujve të vendosur në zarfe me kuadrat transparent, për sa kohë që ky faksimile vendoset në të gjitha rastet në anën e majtë të panelit transparent.

4.4 Operatorët e caktuar e origjinës do të sigurohen që artikujt të jenë shënuar në mënyrën e duhur në përputhje me dispozitat e mësipërme. Do të kërkohej të korrigjohet para dërgimit të artikullit në shtetin e destinacionit çdo defekt i vënë re.

4.5 Operatorët e caktuar ndërmjetës nuk do të vendosin asnjë numër serial në krye të artikullit.



CN 05

CN 05

Recorded delivery

N° A 123456

Size 37 x 13 mm, colour yellow

Recorded delivery

AA 00 123 456 8 SE



Size 74 x 26 mm, colour yellow

Neni RL 134 Artikuj të siguruar

1. Artikujt me prioritet ose jo dhe letrat që përmbajnë letra me vlerë, dokumente ose artikuj me vlerë mund të shkëmbehen me sigurim të përmbajtjes për vlerën e deklaruar nga dërguesi. Ky shkëmbim do të kufizohet në marrëdhëniet midis operatorëve të caktuar që kanë deklaruar gadishmërinë e tyre për të pranuar artikuj të tillë, në mënyrë reciproke ose vetëm në një drejtim.

2. Vlera të sigurimit

2.1 Në parim, shuma e vlerës së sigurimit do të jetë e pa kufizuar. Çdo shtet anëtar ose operator i caktuar mund të kufizojë vlerën e siguruar, për sa i përket, në një shumë jo më të ulët se 4,000 SDR ose për një shumë të paktën të barabartë me atë të miratuar në shërbimin e saj të brendshëm në qoftë se shuma është më e ulët se 4,000 SDR. Megjithatë, kufiri i vlerës së sigurimit të miratuar në shërbimin e brendshëm do të jetë i zbatueshëm vetëm nëse ai është i barabartë me ose më i lartë se shuma e dëmshpërblimit të përcaktuar për humbjen e artikullit të regjistruar.

2.2 Në shërbimin ndërmjet shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar të cilët kanë miratuar vlera të ndryshme maksimale, të gjitha palët duhet të respektojnë limitin më të ulët.

2.3 Vlera e sigurimit nuk mund të kalojë vlerën aktuale të përmbajtjes të artikullit, por do të lejohet të sigurohet vetëm një pjesë e vlerës. Shuma e sigurimit për letra, vlera e të cilave qëndron në koston e përgatitjes së tyre nuk mund të kalojë koston e zëvendësimit të dokumenteve në rast humbje.

2.4 Çdo sigurim i rremë për një vlerë më të madhe se vlera aktuale e përmbajtjes së një artikulli do të jetë përgjegjës për procedurat ligjore të parashikuara nga legjislacioni i shtetit të origjinës.

2.5 Vlera e sigurimit do të shprehet në monedhën e shtetit të origjinës. Ajo do të shkruhet nga dërguesi ose përfaqësuesi i tij sipër adresës së artikullit me fjalë me shkronja romake dhe numra arabë, pa fshirje ose ndryshime, edhe nëse janë të vërtetuara. Shuma e vlerës së sigurimit nuk do të shkruhet me laps ose laps që fshihet.

2.6 Shuma e vlerës së siguruar do të konvertohet në SDR nga dërguesi ose nga zyra e origjinës. Rezultati i konvertimit, i rrumbullakosur nëse është e përshtatshme në SDR-në më të afërt, do të tregohet në shifra në anën ose poshtë shifrave që përfaqësojnë vlerën në monedhën e shtetit të origjinës. Konvertimi nuk do të kryhet në shërbimet e drejtpërdrejta midis shteteve të cilat kanë të njëjtën monedhë.

2.7 Operatori i caktuar i origjinës duhet të njoftohet sa më shpejt të jetë e mundur në rast se rrethanat e çfarëdo lloji zbulojnë një sigurim të rremë për një vlerë më të madhe se vlera aktuale e përmbajtjes së artikullit. Kur është e përshtatshme, dokumentet që lidhen me hetimin, do të dërgohen në atë operator i caktuar. Nëse artikulli nuk është dorëzuar ende tek marrësi, operator i origjinës mund të kërkojë kthimin e tij.

3. Tarifat. Shuma maksimale

3.1 Tarifa për artikujt e siguruar do të paguhet paraprakisht. Ajo do të përbëhet nga tarifa e zakonshme e postimit, tarifa fikse e regjistrimit e caktuar në nenin RL 132 dhe një tarifë sigurimi.

3.1.1 Në vend të tarifës fikse të regjistrimit, operatorët e caktuar mund të mbledhin tarifën korresponduese të shërbimit të tyre të brendshëm ose, në mënyrë të veçantë një tarifë vlera e udhëzimit të së cilës do të jetë 3.27 SDR.

3.1.2 Tarifa maksimale e udhëzuar për sigurimin e zakonshëm do të jetë 0.33 SDR për çdo 65.34 SDR të vlerës së siguruar ose pjesë të saj, ose 0.5% të shkallës së vlerës së siguruar.. Kjo tarifë do të aplikohet pavarësisht nga shteti i destinacionit, edhe në shtete që angazhohen të mbulojnë riskun e forcave madhore.

3.2 Në rastet kur janë të nevojshme masa të jashtëzakonshme të sigurisë, operatorët e caktuar mund të marrin nga dërguesi ose nga marrësi, përveç tarifave të përmendura në pikat 3.1.1 dhe 3.1.2, tarifa të veçanta të parashikuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm.

4. Operatorët e caktuar do të kenë të drejtën ti ofrojnë klientëve të tyre një shërbim të artikujve të siguruar në përputhje me specifikime të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë nen.

5. Pranimi

5.1 Operatorët e caktuar do të marrin masat e nevojshme për të siguruar, për sa është e mundur, artikujt e siguruar në çdo zyrë në shtetin tyre.

5.2 Artikujt e siguruar do të përmbushin kushtet e mëposhtme që të pranohen nga posta.

5.2.1 Artikujt e siguruar do të përgatiten në mënyrë të tillë që përmbajtja të mos mund të preket pa dëme të dukshme në zarf, paketim apo vula dhe do të mbyllën me anë të mjeteve efektive si shiriti i hollë ngjites me një dizajn uniform të veçantë ose shënim të dërguesit. Operatorët e caktuar, megjithatë, mund të bien dakord të mos kërkojë një dizajn apo shenjë të tillë. Në këtë rast, operatorët e caktuar të origjinës do të vendosin disa pulla postare në shiritin adeziv ose në anën që mbyllet të artikullit për të parandaluar ndryshime. Nëse rregullat e tyre e lejojnë këtë gjë, operatorët e caktuar të origjinës do të rekomandojnë që klientët e tyre të përdorin zarfet e veçantë të realizuar për artikujt e siguruar. Përdorimi zarfeve që kanë vetë ngjitës për mbylljen në mënyrë që të sigurohet mos prekje, do të jenë të ndaluar për artikujt e siguruar.

5.2.2 Zarfet ose ambalazhet transparente, dhe / ose zarfet që kanë një ose disa panele transparent, nuk do të pranohen.

5.2.3 Pavarësisht paragrafit 5.2.1, operatorët e caktuar mund të kërkojnë që artikujt e siguruar të jenë të vulosur me vula dylli identike, vula plumbi ose mjete të tjera në fuqi, me një dizajn uniform të veçantë ose të shënohen nga dërguesi

5.2.4 Operatorët e caktuar që nuk aderojnë në dispozitat që përmban paragrafi 5.2.1 dhe 5.2.3 dhe dërgojnë artikujt e siguruar pa vula nuk do të kenë të drejtë të ndonjë kompensimi për vlerën e siguruar në rast humbje, vjedhje ose dëmtimi. Këta artikuj do të trajtohen si artikuj rekomandë dhe do të kompensohen si të tillë.

5.2.5 Vulat, pullat postare që përfaqësojnë një postim të parapaguar, dhe etiketat e shërbimit postar dhe të shërbimeve të tjera zyrtare do të vendosen në të një largësi të mjaftueshme në mënyrë të tillë që të mos fshehin dëmtime të zarfit ose paketimit. Pullat postare dhe etiketat nuk do të palosen në të dyja anët e zarfit ose paketimit në mënyrë që të mbulojnë vetëm një anë. Do të jetë e ndaluar të vendoset në artikuj etiketa të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimin postar ose shërbimet zyrtare ndërhyrja e të cilave mund të kërkohe sipas legjislacionit kombëtar të shtetit të origjinës.

5.2.6 Nëse artikujt janë lidhur në formë kryqi me një shirit dhe vulosur si është përshkruar në 5.2.1, vetë shiriti nuk duhet të vuloset.

5.3 Artikujt që kanë pamje të jashtme të një kutie duhet të plotësojnë kushtet shtesë të mëposhtme.

5.3.1 Ato duhet të jenë prej druri, metali ose plastike dhe mjaftueshmërisht të forta.

5.3.2 Muret e kutisë prej druri duhet të kenë një trashësi minimale prej 8 mm.

5.3.3 Pjesa e sipërme dhe fundi do të mbulohen me letër të bardhë për të vendosur adresën e marrësit, deklaratën e vlerës së siguruar dhe vendosjen e pullës zyrtare. Këto kuti do të vulosen në të katërt anët në mënyrën e përshkruar sipas 5.2.1. Nëse kërkohet për të siguruar paprekshmërinë, kutitë do të lidhen në formë kryqi me spango të fortë pa nyje. Dy fundet e spangos do të bashkohen me një vulë dylli që mbart një dizajn të veçantë uniform ose shenjë të dërguesit.

5.4 Dërguesit do ti jepet pa pagesë një faturë për një artikullin e siguruar në momentin e postimit.

5.5 Postimet e parapaguara mund të shënohen me një tregues që vërteton se postimi është paguar plotësisht, për shembull: "Taxe perçue" (Taksa e paguar). Ky shënim do të shfaqet në pjesën sipër djathtas të adresës dhe vërtetohet nga një shënim i vulës datare të zyrës së origjinës.

5.6 Nuk do të pranohen artikujt të adresuar me initiale ose adresa që janë vendosur me laps dhe ato që kanë fshirje ose korrigjime në adresë. Artikuj të tillë që janë pranuar gabimisht do ti kthehen zyrës së origjinës.

6. Shënimi dhe trajtimi i artikujve

6.1 Artikujt e siguruar do të kenë një etiketë CN 06 që do të mbartë me shkronja romake shkronjën V, emrin e zyrës së origjinës dhe numrin serial të artikullit.

6.2 Në artikull do të shënohet pesha e saktë në gram.



6.3 Etiketa CN 06 dhe shënimi i peshës do të vendoset në anën e adresës dhe, nëse është e mundur, në cepin e sipërm majtas, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit nëse këto janë dhënë.

6.4 Megjithatë operatorët e caktuar mund të zëvendësojnë etiketën CN 06 me etiketën CN 04 të përshkruar në nenin RL 132.5.2, dhe një etiketë e vogël rozë që mbart me shkronja të zeza fjalët "Valeur déclarée" (vlerë e deklaruar).

6.5 Në anën e adresës do të vendoset një vulë që shënon zyrën dhe datën e postimit.


6.6 Operatorët e caktuar ndërmjetës nuk do të vendosin asnjë numër serial në anën e përparme të artikujve.

6.7 Zyra e destinacionit do të aplikojë në pjesën e pasme të çdo artikulli një vulë që tregon datën e marrjes.

6.8 Operatorët e caktuar dërgues do të marrin firmën e pranimit ose ndonjë formë tjetër evidentimi të vërtetimit të marrjes nga marrësi kur dorëzojnë ose japin në dorëzim një artikull të siguar të postës së letrave. Në shtesë të firmës do të vendoset emri me shkronja të mëdha ose çdo shënim të qartë dhe të lexueshëm që lejon identifikimin e qartë të personit që nënshkruan.

6.9 Për më shumë operatorët e caktuar rekomandohen të krijojnë sistemet që gjenerojnë të dhëna të konfirmimit elektronik të dorëzimit, dhe bien dakord të shkëmbejnë të dhëna të tilla me operatorët e caktuar të shtetit të origjinës të artikujve.

6.10 Operatorët e caktuar që kanë vendosur sisteme që gjenerojnë konfirmim elektronik do të kenë të drejtën për të përdorur firma që vendosen elektronikisht nga ky sistem, të sigurojnë prova të dërgimit të artikujve individual për operatorët e caktuar dërgues, subjekt i reklamimit CN -08 nga operatorët e caktuar për dërgimin. Të dhënat e konfirmimit elektronik të dorëzimit mund të sigurohen në mënyrë elektronike (e-mail) ose në formën e kopjes së shtypur sipas zgjedhjes së operatorëve postar të caktuar për dorëzimin.



Neni RL 135
Artikuj me pagesë nga marrësi

1. Disa artikuj mund të dërgohen me pagesë nga marrësi. Shkëmbimi i artikujve me pagesë nga marrësi do të kërkojë marrëveshje paraprake midis operatorëve të caktuar të origjinës dhe atyre të destinacionit.

2. Artikujt e pranuar

2.1 Në bazë të marrëveshjeve dypalëshe, mund të dërgohen me pagesë nga marrësi artikuj të zakonshëm, artikuj rekomandë dhe artikujt të siguar të cilat plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë Rregullore.

2.2 Operatori i caktuar do të ketë të drejtën të kufizojë shërbimet e dërgimit me pagesë nga marrësu vetëm për disa nga kategoritë e artikujve të përmendura mësipër.

3. Tarifa

3.1 Operatorët e caktuar të origjinës të artikullit do të vendosin lirisht tarifën që paguhet nga dërguesi, përveç tarifave postare të pagueshme për kategoritë të cilave i përketin këto artikuj.

4. Funkcioni i zyrës së postimit

4.1 Indikacione që duhet të jepen në artikujt COD. Artikujt e zakonshëm dhe rekomandë dhe artikujt e siguar do të kenë të shënuar dukshëm, në anën e adresave të kutisë së artikullit, shënimin "rimbursim" (COD) të ndjekur nga shuma e COD në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet RF 201.2 dhe RF 303 Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimit të Pagesave Postare. Megjithatë operatorët e caktuar mund të japin

këto informacione me anë të tabelës CN 29bis.

4.2 Etiketat. Kur një tarifë COD është e pagueshme, artikujt do të mbartin në anën e adresës, nëse është e mundur në cepin e sipërm majtas, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit, kur këto jepen, një etiketë ngjyrë portokalli në formën e modelit CN 29. Etiketa CN 04 e dhënë në nenin RL 132.5.2 (ose vendosja e një vule të veçantë në vend të saj) do të aplikohet nëse është e mundur në cepin e sipërm të etiketës CN 29; megjithatë, në vend të dy etiketave të sipër përmendura, operatorët e caktuar mund të përdorin një etiketë të vetme në formën e një modelit CN 30 që mbart në shkronja romake emrin e zyrës së orgjinës, shkronjën R, numrin serial të artikullit dhe në një trekëndësh ngjyrë portokalli që përmbajnë fjalën "Remboursement" (COD).

4.3 Formulari do ti bashkëlidhet artikujve. Çdo artikull COD do të shoqërohet nga urdhër pagesa në përputhje me dispozitat e nenit RF 201.2.


5. Funksioni i zyrës së destinacionit

5.1 Artikujt për të cilët është e pagueshme një tarifë COD do ti dorëzohen marrësit sipas kushteve të vendosura nga shtetet anëtare ose operatorët e caktuar të destinacionit. Shumat e mbledhura do trajtohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen e Shërbimeve të Pagesave Postare .

6. Ri-adresimi

6.1 Çdo artikull për të cilin është e pagueshme një tarifë COD mund të ri-adresohet nëse shteti i destinacionit të ri e siguron këtë shërbim në lidhje me shtetin e origjinës.

CN 29




Size 37 x 18 mm (base x height), colour orange

CN 29bis	
COD	
Currency unit/amount	
to be credited to account No	
of (bank)	
Giro centre/Bank branch	

Size 105 x 75 mm, triangle orange

CN 30



Size 37 x 13 mm, triangle orange



Neni RL 136 Artikuj Ekspres

1. Me kërkesë të dërguesit, artikujt e postës së letrave për shtetet ku operatorët e caktuar e ofrojnë këtë mënyrë shërbimi do të dorëzohet me anë të një mënyre të veçantë sa më shpejtë të jetë e mundur pas mbërritjes së tyre në zyrën e dorëzimit. Çdo operator i caktuar do të ketë të drejtën të kufizojë këto shërbime për artikujt me prioritet, për artikujt e postës ajrore, kur kjo është e vetmja mënyrë e përdorur midis dy operatave të caktuar, për artikujt tokësorë LC.

2. Tarifa

2.1 Artikujt ekspres do të jenë subjekt, përveç postimit, e një tarife shtesë e cila nuk mund të jetë më e vogël se shuma e postimit të parapaguar për artikujt të zakonshëm, me prioritet ose jo, sipas rastit, ose në një çmim të vetëm të paregjistruar dhe shumës e udhëzimit për këtë tarifë është 1.63 SDR. Për çdo thes M, operatorët e caktuar do të mbledhin, në vend të tarifës për artikull, një tarifë për postim në sasi të mëdha që nuk kalon pesëfishin e tarifës për artikull. Kjo tarifë do të paguhet e gjitha paraprakisht.

2.2 Kur kërkohen dërgimi ekspres përfshin kërkesa të posaçme, do të mbledhet një tarifë shtesë në përputhje me dispozitat që lidhen me artikujt e të njëjtit lloj në shërbimin e brendshëm.

2.3 Nëse rregulloret e operatorëve të caktuar të destinacionit e lejojnë, marrësi mund të pyesë zyrën e dorëzimit për dorëzimin ekspres menjëherë pas mbërritjes për artikujt që i janë adresuar atyre. Në këtë rast operatorët e caktuar do të autorizohen të mbledhin, tarifën që aplikohet në shërbimin e tyre të brendshëm për dorëzimin.

3. Shënimi

3.1 Artikujt për dorëzimet ekspres do të pajisen njëkohësisht me një etiketë të veçantë të printuar me ngjyrë të kuqe të shndritshme ose një vulë me të njëjtën ngjyrë që ka fjalën "Exprès" (Ekspres) me shkronja të zeza. Në mungesë të një etikete ose një vule, fjala "Exprès" do të shkruhet me shkronja të trasha të mëdha me ngjyrë të kuqe të shndritshme. Nëse është e mundur, etiketa ose vula do të ketë formën e paraqitur më poshtë. Etiketa "Exprès", pulla ose shënimi do të vendosen në anën e adresës, nëse është e mundur në cepin e sipërm majtas, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit nëse ato jepen.



4. Trajtimi i artikujve

4.1 Artikujt ekspres mund të shpërndahen në një mënyrë të ndryshme, për sa kohë që niveli i përgjithshëm i shërbimit të ofruar për marësin është të paktën e barabartë me atë që do të kishte qenë me anë të korrierëve të veçantë të dorëzimit.

4.2 Operatorët e caktuar të cilët kanë nivele të ndryshme të postës së letrave do të fusin artikujt ekspres në kategorinë më të shpejtë të postës së brendshme të letrave me pas mbërritjes së tyre në zyrën e brendshme të shkëmbimit dhe pas kësaj të dorëzojnë këto artikuj në mënyrën më të shpejtë të mundshme.

4.3 Nëse artikujt arrijnë në zyrën e dorëzimit pas dorëzimit të fundit të zakonshëm, ato do të dorëzohen më anë të një korrieri të veçantë në të njëjtën ditë dhe sipas të njëjtave kushte si aplikohet në shërbimin e brendshëm, në këto vende që sigurojnë këtë shërbim.

4.4 Për më tepër, operatorët e caktuar mund të sigurojnë konfirmime elektronike të dorëzimeve dhe të bien dakord të shkëmbejnë këto të dhëna të dërgesave me operatorët e caktuar të origjinës së artikujve.

4.5 Kur rregulloret e tij e mundësojnë, operatorët e caktuar mund të dorëzojnë me ekspres një njoftim të mbërritjes së një artikulli të siguruar dhe jo vetë artikullin.

4.6 Nëse artikujt ekspres duhet ti nënshtrohen kontrollit doganor, operatorët e caktuar duhet:

4.6.1 t'ia paraqesin ato Doganës sa më shpejtë të jetë e mundur pas mbërritjes së tyre; dhe

4.6.2 të nxisin autoritetet doganore në shtetin e tyre për të realizuar kontrollin e këtyre artikujve sa më shpejt

4.7 Artikujt ekspres për të cilat shuma totale e tarifës së pagueshme paraprakisht nuk është paguar plotësisht do të dorëzohet si postë e zakonshme me përjashtim të rastit kur ato janë trajtuar si ekspres nga zyra e origjinës. Më vonë do të mbledhet një tarifë për to në përputhje me nenin RL 118.7.

4.8 Operatorët e caktuar mund të kufizojnë veten duke bërë vetëm një përpjekje të dërgimit ekspres. Çdo përpjekje e mëvonshme për të realizuar dërgimin ekspres të artikullit nuk do të jetë domosdoshmërisht e detyrueshme. Më pas artikulli do të trajtohet si artikull i zakonshëm.

Neni RL 137 Lajmërim marrja

1. Në ato operatorë të caktuar që ofrojnë lajmërim marrje për shërbimin e dorëzimit të klientët, dërguesi i një artikulli të regjistruar, një artikulli me dorëzim të regjistruar ose një artikulli të siguruar mund të aplikojë për një njoftim marrje në momentin e postimit duke paguar një tarifë, shuma maksimale sipas udhëzuesit për të cilën do të jetë 0.98 SDR. Ky lajmërim marrje do të kthehet atij me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

2. Shënimi i artikujve me lajmërim marrje

2.1 Artikujt për të cilët dërguesi kërkon një lajmërim marrje do të ketë me shkronja të zeza në anën e adresës shkronjat A.R. Dërguesi do shënojë emrin e tij dhe adresën me shkronja romake në pjesën e jashtme të artikullit. Ky shënim i fundit, kur paraqitet në anën e adresës, do të vendoset në cepin e sipërm majtas. Ky pozicion, nëse është e mundur do të caktohet gjithashtu për shkronjat A.R., që mund të vendosen poshtë emrit dhe adresës së dërguesit nëse këto janë paraqitur.

2.2 Artikujt e përmendur sipas 2.1 do të shoqërohen me një formular CN 07 me ngjyrë të kuqe të lehtë me trashësinë e një kartoline. Formulari CN 07 do të ketë të shkruajtur me shkronja të zeza shkronjat A.R. Dërguesi do të plotësojë, me shkronja romake dhe duke përdorur çdo mënyrë tjetër përveç lapsit të zakonshëm, seksionet e ndryshme siç është përcaktuar nga formulari. Pjesa e përparme e formularit do të plotësohet nga zyra e e origjinës ose nga çdo zyrë tjetër e caktuar nga operatorët e caktuar dhe do të bashkëlidhet në mënyrë të sigurt me artikullin. Nëse formulari nuk mbërrin në zyrën e destinacionit ajo zyrë automatikisht do të bëjë një lajmërim marrje të ri.

2.3 Në llogaritjen e postimit në një artikulli me lajmërim marrje, duke përfshirë, nëse është e aplikueshme, llogaritjen e tarifës shtesë për transportin ajror, do të merret parasysh pesha e formularit CN 07. Tarifa e lajmërim marrjes do të përfaqësohet në artikull me tarifat e tjera.

3. Trajtimi i lajmërim marrjes

3.1 Si çështje me prioritet lajmërim marrja duhet të firmoset nga marrësi ose nëse kjo gjë nuk është e mundur, nga një person i autorizuar për të bërë këtë gjë sipas rregullave të shtetit të destinacionit. Nëse këto rregulla e mundësojnë dhe me përjashtim të rastit të dorëzimit të marrësi personalisht, lajmërimi mund të firmoset nga nëpunësi i zyrës së destinacionit. Në shtesë të firmës, do të vendoset gjithashtu emri me shkronja të mëdha ose çdo e dhënë tjetër e qartë dhe e lexueshme që lejon identifikimin e pa gabueshëm të personit që nënshkruan.

3.2 Zyra e destinacionit do të kthejë formularin CN 07 të plotësuar dhe firmosur në mënyrën e duhur direkt të dërguesi me postën e parë. Ky formular do të dërgohet à découvert dhe me postë të lirë me linjën më të shpejtë (ajrore ose tokësore). Nëse lajmërim marrja kthehet pa u plotësuar në mënyrën e duhur, parregullsia do të njoftohet me anë të formularit CN 08 të dhënë sipas nenit RL 150.2, të cilit do ti bashkëlidhet lajmërim marrja përkatëse.

3.3 Kur dërguesi reklamon një lajmërim marrje të cilën ai nuk e ka marrë brenda një afati normal kohor, ky lajmërim do të kërkohej pa tarifë me formularin CN 08. Një dublikat i lajmërim marrjes, të shënuar në krye me shkronja të zeza fjalën "Duplicata" (Duplikat), do të bashkëlidhet me formularin e reklamimit CN 08. Ky i fundit do të përdoret në përputhje me nenin RL 150.



Neni RL 138

Dorëzimi personalisht tek marrësi

1. Me kërkesë të dërguesit, dhe në shërbimin midis atyre operatorëve të caktuar që kanë dhënë miratimin e tyre, artikujt rekomande, artikujt e dorëzuar të regjistruar dhe artikujt e siguruar do të dorëzohen personalisht te marrësi. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të lejojnë këtë mundësi vetëm për ata artikuj të shoqëruar nga një lajmërim marrje.

2. Në të gjitha rastet, dërguesi do të paguajë një tarifë për dërgimin personalisht te marrësi, shuma e udhëzimit për të cilën do të jetë 0.16 SDR.

3. Shënimi dhe trajtimi i artikujve për dërgim personalisht te marrësi

3.1 Artikujt për dërgim personalisht te marrësi do të kenë të shkruajtur me shkronja të zeza fjalët "À remettre en main propre" (Për dorëzim personalisht te marrësi) ose ekuivalenten e saj në një gjuhë të njohur nga shteti i destinacionit. Ky shënim do të shfaqet në anën e adresës, nëse është e mundur, në cepin e sipërm majtas, poshtë adresës dhe emrit të dërguesit nëse këto janë shënuar.

3.2 Kur dërguesi ka kërkuar një lajmërim marrje dhe dorëzim personalisht te marrësi, marrësi ose nëse kjo nuk është e mundur, një përfaqësues i tij i autorizuar, do të nënshkruajë formularin CN 07. Në shtesë të firmës, do të vendoset gjithashtu me shkronja të mëdha ose në çdo mënyrë të qartë dhe të lexueshme çdo e dhëna që lejon identifikimin e pagabueshëm të personit që nënshkruan.

3.3 Operatorët e caktuar do të bëjnë një përpjekje të dytë për të dorëzuar këta artikuj vetëm nëse mendohet se kjo do të jetë e suksesshme dhe nëse rregullorja e brendshme e lejon këtë gjë.

Neni RL 139

Artikuj për tu dërguar pa pagesa dhe tarifa

1. Në shërbim midis operatorëve të caktuar të cilat kanë njoftuar marrëveshjen e tyre për këtë qëllim, dërguesit, me anë të një deklarate paraprake në zyrën e origjinës, mund të marrin përsipër të paguajnë tërësisht tarifën dhe çmimet subjekt i të cilave janë artikujt e postës së letrave pas dorëzimit. Për sa kohë që artikulli i posatës së letrave nuk është dorëzuar tek marrësi, dërguesi mund të kërkojë pas postimit që artikulli të dorëzohet pa tarifa dhe pagesa.

2. Tarifat

2.1 Dërguesit do të paguajnë shumën që mund të kërkohej nga zyra e destinacionit. Nëse është e nevojshme, ata do të bëjnë një pagesë të përkohshme.

2.2 Operatorët e caktuar e origjinës do të mbledhin nga dërguesi, një pagesë, shumën e udhëzuesit për të cilën do të jetë 0.98 SDR, të cilën ai do ta mbajë si pagesë për shërbimin e realizuar në shtetin origjinës.

2.3 Në rast të një kërkesë të bërë pas postimit të një artikulli të postës së letrave, operatori i caktuar i origjinës gjithashtu duhet të marrë një pagesë shtesë shuma e udhëzuesit për të cilën do të jetë 1.31 SDR për kërkesë.

2.4 Operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i autorizuar të marrë një pagesë komisioni, shuma e udhëzimit për të cilën do të jetë 0.98 SDR. Kjo pagesë do të jetë e pavaruar nga tarifa për paraqitje në Doganë. Ajo do të mbledhet nga dërguesi për llogari të operatorit të caktuar të destinacionit.

3. Çdo operator i caktuar mund të kufizojë shërbimin e dorëzimit pa pagesë dhe tarifë për artikujt e postës së letrave rekomande dhe të siguruar.

4. Shënimi dhe Trajtimi i artikujve

4.1 Artikujt për dërgimin te marrësi të lirë pa pagesë dhe tarifë do të mbartë me shkronja të zeza titullin "Franc de taxes et de droits" (pa pagesë dhe tarifë) ose një shënim i ngjashëm në gjuhën e shtetit të origjinës. Këto artikuj do të pajisen me një etiketë të verdhë që gjithashtu mbart me shkronja të zeza "Franc de taxes et de droits". Titulli dhe etiketa do të vendoset në anën e adresës, nëse është e mundur në cepin e sipërm majtas, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit nëse këto janë shënuar.

4.2 Çdo artikull i dërguar pa pagesë dhe tarifë do të shoqërohet nga një shënim i postimit pa pagesë CN 11. Dërguesi i artikullit do të plotësojë tekstin e anës së djathtë të fillimit pjesëve A dhe B të shënimit të postimit pa pagesë. Zyra e shpërndarjes do të fusë shënimin e zyrës postare. Shënimet e dërguesit mund të bëhen duke përdorur letrën e karbonit. Teksti duhet të përfshijë angazhimin e përshkruar në pikën 2.1. Shënimi i postimit pa pagesë, i plotësuar në mënyrën e duhur, do të bashkëlidhet atij në mënyrë të sigurt.

4.3 Dërguesi mund të kërkojë, pas postimit, që artikulli të dërgohet pa pagesa dhe tarifa.

4.3.1 Nëse kërkesa duhet të dërgohet me postë, zyra e origjinës duhet të informojë zyrën e destinacionit me një shënim sqarues. Ky i fundit do të mbartë parapagimin e duhur të tarifës. Ai do të dorëzohet si një artikull rekomande me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore) në zyrën e destinacionit e shoqëruar nga një shënim i postimit pa pagesë, i plotësuar në mënyrën e duhur. Zyra e destinacionit do të vendosë etiketën e përshkruar sipas 4.1 për artikullin.

4.3.2 Nëse kërkesa është që dërgimi të realizohet me anë të telekomunikacionit, zyra e origjinës do të informojë zyrën e destinacionit me anë të telekomunikacionit dhe në të njejtën kohë të njoftojë veçoritë që lidhen me postimin e artikullit. Zyra e destinacionit automatikisht do të realizojë një shënim të postimit pa pagesë.

5. Kthimi i pjesës A të shënimit të postimit. Rekuperimi i pagesës dhe tarifës

5.1 Pas dorëzimit të marrësi i një artikulli për dorëzimin pa pagesa dhe tarifa, zyra që ka parapaguar doganën ose pagesa të tjera për llogari të dërguesit do të plotësojë, për sa i përket, me përdorimin e një letre karboni, detajet që paraqiten në pjesën e pasme të pjesës A dhe B të shënimit të postimit pa pagesë. Ai do të dërgojë pjesën A, të shoqëruar nga kuponat mbështetës, në zyrën e origjinës të artikullit, kjo do të dërgohet në një zarf të mbyllur, pa tregues të përmbajtjes. Pjesa B do të mbahet nga operatori i caktuar i destinacionit të artikullit për shlyerjen me operatorin e caktuar debitor.

5.2 Megjithatë, çdo operator i caktuar mund të bëjë marrëveshje që pjesa A e shënimit të postimit pa pagesë, për të cilin tarifat janë tatuar, të kthehet nga zyra e veçantë e caktuar dhe të kërkojë që kjo pjesë të dërgohet një zyre të specializuar.

5.3 Emri i zyrës tek e cila duhet të kthehet pjesa A e shënimit të postimit pa pagesë duhet të kthehet do të vendoset në çdo rast në pjesën qendrore të kësaj pjese nga zyra që shpërndan artikullin.

5.4 Kur një artikull që mbart fjalët "Franc de taxes et de droits" (pa pagesa dhe tarifa) arrin në shërbimin e destinacionit pa një shënim të postimit pa pagesë, zyra përgjegjëse për çdoganimin do të përgatisë një shënim dublikat; për pjesët A dhe B të këtij shënimi ajo do të tregojë emrin e shtetit të origjinës dhe nëse është e mundur, të dhënat e postimit të artikullit.

5.5 Kur shënimi i postimit pa pagesë humbet gjatë dorëzimit të një artikulli, do të përgatitet një dublikat sipas të njëjtave kushte.

5.6 Pjesët A dhe B të shënimit të postimit pa pagesë që lidhen me artikujt të cilët janë kthyer për çfarëdo arsye në origjinë do të fshihet nga operatori i caktuar i destinacionit.

5.7 Pas marrjes së pjesës A të shënimit të postimit pa pagesë që tregon tarifën e paguar nga shërbimi i destinacionit, operatori i caktuar i origjinës do ta konvertojë shumën e këtyre tarifave në monedhën e tij. Kursi i përdorur nuk duhet të jetë më i lartë se kursi i caktuar për lëshimin e urdhër-pagesave për shtetin e interesuar. Rezultati i konvertimit do të tregohet në formular dhe në kuponin në anë të tij. Pas kthimit të shumës së pagesës, zyra e caktuar për këtë qëllim do të dorëzojë dërguesit kuponin nga shënimi dhe faturat mbështetëse.

6. Kontabiliteti i artikujve me operatorët e caktuar e origjinës

6.1 Kontabiliteti në lidhje me tarifat dhe pagesat e klientëve dhe tarifat e tjera të paguara nga çdo operator i caktuar për llogari të një tjetri do të realizohet me anë të llogarive mujore të detahuara CN 12, të hartuara nga operatori i caktuar kreditor në monedhën e shtetit të tij. Të dhënat në pjesën B të shënimit pa pagesë të cilat janë mbajtur do të regjistrohen në rendin alfabetik të zyrës që ka kaluar pagesat dhe në rendin numerik që i është dhënë atyre.

6.2 Nëse dy operatorët e caktuar të interesuar, në marrëdhëniet e tyre me njëra tjetrën, veprojnë edhe me pjesën e shërbimit të kolipostës, ato në mungesë të një njoftimi të kundërt, mund të përfshijnë në llogaritje e tarifave dhe pagesave të doganës dhe tarifa të tjera të atij shërbimi, edhe atë të postës së letrave.

6.3 Llogaria e detajuar e CN 12, e shoqëruar nga pjesët B të shënimit të postimit pa pagesë, do të dërgohet operatorëve të caktuar debitorë të paktën në fund të muajit vijues të atij që lidhet me të. Nuk do të përgatiten llogaritë "zero".

6.4 Llogaritë do të shlyhen të ndara. Çdo operator i caktuar, megjithatë mund të kërkojnë që këto llogari të shlyhen me ato të urdhër-pagesave, me llogaritë CP 75 për koltë postare, ose, në fund, me llogaritë SFP 3, pa u shkrirë me to.



Neni RL 140
Shërbimi Ndërkombëtar i përgjigjes së biznesit (IBRS)

1. Të përgjithshme

1.1 Operatorët e caktuar mund të bien dakord me njëri tjetrin të marrin pjesë në shërbim fakultativ ndërkombëtar për përgjigjen e biznesit (IBRS). Megjithatë, të gjithë operatorët e caktuar do të jenë të detyruar të kryejnë shërbimin e “kthimit” të IBRS për artikujt që plotësojnë specifikimet e IBRS-së.

1.2 Qëllimi i shërbimit ndërkombëtar të përgjigjes së biznesit (IBRS) është ti mundësojë dërguesve të autorizuar të paguajnë paraprakisht artikujt e postuar nga i anketuari jashtë shtetit.

1.3 Operatorët e caktuar që realizojnë këtë shërbim do të plotësojnë dispozitat e caktuara më poshtë

1.4 Operatorët e caktuar sidoqoftë mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme që të aplikohet një sistem tjetër midis tyre.

1.5 Operatorët e caktuar mund të caktojnë një sistem kompensimi që merr në konsideratë kostot që lindin.

2. Mënyrat e veprimt

2.1 IBRS punon si më poshtë vijon:

2.1.1 artikujt nga dërguesi i autorizuar që jeton në shtetin "A" i dërgohet të anketuarit që jeton në një ose disa shtete "B" ku secili përmban një zarf, kartelë ose etiketë IBRS;

2.1.2 I anketuari që jeton në shtetin (ose shtetet) "B" mund të përdorë zarfat, etiketat ose kartelat IBRS për t'iu përgjigjur dërguesit; artikujt IBRS do të konsiderohen si artikuj me prioritet ose artikuj të zakonshëm të postës ajrore të parapaguara në përputhje me nenin RL 114.2.1.4;

2.1.3 artikujt IBRS të postuar do të transmetohen në shtetin "A" dhe do ti dorëzohen dërguesit të autorizuar.

2.2 Shtetet anëtare ose operatorët e caktuar do të jenë të lirë të caktojnë tarifat dhe kushtet për autorizimin e përdorimit të shërbimit dhe trajtimin e artikujve të postuar.

2.3 Operatorët e caktuar që veprojnë me IBRS mund të veprojnë në këtë mënyrë në një bazë reciproke ose vetëm në një drejtim (shërbimi i “Kthimit”). Procedura e fundit supozon se operatori i caktuar i shtetit “B” pranon artikujt IBRS për postimin por nuk lëshon autorizim për të përdorur shërbimin për klientët që qëndrojnë në territorin e tij.

2.4 Operatorët e caktuar që realizojnë shërbimin do ti bëjnë të qartë klientëve të tyre, për autorizimin e përdorimit të shërbimit, detyrimin në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe për rregulloret në Manualin e Postës së Letrave.

3. Specifikime për artikujt IBRS


3.1 Artikujt IBRS mund të jenë në formën e kartelave ose zarfeve në përputhje me modelet e dhëna dhe me rregulloret e Manualit të Postës së Letrave.

3.2 Artikujt që konsistojnë në zarfe ose paketime që kanë një etiketë konform modeleve të dhëna dhe rregulloret në Manualin e Postës së Letrave, gjithashtu do të përdoren si artikujt IBRS.

3.3 Artikujt IBRS duhet të përputhen me limitet e aplikueshme të përmasave për artikujt ekuivalent të postës së letrave të paraqitura në nenin RL 122. Në lidhje me formën e kartolinave ose artikujve prej kartoni, artikujt IBRS gjithashtu mund të pranohen në përputhje me nenin RL 128.5. Artikujt IBRS nuk duhet të peshojnë më shumë se 50 gram.

3.4 artikujt IBRS mund të përmbajnë korrespondenca dhe letra të printuara.

3.5 Pavarësisht nga pikat 3.3 dhe 3.4, operatorët e caktuar mund të bien dakord të pranojnë të mira pa vlerë tregtare në artikujt IBRS dhe të kufizojnë peshën e tyre në 250 gram. Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme për ndonjë shtrirje të mëtejshme të shërbimit.



4. Llogaritje të tarifave IBRS

4.1 Çdo operator i caktuar që kthen artikujt IBRS tek një operator tjetër i caktuar do të jetë i detyruar të mbledhë nga ky operator i caktuar një shumë që korrespondon me koston që shkaktohet nga kthimi i artikujve IBRS.

4.2 Kjo shumë do të caktohet në bazë të një tarife për artikull dhe një tarife për kilogram . Këto tarifa do të llogariten si më poshtë vijon:

4.2.1 tarifa për artikull do të caktohet në 0.15 SDR;

4.2.2 tarifa për kilogram do të llogaritet, në parim, siç është treguar në nenin RL 237.3, por në përputhje me peshën neto. Tarifa për kilogram do të caktohet në bazë të jo më shumë se 10 tarifave mesatare, ku secila prej tyre lidhet me një grup shtetesh të destinacionit dhe caktohet në përputhje me peshën e postës për destinacione të ndryshme brenda grupit. Tarifa për kilogram do ti paraqitet Byrosë Ndërkombëtare dhe do të publikohet çdo vit në Listën CN 68.

4.3 Çdo rishikim i tarifës së përmendur në pikën 4.2.1 do të bazohet në të dhënat ekonomike të disponueshme.

4.4 Me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar vendosin ndryshe, tarifat IBRS nuk do të paguhen kur shuma vjetore e artikujve IBRS të kthyer nga çdo operator i caktuar është e barabartë ose më e vogël se 1,000. Kur numri vjetor i artikujve IBRS të kthyer kalon 1,000 për një operator të caktuar, shuma e paguar do të marrë në konsideratë numrin e artikujve IBRS të kthyer nga të dy operatorët e caktuar.

5. Llogaritja e tarifave IBRS

5.1 Përgatitja e situacioneve CN 09 dhe CN 10 të artikujve IBRS

5.1.1 Pas transmetimit të postës së fundit të çdo muaji, zyra e shkëmbimit të origjinës së artikujve IBRS do të përgatisë, me anë të zyrës së shkëmbimit të destinacionit, nga të dhënat në faturat CN 31 dhe CN 09 situacionin për artikujt e dërguar IBRS. Më pas ajo do t'ia dërgojë këto situacione administratës të saj qendrore.

5.1.1.1 Kur fatura CN 31 nuk ka të dhëna për peshën e artikujve IBRS të kthyer, do të aplikohet një peshë e pa paguar prej 5 gramësh.

5.1.2 Për çdo operator të caktuar e destinacionit për artikujt IBRS, operatori i caktuar e origjinës duhet të përgatisë çdo tremujor, nga të dhënat e situacionit CN 09, nga zyra e origjinës, nga zyra e destinacionit dhe kur është e përshtatshme, duke rruga e dërgimit, një situacion përmbledhës CN të artikujve IBRS.

5.1.3 Operatorët e caktuar të destinacionit do të pajisen me situacionet CN 09 për të mbështetur situacionin përmbledhës CN 10.

5.2 Transmetimi dhe pranimi i situacioneve CN 09 dhe CN 10 të artikujve IBRS

5.2.1 Situacioni përmbledhës CN 10 do të dërgohet me dublikatë tek operatorët e caktuar të destinacionit të artikujve IBRS brenda pesë muajve të përfundimit të tremujorit në fjalë.

5.2.2 Pas pranimit të tij, operatorët e caktuar të destinacionit të artikujve IBRS do të kthejnë një kopje operatorit të caktuar që e ka përgatitur atë. Nëse operatori i caktuar nuk ka marrë ndonjë njoftim për



ndryshime brenda tre muajve nga data e shpërndarjes, ai do ta konsiderojë atë si plotësisht të pranuar. Nëse verifikimet nxjerrin ndonjë mospërputhje, situacioni CN 09 i korrigjuar do të bashkëlidhet në mbështetje situacionit përmbledhës CN 10 amenduar dhe të pranuar. Nëse operatori i caktuar i origjinës të artikujve IBRS kundërshton ndryshimin e realizuar në situacionin CN 09, ai do të konfirmojë të dhënat aktuale duke dërguar fotokopjet e formularit CN 31 të hartuar nga zyra e origjinës në dërgimin e artikujve IBRS të diskutuar.

5.2.3 Operatorët e caktuar mund të bien dakord që situacionet CN 09 dhe CN 10 të përgatiten nga operatori i caktuar i destinacionit të artikujve IBRS. Në këtë rast, procedura e pranimit e dhënë sipas pikave 5.2.1 dhe 5.2.2 do të përshtatet.

5.3 Përgatitja, transmetimi dhe miratimi i llogarive IBRS

5.3.1 Operatori i caktuar do të jetë përgjegjës për përgatitjen e llogarive dhe dërgimin e tyre te operatorët e caktuar debitorë.

5.3.2 Llogaritë e detajuara do të përgatiten në një formular CN 19, në bazë të ndryshimeve midis shumave që përputhen me llogaritë bazuar në normat dhe peshën e artikujve IBRS të marrë dhe shpërndarë si shfaqet nga situacioni përmbledhës CN 10.

5.3.3 Llogaria e detajuar CN 19 do të dërgohet në dublikat tek operatori i caktuar debitor sa më shpejt të jetë e mundur pas përfundimit të vitit të cilit i referohet.

5.3.4 Operatori i caktuar debitor nuk do të jetë i detyruar të pranojë llogaritë e detajuara që nuk dërgohen atij brenda 12 muajve nga përfundimi i vitit që lidhet me të.

5.3.5 Nëse operatori i caktuar që dërgon llogarinë e detajuar nuk merr njoftim të ndryshimeve brenda tre muajve nga data e shpërndarjes, llogaria do të mendohet si plotësisht e pranuar.

5.3.6 Llogaria e detajuar CN 19 mund të përmbledhet në një llogari të përgjithshme CN 52 nga operatori i caktuar kreditor sipas kushteve të dhëna sipas nenit RL 242.5.

5.4 Llogaritë e përgjithshme të likuidimit dhe pagesa e tarifave IBRS

5.4.1 Për tarifën IBRS, për të cilat operatori i caktuar kreditor përgatit situacionin CN 20 do të zbatohet Neni RL 250.

Neni RL 141

Shërbimi Ndërkombëtar i Përgjigjes së Biznesi – përgjigjet lokale

1. Operatorët e caktuar mund të bien dakord me marrëveshje dypalëshe për të kryer një IBRS shtesë – të përgjigjes lokale, me baza reciproke ose vetëm në një drejtim (shërbimi i kthimit).

2. IBRS – përgjigja lokale është bazuar në IBRS por përgjigja e parapaguar përdor përgjigjen e biznesit të brendshëm të hartuar nga operatori i caktuar në të cilin ato janë postuar. Operatori i caktuar i shtetit të postimit dorëzon këtë përgjigje në një Kutë të Zyrës Postare me adresë në territorin e tij, i tërheq ato nga kutia P.O. dhe ia shpërndan ato operatorit të caktuar të origjinës në postën ndërkombëtare.

3. Detajet e këtij shërbimi do të paraqiten në mënyrë të dyanshme midis operatorëve të caktuar në bazë të dispozitave udhëzuese të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare.

Neni RL 142

Kupona të përgjigjes ndërkombëtare


1. Operatorët e caktuar do të lejohen të shesin kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të emetuar nga Byroja Ndërkombëtare dhe të kufizojnë shitjen e tyre në përputhje me legjislacionin tyre të brendshëm.

2. Vlera e kuponit të përgjigjes të dhënë sipas nenit 13.4.2 të Konventës do të jetë 0.74 SDR. Çmimi i shitjes i caktuar nga operatorët e caktuar nuk mund të jetë më i ulët se kjo vlerë.

3. Kuponat e përgjigjes do të jenë të shkëmbyeshëm në çdo shtet anëtar për pullat postare dhe nëse nuk është e ndaluar nga legjislacioni i brendshëm i shtetit të shkëmbimit, për shënimet e artikujve shkrimi postar ose shënimet e parapagimeve postare ose vulat që përfaqësojnë minimumin e parapagimeve postare për një artikull të postës së letrave të pa regjistruar me prioritet ose një letër të paregjistruar të postës ajrore që dërgohet jashtë shtetit, cilido qoftë shteti i destinacionit.

4. Operatori i caktuar i një shteti anëtar, për më shumë, mund të rezervojë të drejtën për të kërkuar kuponat e përgjigjes dhe artikujt që duhet të parapagohen në shkëmbim të këtyre kuponave që duhet të paraqiten në të njëjtën kohë.

5. Kuponat e përgjigjes ndërkombëtare do të jenë në përputhje me modelin CN 01 të bashkëlidhur. Ato do të printohen, në një letër që si sfond inicialet UPU me shkronja të mëdha, sipas marëveshjeve të realizuara nga Byroja Ndërkombëtare. Emri i shtetit të orgjinës do të printohen te kuponat. Ata gjithashtu do të kenë të printuar, inter alia, një barkod të standardizuar UPU që përmban kodin ISO të shtetit, datën e printimit dhe çmimin e shitjes së Byrosë Ndërkombëtare të shprehur në SDR. Ato do të dorëzohen menjëherë pasi operatorët e caktuar të kenë paguar shumën e faturës që i është dërguar paraprakisht nga Byroja Ndërkombëtare, të përbërë nga vlera e kuponit dhe prodhimin e lidhur me të, transportin dhe koston e sigurimit.



6. Operatorët e caktuar do të porosisin kupona të përgjigjes ndërkombëtare nga Byroja Ndërkombëtare. Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë një faturë dorëzimi brenda 10 ditëve të punës nga marrja e porosisë dhe do ia dërgojë atë operatorit të caktuar të interesuar. Peridha e pagesës do të jetë gjashtë javë nga data në të cilën është dërguar fatura. Në rastin e mos pagesave brenda kësaj periudhe, fatura dhe porosia që lidhet me të do të fshihet. Megjithatë një operator i caktuar me një kredit në Byronë Ndërkombëtare që rrjedh nga një llogari e kuponave ndërkombëtarë të përgjigjes mund të përdorë atë për shlyerjen e pjeshme ose të plotë të faturës së dorëzimit.

7. Çdo operator i caktuar do të ketë mundësinë e shënimit të çmimit të shitjes në kuponin e përgjigjes me anë të procesit të printimit ose duke i kërkuar Byrosë Ndërkombëtare të shënojë këtë çmimim në momentin e printimit.

8. Periudha e vlefshmërisë së kuponit do të shënohet në të. Zyrat postare do ti plotësojnë vetë në mënyrë të qartë dokumentet kur ata i shkëmbejnë dhe do të kontrollojnë në mënyrë të veçantë praninë e shenjave të sfondit dhe veçorive të tjera të sigurisë, detaje të të cilave do ti komunikohen paraprakisht nga Byroja Ndërkombëtare. Kuponat e përgjigjes në të cilat teksti i printuar nuk përputhet me tekstin zyrtar, do të refuzohen si të pavlefshëm. Kuponat e përgjigjes do të pajisen me një shënim të vulës datare të zyrës që i shkëmben ato.

9. Kuponat e shkëmbyer të përgjigjes do ti kthehen Byrosë Ndërkombëtare në paketime një mijëshe. Operatorët e caktuar që shkëmbejnë më pak se një mijë kupona në vit mund ti kthejnë Byrosë Ndërkombëtare kuponat që kanë shkëmbyer në fund të vitit. Ato do të dërgohen së bashku me një situacion CN 03 të përgatitur me dublikat dhe që tregon numrin e tyre total dhe vlerën. Vlera do të llogaritet në përputhje me normat e paraqitura sipas pikës 2. Në rast të ndryshimit të kësaj norme, të gjithë kuponat e përgjigjes të shkëmbyer para kësaj date të ndryshimit do të dërgohen në një dorëzim të vetëm duke përfshirë, pa përjashtime, pjesët e prishura; ato do të shoqërohen nga një situacion i veçantë CN 03 të realizuar me vlerën e vjetër.



10. Pas verifikimeve nga Byroja Ndërkombëtare, CN 03 do të datohet dhe nënshkruhet në mënyrën e duhur dhe do ti kthehet operatorit të caktuar. Në fund të çdo tremujori, Byroja Ndërkombëtare në bazë të CN 03 të marrë, do të përgatisë një situacion të konsoliduar të kuponave të shkëmbyer nga secili operator i caktuar. Ai do të bëjë pagesa në bazë të ketyre situacioneve. Pagesat do të bëhen brenda një periudhe prej gjashtë javësh pas përfundimit të tremujorit. Operatorët e caktuar do të kenë mundësinë e marrjes së pagesave në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ose me anë të kreditimit të llogarisë së tyre IRC në Byronë Ndërkombëtare. Nuk do të jepet asnjë kredit për kuponat e shkëmbyer të imituara ose të falsifikuara.

11. Në Byronë Ndërkombëtare do të krijohet një sistem i ndarë për IRC-të që përfshin një llogari të ndarë për çdo operator të caktuar që merr pjesë në këtë shërbim. Ky sistem do të menaxhohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores për menaxhimin administrativ dhe financiar të kuponave Ndërkombëtare të përgjigjes.

12. Byroja Ndërkombëtare gjithashtu do të marrë mbrapsht kuponat e përgjigjes të dëmtuar të dërguara së bashku me një situacion të ndarë CN 03 të përgatitur në dublikat, të pajisur të paktën me një pjesë të barkodit që bëjnë të mundur përcaktimin e vlerës së kuponave të tillë .

Neni RL 143 Shërbimi i Dorëzimit

1. Operatorët e caktuar mund të bien dakord midis tyre që të marrin pjesë në një shërbim "Dorëzimi" fakultativ për artikujt kolektivë të dërguara jashtë shtetit nga një dërgues.

2. Nëse është e mundur, ky shërbim do të identifikohet nga logo e përcaktuar në pikën 4.

3. Detajet e këtij shërbimi do të përcaktohen në mënyrë të dyanshme midis operatorit të caktuar të origjinës dhe operatorit të caktuar të destinacionit në bazë të dispozitave të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare.

4. Identifikimi i shërbimit të "Dorëzimit"

4.1 Logo e dizenuar për të identifikuar shërbimin e "Dorëzimit" do të përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- fjala "DËRGESE" me shkronja blu;
- tre shirita horizontal (një i kuq, një blu dhe një jeshil).

==CONSIGNMENT==

KAPITULLI 6 NDALIMI I FUTJES SË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME NË ARTIKUJT E POSTËS SË LETRAVE. ARTIKUJ TË PRANUAR GABIM. RI-ADRESIMI. KTHIMI TEK DËRGUESI. TËRHEQJA E ARTIKUJVE NGA POSTA. REKLAMIMI

Neni RL 144 Ndalimi për të futur të mira të rrezikshme në artikujt e postës së letrave

1. Artikujt e mbuluar nga "Rekomandimet për Transportin e Mallrave të Rrezikshme" të hartuara nga Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mallrave të caktuara të rrezikshme dhe materialeve radioaktive të parashikuara në këto rregullore, si dhe nga Udhëzimet Teknike të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe Rregulloret e Mallrave të rrezikshme të Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) do të konsiderohen si substanca të rrezikshme, në përputhje me dispozitat e nenit 15.3.1 të Konventës dhe të ndaluara për tu futur në artikujt e postës së letrave.

Neni RL 145 Trajtimi i artikujve të pranuar gabim

1. Artikujt që janë pranuar gabimisht dhe që nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga kushtet e nenit 12 të Konventës për sa i përket klasifikimit dhe peshës dhe atyre të kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me

përmbajtjen, madhësinë, përgatitjen dhe shënimin, do të dërgohen tek marrësi pa pagesa shetsë. Artikujt që pranohen gabimisht që përmbajnë substanca biologjike që prishen ose materiale radioaktive dhe që nuk pajtohet me dispozitat e nenit 16 të Konventës mund gjithashtu të dërgohen tek marrësi nëse dispozitat që zbatohen në shtetin e destinacionit e lejojnë këtë gjë. Nëse dorëzimi nuk është i përshtatshëm ose i pamundur, artikujt që janë pranuar gabimisht do të kthehen tek operatori i caktuar i origjinës.

2. Artikujt që përmbajnë artikujt e përmendur në nenet 15.2.1.1 dhe 15.3.1 të Konventës dhe që janë pranuar gabimisht nga posta do të shpërndahen në përputhje me legjislacionin e shtetit të operatorit të caktuar të origjinës, tranzitit ose destinacionit që përcaktojnë praninë e tyre.

3. Operatori i caktuar i destinacionit mund të dorëzojë te marrësi pjesën e përmbajtjes që nuk është subjekt i ndalimit.

4. Kur një artikull i pranuar gabimisht nga posta nuk është kthyer në origjinë dhe as nuk është dorëzuar te marrësi, operatori i caktuar i origjinës do të njoftohet pa vonesë, se si është vepruar me të. Ky njoftim do të tregojë në mënyrë të qartë ndalimin të cilit i takon artikulli dhe nenet që shkaktojnë sekuestrimin. Një artikull i pranuar gabimisht që është kthyer në origjinë do të shoqërohet nga një njoftim i ngjashëm.

5. Në rastin e konfiskimit të një artikulli të pranuar gabimisht, operatori i caktuar i tranzitit ose destinacionit do të njoftojë operatorin e caktuar të origjinës me anë të raportit të njoftimit CN 13 ose duke përdorur mesazhin standard UPU EDI të nivelit të artikullit, nëse është rënë dakort në mënyrë të dyanshme.

6. Për më shumë, çdo shtet anëtar do të rezervojë të drejtën për refuzimin e transportimit në tranzit à découvert (të hapur) për territorin e tij të artikujve të postës së letrave, përveç letrave, kartolinave dhe literaturës për të verbër, të cilat nuk plotësojnë kërkesat që disiplinojnë kushtet e publikimit ose qarkullimit të tyre në këtë shtet. Artikujt të tillë do të kthehen tek operatori i caktuar i origjinës.

6bis. Artikujt e postës së letrave që përmbajnë artikuj, për të cilat dyshohet dëmtimi ose prishja e mëparshme

6bis.1 Artikujt që përfshihen në artikujt e postës së letrave për të cilat dyshohet dëmtimi ose prishja e mëparshme, dhe vetëm këto artikuj, mund të shiten menjëherë, pa njoftim paraprak. Shitja do të bëhet për llogari të pronarit të ligjshëm edhe gjatë transportit të rrugës ose gjatë kthimit. Nëse shitja është e pamundur, artikujt e dëmtuar ose të prishur do të shkatërrohen.

6bis.2 Kur një artikull i postës së letrave është shitur ose shkatërruar në përputhje me pikën 6bis.1, do të hartohet një procesverbal i shitjes ose shkatërrimit. Një kopje e procesverbalit e shoqëruar me një shënim verifikimi CN 43 do të dorëzohet në zyrën e origjinës.

6bis.3 Procedura e shitjes, do të shërbejë së pari për të mbuluar pagesat e postës së letrave. Bilanci, nëse do të ketë një të tillë, do të dërgohet në zyrën e origjinës për t'iu dorëzuar dërguesit. Kjo e fundit do të ketë kosto dorëzimi.

Neni RL 146 Riadresimi

1. Nëse ndonjë marrës ndërron adresën, artikujt do të ri-dërgohen atij menjëherë, subjekt i kushteve të përcaktuara më poshtë.

2. Megjithatë artikujt nuk do të ridërgohen:

2.1 Nëse dërguesi ka ndaluar ridërgimin me anë të një shënimi në një gjuhë të njohur në shtetin e destinacionit;

2.2 Nëse ato mbartin përveç adresës së marrësit shprehjen "ose qiramarrës".

3. Operatorët e caktuar që merr një tarifë për kërkesat e ri-adresimit në shërbimin e tyre të brendshëm do të jenë të autorizuar të marrin të njëjtën pagesë në shërbimin ndërkombëtar.

4. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në vijim, nuk do të merret asnjë pagesë shtesë për artikujt e postës së letrave të ri-adresuara nga sheti në shtet. Megjithatë, operatorët e caktuar që marrin tarifa për ri-adresimin e artikujve në shërbimin e tyre të brendshme do të jenë të autorizuar të marrin të njëjtat tarifa për artikujt e postës së letrave ndërkombëtar e ri-adresuara në shtetin e tyre.

5. Procedurat e ri-adresimit

5.1 Artikujt e adresuara te marrës që kanë ndërruar adresën e tyre do të konsiderohen si të adresuar direkt nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit të ri.

5.2 Çdo artikull i siguruar marrësi i të cilit është larguar për në një shtet tjetër mund të ridërgohet nëse ai shtet kryen shërbimin në marrëdhëniet e tij me shtetin e destinacionit të parë. Nëse jo, artikulli do të dërgohet më pas menjëherë tek operatori i caktuar i origjinës për tu kthyer te dërguesi.



5.3 Ri-adresimi nga një shtet në tjetrin do të realizohet vetëm nëse artikujt plotësojnë kushtet për transportin e mëtejshëm. Kjo do të aplikohet për artikujt për një marrës brenda një shteti.

5.4 Për ri-adresimin, zyra e ridërgimit do të aplikojë vulën e saj datare në pjesën e përparme të artikujve në formën e një karteje dhe në pjesën e pasme të të gjitha kategorive të tjera të artikujve.

5.5 Artikujt e zakonshëm ose rekomandë të kthyer të dërguesi për plotësim ose korrigjim të adresës nuk do të konsiderohen si artikuj të ridërguar në ripostim. Ata do të trajtohen si korrespondencë e re përgjegjëse për një tarifë të re.

5.6 Nëse përpjekja për të dorëzuar një artikull ekspres në vendin e adresës me anë të një korrieri ka dështuar, zyra e ridërgimit do të shënojë etiketën ose shënimin "Exprès" (Ekspres) me dy vija të trasha horizontale.

5.7 Cdo operator i caktuar mund të përcaktojë një periudhë ridërgimi në përputhje me atë në fuqi në shërbimin e tij të brendshëm.

6. Dërgimi

6.1 Artikujt me prioritet dhe artikujt e postës ajrore do të ri-adresohen në destinacionin e tyre të ri me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

6.2 Artikujt të tjerë do të ri-adresohen me anë të transportit normal që do të përdoret për artikujt jo me prioritet ose artikujt e transportit tokësor (duke përfshirë S.A.L.). Ato mund të ri-adresohen me prioritet ose me rrugë ajrore me kërkesë të ekspresit nga marrësi nëse ky i fundit merr përsipër të paguajë diferencën në postim për transportin e ri me prioritet ose për rrugën e re ajrore. Në këtë rast diferenca në postim do të merret, në parim, në momentin e dorëzimit të artikullit dhe mbahet nga operatori i caktuar i dorëzimit. Të gjitha artikujt gjithashtu mund të ri-adresohen me anë të rrugës më të shpejtë nëse diferenca në postim është paguar në zyrën e ri-adresimit nga një person i tretë. Ri-adresimi i këtyre artikujve me anë të rrugës më të shpejtë brenda shtetit të destinacionit do të disiplinohet nga rregulloret e brendshme të atij shteti.

6.3 Operatorët e caktuar që aplikojnë tarifa të kombinuara mund të caktojnë një tarifë të veçantë, e cila mund nuk duhet të kalojë tarifat e kombinuara, për ri-adresimin në rrugë ajrore ose me prioritet sipas kushteve të paraqitura në pikën 6.2.

7. Tarifat

7.1 Artikujt e pa paguar ose të nën paguar për transportin e tyre të parë do të jenë subjekt i tarifës që duhet të ishte aplikuar për ta nëse do ishin adresuar direkt nga pika e origjinës në vendin e ri të destinacionit.

7.2 Artikujt e paguar në mënyrën e duhur për transportimin e tyre të parë, por në të cilët tarifa shtesë për transportimin e mëvonshëm nuk është paguar para ridërgimit, do të jenë subjekt i një tarife që përfaqëson diferencën midis postimit të paguar dhe atij që do të ishte tarifuar nëse artikujt do të ishin shpërndarë fillimisht në destinacionin e tyre të ri. Kësaj tarife do ti shtohet tarifa e trajtimit të artikujve të pa paguar ose të nën paguar. Nëse ridërgohen me rrugë ajrore ose me prioritet, artikujt për më tepër do të jenë subjekt, për transmetimin tyre të mëvonshëm, të tarifave, pagesave të kombinuara ose tarifave të veçanta në përputhje me pikat 6.2 dhe 6.3.

7.3 Artikujt që fillimisht kanë qarkulluar pa tarifa në një shtet, do të jenë subjekt i tarifave postare të cilat do të ishin të pagueshme nëse ky artikull do të ishte adresuar direkt nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit të ri. Këtyre tarifave do ti shtohet tarifa e trajtimit për artikujt e pa paguar ose të nën paguar.

7.4 Në rast të ridërgimit në një shtet tjetër, do të fshihen tarifat e mëposhtme:

7.4.1 Tarifat e postës restante;

7.4.2 Tarifa e paraqitjes në Doganë;

7.4.3 Tarifa e magazinimit;

7.4.4 Tarifa e komisionit;

7.4.5 Tarifa shtesë e ekspresit;

7.4.6 Tarifa për dorëzimin e pakove të vogla të marrësi.

7.5 Detyrimet e doganës dhe tarifat e tjera për të cilat nuk është bërë e mundur që të fshihen në ridërgim ose kthim në origjinë do të merren COD nga operatori i caktuar i destinacionit të ri. Në këtë rast, operatori i caktuar i destinacionit fillestar do të bashkëlidhë të artikulli një shënim shpjegues dhe urdhër pagesë COD (modeli i formularit TFP 3 të Rregullores së Marrëveshjes së Pagesave Postare). Nëse nuk ka shërbim me pagesë nga marrësi midis operatorëve të caktuar të interesuar, tarifat në fjalë do të merren me anë të korrespondencës.

7.6 Artikujt e postës së letrave të ridërguar do të dorëzohen te marrësi pas pagesës së tarifave që rrjedhin në dërgim, në mbërritje, ose gjatë transportit për shkak të ridërgimit pas transportimit të parë. Detyrimet doganore ose tarifa të tjera të posaçme të cilat shteti i ridërgimit nuk i fshin do të paguhën gjithashtu nga marrësi.

8. Ri-adresime kolektive

8.1 Artikujt e zakonshëm që duhet ti ridërgohen tek i njëjti peroson në një adresë të re, mund të mbyllën në zarfe kolektive CN 14 të siguruar nga operatorët e caktuar. Në këto zarfe do të shkruhet vetëm emri dhe adresa e re e marrësit.

8.2 Kur numri i artikujve që do të ridërgohen në mënyrë kolektive e justifikon këtë gjë, mund të përdoren thasë. Në këtë rast detajet e kërkuara do të vendosen në një etiketë të veçantë të siguruar nga operatori i caktuar dhe do të printohen, në përgjithësi, në strukturën e zarfit CN 14.

8.3 Artikujt që do të nënshtrohen kontrollit të doganës nuk do të mbyllën në këto zarfa ose thasë. Do të përjashtohen gjithashtu artikujt forma, volumi dhe pesha e të cilëve mund të shkaktojnë prishje.

8.4 Zarfat dhe thasët kolektive CN 14 të përdorura për ri-adresime kolektive të korrespondencës do të dërgohen në një destinacion të ri me anë të rrugës së përshkruar për artikujt individual.

8.5 Zarfi ose thesi do të paraqitet i hapur në zyrën e ridërgimit. Kjo zyrë, nëse është e nevojshme, do të marrë tarifat shtesë për të cilat mund të jenë subjekt artikujt e ridërguar. Kur tarifat shtesë nuk janë paguar tarifa që duhet të merret në mbërritje do të shënohet në këto artikuj. Pas kontrollit të saj, zyra e dërgimit do të mbyllë zarfin ose thesin. Ajo do të vendosë në etiketën e zarfit dhe thesit, nëse është e nevojshme, vulën T duke shënuar që tarifat do të mblidhen për të gjitha ose për disa prej artikujve të ridërguar.

8.6 Me të mbërritur në destinacion, zarfi ose thesi mund të hapet dhe përmbajtja e tij do të kontrollohet nga zyra e dorëzimit e cila do të marrë, nëse është e nevojshme, tarifat shtesë të pa paguara. Tarifat e përpunimit për artikujt e papaguar ose të nën paguar do të merren vetëm një herë për të gjithë artikujt e futur në këto zarfe ose thasë.

8.7 Artikujt e pa regjistruar të adresuar si për marinarët ashtu edhe pasagjerët që janë në të njëjtën anije, ose për persona që udhëtojnë si skuadër, gjithashtu mund të trajtohen sipas parashikimeve të pikave 8.1 deri 8.6. Në këtë rast, etiketat e zarfeve ose çantave do të kenë adresat e anijes ose të agjencisë lundruese, etj., në të cilën do të dorëzohen zarfat ose çantat.

Neni RL 147

Artikuj që nuk mund të dorëzohen. Kthimi në shtetin e origjinës ose tek dërguesi dhe periudha e mbajtjes.

1. Operatorët e caktuar do të kthejnë artikujt për të cilët nuk është bërë e mundur të dorëzohen te marrësi për çfarëdo arsye.

2. Periudha e mbajtjes së artikujve është paraqitur në paragrafet më poshtë.

3. Përveç përjashtimit të paraqitur më poshtë, nuk do të mblidhet asnjë tarifë shtesë për artikujt e pa dorëzuar që kthehen në shtetin e origjinës. Megjithatë operatorët e caktuar që marrin një tarifë për kthimin e artikujve në shërbimin e tyre të brendshëm do të jenë të autorizuar të mbledhin të njëjtën tarifë për postën ndërkombëtare që i është kthyer atyre.

4. Pavarësisht dispozitave sipas pikës 3, kur një operator i caktuar, merr për kthimin te dërguesi, artikujt e postuar jashtë shtetit nga klientë që banojnë në territorin e tyre, ai do të jetë i autorizuar të marrë nga dërguesi ose dërguesit një tarifë përpunimi për artikullin që nuk duhet të tejkalojë tarifën e postimit që duhet të ishte mbledhur nëse artikulli do të ishte postuar nga operatori i caktuar në fjalë.

4.1 Për qëllimet e dispozitave sipas pikës 4, dërguesi ose dërguesit do të kuptohen si të ishin personat ose titullarët emri i të cilëve shfaqet në adresën ose adresat e kthimit.

5. Dispozita të përgjithshme

5.1 Subjekt i dispozitave ligjore të shtetit të destinacionit, artikujt e pa dorëzuar do të kthehen te operatori i caktuar i origjinës shënimi i pagesës së të cilëve shfaqet në artikull.

5.2 Artikujt e refuzuar nga marrësi ose dorëzimi i të cilave është në mënyrë të dukshme i pamundur do të kthehen menjëherë.

5.3 Artikujt të tjerë të pa dorëzuar do të mbahen nga operatori i caktuar i destinacionit për një periudhë të përcaktuar nga rregullat e tij. Megjithatë, periudha e mbajtjes mund të mos kalojë një muaj me përjashtim të rasteve të veçanta kur nga operatori i caktuar i destinacionit konsiderohet e nevojshme që të shtyhet në një maksimum prej dy muajsh. Kthimi në shtetin e origjinës do të realizohet brenda një periudhe të



shkurtër kohore nëse dërguesi ka kërkuar këtë me anë të një shënimi në anën e adresës në një gjuhë të njohur në shtetin e destinacionit.

6. Procedura të veçanta

6.1 Artikujt e pa dorëzuar të shërbimit të brendshëm do të ri-adresohen jashtë për kthim te dërguesi vetëm nëse ato plotësojnë kushtet për transport të mëtejshëm. E njëjta procedurë do të zbatohet për korrespondencën ndërkombëtare kur dërguesi ka lëvizur në një shtet tjetër.

6.2 Kartolinat që nuk kanë adresë të dërguesit nuk do të kthehen. Megjithatë kartolinat e regjistruara do të kthehen gjithmonë.

6.3 Kthimi në origjinë për letrat e printuara të pa dorëzuara nuk do të jetë i detyrueshëm, me përjashtim të rastit kur dërguesi ka kërkuar për kthimin e tyre me anë të një shënimi në artikull në një gjuhë të njohur në shtetin e destinacionit. Megjithatë, operatorët e caktuar përpiqen të realizojnë këtë kthim te dërguesi, ose të informojnë atë në mënyrën e duhur, kur janë përfshirë tentativa për dorëzimin ose artikujt në sasi të mëdha. Letrat rekomande të printuara dhe librat gjithashtu do të kthehen.

6.4 Sa në vijim do të trajtohen si artikujt të pa dorëzuar, artikujt për perosna të tretë:

6.4.1 të adresuara për shërbimet diplomatike ose konsullore dhe të kthyera nga ata në zyrën postare si të pa kërkuara;

6.4.2 të adresuara në hotele ose agjenci ajrore ose shoqëri lundrimi dhe të kthyera në zyrën postare sepse ato nuk mund të dorëzohen te marrësi.

6.5 Në asnjë rast artikujt e përmendur në pikën 6.4 nuk do të konsiderohen si artikujt të rinj subjekt i pagesave postare.

7. Dërgimi

7.1 Kur shteti që kthen artikullin nuk përdor më transportin tokësor, ai do të kthejë artikujt e pa dorëzuar me anë të mënyrave më të përshtatshme të përdorura.

7.2 Artikujt me prioritet, letrat me postë ajrore dhe kartolinat postare ajrore që duhet të kthehen në origjinë do të kthehen me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

7.3 Artikujt e postës ajrore të pa dorëzuara, të ndryshëm nga letrat e postës ajrore dhe kartolinat e postës ajrore, do të kthehen në origjinë me anë të transportit normal të përdorur për artikujt jo me prioritet ose artikujt tokësorë (duke përfshirë S.A.L.), me përjashtim:

7.3.1 të rastit të ndërprerjes të këtyre mënyrave të transportit, ose

7.3.2 nëse operatori i caktuar i destinacionit ka zgjedhur sistematikisht rrugën ajrore për kthimin këtyre artikujve.

7.4 Për kthimin e këtyre artikujve në origjinë me prioritet ose me rrugë ajrore me kërkesë të dërguesit, do të aplikohen në mënyrë analoge neni RL 146.6.2 dhe 3.

8. Trajtimi i artikujve

8.1 Para kthimit tek operatori i caktuar i origjinës të artikujve, të cilët për çfarëdo arsye nuk janë dorëzuar, zyra e destinacionit do të tregojë, në Frëngjisht, arsyen për mos dorëzimin. Arsyja do të paraqitet, në mënyrë të qartë dhe të saktë, nëse është e mundur në pjesën e përparme të artikullit, në formën e mëposhtme: "inconnu" (e panjohur), "refusé" (e refuzuar), "déménagé" (e lëvizur), "non réclamé" (e pa kërkuar), "adresse insuffisante" (adresë jo e plotë), etj. Për sa i përket kartolinave dhe letrave të printuara në formën e kartelave, arsyja për mos dorëzimin do të paraqitet në gjysmën e djathtë të pjesës së përparme.

8.2 Ky informacion do të paraqitet me anë të aplikimit të vulës ose vendosjes së një etikete CN 15, që do të plotësohet në mënyrën e duhur. Çdo operator i caktuar mund të shtojë përkthimin, në gjuhën e tij, të arsyes për mos dorëzimin dhe veçanti të tjera të përshtatshme. Në shërbimin me operatorët e caktuar që kanë rënë dakord në këtë mënyrë të dhënat mund të bëhen në një gjuhë të vetme që është rënë dakord. Shënimet e dorëshkrimeve që kanë të bëjnë me mos dorëzimet e realizuara nga punojnës të postës mund të mendohen gjithashtu si të mjaftueshme në këtë rast.

RETURN		CN 15
☐ Unknown	☐ Refused	
☐ Moved	☐ Unclaimed	
☐ Incomplete address		
☐		
Return date:		

Maximum size 52 x 52 mm, colour pink

8.3 Zyra e destinacionit do të nxjerrë veçoritë e adresës me të cilat ka të bëjë ndërkohë që i lë ato të lexueshme dhe shkruan "Retour" (Kthyer) në pjesën e përparme të artikullit pranë emrit të zyrës së origjinës. Gjithashtu do të aplikojë vulën e saj datore në pjesën e pasme të artikujve me prioritet në zarfe dhe letra dhe në pjesën e përparme të kartolinave.

8.4 Artikujt e pa dorëzuar do të kthehen në zyrën e shkëmbimit të shtetit të origjinës, në mënyrë individuale ose në një pako me etiketë të veçantë "Envois non distribuables" (dërgesa të pa dorëzuara), si të ishin artikuj të adresuar për atë shtet. Artikujt e zakonshëm të pa dorëzuar që kanë detajet e duhura të kthimit do të kthehen direkt te dërguesi.

8.5 Artikujt e siguruar që nuk janë dorëzuar do të kthehen pas sa më shpejt të jetë e mundur, dhe së fundi të paktën për një periudhë të caktuar prej pikës 5.3. Këto artikuj do të vendosen në listën e shpërndarjes CN 16 dhe do të përfshihen në paketim, zarfe ose thasë të etiketuar "Valeurs déclarées" (vlerë e deklaruar).

8.6 Artikujt e pa dorëzuar të kthyer në shtetin e origjinës do të trajtohen në përputhje me nenin RL 146.7

Neni RL 148

Trajtimi i kërkesave për tërheqje të artikujve nga posta ose për ndryshime ose korrigjime të adresës

1. Dërguesi i artikullit të postës së letrave mund ta tërheqë atë nga posta, ose të ndryshojë ose korrigjojë adresën e tij sipas kushteve të përcaktuara në vijim.

2. Nëse legjislacioni i tij e lejon, çdo operator i caktuar do të jetë i detyruar të pranojë kërkesën për tërheqje nga posta e letrave ose ndryshime ose korrigjime të adresës në lidhje me çdo artikull të postës së letrave të postuar në shërbimin e një operatori tjetër të caktuar.

3. Përgatitja e kërkesës

3.1 Çdo kërkesë për tërheqje të artikujve nga posta ose ndryshime ose korrigjime të adresës do të përfshijë plotësimin nga dërguesi të një formulari CN 17. Një formular mund të përdoret për disa artikuj të postuar në të njëjtin moment në të njëjtën zyrë nga i njëjti dërgues për të njëjtin marrës.

3.2 Në përpunimin e kërkesës në zyrën postare dërguesi do të provojë identitetin e tij dhe të do të paraqes vërtetimin e postimit nëse ka një të tillë. Operatori i caktuar i shtetit të origjinës do të marrë përgjegjësinë për provimin e identitetit.

3.3 Një kërkesë për korrigjim të thjeshtë të adresës (pa ndryshime të emrit ose statusit të marrësit) mund të bëhet drejtpërdrejtë në zyrën e destinacionit nga dërguesi. Tarifa e përshkruar në pikën 4 nuk do të merret në një rast të tillë.

3.4 Me anë të njoftimit të Byrosë Ndërkombëtare, çdo operator i caktuar mund të bjerë dakord që kërkesat CN 17 që kanë të bëjnë me to, të shkëmbehen me anë të administratës qendrore ose me anë të një zyre të veçantë të caktuar. Ky njoftim do të përmbajë emrin e kësaj zyre.

3.5 Operatorët e caktuar të cilët ushtrojnë mundësinë e paraqitur sipas pikës 3.4 do të marrin çdo tarifë që mund të rezultojë në shërbimin e tyre të brendshëm nga transporti me anë të postës ose telekomunikacionit të komunikimeve që do të shkëmbehen me zyrën e destinacionit. Kërkesa me anë të telekomunikacionit ose shërbime të tjera të ngjashme do të jenë të detyrueshme kur dërguesi ka përdorur këto mjete dhe zyra e destinacionit nuk mund të njoftohet në kohë nga posta.

3.6 Nëse artikulli është ende në shtetin e origjinës, kërkesa do të realizohet në përputhje me legjislacionin atij shteti.



4. Tarifat

4.1 Dërguesi do të paguajë, për çdo kërkesë, një tarifë të veçantë shumës e udhëzimit për të cilën do të jetë 1.31 SDR.

4.2 Kërkesa do të dërgohet me postë ose telekomunikacion me shpenzimet e dërguesit. Kushtet e dërgimit dhe dispozitat që lidhen me përdorimin e telekomunikacionit janë paraqitur në pikën 6 vijuese.

4.3 Tarifat e përshkruara sipas pikës 4.1 dhe 4.2 do të merren vetëm një herë për çdo kërkesë për tërheqje nga posta ose ndryshime ose korrigjime të adresës që përfshijnë disa artikuj të postuar në të njëjtën kohë, në të njëjtën zyrë, nga i njëjti dërgues dhe për të njëjtin marrës.

5. Transmetimi i kërkesës me postë

5.1 Nëse kërkesa do të dërgohet me postë, formulari CN 17, i shoqëruar nëse është e mundur nga një faksimile perfekt i zarfit ose i adresës së artikullit, do të dërgohet direkt në zyrën e destinacionit me sigurim të regjistruar me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

5.2 Nëse kërkesat janë shkëmbyer me anë të administratës qendrore, një kopje e kërkesës, në rast urgjence, mund të dërgohet direkt nga zyra e origjinës te zyra e destinacionit. Kërkesat e dërguara direkt do të realizohen menjëherë. Artikujt nuk do të dorëzohen deri në mbërritjen e kërkesës nga adminstrata qendrore.

5.3 Me marrjen e formularit CN 17, zyra e destinacionit do të kërkojë artikullin në fjalë dhe të ndërmarrë hapat e nevojshme.

5.4 Hapat e ndërmarra nga zyra e destinacionit për çdo kërkesë për tërheqje nga posta ose ndryshim ose korrigjim të adresës do të komunikohet menjëherë në zyrën e origjinës me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore), duke përdorur një kopje të formularit CN 17 me pjesën e "Përgjigjes së zyrës së destinacionit" të plotësuar në mënyrën e duhur. Zyra e origjinës do të informojë aplikantin. E njëjta gjë do të aplikohet në rrethanat e mëposhtme:

5.4.1 kërtime të pa frytshme;

5.4.2 artikuj të dërguar te marrësi;

5.4.3 artikuj të konfiskuar, të shkatërruar ose sekuestruar.

5.5 Një artikull jo me prioritet ose i transportit tokësor do të kthehet në origjinë me prioritet ose me rrugë tokësore në vijim të një kërkesë për tërheqje nga posta kur dërguesi merr përsipër të paguajë diferencën përkatëse. Kur një artikull është ridërguar me prioritet ose me rrugë ajrore në vijim të kërkesës për ndryshim ose korrigjim të adresës, diferenca e postimit që korrespondon me linjën e re do të mbledhet nga marrësi dhe mbahet nga operatori i caktuar.

6. Transmetimi i kërkesës me telekomunikacion

6.1 Nëse kërkesa do të bëhet me telekomunikacion, formulari CN 17 do të dorëzohet shërbimeve përkatëse për transmetimin e detajeve tek zyra postare e destinacionit. Dërguesi do të paguajë tarifën përkatëse për këtë shërbim.

6.2 Për të vërtetuar mesazhin e marrë me anë të telekomunikimit, zyra e destinacionit do të kërkojë artikullin në fjalë dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm.

6.3 Çdo kërkesë për ndryshim ose korrigjim të adresës që lidhet me artikullin e siguar e kryer me anë të telekomunikacionit do të konfirmohet nga posta, me postën e parë, siç përshkruar në pikën 5.1. Formulari CN 17 më pas do të mbartë në krye, me shkronja të zeza, shënimin "Confirmation de la demande transmise par voie des télécommunications du ..." (Konfirmim i kërkesës të kryer me anë të telekomunikacionit më datë ...); në pritje të këtij konfirmimi, zyra e destinacionit vetëm do të mbajë artikullin. Megjithatë, operatori i caktuar i destinacionit, me përgjegjësinë e tij, mund të veprojë me kërkesë të bërë me anë të telekomunikacionit pa prituri për konfirmim nga posta.

6.4 Në marrëdhëniet midis dy shteteve që pranojnë këtë procedurë, dërguesi mund të kërkojë të informohet me anë të telekomunikacionit për veprimin e kryer nga zyra e destinacionit me kërkesë të tij. Ai do të paguajë tarifën përkatëse. Nëse përdoren telegramet, ai do të paguajë tarifën për telegram të llogaritur në bazë e pesëmbëdhjetë fjalëve. Kur përdoret teleksi tarifa për dërguesin do të jetë shuma e njëjtë me tarifën që përdoret për dërgimin e kërkesës me teleks.

6.5 Nëse dërguesi i një kërkesë të dërguar me telekomunikacion ka kërkuar të njoftohet me një mënyrë të ngjashme, përgjigja do të kthehet me anë të mjeteve të zyrës së origjinës. Ajo do të informojë aplikuesin sa më shpejtë të jetë e mundur. E njëjta procedurë do të aplikohet nëse një kërkesë me telekomunikacion nuk është e mjaftueshëm e qartë për të identifikuar artikullin me siguri .

Neni RL 149

Tërheqja nga posta. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës. Artikujt e postuar në një shtet të ndryshëm nga ai që merr kërkesën

1. Çdo zyrë që merr një kërkesë për tërheqje të artikujve nga posta ose ndryshim ose korrigjim të adresës të bërë në përputhje me nenin RL 148.2 do të verifikojë identitetin e dërguesit të artikullit. Do të sigurojë, në veçanti se adresa e dërguesit paraqitet në mënyrë të qartë në vendin e parashikuar për këtë qëllim në formularin CN 17. Më pas do të dërgojë formularin CN 17 në zyrën e origjinës ose në destinacionin e artikullit.

2. Nëse kërkesa ka të bëjë me një artikull rekomande ose të siguruar, dërguesi duhet të paraqesë faturën origjinale dhe formulari CN 17 do të përfshijë: "Vu l'original du récépissé" (Kontrolluar fatura origjinale). Para se fatura ti kthehet dërguesi, do të vendoset në të shënimi: "Demande de retrait (de modification ou de correction d'adresse) déposée le ... au bureau de ..." (Kërkesë për tërheqje nga posta (ndryshim ose korrigjim i adresës) e depozituar në ... në zyrën e ...). Ky shënim do të shoqërohet me anë të një shënimi të vulës datare të zyrës që merr kërkesën. Formulari CN 17 më pas do të dërgohet në zyrën e destinacionit nga zyra e origjinës së artikullit.

3. Çdo kërkesë e bërë me anë të telekomunikacionit sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1 do të dërgohen direkt në zyrën e destinacionit të artikullit. Megjithatë, nëse ajo i referohet një artikulli rekomande ose të siguruar, do të dërgohet në zyrën e origjinës së artikullit edhe një formular CN 17 që ka shënimin "Vu l'original du récépissé de dépôt" (Kontrolluar vërtetimi origjinal i postimit) dhe "Demande transmise par voie des télécommunications déposée le ... au bureau de ..." (kërkesë e bërë me anë të telekomunikacionit në... në zyrën e ...). Pasi janë verifikuar detajet, zyra e origjinës do të shkruajë në qendër të formularit CN 17 me shkronja shumë të zeza, shënimin "Confirmation de la demande transmise par voie des télécommunications du ..." (konfirmim i kërkesës të bërë me anë të telekomunikacionit në datë ...) dhe do ta dërgojë atë në zyrën e destinacionit. Zyra e destinacionit do të mbajë artikullin rekomande ose të siguruar deri në marrjen e konfirmimit.

4. Në mënyrë që të informohet dërguesi, zyra e destinacionit të artikullit do të informojë zyrën që merr kërkesën se si është vepruar me të. Megjithatë, kur një artikull rekomande ose i siguruar ka lidhje me të, ky informacion do të kalojë nga zyra e origjinës së artikullit. Në rastin e tërheqjes, artikulli i tërhequr do të bashkëlidhet këtij informacioni.

5. Neni RL 148 do të aplikohet, me analogji, për zyrën që merr kërkesën dhe operatorin e caktuar.

Neni RL 150

Reklamime

1. Parimet

1.1 Brenda periudhës kohore të përshkruar në nenin 17 të Konventës, reklamimet do të pranohen sa më shpejt, sapo problemi të raportohet nga dërguesi ose i adresuari. Megjithatë, kur reklamimi i një dërguesi ka lidhje me artikuj të pa dorëzuar dhe koha e parashikuar për transportin nuk ka kaluar, dërguesi do të informohet për kohën e transportit.

2. Përgatitja e kërkesës

2.1 Çdo reklamim do të përfshijë përgatitjen e një formulari CN 08. Me marrëveshje midis operatorëve të caktuar të interesuar, reklamimi mund të jetë në formën e një dosje kompjuterike ose mesazh (elektronik CN 08) të transmetuar në mënyrë elektronike, për shembull duke përdorur internetin. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, ajo do të jetë në formën e një dokumenti CN 08.

2.2 Formulari CN 08 do të plotësohet, nëse është e mundur, me faksimile të adresës së artikullit. Formulari i reklamimit do të plotësohet me të gjitha detajet e duhura, duke përfshirë informacionin e detyrueshëm për tarifat e paguara nëse reklamimi ka të bëjë me një artikull rekomande ose një artikull të siguruar, dhe shumë të qarta, preferohet me shkronja romake dhe shifra arabe, ose më mirë, me karaktere të printuara.

2.3 Nëse reklamimi ka të bëjë me një artikull të paguar nga marrësi, ajo gjithashtu do të dërgohet me një dublikatë të formularit të urdhër-pagesës TFP 3 të Rregullores të Marrëveshjes së Shërbimit të pagesave Postare.

2.4 Një formular mund të përdoret për disa artikuj të postuar në të njëjtën kohë, në të njëjtën zyrë, nga i njëjti dërgues, dhe të dërguara me të njëjtën rrugë, tek i njëjti marrës.



2.5 Të gjithë operatorët e caktuar duhet të dërgojnë Byrosë Ndërkombëtare njoftimin e adresës postare dhe, nëse është e mundur, adresën elektronike për të cilat duhet të dërgohen reklamimet CN 08 dhe dublikatat e reklamimit CN 08.

2.6 Operatori i parë i caktuar që merr formularin CN 08 dhe dokumentet shoqëruese nga një klient do të plotësojë investigimin e tij në mënyrë të pa ndryshueshme brenda dhjetë ditëve dhe të dërgojë formularin CN 08 dhe dokumentet përkatëse në operatorin e caktuar përkatës. Formulari dhe dokumentet do të kthehen te operatorët e caktuar të cilët filluan reklamimin, sa më shpejt të jetë e mundur dhe të paktën brenda dy muajve nga data e fillimit të hetimit ose brenda 30 ditëve nga data e fillimit të hetimit nëse rasti është raportuar me faks ose çdo mënyrë tjetër elektronike. Reklamimet për artikujt e siguar, rekomande dhe me dorëzim të regjistruar do të shoqërohet nga deklarata e marrësit e realizuar me anë të formularit CN 18 dhe që vërteton mos marrjen e artikullit të reklamuar, me përjashtim të rastit kur dërguesi e kërkon këtë gjë. Pasi ka kaluar periudha përkatëse, do të dërgohet një përgjigje me faks, e-mail ose çdo mjet tjetër telekomunikimi te operatori i caktuar i origjinës, me shpenzime të operatorit të caktuar të destinacionit. Kur ka një marrëveshje për përdorimin e një sistemi elektronik, afatet e përgjigjes do të jenë ato të vendosura në marrëveshjen midis operatorëve të caktuar, por që nuk do të jenë më të gjata se ato të përcaktuara në këtë paragraf.

2.7 Përgjigjet për reklamimet e dërguara me faks ose e-mail ose me anë të mënyrave të tjera elektronike, nëse është e mundur, do të dërgohen me anë të të njëjtave mënyra.

2.8 Me kërkesë, do të lëshohet një faturë ose një numër referimi pa pagesë për klientin që reklamon në çdo rast kur kjo është një kërkesë nga klienti ose operator i caktuar që mund të jetë në gjendje të gjurmojë progresin e reklamimit ose kur operatori i caktuar ndjek reklamimin duke përdorur procesin CN 08. Në Rregullore është dhënë një shembull për qëllime udhëzimi.

2.9 Nëse dërguesi pretendon se, pavarësisht vërtetimit të dorëzimit të operatorit të caktuar të destinacionit, marrësi deklaron që nuk ka marrë artikullin e reklamimit, do të ndiqet procedura e mëposhtme. Me kërkesë të shprehur të operatorit të caktuar të origjinës, operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i detyruar ti sigurojë dërguesit sa më shpejt të jetë e mundur dhe, maksimumi në një periudhë prej 30 ditësh nga data e dërgimit e të kësaj kërkesë, me anë të operatorit të caktuar të origjinës, konfirmimin e dorëzimit me letër, të njoftimit të dorëzimit CN 07 ose disa mënyrave të tjera, të nënshkruara në përputhje me nenin RL 137.3.1 ose RL 138.3.2, sipas rastit ose një kopje të një pranimi të nënshkrimit të pranimit ose ndonjë mënyrë tjetër të evidentimit të marrjes nga marrësi në përputhje me nenin RL 132.5.9 ose RL 134.6.8.

3. Hetime rreth artikujve me dorëzim të regjistruar

3.1 Zyra që merr reklamimin do t'ia dërgojë atë automatikisht zyrës përkatëse. Kjo e fundit pasi ka marrë informacionin e nevojshëm nga marrësi ose dërguesi, sipas rastit, automatikisht do të kthejë formularin CN 08 në zyrën që e ka përgatitur atë. Me marrëveshje midis operatorëve të caktuar të përfshirë, reklamimi dhe përgjigja mund të jetë në formën e një dosje kompjuterike ose mesazhi të transmetuar elektronikisht, për shembull duke përdorur Internet Eorl Eide Eeb. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, nëse është e mundur, reklamimi do të dërgohet me faks ose e-mail, pa kosto shtesë për klientin; në rast të kundërt reklamimi do të dërgohet me postë. Në rastin më të fundit, formulari do të dërgohet në një zarf dhe pa një letër mbështjellëse me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

3.2 Nëse hetimi vërtetohet që është i justifikuar, zyra që përgatit atë do të dërgojë formularin CN 08 për administratën e saj qendrore për investigim të mëtejshme.

4. Hetimi për artikujt rekomande dhe artikujt e siguar

4.1 Kur një hetim ka lidhje me artikujt e shkëmbyer sipas sistemeve të njoftimit të sasive të mëdha, numri dhe data e shpërndarjes së postës mund të regjistrohen në reklamimin CN 08. Me anë të marrëveshjes midis operatorëve të caktuar të përfshirë, reklamimi dhe përgjigja mund të jetë në formën e një dosje kompjuterike ose mesazhi që transmetohet në mënyrë elektronike, për shembull, duke përdorur Internetin. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, reklamimi, nëse është e mundur, do të dërgohet me postë. Në rastin e fundit, formulari do të dërgohet automatikisht, pa ambalazh mbështjellës dhe gjithmonë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

4.2 Nëse operatori i caktuar i origjinës ose operatori i caktuar i destinacionit, e kërkon, reklamimi do të dërgohet direkt nga zyra e origjinës te zyra e destinacionit.

4.3 Nëse, për kërkesën e reklamimit, administrata qendrore e shtetit të destinacionit ose zyra e veçantë e caktuar është në gjendje të përcaktojë përfundimisht se çfarë i ka ndodhur artikullit, ajo do të plotësojë pjesën e formularit CN 08 "Veçanti për tu plotësuar nga shërbimi i destinacionit". Në rastet e

dërgesave të vonuara, të mbajtura ose të kthyer në origjinë arsyjeja do të vendoset në mënyrë të shkurtuar në formularin CN 08.

4.4 Një operator i caktuar që nuk është në gjendje të realizojë as dorëzimin të marrësit as transmetimin e saktë të një operator tjetër i caktuar do të urdhërojë menjëherë reklamimin e nevojshëm. Ai do të regjistrojë në pjesën e formularit CN 08 "Raporti përfundimtar" vendimin e tij për përgjegjësinë. Kur është përdorur një version elektronik i CN 08 me marrëveshje midis operatorëve të caktuar pranimi i përgjegjësisë, do të regjistrojë në kutinë e kodit të autorizimit elektronik në CN 08, numrin e referencës duke autorizuar pranimin e përgjegjësisë. Pranimi i plotë i përgjegjësisë do të vendoset në kutinë e Shënimeve (p.sh. shuma e plotë, gjysma e shumës së paguar (njoftimi i sasive të mëdha) ose në përputhje me marrëveshjen midis dy shteteve, ju duhet të kompensoni reklamuesin).

4.5 Formulari CN 08, i plotësuar në mënyrën e duhur si është përshkruar sipas pikave 4.3 dhe 4.4, do të kthehet në adresën e zyrës që e përgatiti duke përdorur, kur është e mundur, të njëjtat mënyra që janë përdorur për transmetimin e reklamimit, elektronikisht, me anë të faksit ose e-mail, ose me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

4.6 Operatori i caktuar i origjinës do të dërgojë reklamimet për artikujt e dërguar në tranzit à découvert në të njëjtën kohë për të dy operatorët e caktuar ndërmjetës dhe të destinacionit. Reklamimet për artikujt që përfshihen në posta të mbyllura që janë tranzituar me anë të një ose disa operatorësh të caktuar ndërmjetës do të menaxhohen direkt midis shtetit të origjinës dhe shtetit të destinacionit përfundimtar. Megjithatë, operatori i caktuar i origjinës, për të shpejtuar procesin e investigimit, mund të kërkojë çdo operatori të caktuar ndërmjetës të sigurojë informacionin e duhur të shpërndarjes.

4.6.1 Reklamimet e dërguara tek operatorët e caktuar ndërmjetës që shënohen në Letrën Përmbledhëse të Postës do të shoqërohen nga një CN 37, CN 38 ose CN 41, sipas rastit. Kopjet mund të jenë si elektronike ashtu edhe fizike në përputhje me parimet e caktuara në RL 150.2.5.

4.6.2 Çdo operator i caktuar i konsultuar do të dërgojë formularin CN 08 te operatori tjetër i caktuar, dhe formularin përkatës CN 21 te operatori i caktuar i origjinës, sa më shpejtë të jetë e mundur, por brenda një periudhe që nuk kalon 10 ditë.

4.7 (i fshirë.)

5. Reklamime për mos kthimin tek dërguesi i një njoftim të dorëzimit

5.1 Në rastet e parashikuara në nenin RL 137.3.3 dhe nëse ndonjë artikull është dorëzuar, operatori i caktuar i shtetit të destinacionit do të marrë në njoftimin e dorëzimit CN 07 që ka fjalën "Dublikatë" firmën e personit që ka marrë artikullin. Subjekt i dispozitave legjislative të shtetit shpërndarës të njoftimit të dorëzimit, në vend të marrjes së firmës në dublikatën e njoftimit të dorëzimit, ai gjithashtu do të jetë i autorizuar të bashkëlidhë formularin CN 07 një kopje të dokumentit të përdorur në shërbimin e brendshëm me firmën e personit që ka marrë artikullin ose kopje të firmës elektronike të vendosur në dorëzimin e artikullit. Formulari CN 07 do të mbetet i bashkëlidhur formularit të reklamimit CN 08 për dorëzime të mëvonshme tek reklamuesi.

6. Kërkesë për tu dërguar me telegram, ose telex ose EMS

6.1 Nëse është bërë kërkesë për transmetimin e një reklamimi me telegraf, do të dërgohet një telegram, në vend të formularit CN 08 si në administratën qendrore të shtetit të destinacionit ose në zyrën e veçantë të caktuar që lidhet me të. Tarifa e telegrafit do të merret nga reklamuesi.

6.2 Nëse është bërë një kërkesë për transmetimin me EMS, mund të merren nga reklamuesi tarifat e marra normalisht për këtë shërbim.

6.3 Në marrëdhëniet midis dy shteteve që pranojnë këtë procedurë, dërguesi mund të kërkojë të njoftohet me telegram të veprimit të ndërmarrë në këtë reklamim. Në këtë rast, ai do të paguajë tarifën për një telegram, të llogaritur në bazë prej pesëmbëdhjetë fjalësh. Kur përdoret teleksi, tarifa e marrë normalisht nga dërguesi, do të jetë e njëjta shumë me atë të dërgimit të reklamimit me teleks. Kostoja e përgjigjes së dërguar me anë të mënyrave të tjera të telekomunikacionit ose me EMS do të merret parasysht në bazat e reciprocitetit.

6.4 Nëse reklamimi me telegram ose teletex nuk përcakton çfarë i ka ndodhur një artikulli rekomandë ose të siguruar, reklamimi do të bëhet përsëri me postë përpara se të konsiderohet dëmshpërblimi. Një formular CN 08 megjithatë do të përgatitet për trajtimin në përputhje me pikat 4.1 deri 4.7.

6bis. Nuk do të bëhet asnjë rezervim në lidhje me periudhën e trajtimit dhe zgjidhjes së reklamimeve të caktuar në këtë nen, përveç asaj brenda kuadrit të një marrëveshje të dyanshme.



Neni RL 151

Reklamime që lidhen me artikujt e postuar në një shtet tjetër

1. Nëse reklamimi ka të bëjë me një artikull të postuar në një shtet tjetër, formulari CN 08 do të dërgohet në administratën qendrore ose zyrën e veçantë të caktuar, të operatorit të caktuar të origjinës së artikullit. Vërtetimi i postimit do të paraqitet por nuk do të bashkëlidhet me formularin CN 08. Tek ky i fundit do të shkruhet “Vu réceptionné de dépôt No... délivré le... par le bureau de...” (Kontrolluar, vërtetimi i postimit Nr. ... lëshuar më ... nga zyra e ...).

2. Formulari duhet të mbërrijë tek operatori i caktuar të origjinës brenda periudhës së parashikuar për mbajtjen e dokumenteve.

KAPITULLI 7

ÇËSHTJE DOGANORE

Neni RL 152

Artikuj subjekt i kontrollit doganor

1. Artikujt që do ti nënshtrohen kontrollit doganor do të mbartin në pjesën e përparme deklaratën doganore CN 22, ose të pajiset me një etiketë të lidhur në të njëjtën formë. Deklarata doganore CN 22 do të vendoset në krahun e adresës, nëse është e mundur në cepin e sipërm majtas, poshtë emrit dhe adresës së dërguesit, të cilat duhet të shfaqen në artikull.

1bis. Kur operatorët e caktuar bien dakord paraprakisht, të dhënat e doganave të paraqitura në përputhje me instruksionet e deklaratave doganore CN 22 ose CN 23, duke përfshirë emrat dhe adresat e dërguesit dhe marrësit, mund të transmetohen në mënyrë elektronike te operatorët e caktuar të shtetit të destinacionit. Operatori i caktuar i origjinës mund të ndajë të gjitha ose një pjesë të këtyre të dhënave me administratën doganore në shtetin e origjinës për qëllime eksporti, dhe operatori i caktuar i destinacionit mund të ndajë të gjitha ose një pjesë të këtyre të dhënave me administratën doganore për qëllime importi.

1ter. Përdorimi i të dhënave nga letra e deklaratës doganore CN 22 ose CN 23 të paraqitur sipas paragrafit 1bis të mësipërm, do të kufizohet për proceset që lidhen me shkëmbimin e postës dhe formaliteteve të doganave në lidhje me eksportin ose importin e artikujve postarë dhe nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër.

2. Me autorizimin e operatorit të caktuar të origjinës, përdoruesit mund të përdorin zarfe ose ambalazhe që kanë, në vendin e caktuar për vendosjen e deklaratës doganore CN 22, një faksimile të printuar paraprakisht të asaj deklarate. Për më shumë, përdoruesit mund të bëjnë deklaratën doganore CN 22 me autorizimin e operatorit të caktuar të origjinës. Përmasat, formati dhe elementet e të dhënave duhet të jenë të njëjtat me ato të deklaratës doganore CN 22.

3. Nëse vlera e përmbajtjes e deklaruar nga dërguesi kalon 300 SDR, ose nëse dërguesi preferon, artikujt gjithashtu do të shoqërohen nga numrat e përshkruar të deklaratës doganore CN 23. Një nga këto deklarata duhet të vendoset në artikull. Nëse deklarata nuk duket në mënyrë të drejtpërdrejtë në pjesën e përparme të artikullit, do të jetë e mundur të zëvendësohet pjesa e ndashme e deklaratës doganore CN 22 me një etiketë të bardhë ose të gjelbër të ngjitur ose auto adezive të përshkruar si më poshtë:

Mbishkrimi me të zeza

CN 23 enclosed
May be opened
officially

(përmasa 50 x 25 mm, ngjyra e badhe ose jeshile)

4. Deklarata doganore CN 23 do të bashkëlidhet në mënyrë të sigurt në pjesën e jashtme të artikullit, preferohet në një zarf adeziv transparent. Përfshirja, nëse dërguesi preferon, kjo deklaratë mund të vendoset në një zarf të mbyllur brenda artikujve rekomandë, nëse ato përmbajnë artikullin me vlerë sipas nenit 15.6.1 të Konventës, ose brenda artikujve të siguar.

5. Paket e vogla gjithashtu do të pajisen me një deklaratë doganore, e cila do të jetë ose formulari CN 22 ose formulari CN 23 sipas parashikimeve të pikave 1 deri 4.

6. Për thasët M, deklarata doganore CN 22 do të ngjitet në etiketën e adresës nëse e kërkon shteti i destinacionit. Nëse vlera e përmbajtjes e deklaruar nga dërguesi kalon 300 SDR, ose nëse dërguesi preferon, pjesa e ndashme e deklaratës doganore CN 22 ose e etiketës auto adezive të sipërpërmendur do të vendoset në etiketën e adresës dhe deklarata doganore CN 23 do të vendoset në të njëjtën etiketë. Nëse operatori i caktuar i shtetit të destinacionit e kërkon, ato do të bashkëlidhen me një nga artikujt e përfshirë në thes.

7. Mungesa e deklaratës doganore CN 22 ose CN 23, në asnjë rrethanë, nuk do të sjellë kthimin në zyrën e origjinës të ngarkesës së letrave të printuara, serumeve, vaksinave, substancave biologjike që prishen, materialeve radioaktive dhe ilaçeve të kërkuara me urgjencë të cilat është e vështirë të sigurohen.

8. Përmbajtja e artikullit do të paraqitet në detaje në deklaratën doganore CN 22 dhe CN 23. Nuk do të pranohen përshkrimet me karakter të përgjithshëm.

9. Operatorët e caktuar nuk do të pranojnë përgjegjësi për deklaratat doganore. Plotësimi i deklaratës doganore do të jetë përgjegjësi vetëm e dërguesit. Megjithatë operatorët e caktuar do të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme për të informuar klientët e tyre se si të përmbushin formalitetet e doganave, dhe në mënyrë të veçantë të sigurohen që deklaratat doganore CN 22 dhe CN 23 të plotësohen në mënyrë të plotë, me qëllim lehtësimin e doganimit për artikujt.

9bis. Të gjitha dispozitat e paragrafëve të tjerë të këtij artikulli do të zbatohen edhe për të dhënat nga dokumenti i deklaratës doganore CN 22 ose CN 23 të dhënë në paragrafin 1bis të mësipërm. Në rast të një mospërputhje midis të dhënave në deklaratën doganore CN 22 ose CN 23 dhe versionit elektronik të siguruar sipas paragrafit 1bis të mësipërm, deklarata doganore CN 22 ose CN 23 do të përbëjë deklaratën doganore.

Neni RL 153

Tarifa për paraqitjen në doganë

1. Shuma e udhëzuesit për tarifën e posaçme të përshkruar në nenin 18.2 të Konventës për artikujt që i nënshtrohen kontrollit doganor në shtetin e origjinës ose të destinacionit do të jetë 2.61 SDR. Për çdo thes M, shuma maksimale e udhëzuesit është 3.27 SDR.

Neni RL 154

Fshirja e detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera

1. Operatorët e caktuar do të angazhohen të kërkojnë nga shërbimet kompetente në shtetin e tyre fshirjen e detyrimeve doganore ose tarifave të tjera për artikujt:

1.1 e kthyer në origjinë;

1.2 të shkatërruar për shkak të dëmtimeve totale të përmbajtjes;

1.3 ri-adresuar në një shtet të tretë .

KAPITULLI 8

PËRGJEGJËSIA E OPERATORËVE TË CAKTUAR

Neni RL 155

Zbatimi i përgjegjësisë të operatorëve të caktuar

1. Përgjegjësitë e operatorëve të caktuar do të jenë të detyrueshëm për artikujt e dërguara à découvert njëjloj si për ato të dërguara në dërgesa të mbyllura.

2. Operatorët e caktuar që angazhohen të mbulojnë riskun që lind nga një shkak i forcës madhore do të jenë përgjegjës ndaj dërguesve të artikujve të postuar në shtetin e tyre për çdo rast të forcës madhore që ka ndodhur në çdo moment gjatë transmetimit të artikujve. Ky angazhim do të mbulojë gjithashtu çdo ri-adresim ose kthim në origjinë.



3. Operatori i caktuar në shërbimin e të cilit ka ndodhur humbja, vjedhja, ose dëmtimi ose kthimi pa arsye, do të vendosë, në përputhje me ligjet e shtetit të tij, nëse humbja, vjedhja, ose dëmtimi ose kthimi pa arsye është shkaktuar nga rrethana të forcave madhore. Këto rrethana do t'i bëhen të ditura operatorit të caktuar të shtetit të origjinës nëse ky operator i caktuar e kërkon këtë.

4. Shuma e dëmshpërblimit të referuar në nenin 21.21. të Konventës për humbjet, vjedhjen e plotë ose dëmtimin e plotë të një artikulli rekomande do të jetë 30 SDR. Dëmshpërblimi për humbjen, vjedhjen e plotë ose dëmtim të plotë të thesit M rekomande do të jetë 150 SDR. Pagesat dhe tarifat e paguara për artikujt e postuar, me përjashtim të tarifave të regjistrimit, do ti shtohen këtyre vlerave për të përcaktuar kompensimin e plotë të pagueshëm.

4bis. Shuma e dëmshpërblimit të referuar në nenin 21.2.2 të Konventës për artikuj rekomande që janë vjedhur ose dëmtuar pjesërisht nuk duhet të kalojë shumën përkatëse të përmendur në paragrafin 4 për artikujt rekomande që kanë humbur, janë vjedhur plotësisht, ose dëmtuar plotësisht.

5. Operatorët e caktuar që marrin pjesë në shkëmbimin e artikujve COD do të jenë përgjegjës, deri në shumën COD, për dërgimin e artikujve COD pa mbledhjen e fondeve ose kundrejt mbledhjes së çdo shume më të vogël se shuma COD. Operatorët e caktuar nuk do të mbajnë përgjegjësi për vonesa që mund të lindin gjatë mbledhjes dhe shpërndarjes së fondeve.

Neni RL 156

Dorëzimi i artikujve të siguruar të dëmtuar ose të shkatërruar

1. Zyra që bën dërgimin e një artikulli të siguruar të dëmtuar ose të shkatërruar do të përgatisë një raport CN 24 mbi inspektimin e përbashkët dhe do të marrë kundërfirmë nga marrësi, sa herë që është e mundur. Një kopje e raportit do të dorëzohet te marrësi ose, nëse artikulli është refuzuar ose ridërguar, do t'i bashkëlidhet atij. Një kopje do të mbahet nga operatori i caktuar që ka përgatitur raportin.

2. Nëse artikulli është dorëzuar, kopja e raportit CN 24 e përgatitur në përputhje me nenin RL 193.10.2 do të bashkëlidhet me artikullin dhe do të trajtohet në përputhje me rregulloret e shtetit të destinacionit. Nëse artikulli refuzohet, kjo kopje do të mbetet e bashkëlidhur me artikullin.

3. Kur kërkohet nga rregulloret e brendshme, një artikull, subjekt i trajtimit të përcaktuar në pikën 1 do të kthehet tek dërguesi nëse marrësi refuzon të kundërfirmosë raportin CN 24.

Neni RL 157

Përcaktimi i përgjegjësisë së dërguesit

1. Një operator i caktuar që zbulon një dëmtim për faj të dërguesit do të informojë operatorin e caktuar të origjinës, përgjegjësia e të cilit është të marrë masa kundrejt dërguesit kur është e përshtatshme.

1bis. Duke iu referuar dispozitave të paragrafit 1, operatorët e caktuar të origjinës dhe destinacionit mund të bien dakord të fillojnë procedurat kontabël që lidhen me shumën e dëmtimit që do të mbulohet nga dërguesi.

Neni RL 158

Pagesa e dëmshpërblimit

Operatorët e caktuar të origjinës ose destinacionit, sipas rastit, do të jenë të autorizuar të dëmshpërblejnë reklamuesin në të drejtë për llogari të operatorit të caktuar, i cili edhe pse ka marrë pjesë në transport dhe është informuar në mënyrë të duhur, ka lejuar të kalojnë dy muaj dhe, nëse rasti është raportuar me faks ose çdo mënyrë tjetër elektronike me anë të së cilës mund të konfirmohet marrja e reklamimit, 30 ditë pa zgjidhur përfundimisht çështjen, ose pa eraportuar:

1.1 se dëmtimi duket të jetë shkaktuar nga një forcë madhore;

1.2 se artikulli është mbajtur, konfiskuar ose shkatërruar nga autoritetet kompetente për arsye të përmbajtjes së tij ose sekuestruar sipas legjislacionit të shtetit të destinacionit.

1bis Periudha prej dy muajsh dhe tridhjetë ditësh e caktuar sipas pikës 1 fillon nga data kur formulari CN 08 është plotësuar në mënyrën e duhur nga operatori i caktuar i origjinës, duke përfshirë informacionet e nevojshme që lidhen me transportin e dërgesave.

1ter Operatori i caktuar i origjinës do të jetë i autorizuar të dëmshpërblejë reklamuesin për llogari të operatorit të caktuar të destinacionit që është informuar në mënyrën e duhur në lidhje me kërkesën e operatorit të caktuar të origjinës për të dhënë një konfirmim të dërgimi të artikullit sipas reklamimit, të përmendur në nenin RL 150.2.9, ka lejuar që të kalojnë 30 ditë, nga data e dërgimit të kësaj kërkesë nga operatori i caktuar i origjinës, pa kërkuar një hetim të dytë në lidhje me kryerjen e papërshtatshme të shërbimit.

2. Operatori i caktuar i origjinës ose destinacionit, sipas rastit, do të jetë i autorizuar të shtyjë pagesën e dëmshpërblimit për reklamuesin në rastet kur formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur ose është plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe duhet të kthehet për informacione shtesë ose ndryshime, në këtë mënyrë sjell që afati kohor i caktuar në pikën 1 të kalohet. Dëmshpërblimi do të mund të paguhet brenda një kufiri kohor prej dy muajsh nga data në të cilën formulari CN 08 është plotësuar ose ndryshuar. Nëse nuk është shtuar ndonjë informacion shtesë ose nuk është bërë ndonjë reklamim, operatori i caktuar i interesuar do të jetë i autorizuar që të mos dëmshpërblejë reklamuesin.

2bis Nuk do të ketë asnjë rezervim në lidhje me periudhën e trajtimit dhe zgjidhjes së reklamimeve dhe periudha dhe kushtet për pagesën e dëmshpërblimit dhe rimbursimet e operatorëve të caktuar pagues mund të bëhen për këto artikuj, me përjashtim të rastit kur është brenda kuadrit të një marrëveshjeje dypalëshe.

Neni RL 159

Periudha për pagesën e dëmshpërblimit

1. Pagesa e dëmshpërblimit do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe, maksimumi, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dita pas ditës së reklamimit.

1bis. Nuk mund të bëhet asnjë rezervim për këtë nen në lidhje me periudhën e pagesës së dëmshpërblimit, me përjashtim të rastit të kuadrit të një marrëveshjeje dypalëshe.

Neni RL 160

Pagesat automatike e dëmshpërblimeve

1. Kthimi i formularit CN 08 në të cilin seksionet "Të dhënat që duhet të paraqiten nga shërbimet ndërmjetëse", "Të dhënat që duhet të paraqiten nga shërbimi i destinacionit" dhe "Përgjigja përfundimtare" nuk janë plotësuar, nuk do të konsiderohet si një përgjigje përfundimtare sipas kuptimit të nenit RL 158.1.

2. (i fshirë)

Neni RL 161

Përcaktimi i përgjegjësisë midis operatorëve të caktuar

1. Derisa nuk është provuar e kundërta, përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar i cili, pasi ka marrë artikullin pa raportuar një mospërputhje me anë të një shënimi të verifikimit CN 43 në momentin e marrjes të dërgesës me të cilin është dërguar artikulli dhe, edhe pse i pajisur me të gjitha mjetet e reklamimit të përshkruara, nuk mund të provojë nëse është bërë dorëzimi të marrësi ose, sipas rastit, transferimin korrekt tek një operator i caktuar.

2. Nëse humbja, vjedhja ose dëmtimi ndodh gjatë transportit pa qënë e mundur të përcaktohet në territorin e cilit shtet ose shërbim ka ndodhur, operatorët e caktuar të interesuar do të përballin humbjen në mënyrë të barabartë. Megjithatë në rast të humbjes së artikujve rekomandë, ky parim do të zbatohet vetëm për artikujt e identifikuar nga etiketa CN 04 me identifikues të vetëm të artikullit, në përputhje me nenin RL 132, Artikujt rekomandë. Në të kundërt humbja do të përballlet vetëm nga operatori i caktuar dërgues.

3. Për sa i përket artikujve të siguruar, përgjegjësia e një operatori të caktuar kundrejt operatorëve të tjerë në asnjë rast nuk do të kalojë maksimumin e vlerës së siguruar që ai ka miratuar.

4. Operatorët e caktuar që nuk ofrojnë shërbimin e artikujve të siguruar do të mbajnë përgjegjësinë e përcaktuara për artikujt rekomandë në lidhje me artikujt e transportuar në dërgesa të mbyllura. Kjo dispozitë do të zbatohet gjithashtu kur operatorët e caktuar nuk pranojnë përgjegjësinë për artikujt e transportuar në bord të anijes ose avionit të përdorur nga ata.

5. Nëse humbja, vjedhja ose dëmtimi i një artikulli të siguruar ka ndodhur në territorin e shërbimit të një operatori të caktuar ndërmjetës që nuk ofron shërbimin e artikujve të siguruar, operatori i caktuar i



originjës do të përballë humbjen që nuk mbulohet nga operatori i caktuar ndërmjetës. I njëjti rregull do të zbatohet nëse shumë e dëmtimit është më e madhe se maksimumi i vlerës së siguruar të miratuar nga operatori i caktuar ndërmjetës.

6. Operatorët e caktuar përgjegjës për humbjet, vjedhjet ose dëmtimet do të paguajnë detyrimet doganore dhe tarifa të tjera për të cilat nuk është e mundur të sigurohet anulimi.

7. Një operator i caktuar që ka paguar dëmshpërblimin do të ketë të drejtat e personit që e ka marrë atë në çdo veprim që mund të merret kundrejt marrësit, dërguesit ose palëve të treta, deri në shumën e dëmshpërblimit.

Neni RL 162

Procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së operatorëve të caktuar

1. Deri sa të provohet e kundërta dhe subjekt i nenit RL 161.2 të Konventës, një operator i caktuar ndërmjetës ose operator i caktuar i destinacionit do të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë:

1.1 kur janë respektuar të gjitha dispozitat për inspektimin e postës dhe caktimin e parregullsive;

1.2 kur mund të provohet se është informuar për reklamimin pas shkatërrimit të të dhënave postare që lidhen me artikullin në fjalë, pas përfundimit të periudhës së mbajtjes. Kjo rezervë nuk do të dëmtojë të drejtën e reklamuesit;

1.3 në rastin e regjistrimit individual të një artikulli rekomande, kur dërgimi korrekt i artikullit të humbur nuk mund të provohet sepse operatori i caktuar i origjinës nuk e ka përfshirë artikullin rekomande në faturën e detajuar CN 31 ose CN 32 ose në listën e veçantë CN 33.

2. Derisa nuk është vërtetuar e kundërta, operatori i caktuar dërgues i një artikulli të siguruar do të çlirohet nga përgjegjësitë nëse zyra e shkëmbimit në të cilën është dorëzuar artikulli nuk ka dërguar me anë të postës së parë të disponueshme pas kontrollit tek operatori i caktuar dërgues një raport CN 24 i cili deklaron se e gjithë pakoja e artikujve të siguruar ose artikulli i veçantë mungon ose është ngatërruar.

3. Nëse vjedhja ose dëmtimi i një artikulli të siguruar është vendosur në shtetin e destinacionit ose, në rastin e kthimit të dërguesit, në shtetin e origjinës, operatori i caktuar i atij shteti duhet të provojë:

3.1 Se as pakoja, zarfi ose thesi dhe as mbërthimi i saj, dhe as ambalazhi dhe mbërthimi i artikullit nuk tregojnë ndonjë gjurmë të dukshme të vjedhjes ose dëmtimit;

3.2 Se pesha e caktuar në momentin e postimit nuk ka ndryshuar.

4. Kur është dhënë prova e përmendur në pikën 3, asnjë prej operatorëve të caktuar nuk mund të mohojnë ndarjen e përgjegjësisë me justifikimin që ka marrë në dorëzim artikullin pa asnjë vërejtje nga operatori i caktuar i radhës.

5. Kur një artikull rekomande ose një artikull i siguruar është humbur, prishur ose dëmtuar si rezultat i forcës madhore, operatori i caktuar në territorin juridik ose shërbimin e të cilit ka ndodhur humbja, vjedhja ose dëmtimi do të jetë përgjegjës ndaj operatorit të caktuar të origjinës vetëm nëse të dy operatorët e caktuar angazhohen të mbulojnë riskun e forcës madhore.

Neni RL 163

Rikuperimi i dëmshpërblimeve të paguara nga transportuesit ajrorë

1. Kur humbja, vjedhja ose dëmtimi ndodh në shërbimin e një agjencie të transportit ajror, rimbursimi i dëmshpërblimit të paguar dërguesit do ti merret agjencisë së transportit :

1.1 nga operatori i caktuar i origjinës nëse ai ka shlyer detyrimet transportit drejtpërdrejtë me agjencinë e transportit ajror;

1.2 nga operatori i caktuar që mbledh tarifat e transportit, kur operatori i caktuar i origjinës nuk i shlyen ato direkt me agjencinë e transportit ajror. Dëmshpërblimi i paguar dërguesit do ti rimbursohet operatorit të caktuar të origjinës nga operatori i caktuar që mbledh tarifat e transportit.

Neni RL 164

Rimbursimi i dëmshpërblimit për operatorët e caktuar pages

1. Operatori i caktuar përgjegjës ose për llogari të të cilit është kryer pagesa, do ti rimbursojë operatorit të caktuar pages shumën e dëmshpërblimit, pagesat dhe tarifat që i janë paguar reklamuesit në

përputhje me informacionin e detyrueshëm të dhënë në formularin CN 08. Procedurat e kontabilizimit që do të ndiqen janë përshkruar në nenet RL 165 dhe RL 166.

2. Nëse dëmshpërblimi, pagesat dhe tarifat e paguara që i janë rimbursuar reklamuesit duhet të përballohen nga operatorë të caktuar të ndryshëm, i gjithë dëmshpërblimi, pagesat dhe tarifat e paguara që i janë rimbursuar reklamuesit në të vërtetë, do t'i paguhen operatorit të caktuar pagues nga operatori i parë i caktuar i cili, pasi ka marrë sipas rregullave artikullin e reklamuar, nuk është në gjendje të vërtetojë transferimin e rregullt në shërbimin pasardhës. Do të jetë në përgjegjësinë e këtij operatori të caktuar të marrë pjesën e dëmshpërblimit që i është paguar reklamuesit në të drejtë nga secili prej operatorëve të tjerë të caktuar përgjegjës.

3. Operatori i caktuar përgjegjësia e të cilit është përcaktuar sipas rregullave dhe që fillimisht ka kundërshtuar të paguajë dëmshpërblimin do të mbajë të gjitha kostot shtesë që rezultojnë nga vonesat e pa justifikuara në pagesa.

Neni RL 165

Shlyerja e dëmshpërblimeve midis operatorëve të caktuar

1. Nëse një vit pas datës së dërgimit të autorizimit për pagesën e dëmshpërblimit, operatori i caktuar pagues nuk ka debituar llogarinë e operatorit të caktuar përgjegjës, autorizimi do të konsiderohet i pavlefshëm dhe i anuluar. Operatori i caktuar që e ka marrë atë, nuk do të ketë më të drejtë për të kërkuar rimbursimin e çfarëdo dëmshpërblimi të paguar.

2. Kur është pranuar përgjegjësia, si edhe në rastet e paraqitura në nenin RL 158.1, shuma e dëmshpërblimit mund të rikupërohet automatikisht nga operatori i caktuar përgjegjës me anë të një llogarie likuidimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të ndërmjetësisë së një operatori të caktuar i cili realizon rregullisht llogari të likuidimit me peratorin e caktuar përgjegjës.

4. Nëse dërguesi ose marrësi merr në dorëzim një artikull të gjetur më pas kundrejt ripagimit të shumës së dëmshpërblimit, ajo shumë do të kompensohet sipas rastit, operatorit të caktuar, ose operatorit të caktuar që mbart humbjen, brenda një viti nga data e kësaj ripagese.

5. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të shlyejnë periodikisht dëmshpërblimet që ata i kanë paguar reklamuesit në të drejtë dhe që ata kanë pranuar si të justifikuara.

6. Operatorët e caktuar të origjinës dhe destinacionit mund të bien dakord që e gjithë humbja do të paguhet nga operatori i caktuar që duhet ti bëjë pagesën reklamuesit në të drejtë.

7. Operatori i caktuar kreditor do të rimbursohet në përputhje me rregullat për pagesën të caktuara në nenin RL 251.

Neni RL 166

Kontabilizimi i shumave të detyruara për dëmshpërblimet e artikujve të postës së letrave

1. Kur operatorit të caktuar përgjegjës duhet ti ngarkohen pagesa operatori i caktuar kreditor do të përgatisë llogaritë CN 48 mujore ose tremujore.

2. Llogaritë CN 48 do të dërgohen tek operatori i caktuar debitor në dy kopje me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore) dhe maksimumi brenda dy muajve pas periudhës me të cilën kanë të bëjnë. Nuk do të përgatiten llogaritë "Zero".

3. Pas kontrollit dhe pranimi, një kopje e llogarisë CN 48 do të kthehet tek operatori i caktuar kreditor të paktën në përfundim të dy muajve nga data e dërgimit. Nëse operatori i caktuar kreditor nuk ka marrë ndonjë njoftim për ndryshim brenda limitit të kohës së përshkruar, llogaria do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

4. Në parim, këto llogari do të shlyhen në mënyrë të ndarë. Megjithatë, operatorët e caktuar mund të arrijnë në një marrëveshje për shlyerjen e tyre me llogarinë e detajuar CN 51 ose llogarinë e përgjithshme CN 52, ose mundësisht me llogarinë CP 75.



KAPITULLI 9 PROCEDURAT NË LIDHJE ME TRANSMETIMIN, ITENERARIN DHE MARRJEN E DËRGESAVE / ARTIKUJVE

Neni RL 167 Shkëmbimi i artikujve

1. Operatorët e caktuar mund të shkëmbejnë, midis një ose disa prej tyre, dërgesa të mbyllura si edhe artikuj à découvert sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimit.

2. Kur rrethana të veçanta detyrojnë një operator të caktuar që të pezullojë përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht shërbimet e tij, ai duhet të informojë menjëherë operatorët e caktuar të interesuar.

3. Kur transporti i postës transit në një shtet realizohet pa pjesëmarrjen e operatorëve të caktuar të atij shteti, kjo formë transiti nuk do të përfshijë përgjegjësinë e operatorit të caktuar të shtetit të transitit.

4. Operatorët e caktuar mund të dërgojnë postën tokësore me rrugë ajrore, me prioritet të reduktuar. Operatori i caktuar i destinacionit do të përcaktojë zyrën e shkëmbimit ose aeroportin e destinacionit për këtë dërgesë.

4bis. Operatorët e caktuar do të bëjnë çdo përpjekje për të tërhequr dhe shkëmbyer informacionin e para-dërgimit dhe të dërgimit në përputhje me mesazhet UPU PREDES dhe RESDES EDI për të gjitha dërgesat e postës së letrave dhe depozitat dhe duke përfshirë të dhënat e nivelit të artikujve kur janë të pranishëm artikujt e identifikuar.

Neni RL 168 Trajtimi prioritar i artikujve me prioritet dhe artikujve me postë ajrore

1. Operatorët e caktuar do të jenë të detyruar të dërgojnë me anë të komunikimit ajror që ata përdorin për të transportuar dërgesat tyre me prioritet dhe dërgesat-ajrore të këtij lloji që u mbërrijnë atyre nga operatorët e caktuar të tjerë.

2. Operatorët e caktuar që nuk kanë një shërbim ajror do të dërgojnë dërgesat prioritare dhe dërgesat ajrore me rrugën më të shpejtë të përdorur për postën. E njëjta procedurë do të zbatohet nëse, për çfarëdo arsye, dërgimi me rrugë tokësore është më i favorshëm se përdorimi i linjave ajrore.

3. Çdo operator i caktuar do të sigurojë një kohë specifike dorëzimi mundësisht prej një ore, deri në dy orë maksimumi me operatorët e caktuar pritës sipas kontratës së tyre me shoqëritë të fluturimit. Operatori i caktuar pritës do të përpaket të asistojë zbatimin e kësaj duke i ofruar operatorit të caktuar dërgues monitorimin e performancës së shoqërive të fluturimit në raport me afatin e parashikuar.

Operatorët e caktuar do të marrin të gjitha masat e nevojshme për:

4. 1 të siguar kushtet më të mira për marrjen dhe ridërgimin e dërgesave që përmbajnë artikuj prioritarë dhe artikuj me postë ajrore.

4. 2 të siguar se do të respektohen marrëveshjet e lidhura me transportuesit ajrorë në lidhje me prioritetin e këtyre dërgesave;

4. 3 të përshpejtuar procedurat përkatëse për kontrollet doganore të dërgesave prioritare dhe të dërgesave me postë ajrore të dërguar në shtetin e tyre;

4. 4 të reduktuar në minimum kohën e nevojshme për dërgimin e dërgesave prioritare dhe dërgesave me postë ajrore nga shteti i tyre në shtetet e destinacionit dhe shpërndarjen tek marrësit të dërgesave prioritare dhe dërgesave me postë ajrore që vijnë nga jashtë. Artikujt e vetëm që vijnë me postë prioritare ose me postë ajrore dhe që nuk kanë shënimet përkatëse të prioritetit ose postës ajrore siç është përcaktuar nga neni RL125 do të konsiderohen si artikuj prioritarë ose artikuj me postë ajrore dhe do të trajtohen në filialin e përpunimit të operatorit të caktuar të destinacionit.

5. Operatorët e caktuar të transitit dhe të destinacionit do të trajtojnë artikujt prioritarë dhe të postës ajrore në mënyrë të barabartë; operatorët e caktuar duhet gjithashtu të japin të njëjtin trajtim për artikujt tokësore LC kur dërguesit nuk i është ofruar një nivel shërbimi më i lartë. Në të njëjtën mënyrë, nuk do të ketë dallim për sa i përket shpejtësisë së përpunimit ndërmjet postës ajrore jo prioritare, artikujve tokësorë AO dhe artikujve S. A. L

Neni RL 169
Dërgesat

Dërgesat ndahen si vijon:

1.1 “Dërgesa ajrore” të cilat transportohen në rrugë ajore me prioritet. Dërgesat ajrore mund të përmbajnë postë ajrore dhe artikuj prioritarë.

1.2 “Dërgesa prioritare”, të transportuara me rrugë tokësore, por që kanë të njëjtin prioritet si dërgesat ajrore. Dërgesat prioritare mund të përmbajnë artikuj prioritarë dhe artikuj ajrorë.

1.3 “Dërgesa ajrore brenda shtetit (SAL)”, që përmban artikuj SAL dhe artikuj jo prioritarë.

1.4 “Dërgesa tokësore”, që përbëhet nga artikuj tokësorë dhe artikuj jo prioritarë.

Dërgesat e transportuara me rrugë ajrore dhe me rrugë tokësore të cilat përmbajnë vetëm dërgesa në sasi të mëdha do të quhen “postë në sasi të mëdha”.

2.1 Dispozitat e kësaj Rregulloreje të zbatueshme për dërgesat sipas pikave 1.1 deri në 1.4 do të zbatohen edhe për postën në sasi të mëdha të transportuar me të njëjtën rrugë ose mënyrë, me përjashtim të rasteve kur janë parashikuar shprehimisht dispozita specifike.

3. Shkëmbimi i dërgesave do të kryhet nga zyrat e quajtura “zyra të shkëmbimit”. Sa herë që një zyrë shkëmbimi duhet të specifikohet në një formular postar, kjo duhet të bëhet në përputhje me rregullat e dhëna në Standardet Teknike S34 të UPU (identifikimi/kodifikimi i Qendrave të Trajtimit të Postës ndërkombëtare (IMPC). Kjo përfshin:

3.1 emrin e zyrës së shkëmbimit;

3.2 emrin e operatorit përgjegjës për zyrën e shkëmbimit;

3.3 barkodet identifikuese, kodi S34 është kodi identifikues i zyrës së shkëmbimit.

4. Të gjitha zyrat e shkëmbimit duhet të regjistrohen në listën e kodeve të Qendrës së Trajtimit të Postës Ndërkombëtare nga operatori përgjegjës për atë zyrë. Kjo listë është publikuar në faqen e internetit të UPU-t.

5. Në të gjitha formularët, një zyrë shkëmbimi do të identifikohet nga emri i saj së bashku me emrin e operatorit përgjegjës, siç janë publikuar në listën e sipërpërmendur të kodeve.

6. Në identifikuesit me barkode, kodi S34 shërben për të identifikuar një zyrë specifike të shkëmbimit. Operatorët e caktuar duhet të mbajnë një listë me operatorët përgjegjës për çdo kod në bazën e tyre të të dhënave.

Neni RL 170
Shkëmbime në postë të mbyllur

1. Dërgesat e mbyllura duhet të përgatiten për shtetin e destinacionit kur numri i artikujve për dërgesë ose për ditë (nëse kryhen shumë dërgime në një ditë), tejkalon transmetimin e dërgesave à découvert në kushtet e parashikuara nga neni RL 171.

2. Shkëmbimi i artikujve me postë të mbyllur bëhet me marrëveshje të përbashkët midis operatorëve të caktuar të interesuar. Çdo ndryshim i itinerarit do të njoftohet nga operatori i caktuar dërgues për operatorët e caktuar të destinacionit në një kohë sa më të shkurtër dhe, nëse është e mundur përpara datës së vënies në jetë.

3. Me qëllim pjesëmarrjen në qarkullimin me cilësi të mirë të postës, çdo operator i caktuar duhet të përgatisë një minimum prej tre dërgesash të letrave prioritare në javë për çdo destinacion. Nëse volumi dhe pesha e dërgesave nuk justifikojnë një frekuencë të tillë, duhet të parashikohet dërgimi në tranzit à découvert.

4. Operatorët e caktuar nëpërmjet të cilëve dërgohen postat e mbyllura duhet të njoftohen në mënyrë të përshtatshme.

5. Në rastet kur duhet të dërgohet një numër jashtëzakonisht i konsiderueshem artikujsh të zakonshëm ose rekomande në një shtet tek i cili posta dërgohet zakonisht me tranzit à découvert, operatori i caktuar i origjinës është i autorizuar të përgatisë postë të mbyllur për zyrat e shkëmbimit të shtetit të destinacionit. Ajo lajmëron shtetet e transitit dhe ato të destinacionit.



Neni RL 171 Transiti à découvert (i hapur)

1. Transmetimi i artikujve à découvert tek operatorët e caktuar ndërmjetës duhet të kufizohet rreptësisht në rastet kur përgatitja e postave të mbyllura për shtetin e destinacionit nuk është e justifikueshme. Transmetimi à découvert nuk duhet të përdoret përderisa në shtetet e destinacionit për të cilat peshat mesatare e dërgesave i kalon rregullisht 3 kilogram për dërgesë ose në ditë (nëse bëhen shumë dërgesa në ditë) dhe nuk duhet të përdoret për thasët M.

2. Operatorët e caktuar dërgues duhet të konsultohen me operatorët e caktuar ndërmjetës për përshtatshmërinë e përdorimit të tyre për artikujt à découvert drejt destinacionit dhe njofton operatorët e caktuar në fjalë për datën e fillimit të dërgesës postare à découvert. Artikujt à découvert, përsa është e mundur, duhet ti dërgohen operatorëve të caktuar që përgatisin postën për operatorët e caktuar të destinacionit.

3. Artikujt à découvert të dërguara në rrugë tokësore i nënshtrohen pagesës së tarifave të transitit. Do të jenë të zbatueshme tarifat që pasqyrohen në nenin RL 205 të shtuara me 10 %. Llogaritja dhe kontabilizimi kryhen në përputhje me dispozitat e nenit RL 208.

4. Artikujt e postës ajrore à découvert dhe artikujt S.A.L à découvert të dërguara me rrugë normale ajrore do të jenë subjekt i pagesës së tarifave të transportit ajror të llogaritur në përputhje me dispozitat e nenit RL 238 të shtuara me 5%.

5. Në mungesë të një marrëveshje të posaçme, të gjitha dërgesat e dërguara në bordin e anijeve dhe të përfshira në një thes të mbyllur siç përmendur në nenin 19 të Konventës, duhet të dorëzohen à découvert, nga agjenti i anijes direkt tek zyra e postës së portit pavarësisht nëse këto artikuj janë vulosur në bord ose jo.

6. Në mungesë të marrëveshjes së posaçme, artikujt à découvert duhet të radhiten si më poshtë:

6.1 Artikujt prioritarë të dërguar dhe artikujt me postë ajrore do të përgatiten në pako të identifikuara nga etiketat CN 25

6.2 Artikujt prioritarë të dërguar me rrugë tokësore, artikujt jo prioritarë dhe artikujt tokësorë do të përgatiten në pako të identifikuara nga etiketat CN 26.

7. Kur numri dhe përgatitja e lejon, artikujt e dërguar à découvert tek një operator i caktuar duhen të ndahen sipas vendit të destinacionit. Ato do të përgatiten në pako të etiketuara me emrin e çdo shteti të shkruar me shkronja romake.

Neni RL 172 Iteneraret dhe mënyrat e transmetimit të artikujve të siguruar

1. Me anë të tabelave CN 27 të marra personat e tjerë të interesuar, çdo operator i caktuar do të përcaktojë iteneraret që do të përdoren për transportin e këtyre artikujve të siguruar.

2. Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve të ndara nga një ose më shumë shërbime ndërmjetëse, artikujt e siguruar duhet të ndjekin itinerarin më të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në rastet kur transporti me itinerarin më të drejtpërdrejtë nuk do të kishte garanci të përgjegjësisë mbi të gjithë udhëtimin, operatorët e caktuar të interesuar mund të bien dakord me njëri tjetrin për të rregulluar transportin à découvert me rrugë dytësore.

3. Subjekt i kërkesave të shërbimit, artikujt e siguruar mund të dërgohen me postë të mbyllur. Gjithashtu ato mund ti dorëzohen à découvert operatorëve të caktuar të parë ndërmjetës, nëse ky operator i caktuar siguron transportin në kushtet e parashikuara nga tabela CN 27.

4. Operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit mund të bien dakord ndërmjet tyre për të shkëmbyer artikujt e siguruar në posta të mbyllura, me anë të shërbimeve të një ose më shumë shteteve ndërmjetëse, pavarësisht nëse këto marrin pjesë në shërbimin e artikujve të siguruar ose jo. Operatorët e caktuar ndërmjetës duhet të paralajmërohen një muaj përpara fillimit të shërbimit.

Neni RL 173 Përgatitja e dërgesave

1. Përgatitja e pakove

1.1 Të gjithë artikujt e zakonshëm që do të paketohen do të ndahen sipas përmasave (artikuj të standardizuar, zarfe të mëdha dhe dërgesa të tjera) dhe të renditura me adresën nga i njëjti krah. Operatorët e

caktuar që zbatojnë sistemin e klasifikimit të bazuar në përmbajtje, parashikuar në nenin 12.3 të Konventës, do të paketojnë artikujt sipas kategorive të mëposhtme:

1.1.1 letra dhe kartolina

1.1.2 gazeta dhe periodike të përmendura në nenet RL 184. 5 dhe 7 artikuj të tjerë AO

1.2 Pakot do të dallohen nga etiketa, që kanë të shkruajtur me shkronja romake treguesin e zyrës së destinacionit ose zyrës së ri-adresimit të artikujve të paketuuar. Etiketa CN 25 do të përdoret nëse bëhet fjalë për artikuj prioritarë të dërguar me postë ajrore ose artikujt të postës ajrore, dhe etiketat CN 26 nëse bëhet fjalë për dërgesa prioritare të dërguara në rrugë tokësore, dërgesa jo prioritare ose dërgesa tokësore.

1.3 Artikujt e pa paguar ose të nën paguar do të përgatiten në pako që do të vendosen në thesin që përmban faturën. Etiketa e pakos do të jetë e vulosur me vulën T.

1.4. Trashësia e pakove të artikujve të standardizuar do të jetë e kufizuar në 150 mm sipas lidhjes. Pesha e pakove të artikujve të pa standardizuar nuk mund të kalojë 5 kilogramë.

1.5. Nëse artikujt prioritarë dhe letrat tregojnë shenja të hapjes, dëmtime ose shkatërtime ato duhet të kenë një shënim të faktit dhe do të shënohen me vulën datare të zyrës që e konstaton. Përveç të tjerave, nëse siguria e përmbajtjes së tyre e kërkon, artikujt do të vendosen, nëse është e mundur, në zarfa transparente ose në një ambalazhim të ri mbi të cilin duhet të shënohen të dhënat e zarfit.

2. Përgatitja e thasëve

2.1 Dërgesat, duke përfshirë edhe ato të përbëra vetëm prej thasëve bosh, duhet të jenë të përfshira në thasë, numri i të cilëve do të mbahet në minimum të rreptë. Thasët duhet të jenë në gjendje të mirë për të mbrojtur përmbajtjen e tyre. Çdo thes duhet të etiketohet.

2.2 Thasët do të mbyllen, mundësisht me ngjites. Vulat duhet të jenë prej metali ose plastike. Mbyllja duhet të jetë e tillë që të mos mund të preket ose të hapet pa lënë gjurmë manipulimi. Vulat duhet të paraqesin, me shkronja romake të lexueshme, emrin e zyrës së origjinës ose të dhëna të mjaftueshme për të lejuar përcaktimin e zyrës. Gjithësesi, nëse operatori i caktuar i origjinës dëshiron, shenjat e vulës mund të paraqesin vetëm emrin e operatorit të caktuar të origjinës.

2.3 Nëse numri dhe shteti i dërgimit janë treguar në mjetet e mbylljes, dhe nëse thasët kanë etiketë të kuqe, numri i mësipërm mund të regjistrohet gjithashtu në faturat CN 31 ose CN 32 dhe në rast të kundërt, në listën e posaçme CN 33.

2.4 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2.4.1, për përgatitjen e postës ajrore do të përdoren thasët tërësisht blu ose me fasha të gjera blu. Vetëm me marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, thasët e postës ajrore do të përdoren edhe për postën prioritare. Për përgatitjen e postës së tokësore ose postës së brendshme tokësore të transportuara me rrugë ajrore do të përdoren thasë me ngjyrë të ndryshme nga ato të postës me rrugë ajrore (p.sh. ngjyrë bezhë, kafe, të bardhë etj.). Operatorët e caktuar të destinacionit duhet të verifikojnë të gjitha etiketat e thasëve me qëllim që të sigurojnë një përpunim korrekt.

2.4.1 Operatorët e caktuar që përdorin thasët e zakonshëm postarë për shumë qëllime mund të përdorin këta thasë për të përgatitur të gjitha kategoritë e postave të përmendura më sipër, me kusht që kategoria e postës së transportuar në thasë të jetë dhënë saktësisht në etiketën e thasëve.

2.5 Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme të përdorin thasët ose kontenierëve të tillë si kuti etj., të posaçëm të postës ajrore me shënimet që i dallojnë ato që përmbajnë vetëm artikujt ekspres.

2.6 Thasët duhet të tregojnë lexueshëm, me shkronja romake, zyrën ose shtetin e origjinës dhe të kenë shënimin "Postes" (Postë) ose çdo shënim tjetër të ngjashëm që i dallon ato si dërgesa postare.

2.7 Nëse numri ose volumni i artikujve kërkon përdorimin e më shumë se një thesi, do të përdoren, për sa është e mundur, thasë të ndarë:

2.7.1 për letrat dhe kartolinat;

2.7.2 nëse është e aplikueshme, për gazetatat dhe shkrimet periodike të përmendura në nenet RL 184.5 dhe 7

2.7.3 për artikujt e tjerë AO

2.7.4 nëse është e aplikueshme, për pakot e vogla; etiketat e këtyre thasëve do të mbajnë shënim "Petits paquets" (pako të vogla).

2.8 Pakot ose thasët e artikujve rekomande ose të siguruar do të vendosen në një nga thasët e letrave ose në një thes të veçantë; thesi i jashtëm duhet të ketë në të gjitha rastet një etiketë të kuqe. Nëse ka më shumë se një thes për artikujt rekomande ose të siguruar, të gjithë këta thasë duhet të jenë të pajisur me një etiketë të kuqe.



2.9 Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme të mos vendosin postën e zakonshme në thesin që përmban faturën, por ta lënë këtë thes vetëm për artikujt rekomandë, të siguruar dhe ekspres.

2.10 Pësja e çdo thesi në asnjë rast nuk mund të tejkalojë 30 kilogramë.

3. Përgatitja e pakove dhe zarfeve

3.1 Në mungesë të një marrëveshje të veçantë, dërgesat e vogla thjesht do të mbështillen me letër të fortë, në mënyrë që të evitohet çdo dëmtim i përmbajtjes.

3.2 Pakot duhet të jenë të mbyllura, të vulosura, të ngjitura ose të pajisura me vulë metali të hollë ose me lëndë plastike.

3.3 Nëse pakot nuk përmbajnë tjetër veçse dërgesa të zakonshme, ato mund të mbyllen me anë të një vule gome e cila ka të shtypura të dhënat e zyrës së origjinës.

3.4 Për dërgesat me postë ajrore të artikujve me prioritet dhe artikujve të postës ajrore në paketime të vogla mund të përdoren zarfat CN 28. Këta mund të përbëhen nga letër e fortë me ngjyrë blu ose, me material plastik ose material tjetër dhe do të kenë etiketë blu.

3.5 Postimet e vona në zyrat e aeroportit të artikujve prioritarë dhe artikujve me postë ajrore në sasi të vogla mund të dërgohen në zarfa CN 28 me avionët në nisje. Kjo procedurë do të pranohet vetëm për dërgim në zyrat e shkëmbimit të atyre operatorëve të caktuar të destinacionit të cilat kanë rënë dakord për të marrë sendet me postë ajrore të përgatitur në këtë mënyrë.

4. Thasët përmbledhës. Transportimi në kontenier

4.1 Për sa është e mundur zyrat e shkëmbimit do të përfshijnë në dërgesat e tyre për një zyrë të caktuar, të gjitha dërgesat e vogla (pako ose thasë) që i vijnë atyre për këtë zyrë.

4.2 Kur garantohet nga numri i thasëve, zarfave ose pakove me peshë të lehtë që duhet të transportohen në të njëjtin sektor, do të përgatiten, sa herë të jetë e mundur, thasë përmbledhës. Ata do të përgatiten nga zyrat e postës përgjegjëse për dorëzimin e postës ajrore tek shoqëria e fluturimit që do të kryejë transportin. Etiketat e thasëve përmbledhës do të kenë të shkruar me shkronja të zeza treguesin "Sac collecteur" (thes përmbledhës). Operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakord mbi adresën që do të vendoset në etiketa.

4.3 Për qëllimin e transportimit të tyre, dërgesat mund të vendosen në kontenierë, sipas një marrëveshje të posaçme midis operatorëve të caktuar të interesuar mbi modalitetet e përdorimit të kontenierëve.

4.4 Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme, të shkëmbejnë posta në kontenierë të tjerë përveç thasëve (p. sh. kuti, paleta, etj) nëse është përcaktuar që kjo lehtëson veprimet e përpunimit dhe ruan gjendjen e postës.

Neni RL 174

Faturat

1. Një faturë CN 31 do të shoqërojë çdo thes, me përjashtim postës në sasi të mëdha dhe për postën për akses të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm. Fatura do të vendoset në një zarf që ka të shkruar, me shkronja të zeza, shënimin "Feuille d'avis" (faturë). Ky zarf do të jetë në ngjyrë rozë nëse dërgesa përmban një artikull të siguruar, dhe ngjyrë blu nëse jo. Ai do të vendoset jashtë pakos ose thesit të artikujve rekomandë. Nëse nuk ka dërgesa rekomandë, zarfi do të bashkëlidhet kudo që të jetë e mundur në pakon e artikujve të zakonshëm.

2. Postimet në sasi të mëdha do të shoqërohen me një faturë CN 32, në përputhje me dispozitat e nenit RL 182.

3. Operatorët e caktuar do të bien dakord midis tyre mbi dokumentet që do të përdoren për postën e destinuar për akses të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm. Ky dokumentacion mund të jetë një faturë CN 31 e modifikuar ose dokument tjetër i pranueshëm, të tilla si një deklaratë të postës vendase.

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet RL 178.1 dhe RL 179.2, ku një dërgesë nuk përmban ndonjë postë rekomandë apo të siguruar, operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme të bashkëlidhin faturën në pjesën e jashtme të një prej thasëve të dërgimit në një xhep të fortë, të papërshkueshëm nga uji, që të mund të përballojë transportin.

5. Në marrëdhëniet midis shteteve operatorët e caktuar të të cilave kanë arritur një marrëveshje, zyra dërguese e shkëmbimit do të dërgojë një kopje të CN 31 me rrugë ajrore në zyrën e shkëmbimit të destinacionit. Operatorët e caktuar, me anë të marrëveshjeve të veçanta, mund të vendosin që posta që përfshin vetëm thasë bosh të mos shoqërohet me një faturë.

5.bis Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme të shkëmbejnë fatura ose të dhëna të faturave me mënyrë elektronike; në këtë rast, ata mund të vendosin se nuk është e nevojshme që dërgesa e shkëmbyer midis tyre të shoqërohet me një faturë fizike CN 31.

6. Zyra e dërgimit plotëson faturën me të gjitha detajet, duke mbajtur në konsideratë sa më poshtë vijon:

6.1 Titulli: në mungesë të një marrëveshje të posaçme, zyrat dërguese duhet të numërtojnë faturat sipas një serie vjetore për çdo zyrë të destinacionit në mënyrë të ndarë për postën tokësore, postën SAL dhe postën ajrore, ose për postën prioritare dhe jo prioritare. Çdo postë duhet të ketë një numër të veçantë. Në rastin e dërgesës së parë të çdo viti, fatura duhet të ketë, përveç numrit serial të postës, edhe atë të postës së fundit të vitit paraardhës. Nëse posta është mbajtur, zyra dërguese do të regjistrojë pranë numrit të postës së fundit, shënimin “postë e fundit”

6.2 Tabela 1: operatorët e caktuar mund të bien dakord që vetëm thasët e pajisur me etiketë të kuqe të regjistrohen në tabelën 1 të faturës.

6.3 Tabela 3: Numri total i artikujve të regjistruar, si ato të renditura individualisht dhe ato të njofuara në sasi të mëdha, dhe numri total i artikujve të siguruar përfshirë në dërgesë do të regjistrohen në tabelën 3 të faturës.

6.3 bis Numri i artikujve rekomande dhe artikujve të siguruar që kanë të bëjnë me shërbimin postar dhe numrin e artikujve të kthyer në origjinë me përjashtim nga detyrimet përfundimtare, do të regjistrohen në tabelën 3 në kolonën me titull “Numri i artikujve të kthyer në origjinë me përjashtim nga detyrimet përfundimtare”

6.4 Tabela 4: Numri i thasëve të përdorur nga operatorët e caktuar dërgues, nga njëra anë, dhe numri i thasëve të ridërguar në operatorët e caktuar destinacionit, do të tregohen në këtë tabelë. Kur është e aplikueshme, numri i thasëve bosh që i përket një operatori të caktuar të ndryshëm nga ai të cilit i është drejtuar posta duhet të paraqitet veçmas me të dhënat e këtij operatori të caktuar. Nëse dy operatorë të caktuar kanë rënë dakord të regjistrojnë vetëm thasët e pajisur me etiketën e kuqe (6.2), numri i thasëve të përdorur për përgatitjen e postës ose numri i thasëve bosh që i përkasin operatorëve të caktuar të destinacionit nuk do të jepet në tabelën 4. Nëse artikujt IBRS janë përfshirë në postë, duhet të plotësohen kutitë “Të dhëna të tjera”, duke shënuar në mënyrë të ndarë numrin dhe peshën e thasëve dhe pakove IBRS dhe numrin total të artikujve IBRS. Prania e dërgesave të zakonshme ose rekomande COD do të shënohet në kutinë përkatëse si në rastin e regjistrimeve individuale dhe në atë të dërgesave në sasi të mëdha.

6.5 Nëse operatorët e caktuar bien dakord në mënyrë të dyanshme të shkëmbejnë postat në kontenerie të ndryshëm nga thasët, ata duhet të vendosin në faturën CN 31 numrin dhe peshën e çdo lloji konteneri. Formulari CN 31 pra duhet të parashikojë regjistrimin e këtij informacion.

6.5bis Kur operatorët e caktuar kanë rënë dakord në mënyrë të dyanshme të ndajnë postat e tyre dalëse ndërkombëtare sipas përmasave, numrit të kontenerëve dhe peshës sipas përmasave duhet të regjistrohet në faturën CN 31. Në këto raste, dispozitat për regjistrimin e detajeve të përmasave do të bëhen në formularin CN 31.

7. Operatorët e caktuar mund të bien dakord me njëri tjetrin të përfshijnë tabela ose rubrika shitesë në faturë ose të modifikojnë tabelat në përputhje me nevojat e tyre kur i gjykojnë të nevojshme.

8. Në rastin e artikujve à découvert tokësore që peshojnë më shumë se 3 kilogram për postë të dërguar ose për ditë në një shtet të përcaktuar destinacioni, operatorët e caktuar të transitit do të jenë të autorizuar të përgatisin një faturë CN 31 për çdo shtet, një kopje e të cilës i dërgohet operatorëve të caktuar të origjinës.

9. Nëse një zyrë këmbimi nuk ka asnjë dërgesë për të dorëzuar në zyrën përkatëse dhe nëse, me marrëveshje të posaçme midis operatorëve të caktuar të interesuar, faturat nuk janë të numëruara do të dërgohet një faturë “Zero” me postën e ardhshme. Nëse bëhet fjalë për postë vjetore të numëruar, nuk do të dërgohet faturë “Zero”.



Neni RL 175

Transmetimi i artikujve rekomande

1. Artikujt rekomande do të transmetohet të regjistruar individualisht në anën e pasme të faturës. Mund të përdoren një ose më shumë lista të posaçme CN 33, në vend të pjesës pasme të faturës apo si një shtojcë e kësaj fature. Përdorimi i listave të posaçme do të jetë i detyrueshëm nëse kjo kërkohet nga operatori i caktuar i destinacionit. Listat në fjalë do të tregojnë të njëjtin numër dërgese si ajo e treguar në faturën përkatëse të dërgesës. Kur janë përdorur disa lista të posaçme ato duhet të numërtohen me serinë e tyre për çdo dërgesë. Numri i artikujve rekomande të cilat mund të regjistrohen në një listë të posaçme ose në pjesën e prapme të faturës do të jetë i kufizuar në numrin e parashikuar nga formulari përkatës. Numri i përgjithshëm i artikujve rekomande të përfshirë në dërgesë do të regjistrohet në tabelën 3 të faturës.

2. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për njoftimin e sasive të mëdha të artikujve rekomande. Numri i përgjithshëm i artikujve rekomande të përfshira në dërgesë do të regjistrohen në tabelën 3 të faturës. Kur dërgesa përfshin disa thasë me artikuj rekomande, çdo thes përveç atij në të cilin është futur fatura duhet të përmbajë një listë të posaçme CN 33 që tregon, në hapësirën e dhënë, me fjalë dhe shifra numrin e përgjithshëm të artikujve rekomande që ai përmban. Numri i artikujve rekomande të futur në thesin që përmban faturën do të përmendet në kutinë e rezervuar për këtë qëllim në tabelën 6.

3. Artikujt rekomande dhe, nëse aplikohen, listat e posaçme të parashikuara në pikën 1, do të përgatiten në një ose më shumë pako apo thasë të veçantë të cilët do të ambalazhohen në mënyrë të përshtatshme ose do të mbyllen dhe do të vulosen me ose pa plumb në mënyrë që të mbrojnë përmbajtjen. Thesi dhe pakoja të përgatitura në këtë mënyrë mund të zëvendësohen nga thasë plastikë të mbyllur me nxehtësi. Artikujt rekomande do të organizohen në çdo paketë, sipas rendit të tyre e hyrjes. Kur janë përdorur një apo më shumë lista të posaçme, secila prej tyre do të jetë e lidhur me artikujt rekomande të cilave ajo i referohet dhe do të vendoset mbi artikullin e parë të pakos. Kur janë përdorur disa thasë secili prej tyre duhet të përmbajë një listë të posaçme e cila detajon artikujt që ai përmban.

4. Subjekt i marrëveshjes ndërmjet operatorëve të caktuar të interesuar dhe kur vëllimi i tyre e lejon, artikujt rekomande mund të futen në zarfin e veçantë që përmban faturën. Ky zarf do të vuloset.

5. Në asnjë rast artikujt rekomande nuk mund të vendosen në të njëjtën pako me artikujt e zakonshëm.

6. Për sa është e mundur, i njëjti thes nuk duhet të përfshijë me tepër se 600 artikuj rekomande.

7. Nëse artikujt rekomande COD janë regjistruar individualisht pas faturës CN 31 ose në një listë të posaçme CN 33, fjala «Rimbursim (COD)», ose shkurtimi «Rimb» ose «COD», duhet të shkruhet përballë regjistrimit të përshtatshëm në kolonën «Vërejtje».

8. Thasët M rekomande duhet të regjistrohen si një artikull i vetëm në tabelën 6 ose pas faturës CN 31 ose në një listë të posaçme CN 33. Në kolonën «Vërejtje» duhet të vendoset shkonja M.

9. Operatorët e caktuar mund të krijojnë sisteme të cilat gjenerojnë të dhëna konfirmimi të transmetimit elektronik dhe të bien dakord të shkëmbejnë këto të dhëna me operatorët e caktuar të origjinës së artikujve.

Neni RL 176

Transmetimi i artikujve rekomande të dorëzuar

1. Artikujt me dorëzim të regjistruar do të transmetohen në të njëjtën mënyrë si artikujt e zakonshëm.

Neni RL 177

Transmetimi i artikujve të siguruar

1. Zyra e shkëmbimit dërguese do të regjistrojnë artikujt e siguruar në një listë të posaçme të dërgimit CN 16 me të gjitha detajet që parashikon ky formular. Në rastin e artikujve COD, fjala «Rimbursim», ose shkurtimi «Rimb.» duhet të shënohet përballë shënimit të dërgesës në kolonën «Vërejtje».

2. Artikujt e siguruar do të përgatiten me listë ose lista të dërgimit në një ose më shumë pako speciale të lidhura me njëra-tjetrën. Këto të fundit do të mbështillen me letër të fortë, do të lidhen nga jashtë dhe do të

vulosen me dyll në çdo ambalazh me anë të vulës së zyrës dërguese të shkëmbimit. Këto pako do të shënohen "Valeurs déclarées" (Artikuj të siguar).

3. Në vend të përgatitjes në një paketim, artikujt e siguar mund të vendosen në një zarf me letër të fortë, të mbyllur me anë të vulave prej dylli.

4. Paket ose zarfet e artikujve të siguar mund të mbyllen edhe me vulë gome e cila mban të dhënat e operatorëve të caktuar të origjinës së dërgesës. Duhet të vendoset një vulë datare e zyrës dërguese mbi vulën prej gome në mënyrë që ajo të figurojë pjesërisht mbi vulë dhe pjesërisht mbi ambalazh. Kjo metodë e mbylljes nuk do të përdoret nëse operatorët e caktuar të destinacionit të dërgesës kërkojnë vulosjen me dyll ose plumb të pakove ose zarfave të artikujve të siguar.

5. Nëse numri ose volumni i artikujve të siguar e bën të nevojshme, ata mund të futen në një thes të përshtatshëm të mbyllur dhe të vulosur me dyll ose plumb.

6. Pakoja, zarfi apo thesi i artikujve të siguar duhet të futet në pakon apo thesin që përmban artikuj rekomandë ose në mungesë të tyre, në pakon apo thesin i cili do të mbante normalisht artikuj rekomandë. Kur artikujt rekomandë janë futur në më shumë se një thes, pakoja, zarfi apo thesi i artikujve të siguar duhet të vendoset në fillim të thesit në të cilin është bashkëlidhur zarfi i posaçëm që mban faturën.

7. Thesi i jashtëm i cili mban artikujt rekomandë duhet të jetë në gjendje të mirë, dhe nëse është e mundur, në pjesën e sipërme me një lidhëse e cila pengon hapjen e paligjshme pa lënë gjurmë të dukshme.

8. Në tabelën 3 të faturës duhet të regjistrohet numri i përgjithshëm i artikujve të siguar i përfshirë në dërgesë.

9. Operatorët e caktuar mund të krijojnë sisteme që gjenerojnë të dhëna konfirmimi të transmetimit elektronik dhe të bien dakord të shkëmbejnë këto të dhëna me operatorët e caktuar të origjinës së artikujve.

Neni RL 178

Transmetimi i mandat pagesave dhe artikujve të zakonshëm COD

1. Mandat pagesat postare të dërguara të pambyllura do të përgatiten në një pako të veçantë dhe do të vendosen në një pako ose thes që përmban artikuj rekomandë ose, nëse nuk ka të tillë, në pako apo thes me artikuj të siguar. E njëjta procedurë do të zbatohet për artikujt e zakonshëm COD. Nëse dërgesa nuk përmban artikuj rekomandë dhe as të siguar, mandat pagesat dhe çdo artikull i zakonshëm COD duhet të vendosen në zarfin që përmban faturën ose që lidhet me këtë të fundit.

2. Prania e artikujve të zakonshëm COD do të shënohet në tabelën 4 të faturës CN 31 ose në tabelën 3 të faturës CN 32, sipas rastit.

Neni RL 179

Transmetimi i artikujve ekspres

1. Prania e artikujve ekspres do të shënohet me shkronjën X në kutinë përkatëse të tabelës 4 të CN 31 (tabela 3 e faturës CN 32)

2. Artikujt ekspres do të përgatiten në pako të veçanta dhe do të pajisen me një etiketë e cila mban simbolin "Exprès" (Ekspres) sipas parashikimeve të nenit RL 136. Kjo lidhje duhet të vendoset, nëse është e mundur, në kontenierë të ndarë. Nëse kjo nuk është e mundur, ato duhet të vendosen në kontenierin që ka faturën.

3. Artikujt ekspres rekomandë do të rregullohen në rendin e tyre ndërmjet artikujve të tjerë rekomandë. Fjala "Exprès" (Ekspres) do të shkruhet pranë regjistrimeve përkatëse në kolonën "Vërejtje" në pjesën e pasme të faturës ose në listën e posaçme CN 33. Në rastin e njoftimeve të dërgesave në sasi të mëdha, prania e këtyre artikujve rekomandë do të shënohet gjithashtu me shkronjën "X" në kutinë përkatëse të tabelës 4 të faturës. Një shënim i ngjashëm do të vihet në kolonën "Vërejtje" të listës së dërgimit CN 16, përkrah regjistrimeve të artikujve të siguar për dërgim ekspres.

Neni RL 180

Transmetimi i artikujve IBRS

1. Operatorët e caktuar që kryejnë shërbimin do të caktojnë zyrën e shkëmbimit të destinacionit të specializuar në trajtimin e dërgesave që përmbajnë artikuj IBRS. Nëse justifikohet nga shkaqe operationale, operatorët e caktuar mund të përcaktojnë disa zyra të shkëmbimit për këtë qëllim.



2. Artikujt IBRS do të përgatiten në pako të veçanta. Etiketa e pakos CN 25 do të ketë të shkruar treguesin "IBRS" dhe numrin e artikujve. Pakot e artikujve IBRS do të vendosen në thasët që kanë faturën. Megjithatë, ato nuk duhet të vendosen në thesin e artikujve rekomande.

2. 1 Nëse dërgesa përmban më shumë se 2 kilogramë artikuj IBRS, këto artikuj do të vendosen në thasë të veçantë. Etiketa e thesit do të ketë të shkruar shënimin IBRS dhe në pjesën e pasme të saj, numrin e artikujve.

3. Artikujt IBRS të një dërgese do të paraqiten në tabelën 4 të faturës CN 31 (tabela 3 e faturës CN 32), në "Të dhëna të tjera", si më poshtë vijon:

3. 1 për artikujt në thasë të ndarë, në rreshtin "Thes IBRS" duhet të shkruhet numri dhe pesha e thasëve dhe numri i artikujve.

3. 2 për artikujt e dërguar me pjesën tjetër të dërgesës, në rreshtin "Pako IBRS" duhet të shkruhet numri dhe pesha e pakove dhe numri i artikujve.

4. Në varësi të volumit e trafikut të përfshirë, operatorët e caktuar mund të bien dakord për procedura specifike me marrëveshje të dyanshme.

Neni RL 181

Transmetimi i thasëve M

1. Çdo thes M duhet të jetë e pajisur me etiketën CN 34, CN 35 ose CN 36 të plotësuar me shkronjën M me karaktere të mëdha në cepin e sipërm të djathtë. Kjo etiketë i shtohet etiketës së adresës të dhënë nga dërguesi. Pakot M të cilët nuk janë të vendosur në thasë duhet të vendosen në një "thes përmbledhës M" për transmetim.

Neni RL 182

Transmetimi i artikujve në sasi të mëdha

1. Nëse operatori i caktuar i destinacionit ka kërkuar pagesë të posaçme për postën në sasi të madhe, operatori i caktuar i origjinës mund të dërgojë artikujt në sasi të mëdha në dërgesa specifike, të shoqëruara me një faturë CN 32.

2. Fatura CN 32 do të përmbajë numrin dhe peshën e artikujve.

2.1 Për operatorët e caktuar që kanë rënë dakord për këtë çështje, numri dhe pesha e artikujve mund të jepet sipas formatit të tyre.

3. Për faturën CN 32 do të zbatohen për analogji dispozitat e nenit RL 174.

4. Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë reciproke për forma dhe procedura alternative të kontabilitetit për artikujt e postës me sasi të mëdha.

Neni RL 183

Transmetimi i artikujve të destinuar për akses të drejtpërdrejtë në regjimin e brendshëm

1. Artikujt e destinuar për akses të drejtpërdrejtë në shërbimin e brendshëm të një operatori të caktuar sipas kushteve të nenit 28.4 të Konventës, do të dërgohen me postë specifike të shoqëruara nga një faturë CN 31, me përjashtim të rastit kur operatori i caktuar i destinacionit ose origjinës ka kërkuar specifikisht dokumentacion tjetër në bazë të legjislacionit kombëtar.

2. Fatura CN 31 e ndryshuar ose çdo dokument tjetër i kërkuar nga operatori i caktuar i destinacionit do të përfshijë numrin, peshën dhe, nëse është e aplikueshme, kategorinë e dërgesave ose çdo informacion tjetër shtesë të kërkuar nga ana e operatorit të caktuar të destinacionit.

3. Dispozitat e nenit RL 174 do të zbatohen për analogji për faturën CN 31 ose çdo dokument tjetër të kërkuar nga operatori i caktuar i destinacionit.

4. Operatorët e caktuar duhet të bien dakord në mënyrë të dyanshme për format dhe procedurat alternative për transmetimin e artikujve të destinuar për akses të drejtpërdrejtë në regjimin e brendshëm nëse kjo kërkohet nga operatori i caktuar i destinacionit.

Neni RL 184 Etiketimi i dërgesës

1. Etiketat e thasëve duhet të jenë të përbëra nga pëlhurë bezeje të sertë, lëndë plastike, karton i fortë, lëndë e papërshkueshme ose prej letre të ngjitur në dru. Ato duhet të kenë një vrimë. Ambalazhimi dhe teksti i tyre duhet të jenë në përputhje me modelet e bashkëlidhura m dhe të paraqitura si më poshtë

1.1 CN 34 në rastin e thasëve për transport tokësor;

1.2 CN 35 në rastin e thasëve për transport ajror;

1.3 CN 36 në rastin e thasëve për transport të brendshëm (S. A. L).

2. Në shërbimin ndërmjet zyrave të afërta, mund të përdoren etiketa prej letre të fortë. Këto, megjithatë, duhet të kenë një qendrueshmëri të mjaftueshme për t'i rezistuar proceseve të ndryshme të përpunimit të cilave u nënshtrohet posta gjatë transmetimit.

3. Thasët që përmbajnë artikuj rekomandë, artikuj të siguruar dhe / ose fatura duhet të pajisen me një etiketë të kuqe të errët.

3.1 Megjithatë, operatorët e caktuar mund të bien dakord të mos përdorin, në marrëdhëniet e tyre dypalëshe, etiketat e kuqe dhe të zgjedhin me marrëveshje të përbashkët, për arsye sigurie, një metodë tjetër.

4. Për thasët që përmbajnë vetëm artikuj të zakonshëm, duhet të përdoret një etiketë e bardhë e kategorive, si më poshtë:

4.1 Artikuj prioritarë

4.2 Letra dhe kartolina të dërguara me rrugë tokësore dhe ajrore;

4.3 Artikuj të përzierë (letra, kartolina, gazeta dhe shkrime periodike si dhe artikuj të tjerë)

5. Etiketa e bardhë do të përdoret edhe për thasët që përmbajnë gazeta të dërguara në sasi të mëdha nga botuesit ose agjentët e tyre dhe të dërguara me rrugë tokësore, me përjashtim të atyre që i kthehen dërguesit. Shënimi «Journaux» (Gazeta) ose treguesi «Jx» duhet të shkruhet mbi etiketën e bardhë, kur thasët përmbajnë vetëm artikuj të kësaj kategorie.

6. Etiketa blu e hapur do të përdoret për thasët që përmbajnë vetëm dërgesa të zakonshme të kategorive jo prioritare, letra të shtypura, (literaturë për të verbrit) cekograme, dhe paketa të vogla.

7. Etiketa blu e hapur do të përdoret gjithashtu për thasët që përmbajnë shkrime periodike të ndryshëm nga ato që janë shënuar në pikën 5. Shënimi «Ecrits périodiques» (shkrime periodike) mund të shkruhet në etiketën blu kur thasët përmbajnë vetëm artikuj të kësaj kategorie.

8. Etiketa ngjyrë vjollcë do të përdoret për thasë që përmbajnë vetëm artikuj të zakonshëm me sasi të mëdha.

9. Për kontenitorët që përmbajnë dërgesa të kësaj kategorive do të përdoret etiketa e bardhë me bordurë me vija ngjyrë vjollcë dhe fjalët «Accès Direct» (akses i drejtpërdrejtë).

10. Për thasët që përmbajnë vetëm thasë bosh që kthehen në origjinë do të përdoret një etiketë e gjelbër.

11. Kur bëhet fjalë për një dërgesë prioritare të dërguar në rrugë tokësore, etiketa CN 34 duhet të ketë me shkronja të mëdha shënimin «PRIORITAIRE» (Prioritare).

12. Etiketa e thesit ose e pakos, që mban faturën shoqëruese do të ketë gjithmonë të shënuar me shkronja të zeza shkronjën F. Duhet të shkruhet gjithashtu edhe numri i thasëve të përfshira në dërgesë.

13. Etiketa e kontenierëve që përmbajnë artikuj ekspres duhet të ketë një skedë ose të shënohet "Exprès" (Ekspres). Nëse tabela "Ekspres" ose shënimi do të ndërhyjë me ndonjë bar kod ose tekst të etiketës CN 35, në thes do të vendoset një etiketë tjetër më e madhe me shprehjen "Ekspres".

14. Etiketa e bardhë mund të përdoret gjithashtu me skedën 5 x 3 cm të njëres nga ngjyrat e përmendura në pikat 3, 7 dhe 10. Një etiketë blu ose vjollcë mund të përdoret së bashku me një skedë të ngjashme të kuqe.

15. Artikujt që përmbajnë substanca infektive të lejuara do të vendosen në kontenierë të veçantë. Çdo kuti duhet të pajiset me një etiketë identifikimi, të ngjashëm në ngjyrë dhe formë me etiketën e parashikuar në nenin RL 130, por më të madhe në mënyrë që të lërë vend për vendosjen e një vrime.

16. Kur bëhet fjalë për thasë që mbajnë vetëm artikuj të përjashtuar nga detyrimet përfundimtare, etiketa e thesit duhet të ketë të shkruar me shkronja të zeza treguesin «Përjashtuar».

17. Pesha bruto e secilit thes, zarf ose pako pjesë përbërëse e dërgesës do të tregohet në etiketën e thesit ose në adresën e jashtme. Nëse është përdorur thesi përmbledhës, pesha e tij nuk do të merren parasysh.



Pesha do të rrumbullakoset deri në hektogramin më të afërt, ku fraksioni i hektogramit është i barabartë ose më i madh se 50 gram dhe të rrumbullakosura deri në hektogramin më të ulët. Treguesi i peshës do të zëvendësohet nga numri 0 për postën ajrore që peshon 50 gram ose më pak.

18. Zyrat ndërmjetëse nuk duhet të regjistrojnë asnjë numër mbi etiketat e thasëve ose të pakove të dërgesave të mbyllura në transit.

18 bis. Të gjithë operatorët e caktuar do të përfshijë në etiketat e kontenierëve të tyre një identifikues me barkod në përputhje me Standardin Teknik UPU S9.

Neni RL 185 Përdorimi i barkodeve

1. Operatorët e caktuar mund të përdorin barkode të gjeneruara nga kompjuteri dhe një sistem unik të identifikimit në shërbimet postare ndërkombëtare për qëllime të tilla si sistemet e gjurmim / gjetjes dhe aplikacioneve të tjera të identifikimit. Specifikimet do të përcaktohen nga Këshilli i Operacioneve Postare.

2. Operatorët e caktuar të cilat zgjedhin të përdorin barkodet në shërbimet ndërkombëtare duhet të përmbushin specifikimet teknike të parashtruara nga Këshilli i Operacioneve Postare. Përfaqësimi i zyrave të shkëmbimit me barkode duhet të pajtohet me rregullat e përcaktuara në nenin RL 169.3.

2bis. Kur një operator i caktuar i origjinës zbaton një identifikues me barkod standard me 13-karakte të UPU për artikujt e postës së letrave në shërbimin ndërkombëtar, do të përdorë vetëm një identifikues unik të tillë. Ky identifikues duhet të përputhet me standardin S10c të UPU (identifikimi i dërgesave postare – Pjesa C: identifikuesi me 13-karakte për produktet e posaçme të letrës) dhe do të kodohet në artikull edhe në formën e lexueshme nga njeriu edhe në atë me barkod.

2ter. Në rastin kur operatorët e caktuar ndërmjetës apo të destinacionit vendosin një barkod shtesë për artikujt e postës së letrave, etiketa shtesë do të jetë e pozicionuar në një mënyrë që të shmangë mbulimin e çfarëdo pjese të adresës së dërguesit ose adresën e kthimit, dhe duhet:

2ter.1 të dublikojë identifikuesin e aplikuar në shtetin e origjinës, ose;

2ter.2 të pozicionohet në mënyrë që të shmangë mbulimin e ndonjë pjese të identifikuesit të vendosur në shtetin e origjinës.

2 quater Në rastin kur një artikull i postës së letrave i cili ka pasur disa etiketa në përputhje me pikën 2ter.2 është dërguar tek një operator tjetër i caktuar apo është kthyer tek operatori i caktuar i origjinës, operatori i caktuar që ka vendosur disa etiketa duhet të heqë ose zhdukë atë para dërgimit të artikullit nëse edhe barkodi i këtyre etiketave është në formatin me 13 karakte të standardit të UPU.

2quinquies Operatorët e caktuar që dërgojnë më shumë se 100 tonë dërgesa me postën e letrave për vit në një fluks specifik, ose që shlyejnë detyrimet përfundimtare në bazë të vlerësimeve të fluksit individual të dërgesave, do të përdorin identifikuesin e kontenierëve të Standardit UPU S9 për të gjithë kontenierët postarë (duke përfshirë ato ajrore, S.A.L., dhe tokësorë) dhe do të transmetojnë:

2quinquies.1 Mesazhet paralajmërues elektronike të standardit të UPU-t për të gjitha dërgimet nga jashtë, duke përfshirë kodet e identifikuesve të kontenierëve dhe, nëse është e aplikueshme, identifikuesit e artikujve për artikujt rekomandë, të siguruar dhe me dorëzim të regjistruar që përputhen me standardin S10c të UPU-t, siç është publikuar në Standardet Teknike të UPU-t;

2quinquies.2 Mesazhet elektronike të konfirmimit të standardit të UPU-t për raportimin e faturave të dërgimeve të brendshme që u janë paralajmëruar në mënyrë elektronike, duke përfshirë edhe llojin e kontenierëve që përdor kodet e kontenierëve të Standardeve të UPU.

2sexies Limiti i volumit të pikës 2bis do të reduktohet në 75 tonë në vitin 2011, 50 tonë në 2012, dhe 25 tonë në 2013.

Neni RL 186 Itinerari i dërgesave

1. Dërgesat e mbyllura do të dërgohen me rrugën më të drejtpërdrejtë të mundshme.

2. Kur një dërgesë përbëhet nga shumë thasë, këto, për sa është e mundur, do të qendrojnë bashkë dhe do të dërgohen në të njëjtin vend.

3. Operatori i caktuar i shtetit të origjinës mund të përshkruajë itinerarin që duhet ndjekur nga dërgesat e mbyllura që ai dërgon, me kusht që përdorimi i këtij itinerari të mos sjellë shpenzime të veçanta për

operatorin e caktuar ndërmjetës. Informacionet për itinerarin do të regjistrohen në faturat CN 37, CN 38 ose CN 41 dhe në etiketat CN 34, CN 35, ose CN 36.

4. Posta ajrore e mbyllur duhet të dërgohet me fluturimin e kërkuar nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me kusht që ky fluturim të përdoret nga operatori i caktuar i shtetit të transitit për transmetimin e dërgesave të tij. Nëse kjo nuk është e mundur apo kur koha e transportit nuk është e mjaftueshme, duhet të lajmërohet operatori i caktuar i shtetit të origjinës.

5. Në rast se midis dy operatorëve të caktuar është bërë një ndryshim në shërbimin e shkëmbimit të dërgesave të mbyllura me një apo më shumë shtete të treta, operatori i caktuar i origjinës së dërgesave do të njoftojë operatorët e caktuar të shteteve të tjera.

6. Nëse bëhet fjalë për një ndryshim në itinerarin e dërgesave, itinerari i ri që do të ndiqet do t'i raportohet operatorëve të caktuar të cilët kanë ofruar më parë transitin. Rruga e vjetër, do ti bëhet e ditur për informacion, operatorëve të caktuar që do të ofrojnë transitin në të ardhmen.

Neni RL 187

Transportimi i postës ajrore dhe i postës ajrore brenda vendit (S.A.L.)

1. Në parim, operatori i caktuar i shtetit të origjinës, në përputhje me preferencat e tij, do të drejtojë dërgesat për transport të drejtpërdrejtë në aeroportin transit me avionët e të njëjtës linjë ajrore ose me ato të linjave ajrore të ndryshme.

2. Kur transferimi me avion nuk është i mundur, transporti do të bëhet nga operatori i caktuar i shtetit në territorin e të cilit ndodhet aeroporti transit dhe do të jetë subjekt i tarifave të trajtimit të transitit.

2bis Dërgesat e transportuara drejtpërdrejt në aeroportin tranzit me anë të avionit të së njëjtës linjë nuk do të jenë subjekt i tarifave të transitit.

3. Në rastet e referuara në pikën 1 dhe nëse operatori i caktuar i origjinës dhe i destinacionit dhe shoqëria e fluturimeve e interesuar kanë rënë dakort paraprakisht, shoqëria që kryen transportin do të ketë mundësinë të përgatisë, nëse është e nevojshme një faturë dërgimi të posaçme që do të zëvendësojë faturën origjinale CN 38 ose CN 41. Palët e interesuara do të bien dakord për procedurat që do të ndiqen dhe formularin në përputhje me nenin RL 191. Është e preferueshme që thasët e dërgesave të jenë të pajisura, përveç etiketës së parashikuar për transportin e postës ajrore, edhe me një etiketë CN 42.

4. Kur dërgesat tokësore të një operatori të caktuar janë ri-dërguar me rrugë ajrore nga një operator tjetër i caktuar, kushtet e këtij ri-dërgimi do të përbëjnë objektin e një marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar.

Neni RL 188

Hapat që do të ndërmerren kur transporti i drejtpërdrejtë i postës ajrore nuk mund të realizohet sipas planit

1. Nëse dërgesat e dokumentuara për transport të drejtpërdrejtë nuk arrijnë tek fluturimi i planifikuar në aeroportin e transportit, shoqëria e fluturimit do ti dorëzojë ato menjëherë tek nëpunësit e postës në aeroportin e transportit për ti ridërguar me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

2. Kjo nuk do të zbatohet kur:

2.1 operatori i caktuar që kryen dërgesat ma marrë masat e nevojshme për të siguruar ri-dërgimin e tyre me një fluturim vijues;

2.2 Në rast mungese të masave të parashikuara në pikën 2.1, shoqëria e fluturimeve përgjegjëse për marrjen e dërgesave mund të bëjë marrëveshje për ri-dërgimin e tyre brenda 24 orëve që pasojnë mbërritjen e tyre në aeroportin e transportit.

3. Në rastin e dhënë në pikën 1, zyra që ka siguruar ri-dërgimin do të informojë zyrën e origjinës për çdo dërgesë me anë të njoftimit të verifikimit CN 43, duke treguar në veçanti shërbimin ajror nga i cili është marrë dërgesa dhe shërbimet e përdorura (rrugë ajrore ose tokësore) për transportin e mëtejshëm deri në destinacion.

Neni RL 189

Përgatitja e njoftimeve të provës

1. Për të përcaktuar rrugën më të favorshme dhe kohëzgjatjen e transmetimit të një dërgese, zyra e



shkëmbimit e origjinës mund t'i dërgojë zyrës së destinacionit të kësaj dërgese, një njoftim prove CN 44 . Ky njoftim duhet të përfshihet në dërgesë dhe të bashkëlidhet me faturën CN 31 mbi të cilën prania e saj tregohet me anë të një kryqi në hapësirën përkatëse të tabelës 4 (tabela 3 e faturës CN 32). Nëse formulari CN 44 mungon në mbërritjen e dërgesës, zyra e destinacionit duhet të hartojë një dublikatë. Njoftimi i provës, i plotësuar rregullisht nga zyra e destinacionit, kthehet me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore) në adresën e specifikuar, ose nëse nuk është dhënë një adresë, në zyrën në të cilën është përgatitur.

2. Për të përcaktuar itinerarin më të favorshëm dhe kohëzgjatjen e transmetimit të dërgesave të dërguar à découvert nëpërmjet ndërmjetësive të një operatori të caktuar, zyra e shkëmbimeve e origjinës mund t'i dërgojë operatorit të caktuar të destinacionit të këtyre artikujve një buletin prove CN 44. Ky buletin duhet të jetë vendoset në zarf në të cilin do të shkruhet treguesi «CN 44» në cepin e sipërm në të majtë në pjesën e pasme. Buletini i provës i plotësuar rregullisht nga operatori i caktuar i destinacionit dërgohet me rrugën më të shpejtë (ajrore apo tokësore).

3. Në të gjitha rastet kur operatori i caktuar i destinacionit vë re vonesa të mëdha dhe zbulon një rrugë më të shpejtë ai mund të përgatisë një buletin prove CN 44 dhe sugjeron itinerarin më të favorshëm si për dërgesat e mbyllura dhe për artikujt e dërguar à découvert nëpërmjet një operatori tjetër të caktuar. Operatori i caktuar i origjinës duhet të marrë në konsideratë kërkesën e zyrës së destinacionit.

Neni RL 190 Transferimi i dërgesave

1. Dërgesat prioritare dhe dërgesat tokësore

1.2 Në mungesë të marrëveshjes së veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, transferimi i dërgesave midis dy zyrave korrespondente do të kryhet me anë të faturës së dërgimit CN 37. Do të përgatiten dy kopje të faturës. E para i drejtohet zyrës marrëse dhe e dyta zyrës dërguese. Zyra marrëse do të vërtetojë kopjen e dytë dhe do ta kthejë atë menjëherë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

1.2 Kur transferimi i dërgesave midis dy zyrave korrespondente bëhet nëpërmjet një shërbimi transporti fatura e dërgimit CN 37 do të përgatitet në tre kopje. Në këtë rast, kopja e parë i dërgohet zyrës marrëse dhe do të shoqërojë dërgesat. E dyta do të vërtetohet nga shërbimi i transportit dhe do ti jepet zyrës dërguese. E treta do të mbahet nga shërbimi i transportit pas nënshkrimit nga zyra marrëse.

1.3 Kur transmetimi i dërgesave kryhet me mjete transporti pa personel shoqërues fatura e dërgimit CN 37 do të përgatitet në tre kopje. Dy kopjet e para do të dërgohen me dërgesat dhe e treta do të mbahet nga zyra dërguese. E para i dërgohet zyrës marrëse dhe e dyta, e nënshkruar rregullisht nga ky i fundit, do të kthehet me rrugën më të shpejtë në zyrën e dërgimit.

1.4 Për arsye të organizimit të tyre të brendshëm, disa operatorë të caktuar mund të kërkojnë që të përgatiten fatura CN 37 të veçanta për dërgesat e postës së letrave nga njëra anë, dhe për koltë postare nga ana tjetër.

1.5 Kur transferimi i dërgesave midis dy zyrave korrespondente përfshin një shërbim detar, zyra e shkëmbimeve dërguese mund të përpilojë një kopje të katërt të faturës së dërgimit CN 37 të cilën zyra e shkëmbimeve marrëse do ta kthejë pasi ta ketë vërtetuar. Në këtë rast, kopja e tretë dhe e katërt do të shoqërojnë dërgesat. Një kopje e faturës CN 37 duhet të dërgohet paraprakisht me avion ose me postë elektronike ose me çdo mjet tjetër telekomunikacioni, zyrës së shkëmbimeve marrëse ose portit të shkarkimit ose administratës së tij qendrore.

2. Posta ajrore dhe i postës ajrore brenda vendit (S.A.L.)

2.1 Nëse behet fjalë për dërgesa të postës ajrore brenda vendit (S.A.L.), dërgesat që do të dorëzohen në aeroport do të shoqërohen me pesë kopje të faturës së dorëzimit CN 38, për secilën nga ndalesat në rastin e postës ajrore ose CN 41.

2.2 Një kopje e faturës CN 38 ose CN 41 e nënshkruar si mandat për dërgesat nga shoqëria e fluturimit ose autoritetet përgjegjëse të shërbimit tokësor, do të mbahet nga zyra dërguese.

2.3 Dy kopje të faturave CN 38 ose CN 41 do të mbahen në aeroportin e ngarkimit nga shoqëria e fluturimit që transporton dërgesat.

2.4 Dy kopje të faturave CN 38 dhe CN 41 do të futen në zarfin CN 45. Këto do të transportohen në portofolin e bordit të avionit ose në një vend tjetër të veçantë ku mbahen dokumentat e bordit. Pas mbërritjes në aeroportin e shkarkimit të dërgesave kopja e parë rregullisht e nënshkruar si mandat për dërgesat, do të

mbahet nga shoqëria e fluturimit që ka transportuar dërgesat. Kopja e dytë do të shoqërojë dërgesat në zyrën e postës në të cilën janë adresuar faturat CN 38 dhe CN 41.

2.5 Kur dy kopjet e identifikuara në pikën 2.4 nuk janë menjëherë të disponueshme në zyrën e shkëmbimeve të mbërritjes mund të pranohen faturat CN 38 dhe CN 41 të dërguara elektronikisht nga transportuesi ajror. Në këtë rast dy kopjet e faturave CN 38 dhe CN 41 duhet të nënshkruhen nga përfaqësuesi i shoqërisë së fluturimit në aeroportin e destinacionit para paraqitjes tek operatori i caktuar marrës. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2.5.1 ose 2.5.2, një kopje nënshkruhet nga operatori i caktuar marrës si mandat për dërgesat dhe do të mbahet nga transportuesi ajror. Kopja e dytë në të gjitha rastet shoqëron dërgesat deri në zyrën e postës të cilës i është adresuar fatura CN 38 ose CN 41.

2.5.1 Operatorët e caktuar që kanë vendosur një sistem regjistrimi elektronik të dërgesave që ata marrin nëpërmjet transportuesve ajrorë mund të përdorin të dhënat e sistemit në vend që të ndjekin procedurat që përfshijnë faturat CN 38 ose CN 41 të përshkruara në pikën 2. 5. Në vend të kopjes së nënshkruar të formularit CN 38 ose CN 41, operatori i caktuar marrës mund ti japë transportuesit ajror një kopje të të dhënave elektronike për atë dërgesë.

2.5.2 Në mënyrë alternative, operatorët e caktuar që këmbejnë mesazhe EDI në dërgimin e dërgesave mund të përdorin mandatat e mesazheve EDI në vend që të procesit CN 38 ose CN 41 të përshkruar në pikën 2.5. Në vend të kopjes së nënshkruar të formularit CN 38 ose CN 41, operatori i caktuar marrës mund të transmetojë mandatin e mesazhit EDI.

2.6 Operatorët e caktuar mund të bien dakord ndërmjet tyre për përdorimin sistematik të postës elektronike ose të çdo lloj tjetër mjeti të telekomunikacionit për transmetimin e faturave CN 38 ose CN 41 ndërmjet zyrës që përgatit dokumentin dhe zyrës që e merr atë.

2.7 Kur dërgesat i dërgohen me rrugë tokësore një operatori të caktuar ndërmjetës për t'u ridërguar me rrugë ajrore, ato do të shoqërohen nga faturat CN 38 ose CN 41, për zyrën ndërmjetëse. Një faturë CN 38 ose CN 48 do të përgatitet edhe për shtetin e destinacionit për në lidhje me postën ajrore të ri-dërguar me rrugë tokësore.

3. Dërgesat duhet të dorëzohen në gjendje të mirë. Megjithatë, një dërgesë nuk mund të refuzohet për shkak të dëmtimeve apo vjedhjeve.

4. Në rast se faturat e dërgimit CN 37, CN 38 dhe CN 41 prodhohen me mjete elektronike dhe transmetohen online tek shërbimi i transportit ose tek një agent bashkëpunëtor pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të personelit të operatorit të caktuar, dhe, nëse këto fatura janë stampuar atje, operatorët e caktuar të përfshirë në veprimet e transportit mund të bien dakort që faturat e dërgimit të mos nënshkruhen.

5. Dispozitat e parashikuara në pikën 1 deri në pikën 4 do të zbatohen edhe për dërgesat me sasi të mëdha.

Neni RL 191

Përgatitja dhe kontrolli i faturave të dorëzimit CN 37, CN 38 ose CN 41

1. Faturat e dërgimit do të plotësohen, në përputhje me formatin e tyre, mbi bazën e veçorive në etiketat e thasëve ose në adresë. Numri i përgjithshëm dhe pesha totale e thasëve dhe artikujve në çdo postë, do të regjistrohen në masë sipas kategorisë. Operatorët e caktuar të origjinës mund të zgjedhin të regjistrojnë çdo thes individualisht nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Megjithatë, çdo shtet ndërmjetës apo tranziti duhet të listojë çdo kontenier tranzit në mënyrë individuale, duke ruajtur operatorin e caktuar të origjinës, zyrën e destinacionit, të dërgimit dhe numrin kontenierëve të treguar nga operatori i caktuar i origjinës. Kodi identifikues IMPC me gjashtë-karakte të origjinës dhe destinacionit të kontenierit do të regjistrohet përkatësisht në kolonat 2 dhe 3. Numri dhe pesha e thasëve që kanë etiketën e kuqe duhet të tregohen veçmas, ato do të tregohen nga një "R" në kolonën "Vërejtje" të faturës së dërgimit. Nëse peshat e regjistruara përfshijnë edhe ato të dërgesave të përjashtuara nga detyrimet përfundimtare, kolona "Vërejtje" do të përdoret gjithashtu për të përcaktuar sipas kategorisë peshat që do të zbriten.

2. Prania e dërgesave prioritare tokësore do të shënohet me emërtimin "PRIOR" në kolonën "Vërejtje" të faturës CN 37.

3. Gjithashtu, do të regjistrohen në faturën e dërgimit CN 38:

3.1 Dërgesat e futura në thasët përmbledhës të regjistruara individualisht me tregues që janë futur në këta lloj thasësh.

3.2 Dërgesat me zarf CN 28.

4. Çdo zyrë ndërmjetëse ose e destinacionit që vëren gabime në regjistrimet e faturave CN 38 ose CN



41 duhen ti korrigjojë ato menjëherë. Ato do të raportohen me anë të shënimit të verifikimit CN 43 në zyrën e fundit të shkëmbimit dërguese dhe në zyrën e shkëmbimit që ka përgatitur dërgesën. Operatorët e caktuar mund të bien dakort për përdorimin sistematik të postës elektronike ose çfarëdo lloj mënyre telekomunikacioni të përshtatshme për raportimin e parregullsive.

5. Kur dërgesat e dërguara janë të futura në kontenerë të vulosur nga shërbimi postar, numri serial dhe numri i vulës për çdo kuti do të regjistrohet në kolonën e faturës CN 37, CN 38 ose CN 41 të rezervuar për këtë rast.

Neni RL 192

Mungesa e faturës së dorëzimit CN 37, CN 38 ose CN 4

1. Në mungesë të faturës CN 37, zyra marrëse duhet të përgatisë një të tillë në tre kopje, në përputhje me ngarkesën e marrë. Dy kopje, të shoqëruara me një shënim verifikimi CN 43, do të përcillen në zyrën dërguese, e cila do të kthejë një kopje pas shqyrtimit dhe nënshkrimit.

2. Kur një dërgesë arrin në aeroportin e destinacionit - ose në një aeroport ndërmjetës përgjegjës për të përcjellë atë me një transportues tjetër - pa faturën CN 38 ose CN 41, operatori i caktuar nën juridiksionin e të cilit është aeroporti do të përgatisë automatikisht një të tillë. Ky i fundit do të kundërfirmoset rregullisht nga transportuesi prej të cilit është marrë dërgesa. Ky fakt do të raportohet nga një shënim verifikimi CN 43, së bashku me dy kopje të CN 38 të përgatitur në këtë mënyrë, në zyrën përgjegjëse për ngarkimin e dërgesës. Kësaj zyre të fundit do ti kërkohet që të kthejë një kopje të vërtetuar rregullisht.

3. Nëse fatura origjinale CN 38 ose CN 41 mungon, operatori i caktuar që merr dërgesën duhet të pranojë faturën zëvendësuese CN 46 të përgatitur nga shoqëria e fluturimit. Fakti raportohet në zyrën e origjinës me anë të shënimit të verifikimit CN 43 të shoqëruar nga dy kopje të faturës zëvendësuese CN 46.

4. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të rregullojnë rastet e mungesës së faturës CN 38 dhe CN 41 duke përdorur në mënyrë sistematike postën elektronike ose çfarëdo mjeti telekomunikimi të përshtatshëm.

5. Zyra e shkëmbimit në aeroportin e destinacionit - ose një aeroport ndërmjetës përgjegjës për dërgimin e postës me një transportues tjetër - mund të pranojë, pa përgatitjen e shënimit të verifikimit CN 43, një faturë CN 38 ose CN 41 të dhënë nga transportuesi fillestar që është transmetuar elektronikisht nga zyra e tij në aeroportin e dërgimit dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i saj në aeroportin ku do të shkarkohet dërgesa.

6. Nëse aeroporti i ngarkesës nuk mund të përcaktohet, shënimi i verifikimit i adresohet direkt zyrës dërguese të postës në mënyrë që të dërgojë shënimin në zyrën nga e cila është marrë dërgesa.

Neni RL 193

Verifikimi i dërgesave

1. Çdo zyrë që merr një dërgesë duhet të verifikojë:

1.1 Originën dhe destinacionin e thasëve që përmban dërgesa dhe regjistrimet në faturën e dërgimit;

1.2 Vulosjen dhe përgatitjen e thasëve me etiketë të kuqe;

1.3 Saktësinë e informacionit në faturën e dërgimit.

2. Pësia e treguar në etiketën CN 34, CN 35, CN 36 do të verifikohet me kampionë ose në mënyrë sistematike. Të dhënat e zyrës së origjinës do të pranohen si të vlefshme nëse pësia ose numri i artikujve të vërtetuar ndryshon:

2.1 Me 200 gr ose më pak në rastin e thasëve të dërgesave me rrugë tokësore ose dërgesave me postë ajrore brenda shtetit (SAL);

2.2 Me 100 gr ose më pak nëse bëhet fjalë për thasë të dërgesave ajrore, të dërgesave prioritare ose të dërgesave me sasi të mëdha;

2.3 Nga 100 gr ose më pak, ose 20 dërgesa ose më pak, nëse bëhet fjalë për dërgesa IBRS.

3. Kur një zyrë ndërmjetëse ose e destinacionit vëren që diferenca ndërmjet peshës reale dhe peshës së regjistruar në thasë ose diferenca ndërmjet numrit ose peshës reale dhe numrit ose peshës së regjistruar në artikujt IBRS i kalon kufijtë e parashikuara në pikat 2.1, 2.2, ose 2.3, sipas rastit, do të korrigjojë etiketën e thesit dhe faturën e dërgimit. Ajo do të njoftojë menjëherë me anë të shënimit të verifikimit CN 43, për gabimin, zyrën e shkëmbimit dërguese, dhe kur është e përshtatshme, edhe zyrën e fundit të shkëmbimit ndërmjetës.

4. Kur një zyrë ndërmjetëse merr një dërgesë në gjendje të keqe, duhet të verifikojë përmbajtjen nëse

gjykon se kjo nuk është e paprekut, ajo do ta vendosë atë në një ambalazhim të ri ashtu siç është. Kjo zyrë duhet të kopjojë detajet e etiketës origjinale në një etiketë të re dhe të vendosë tek kjo e fundit vulën datare, të paraprirë nga shënimi “Remballé à ...” (e ambalazhuar në. . . .). ajo do të përgatisë një shënim verifikimi CN 43 dhe do të vendosë një kopje të saj dërgesën e ri-ambalazhuar.

5. Me marrjen e një dërgese, zyra e shkëmbimit marrëse do të procedojë si vijon:

5.1 Verifikon nëse dërgesa është e plotë dhe nëse ka ardhur në sekuencën me të cilën është dërguar.

5.2 Verifikon nëse regjistrimet e faturës dhe, nëse është e aplikueshme, listat e dërgimit CN 16 dhe listat e posaçme CN 33, janë të sakta.

5.3 Sigurohet që nuk paraqiten parregullsi në gjendjen e jashtme të thesit të jashtëm dhe të pakos, zarfit ose thesit të brendshëm që përmbajnë artikuj të siguruar.

5.4 Kontrollon numrin e artikujve të siguruar dhe i inspekton ato individualisht, inter alia, në lidhje me peshën, vulat dhe shënimet, dhe verifikon nëse artikujt COD janë shënuar si të tilla dhe janë të shoqëruara me formularët përkatës të pagesës.

5.5 Sigurohet që dërgesat ekspres të dërguara në thasë të posaçëm ose të përfshira në thasët që përmbajnë faturën janë përfshirë menjëherë në sistemin e brendshëm për shpërndarje dhe dorëzim sa më shpejt të jetë e mundur.

5.6 Në rast një ose më shumë thasë mungojnë, ky fakt do të konstatohet menjëherë nga dy nëpunës. Këta të fundit bëjnë korrigjimet e nevojshme në faturë ose në listat e posaçme. Ata do të kujdesen të heqin, kur është e nevojshme, të dhënat e gabuara në mënyrë të tillë që të lënë të lexueshme të dhënat origjinale. Me përjashtim të rastit kur ka një gabim të dukshëm, korrigjimi do të pranohet në deklaratën origjinale.

5.7 Procedura e parashikuar në pikën 5.6 do të zbatohet edhe në rastet e parregullsive të tjera, si p.sh mungesa e artikujve të siguruar, artikujve rekomande, faturës, listës së dërgimit ose listës së posaçme.

5.8 Në rast të mungesës së faturës, listës së dërgimit ose listës së posaçme, zyra e marrjes duhet të përgatisë, ndër të tjera, një faturë, listë dërgimi ose listë të posaçme, ose të bëjë një shënim të posaçëm për artikujt e siguruar ose rekomande të marra.

6. Informacion shtesë në lidhje me dërgesat me sasi të mëdha

6.1 Operatorit të caktuar të origjinës do ti dërgohet një shënim verifikimi CN 43, sëbashku me faturën zëvendësuese CN 32 e cila do të përfshijë detajet e artikujve me sasi të mëdha të marra në rastet e mëposhtme:

6.1.1 Operatori i caktuar i origjinës ka zgjedhur të përgatisë dërgesa me sasi të mëdha dhe dërgon artikujt e postës me sasi të mëdha me dërgesat e tjera;

6.1.2 Dërgesat me sasi të mëdha nuk shoqërohen nga fatura CN 32;

6.1.3 Operatori i caktuar i destinacionit merr dërgesat me sasi të mëdha të pa raportuara për të cilat zbatohet me efekt të menjëhershëm pagesa e veçantë; në këtë rast operatori i caktuar i destinacionit do të dërgojë formularët CN 43 dhe CN 32 me anë të telekomunikacionit, tek operatori i caktuar i origjinës së dërgesave.

6.2 Në rastet e parashikuara në pikat 6.1.1 dhe 6.1.3, fatura CN 31 e dërgesës që përmban artikuj me sasi të mëdha do të korrigjohet dhe transmetohet bashkë me shënimin e verifikimit CN 43.

7. Kur hapen dërgesat, elementët përbërës të mbylljes (plumbi, dhe vula të tjera, spango, etiketa), duhet të bashkohen. Për të arritur këtë qëllim spangoja pritët vetëm në një vend.

7bis Çdo operator i caktuar do të ketë të drejtë, në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar dhe procedurat e rëna dakord me autoritetet e tij doganore, të hapë dhe të inspektojë thasët M të marra, për të kontrolluar për përmbushjen e specifikimeve të detajuara të produkteve të nenit RL 124.7.1 deri në 7.5 dhe për të siguruar përputhshmërinë doganore. Të gjitha artikujt që nuk janë në pajtim me specifikimin e produktit do të shtohen në detyrimet përfundimtare të operatorit të destinacionit për dërgesat me prioritet dhe jo. Do të krijohet një shënim verifikimi CN 43 për të njoftuar operatorin e caktuar të origjinës për rregullimet për faturën CN 31.

8. Kur një zyrë merr fatura, lista të dërgimit ose lista të posaçme që nuk i përkasin, ia dërgon zyrës së destinacionit me rrugën më të shpejtë (Ajrore ose tokësore), ose kopje njësie me origjinalin, nëse e kërkon rregullorja e tij e brendshme.

9. Parregullsitë e konstatuara në marrjen e dërgesave që përmbajnë artikuj të siguruar do të bëhen menjëherë subjekt i rezervave të shërbimit të transferimit. Njoftimi i një artikulli që mungon, ndryshon ose ndonjë parregullsi tjetër për të cilën mund të jetë përgjegjës operatori i caktuar në lidhje me artikullin e siguruar do të dërgohet menjëherë me anë të telekomunikacionit në zyrën e shkëmbimit dërguese ose në atë të



shërbimit ndërmjetës. Përveç kësaj realizohet një raport formal CN 24. Gjendja në të cilën është gjetur ambalazhimi i dërgesës duhet të tregohet në këtë raport. Raporti formal i dërgohet me rekomande zyrës qendrore së operatorit të caktuar të shtetit së cilit i përket zyra e shkëmbimit dërguese, pavarësisht nga shënimi i verifikimit CN 43 i cili do të dërgohet menjëherë në atë zyrë. Një kopje e raportit i dërgohet në të njëjtën kohë edhe zyrës qendrore të operatorit të caktuar nga e cila varet zyra e shkëmbimit marrëse ose ndonjë autoriteti tjetër kontrollues të emëruar nga ai operator i caktuar.

10. Zyra e shkëmbimit që merr nga zyra korrespondente një artikull të siguar të dëmtuar ose të pambalazhuar mirë duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

10.1 Nëse bëhet fjalë për një dëmtim të lehtë ose për dëmtim të vulave, mjafton që të vulozet përsëri artikulli i siguar për të ruajtur përmbajtjen. Kjo do të autorizohet me kusht që të jetë e qartë se përmbajtja nuk është dëmtuar, dhe, në bazë të kontrollit të peshës, i mangët. Duhet të respektohen vulat ekzistuese. Nëse është e mundur artikujt e siguar duhet të paketohen sërish duke ruajtur sa më shpejt të jetë e mundur paketimin origjinal. Ri-paketimi mund të kryhet duke futur artikujt e dëmtuar në një thes me etiketë dhe të vulosur me plumb. Në këto raste nuk është e nevojshme të vulozet sërish dërgesa e dëmtuar. Etiketa e thesit duhet të ketë shënimin “Envoi avec valeur déclarée endommagée” (Artikull i siguar i dëmtuar). Ajo duhet të tregojë informacionin vijues: numrin e serisë, zyrën e origjinës, shumën e artikullit të siguar, emrin dhe adresën e marrësit, vulën datare dhe firmën e nëpunësit i cili ka ambalazhuar artikullin.

10.2 Nëse gjendja e artikullit të siguar është e tillë që përmbajtja mund të jetë hequr, zyra do ta hapë automatikisht atë, kur kjo nuk është në kundërshtim me ligjet e shtetit, dhe do të kontrollojë përmbajtjen. Rezultati i këtij kontrolli do të jepen në një raport formal CN 24. Një kopje e këtij raporti do të bashkëngjitet me artikullin e siguar. Ky i fundit do të ripaketohet.

10.3 Në të gjitha këto raste, pesha e sendit të siguar në mbërritje dhe pesha pas ripaketimi do të kontrollohet dhe do të shënohet në ambalazhin e jashtëm. Ky shënim do të pasohet nga fjalët "Scellé d'office à ..." (Vulosur në ...) ose "Remballé à ..." (Ripaketuar në ...). Ky shënim do të plotësohet nga një vulë datare dhe nga nënshkrimi i nëpunësve të cilët kanë vendosur vulat ose kanë bërë ripaketimin.

11. Zbulimi i çfarëdolloj parregullsie gjatë verifikimit nuk do të shkaktojë në asnjë rast kthimin e një artikulli të përfshirë në dërgesën e ekzaminuar, me përjashtim të sa është parashikuar në nenin 15 të Konventës.

Neni RL 194 Shënimet e verifikimit

1. Parregullsitë e konstatuara pas kontrollit të plotë të dërgesës do t'i raportohen menjëherë zyrës së origjinës së dërgesës, me anë të një shënimi të verifikimit CN 43 të bërë në dy kopje. Kur është i përfshirë tranziti, shënim i verifikimit do të dërgohet në zyrën e fundit ndërmjetëse që ka transmetuar dërgesën në gjendje të keqe.

2. Detajet në shënimin e verifikimit do të specifikojnë sa më saktësisht të jetë e mundur, thasët, ambalazhet, pako ose artikujt në fjalë. Nëse dërgesa përmban sasi të mëdha të pajisura me etiketa CN 25 dhe CN 26, këto etiketa, në rast parregullsie, do të bashkëngjiten në shënimin e verifikimit. Në rast të parregullsisë të shërbimeve të cilat sjellin dyshime për të menduar humbje apo vjedhje, gjendja në të cilën është gjetur paketimi i dërgesës do të tregohet në shënimin e verifikimit me sa më shumë detaje të jetë e mundur.

3. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e pamundur për një arsye të caktuar, elementet e mëposhtme do të ruhen të paprekur për një periudhë prej gjashtë javësh nga data e verifikimit dhe do t'i dërgohen operatorit të caktuar të origjinës, nëse ky i fundit e kërkon këtë:

3.1 Thesi ose zarfi, me spangon, etiketat, dhe plumbat apo vulat e tjera të mbylljes;

3.2 Të gjitha pakot ose thasët e brendshëm dhe të jashtëm në të cilat ishin futur artikujt e siguar dhe artikujt rekomande.

3.3 Ambalazhimi i artikujve të dëmtuar i cili mund të merret nga marrësi.

4. Kur dërgesat transmetohen nëpërmjet ndërmjetësimit të një transportuesi, faturat CN 37, CN 38 ose CN 41 ku përmenden parregullsitë e vëna re nga ana e operatorit të caktuar ndërmjetës ose operatorit të caktuar të destinacionit gjatë marrjes së dërgesave, kur është e mundur, do të kundërfirmosen nga transportuesi ose përfaqësuesi i tij, si dhe nga operatori i caktuar i tranzitit ose i destinacionit që merr në

dorëzim dërgesat, i cili do të konfirmojë se nuk ka parregullsi. Nëse do të ketë ndonjë rezervë në lidhje me shërbimin e transportuesit, kopjet e faturave CN 37, CN 38 ose CN 41 duhet të tregojnë këto rezerva. Kur dërgesat transportohen në kontejnerë, këto rezerva do të lidhen vetëm me gjendjen e kontenierit, mbylljen dhe vulat e tij.

5. Në rastet e parashikuara në nenin RL 193.4, 5 dhe 8, zyra e origjinës dhe, sipas rastit, zyra e fundit ndërmjetëse e shkëmbimit, mund të njoftohen me anë të telekomunikacioneve me shpenzime të operatorit të caktuar që ia dërgon atë njoftim. Ky njoftim duhet të dërgohet sa herë që dërgesa tregon gjurmë të dukshme të ngacmimit, kështu që zyra e dërgimit ose ajo ndërmjetëse mund të hetojë çështjen pa vonesë. Kur është e nevojshme, zyra ndërmjetëse duhet të njoftojë operatorin e caktuar paraprirës me telekomunikacione për vazhdimin e hetimit.

6. Kur mungesa e një dërgese është rezultat i një humbjes së transportit të dërgesës ose nëse është shpjeguar në faturën e dërgimit, do të përgatitet një shënim verifikimi CN 43 vetëm nëse dërgesa nuk mbërrin në zyrën e destinacionit me postën vijuese.

7. Sapo dërgesa e raportuar si e humbur në zyrën e origjinës mbërrin në zyrën e fundit ndërmjetëse dhe, nëse është e përshtatshme, këtyre zyrave mund ti dërgohet një njoftim i dytë verifikimi që njofton për marrjen e dërgesës me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

8. Kur një zyrë marrëse përgjegjëse për kontrollin e një dërgese nuk i ka dërguar një shënim CN 43 që raporton parregullsi të çfarëdo lloji në zyrën e origjinës dhe, sipas rastit, të zyrës së fundit ndërmjetëse të shkëmbimit me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore), ajo do të të konsiderohet të ketë marrë postën dhe përmbajtjen e saj, derisa provohet e kundërta. I njëjti supozim do të bëhet në lidhje me parregullsi për të cilat nuk është bërë asnjë referencë ose të cilat janë raportuar të paplota në shënimin e verifikimit. E njëjta procedurë do të zbatohet kur dispozitat e këtij neni dhe të nenit RL 193 lidhur me formalitetet që duhet të përmbushen nuk janë respektuar.

9. Shënimet e verifikimit preferohet të dërgohen me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër të komunikimit elektronik. Nëse nuk e praktikueshme, këto shënime do të dërgohen me anë të rrugës më të shpejtë të postës (ajrore ose tokësore).

10. Shënimet e verifikimit e dërguara me postë do të dërgohen me zarfe që kanë me shkronja të dukshme shënimin "Bulletin de vérification" (Shënim i verifikimit). Këto zarfe mund të jenë të gatshme ose të shënohen me anë të vulave që të kenë treguesin të qartë.

11. Zyrat në të cilën janë dërguar shënimet e verifikimit do ti kthejnë ato sa më shpejt të jetë e mundur, mundësisht me mjete elektronike, në zyrën e shkëmbimit nga të cilat ato kanë ardhur, pasi i kanë shqyrtuar ato dhe kanë shprehur qartë vërejtjet e tyre, nëse ka. Shënimet e verifikimit do të konsiderohen të pranuar rregullisht derisa nuk provohet ndryshe:

11.1 Nëse ato nuk kanë marrë përgjigje brenda një periudhe prej një muaji që nga data e dërgimit të tyre;

11.2 Nëse operatori i caktuar i origjinës nuk është njoftur brenda kësaj kohe për ndonjë hetim i cili mund të jetë ende i nevojshëm ose të dërgesës shtesë të dokumenteve të nevojshme.

Neni RL 195 Artikuj të dërguar gabim

Artikujt e çfarëdo lloji që nuk janë postuar në vendin e duhur, do të ri-dërgohen në destinacionet e tyre pa asnjë vonesë dhe me rrugën më të shpejtë.

Neni RL 196 Masat që duhen marrë në rast aksidenti

1. Kur, si pasojë e një aksidenti gjatë transportit, një anije, tren, avion apo ndonjë strukturë tjetër e transportit nuk është në gjendje të vazhdojë udhëtimin e saj dhe të dorëzojë dërgesat në portet apo stacionet e planifikuara, ekuipazhi do të dorëzojë dërgesat në zyrën postare më të afërt me vendin e aksidentit apo në zyrën më të afër për të ri-dërguar postën. Nëse ekuipazhi nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ajo zyrë, e informuar për aksidentin, do të marrë masa të menjëhershme, duke marrë në dorëzim dërgesat dhe duke e ri-dërguar atë në destinacion me rrugën më të shpejtë, pasi gjendja e tij është kontrolluar dhe të gjitha sendet e dëmtuara janë rregulluar.



2. Operatori i caktuar e shtetit ku ka ndodhur aksidenti duhet të njoftojë me anë të telekomunikacionit të gjithë operatorët e caktuar të porteve apo stacioneve të mëparshme për gjendjen e dërgesave. Këto duhet të lajmërojnë më pas me të njëjtën rrugë të gjitha operatorët e caktuar të interesuar.

3. Operatori i caktuar i origjinës i cili ka dërgesa në mjetin e transportit të përfshirë në aksident, duhet të dorëzojë një kopje të faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41, operatorit të caktuar të shtetit ku ka ndodhur aksidenti.

4. Zyra e kualifikuar do të njoftojë zyrat e destinacionit të dërgesave të përfshira në aksident me anë të shënimit të verifikimit CN 43 duke dhënë detajet e rrethanave të aksidentit dhe rezultatet e kontrollit të dërgesave. Një kopje e shënimit të verifikimit do të dërgohet në zyrat e origjinës së dërgesave përkatëse dhe një tjetër për operatorin e caktuar të shtetit të cilit i përket shoqëria e transportit. Këto dokumente do të dërgohen me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

Neni RL 197

Hapat që duhen marrë në rast të fluturimit të ndërprerë, ose devijimit ose dërgimit të gabuar të postës ajrore

1. Kur një avion ndërpret fluturim e tij për një periudhë kohe që do të vonojë dërgesat ose kur, për çfarëdo arsye, dërgesat janë shkarkuar në një aeroport të ndryshëm nga ai i dhënë në faturat e dërgimit CN 38, shoqëria e fluturimit do të dorëzojë menjëherë këto dërgesa tek nëpunësit e operatorit të caktuar të shtetit ku është bërë ndalesa. Këta të fundit do të ridërgojnë ato me rrugën më të shpejtë (ajrore ose sipërfaqësore).

2. Operatori i caktuar i cili merr dërgesat të postës ajrore ose thasët e dërguar gabim për shkak të një gabim në etiketë duhet të bashkëlidhin një etiketë të re të dërgesës ose thesit, me një tregues të zyrës së origjinës, dhe do ta ri-dërgojë atë në destinacionin e tij të saktë.

3. Në çdo rast, zyra që ka bërë ri-dërgimin do të informojë zyrën e origjinës të secilës dërgesë ose thes me anë të një shënimi verifikimi CN 43, duke shënuar në mënyrë të veçantë në shënimin e verifikimit shërbimin ajror nga i cili është marr dërgesa, shërbimin e përdorur (ajror ose tokësor) për transportim të mëtejshëm në destinacionin e tij dhe arsyen e dërgimit të gabuar, të tillë si gabimi në transport ose etiketë.

Neni RL 198

Hapat që duhen marrë në rast të fluturimit të ndërprerë, ose të devijimit ose të dërgimit të gabuar të postës ajrore brenda vendit (S.A.L.)

1. Kur dërgesat e përfshira në një dërgesë ajrore brenda shtetit (SAL) janë në një fluturim që është ndërprerë ose janë shkarkuar në një aeroport të ndryshëm nga ai i treguar në faturën e dërgimit CN 41, procedura do të jetë si më poshtë:

1.1 Nëpunësit e operatorit të caktuar të shtetit ku dërgesat janë në tranzit do të marrin në ngarkim dhe do të ridërgojnë ato me rrugë tokësore nëse kushtet janë të tilla që dërgesa të mund të dërgohen menjëherë në shtetin e destinacionit. Operatori i caktuar i origjinës do të informohet me e-mail ose me ndonjë mjet tjetër të telekomunikacionit.

1.2 Nëse në shtetin e destinacionit nuk mund të sigurohet dërgesa e shpejtë me rrugë tokësore, operatori i caktuar i shtetit të tranzitit do të kontaktojë, me mjete të telekomunikacionit, me operatorin e caktuar të origjinës të dërgesës për të përcaktuar si do të ridërgohen këto në destinacionin e tyre dhe si do të llogaritet dhe shlyhet kompensimi për ridërgimin.

1.3 Operatori i caktuar i origjinës së shtetit të tranzitit do të bëjë një faturë të re të dorëzimit (CN 37, CN 38 ose CN 41, sipas kërkesës) dhe ridërgojë postën si është udhëzuar nga operatorin e caktuar i origjinës.

Neni RL 199

Hapat që duhen marrë në rast të pezullimit të përkohshëm dhe rifillimi i shërbimeve

1. Nëse shërbimet janë pezulluar përkohësisht, operatori i caktuar ose operatorët e caktuar të interesuar duhet të njoftohen për faktin me anë të telekomunikacionit, duke treguar nëse është e mundur, kohëzgjatjen e mundshme të pezullimit të shërbimit. E njëjta procedurë do të zbatohet për rifillimin e shërbimeve të pezulluara.

2. Byroja Ndërkombëtare duhet të njoftohet për pezullimin dhe rifillimin e shërbimeve nëse gjykohet së është i nevojshëm një njoftim i përgjithshëm. Nëse është e nevojshme, Byroja Ndërkombëtare do të njoftojë operatorët e caktuar me anë të telekomunikacionit.

3. Operatori i caktuar i origjinës do të ketë të drejtën ti kthejë dërguesit tarifat postare, tarifat e posaçme dhe pagesat shtesë të transportit ajror nëse, për shkak të pezullimit të shërbimeve, përfitimet që lindin nga transporti i artikullit në fjalë është marrë vetëm pjesërisht ose nuk është marrë.

Neni RL 200 Kthimi i thasëve bosh

1. Pronarët e thasëve bosh do të vendosin nëse ata dëshirojnë që thasët e tyre të kthehen ose jo dhe nëse po, me çfarë mënyre transporti. Megjithatë, operatori i caktuar i destinacionit do të ketë të drejtën të kthejë thasët që nuk mund të digjen lehtësisht dhe lirë në shtetin e tij. Operatori i caktuar i origjinës do të marrë përsipër koston e kthimit të këtyre thasëve.

2. Në mungesë të një marrëveshje midis operatorëve të caktuar të interesuar, thasët bosh do të kthehen me anë të postës së ardhshme në një dërgesë për shtetin të cilit i përkasin dhe nëse është e mundur me anë të linjës së zakonshme të ndjekur në udhëtimin e jashtëm. Numri i thasëve të kthyer me çdo dërgesë do të shënohet në tabelën 4 të faturës CN 31 (tabela 3 e faturës CN 32). Ky shënim do të bëhet kur dy operatorë të caktuar kanë rënë dakord të shënojnë në faturë vetëm thasët me etiketë të kuqe.

3. Operatorët e caktuar të origjinës mund të përgatisin postime të veçanta për thasët bosh. Megjithatë, përgatitja e postimeve të veçanta do të jetë e detyrueshme kur operatorët e caktuar të tranzitit ose të destinacionit e kërkojnë një gjë të tillë. Përgatitja e dërgesave të veçanta do të jetë e detyrueshme për thasët e kthyer me rrugë ajrore. Postimet e veçanta do të përshkruhen në faturën CN 31. Nëse nuk janë përgatitur postime të veçanta për thasët bosh që do të kthehen me rrugë tokësore, numri dhe pesha i thasëve bosh do të regjistrohet në kolonën e duhur të faturës CN 37.

4. Kthimi do të realizohet midis zyrave të shkëmbimit të emëruara për këtë qëllim. Operatorët e caktuar të interesuar mund të bien dakord midis tyre për procedurën e kthimit. Në shërbimin e distancave të mëdha, ata, si rregull i përgjithshëm, do të caktojnë vetëm një zyrë përgjegjëse për marrjen e thasëve bosh që u janë kthyer atyre.

5. Thasët bosh do të mbështillen në pako të përshtashme. Kur është e përshtatshme blloqet e etiketave, etiketat prej cope, pergamenat ose materiale të tjera të forta do të vendosen brenda thasëve.

6. Nëse nuk ka shumë prej tyre, thasët bosh që do të kthehen me rrugë tokësore mund të vendosen në thasët që përmbajnë artikuj të postës së letrave. Në të gjitha rastet kur thasët bosh janë kthyer me rrugë ajrore, ato do të vendosen në thasë të veçantë të etiketuar me emrin e zyrave të shkëmbimit. Këto thasë, me marrëveshje të përbashkët të operatorëve të caktuar, mund të vulosen. Etiketat do të kenë shënimin "Sacs vides" (Thasë bosh).

7. Thasët e përdorur për letrat e printuara për të njëjtin marrës në të njëjtën adresë (Thasë M) do të rimerren pasi janë dorëzuar te marrësi dhe do të kthehen, në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, tek operatorët e caktuar të shteteve që i përkasin.

8. Nëse kontrolli i bërë nga operatori i caktuar përcakton që thasët që i përkasin nuk janë kthyer në shërbimin e tij brenda një periudhë më të gjatë se ajo e kërkuar për transportin e tyre (rruga vajtje-ardhje), ai do të ketë të drejtë të kërkojë rimbursimin e vlerës së thasëve siç është parashikuar në pikën 9. Operatori i caktuar në fjalë mund të refuzojë këtë rimbursim vetëm nëse ai mund të provojë se thasët që mungojnë janë kthyer.

9. Çdo operator i caktuar për administrimin do të vendosë, në mënyrë periodike dhe uniforme për çdo lloj thesi të përdorur nga zyra e tij e shkëmbimit, një vlerë në SDR dhe do t'ia komunikojë atë operatorëve të caktuar të interesuar me anë të byrosë Ndërkombëtare. Në rast rimbursimi do të konsiderohet kostoja e zëvendësimit të thasëve.

10. Një operator i caktuar, me marrëveshje paraprake, mund të përdorë thasët që i përkasin operatorit të caktuar të destinacionit për përgatitjen e dërgesave të tij ajrore. Nuk mund të përdoren thasët që i përkasin një pale të tretë.

11. Dërgimi i thasëve bosh do të jetë subjekt i një pagese prej 30% të tarifave të aplikueshme të transitit për dërgesat e postës së letrave.



12. Një operator i caktuar dërgues mund të shënojë nëse do të dojë ose jo të ketë konteneirë të përdorur për një dërgesë të veçantë të kthyer. Ky shënim do të bëhet në faturat e përdorura për dërgesën.

13. Kontabiliteti për kthimin e thasëve bosh do të bazohet në Udhëzuesin e Statistikave dhe Kontabilitetit të përdorur nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Neni RL 201

Dërgesa të shkëmbyera me njësitë ushtarake

1. Operatorët e caktuar ndërmjetës do të informohen, nëse është e mundur paraprakisht, për krijimin e një shkëmbimi të postës së mbyllur siç përmendur në nenin 19 të Konventës.

2. Adresat e këtyre dërgesave do të shprehen si më poshtë vijon:

Nga zyra e

Për	{	Njësia (shtetësia) detare (ose ajrore) e (destinacioni i njësisë) në	}	(Shteti)
		anija (shtetësia) (emri i anijes) në		

ose

Nga njësia (shtetësia) detare (ose ajrore) e (destinacioni i njësisë) në	}	(Shteti)
Nga anija (Shtetësia) (emri i anijes) në		
Për zyrën e		

ose

Nga njësia (shtetësia) detare (ose ajrore) e (destinacioni i njësisë) në			}	(Shteti)
Nga anija (shtetësia) (emri i anijes) në				
Për	{	Njësia (shtesësia) detare (ose ajrore) e (destinacioni i njësisë) në	}	(Shteti)
		anija (shtetësia) (emri i anijes) në		

3. Dërgesat në fjalë do të dërgohen me linjën më të shpejtë (ajrore ose tokësore), në përputhje me shënimet që lexohen në adresë, dhe sipas të njëjtave kushte si postimet e shkëmbyera midis zyrave postare.

4. Kapiteni i anijes-postare që transporton dërgesa për njësitë detare ose një anije lufte do ti mbajë ato në dispozicion të oficerit komandant të njësisë detare ose anijes së destinacionit, nëse ky i fundit i kërkon dorëzim në det.

5. Nëse anijet nuk janë në vendin e destinacionit kur postimet që i adresohen atyre mbërrijnë atje, postimet do të mbahen në zyrën postare derisa ato të merren nga marrësi ose të ridërgohen në një pikë tjetër. Ridërgimi mund të kërkohej edhe nga operatori i caktuar i origjinës, nga oficeri komandant i njësisë detare ose anijes së destinacionit, ose nga një konsull i të njëjtit shtet.

6. Postimet që kanë të shënuar "Aux soins du Consul d'..." (në kujdes të Konsullit të ...) do të dorëzohen në konsullatën e treguar. Me kërkesë të konsullit ato mund të merren më pas mbrapsht në shërbimin postar dhe të ridërgohen në shtetin të origjinës ose në një adresë tjetër.

7. Dërgesat e adresuara në një anije lufte do të konsiderohen sikur të jenë në tranzit deri në momentin e dorëzimit të tyre të oficerit komandant i asaj anije, edhe kur ato janë adresuar që në fillim nën kujdesin e zyrës postare ose të një konsulli të ngarkuar për të vepruar si agjent dërgimi. Për këtë ato nuk do të konsiderohen si të kenë arritur adresën e tyre deri në momentin që janë dorëzuar në anijen e luftës në fjalë.

8. Me marrëveshje midis operatorëve të caktuar të interesuar, nëse është e nevojshme, do të zbatohet procedura e mësipërme, për shkëmbimet postare me njësitë ushtarake të vendosura në dispozicion të Kombeve të Bashkuara dhe me avionët ushtarakë.

KAPITULLI 10 CILËSIA E SHËRBIMIT

Neni RL 202 Objektivat e cilësisë së shërbimeve

1. Shtetet anëtare dhe /ose operatorët e caktuar do të angazhohen të verifikojnë në mënyrë periodike që afatet kohore të vendosura janë realizuar si brenda kuadrit të sondazhit të organizuar nga Byroja ndërkombëtare ose nga Sindikatat e Kufizuara, ose në bazë të një marrëveshje të dyanshme.

2. Gjithashtu, është e pëlqyeshme që shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar të verifikojnë në mënyrë periodike se janë respektuar afatet kohore, duke përdorur sisteme të tjera të kontrollit, në mënyrë të veçantë një kontroll të jashtëm të cilësisë.

3. Kur është e mundur, shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar do të zbatojnë sisteme të matjes së cilësisë për postën ndërkombëtare (dalëse dhe hyrëse); për sa është e mundur kjo do të përfshijë matjen nga postimi te dorëzimi (nga fillimi në fund).

4. Të gjithë shtetet anëtare do të japin në Byronë Ndërkombëtare informacion të përditësuar rreth kohëve të fundit të mbërritjes të transportit (LTAT) me të cilat ata operojnë për qëllimin e postës ndërkombëtare. Çdo ndryshim do të njoftohet sapo të jetë planifikuar, në mënyrë që të lejojnë Byronë Ndërkombëtare të komunikojë këto ndryshime tek operatorët e caktuar përpara se ato të zbatohen.

5. Kur është e mundur, do të jepen informacione të veçanta për qarkullimin e fluksit të trafikut me prioritet dhe jo prioritet.

KAPITULLI 11 TARIFAT E TRANSITIT DHE DETYRIMET PËRFUNDIMTARE

Neni RL 203 Tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

1. Tarifat e transitit

1.1 Llogaritja për tarifat e transitit të postës-sipërfaqësore dhe për tarifat e trajtimit të transitit të postës ajrore do të bëhet çdo vit nga operatori i caktuar i transitit, për çdo operator të caktuar të origjinës. Ajo do të bazohet në peshën e dërgesave të marra në transit, të dërguara në vitin në fjalë. Do të zbatohen tarifat e përcaktuara në nenin RL 205.

1.2 Tarifat e transitit dhe tarifat për përpunimin tranzit të postës ajrore do të jenë në ngarkim të operatorit të caktuar të origjinës së dërgesave. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara sipas nenit 1.4, ato do të jenë të pagueshme për operatorët e caktuar të shteteve në të cilat kanë kaluar ose shërbimi i të cilave ka marrë pjesë në transportin tokësor ose ajror të dërgesave.

1.3 Kur operatori i caktuar i shtetit që është kaluar nuk merr pjesë në transportin ajror ose tokësor të dërgesave, tarifat e zbatueshme të transitit do të jenë të pagueshme për operatorin e caktuar të destinacionit nëse ka kosto që lidhen me këtë transit.

1.4 Tarifat për transportin detar të postës në tranzit mund të shlyhen direkt midis operatorëve të caktuar të origjinës të postës dhe shoqërive detare ose agentëve të tyre. Operatorët e caktuar të portit të imbarkimit të interesuar do të japin paraprakisht marrëveshjen e tyre.

2. Detyrimet përfundimtare

2.1 Për artikujt e postës së letrave, me përjashtim të thasëve M, llogaritja për detyrimet përfundimtare do të jenë vjetore nga operatori i caktuar kreditor, në përputhje me peshën aktuale të postës dhe numrin aktual të artikujve të regjistruar dhe të artikujve të siguruar të marrë dhe, kur është e aplikueshme, të numri i artikujve të marrë gjatë vitit në fjalë. Do të zbatohen detyrimet e përcaktuara në nenet 29 dhe 30 të Konventës.

2.2 Për thasët M, llogaritja për detyrimet përfundimtare do të bëhen çdo vit nga operatori i caktuar kreditor, në bazë të peshës subjekt i detyrimeve përfundimtare në përputhje me kushtet e paraqitura në nenet 29 dhe 30 të Konventës.

2.3 Për të mundësuar peshën vjetore dhe numrin e artikujve që do të përcaktohen, operatorët e caktuar për administrimin e origjinës të postave në mënyrë të përhershme do shënojnë, për çdo postë:



- peshën e dërgesës (duke përfshatur thasët M);
- peshën e thasëve M që peshojnë më shumë se 5 kilogram;
- numrin e thasëve M që peshojnë më pak se 5 kilogram;
- numrin e artikujve të regjistruar të përfshirë në postë;
- numrin e artikujve të regjistruar të përfshirë në postë.

2.4 Në mungesë të një marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, në marrëdhënien midis dy shteteve në sistemin objektiv, numri i artikujve do të përcaktohet në përputhje me nenet RL 222 dhe RL 223.

2.5 Kur është e nevojshme të përcaktohet numri dhe pesha e artikujve të në sasi të mëdha, do të aplikohen ndryshimet e shënuara në nenin RL 182 për këtë kategori të postës.

2.6 Operatorët e caktuar të interesuar mund të bien dakord të llogarisin detyrimet përfundimtare në lidhjet e tyre reciproke me anë të mënyrave ndryshme statistikore. Ata gjithashtu mund të bien dakord për një periodicitet të ndryshëm nga ai i parqitur në nenin RL 224 për periudhat statistikore .

3. Çdo operator i caktuar do të jetë i autorizuar të paraqesë për vlerësim të komisionit të arbitrazhit çdo rezultat vjetor që sipas mendimit të tij ndryshon shumë nga realiteti. Arbitrazhi do të rregullohet sipas përcaktimeve të nenit 132 të Rregullores së Përgjithshme. Arbitrat do të jenë të autorizuar të caktojnë në një mënyrë të saktë dhe të arsyeshme tarifat e transitit ose detyrimet përfundimtare që duhet të paguhet.

4. Përfshirimi nga tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare

4.1 Artikujt e postës së letrave që lidhen me shërbimet postare të referuara në nenin RL 110.2 dhe artikujt postarë të pa dorëzuar të kthyer në origjinë në dërgesa të mbyllura do të përfshihen nga detyrimet përfundimtare. Dërgesat e kontenierëve bosh do të përfshihen nga detyrimet përfundimtare por jo nga tarifat e transitit që do të paguhet nga operatori i caktuar që zotëron kontenierët.

4.2 Artikujt IBRS do të përfshihen nga detyrimet përfundimtare.

A. Tarifat e Transitit

Neni RL 204

Zbatimi i tarifave të transitit

1. Në mungesë të një marrëveshje të veçantë, transportimi direkt detar midis dy shteteve me anë të anijeve të njërit prej tyre do të konsiderohen si shërbim i palës së tretë.

2. Transiti detar fillon kur dërgesat janë dorëzuar në shoqërinë e lundrimit të caktuar nga operatorët e caktuar dërgues dhe do të përfundojë kur dërgesat i janë dorëzuar operatorit të caktuar të destinacionit, ose kur operatori i caktuar i destinacionit ka dhënë urdhrin e dorëzimit ose çdo dokument tjetër që ka të bëjë me të, cili të jetë më i afërti. Tarifat e transitit detar, të pagueshme nga operatori i caktuar dërgues, do të përfshijnë të gjitha kostot që shkaktohen nga linja e lundrimit në portin e mbërritjes. Nëse operatori i caktuar i destinacionit duhet të paguajë tarifa për shërbimet e ndodhura para njoftimit, të tilla si tarifa të portit, taksa të kanalit, terminalit ose molit për shërbimet përkatëse dhe çdo tarifë tjetër e ngjashme për dorëzimin e dërgesave të kontenierit ose të dërgesave në sasi të mëdha, operatori i caktuar i destinacionit mund të marrë rimbursimin të këtyre tarifave shtesë nga operatori i caktuar dërgues. Megjithatë çdo kosto magazinimi që vjen pas njoftimit nga linja e lundrimit se dërgesat janë të disponueshme dhe fizikisht të aksesueshme për tu marrë, do të paguhet nga operatori i caktuar i destinacionit.

2.1 Pavarësisht nga dispozita e pikës 2, operatori i caktuar i destinacionit të dërgesave do të marrë nga operatori i caktuar i origjinës shumën që i korrespondon tarifave të magazinimit të portit, kur zyra e dërgimit dështon në dërgimin e një kopje të faturës CN 37 në kohë siç është parashikuar në nenin RL 190.1.5.

3. Kur një shërbim i jashtëm transporti kalon territorin e shtetit pa pjesëmarrjen e shërbimeve të këtij të fundit në përputhje me nenin RL 167, dërgesat e përcjella në këtë mënyrë nuk do të jenë subjekt i pagesës të tarifave të transitit tokësor.

3bis Një adresë kontakti aktuale e dërgesës detare, duke përfshirë adresën fizike, telefonin, faksin adresën e e-mailit do të mbahet në Listën e adresave të kryetarëve dhe zyrtarëve të lartë të administratave postare dhe Sindikatave të Kufizuara për të gjitha shtetet që dërgojnë dhe pranojnë dërgesa detare. Mund të

jetë e nevojshme të përfshihet dy adresa kur sektorë të ndryshëm brenda një operatori të caktuar merren me eksport dhe import. Kur është e mundur, çdo operator i caktuar do të japë një adresë e përgjithshme e-maili (p.sh. seamail@xxpost.com) për të shmangur devijimin e njoftimeve.

Neni RL 205 Tarifat e transitit

1. Tarifat e transitit që do të paguheshin nga operatori i caktuar i origjinës do të llogariten në bazë të komponentëve të mëposhtëm:

1.1 Një tarifë për përpunimin e dërgesave transit, që do të jetë 0.195 SDR për kilogram për postën ajrore dhe postën S.A.L, dhe 0.170 SDR për kilogram për vitin 2006, 0.180 SDR për kilogram për vitin 2007, 0.190 SDR për kilogram për vitin 2008 dhe 0.195 SDR për kilogram për vitin 2009 për postime tokësore.

1.2 Një tarifë të bazuar tek distanca, e cila do të jetë:

1.2.1 Për transitin ajror: tarifa bazë e transitit ajror e caktuar nga Këshilli i Operacioneve Postare duke përdorur formulën e nenit RL 237;

1.2.2 për transportimin tokësor:

1.2.2.1 0.200 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe për kilometër deri në 1,500 kilometra;

1.2.2.2 0.140 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe për kilometër shtesë deri në 5000 kilometra;

1.2.2.3 0.100 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe kilometra shtesë;

1.2.2.4 tarifa e bazuar në distancë llogaritet për hapa prej 100-kilometrash distancë, bazuar në vlerën mesatare të hapit;

1.2.3 për transportin detar:

1.2.3.1 0.070 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe milje detare (1.852 km) deri në 1,000 milje detare;

1.2.3.2 0.040 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe për milje detare shtesë deri në 2,000 milje detare;

1.2.3.3 0.034 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe milje detare shtesë deri në 4,000 milje detare;

1.2.3.4 0.022 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe milje detare shtesë deri në 10,000 milje detare;

1.2.3.5 0.015 të mijtave të SDR-së për kilogram dhe milje detare shtesë;

1.2.3.6 4 tarifa e bazuar në distancë llogaritet për hapa prej 100-milje detare distancë, bazuar në vlerën mesatare të hapit;.

Neni RL 206 Distanca kilometrike

1. Distanca e përdorur për të përcaktuar tarifat e transitit për distancat në tokë në përputhje me nenin RL 205.1.2 do të merren nga "Lista e Distancave Kilometrike që lidhen me sektorët tokësorë të dërgesave në transit" të publikuar nga Byroja Ndërkombëtare.

Neni RL 207 Shërbime të jashtëzakonshme. Transporti me shumë modalitete

1. Tarifat e transportit të përcaktuara në nenin RL 205 nuk do të aplikohen për transportet e shërbimeve të veçanta të përcaktuara ose të mbajtura nga operatori i caktuar me kërkesë të një ose më shumë operatorëve të caktuar. Kushtet e kësaj klase të transportit do të rregullohen me marrëveshje të përbashkët midis operatorëve të caktuar të interesuar.

2. Kur një operator i caktuar ka përcjellë dërgesat tokësore me transport të kombinuar tokësor dhe ajror, kushtet e këtij ridërgimi do të mbulohen nga një marrëveshje e veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar.

Neni RL 208 Llogaritja dhe kontabilizimi për tarifat e artikujve të dërguar gabim dhe artikujve në transit à découvert të dërguar me rrugë tokësore

1. Të përgjithshme

1.1 Çdo operator i caktuar që dërgon një artikull à découvert me rrugë tokësore do të ketë të drejtën



të marrë nga operatori i caktuar i origjinës pagesën për kostot që lindin dhe shtesat e detyrimeve përfundimtare që duhet ti paguhen operatorit të caktuar të destinacionit. Kostot e transportit dhe përpunimit do të llogariten, në parim, siç është përcaktuar në nenin RL 205, por në përputhje me peshën neto. Shtesa e detyrimeve përfundimtare do të llogariten në bazë të diferencës mesatare midis detyrimeve përfundimtare të marra nga operatori i caktuar i transitit dhe atyre të paguara nga operatori i caktuar i destinacionit. Tarifat e transitit do të caktohen në bazë të jo më shumë se 10 tarifave mesatare, secila e lidhur me një grup të shteteve të destinacionit dhe caktohet në përputhje me koston transportit dhe përpunimit si dhe shtesave të detyrimeve përfundimtare për destinacione të ndryshme brenda grupit. Shuma e këtyre detyrimeve do të shtohet me 10%.

1.2 Kontabilizimi për artikujt e transitit à découvert do të realizohen, në parim, në bazë të të dhënave të kthimeve statistikore, por nëse operatori i caktuar i transitit e kërkon, ai do të bazohet në peshën reale.

1.3 Kontabilizimi do të realizohet në bazë të peshës reale në rastin e artikujve të dërguar gabim dhe artikujve të postuar në bord të anijes ose të dërguar në intervale jo të rregullta ose në shuma shumë të ndryshme. Megjithatë ky kontabilizim do të bëhet vetëm nëse operatori i caktuar ndërmjetës kërkon të paguhet për shërbimin e ofruar të transportit. Për këtë qëllim formulari CN 65 do të përdoret nga operatori i caktuar ndërmjetës, i shoqëruar nga shënimi përkatës i verifikimit. Operatori i caktuar ndërmjetës gjithashtu mund të bjerë dakord me operatorin e caktuar të origjinës të bazojë në statistika kontabilizimin e artikujve të dërguar gabim.

2. Veprimet statistikore

2.1 Veprimet statistikore do të kryhen çdo vit dhe në mënyrë alternative gjatë Majit në vitet teke dhe Tetorit në vitet çifte.

2.2 Gjatë periudhës statistikore, artikujt në transit à découvert do të shoqërohen me faturat CN 65. Etiketa CN 26 e pakove dhe fatura CN 65 do të printohet në to me shkronjën "S". Kur nuk ka artikuj à découvert, rekomande ose jo, që do të përfshihen në postë që normalisht përmban artikuj të tillë, një ose dy fatura CN 65, si të jetë e nevojshme, të shënuara "Néant" (Bosh) do të shoqërojnë faturën e dërgesës.

2.3 Gjatë periudhës statistikore, të gjithë artikujt në transit à découvert do të vendosen me faturën CN 65 në thes të mbyllur, i cili mund të jetë prej plastike transparente, të vendosur në thesin që përmban faturën.

2.4 Çdo operator i caktuar që dërgon artikuj në transit à découvert do të informojë operatorët e caktuar për çdo ndryshim në dispozitat e paraqitura për shkëmbimin e këtyre dërgesave që ndodh gjatë një periudhe kontabël.

3. Përgatitja dhe kontrolli i faturave CN 65

3.1 Në faturat CN 65 peshat do të tregohen në mënyrë të ndarë për çdo grup të shteteve të destinacionit. Këto do të jenë renditur në mënyrë të veçantë në dy seri vijuese, një për artikujt e pa regjistruar dhe tjetra për artikujt rekomande. Numri i faturave CN 65 do të regjistrohet në artikujt korrespondues të tabelës të faturës CN 31 (tabela 3 e faturës CN 32). Operatorët e caktuar të transitit mund të kërkojnë përdorimin e një fature CN 65 që rendit në një rend të caktuar grupet më të rëndësishëm të shteteve. Të gjitha faturat CN 65 do të futen në thasët që kanë faturën CN 31.

3.2 Pesha e artikujve à découvert për çdo grup të shteteve do të rrumbullakoset në dekagramin më të afërt kur ndarja e dekagramit është e barabartë ose më të madhe se 5 gram; ajo do të rrumbullakoset në dekagramin më të afërt.

3.3 Nëse zyra ndërmjetëse përcakton se pesha reale e artikujve à découvert ndryshon me më shumë se 20 gram nga pesha e regjistruar, do të korrigjojë faturën CN 65 dhe do të njoftojë menjëherë zyrën e shkëmbimit dërguese për gabimin me anë të një shënimi verifikimi CN 43. Nëse mospërputhja e vërejtur është brenda kufijve të sipërpërmendur do të gjykohen të sakta regjistrimet e bëra nga zyra e dërgimit.

3.4 Në mungesë të faturës CN 65, në rastet e përshtatshme, do të përgatitet fatura CN 65 në mënyrë të zakonshme dhe zyrës së origjinës do ti bëhet me dije parregullsia me anë të shënimit CN 43.

4. Artikujt në transit à découvert për cilët llogaritet janë përgatitur në bazë të peshës reale

4.1 Nëse operatori i caktuar i transitit kërkon që tarifa për artikujt à découvert të llogaritet në bazë të peshës reale, dërgesat që përmbajnë artikuj të tillë do të shoqërohen nga faturat CN 65, që janë i bashkëlidhen faturës. E njëjta procedurë do të përdoret për artikujt në transit à découvert që janë përjashtuar nga veprimtaritë statistikore dhe për të cilat janë përgatitur llogari në bazë të peshës reale. Nëse pesha e artikujve të dërguar gabim me origjinë nga e njëjta zyrë shkëmbimi dhe të përfshira në një dërgesë nga ajo zyrë nuk kalojnë 50 gram, nuk do të përgatitet fatura CN 65 në përputhje me pikën 3.4.

4.2 Artikujt e postuar në bord të anijes në det të hapur, të parapaguar me anë të pullave postare të shtetit në flamurin e të cilit lundron anija ose në të cilin është regjistruar, do të shoqërohen me faturën CN 65 kur dorëzohen à découvert tek operatori i caktuar i një porti ndërmjetës. Nëse anija nuk ka një zyrë postare, artikujt do të shoqërohen me një situacion të peshës që do të shërbejë si bazë për operatorin e caktuar ndërmjetës për të kërkuar tarifat e transitit tokësor ose detar/ tarifat e transportit S.A.L.. Fatura CN 65 ose situacioni i peshës do të përfshijë peshën e artikujve për çdo shtet të destinacionit, datën dhe emrin dhe flamurin e anijes, dhe do të renditet në seri vjetore vijuese për çdo anije. Këto detaje do të kontrollohen nga zyra në të cilën anija dorëzon artikujt.

Neni e RL 209

Tarifat e transitit për dërgesat e devijuara ose të dërguara gabim

1. Operatorët e caktuar të transitit do të bëjnë maksimumin e tyre për drejtimin e dërgesave si është përcaktuar si nga operatori i caktuar dërgues. Nëse dërgesat janë devijuar ose janë dërguar gabim, tarifat e transitit do të paguhet nga operatorët e caktuar që marrin pjesë në transportin transit të këtyre dërgesave pa aplikuar nenin RL 234.7. Operatorët e caktuar të origjinës mund të kërkojnë rimbursim nga operatori i caktuar shërbimi i të cilit ka bërë gabimin në dërgesë.

Neni RL 210

Posta ajrore dhe S.A.L. në transit tokësor

1. Në mungesë të një marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, posta ajrore dhe S.A.L. të dërguara shpesh herë me rrugë tokësore për pjesë të udhëtimit të tyre në shtete të treta do të jenë subjekt të pagesave të tarifave të transitit.

2. Në rastin e referuar më sipër, tarifat e transitit do të llogariten në përputhje me peshën e tyre reale bruto të paraqitur në faturën e dërgimit CN 38 për postën ajrore dhe në faturën CN 41 dhe, sipas rastit, etiketën CN 36 për dërgesat S.A.L.

Neni RL 211

Pagesa të tarifave të transitit për transportin e thasëve bosh

1. Tarifat e transitit për thasët bosh, e llogaritur në bazë të nenit RL 205, do të paguhet nga operatori i caktuar që zotëron thasët.

2. Operatori i caktuar që kthen thasët bosh nuk do të ketë të drejtën e rimbursimit të kostove në shtetin e tij, nëse distanca mesatare e matur për transportin e thasëve bosh deri në kufijt e shtetit të tij nuk i kalon 300 km. Nëse distanca mesatare e matur i kalon 300 km do të paguhet tarifa e transportit për numrin e km mbi 300km, por jo tarifa e trajtimit.

3. Tarifa e transportit të pagueshme për transportin në shtetin që kthen thasët do të caktohet në formën e një çmimi të vetëm për kg. Ky çmim i vetëm do përfshijë tarifën e transportit brenda shtetit, midis zyrave të ndryshme të shkëmbimit dhe kufijve. Do të llogaritet në bazë të tarifave aktualisht të paguara për transportin e postës brenda shtetit të destinacionit, por pa kaluar tarifën e transportit të përcaktuar në nenin RL 205. Distanca mesatare e matur do të llogaritet nga Byroja Ndërkombëtare në terma të peshës bruto të thasëve bosh të dërgesave, të dërguara nga shteti i interesuar.

4. Operatorët e caktuar që kërkojnë rimbursim të kostos së transportit do të jenë të detyruara të komunikojnë Byrosë Ndërkombëtare deri më datë 1 Korrik të dhënat që nevojiten për llogaritjen distancës mesatare të matur dhe pagesat. Byroja Ndërkombëtare do të komunikojë distancën mesatare të matur dhe pagesat të gjithë operatorëve të caktuar deri më datë 1 Tetor dhe ato do të hyjnë në fuqi nga data 1 Janar e vitit vijues.

B. Detyrimet Përfundimtare. Dispozita të përgjithshme



Neni RL 212

Anëtarësimi vullnetar në sistemin objektiv me anë të sistemit të tranzicionit në shtetet anëtare

1. Për qëllimin e nenit 29, paragrafi 7 i Konventës, çdo shtet anëtar në sistemin e përkohshëm mund të deklarojnë hyrje vullnetare në sistemin objektiv. Operatori i caktuar i shtetit që dëshiron të anëtarësohet do ti dërgojë Byrosë Ndërkombëtare një deklaratë zyrtare për këtë efekt, jo më vonë se data 1 Qershor i vitit paraardhës se ai dëshiron të bashkohet me sistemin objektiv. Byroja Ndërkombëtare do të njoftojë shtetet e sistemit objektiv brenda 30 ditëve nga marrja e deklaratës.

2. Në deklaratën e tij, operatori i caktuar i shtetit hyrës do të marrë përsipër të realizojë të gjitha statistikatat, llogaritjet dhe veprime të tjera të përfshira në pjesëmarrjen në sistemin objektiv me efekt nga 1 Janar i vitit pasardhës.

3. Para dërgimit të deklaratës së tij, ose gjatë përgatitjes së saj, operatori i caktuar që dëshiron të anëtarësohet do ti dërgojë Byrosë Ndërkombëtare tarifën për letër prioritare 20 – gram në efekt të shërbimit të tij të brendshëm. Përpara datës 1 Korrik të vitit anëtarësimit, Byroja Ndërkombëtare do të informojë shtetet e sistemit objektiv dhe operatorin e caktuar të shtetit hyrës për tarifatat për artikull dhe për kilogram të pagueshme për shtetet hyrëse me efekt nga 1 Janari i vitit pasardhës.

4. Të gjitha dispozitat e lidhura me sistemin objektiv, duke përfshirë periudhën e njoftimit për tarifën e letrës prioritare prej 20-gram në shërbimin e brendshëm, do të zbatohen në shtetin e anëtarësuar nga data 1 Janar e vitit në të cilin anëtarësimi në sistemin objektiv ka hyrë në fuqi.

Neni RL 213

Aksesi i drejtpërdrejtë në shërbimet e brendshme

1. Të gjithë operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve do ti komunikojnë Byrosë Ndërkombëtare kushtet e aplikueshme për akses direkt si në sistemin e tyre të brendshëm, duke përfshirë të dhënat për personat e kontaktit (Manaxherë të Llogarive kyç), shërbimet, produktet dhe tarifa, kërkesat operacionale dhe financiare gjithashtu si linket në Internet që ofrojnë një informacion të mëtejshëm. Operatorët e caktuar do të kujdesen që të gjitha ndryshimet lidhur me tarifatat ose çështjet e tjera që kanë ndikim në aksesin e drejtpërdrejtë ti komunikohen Byrosë Ndërkombëtare para se të hyjnë në fuqi.

2. Lidhur me informacionet e dhëna, Byroja Ndërkombëtare publikon një Bazë e të Dhënash të Aksesit Direkt, në faqen e internetit të UPU dhe do t'ia dërgojë ato operatorëve të caktuar pjesëmarrës në CD-ROM. Byroja ndërkombëtare do të përditësojë bazën e të dhënave në mënyrë sistematike. Gjithashtu Byroja Ndërkombëtare do të verë në dispozicion të pjesëmarrësve një guidë operacionale.

2 bis Operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve që anëtarësohen në sistemin objektiv nga 2010 ose 2012 do të njoftojnë Byronë Ndërkombëtare nëse ata do të zgjedhin ose jo të japin disponibilitetin për akses direkt për të gjithë operatorët e caktuar sipas përcaktimeve të nenit 28.4.3 të Konventës. Një operator i caktuar që zgjedh një periudhë prove dy vjeçare, në fund të kësaj periudhe, do të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për vendimin të saj për të bërë disponibël aksesin e drejtpërdrejtë për të gjithë operatorët e tjerë të caktuar, pa asnjë lloj diskriminimi ose për ta ndërprerë atë. Byroja ndërkombëtare duhet të jetë i informuar për çdo kërkesë për akses të drejtpërdrejtë nga operatori i caktuar i një shteti të ri objektiv për një operator caktuar të një shteti objektiv. Në mbështetje të nenit 28.4.3, kjo nënkupton detyrimin e disponibilitetit për akses të drejtpërdrejtë të gjithë operatorëve të caktuar. Byroja Ndërkombëtare do të përditësojë bazën e të dhënave të aksesit të drejtpërdrejtë në përputhje me rrethanat.

2 ter Operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin e tranzicionit do të njoftojnë Byronë Ndërkombëtare nëse ata do të bëjnë ose jo aktive aksesin direkt për operatorë të tjerë të caktuar, si është parashikuar në nenin 28.4.4 të Konventës. Një operator i caktuar që zgjedh një periudhë prove dy vjeçare, në fund të kësaj periudhe, do të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për vendimin të saj për të bërë disponibël aksesin e drejtpërdrejtë për të gjithë operatorët e tjerë të caktuar, pa asnjë lloj diskriminimi ose për ta ndërprerë atë. Byroja Ndërkombëtare do të përditësojë bazën e të dhënave të aksesit të drejtpërdrejtë në përputhje me rrethanat.

3. Operatori i caktuar që dëshiron të përfitojë nga aksesin direkt i ofruar nga një operator i caktuar tjetër duhet të kontaktojë këtë të fundit lidhur me informacionet e nevojshme të reja si dhe të shqyrtojë së

bashku çështjet që kanë mbetur pezull më përpara fillimit të shërbimit.

Neni RL 214

Llogaritja e çmimeve të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për shtetet dhe territoret që zbatojnë nenin 29.2 deri 4 të Konventës.

1. Pagesa e detyrimeve përfundimtare ndërmjet shteteve anëtare të sistemit objektiv bazohet mbi taksën e një letre prej 20 gramë të shërbimit të brendshëm, sipas dispozitave të nenit RL 128, në fuqi që nga 1 qershor të vitit paraardhës të vitit kur janë zbatuar detyrimet përfundimtare. Në parim do të merret si bazë shërbimi prioritar. Tarifa e mësipërme do të përdoret për llogaritjen e detyrimeve përfundimtare për shtetet dhe territoret që aplikojnë dispozitat e nenit 29.2 deri 4 të Konventës.

2. Në bazë të kësaj tarife, të shprehur në monedhën vendase, e cila do ti njoftohet Byrosë Ndërkombëtare jo më vonë se data 1 qershor, Byroja Ndërkombëtare do të transformojë për çdo vit vlerën e caktuar të çmimit për dërgesë dhe të çmimit për kilogram, të deklaruar në SDR. Për të përlllogaritur çmimet në SDR, Byroja Ndërkombëtare përdor kursin mesatar të këmbimeve mujore të periudhës nga 1 Janari deri 31 Maj të vitit para vitit të referencës së detyrimeve përfundimtare. Çmimet përfundimtare do të bëhen të ditura me anë të qarkores jo më vonë se 1 korriku.

3. Nëse Byrosë ndërkombëtare nuk i është komunikuar asnjë tarifë deri më 1 qershor atëhere operatori i caktuar do të zbatojë tarifën që është përdorur në vitin paraardhës. Nëse llogaritja bëhet për herë të parë për operatorin e caktuar në fjalë, atëhere zbatohen tarifat e përcaktuara në nenin 29. 4 të Konventës.

4. Pavarësisht dispozitave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, Byroja Ndërkombëtare duhet të informohet nga operatorët e caktuar në rast të zvogëlimit të tarifës për letrën prej 20 gram në sistemit të brendshëm.

5. Çmimet e reja të llogaritura në bazë të këtij neni do të hyjë në fuqi më 1 Janar dhe vazhdon të jenë në fuqi përgjatë gjithë vitit.

Neni RL 215

Cilësia e shërbimeve të lidhura me pagesat e detyrimeve përfundimtare midis operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin objektiv

1. Shpërblimi i detyrimeve përfundimtare midis operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin objektiv do të bazohet në cilësinë e shërbimit të operatorëve të caktuar të në territorit të destinacionit.

2. Pjesëmarrja në sistemin e rënë dakord të UPU-t për matjen e cilësisë së shërbimit të lëvizjes në hyrje në shtetin e destinacionit, për lidhjet midis detyrimeve përfundimtare dhe cilësisë së shërbimit, është vullnetar. Nëse operatori i caktuar i shtetit ose territorit të origjinës nuk merr pjesë në përcaktimin e fluksit postar në dalje, operatori i caktuar i shtetit ose territorit pritës ka të drejtë sipas rregullores së përcaktimit të detyrimeve përfundimtare në funksion të cilësisë së shërbimeve, e cila nuk mund të përlllogaritet në vlerë më të vogël se 100 % të bazës të detyrimeve përfundimtare (çmimi i detyrimeve përfundimtare pa ndonjë incentiv ose rregullim për cilësinë e shërbimit të performancës). Nëse një operator i caktuar i shtetit ose territorit të destinacionit nuk vendos një sistem UPU të rënë dakord për matjen e cilësisë së shërbimit për fluksin në hyrje, ai do të marrë 100 % të detyrimeve bazë përfundimtare.

3. Operatorët e caktuar që marrin pjesë në sistemin e matjes UPU të rënë dakord për cilësinë e shërbimit për lidhjen midis detyrimeve përfundimtare dhe cilësisë së shërbimit do të marrë, si incentiv, një rritje të detyrimeve përfundimtare prej 2.5% për të gjithë fluksin të postës së letrave hyrëse. Nëse cilësia e shërbimeve ka arritur objektivat për vitin kalendarik përkatës, operatorët e caktuar të interesuara përfitojnë një rritje shtesë prej 2.5%.

4. Subjekt i tarifave minimale të caktuara në nenet 29.4 dhe 29.5 të Konventës, operatorët e caktuar do të jenë subjekt i penalitetit nëse nuk është arritur objektivi i përcaktuar në lidhje me shërbimin. Ky penalitet luhet nga 1/3 të shpërblimit të detyrimeve përfundimtare për çdo përqindje më të ulët se objektivi i performancës. Penaliteti në asnjë rast nuk mund të kalojë vlerën prej 5%. Për shkak të incentivit për pjesëmarrje prej 2.5%, penaliteti maksimal nuk do të çojë në shpërblime më të vogla se 97.5 % të tarifës bazë të detyrimeve përfundimtare.

4 bis Cilësia e përkohshme në lidhje me çmimet e detyrimeve përfundimtare do të llogaritet nga



Byroja Ndërkombëtare dhe njoftohet me qarkore jo më vonë se 1 korriku të çdo viti. Çmimet e përkohshme do të hyjnë në fuqi më 1 janar të vitit të ardhshëm dhe do të mbeten në fuqi të gjithë për vitin kalendarik. Çmimet e përkohshme të detyrimeve përfundimtare do të llogariten në përputhje me nenin RL 214, por, përveç kësaj, do të përfshijnë një incentiv dhe një rregullim të bazuar në cilësinë e shërbimeve që rezulton për vitin kalendarik të mëparshëm.

4 ter Cilësia përfundimtare e shërbimit e lidhur me detyrimet përfundimtare do të llogaritet nga Byroja Ndërkombëtare duke ndjekur publikimin e rezultatit të cilësisë përfundimtare të shërbimit për vitin kalendarik në fjalë. Cilësia përfundimtare e shërbimit e lidhur me çmimet e detyrimeve përfundimtare do të njoftohet me qarkore të Byrosë Ndërkombëtare jo më vonë se 1 Maji i vitit që pason vitin kalendarik në fjalë dhe do të zëvendësojë çmimet e përkohshme të detyrimeve përfundimtare të lëshuara më parë për atë vit kalendarik.

4quater Operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve që anëtarësohen në sistemin objektiv në 2010 dhe në 2012 do të aplikojnë dispozitat e nenit 28.6 të Konventës dhe paragrafet nga 1 deri në 4 të mësipërme jo më vonë se viti i tretë pas anëtarësimit në sistemin objektiv. Gjatë dy viteve të para pas anëtarësimit në sistemin objektiv, ata mund të përfitojnë nga marrëveshjet e mëposhtme të tranzicionit:

a) Ata mund të vendosin të mos aplikojnë dispozitat e nenit 28.6 të Konventës dhe paragrafët nga 1 deri në 4 të mësipërm, që nënkupton se ata mund të vendosin të mos marrin pjesë në një sistem të matjes së cilësisë së shërbimit. Ky vendim nuk do të ketë efekt në çmimet që ata do të marrin dhe do të paguajnë për detyrimet përfundimtare.

b) ata mund të vendosin të marrin pjesë në sistemin e UPU për matjen e cilësisë të rënë dakord pa efekt në çmimet që ata do të paguajnë dhe marrin për detyrimet përfundimtare.

c) ata mund të vendosin të aplikojnë dispozitat e nenit 28.6 të Konventës dhe të paragrafeve nga 1 deri në 4 të mësipërm që lidhen incentivët dhe penalitetet, edhe që nga viti i parë ose i dytë pas anëtarësimit në sistemin objektiv.

4quinqies Këshilli i Operacioneve Postare do të caktojë standardet vjetore të cilësisë së shërbimit dhe objektivat e bazuara në standartet e aplikuara në shërbimin e brendshëm në lidhje me artikuj dhe kushte të krahasueshme.

Neni RL 216

Cilësia e shërbimeve e lidhur me pagesat e detyrimeve përfundimtare të aplikueshme për fluksin e postës për, nga dhe midis operatorëve të caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin e tranzicionit

1. Operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin e tranzicionit mund të zgjedhin të bazojnë shpërblimet e detyrimeve të tyre përfundimtare në performancën e cilësisë së shërbimit dhe të marrin pjesë në një sistem matje të rënë dakord me UPU për cilësinë e shërbimit. Do të aplikohen dispozitat e nenit RL 215. Megjithatë detyrimet përfundimtare të pagueshme për postën për dhe nga këto shtete dhe territore nuk do të jenë më të ulëta se çmimet e detyrimeve përfundimtare në nenet 30.1 30.2 ose 30.3 të Konventës.

1bis Operatorët e caktuar të shteteve dhe territoreve në sistemin e tranzicionit mund të marrin pjesë në një sistem të matjes të rënë dakord me UPU për cilësinë e shërbimit, pa qenë i detyruar të zbatojë dispozitat e neneve RL 215.2 deri në 4, në lidhje me incentivët dhe penalitetet.

Neni RL 217

Mekanizmat e rishikimit të çmimeve të detyrimeve përfundimtare

1. Një operator i caktuar që dërgon ose merr flukes më të larta se 100 ton të postës në vit (me përjashtim të thasëve M) mund të kërkojë nga operatori i caktuar përkatës zbatimin e mekanizmit të rishikimit të përshkruar më poshtë për të përcaktuar çmimin e ri të detyrimeve përfundimtare të përshtatshëm për trafikun e tyre. Kjo kërkesë mund të bëhet në çdo kohë gjatë vitit subjekt të kushteve të mëposhtme:

1.1 kur një operator i caktuar në sistemin objektiv përcakton se numri mesatar i artikujve të marra nga një operator i caktuar në sistemin e tranzicionit është më i lartë se 17;

1.2 kur një operator i caktuar në sistemin e tranzicionit përcakton se numri mesatar i artikujve të dërguara për çdo operator të caktuar është më i ulët sesa 12;

1.2.1 nëse operator i caktuar në sistemin e tranzicionit kërkon zbatimin e mekanizmit të rishikimit

sipas pikës 1.2 për një fluks ndaj një operatori të caktuar në sistemin objektiv, ky i fundit mund të kërkojë zbatimin e mekanizmit edhe në drejtim të kundërt, kur kushtet e tjera për rishikim në rënie janë plotësuar;

1.3 kur një operator i caktuar në sistemin e tranzicionit përcakton se numri mesatar i artikujve të marra nga një operator tjetër i caktuar është më i lartë se 17;

1.4 kur një operator i caktuar kërkon zbatimin e mekanizmit të rishikimit për një fluks prej më shumë se 100 ton në vit, operatori i caktuar përkatës mund të bëjë të njëjtën gjë edhe në qoftë se fluksi në drejtimin tjetër është më i ulët se 100 ton në vit, kur janë plotësuar kushtet e tjera për rishikimin për më lart ose më poshtë.

1.4bis kur një operator i caktuar përcakton se numri mesatar i artikujve (IPK) të marra ose të dërguara operatorit tjetër të caktuar ka ndryshuar me më shumë se 20 për qind nga IPK fillestare e përdorur të vendosë një çmim të rishikuar për kilogram në bazë të një zbatimi të mëparshëm të mekanizmit të rishikimit.

2. Mekanizmi i rishikimit do të konsistojë në kryerjen e një llogarie të veçantë statistikore për të llogaritur numrin mesatar të artikujve për kilogram, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet RL 224 dhe 226.

3. Operatori i caktuar që ka qëllim të zbatojë mekanizmin e rishikimit do të njoftojë operatorin e caktuar përkatës të paktën tre muaj më parë.

4. Kërkesa duhet të mbështetet nga të dhëna statistikore që tregojnë se numri mesatar i artikujve për kilogram të fluksit në fjalë devijon nga mesatarja botërore. Këto të dhëna statistikore duhet të merren me kampione të paktën gjashtë vëzhgime në ditë për një periudhë një mujore.

5. Në respektim të afatit të parashikuar në pikën 3, periudha statistikore fillon në fillim të një periudhe kontabël tre mujore. Çmimi i ri fillon të zbatohet duke filluar nga ky moment dhe mbetet në fuqi të paktën gjatë një viti dhe deri në një kërkesë për rishikim të ri nga një nga operatorët e caktuar të interesuar sipas kushteve të nenit 30 të Konventës.

6. Nëse rezultatet e llogarisë statistikore konfirmojnë konstatimet e operatorit të caktuar që kërkon mekanizmin e rishikimit, ky i fundit do të ketë të drejtë të zbatojë çmimet e reja të detyrimeve përfundimtare për trafikun në fjalë, të llogaritur në SDR siç vijon: çmimi për kilogram = (numri mesatar i artikujve për kg x çmimin për njësi të dhënë në nenin 30.2) + çmimin për kilogramë të dhënë në nenin 30.2.

7. Në rastet kur numri mesatar i artikujve për kilogram që rezultojnë nga ky rishikim bie ndërmjet 12 dhe 17, për trafikun në fjalë do të zbatohet çmimi e parashikuar në nenin 30.3 të Konventës. Përveç kësaj, marrja e kampioneve për artikujt për kilogram do të pushojë nëse numri mesatar i artikujve për kilogram bie ndërmjet 12 dhe 17, për aq kohë sa kushtet e marrjes së kampioneve bëhen të kënaqshme dhe riaktivizohet marrja e mostrave.

Neni RL 219

Kërkesa për pagesa specifike për dërgesat në sasi të mëdha

1. Operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i autorizuar të kërkojë zbatimin e pagesës së veçantë në postën me sasi të mëdha kur ai konstaton:

1.1 Marrjen, në të njëjtën dërgesë, ose në një ditë kur përgatiten disa dërgesa në ditë, të 1500 ose më shumë artikujve të postuara nga i njëjti dërgues.

1.2 Marrjen, në një periudhë dy javore, të 5000 ose më shumë artikujve të postuar nga i njëjti dërgues.

2. Operatori i caktuar i destinacionit që dëshiron të aplikojë pagesën specifike të postës në sasi të mëdha do të njoftojë operatorin e caktuar të origjinës brenda dy javësh nga marrja e saj e parë e postës në sasi të mëdha. Ky njoftim duhet të dërgohet me faks ose në mënyrë elektronike në adresën e posaçme të parashikuar në nenin RL 233 dhe duhet të përmbajë numrin e dërgesës, datën e dërgimit, zyrën e origjinës të shkëmbimit, zyrën e destinacionit të shkëmbimit dhe një fotokopje të një kampioni të pjesëve të postës në fjalë.

2.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 3 dhe 4, pagesa e veçantë nuk do të hyjë në fuqi deri në tre muaj nga dita e pranimit të një njoftimi të tillë nga operatori i caktuar i destinacionit. Kjo pagesë specifike do të zbatohet vetëm për dërgesat në sasi të dërguara pas përfundimit të periudhës së njoftimit prej tre muajsh.



2.2 Marrja e postës me sasi të mëdha e parashikuar në pikën 2. 1 duhet të konstatohet nga operatori i caktuar i destinacionit në përputhje me dispozitat e nenit RL 193.6.

3. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 2.1, operatori i caktuar i destinacionit ka të drejtë të zbatojë, me efekt të menjëhershëm, pagesën e veçantë për postën me sasi të mëdha kur ai konstaton:

3.1 Marrjen, në të njëjtën dërgesë, ose në një ditë kur përgatiten disa dërgesa në ditë, të 3000 ose më shumë artikujve të postuara nga i njëjti dërgues.

3.2 Marrjen, në një periudhë dy javore, të 10000 ose më shumë artikujve të postuar nga i njëjti dërgues.

4. Operatori i caktuar i destinacionit që dëshiron të aplikojë pagesën specifike të postës në sasi, me efekt të menjëhershëm do të njoftojë operatorin e caktuar të origjinës brenda tri ditëve pune nga marrja e postës në sasi. Ky njoftim do të jetë në formën e një shënimi të verifikimit duke specifikuar numrin e dërgesës, datën e dërgimit, zyrën e origjinës të shkëmbimit, zyrën e destinacionit të shkëmbimit dhe një fotokopje të një kampini nga pjesët e postës në fjalë, të dërguar me faks ose në mënyrë elektronike në adresën e veçantë të parashikuar në nenin RL 233.

5. Kur operatori i caktuar i destinacionit ka kërkuar pagesën e veçantë për postën në sasi, operatori i caktuar i origjinës brenda tre muajve mund të kërkojë zbatimin e kësaj pagese të veçantë tek të gjitha postat në sasi që do t'i dërgojë këtij operatori të caktuar, me përjashtim të rastit kur kërkesa origjinale e operatorit të caktuar të destinacionit është tërhequr.

6. Ndërprerja e pagesës së veçantë për postën në sasi të parashikuar në pikën 5 duhet të njoftohet nga operatori i caktuar i origjinës tre muaj përpara ndërprerjes ose vendimit me marrëveshje të përbashkët.

Neni RL 220

Dërgesa të mbyllura të shkëmbyera me njësitë ushtarake

1. Do të jetë përgjegjësi e operatorëve të caktuar të shteteve të cilave i përkasin këto njësi ushtarake, anije lufte apo avionë ushtarak të shlyejnë direkt me operatorët e caktuar të përfshira tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare që rrjedhin nga dërgesat e dërguara nga këto njësi ushtarake, anije apo avionë.

2. Nëse këto dërgesa janë ri-adresuar, operatori i caktuar ridërgues do të njoftojë operatorin e caktuar të shtetit të cilit i përkasin këto njësi ushtarake, anije apo avionë.

C. Shembuj të operacioneve

Neni RL 221

Parimet e përgjithshme për kampionët statistikorë dhe vlerësimin e numrit mesatar të artikujve për kilogram

1. Parimet e mëposhtme do të zbatohen për të gjitha llojet e kampioneve të flukseve të postës që janë të nevojshme për qëllime të pagesës së detyrimeve përfundimtare të bazuara në tarifat për artikull dhe për kilogram (p.sh. marrja e kampioneve në lidhje me mekanizmin e rishikimit, shkëmbimet midis operatorëve të caktuar në sistemin objektiv).

1.1 Si kampionet dhe vlerësimi i numrit mesatar të dërgesave për kilogram duhet të pasqyrojnë përbërjen e dërgesës. Duke qenë se kjo përbërje ndryshon sipas mënyrës së transportit, llojit të kontenierit, periudhës së vitit (muaji) dhe ditës së javës, kampioni i dërgesës duhet të pasqyrojë ndryshimet dhe të paraqesë, sa më saktë të jetë e mundur, tërësinë e flukseve të postës. Në mënyrë të ngjashme, metoda e vlerësimit duhet të pasqyrojë këto ndryshime.

1.2 Programi i kampioneve statistikore duhet të projektohet për të arritur një saktësi statistike prej $\pm 5\%$, me siguri 95 % dhe në vlerësimin e IPK të numrit mesatar të artikujve për kilogram dhe numrit të artikujve të shkëmbyer ndërmjet operatorëve të caktuar.

1.2.1 Kjo shkallë saktësie statistike përcakton një qëllim që të gjithë operatorët e caktuar që kryejnë marrje kampionësh të përpiqen të arrijnë nëpërmjet metodave të tyre. Ai nuk përcakton një kërkesë minimale të saktësisë.

1.3 Projekti i programit të kampioneve, përzgjedhja e kampioneve, metoda e grumbullimit të të dhënave dhe procesi i vlerësimit duhet të jenë në përputhje me parimet përgjithësisht të pranuar nga statistika matematikore, teoria e probabilitetit të kampioneve dhe projekti i studimeve statistike.

1.4 Brenda kufizimeve të këtyre parimeve, çdo operator i caktuar ka fleksibilitet të mjaftueshëm për

të përshtatur hartimin e programit të saj të kampionëve për atributet e fluksit të saj të postës dhe kufizimeve burimeve të saj. Megjithatë, çdo operator i caktuar duhet të njoftojë operatorin e caktuar përkatës për vendimet e tij të projektimit, duke përfshirë qasjen e vlerësimit, para të periudhës së vëzhgimit.

Neni RL 222

Njehsime statistikore për shkëmbimet e dërgesave midis shteteve anëtare në sistemin objektiv

1. Për shkëmbime të dërgesave ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv duhet të kryhet një njehsim statistikor. Megjithatë, për të shmangur kostot e kampioneve për shkëmbime të vogla, numri mesatar i artikujve për kilogram ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv do të zbatohet për flukset e postës nën një prag të caktuar, me përjashtim të rastit kur një ose të dyja shtetet anëtare të interesuara këmbëngulin në marrjen e kampionëve për të ditur numrin e saktë të artikujve për kilogram në njërën ose të dyja drejtimet. POC do të vendosë prapun dhe numrin mesatar të artikujve për kilogram që do të aplikohet.

2. Njehsimi statistikor duhet të përputhet me parimet e parashtruara në nenin RL 221. Ditët e vëzhgimit do të përhapen në mënyrë sa më uniforme të jetë e mundur gjatë ditëve të punës të javës (do të merren në konsideratë vetëm ditët e punës së zyrës së shkëmbimit të interesuar) dhe do të reflektojnë mënyrat e transportit të përdorura për fluksin e postës në tërësi. Njehsimi statistikor do të përbëhet nga të paktën 48 ditë vëzhgim në vit të kampionëve me katër ditë për muaj. Brenda një dite të vëzhgimit, operatorët e caktuar mund të përdorë nën-kampionët, nëse nuk është e mundur për të kryer një njehsim të plotë të të gjithë postës të marrë gjatë ditës në fjalë.

2.1 Si alternativë për marrjen e kampionëve në një grup të caktuar të ditëve, operatorët e caktuar mund të përdorin marrjen e vazhdueshme të kampionëve, në të cilën një zgjidhet një marrje sistematike e kampionëve të kontenierëve për testimin e të gjithë periudhës së vëzhgimit. Operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakord për format statistikore të përdorura.

3. Vlerësimi i numrit vjetor të artikujve

3.1 Numri vjetor i dërgesave korrespondon me mesataren e ponderuar të numrave të artikujve të vlerësuar veçmas për çdo mënyrë transporti dhe muaj ose tremujor. Llogaritjet do të kryhen si më poshtë:

3.1.1 Numri vjetor i artikujve për kilogram të marrë nga kampionët për një mënyrë të dhënë të transportit, gjatë një muaji ose një tremujori të dhënë shumëzohet me peshën e përgjithshme të postës së dërguar për këtë lloj transporti gjatë muajit ose tremujorit në fjalë, duke pasur si qëllim të vlerësojnë numrin e përgjithshëm të dërgesave për mënyrën e transportit dhe muajin apo tremujorin e marrë në konsideratë.

3.1.2 Vlerësimet e numrit të përgjithshëm të dërgesave për çdo mënyrë transporti dhe çdo muaj apo çdo tremujor do të mbledhen së bashku për të përcaktuar numrin vjetor të vlerësuar të dërgesave.

3.1.3 Për marrjen e vazhdueshme të kampionëve, në kuadrin e procedurës në pikën 3.1 dhe 3.1.2, operatorët e caktuar mund të zevendësojnë muajin ose tremujorin me ditën.

4. Çdo operator i caktuar duhet të lajmërojë operatorin e caktuar përkatës në lidhje me projektin e programit të të tij të kampionëve, mbi të gjitha për sa i përket metodës së zgjedhur të vlerësimit, të paktën dy muaj përpara periudhës së vëzhgimit. Megjithatë, operatori i caktuar marrës nuk është i detyruar të njoftojë paraprakisht operatorin e caktuar dërgues ditët e vëzhgimit apo kontenierët e zgjedhur si kampionë.

4bis Kur nuk është kryer marrja e kampionëve për kilogram ose rezultatet nuk janë bërë të njohur brenda pesë muajve pas përfundimit të tremujorit të katërt, operatori tjetër i caktuar do të ketë të drejtë të paraqesë rezultatet e veta të kampionëve për të dhënat që mungojnë. Marrja e kampionëve statistikore dhe vlerësimi duhet të përputhet me parimet e parashtruara në nenin RL 221, përveç se do të aplikohet saktësia objektiv prej $\pm 7.5\%$, në vend të $\pm 5\%$. Nëse nuk ka të dhëna të disponueshme, do të përdoret numri më i ulët i numrit të miratuar mesatar të artikujve për kilogram ose numri mesatar të artikujve për kilogram rënë dakord për flukset e shtetit anëtar objektiv.

Neni RL 223

Metodë alternative statistikore për shkëmbimet e postës ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv

1. Për ato shkëmbime midis operatorëve të caktuar në sistemin objektiv që shkëmbejnë letra dhe / ose kuti të sheshta, operatorët e caktuar mund të ndërmarrin hapa për të zhvilluar vlerësime të artikujve bazuar mbi llojin e kontenierit. Njehsimi statistikor duhet të përputhet me parimet e parashtruara në nenin RL 221. Ditët e vëzhgimit do të shpërndahen në mënyrë sa më uniforme të jetë e mundur gjatë ditëve të punës të javës



(do të merren në konsideratë vetëm ditët e punës së zyrës së shkëmbimit në fjalë) dhe do të reflektohen mënyrat e transportit të përdorura për fliksin e postës në tërësi. Njehsimi statistikor do të përbëhet nga të paktën 48 ditë të vëzhgimit të marrjes së kampionëve në vit me katër ditë për muaj. Brenda një dite të vëzhgimit, operatorët e caktuar mund të përdorin nën-kampionët, nëse nuk është e mundur të kryhet një njehsim i plotë i të gjithë postës të marrë gjatë ditës në fjalë.

1.1 Si alternativë për marrjen e kampionëve në një grup të caktuar të ditëve, operatorët e caktuar mund të përdorin marrjen e vazhdueshme të kampionëve, në të cilën zgjidhet një marrje sistematike e kampionëve të kontenierëve për testimin e të gjithë periudhës së vëzhgimit. Operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakord për format statistikore të përdorura.

2. Vlerësimi i numrit vjetor të artikujve

2.1 Numri vjetor i dërgesave korrespondon me mesataren e ponderuar të numrit të artikujve të vlerësuar veçmas për çdo lloj kontenieri dhe mënyrë transporti. Llogaritjet do të kryhen si më poshtë:

2.1.1 Numri mesatar i artikujve për kilogram të marrë nga kampionët për një lloj të dhënë kontenieri dhe mënyrë të dhënë të transportit shumëzohet me peshën e përgjithshme të postës së dërguar për këtë lloj kontenieri dhe mënyrë transporti, duke pasur si qëllim të vlerësojnë numrin e përgjithshëm të dërgesave për llojin e kontenierit dhe mënyrën e transportit të marrë në konsideratë.

2.1.2 Vlerësimet e numrit të përgjithshëm të dërgesave për lloj kontenieri dhe mënyrë transporti do të mbledhen së bashku për të përcaktuar numrin vjetor të vlerësuar të dërgesave.

3. Operatorët e caktuar duhet të tregojnë peshën e postës së dërguar sipas llojit të kontenierit (për shembull pesha e dërgesave në kaska, në enë te sheshta, thasë etj) në formularë të modifikuar në mënyrë të duhur dhe, nëse është e mundur, të japin informacion në lidhje me kontenierët nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave elektronike (EDI).

4. Çdo operator i caktuar duhet të lajmërojë operatorin e caktuar përkatës në lidhje me projektin e programit të të tij të kampionëve, mbi të gjitha për sa i përket metodës së zgjedhur të vlerësimit, të paktën dy muaj përpara periudhës së vëzhgimit. Megjithatë, operatori i caktuar marrës nuk është i detyruar të njoftojë paraprakisht operatorin e caktuar dërgues ditët e vëzhgimit apo kontenierët e zgjedhur si kampionë.

4bis Kur nuk është kryer marrja e kampionëve për kilogram ose rezultatet nuk janë bërë të njohur brenda pesë muajve pas përfundimit të tremujorit të katërt, operatori tjetër i caktuar do të ketë të drejtë të paraqesë rezultatet e veta të kampionëve për të dhënat që mungojnë. Marrja e kampionëve statistikore dhe vlerësimi duhet të përputhet me parimet e parashtuara në nenin RL 221, përveç se do të aplikohet saktësia objektive prej $\pm 7.5\%$, në vend të $\pm 5\%$. Nëse nuk ka të dhëna të disponueshme, do të përdoret numri më i ulët i numrit të miratuar mesatar të artikujve për kilogram ose numri mesatar të artikujve për kilogram rënë dakord për flukset e shtetit anëtar objektiv.

Neni RL 224

Njehsimi specifik statistikor për zbatimin e mekanizmit të rishikimit

1. Për të aplikuar mekanizmin e rishikimit ose mekanizmin e harmonizimit të sistemit, në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë, e tillë si një marrëveshje e ndërsjellë për të përdorur numrin mesatar UPU të artikujve për kilogram në flukset e postës nga shtetet e tranzicionit në shtetet anëtare objektive kalimtare nga studimi i fundit i fluksit të UPU, do të kryhet një njehsim statistikor mbi bazën e një kampionëve të fluksit në fjalë.

1.1 Kampionët duhet të pasqyrojnë përbërjen e postës, dhe duhet të përputhen me parimet e parashtuara në nenin RL 221. Njehsimi statistikor do të përfshijë të paktën 24 ditë të vëzhgimit brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore të cilës ai i referohet. Në një ditë të vëzhgimit, operatorët e caktuar mund të përdorin nën-kampionët, nëse nuk është e mundur të kryhet një njehsim i plotë i të gjithë postës të marrë gjatë ditës në fjalë.

1.1.1 Si alternativë për marrjen e kampionëve në një grup të caktuar të ditëve, operatorët e caktuar mund të përdorin marrjen e vazhdueshme të kampionëve, në të cilën një zgjidhet një marrje sistematike e kampionëve të kontenierëve për testimin e të gjithë periudhës së vëzhgimit. Operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakord për format statistikore të përdorura.

1.2 Ditët e vëzhgimit do të shpërndahen në mënyrë sa më uniforme të jetë e mundur gjatë ditëve të punës të javës (do të merren në konsideratë vetëm ditët e punës së zyrës së shkëmbimit në fjalë) dhe mënyrat e

transportit për të gjithë fluksin e postës. Ato do të zgjidhen në baza vjetore, tremujore ose mujore siç tregohet më poshtë:

1.2.1 bazë vjetore: të paktën 24 ditë vëzhgimi në një periudhë 12 mujore; çdo ditë pune e javës do të vëzhgohet të paktën njëherë në tremujor;

1.2.2 bazë tremujore: të paktën gjashtë ditë vëzhgimi në një periudhë tremujore; çdo ditë pune e javës do të vëzhgohet të paktën njëherë me të njëjtën procedurë të përsëritur në tre tremujorët vijues;

1.2.3 bazë mujore: të paktën 24 ditë vëzhgimi në një muaj; të gjitha ditët e punës për atë muaj; njehsimi statistikor do të bëhet në Maj në vitet teke dhe në Tetor në vitet çifte.

2. Vlerësimi i numrit mesatar të artikujve për kilogramë

2.1 Në rastin e marrjes së kampionëve në baza vjetore ose tremujore, numri mesatar vjetor i artikujve për kilogram do të jetë mesatarja e ponderuar e numrit mesatar të artikujve për kilogram të llogaritur veçmas për çdo mënyrë të transportit dhe muaj. Ai do të llogaritet si vijon:

2.1.1 Numri mesatar i artikujve për kilogram, të përfshirë nga marrja e kampionëve në një mënyrë të dhënë të transportit gjatë një muaji të caktuar, do të shumëzohet me peshën totale të postës për atë mënyrë transporti dhe muaj, duke pasur qëllimin që të vlerësojë numrin e përgjithshëm të artikujve për atë mënyrë transporti dhe muaj.

2.1.2 Shuma e vlerësimeve të numrit total të artikujve për çdo mënyrë transporti dhe muaj do të pjesëtohet me peshën totale vjetore të postës.

2.1.3 si alternativë, operatorët e caktuar mund të zëvendësojnë ditën ose tremujorin me muajin në procedurën sipas pikave 2.1.1 dhe 2.1.2.

2.2 Në rastin e marrjes së kampionëve në baza mujore, numri mesatar vjetor i artikujve për kilogram do të jetë mesatarja e ponderuar e numrit mesatar të artikujve për kilogram të llogaritura veçmas për çdo mënyrë transporti. Ai do të llogaritet si vijon:

2.2.1 Numri mesatar i artikujve për kilogram, të përfshirë nga marrja e kampionëve në një mënyrë të dhënë transporti, do të shumëzohet me peshën totale të postës për atë mënyrë transporti dhe muaj ose tremujor, duke pasur si qëllim të vlerësojë numrin e përgjithshëm të artikujve për atë mënyrë transporti dhe muaj ose tremujor.

2.2.2 Shuma e vlerësimeve të numrit total të artikujve në muaj ose tremujor për secilën mënyrë transporti do të pjesëtohet me peshën totale vjetore të postës.

3. Operatori i caktuar që kërkon aplikimin e mekanizmit të rishikimit do të zgjedhin sistemin statistikor që do të aplikohet, duke përfshirë përjasjen e vlerësimit dhe do të njoftojë operatorin e caktuar përkatës për këtë në mënyrë që ky i fundit mund të marrë të gjitha masat e nevojshme të kontrollit. Nga ana tjetër, operatori i caktuar që kërkon aplikimin e mekanizmit të rishikimit mund të bierë dakord me operatorin e caktuar përkatës për të aplikuar numrin mesatare UPU të artikujve për kilogram në flukset e postës nga shtetet e tranzicionit në ato objektiv të përcaktuar nga studimi i fundit UPU për fluksin.

4. Operatorit të caktuar që kërkon aplikimin e mekanizmit të rishikimit nuk do ti kërkohet të japë njoftim paraprak për ditët e vëzhgimit që ka zgjedhur.

D. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i situacioneve dhe llogarive që kanë të bëjnë me tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare

Neni RL 225

Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54 për shkëmbimet e postës ndërmjet shteteve anëtare të sistemit objektiv

1. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54

1.1 Për njehsimet statistikore për shkëmbime të postës ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv në përputhje me nenet RL 222 dhe 223, zyra e shkëmbimit të operatorit të caktuar marrës do të regjistrojë, për çdo kontenier që është marrë si kampion, llojin e kontenierit, numrin dhe pesha e artikujve që ai përmban, numrin përkatës të artikujve për kilogram (IPK), dhe barkodin e kontenierit në një faturë CN 53. Për çdo mënyrë transporti (ajrore, S.A.L., tokësore) dhe lloj kontenieri do të përgatiten fatura CN 53 të veçanta.

1.2 Nga faturat CN 53, operatori i caktuar marrës do të përgatisë një deklaratë CN 54 që përmbledh faturat CN 53 sipas llojit të kontenierit, mënyrës së transportit (ajrore, S.A.L., tokësore) dhe muajit për një



tremujor kalendarik.

1.3 Deklarata përmbledhëse CN 54, e shoqëruar nga modulet CN 53, i transmetohen operatorit tjetër të caktuar të interesuar çdo tremujor, jo më vonë se pesë muaj pas marrjes së dërgesës së fundit të përfshirë në statistikë. Këto lista CN 53 dhe CN 54 do të jepen, sa herë është e mundur, në format elektronik të standardizuar dhe mundësisht në një format të faqes të përdorur gjerësisht.

1.4 Nëse operatori i caktuar dërgues ka marrë CN 53 dhe CN 54 në formë të printuar dhe nuk ka bërë një vërejtje në një afat prej tre muajsh duke filluar nga data e transmetimit të deklaratës përmbledhëse CN 54, kjo e fundit konsiderohet si plotësisht e pranuar.

1.5 Nëse operatori i caktuar dërgues ka marrë CN 53 dhe CN 54 në formë elektronike të standardizuar dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje brenda dy muajve duke filluar nga data e transmetimit të deklaratës përmbledhëse CN 54, kjo e fundit konsiderohet si plotësisht e pranuar.

2. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i deklaratave përmbledhëse CN 54bis

2.1 Nga deklaratat përmbledhëse CN 54 dhe CN 56 të pranuar, operatori i caktuar marrës do të përgatisë deklaratën vjetore CN 54bis duke konsoliduar të dhënat që kanë të bëjnë me dërgesat e marra si kampionë sipas mënyrës së transportit dhe të tremujorit dh mbi bazën e së secilës llogaritet numri vjetor i artikujve për kilogramë për vitin në fjalë.

2.2 Deklarata vjetore CN 54bis do t'i dërgohet operatorëve të tjerë të caktuar në fjalë jo më vonë se një muaj pas pranimit të deklaratave përmbledhëse CN 54 dhe CN 56 të lidhura me tremujorin e katërt. Përveç kopjeve të printuara, CN 54bis do të jepet, kur është e mundur, në format të standardizuar elektronik.

2.3 Nëse operatori i caktuar dërgues ka marrë CN 54bis, dhe nuk ka bërë asnjë koment brenda një muaji nga data e transmetimit të deklaratës vjetore CN 54bis, kjo e fundit do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

3. Në rastet kur operatori i caktuar dërgues ka kryer kontrole statistikore, të dhënat e shtetit marrës do të konsiderohen si të vlefshme nëse këto ndryshojnë me më shumë se 10 % nga ato të një operatori tjetër të caktuar.

3.1 Në rast të një difference më të madhe se 10%, operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakord për vlerat që do të përdoren për rregullimin e detyrimeve përfundimtare duke marrë në konsideratë saktësinë e sistemeve statistikore të përdorura nga çdo operator i caktuar.

4. Nëse dy palë nuk mund të bien dakord për zbatimin e këtij neni, operatorët e caktuar mund t'i drejtohen procedurës së arbitrazhit të parashikuar në nenin 132 të Rregullores së përgjithshme.

Neni RL 226

Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54 për mekanizmin e rishikimit

1. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i faturave CN 53 dhe CN 54

1.1 Gjatë ditëve të vëzhgimit, zyra e shkëmbimit e operatorit të caktuar që kërkon zbatimin e mekanizmit të kontrollit do të regjistrojë në faturën CN 53 numrin dhe peshën e artikujve për çdo dërgesë të marrë si kampion.

1.2 Nga faturat CN 53, operatori i caktuar i cili ka kërkuar njehsimin e veçantë statistikor do të përgatisë një deklaratë përmbledhëse CN 54 që konsolidon të dhënat përkatëse të dërgesave të marra si kampionë sipas mënyrës së transportit dhe muajit për një tremujor.

1.3 Deklarata përmbledhëse CN 54, e shoqëruar nga formulari CN 53, do t'i dërgohet operatorit tjetër të caktuar të interesuar pas çdo tremujori dhe / ose në fund të periudhës së marrjes së kampionëve jo më vonë se një muaj pas dërgimit ose marrjes së dërgesës së fundit të përfshirë në statistikë. Përveç kopjeve të printuara këto fatura CN 53 dhe CN 54 do të jepen, kur është e mundur, në format të standardizuar elektronik.

1.4 Nëse operatori tjetër i caktuar i interesuar ka marrë faturat CN 53 dhe CN 54 në formë të printuar dhe nuk ka bërë asnjë koment në një afat prej tre muajsh duke filluar nga data e transmetimit të deklaratës përmbledhëse CN 54, kjo e fundit do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

1.5 Nëse operatori tjetër i caktuar i interesuar ka marrë faturat CN 53 dhe CN 54 në format të standardizuar elektronik dhe nuk ka bërë asnjë koment në një afat prej dy muajsh duke filluar nga data e transmetimit të deklaratës përmbledhëse CN 54, kjo e fundit do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

2. Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i deklaratave përmbledhëse CN 54bis

2.1 Nga deklaratat përmbledhëse CN 54 dhe CN 56 të pranuar, operatori i caktuar që ka kërkuar një njehsim të veçantë statistikor duhet të përgatisë një deklaratë vjetore CN 54bis duke konsoliduar të dhënat në lidhje me dërgesat e marra kampion sipas mënyrës së transportit dhe tremujorit.

2.2 Nga deklarata vjetore CN 54bis, operatori i caktuar që ka kërkuar njehsimin statistikor duhet të llogarisë numrin mesatar të artikujve për kilogram dhe, në rastin e aplikimit të mekanizmit të rishikimit, çmimin e ri të detyrimeve përfundimtare duke zbatuar formulën e përcaktuar në nenin RL 217.6.

2.3 Deklarata vjetore CN 54bis do t'i dërgohet operatorëve të tjerë të caktuar në fjalë jo më vonë se një muaj pas pranimit të deklaratave përmbledhëse CN 54 dhe CN 56 të lidhura me tremujorin e katërt. Përveç kopjeve të printuara, CN 54bis do të jepet, kur është e mundur, në format të standardizuar elektronik.

2.4 Nëse operatori tjetër i caktuar i interesuar ka marrë faturat CN 54bis dhe nuk ka bërë asnjë koment në një afat prej një muaji duke filluar nga data e transmetimit të deklaratës vjetore CN 54bis, kjo e fundit do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

3. Në rast se operatori tjetër i caktuar i interesuar ka kryer një njehsim të njehsimit statistikor, të dhënat e përcaktuara nga operatori i caktuar i cili ka kërkuar zbatimin e mekanizmit të kontrollimit do të konsiderohen si të vlefshme nëse këto nuk ndryshojnë me më shumë se 10% nga ato të përcaktuara nga operatori tjetër i caktuar.

3.1 Në rast të një difference më të madhe se 10%, operatorët e caktuar të interesuar do të bien dakort për vlerat që do të përdoren për rregullimin e detyrimeve përfundimtare duke marrë në konsideratë saktësinë e sistemeve statistikore të përdorura nga çdo operator i caktuar.

4. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet dy palëve për zbatimin e mekanizmit të rishikimit, operatorët e caktuar mund t'i drejtohen procedurës së arbitrazhit të parashikuar në nenin 132 të Rregullores së përgjithshme.

Neni RL 228

Përgatitja e situacioneve të dërgesave CN 55 dhe CN 56

1. Pas marrjes së dërgesës së fundit të çdo muaji, zyra e shkëmbimit e destinacionit do të përgatisë nga veçoritë mbi faturat CN 31, sipas llojit të postës dhe sipas zyrës së shkëmbimit, një situacion të dërgesave CN 55. Në rastet kur operatorët e caktuar kanë rënë dakord reciprokisht për të regjistruar numrin e kontenierëve dhe peshën sipas formatit në faturën CN 31, formulari CN 55 do të tregojë peshën e dërgesës sipas formatit. Një situacion CN 55 do të përgatitet gjithashtu sipas llojit të dërgesës transit dhe zyrës së dërgimit dhe zyrës së destinacionit, në përputhje me veçoritë e përfshira në faturat e dërgimit CN 37 dhe CN 41. Këto deklarata do të dërgohen në administratën e tij qendrore.

2. Për çdo operator të caktuar të shtetit të origjinës së dërgesave, operatori i caktuar i shtetit të destinacionit dhe operatori i caktuar i transitit do të përgatisin çdo tremujor, nga detajet e situacioneve CN 55, sipas llojit të dërgesave, zyrës së origjinës dhe zyrës së destinacionit dhe, sipas rastit, sipas itinerarit të dërgimit, një situacion përmbledhës të dërgesave CN 56.

3. Situacionet CN 55 do t'i dërgohen operatorit të caktuar të shtetit të origjinës në mbështetje të situacioneve përmbledhëse CN 56. Pas pranimit të tyre, ai operator i caktuar do të kthejë një kopje tek operatori i caktuar që ka përgatitur situacionin.

Neni RL 229

Transmetimi dhe pranimi i situacioneve të dërgesave CN 55 dhe CN 56

1. Situacioni përmbledhës CN 56 do të dërgohet në dy kopje operatorëve të caktuar të origjinës së dërgesave maksimumi brenda pesë muajve pas mbarimit të tremujorit të cilit i referohet.

2. Pas pranimit, operatori i caktuar i origjinës së dërgesave i kthen një kopje operatorit të caktuar që e ka përgatitur. Nëse operatori i caktuar i interesuar nuk ka marrë asnjë vërejtje korrigjuese brenda tre muajve nga dita e dërgimit, ajo e konsideron atë si plotësisht të pranuar. Nëse verifikimi shfaq mospërputhje, situacioni përmbledhës CN 55 e korrigjuar duhet ti bashkëlidhet në mbështetje të deklaratës përmbledhëse CN 56 të ndryshuar dhe pranuar. Nëse operatori i caktuar i destinacionit kundërshton amendimet e bëra në situacionin CN 55, operatori i caktuar i origjinës do të konfirmojë të dhënat reale duke transmetuar fotokopje të formularëve CN 31 të hartuara nga zyra e origjinës gjatë dërgimit të dërgesave të kundërshtuara.



3. Operatorët e caktuar mund të bien dakord që situacionet CN 55 dhe CN 56 të përgatiten nga operatori i caktuar i origjinës së dërgesave. Në këtë rast, do të përdoret procedura e pranimit e parashikuar në pikën 1 dhe 2.

Neni RL 230

Kontabiliteti i postës në sasi të mëdha

1. Kur operatori i caktuar i origjinës ka zgjedhur të dërgojë postë në sasi të mëdha në përputhje me nenin 219.5, deklaratat CN 55 të përgatitura nga zyra e shkëmbimit të destinacionit do të përfshijnë edhe postën në sasi, mbi bazën e të dhënave të faturës CN 32

1.1 Të dhënat në lidhje me postën në sasi do të përdoren për përgatitjen tremujore të situacioneve përmbledhëse CN 56.

1.2 Në rast kur të dhënat në lidhje me postën në sasi të mëdha deklaratat CN 55 ndryshojë, operatori i caktuar i origjinës do të transmetojë fotokopje të faturave CN 32 në lidhje me dërgesat e kundërshtuara.

2. Kur operatori i caktuar i destinacionit ka zbatuar pagesën e veçantë për postën në sasi sipas nenit RL 219.1, do të jenë të zbatueshme procedurat e pikës 1.1 dhe 1.2.

2.1 Kur janë përgatitur situacionet përmbledhëse CN 56, operatori i caktuar i destinacionit përgatit një llogari CN 57 nga faturat CN 32 të transmetuara operatorit të caktuar të origjinës të dërgesave, në përputhje me nenin RL 193.6.1.3. operatori i caktuar i origjinës mund të refuzojë verifikimin dhe pranimin e çdo llogarie CN 57 që nuk është paraqitur për një afat prej 6 muajsh pas tremujorit të cilit i referohet.

2.2 Llogaria CN 57 duhet të pranohet dhe shlyhet nga operatori i caktuar i origjinës në gjashtë javët që pasojnë përgatitjen e saj.

2.3 Llogaritë CN 57 të shlyera nga operatori i caktuar i origjinës së dërgesave do të jenë subjekt i situacionit përmbledhës CN 58. Shuma e situacionit përmbledhës CN 58 i zbritet llogarisë së veçantë CN 61. Nje kopje e formularit CN 58 i bashkëngjitet llogarisë së veçantë CN 61.

3. Operatorët e caktuar mund të vendosin në mënyrë të dyanshme të përdorin formularë dhe procedura alternative për postën në sasi të mëdha.

Neni RL 231

Kontabiliteti i postës së destinuar për hyrje direkte në sistemin e brendshëm

1. Shpenzimet që kanë të bëjnë me postën e destinuar për hyrjen direkte në sistemin e brendshëm do të faturohen nga operatori i caktuar i destinacionit me anë të formularëve të kontabilitetit të rëna dakord midis tyre.

2. Llogaritë do të shlyhen nga operatori i caktuar i origjinës në afatin e caktuar nga operatori i caktuar i destinacionit të postës. Ky afat nuk duhet të jetë më pak i favorshëm se ai i përcaktuar nga operatori i caktuar në fjalë për klientët kombëtar. Operatori i caktuar i destinacionit përcakton gjithashtu monedhën me të cilën duhet kryer pagesa, në përputhje me dispozitat e nenit RL 252.1.

3. Në rastet kur të dhënat në lidhje me postën e destinuar për hyrje direkte në sistemin e brendshëm të regjistruara në deklaratat e kontabilitetit ndryshojnë, operatori i caktuar i origjinës do të transmetojë fotokopje të formularëve të kontabilitetit që kanë shoqëruar dërgesat e kundërshtuara.

Neni RL 232

Përgatitja, transmetimi dhe pranimi i tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare

1. Operatori i caktuar kreditor do të jetë përgjegjës për përgatitjen e llogarive dhe përcjelljen e tyre tek operatori i caktuar debitor. Megjithatë, dërgimi i llogarive do të kërkohej kur bilanci është më i ulët se minimumi i parashikuar për këtë qëllim në nenin RL 234.7 dhe 8

2. Llogaritë e detajuara do të përgatiten si në vijim:

2.1 Tarifat e transitit. Në një formular CN 62, sipas peshës së përgjithshme të kategorive të dërgesave siç shfaqet në situacionet përmbledhëse CN 56.

2.2 Detyrime përfundimtare. Në një formular CN 61, sipas diferencës së shumave për tu kontabilizuar në bazë të peshës së dërgesave të marra dhe të dërguara për çdo kategori të postës siç shfaqen në situacionet përmbledhëse CN 56 dhe në llogaritë CN 19.

3. Llogaritë e detajuara CN 62 dhe CN 61 do t'i dërgohen në dy kopje operatorit të caktuar debitor, sa më herët të jetë e mundur, pas mbarimit të vitit së cilit i referohet.

4. Operatori i caktuar debitor nuk është i detyruar të pranojë llogaritë e detajuara të cilat nuk i janë dërguar në afatin prej 12 muajsh pas përfundimit të vitit të cilit i referohen.

5. Nëse operatori i caktuar që dërgon llogarinë e hollësishme nuk merr njoftim të ndryshimit brenda tre muajve nga data e dërgimit, llogaria do të konsiderohet si plotësisht e pranuar. Formularët do të transmetohen elektronikisht ose, nëse kjo nuk është në dispozicion, do të dërgohen si artikuj rekomandë. Nëse data në letrën që shoqëron formularët ndryshon nga data e marrjes me më shumë se dy javë, shteti marrës do të ketë të drejtë të njoftojë operatorin e caktuar dërgues se periudha e tre muajve të përmendura më sipër fillon vetëm pas datës së marrjes.

6. Si masë e jashtëzakonshme, llogari të detajuara shtesë mund t'i dërgohen operatorit të caktuar debitor vetëm nëse është plotësuese e llogarive tashmë ekzistuese të vitit në fjalë. Për to do të zbatohen kushtet e pikës 4 dhe 5.

7. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të shlyejnë veçmas llogaritë e detyrimeve përfundimtare të dërgesave me rrugë tokësore dhe atyre me rrugë ajrore. Në këtë rast operatorët e caktuar të interesuar do të përcaktojnë procedurat e përgatitjes, pranimit dhe shlyerjes së llogarive.

Neni RL 233

Adresa e veçantë për transmetimin e formularëve që kanë të bëjnë me tarifat e transitit dhe detyrimet përfundimtare

1. Çdo operator i caktuar do të njoftojë operatorët e tjerë të caktuar, nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare, për adresën e veçantë, që mund të përfshijë edhe një adresë e-maili, në të cilën duhet të dërgohen të gjithë formularët që do të konsiderohen për shlyerjen e tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare (CN 43, CN 54, CN 54bis, CN 56, CN 57, CN 58, CN 61, CN62, CN 63 dhe CN64).

Neni RL 234

Pranimi i tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare

1. Kur nuk është kryer asnjë pagesë provizore, pagesat e tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare mund të kryhen eskuzivisht sipas llogarive të detajuara CN 61 dhe CN 62, në të cilat duhet të tregohet mënyra preferuar për shlyerjen.

2. Në rastin kur është kryer pagesa provizore, sapo të jenë pranuar ose konsideruar si plotësisht të pranuar llogaritë e detajuara CN 61 dhe CN 62 ndërmjet operatorëve të caktuar, operatori i caktuar kreditor do të përgatisë situacionet CN 63 dhe CN 64 për tarifat e transitit dhe për detyrimet përfundimtare në dy kopje.

3. Nëse është e nevojshme, situacionet CN 63 ose CN 64, do të dërgohen, në dy kopje, tek operatori i caktuar në fjalë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore). Nëse, brenda një muaji duke filluar nga data e dërgimit të këtyre situacioneve, operatori i caktuar që i ka përgatitur nuk ka marrë asnjë kundërshtim nga operatori i caktuar në fjalë, situacionet do të konsiderohen si plotësisht të pranuar.

4. Të gjitha ndryshimet e bëra në situacionet CN 63 ose CN 64 nga operatori i caktuar debitor duhet të shoqërohen nga llogaritë e detajuara CN 61 ose CN 62 mbështetëse.

5. Për flukset ndërmjet një operatorit të caktuar që kontribuon në fondin e Cilësisë së Shërbimit dhe një operatori të caktuar që përfiton nga ky fond, ky operator i caktuar do të dërgojë organit të ngarkuar për faturimin e shumave të detyruara në respektim të Fondit të Cilësisë së Shërbimit një kopje të llogarive të detajuara CN 61 dhe, nëse nevojitet, situacionin CN 64 të pranuar ose të konsideruar si plotësisht të pranuar. Ky organ nuk është i detyruar të pranojë situacionet CN 64 dhe CN 61 të marra pas më shumë se gjashtë muajsh nga pranimi i tyre. Në rast të dështimit për tu përputhur me afatin e transmetimit të dokumenteve CN 61 dhe CN 64:

5.1 një shteti i cili ka marrë një kësht me faturim të përshpejtuar sipas QSF, do të kërkohet që t'ia kompensojë atë, së bashku me interesat e mbledhura, shtetit kontribuues në fjalë nëpërmjet organit përgjegjës për faturimin;

5.2 një shteti i cili nuk ka kërkuar paradhënie humbet të drejtën e fondeve të QSF-së me shtetet



kontribuese që përfshihen, për vitin në fjalë.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 3, situacionet duhet të kenë shënimin “Aucune observation de l'opérateur désigné débiteur n'est parvenue dans le délai réglementaire” (Asnjë vërejtje e operatorit të caktuar debitor nuk ka mbërritur në afatin e parashikuar).

7. Operatori i caktuar debitor do të përjashtohet nga pagesa e tarifave të transitit në rastet kur bilanci vjetor nuk i kalon 163.35 SDR. Ky bilanc vjetor më i ulët se 163.35 SDR duhet të përfshihet në bilancin e vitit pasardhës nga operatorit i caktuar kreditor.

8. Operatori i caktuar debitor do të përjashtohet nga pagesa e detyrimeve përfundimtare në rastin kur bilanci vjetor nuk i kalon 326.70 SDR. Ky bilanc vjetor më i ulët se 326.70 SDR duhet të përfshihet në bilancin e vitit pasardhës nga operatorit i caktuar kreditor.

9. Shlyerjet duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e neneve RL 249 dhe RL 250.

Neni RL 235

Pagesat provizore të tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare

1. Operatorët e caktuar kreditorë mund të pretendojnë pagesa provizore për sa i përket tarifave të transitit dhe detyrimeve përfundimtare. Pagesat provizore për një vit do të llogariten në bazë të peshës së dërgesave dhe rezultateve statistikore (nëse është e zbatueshme) të dërgesave të përdorura për shlyerjet përfundimtare të vitit paraardhës. Operatori i caktuar debitor nuk do të jetë i detyruar të pranojë llogari të pagesave provizore të marra pas 30 Qershorit. Nëse llogaria e vitit të mëparshëm nuk është shlyer ende, pagesat provizore do të llogariten në bazë të situacioneve përmbledhëse të dërgesave CN 56 të pranuar sipas rregullave (nëse është e zbatueshme). Pagesat provizore të një viti duhet të kryhen jo më vonë se në fund të muajit korrik të këtij viti. Më pas pagesat provizore do të rregullohen sapo të pranohen ose të konsiderohen si plotësisht të pranuar llogaritë përfundimtare të vitit.

2. Situacionet CN 63 ose CN 64 që kanë të bëjnë me pagesa provizore të përcaktuara në pikën 1, do të dërgohen operatorit të caktuar debitor nga operatorit i caktuar kreditor në tremujorin e dytë të vitit përkatës.

2bis Nëse një operator i caktuar kreditor është në një pozicion "debitor neto" me lidhje me llogaritë e tjera të pranuar në mes të dy operatorëve të caktuar, operatorit i caktuar debitor mund të kompensojë borxhet e pashlyera të pranuar kundrejt pagesës së përkohshme. Nëse borxhi i papaguar është më i madh sesa pagesat provizore të kërkuara, operatorit të caktuar debitor nuk do t'i kërkohej të kryejë pagesën provizore të detyrimit përfundimtar për atë vit. Operatori i caktuar kreditor gjithashtu mund të kërkojë që operatorit i caktuar debitor të zbatojë pagesën provizore të debive të papaguara midis dy operatorëve të caktuar.

Neni RL 236

Pagesa e shumave për tu paguar si Fonde për financimin e përmirësimit të cilësisë së shërbimit në vendet në zhvillim

1. Në bazë të situacioneve CN 64 ose të llogarive të detajuara CN 61 të pranuar ose të konsideruara si plotësisht të pranuar që i janë dërguar, organizata e ngarkuar për faturimin do të përgatisë situacionin CN 64bis për operatorët e caktuar të shteteve kontribuese. Këto situacione do të përmbajnë informacionet si më poshtë:

1.1 emrin e operatorëve të caktuar të shteteve në zhvillim të cilave i referohen të dhënat;

1.2 Shumën në SDR subjekt i rritjeve të specifikuara në nenin 31 të Konventës;

1.3 Shumën totale për t'u paguar nga operatorit i caktuar i përfshirë.

2. Një situacion CN 64bis do të dërgohet me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore) për miratim të çdo operatorit të caktuar të interesuar. Nëse, brenda një muaji duke filluar nga dita e dërgimit të situacionit, organizata përgjegjëse për faturimin nuk merr asnjë koment, shuma e këtij situacioni do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

2bis Mbi bazën e informacionit të dhënë në situacionet CN 64, Sekretariati i QSF-së do të llogarisë shumën shtesë para vitit 2010 që çdo shtet në sistemin objektiv i detyrohet shteteve në sistemin e tranzicionit dhe që nuk arrijnë minimumin prej 12,565 SDR, siç është përcaktuar në nenin 31.5quinquies të Konventës, në proporcion me vëllimet e dërguara operatorit të caktuar përfitues.

2ter Fatura për shumën shtesë treguar në pikën 2bis do të shoqërohet me një situacion CN 64ter, që

përmban informacionin e mëposhtëm:

- 2ter.1 emrat e operatorëve të caktuar të shteteve në zhvillim me të cilat lidhen të dhënat;
- 2ter.2 vitin e referencës;
- 2ter.3 shumën shtesë (në SDR) të nevojshme për të arritur minimumin prej 12,565 SDR të specifikuar në nenin 31.5 quinter të Konventës;
- 2ter.4 pjesën e kësaj shume shtesë (të shprehur në përqindje) në ngarkim të operatorit të caktuar në fjalë, në proporcion me volumin e dërgesave të shkëmbyera;
- 2ter.5 shumën që do të paguhet nga operatori i caktuar në fjalë.
- 3. Shumat e situacioneve CN 65bis dhe CN 65ter mund të shlyhen me anë të sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare.

KAPITULLI 12 SHPENZIMET E TRANSPORTIT AJROR

Neni RL 237

Formula për llogaritjen e taksës bazë dhe llogaritja e detyrimeve të transportit ajror për dërgesat e mbyllura

1. Llogaritja e detyrimeve të transportit ajror për dërgesat e mbyllura, artikujt prioritarë, artikujve me transport me avion dhe artikujt S. A. L. vetëm kur ridërgohen me rrugë ajrore / prioritare në transit á découvert, si dhe mënyrat përkatëse të kontabilizimit, janë përcaktuar në nenet vijuese të këtij kapitulli.

2. Taksat bazë maksimale të zbatueshme për transportin ajror do të llogariten në përputhje me formulën e mëposhtme, elementët e së cilës do të merren nga Statistikat Ndërkombëtare Financiare të Shoqërive të fluturimit të përgatitura nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil. Kjo taksë do të rrumbullakoset me një të mijtat e SDR për kilogram të peshës bruto dhe për kilometër; formula do të zbatohet në mënyrë proporcionale me pjesët e kilogramit.

$T = (A - B - C + D + E + F)$, ku

T = taksa bazë për t-km (prioriteti i postës ajrore garantohet brenda këtij çmimi)

A = mesatarja e ponderuar e shpenzimeve për t/km të realizuar

B = Kosto e shërbimeve të pasagjerëve për t/km

C = Përqindja e kostonë së biletarive, shitjeve, reklamave (bazuar në numrin e pasagjerëve në raport me volumin e qarkullimit).

D = Shpenzime e artikujve jo-operativë për t/km të realizuara.

E = 10% e (A - B - C + D) si fitim

F = Tatime mbi të ardhurat për një t/km të realizuar.

3. Detyrimet e transportit ajror do të llogariten sipas çmimeve bazë efektive (më të ulta dhe maksimumi të barabarta me çmimet bazë të përcaktuara sipas formulës në pikën 2) dhe distancave kilometrike të dhëna në Listën e Distancave Ajrore Postare, dhe sipas peshës bruto të dërgesave. Nuk do të merret parasysh pesha e thasëve përmbledhës.

4. Kur detyrimet janë të pagueshme për transportin ajror brenda shtetit të destinacionit, ato do të fiksohen në formën e një çmimi të vetëm. Ky çmim i vetëm do të përfshijë të gjitha detyrimet për transportin ajror brenda vendit, pavarësisht nga aeroporti i mbërritjes së dërgesave, minus kostot përkatëse të transportit tokësor. Ato do të llogariten mbi bazën e çmimeve realisht të paguara për transportin e dërgesave në shtetin e destinacionit, porpa tejkaluar çmimin maksimal të përcaktuar sipas formulës në pikën 2, dhe në përputhje me distancat mesatare të ponderuara të sektorëve të kaluar nga dërgesat ndërkombëtare në rrjetin e brendshëm. Duke iu nënshtruar nenit 33.7 të Konventës, distanca mesatare e ponderuar do të llogaritet nga Byroja Ndërkombëtare në terma të peshës bruto të të gjitha dërgesave ajrore që mbërrijnë në vendin e destinacionit, duke përfshirë edhe postën e cila nuk është ridërguar me rrugë ajrore brenda atij shteti.

4.1 Operatorët e caktuar që zbatojnë një shpërblim për detyrimet përfundimtare bazuar në çmimet ose në tarifatat e brendshme duhet t'i komunikojnë Byrosë Ndërkombëtare në afatin e parashikuar nga neni RL 243 të dhënat që lejojnë llogaritjen e distancës mesatare të re të ponderuar.

5. Shpenzimet si transporti ajror, ndërmjet dy aeroporteve të të njëjtit shtet, të ppostës ajrore në transit mund të përcaktohen gjithashtu në formën e çmimit të vetëm. Ky çmim do të llogaritet mbi bazën e çmimit të paguar për transportin ajror të postës brenda vendit transit, pa kaluar taksën maksimale të përcaktuar sipas formulës në pikën 1, dhe sipas distancës mesatare të ponderuar të udhëtimeve të kryera nga posta



ndërkombëtare në rrjetin ajror të brendshëm të shtetit transit. Distanca mesatare e ponderuar është përcaktuar në funksion të peshës bruto të të gjitha dërgesave ajrore që kalojnë nga një shtet ndërmjetës.

6. Shuma e detyrimeve të përmendura në pikat 4 dhe 5 nuk mund të kalojë në total shumën që duhet të paguhet realisht për transportin.

7. Çmimet për transportin ajror ndërkombëtar dhe të brendshëm, të përfituara duke shumëzuar çmimin efektiv bazë sipas distancës, të cilat përdoren në llogaritjen e detyrimeve të përmendura në pikën 3, 4 dhe 5, do të rrumbullakosen në dhjetëshen më të lartë kur numri i formuar me qindëshe dhe mijëshe është i barabartë ose më i lartë se 50; në rast të kundërt ato do të rrumbullakosen me dhjetëshen më të vogël të SDR-së.

8. Në mungesë të marrëveshjeve të veçanta ndërmjet operatorëve të caktuar në fjalë, gradët e tarifave të transimit të treguara në nenin RL 205 do të zbatohen për të gjithë postën ajrore për çfarëdo transiti tokësor apo detar. Megjithatë, përjashtohet nga të gjitha tarifat transiti tokësor për:

8.1 transportin e postës ajrore ndërmjet dy aeroporteve që shërbejnë në të njëjtin qytet;

8.2 transporti i këtyre dërgesave nga një aeroport që i shërben një qyteti dhe një magazine që ndodhet në të njëjtin qytet dhe kthimi i postës për t'u ridërguar.

Neni RI 238

Llogaritja dhe kontabilizimi i tarifave për artikujt e dërguar gabim dhe artikujt në transit à découvert të dërguara me rrugë ajrore

1. Të përgjithshme

1.1 Çdo operator i caktuar i cili dërgon artikuj në tranzit à découvert me rrugë ajrore do të kenë të drejtë të mbledhin nga operatori i caktuar i origjinës pagesën për shpenzimet e bëra dhe rritjet e detyrimeve përfundimtare që duhet ti paguhen operatorit të caktuar të destinacionit. Kostot e transportit do të llogariten, në parim, siç tregohet në nenin RL 237.3. Rritjet e detyrimeve përfundimtare do të llogariten mbi bazën e diferencave mesatare detyrimeve përfundimtare të marra nga operatori i caktuar i transimit dhe ato të paguara operatorit të caktuar të destinacionit. Çmimet e transimit duhet të fiksohen në bazë të jo më shumë se 10 çmimeve mesatare, secili në lidhje me një grup të shteteve të destinacionit dhe të vendosura në bazë të kostove të transportit dhe përpunimit si dhe rritjes së detyrimeve përfundimtare për destinacione të ndryshme brenda grupit. Shuma e këtyre detyrimeve do të rritet me 5%.

1.2 Kontabilizimi i shpenzimeve të transportit ajror të artikujve prioritarë, artikujve me rrugë ajrore dhe artikujve S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert, në parim, do të kryhet sipas të dhënave të kthimeve statistikore. Megjithatë, nëse operatori i caktuar i transimit e kërkon, ai do të bazohet tërësisht ose pjesërisht në peshën reale.

1.3 Kontabilizimi në rastin e artikujve prioritarë të dërguar gabim, të artikujve me postë ajrore dhe artikujve SAL që do të ridërgohen me rrugë ajrore, të postuara në bord të anijeve ose të dërguara me intervale të parregullta ose në sasi shumë të ndryshme, do të bëhet mbi bazën e peshës reale. Për këtë qëllim operatorët postar ndërmjetës do të përdorin formularin CN 65 të shoqëruar nga shënimet e verifikimit CN 43. Megjithatë, ky kontabilizim do të bëhet vetëm nëse administrata e ndërmjetme kërkon të paguhet për shërbimin e transimit të kryer. Administratat e ndërmjetme mund të bien dakord me administratën e origjinës për të bazuar kontabilitetin për artikujt e dërguara gabim në statistika.

2. Veprime statistikore

2.1 Veprimet statistikore do të kryhen çdo vit dhe në mënyrë alternative në muajin e majit për vitet çift dhe në muajin tetor për vitet tek. Megjithatë, operatori i caktuar i transimit mund të zgjedhë periudha statistikore tremujore ose vjetore.

2.2 Gjatë periudhës së statistikore, artikujt parësor, artikujt me rrugë ajrore dhe dërgesat S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert do të shoqërohen nga faturat CN 65. Etiketa e pakos CN 25 dhe fatura CN 65 duhet të kenë të stampuar shkronjën S. Kur nuk ka artikuj parësor, as artikuj me rrugë ajrore, as artikuj S.A.L. të rekomanduara ose jo për tu futur në një dërgesë që normalisht përmban këto lloje artikujsh, një ose dy faturat CN 65, sipas rastit, të shënuara "Néant" (nul) do të shoqërojnë faturën e dërgesës.

2.3 Gjatë periudhës së statistikore, artikujt parësor, artikujt me rrugë ajrore dhe dërgesat S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert do të vendosen në faturën e dërgimit CN 65 në një thes të mbyllur, që mund të jetë një thes transparent plastik, i futur në thesin që përmban faturën.

2.4 Çdo operator i caktuar që dërgon artikuj prioritarë, artikuj me rrugë tokësore ose artikuj S.A.L.

për t'u ridërguar në rrugë ajrore në transit à découvert duhet të njoftojë operatorët e caktuar ndërmjetës për çdo ndryshim që është bërë gjatë një periudhe kontabilizimi në dispozitat e përcaktuara për shkëmbimin e postës.

3. Vendosja dhe verifikimi i borderove CN 65

3.1 Peshat do të tregohen veçmas për çdo grup shtetesh të destinacionit në faturat CN 65. Këto i nënshtrohen një numërtimi të veçantë sipas dy serive konsekuative, njëra për artikujt e zakonshëm, dhe tjetra për artikujt rekomandë. Numri i faturave CN 65 do të regjistrohet në rubriken korrespondente të tabelës 4 faturës CN 31 (tabela 3 e faturës CN 32). Operatorët e caktuar të transitit mund të kërkojnë përdorimin e faturave të posaçme CN 65 duke renditur grupet më të rëndësishme të shteteve. Të gjitha faturat CN 65 futen në thesin që përmban faturëb CN 31.

3.2 Pesha e artikujve prioritarë à découvert, artikujt e postës ajrore dhe artikujt S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore për çdo grup shtetesh do të rrumbullakoset në dekagramin më të lartë kur fraksioni i dekagramit është i barabartë ose më i lartë se 5 gram; në rast të kundërt ai do të rrumbullakoset në dekagramin më të ulët.

3.3 Nëse zyra ndërmjetëse konstaton se pesha reale e artikujve prioritarë, artikujve me postë ajrore dhe artikujve S.A.L. à découvert për t'u ridërguar në rrugë ajrore ndryshon me më shumë se 20 gram nga pesha e deklaruar, do të korrigjojë faturën CN 65 dhe do të njoftojë menjëherë gabimin në zyrën e shkëmbimit dërguese amë anë të shënimit të verifikimit CN 43. Nëse diferenca e konstatuar mbetet në kufijtë e sipërpërmendura, do të merren si të vlefshme regjistrimet e zyrës dërguese.

3.4 Në rast mungese të faturës CN 65, artikujt prioritarë, artikujt me postë ajrore dhe artikujt S.A.L. à découvert për t'u ridërguar me rrugë ajrore duhet të ridërgohen me rrugë ajrore, me përjashtim të rastit kur rruga tokësore është më e shpejtë. Në rastet e përshtatshme, fatura CN 65 do të përgatitet në procedurë rutinë dhe parregullsitë do të dërgohen në zyrën e origjinës me anë të një shënimi CN 43.

4. Artikujt prioritarë, artikujt me postë ajrore dhe artikujt S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert të përjashtuara nga veprimet statistikore

4.1 Artikujt prioritarë, artikujt me postë ajrore dhe artikujt S.A.L. për t'u ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert të përjashtuara nga veprimet statistikore dhe për të cilat llogaritë janë përgatitur në bazë të peshës reale duhet të shoqërohen nga faturat CN 65. Nëse pesha e artikujve prioritarë, artikujve me postë ajrore dhe artikujve S. A. L. të dërguara gabim, që vijnë nga e njëjta zyrë shkëmbimi dhe të përfshira në një dërgesë të kësaj zyre, nuk i kalon 50 gram, nuk do të kryhet përgatitja rutinë e faturës CN 65 sipas pikës 3.4.

4.2 Artikujt prioritarë, artikujt me postë ajrore dhe artikujt S.A.L. të postuara në bordin e anijes në det të hapur me anë të pullave postare të shtetit të cilit i përket anija ose në të cilin është regjistruar ajo duhet të shoqërohen nga një faturë CN 65 kur dorëzohet à découvert në operatorin e caktuar të një porti të nivelit ndërmjetësues. Nëse anija nuk ka një zyrë poste, ato do të shoqërohen nga një deklaratë e peshave që duhet të shërbejë si bazë për kërkimin e detyrimeve të transportit ajror nga operatori i caktuar ndërmjetës. Fatura CN 65 apo deklarata e peshave duhet të përmbajë peshën e artikujve prioritarë, artikujve me rrugë ajrore dhe artikujve S.A.L. për çdo shtet të destinacionit, datën, emrin dhe flamurin e anijes, dhe do të numërohet duke ndjekur një seri vjetore vijuese për çdo anije. Këto tregues do të verifikohen nga zyra tek e cila anija ka dorëzuar artikujt.

Neni RL 239

Kontabilizimi i detyrimeve të transportit ajror

1. Kontabilizimi i shpenzimeve të transportit ajror do të kryhet në përputhje me nenet RL 237 dhe RL 238.

2. Pavarësisht nga rregullat e përmendura në pikën 1, operatorët e caktuar mund të vendosin me marrëveshje të përbashkët që kontabilizimi i dërgesave me rrugë ajrore të kryhet në bazë të kthimeve statistikore. Në këtë rast, ata do të përcaktojnë mënyrat e plotësimit të statistikave dhe përgatitjes së llogarive.



Neni RL 240

Përgatitja e situacioneve të peshës CN 66 dhe CN 67

1. Çdo operator i caktuar kreditor do të përgatisë çdo muaj ose çdo tremujor, sipas preferencës, një situacion CN 66 sipas detajeve të postës ajrore të regjistruara në faturën e dërgesës CN 38. Dërgesat e transportuara në të njëjtin seksion ajror do të regjistrohen në situacion nga zyra e origjinës, e më pas nga shteti dhe zyra e destinacionit dhe, në rend kronologjik të dërgesave për çdo zyrë të destinacionit. Në rastin kur janë përdorur kopje të situacionit CN 55 përdoren për shlyerjen e detyrimeve të transportit ajror brenda vendit të destinacionit sipas nenit 33. 5 të Konventës, do të përdoret situacioni i peshës CN 55 i përgatitur mbi bazën e faturave CN 31 dhe CN 32.

2. Për artikujt prioritarë, artikujt me postë ajrore dhe artikujt S.A.L. à découvert për t'u ridërguar me rrugë ajrore, operatori i caktuar kreditor do të përgatisë në çdo vit një situacion CN 67. Kjo do të kryhet në fund të çdo periudhë statistikore të parashikuar nga neni RL 238.2.1 dhe sipas treguesve që figurojnë në faturat CN 65 të përgatitura gjatë kësaj periudhe. Peshat totale do të shumëzohen me 12 në situacionin CN 67. Nëse llogaritë do të përgatiten sipas peshës reale të artikujve prioritarë, artikujve me postë ajrore dhe artikujve S.A.L., situacionet CN 67 do të përgatiten me shpeshtësi të tillë siç parashikuar në pikën 1 për situacionet CN 66 dhe mbi bazën e faturave korresponduese CN 65.

3. Nëse, gjatë një periudhe kontabël, një ndryshim i ndodhur në marrëveshjet e bëra për shkëmbimin e artikujve prioritarë, artikujve me postë ajrore dhe artikujve S.A.L. të ridërguara me rrugë ajrore në transit à découvert sjell një ndryshim prej të paktën 20% dhe që kalon 163.35 SDR në totalin e shumave për t'u paguar nga operatori i caktuar dërgues tek operatori i caktuar ndërmjetës, këta operatorë të caktuar, me kërkesë të njëjës apo tjetrës, do të bien dakort për të zëvendësuar koeficientin e referuar në pikën 2 me një tjetër që vlen vetëm për vitin e marrë në konsideratë.

4. Në rastin kur operatori i caktuar debitor e kërkon, do të hartohen situacione të veçanta CN 55, CN 66 dhe CN 67 për çdo zyrë shkëmbimi që dërgon postë ajrore ose artikuj prioritarë, artikuj të dërguar me rrugë ajrore dhe artikujt S.A.L. të ridërguar me rrugë ajrore në transit à découvert.

Neni RL 241

Përgatitja e llogarive të detajuara CN 51 dhe të llogarive të përgjithshme CN 52

1. Operatori i caktuar kreditor do të përgatisë, në një formular CN 51, llogaritë e detajuara që tregojnë shumat për tu paguar sipas situacioneve të peshës CN 55, CN 66 dhe CN 67. Llogaritë e detajuara do të përgatiten për postën ajrore të mbyllur dhe për artikujt prioritarë, artikujt me rrugë ajrore dhe artikujt S.A.L. à découvert të ridërguar me rrugë ajrore. Në disa llogari të detajuara CN 51 të përgatitura për postën ajrore të mbyllur, duhet të regjistrohen veçmas per LC/AO, CP dhe EMS pesha dhe shumat për tu paguar në përputhje me situacionet e peshës CN 66.

2. Shumat që do të përfshihen në llogaritë e detajuara CN 51 do të llogariten:

2.1 për dërgesat e mbyllura, mbi bazën e peshave bruto që pasqyrohen në situacionet CN 55 dhe CN 66;

2.2 për artikujt prioritarë, artikujt me rrugë ajrore dhe artikujt S.A.L. à découvert, sipas peshave neto që pasqyrohen në situacionet CN 67, të shtuara me 5%.

3. Në rastin kur detyrimet e transportit ajror brenda vendit të destinacionit duhet të shlyhen, operatori i caktuar i këtij shteti do të dërgojë llogaritë CN 51 në lidhje me to për pranimsë bashku me situacionet CN 55 dhe CN 56.

4. Llogaritë CN 51 do të përgatiten nga operatori i caktuar kreditor në periudha një mujore, tremujore, gjashtëmujore ose vjetore, sipas marrëveshjes ndërmjet operatorëve të caktuar në fjalë.

5. Llogaritë e detajuara CN 51 mund të përmbledhen në një llogari të përgjithshme CN 52 të përgatitur çdo tremujor nga operatori i caktuar kreditor që ka miratuar sistemin e kompensimit për shlyerjen e llogarive. Kjo llogari, megjithatë, mund të përgatitet për periudha gjashtëmujore, sipas marrëveshjes ndërmjet operatorëve të caktuar në fjalë.

Neni RL 242

Paraqitja dhe pranimi i situacioneve CN 55, CN 66 dhe CN 67, llogarive të detajuara CN 51 dhe llogarive të përgjithshme CN 52

1. Sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi brenda gjashtë muajve pas përfundimit të periudhës së cilës i referohet, operatori i caktuar kreditor do ti dërgojë operatorit të caktuar debitor situacionet CN 66, kopje të situacioneve CN 55 dhe të situacioneve CN 67 kur pagesa për artikujt prioritarë, artikujt me rrugë ajrore dhe artikujt S.A.L. à découvert të ridërguara me postë ajrore, kryhet mbi bazën e peshave reale dhe llogaritë e detajuara CN 51 përkatëse, të gjitha në dy kopje. operatori i caktuar debitor mund të refuzojë pranimin e llogarive që nuk i janë dërguar brenda këtij afati.

2. Pas verifikimit të situacioneve CN 55, CN 66 dhe CN 67 dhe pranimit të llogarive të detajuara CN 51 përkatëse, një kopje e llogarive CN 51 do t'i kthehet operatorit të caktuar kreditor. Në rast të korrigjimit ai do të shoqërohet me situacionin CN 55, CN 66 dhe CN 67. Nëse operatori i caktuar kreditor kundërshton ndryshimet e bëra në këto situacione, operatori i caktuar debitor do të konfirmojë të dhënat reale duke transmetuar fotokopje të formularëve CN 38 ose CN 65 të hartuar në zyrën e origjinës gjatë dërgimit të dërgesave të kundërshtuara. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me ndryshimet duhet të paraqiten brenda dy muajve nga marrja e situacioneve dhe llogarive të ndryshuara. Operatori i caktuar kreditor që nuk ka marrë asnjë njoftim të ndryshimit brenda afatit prej dy muajsh nga data e dërgimit do ti konsiderojë llogaritë si plotësisht të pranuar.

3. Operatorët e caktuar që kanë rezultuar kreditorë neto gjatë vitit të mëparshëm mund të zgjedhin të paguhen sipas një periudhe mujore, tremujore, gjashtëmujore ose një vjeçare. Varianti i zgjedhur do të mbetet në fuqi gjatë një viti kalendarik duke filluar nga 1 janari.

4. Operatorët e caktuar kanë të drejtën të përdorin sistemin e drejtpërdrejtë ose sistemin e kompensimit dypalësh.

5. Dispozitat sipas pikave 1 dhe 2 do të zbatohen gjithashtu për artikujt prioritarë dhe artikujt e postës ajrore për të cilat është bërë pagesa mbi bazën e statistikave.

6. Në kuadrin e sistemit të faturimit të drejtpërdrejtë, llogaritë CN 51 do të shërbejnë si fatura që do të shlyhen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Operatori i caktuar debitor duhet të bëjë pagesën e shumës së faturuar brenda afatit prej 6 javësh të parashikuar në nenin RL 252.10. Ai mund të refuzojë verifikimin dhe pranimin e çdo llogarie CN 51 e cila nuk është paraqitur nga operatori i caktuar kreditor brenda afatit 10 mujor pas periudhës së cilës i referohet. Çdo diferencë që i kalon 9.80 SDR që mund të llogaritet nga operatori i caktuar debitor do të regjistrohet në llogarinë CN 51, e cila i kthehet operatorit të caktuar kreditor, e shoqëruar me llogaritë CN 55, CN 66 dhe CN 67. Diferenca e konstatuar do të përfshihet në llogarinë e ardhshme CN 51 që i paraqitet operatorit të caktuar debitor ose do të jetë objekt i një kundërshtimi brenda dy muajve që do të pasojnë marrjen e llogarisë që paraqet diferenca. Nëse kjo nuk arrihet, operatori i caktuar që ka sinjalizuar diferencën, do ta konsiderojë si plotësisht të pranuar dhe do ta paraqesë si të tillë në llogarinë e ardhshme CN 51, të modifikuar sipas rastit.

7. Në kuadrin e sistemit të kompensimit dypalësh, operatori i caktuar kreditor do të përgatisë llogaritë CN 51 dhe CN 52 dhe ia paraqet njëkohësisht operatorit të caktuar debitor çdo muaj, çdo tremujor, çdo gjashtëmujor ose çdo vit. Operatori i caktuar debitor pranon ose ndryshon llogaritë CN 51 dhe CN 52 brenda dy muajve dhe do të kryejë pagesat për shumat e faturuara sipas parashikimeve të nenit RL 252.10. Në rastin e ndryshimit të llogarive CN 51 ose CN 52, pagesa do të kryhet në bazën e shumës së ndryshuar. Nëse operatori i caktuar i cili ka dërguar llogaritë nuk ka marrë asnjë njoftim për ndryshim brenda afatit dy mujor, llogaritë do të konsiderohen si plotësisht të pranuar.

8. Çdo ndryshim i llogarive të përgjithshme CN 52 nga operatori i caktuar debitor duhet të shoqërohet nga llogaritë e detajuara CN 19 dhe CN 51 mbështetëse dhe nga llogaritë përmbledhëse CP 75.

9. Sa herë që statistikat kryhen në tetor, pagesat vjetore për artikujt prioritarë dhe artikujt e postës ajrore në transit à découvert mund të kryhen përkohësisht duke u bazuar në statistikat e kryera në majin e vitit paraardhës. Pagesat e përkohshme do të rregullohen më pas në vitin pasardhës, kur llogaritë e bazuara në statistikat e tetorit pranohen ose konsiderohen si plotësisht të pranuar.

10. Nëse një operator i caktuar nuk mund të kryejë veprimet e statistikave vjetore, ai do të bjerë dakord me operatorin e caktuar të interesuar për të rregulluar pagesën vjetore në bazën e statistikave të vitit paraardhës dhe për të përdorur, nëse është e nevojshme, koeficientin e posaçëm të parashikuar në nenin RL 240.3.

11. Nëse bilanci i një llogarie CN 51 ose CN 52 nuk kalon 163.35 SDR, atëherë do të kryhet me llogarinë e ardhshme CN 51 ose CN 52 kur operatorët e caktuar të interesuara nuk marrin pjesë në sistemin e kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare.

12. Situacionet CN 55, CN 66 dhe CN 67 si dhe llogaritë korresponduese CN 51 dhe CN 52 do të



dërgohen gjithmonë me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

13. Shlyerjet do të kryhen në përputhje me dispozitat e neneve RL 249 dhe RL 251.

Neni RL 243

Ndryshimi i detyrimeve të transportit ajror

1 Ndryshimet që i bëhen detyrimeve të transportit ajror të parashikuara në nenin RL 237.4 dhe RL 238.1 do të:

1.1 hyjnë në fuqi vetëm më datë 1 janar

1.2 njoftohen të paktën tre muaj përpara Byrosë Ndërkombëtare që ia komunikon të gjithë operatorëve të caktuar të paktën dy muaj para datës së vendosur në pikën 1.1.

Neni RL 244

Pagesa e detyrimeve të transportit ajror

1. Detyrimet e transportit ajror do të jenë të pagueshme për shoqërinë e fluturimeve që kryen transportin për të gjithë ose një pjesë të distancës.

2. Pavarësisht nga ky rregull, shoqëria e fluturimeve mund të kërkojë që detyrimet e transportit ti paguhen operatorit të caktuar postar me të cilën shoqëria e fluturimit ka lidhur një marrëveshje për këtë efekt.

3. Detyrimet për artikujt prioritarë, artikujt e postës ajrore dhe artikujt S.A.L në transit à découvert do ti paguhen operatorit të caktuar që kryen ridërgimin e këtyre artikujve.

4. Me përjashtim të rastit kur ka marrëveshje të tjera, detyrimet e transportit për postën ajrore të të dërguara drejtpërdrejt me dy shoqëri të ndryshme fluturimi do të shlyhen nga operatori i caktuar i origjinës:

1.1 Me transportuesit e parë, i cili do të jetë përgjegjës për pagesën e transportuesit tjetër;

1.2 Secilit transportues që merr pjesë në transport.

Neni RL 245

Pagesa e detyrimeve të transportit ajror për transportin e thasëve bosh

1. Detyrimet e transportit ajror të thasëve bosh do të paguhen nga operatori i caktuar që ka në pronësi thasët.

2. Çmimi maksimal i zbatueshëm në rastin e transportit ajror të thasëve bosh i korrespondon 30% të çmimit bazë të vendosur në përputhje me dispozitat e nenit RL 237.2.

Neni RL 246

Detyrimet e transportit ajror të dërgesave apo thasëve të devijuara apo të dërguara gabim

1. Operatori i caktuar i origjinës së një dërgese të devijuar gjatë transportit do të paguajë detyrimet e transportit të kësaj dërgese sipas sektorëve realisht të mbuluar.

2. Ai do të shlyejë detyrimet e transportit deri në aeroportin e dërgimit fillestar të parashikuar në faturën e dërgimit CN 38 kur:

2.1 rruga reale e dërgimit nuk njihet;

2.2 detyrimet për rrugën e kryer realisht nuk janë reklamuar akoma; ose

2.3 devijimi është përgjegjësi e shoqërisë së fluturimit që ka garantuar dhe transportin.

3. Detyrimet shtesë që rezultojnë nga rruga e ndjekur realisht nga dërgesa e devijuar janë të rimbursueshme në kushtet e mëposhtme:

3.1 nga operatori i caktuar shërbimet e së cilit kanë bërë gabimin në rastin e dërgimit gabim;

3.2 nga operatori i caktuar që ka mbledhur detyrimet e transportit të paguara shoqërisë së fluturimit kur ky i fundit ka dorëzuar në një vend të ndryshëm nga ai që tregohet në faturën e dërgimit CN 38.

4. Dispozitat e parashikuara nga pikat 1 deri në 3 janë të zbatueshme për analogji edhe kur vetëm një pjesë e dërgesës është dërguar në një aeroport të ndryshëm nga ai i treguar në faturën e dërgimit CN 38.

5. Operatori i caktuar i origjinës së një dërgese apo të një thesi të dërguar gabim si pasojë e një etiketimi të gabuar duhet të paguajë shpenzimet e transportit për të gjithë distancën ajrore, sipas nenit 33.3.1 të

Konventës.

Neni RL 247

Detyrimet e transportit ajror të dërgesave të humbura apo të shkatërruara

1. Në rast të humbjes apo shkatërrimit të dërgesave si pasojë e një aksidenti që i ka ndodhur avionit apo të çfarëdo shkakut tjetër që bën me përgjegjësi shoqërinë e fluturimeve, operatori i caktuar i origjinës përjashtohet nga çdo pagesë në lidhje me transportin ajror të dërgesave të humbura apo të shkatërruara.

KAPITULLI 13

SHLYERJA E LLOGARIVE. PAGESA

Neni RL 248

Transferta elektronike e situacioneve dhe llogarive

1. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të shkëmbejnë situacionet dhe llogaritë në rrugë elektronike.

2. Në rastin e transfertave elektronike, do të zbatohen afatet e mëposhtme për pranimin e situacioneve dhe llogarive, me përjashtim të rastit kur është rënë dakord ndryshë:

Emërtimi ose lloji	formulari	Afati
Shpërblimet	CN 48	dy muaj
Postë ajrore	CN 51	një muaj
Llogari e përgjithshme	CN 52	një muaj
Situacioni përmbledhës vjetore	CN 54bis	
- Mekanizëm i rishikimit/ harmonizimit		një muaj
- Shkëmbime të dërgesave mes shteteve të industrializuara		dy muaj
Situacione përmbledhëse të dërgesave	CN 56	dy muaj
Llogari të detajuara. Shpenzime terminale	CN 61	një muaj
Llogari të detajuara. Shlyerja. Detyrime përfundimtare	CN 61bis	një muaj
Llogari të detajuara. Shpenzime transiti	CN 62	dy muaj
Situacione. Shpenzime transiti	CN 63	një muaj
Situacione. Detyrime përfundimtare	CN 64	një muaj
Koli	CN 75	një muaj

Neni RL 249

Përgatitja dhe shlyerja i llogarive

1. Shlyerjet ndërmjet operatorëve të caktuar të llogarive ndërkombëtare që vijnë nga trafiku postar mund të konsiderohen si transaksione aktuale dhe të kryera në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të shteteve anëtare të interesuara, kur ekzistojnë marrëveshje lidhur me këtë çështje. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla, këto rregullime të llogarive do të realizohen në përputhje me dispozitat e parashikuara më poshtë.

2. Me përjashtim të rastit të llogarive CN 51 dhe CN 52 të cilat do të vendosen sipas nenit RL 241, çdo operator i caktuar do të hartojë llogaritë e tij dhe ia paraqet ato në dy kopje personave të tjerë të interesuar. Njëra prej kopjeve të pranuar, nëse është e nevojshme e ndryshuar ose e shoqëruar me një gjendje e mospërputhjeve, i dërgohet operatorit të caktuar kreditor. Kjo llogari shërben si bazë për përgatitjen, sipas rastit, të kontabilitetit përfundimtar mes dy operatorëve të caktuar.

3. Në shumën e çdo llogarie të përgatitur në SDR mbi formularët CN 02bis, CN 03, CN 03bis, CN 48, CN 51, CN 52, CN 57, CN 61, CN 61bis, CN 62, CN 63, CN 64 dhe CN 64bis, do të injorohen presjet dhjetore në totalin apo në bilanc. Mospërputhjet në llogaritë e përgatitura në formularët e renditur më sipër nuk do të merren në konsideratë nëse nuk kalojnë në total 9.80 SDR për llogari.

4. Operatorët e caktuar kanë të drejtën të shlyejnë llogaritë e tyre qoftë në mënyrë dypalëshe, qoftë përmes sistemit të kompensimit shumëpalësh të Byrosë ndërkombëtare, qoftë përmes çdo sistemi tjetër të



likuidimit të llogarive. Vetëm operatorët e caktuar që kanë nënshkruar marrëveshjen për aderimin e tyre në sistem kanë të drejtë të marrin pjesë në sistemin e kompensimit shumëpalësh të Byrosë ndërkombëtare.

5. Operatori i caktuar kreditor zgjedh mënyrat e likuidimit, pasi konsultohet me operatorin e caktuar debitor. Në rast të mosmarrëveshjeve, zgjedhja e operatorit të caktuar kreditor ka përparësinë. Në rast të shlyerjes me ndërmjetësinë e sistemit të kompensimit shumëpalësh të Byrosë ndërkombëtare, operatorin e caktuar kreditor dhe ai debitor duhet të kenë nënshkruar të dyja marrëveshjen e aderimit dhe të kenë rënë dakord midis tyre për përfshirjen e llogarisë përkatëse në sistem.

Neni RL 250

Likuidimi i llogarive me anë të Byrosë Ndërkombëtare

1. Likuidimi i llogarive me ndërmjetësinë e sistemit të kompensimit të Byrosë ndërkombëtare bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga Grupi i përdoruesve të kompensimit të UPU*.

Neni RL 251

Pagesa e debive të shprehura në SDR. Dispozitat e përgjithshme

1. Rregullat e pagesës të parashikuara më poshtë janë të zbatueshme për të gjitha debitë e shprehura në SDR dhe të lindura nga një trafik postar. Debitë mund të rezultojnë nga llogaritë e përgjithshme ose nga situacionet e hartuara nga Byroja ndërkombëtare, qoftë nga llogaritë e likuidimit ose situacionet që nuk janë hartuar nga Byroja. Rregullat e mësipërme i përkasin gjithashtu dhe rregullimit të diferencave, të interesave apo sipas rastit, të pagesës së llogarive.

2. Të gjithë operatorët e caktuar janë të lirë të shkarkohen nga përgjegjësitë mbi llogaritë, nga të cilat do të zbriten debitë e tij kur këto janë marrë.

3. Me kusht që të respektohen periudhat e pagesës, çdo operator i caktuar mund të shlyejë debitë postare të shprehura në SDR duke kompensuar kreditë dhe debitë në marrëdhëniet me një operator tjetër të caktuar. Kompensimi mund të shtrihet me një marrëveshje të përbashkët edhe në kreditë e shërbimeve të telekomunikacionit kur të dy operatorët e caktuar sigurojnë shërbime postare dhe telekomunikimi. Kompensimi nuk mund të kryhet me debitë në lidhje me transaksionet e kontraktuara me një organizatë apo një shoqëri nën kontrollin e një operatori të caktuar nëse kundërshtohet nga ky operator i caktuar.

4. Përfshirja e një llogarie të postës ajrore në një llogari të përgjithshme që përfshin debi të ndryshme nuk duhet të ketë si rezultat vonesën e pagesës së shpenzimeve të transportit ajror që duhet të paguhet shoqërisë së fluturimit të interesuar.

Neni RL 252

Rregullat për pagesën e llogarive të pashlyera me anë të Byrosë Ndërkombëtare

1. Debitë do të paguheshin në monedhën e zgjedhur nga operatori i caktuar kreditor pas konsultimit me operatorin e caktuar debitor. Nëse ka mosmarrëveshje, zgjedhja e operatorit të caktuar kreditor do të mbizotërojë në të gjitha rastet. Nëse operatorin e caktuar kreditor nuk specifikon një monedhë, zgjedhja do të takojë operatorin të caktuar debitor.

2. Shuma e pagesës, siç përcaktohet në monedhën e përzgjedhur, do të jetë ekuivalente në vlerë me bilancin e llogarisë të shprehur në SDR.

3. Subjekt i dispozitave të përcaktuara në pikën 4, shumën që duhet të paguhet në monedhën e zgjedhur do të përcaktohet nga konvertimi në SDR në monedhat e pagesës në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

3.1 Në rastin e monedhave për të cilën kursi i këmbimit të SDR-së është publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), do të përdoret kursi i këmbimit në fuqi në ditën para pagesës ose kursi më i fundit e publikuar.

3.2 Në rastin e monedhave të tjera të pagesës, si një fazë e parë, shumën në SDR do të konvertohet në një monedhë të ndërmjetme për të cilën vlera ndaj SDR-së publikohet çdo ditë nga FMN-ja, duke përdorur kursin e këmbimit më të fundit të publikuar. Si fazë e dytë, rezultati i marrë në këtë mënyrë do të konvertohet në monedhën e pagesës, duke aplikuar kursin e fundit të këmbimit të kuotuar në tregun e këmbimit të shtetit anëtar debitor.

4. Nëse, me marrëveshje të ndërsjellë, operatori i caktuar kreditor dhe operatori i caktuar debitor kanë zgjedhur monedhën e një vendi që nuk është anëtar i FMN-së dhe ligjet e të cilit nuk lejojnë zbatimin e dispozitave të përcaktuara sipas pikës 3, operatorët e caktuar në fjalë do të bien dakord mbi marrëdhëniet midis SDR dhe vlerës së monedhës së zgjedhur.

5. Për qëllimin e përcaktimit të ekuivalentit të një monedhe, kursi i përmendur do të jetë kursi i mbylljes për valutën që mund të përdoret në shumicën e transaksioneve të tregtisë në tregun e huaj zyrtar të këmbimit.

6. Operatori i caktuar debitor duhet të paguajë, në datën e pagesës, shumën në monedhën e zgjedhur me anë të xhirimit postar apo ndonjë mjet tjetër të pranueshëm për të dy operatorët e caktuar.

7. Operatorët e caktuar kreditor do të publikojnë, me anë të një qarkoreje të lëshuar nga Byroja Ndërkombëtare, çdo ndryshim në adresat në të cilat do të dërgohen çeqet ose transfertat përcjellëse.

8. Tarifat e pagesës (komisionet bankare, detyrimet e kompensimit, depozitat, komisionet, etj) të mbledhura në shtetin debitor do të përballohen nga operatori i caktuar debitor. Tarifat e mbledhura në shtetin kreditor, duke përfshirë pagesën e tarifave të mbledhura nga bankat në shtetet ndërmjetëse, do të përballohen nga operatori i caktuar kreditor. Kur është përdorur, sistemi i transfertave me xhirim postar me përjashtimin nga tarifati, përjashtimi do të jepet nga zyra e shkëmbimit në shtetin e tretë ose në shtetet që veprojnë si ndërmjetës midis operatorit të caktuar debitor dhe operatorit të caktuar kreditor, kur nuk ka shkëmbime të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre

9. Në qoftë se, midis dërgimit të urdhër transfertës ose pagesës me mjete të tjera dhe marrjes së saj nga ana e operatorit të caktuar kreditor ndodh një ndryshim në vlerën ekuivalente të monedhës së shtetit të zgjedhur, të llogaritur siç përshkruhet në pikat 3, 4 ose 5, dhe nëse diferenca që rezulton nga ky ndryshim e tejkalon 5% të shumës së detyrimit (ndryshimi llogaritet si vijon), diferenca e përgjithshme do të ndahet në mënyrë të barabartë mes dy operatorëve të caktuar.

10. Pagesa do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi brenda gjashtë muajve nga data e pranimi ose njoftimit të pranimi zyrtar të llogarive të likuidimit dhe llogarive që tregojnë shumën ose bilancin që duhet shlyer. Pas kësaj periudhe shumën e detyrimeve do të ngarkohen me interes prej 6% në vit të llogaritur nga dita pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur. Me pagesë kuptohet dërgimi i fondeve ose të instrumentit të pagesës (çek, urdhër-pagesë, etj) ose nënshkrimin e urdhër transfertave ose depozitimit nga organizata përgjegjëse për transferimin në shtetin anëtar debitor.

11. Kur është bërë pagesa, dokumenti i transfertës (çeku, urdhër-pagesa, etj), do të shoqërohet nga veçoritë e titullit, periudha dhe shumën në SDR, kursi i konvertimit të përdorur dhe data e zbatueshme e këtij kursi për çdo sasi të përfshirë në shumën totale të dërguar. Në qoftë se nuk është e mundur që detajet të shoqërojnë transfertën ose dërgesën e parave, do të jepet një letër shpjeguese me anë të mjeteve elektronike ose me postë dhe përmes rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore) në ditën kur është realizuar pagesa. Shpjegimi i detajuar do të jetë në frëngjisht ose në një gjuhë që kuptohet në operatorin e caktuar të cilit i është bërë pagesa.

KAPITULLI 14 SHËRBIMET EMS

Neni RL 253 Shërbimet EMS

1. Në shkëmbimet mes operatorëve të caktuar që kanë vendosur të sigurojnë këtë shërbim shërbimi EMS ka përparësinë mbi artikujt postarë. Ai konsiston në mbledhjen, transmetimin dhe shpërndarjen në afate shumë të shkurtra të korrespondencave të dokumentave apo të mallrave.

2. Shërbimi EMS do të rregullohet mbi bazën e marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe. Aspektet që nuk përfshihen në mënyrë specifike në këto marrëveshje i nënshtrohen dispozitave përkatëse të Akteve të Unionit.

3. Ky shërbim, brenda mundësive, do të identifikohet nga një logo e treguar më poshtë i përbërë nga elementët e mëposhtëm:

- një krah ngjyrë portokalli
- shkronjat EMS me ngjyrë blu
- tre vija horizontale ngjyrë portokalli

Logoja mund të plotësohet nga emri i shërbimit kombëtar.



4. Tarifat që i përkasin shërbimit përcaktohen nga operatori i caktuar i origjinës duke patur parasysh çmimet dhe kërkesat e tregut.

Neni RL 254
Veprimtaria e shërbimit EMS

1. Për të ruajtur rrjetin EMS, dhe nëse rrethanat e kërkojnë, një shtet anëtar dhe / ose operator i caktuar ka mundësinë të japë shërbimin EMS me shoqëritë private që veprojnë në një shtet tjetër, me kusht që të respektojë legjislacionin e brendshëm të atij shteti.

KAPITULLI 15
POSTA ELEKTRONIKE. LIDHJET TELEMATIKE

Neni RL 255
Posta hibride

1. Posta hibride është një shërbim postar që përdor rrugën e telekomunikacioneve për të transmetuar sipas origjinalit dhe në disa sekonda, mesazhet e marra nga dërguesi në formë fizike apo elektronike dhe që duhet t'i dërgohen marrësit në formë fizike apo elektronike. Në rastin e marrjes në formë fizike, informacionet në përgjithësi transmetohen në mënyrë elektronike në distanca sa më të largëta dhe riprodhohen në formë fizike sa më afër marrësit. Mesazhet në formë fizike i dërgohen marrësit si dërgesat e postës apo letrat.

1.1 Kur përdoret dërgimi fizik tek marrësi, informacioni, zakonisht, transmetohet me mjete elektronike për pjesën më të gjatë të procedit dhe prodhohet fizikisht sa më afër adresës së marrësit që të jetë e mundur.

2. Tarifat përkatëse të postës hibride janë të përcaktuara nga operatorët e caktuar duke marrë në konsideratë koston dhe kërkesat e tregut.

Neni RL 256
Shërbimi i faksit

1. Gama e shërbimeve të tipit të faksit zyrtar lejon të transmetosh tekste dhe ilustrime sipas origjinalit përmes telekopjes.

Neni RL 257
Shërbime të bazuara në tekst

1. Gama e shërbimeve lejon transmetimin e teksteve dhe ilustrimeve të gjeneruara nga instalime informatike (PC, kompjuter qëndror)

Neni RL 257bis
Marka e certifikimit elektronik postar

1. Në marrëdhëniet midis operatorëve të caktuar të cilët kanë rënë dakord për të siguruar këtë shërbim, marka e certifikimit elektronik postar, siç përcaktohet nga Standardi Teknik i UPU S43, ofron një zinxhir të provave, të ruajtur nga një operator i caktuar si një palë e tretë të besuar, për të provuar ekzistencën e një ngjarjeje elektronike, për një përmbajtje të caktuar, në një datë dhe kohë të caktuar, dhe që përfshin një ose më shumë palë të identifikuara. Operatorët e caktuar në fjalë do të sigurojnë që ata të vazhdojnë të përmbahen Standardi Teknik UPU S43, në përputhje me procedurat e aplikueshme të miratuara nga Këshilli i Operacioneve Postare me rekomandim të Bordit të Standardeve UPU.

2. Ofrimi i shërbimit të markës së certifikimit elektronik postar përtej kufijve do të qeveriset nga një

Model Trust i pranuar, siç përcaktohet në marrëveshjen shumëpalëshe midis operatorëve të caktuar që marrin pjesë në këtë shërbim. Ky Model Trust është i bazuar në faktin se operatorët e caktuar ofruan digjital të ndryshëm duhet të vërtetojnë veten kur kanë të bëjnë me transaksioneve ndër-kufitare të markës së certifikimit elektronik postare. Kjo do të bëhet nga operatorët e caktuar nëpërmjet shkëmbimit të informacionit përkatës nga identitetet e tyre markës së tyre të certifikimit elektronik postar Identitete Digjitale (çelësat shërbimit të tyre të markës së certifikimit postar p.sh. certifikata digjitale X509).

2.1 Çdo identitet digjital i operatorit të caktuar përbën një identifikues unik dixhital (një vijë ose një shenjë) e dhënë nga një palë e besuar e tretë që do të identifikojë pa dyshime se operatori i caktuar kur bashkëvepron, markën e certifikimit elektronik postar për qëllime të transaksioneve ndërkufitare, me operatorët e tjerë të caktuar dhe përdoruesit e tyre.

3. Me qëllim lejitim të operatorëve të caktuar pjesëmarrës që të jenë në kushte të kryejnë veprime të shërbimit të markës së certifikimit elektronik postar përtej kufijve duhet:

3.1 të merren identiteti i tyre i markës së certifikimit elektronik postar nga një palë e tretë provider e identitetit digjital; dhe

3.2 të informojë të gjithë operatorët e caktuar që ofrojnë një shërbim të tillë për këtë identitet dhe të shpërndajnë identitetin e tyre digjital sipas nevojës.

4. Tarifat për shërbimin e markës së certifikimit elektronik postar do të vendosen nga operatori i caktuar i origjinës do të konsiderojë kostot dhe kërkesat e tregut. Secili operator i caktuar:

4.1 të mbajë të ardhurat e gjeneruara nga oferta e tij e shërbimit të markës së certifikimit elektronik postar me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar pjesëmarrës bien dakord të ndajnë të ardhurat nga shërbimi i markës së certifikimit elektronik postar; dhe

4.2 të japë verifikimin e markës së certifikimit elektronik postar pa tarifa shtesë, pavarësisht nga ku është aplikuar marka e certifikimit elektronik postar.

5. Shërbimi i markës së certifikimit elektronik postar ndërmjet operatorëve të caktuar pjesëmarrës do të disiplinohet në bazë të marrëveshjeve shumëpalëshe të cilat do të reflektojnë dhe plotësojnë dispozitat e zbatueshme të përfshira në këtë Marrëveshje.

5.1 Marrëveshja shumëpalëshe do të specifikojë dispozitat e kërkuara për dhënien e shërbimit të markës së certifikimit elektronik postar përtej kufijve. Operatorët e caktuar, me marrëveshje të përbashkët, do të jenë të detyruar të përmbushin dispozitat e përfshira në marrëveshjen shumëpalëshe.

5.2 Aspektet që nuk janë disiplinuar shprehimisht nga marrëveshja shumëpalëshe e markës së certifikimit elektronik postar do të jenë subjekt i dispozitave të përshtatshme të Akteve të Bashkimit.

6. Shërbimi i markës së certifikimit elektronik postar, sa herë të jetë e mundur, do të identifikohet nga një logo e përcaktuar me marrëveshje shumëpalësh të referuar në paragrafin e mësipërm 5.

Neni RL 258

Lidhje telematike. Dispozita të përgjithshme

1. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të vendosin lidhje telematike mes tyre dhe me partnerë të tjerë.

2. Operatorët e caktuar në fjalë janë të lirë të zgjedhin furnizuesit dhe mbështetjen teknike (material logjistik dhe softëare) që do të shërbejë për realizimin e shkëmbimeve të të dhënave.

3. Në bashkëpunim dhe me furnizuesin e shërbimeve të rrjetit, operatorët e caktuar do të bien dakord në mënyrë dypalëshe për mënyrën e pagimit të këtyre shërbimeve.

4. Operatorët e caktuar nuk janë as financiarisht, as juridikisht përgjegjës nëse një operator tjetër i caktuar nuk bën pagesat që i përkasin shërbimeve të kryera përmes shkëmbimeve telematike.

Neni RL 259

Dispozita të veçanta të lidhura me lidhjet telematike

1. Operatorët e caktuar duhet tu përmbahen normave të zbatuara në nivel ndërkombëtar për të siguruar përshtatshmërinë e sistemeve.

2. Byroja ndërkombëtare do të publikojë, përditësojë dhe aktualizojë një guidë të konceptimit të mesazheve të UPU dhe një manual për përdoruesin e UPU, në kujdesin e operatorëve të caktuar.

3. Në shkëmbimet e tyre të të dhënave me operatorët e tjerë të caktuar dhe të partnerëve të jashtëm,



operatorët e caktuar përdorin mesazhet e përcaktuara në kuadrin e UPU dhe të publikuara nga Byroja ndërkombëtare në Standardet e Mesazheve EDI të UPU-t, nëse këto mesazhe i përkasin shkëmbimeve që ato dëshirojnë të bëjnë. Mund të përdoren gjithashtu mesazhet e përpunuara nga organizata të tjera, pasi të jenë miratuar nga UPU do të publikohen në Standardet e Mesazheve EDI të UPU-t.

4. (i fshirë)

5. Byroja ndërkombëtare do të publikojë rregullisht një listë dokumentash dhe guidash për trajtimin e lidhjeve telematike dhe i vë ato në dispozicion me kërkesë të operatorëve të caktuar që sigurojnë shërbime telematike.

Neni RL 260

Rregullat e pagesës së lidhjeve telematike

1. Operatorët e caktuar do të vendosin për mënyrën e pagesës së shërbimeve të rrjetit duke zgjedhur njërin prej tre procedurave të përshkruara më poshtë:

1.1 operatori i caktuar dërgues nuk paguan për mesazhet që dërgon;

1.2 operatori i caktuar marrës nuk paguan për mesazhet që merr;

1.3 operatorët e caktuar dërgues dhe marrës bien dakord për të ndarë në mënyrë të njëjtë e të barabartë koston e transmetimit dhe marrjes së mesazheve.

2. Në rastin kur dy operatorë të caktuar nuk mund të bien dakord për një mënyrë pagese për shërbimet e rrjetit, metoda e përshkruar në pikën 1. 1 do të zbatohet automatikisht, me përjashtim të rastit kur dy operatorë të caktuar mund të kenë rënë dakord për një mënyrë alternative pagese.

KAPITULLI 16

SHËRBIME LOGJISTIKE TË INTEGRUARA

Neni RL 261

Shërbime logjistike të integruara

1. Në marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të caktuar të cilët kanë rënë dakord për të siguruar këtë shërbim, shërbimi i integruar i logjistikës mund të përfshijë mbledhjen, pranimin, përpunimin, ruajtjen, trajtimin, shpërndarjen, transferimin, transportin dhe dorëzimin fizik të dokumenteve të veçanta ose të kombinuara ose të mallrave.

2. Të dhënat për një shërbim të integruar të logjistikës që përfshin dy ose më shumë operatorë të caktuar do të bazohet në marrëveshjet dypalëshe. Aspektet që nuk rregullohen shprehimisht nga këto të fundit do të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të Akteve të Bashkimit.

3. Tarifat për shërbimin do të përcaktohen nga operatori i caktuar i origjinës duke konsideruar kostot dhe kërkesat e tregut.

KAPITULLI 17

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni RL 262

Informacioni që do të jepet nga operatorët e caktuar

1. Operatorët e caktuar duhet ti komunikojnë Byrosë mbi formularët e dërguar nga kjo e fundit, informacione të nevojshme lidhur me ekzekutimin e shërbimit postar. Më konkretisht këto informacione do të çojnë në pyetjet e mëposhtme:

1.1 vendimet e marra për të drejtën për të zbatuar apo jo disa dispozita të përgjithshme të Konventës dhe të Rregulloreve;

1.2 tarifat e zvogëluara të përshtatura sipas nenit 8 të Kushtetutës dhe detaje të shërbimeve për të cilat zbatohen këto taksa;

1.3 tarifat e brendshme postare të zbatuara;

1.4 në përputhje me nenin 20 të Konventës:

1.4.1 objektivat e cilësisë së shërbimit të caktuara nga shpërndarja në shtetet e tyre të artikujve prioritarë, të postës ajrore dhe artinjeve të zakonshëm dhe me rrugë tokësore.

1.4.2 Kufirin e orarit të pranimit (LAT) për postën ndërkombëtare në hyrje, në aeroport apo në vende të tjera të përshtatshme;

1.4.3 Kufiri i orarit të pranimit në zyrat e shkëmbimit të mbërritjes;

1.4.4 Niveli i shërbimeve që mund të arrihet (p.sh shpërndarja në ditën e nesërme në kryeqytet apo të pasnesërmen në pjesën tjetër të vendit);

1.5 përqindjet e ndryshme të transportit ajror të përcaktuara në nenin RL 237. 4 dhe RL 238. 1. 1 me datat e zbatimit;

1.6 tarifatat ajrore apo tarifatat e kombinuara për kategori të ndryshme të dërgimeve me avion dhe për shtete të ndryshme, me treguesin e emrave të shteteve për të cilat pranohet shërbimi i postës pa tarifë.

2. Çdo ndryshim i raporteve të përshkruara në pikën 1, duhet të transmetohet pa vonesa në Byronë ndërkombëtare me anë të rrugës më të shpejtë. Ato që i përkasin udhëzimeve të paraqitura në pikën 1. 5 duhet të mbërrijnë në Byronë ndërkombëtare në afatin e parashikuar në nenin RL 243.

3. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për t'i komunikuar drejtpërdrejt informacionet lidhur me shërbimet ajrore që u interesojnë, në mënyrë më specifike, oraret dhe orët e përcaktuara për të cilat dërgimet që vijnë nga jashtë vendit me avion duhet të arrijnë për të kapur shpërndarjet e ndryshme.

4. Shtetet pjesëmarrëse të shërbimit të artikujve të siguruar që japin shkëmbime direkte do ti komunikojnë njëra tjetrës me anë të përmes tabelave CN 27, informacionet në lidhje me shkëmbimet e këtyre artikujve.

5. Operatorët e caktuar duhet ti dërgojnë Byrosë ndërkombëtare dy kopje të dokumentacionit që ata publikojnë si për shërbimin e brendshëm ashtu dhe për atë ndërkombëtar. Ato i dërgojnë gjithashtu, me aq sa kanë mundësi, publikimet e tjera në shtetet e tyre që kanë të bëjnë me shërbimin postar.

Neni RL 263

Publikimet e Byrosë Ndërkombëtare

1. Byroja Ndërkombëtare, në bazë të informacioneve të dhëna në përputhje me nenin RL 262, do të publikojë një përmbledhje zyrtare të informacionit me interes të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e Konventës dhe Rregullores të saj në çdo shtet anëtar. Ajo gjithashtu do të publikojë një përmbledhje të ngjashme në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare dhe Rregullores së saj, në bazë të informatave të dhëna nga shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar në fjalë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores së kësaj Marrëveshjeje.

2. Ajo gjithashtu do të publikojë, nga informacioni i dhënë nga operatorët e caktuar dhe, sipas rastit, nga Sindikatat e Kufizuara për sa i përket pikës 2.1, ose Kombeve të Bashkuara për sa i përket pikës 2.5:

2.1 një listë të adresave, të drejtuesve dhe zyrtarëve më të lartë të çështjeve postare të shteteve anëtare dhe të operatorëve të caktuar dhe Sindikatave të Kufizuara duke përfshirë adresat e tyre të emailit. Lista do të përfshijë të paktës për sa i përket shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar duke përfshirë informacionin rreth çdo adrese specifike, duke përfshirë adresën e emailit, për fushat e mëposhtme:

2.1.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare

2.1.2 sigurinë

2.1.3 marrëdhëniet me klientët ndërkombëtarë;

2.1.4 reklamimet

2.1.5 mjedisin

2.1.6 kontabilitetin; dhe

2.1.7 informacionin e emergjencës të llojit operacional (EmIS);

2.2 një listë ndërkombëtare të zyrave postare;

2.3 një përmbledhje të informacionit të transitit duke përfshirë:

2.3.1 një listë të distancave kilometrike që lidhen me sektorët tokësorë të postës në transit;

2.3.2 një listë të shërbimeve të transitit të ofruara për postën tokësore (duke përfshirë edhe postën S.A.L.);

2.4 një listë të ekuivalentëve;

2.5 një listë të artikujve të ndaluara e cila do të përfshijë edhe narkotikët e ndaluar sipas traktateve shumëpalëshe për narkotikët dhe përkufizimet e mallrave të rrezikshme të ndaluara



- për transport me postë të hartuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;
- 2.6 një përmbledhje të tarifave të brendshme të operatorëve të caktuar;
- 2.7 të dhëna statistikore që lidhen me shërbimin postar (të brendshëm dhe ndërkombëtar);
- 2.8 studime, opinione, raporte dhe deklarata të tjera që lidhen me shërbimin postar;
- 2.9 tre katalogët e mëposhtëm:
- 2.9.1 Katalogu i bibliotekës i Byrosë Ndërkombëtare (duke renditur punimet të siguruara nga biblioteka);
- 2.9.2 Katalogu periodik i Byrosë Ndërkombëtare (rendit periodikët e marra nga Byroja Ndërkombëtare);
- 2.9.3 Katalogu i librisë filmike të Byrosë Ndërkombëtare (rendit filma të disponueshëm për tu dhënë hua nga Byroja Ndërkombëtare shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar);
- 2.10 një katalog të pajisjeve postare;
- 2.11 një listë të përgjithshme të shërbimeve të postës ajrore (të njohur si "Lista CN 68"), e cila do të përditësohet çdo vit. Operatorët e caktuar do t'i komunikojë përditësimet Byrosë Ndërkombëtare me 1 Tetor të çdo viti, dhe Byroja Ndërkombëtare do të publikojë CN 68 të përditësuar para fundit të atij viti. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi më 1 janar të vitit pasardhës;
- 2.12 një listë të distancave të postës ajrore (Listë e Distancave të postës Ajrore) të hartuar në bashkëpunim me transportuesit ajror.
3. Ajo gjithashtu do të publikojë:
- 3.1 Manualin e Konventës dhe të Marrëveshjes të Shërbimit të Pagesave Postare;
- 3.2 Akte të tjera të UPU me shënime nga Byroja Ndërkombëtare;
- 3.3 Fjalorin shumë gjuhësh të shërbimit Postar Ndërkombëtar.
4. Ndryshimet në botimet e ndryshme të renditura sipas pikave 1 deri në 3 do të njoftohen me anë të qarkores, buletinit, shtojcave ose mjeteve të tjera të përshtatshme. Megjithatë, çdo ndryshim i publikimeve të renditura sipas paragrafeve 2.11 dhe 2.12 dhe data në të cilën amendamentet hyjnë në fuqi do të njoftohen shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar me anë të mënyrës më të shpejtë (ajrore apo tokësore), me minimumin e vonës dhe në mënyrën më të përshtatshme.
5. Botimet e publikuara nga Byroja Ndërkombëtare do të shpërndahen operatorëve të caktuar në përputhje me rregullat e mëposhtme:
- 5.1 Të gjitha botimet, me përjashtim të atij të specifikuar sipas pikës 5.2, do të shpërndahen në tri kopje, njëra nga të cilat do të jetë në gjuhën zyrtare. Dy të tjerët do të jepen ose në gjuhën zyrtare ose në gjuhën e kërkuar në përputhje me nenin 110 të Rregullores së Përgjithshme.
- 5.2 Botimi periodik Union Postale do të shpërndahet në përpjesëtim me numrin e njësive të kontributeve të caktuara për secilin shtet anëtar dhe operator të caktuar sipas nenit 130 të Rregullores së Përgjithshme.
- 5.3 Përveç numrit të kopjeve të shpërndara falas në bazë të rregullave të përcaktuara sipas pikës 5.1, shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar mund të blejnë botimet e Byrosë Ndërkombëtare me çmimin e kostos.
6. Botimet e publikuara nga Byroja Ndërkombëtare do të dërgohen edhe Sindikatave të Kufizuara.

Neni RL 264
Adresa telegrafike

1. Për komunikimet telegrafike të shkëmbyera midis tyre, operatorët e caktuar do të përdorin adresat telegrafike të mëposhtme:
- 1.1 "Postgen" për telegramet drejtuar administratave qendrore;
- 1.2 "Postbur" për telegrame drejtuar zyrave postare;
- 1.3 "Postex" për telegrame drejtuar zyrave të shkëmbimit.
2. Këto adresa telegrafike do të pasohen nga përcaktimi i shtetit të destinacionit dhe, sipas rastit, nga çdo detaj tjetër që konsiderohet i nevojshëm.
3. Adresa telegrafike e Byrosë Ndërkombëtare do të jetë "UPU Berne".
4. Adresat telegrafike të treguara në pikat 1 dhe 3, të plotësuara sipas nevojës me tregues të zyrës dërguese, do të shërbejnë gjithashtu edhe si nënshkrim i komunikimeve telegrafike.

Neni RL 265

Periudha e mbajtjes së dokumenteve

1. Dokumentet e shërbimit ndërkombëtar do të mbahen për një periudhë minimale prej 18 muajsh nga dita që pason datën së cilës ato i referohen. Megjithatë, nëse dokumentet janë riprodhuar në mikrofilm, mikrofishë, ose mjete të ngjashme, ato mund të shkatërrohen sapo të vërtetohet se riprodhimi është i kënaqshëm.

2. Dokumentet në lidhje me një mosmarrëveshje apo reklamim do të mbahen deri nësa të zgjidhet çështja. Nëse operatori i caktuar, i informuar rregullisht mbi rezultatet e reklamimit, i lejon të kalojnë gjashtë muaj nga data e komunikimit pa ngritur ndonjë kundërshtim, çështja do të konsiderohet si e mbyllur.

Neni RL 266

Formularët

1. Formularët do të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur.

2. Tekstet, ngjyrat dhe përmasat e formularëve si dhe karakteristika të tjera të tilla si pozicioni i rezervuar për vendosjen e barkodit do të jenë ato të përshkruara në këto Rregullore.

3. Formularët për përdorimin e publikut do të kenë një përkthim interlinear në frëngjisht kur ato nuk janë të stampuara në këtë gjuhë.

4. Formularët për përdorimin e operatorëve të caktuar në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin do të hartohen në frëngjisht, me ose pa përkthim interlinear, me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar të interesuar bien dakord ndryshe me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

5. Formularët si dhe çdo kopje e tyre do të plotësohen në një mënyrë të tillë që të dhënat e regjistruara të jenë të lexueshme. Formulari origjinal do ti dërgohet operatorit të caktuar të duhur ose të palës më të interesuar.

6. Kur një zyrë shkëmbimi duhet të specifikohet në një formular postar, do të zbatohen rregullat e specifikuara me nenin RL 169.

Formularët e mëposhtëm do të konsiderohen si formularë për përdorimin e publikut:

Neni RL 267

Formularë në përdorim të publikut

1. Për qëllimet e zbatimit të nenit RL 266.3, sa në vijim do të konsiderohen si formularë në përdorim të publikut:

CN 01 (Kupon përgjigje ndërkombëtare)

CN 07 (lajmërim – marrje / dërgimi/ pagese/ regjistrimi);

CN 08 (Reklamimi);

CN 11 (shënim i vendosjes së pullave);

CN 14 (Zarfa përmbledhës);

CN 17 (Kërkesë tërheqje nga posta, ndryshim apo korigjim të adresës, anulimi apo ndryshimi i shumës COD);

CN 18 (dekaratë në lidhje me mos – marrjen (apo marrjen) e një dërgese postare);

CN 22 (Etiketa “Dogana”);

CN 23 (deklarata doganore);

CN 29 (etiketa “COD”);

CN 30 (Etiketa “R” e kombinuar me emrin e zyrës së origjinës, numrin e dërgesës dhe trekendeshin me fjalën “Rimbursim” (Pagesë nga marrësi)).

Neni RL 268

Zbatimi i standardeve

1. Zbatimi i disa rregulloreve mund të përfshijë zbatimin e disa standardeve. Shteteve anëtare dhe /ose operatorëve të caktuar duhet ti referohen publikimeve të përshtatshme që përmbajnë standardet e miratuara nga UPU.

2. Me përjashtim të rasteve kur zbatimi i një standardi të UPU kërkohet shprehimisht nga një



referencë në Rregullore, aplikimi i standardeve të UPU do të jetë vullnetar. Megjithatë, shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar janë të këshilluar ti përmbahen standardeve që janë të rëndësishme për veprimet e tyre të brendshme dhe ndërkombëtare, me qëllim për të rritur efikasitetin e përpunimit dhe ndërveprueshmërisë së sistemeve dhe proceseve të tyre.

3. Një standard i UPU duhet të miratohet në tërësinë e tij. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar do të sigurohen që përdorimi i një standardi të UPU është plotësisht në përputhje me kërkesat e specifikuara në të. Ata mund të devijojnë nga rekomandimet vetëm në masën e lejuar nga standardi në fjalë.

Neni RL 269
Aspekte mjedisore

1. Operatorët e caktuar duhet të bëjnë produktet dhe shërbimet e tyre sa më efektive të jetë e mundur në ambjent, brenda limiteve të teknologjive dhe burimeve.

2. Konsumimi i materialeve dhe i energjisë duhet të optimizohet dhe të jetë minimalisht në përputhje me drejtimin efikas të operacioneve.

3. Materialet e përdorura duhet të përputhen me standardet e mos-ndotjes dhe mos-helmueshmërisë, të vendosura nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare kompetente.

4. Operatorët e caktuar duhet të promovojnë ricklimin e letrës dhe të materialeve të tjera. Duhet gjithashtu të nxisin përdorimin e materialeve të ricikluara.

KAPITULLI 17
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni RL 270
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores së Postës së Letrave

1. Kjo rregullore do të zbatohet nga dita e vënies në fuqi e Konventës postare universale.
2. Ajo do të ketë të njëjtën kohëzgjatje si Konventa, me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe nga Këshilli i Operacioneve Postare.

E përpiluar në Bernë, më 11 nëntor 2008

Në emër të Këshillit të Operacioneve Postare

Presidenti

Sekretari i përgjithshëm

Firma

Firma

Dr. Andreas TAPRANTZIS

Edouard DAYAN

PROTOKOLL PËRFUNDIMTAR I RREGULLORES SË POSTËS SË LETRAVE

Në momentin e procedimit të miratimit të Rregullores së Postës së Letrave, Këshilli i Operacioneve Postare ka rënë dakord për sa në vijim:

Neni RL I
Letra të printuara. Peshë maksimale

1. Pavarësisht nga neni RL 121.1.2, Kanadaja dhe Irlanda do të autorizohen të limitojnë në 2 kilogramë peshën maksimale të letrave të printuara në hyrje dhe në dalje.

Neni RL II

Dispozita të posaçme të zbatueshme për secilën kategori të artikujve

1. Pavarësisht nga neni 124.2.2, Afganistani dhe Japonia rezervon të drejtën të përfshijë ose bashkëlidhë piktura ose copëza letre në aerograma me të njëjtat kushte si të shërbimit të tyre të brendshëm.
2. Pavarësisht nga neni RL 124.4.5, në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të pranojnë si shtojca në dërgesat e letrave të printuara ndonjë kartolinë, zarf ose ambalazh që ka adresën e dërguesit ose të agjentit të tij në shtetin e destinacionit të artikullit original.
3. Pavarësisht nga neni RL 124.4.5, në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe, Iraku nuk do të pranojë si shtojca të letrave të printuara të postuara në sasi ndonjë kartolinë, zarf ose ambalazh që ka adresën e dërguesit që nuk ndodhet në shtetin e origjinës të artikullit.
4. Pavarësisht nga neni RL 124.5.2, Azerbajzhani, India, Indonezia, Lebani, Nepali, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani dhe Zimbabve do të pranojnë regjistrime të zërit si literaturë për të verbrit vetëm nëse këto janë dërguar nga ose i drejtohen, një institut të njohur zyrtarisht për të verbrit.
5. Pavarësisht nga neni RL 124.7, Kanada do të jetë e autorizuar të mos pranojë ose të përpunojë thaës M që përmbajnë artikuj audio-vizualë ose material informative nga shtete të tjera.
6. (i fshirë)
- 6bis. Asnjë rezervim i bërë në lidhje me postën në sasi nuk do të ketë ndikim në zbatimin e nenit RL 219.

Neni RL III

Artikuj të standardizuar

1. Kanada, Japonia, Kenia, Tanzania (Republika e Bashkuar), Uganda dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të jetë e detyruar të dekurajojë përdorimin e zarfave formati i të cilëve është jashtë përmasave të rekomanduara në nenin RL 128 kur këto zarfa janë gjerësisht të përdorur në shtetet e tyre.
2. Afganistani dhe India nuk do të jenë të detyruara të dekurajojë përdorimin e zarfave, formati i të cilëve është më i madh ose më i vogël se përmasat e rekomanduara në nenin RL 128 kur këto zarfa janë gjerësisht të përdorur në shtetet e tyre.

Neni RL IV

Kushtet e zbatimit të tarifave postare

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit RL 107.2, Irlanda rezervon të drejtën të përdorë 25 gramë si hap i parë i peshës në shkallën e tij të tarifave të postës së letrave.

Neni RL V

Thaës M rekomande

1. Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jenë të autorizuar të mos pranojnë thaës M rekomande dhe të mos japin shërbimin e përpunimit për këto thaës të ardhura nga shtete të tjera.

Neni RL VI

Kufijtë maksimal për artikujt e siguruar

1. Pavarësisht nenit RL 134, Suedia rezervon të drejtën për të kufizuar vlerën e përmbajtjes së kolive të zakonshme dhe të siguruara për Suedinë, sipas kufijve maksimale të mëposhtëm:

Artikuj të postës së letrave në hyrje

	Vlera Maksimale tregtare e përmbajtjes	Vlera maksimale e siguruar	Dëmshpërblimi maksimal
Artikuj	500 SDR	–	30 SDR



rekomande (thes M: 150 SDR)

Artikuj të siguruar	1,000 SDR	1,000 SDR	1,000 SDR
---------------------	-----------	-----------	-----------

2. Kufizimi nuk mund të anashkalohet me sigurim të pjesshëm të vlerës më të lartë se 1.000 SDR. Nuk ka kufizime të reja për llojin e përmbajtjes së artikujve të siguruar dhe rekomande. Artikujt me një vlerë më të lartë se këto kufizime do të kthehen në origjinë.

3. Pavarësisht nga neni RL 134, Danimarka rezervon të drejtën të kufizojë vlerën e përmbajtjes së artikujve rekomande ose të siguruara të postës së letrave të dërguara që përmbajnë të para ose letra me vlerë të çdo lloji të pagueshëm për sjellësin, sipas kufijve maksimal të mëposhtëm:

Inward letter-post items

	Vlera Maksimale tregtare e përmbajtjes	Vlera maksimale e siguruar	Dëmshpërblimi maksimal
Artikuj rekomande të postës së letrave	100 SDR	–	30 SDR
Artikuj të siguruar të postës së letrave	4,000 SDR	4,000SDR	4,000SDR

3.1 Këto kufizime nuk mund të anashkalohen duke kryer sigurim të pjesshëm në shuma më të larta se 4.000 SDR.

Neni RL VII Artikuj të siguruar

1. Pavarësisht nga neni RL 134, Franca rezervon të drejtën të limitojë vlerën e artikujve të siguruar të postës së letrave për Francën, në përputhje me limitet maksimale të mëposhtme:

	Vlera Maksimale tregtare e përmbajtjes	Vlera maksimale e siguruar	Dëmshpërblimi maksimal
Artikuj të siguruar	630 SDR	630 SDR	630 SDR

2. Këto limite nuk mund të anashkalohen me sigurim të pjesshëm të vlerës më të lartë se 630 SDR. Artikujt me një vlerë më të lartë se këto kufizime do të kthehen në origjinë. Nuk është e mundur të deklarohet një vlerë më e ulët se vlera tregtare e artikullit.

Neni RL VIII Kontabilizimi i tarifave IBRS

1. Kepi i gjelbër, Egjipti, Kazakistani, Kirxhizistani, Maroku, Omani, Nepali, Katari dhe Uzbekistani rezervojnë të drejtën të kërkojnë kompensim të kostove të shërbimit IBRS edhe kur numri vjetor i artikujve të të kthyerë është më i ulët ose i barabartë me kufirin e përcaktuar në nenin RL 140.4.4.

Neni RL IX Trajtimi i artikujve të pranuar gabimisht

1. Afganistani, Angola, Xhibuti dhe Pakistani nuk do të jenë të detyruara të përmbushin dispozitat e përcaktuara në nenin RL 145.4, sipas të cilës "Ky njoftim do të tregojë qartë ndalimin ku bëjnë pjesë artikujt dhe artikujt që shkaktojnë sekuestrimin."

2. Afganistani, Angola, Australia, Azerbajzhani, Republika Demokratike e Popullit të Koresë, Xhibuti, Estonia, Kazakistani, Kirxhistani, Nepali, Sudani, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani dhe Vietnami rezervojnë të drejtën të japin informacion rreth arsyes së sekuestrimit të artikullit postar vetëm brenda limiteve të informacionit të dhënë nga autoritetet doganore dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

2bis Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën për të trajtuar si të pranuar gabimisht, dhe të trajtimit në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe praktikës doganore, çdo artikull që përmban substanca të kontrolluara, siç përcaktuar në nenin 1308 të kapitullit 21 të Kodit të Rregulloreve Federale të SHBA

Prot. Neni RL IXbis
Ri-adresimi

1. Dispozitat e nenit RL 146.2 nuk do të zbatohen për operatorët e caktuar të Danimarkës dhe Finlandës, pajisjet e të cilave gjatë procesit të përpunimit ri-adresojnë automatikisht dërgesat tek një marrës që ka ndërruar adresë.

Neni RL X
Trajtimi i reklamimeve

1. Pavarësisht nga neni RL 150, Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën të mos pranojnë reklamime CN 08 nga operatori i caktuar i origjinës për artikujt rekomandë të dërguara si artikuj në transit à découvert dhe nuk do të pranojë përgjegjësi në lidhje me këtë lloj të artikujve të ndaluar.

Neni RL XI
Artikuj subjekt i kontrollit doganor

1. Pavarësisht nga neni RL 152, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nuk do të pranojë përgjegjësi për marrjen e nënshkrimit të dërguesit në formularët CN 22 dhe CN 23 se artikujt nuk përmbajnë ndonjë send të rrezikshëm të ndaluar nga rregulloret postare.

Neni RL XII
Pagesa e dëmshpërblimit

1. (I fshirë)

Neni RL XIII
Thasët

Dispozitat e nenit 173.2.10 nuk do të zbatohen për Britaninë e Madhe, legjislacioni i brendshëm i së cilës kërkon një limit më të ulët të peshës. Legjislacioni i shëndetit dhe sigurisë në Britaninë e Madhe kufizon peshën e thasëve të postës në 20 kilogramë.

Neni RL XIV
Itinerari i dërgesave

1. Azerbajzhani, Bolivia, Estonia, Latvia, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani do të njohin vetëm kostot e transportit të kryer në përputhje me dispozitën në lidhje me linjën të treguar në etiketat e thasëve CN 35 të dërgesave ajrore dhe faturave të dërgesave CN 38.

2. Duke konsideruar dispozitën në pikën 1, Franca, Britania e Madhe, Greqia, Italia, Senegali, Tailandë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të dërgojnë postë ajrore të mbyllur vetëm sipas kushteve të përcaktuara në nenin RL 186.4.



Neni RL XV Tarifa të posaçme të transitit

1. Greqia rezervon të drejtën të rrisë me 30% tarifat e transitit tokësor dhe me 50% tarifat e transitit detar të dhëna në nenin RL 205.1.
2. Australia, Finlanda dhe Singapori rezervojnë të drejtën të rrisin me 50% tarifat e transitit tokësor dhe detar të dhëna në nenin RL 205.1.
3. Federata Ruse do të jetë e autorizuar të mbledhi një shtesë prej 0.65 SDR mbi tarifat e transitit të treguara në nenin RL 205.1 për çdo kilogram të postës së letrave të transportuar në transit në rrugën Trans-Siberiane.
4. Egjipti dhe Sudani do të jenë të autorizuar të mbledhin një shtesë prej 0.16 SDR mbi tarifat e transitit të treguara në nenin RL 205.1 për çdo thes të postës së letrave në transit mbi Liqenin Naser ndërmjet Shallalit, Egjipt, dhe Ëadi Halfa, Sudan.
5. Panama (Rep.) do të jetë e autorizuar të mbledhi një shtesë prej 0.98 SDR mbi tarifat e transitit të përmendura në nenin RL 205.1 për çdo thes të postës së letrave në transit në Isthmus të Panamasë ndërmjet porteve të Balboa në Oqeanin Paqësor dhe Kristobal në Oqeanin Atlantik.
6. Finlanda do të jetë e autorizuar të mbledhë një shtesë për çdo kilogram të artikujve të postës së letrave të adresuar në Ishujt Åland.
- 6.1 Për postën ajrore dhe dërgesat prioritare shtesa do të jetë tarifa përkatëse e transitit tokësor dhe tarifa përkatëse e transitit ajror.
- 6.2 Për postën tokësore dhe dërgesat e zakonshme shtesa do të jetë tarifa përkatëse e transitit tokësor dhe tarifa përkatëse e transportit detar.
7. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Panama (Rep.) do të jetë e autorizuar të mbledhë një tarifë prej 0.65 SDR për thes në rrugë të gjitha dërgesat e magazinuar ose të transportuara në postin e Balboas ose Kristobalit, me kusht që të mos marrë ndonjë pagesë në lidhje me transitin tokësor ose detar të këtyre dërgesave.
8. Pavarësisht nga neni RL 205.1, operatori i caktuar i Afganistanit do të jetë përkohësisht i autorizuar, për shkak të vështirësive të tij për sa i përket mjeteve të transportit dhe telekomunikacionit, të kryejë transitin e dërgesave të mbyllura dhe korrespondencave à découvert në territorin e tij në afatë të rëna posaçërisht dakord me operatorët e caktuar të interesuar.
9. Pavarësisht nga neni RL 205.1, shërbimet motor të Sirisë–Irakut do të konsiderohen si shërbime të jashtëzakonshme që sjellin mbledhjen e tarifave të posaçme të transitit.
10. Danmarka do të jetë e autorizuar të mbledhë një shtesë tarife për çdo kilogram të artikujve të postës së letrave të adresuar në Ishujt Faroe ose Grenlandë.
- 10.1 Për postën ajrore, dërgesat prioritare dhe ato S.A.L., shtesa do të jetë tarifa përkatëse e përpunimit të postës ajrore në transit dhe tarifa përkatëse e transportit ajror.
- 10.2 Për postën tokësore dhe dërgesat e zakonshme, shtesa do të jetë tarifa përkatëse e transitit tokësor dhe tarifa përkatëse e transitit detar.
11. Ukraina rezervon të drejtën e rritjes me 50% të tarifave të transitit detar të përcaktuara në nenin RL 205.1.
12. Gjermania do të ketë të drejtën e rritjes me 50% të tarifave të transitit detar të dhëna në nenin RL 205.1.

Neni RL XVI Njehsime statistikore për shkëmbimet e dërgesave ndërmjet shteteve anëtare në sistemin objektiv

1. Pavarësisht nga neni RL 222.2, Kanadaja është e autorizuar të zbatojë një minimum prej 24 ditësh të vëzhgimit në vit për marrjen e kampionëve.

Neni RL XVII Kontabilizimi për postën në sasi të mëdha

1. Pavarësisht nga neni RL 230.2.2, llogaritë e paraqitura tek operatorët e caktuar të Australisë,

Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk do të konsiderohen të pranuar, as për tu paguar, deri në gjashtë javë pasi këto llogari janë marrë, me përjashtim të rastit kur llogaritë janë marrë brenda shtatë ditëve nga data kur ato janë përgatitur nga operatori i caktuar kreditor.

Neni RL XVIII
(i fshirë)

Neni RL XIX

Paraqitja dhe pranimi i situacioneve CN 55, CN 66 dhe CN 67, llogarive të detajuara CN 51 dhe llogarive të përgjithshme CN 52

1. Pavarësisht nga neni RL 242.6, llogaritë e paraqitura tek operatorët e caktuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës Popullore Demokratike të Laos nuk do të konsiderohen të pranuar, as për tu paguar, deri në gjashtë javë pasi këto llogari janë marrë, me përjashtim të rastit kur llogaritë janë marrë brenda shtatë ditëve nga data kur ato janë përgatitur nga operatori i caktuar kreditor.

2. Pavarësisht nga neni RL 242.6 dhe 7, llogaritë e paraqitura tek operatorët e caktuar të Australisë, Kinës (Republika Popullore.) dhe Arabisë Saudite nuk do të konsiderohen të pranuar deri në dy muaj pasi këto llogari janë marrë, as nuk do të ketë detyrim pagese deri në gjashtë jave pas marrjes së llogarive, nëse është aplikuar sistemi i drejtpërdrejtë i faturimit, me përjashtim të rastit kur llogaritë janë marrë brenda shtatë ditëve nga data e dërgimit të tyre nga operatori i caktuar kreditor.

Neni RL XX

Kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të lëshuara para 1 Janarit 2002

1. Kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të një lloji më të hershëm të lëshuara para 1 Janarit 2002 dhe të shkëmbyera deri më 30 Qershor 2006 mund të shlyhen drejtpërdrejt ndërmjet operatorëve të caktuar të interesuar në përputhje me dispozitat e treguara në vijim. Ato nuk do të jenë më subjekt i llogarisë së përgjithshme të likuidimit të kuponave të përgjigjes ndërkombëtare të përgatitura nga Byroja Ndërkombëtare.

2. Në mungesë të marrëveshjes së posaçme, pas kësaj periudhe të tranzicionit, kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të llojit të hershëm nuk do të sjellin më shlyerje midis operatorëve të caktuar.

3. Në llogaritë e likuidimit midis operatorëve të caktuar, vlera e kuponave të përgjigjes do të llogaritet në çmimin prej 0.74 SDR për kupon.

4. Kuponat e përgjigjes të shkëmbyer duhet të dërgohen çdo vit, brenda periudhës prej gjashtë muajsh pas përfundimit të periudhës përkatëse, tek operatorët e caktuar që i kanë lëshuar, me numrin dhe vlerën totale të treguar në deklaratën në përputhje me modelin bashkëlidhur CN 02bis.

5. Kuponat e përgjigjes të tarifuar gabimisht në llogarinë e një operatori të caktuar të ndryshëm nga operatori i caktuar lëshues do të zbriten nga llogaria e këtij të fundit dhe do të kthehen operatorit të caktuar që i ka dërguar ato gabimisht; ato duhet të shënohen në përputhje me rrethanat. Ky operacion mund të kryhet gjatë periudhës kontabël vijuese me qëllim evitimin e llogarive shtesë. Kjo dispozitë nuk do të aplikohet pas vitit 2006.

6. Sapo dy operatorë të caktuar të kenë rënë dakord për numrin e kuponave të përgjigjes të shkëmbyer në marrëdhëniet e tyre reciproke, operatori i caktuar kreditor do të përgatisë dhe dërgojë në dy kopje një deklaratë në përputhje me modelin bashkëlidhur CN 03bis tek operatori i caktuar debitor për miratim, nëse balanca tejkalon 74 SDR dhe nëse nuk është miratuar një rregullore e posaçme midis operatorëve të caktuar në fjalë. Nëse, brenda një muaji nga data e dërgimit të deklaratës, operatori i caktuar kreditor nuk ka marrë komente, shuma e kësaj deklarate do të konsiderohet si plotësisht e pranuar.

7. Kur bilanci midis dy operatorëve të caktuar nuk i kalon 74 SDR, ky bilanc do të kalohet në atë të vitit pasardhës nga operatori i caktuar kreditor. Nëse bilanci është më i ulët se 74 SDR në llogarinë përfundimtare të kuponave të përgjigjes të shkëmbyer deri më 30 Qershor 2006, nuk do të bëhet asnjë pagesë.

8. Pagesat do të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi brenda gjashtë javëve nga data e pranimit ose e njoftimit se bilanci që do të shlyhet është pranuar plotësisht.

8bis Kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të një lloji të lëshuar para 1 Janarit 2002 nuk do të shkëmbehen më në zyrat postare pas 31 Gushtit 2007.



Neni RL XXI

Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive me anë të llogarisë përfundimtare të likuidimit për kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të shpërndara para 1 Janarit 2002

1. Debitë për t'iu paguar një operatori të caktuar si rezultat i shlyerjes së llogarive nëpërmjet llogarisëpërfundimtare të likuidimit të Byrosë Ndërkombëtare për kuponat e përgjigjes ndërkombëtare të shpërndara para 1 Janarit 2002 të cilat janë të në vonesë pas 1 Prillit 2003 mund të rregullohen me anë të krediteve nga një tjetër operator i caktuar që i paguhen debitorit në fjalë. Para se të ndërmarrë një hap të tillë, Byroja Ndërkombëtare do të konsultohet me kreditorin në fjalë dhe do ti dërgojë debitorit një kujtesë. Nëse pagesa nuk bëhet brenda një periudhe prej një muaji nga data e kësaj kujtesë, Byroja Ndërkombëtare do të jetë kompetente në mënyrë të njëanshme për të bërë rregullimet e nevojshme të kontabilitetit pasi informimit të të gjitha palëve të interesuara. Miratimi i debitorit në vonesë nuk do të jetë i nevojshëm.

2. Kur bën këto rregullime të kontabilitetit, Byroja Ndërkombëtare do të kompensojë vetëm llogaritë që janë të pranuar nga të dy, nga debitori që nuk ka paguar në kohë dhe nga operatori i caktuar që i ka dhënë hua debitorit që është në vonesë.

3. Debitori në vonesë nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj operatorit të caktuar që i ka dhënë hua për kreditë e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare kreditorit në përputhje me procedurën e përshkruar në paragrafin 1.

Neni RL XXII

Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi para 1 Janarit 2001

1. Debitë e pagueshme si rezultat i shlyerjes së llogarive me anë të sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi përpara datës 1 Janar 2001 nga çdo operator i caktuar të cilët janë vonuar pas afatit të fundit për shlyerjen e deklaratave përfundimtare të sistemit të kompensimit nga tremujori i fundit i vitit 2000 mund të rregullohen me anë të kredive që i takojnë debitorit nga çdo operator tjetër i caktuar. Para se të ndërmarrë një hap të tillë, Byroja Ndërkombëtare do të konsultohet me kreditorin në fjalë dhe do ti dërgojë debitorit një kujtesë. Nëse pagesa nuk bëhet brenda një periudhe prej një muaji nga data e kësaj kujtesë, Byroja Ndërkombëtare do të jetë kompetente në mënyrë të njëanshme për të bërë rregullimet e nevojshme të kontabilitetit pasi informimit të të gjitha palëve të interesuara.

2. Kur bën këto rregullime të kontabilitetit, Byroja Ndërkombëtare do të kompensojë vetëm llogaritë që janë të pranuar nga të dy, nga debitori që nuk ka paguar në kohë dhe nga operatori i caktuar që i ka dhënë hua debitorit që është në vonesë.

3. Debitori në vonesë nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj operatorit të caktuar që i ka dhënë hua për kreditë e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare kreditorit në përputhje me procedurën e përshkruar në paragrafin 1.

Neni RL XXIII

Formularët

1. Pavarësisht nenit RC 213.2 operatorët e caktuar të Brazilit, Gjermanisë, Rep. Hungareze, Luksemburgut dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mund të ndryshojnë përmasat dhe formën e formularit CN 07.

2. Pavarësisht nga neni RL 266.2, Franca mund të bëjë ndryshimet vijuese në formularin CN 07:

2.1 të shtojë një barkod me shirita dhe/ose shifra që përputhet me specifikimet teknike të pranuar në standardet e miratuara nga UPU;

2.2 të përfshijë një zonë bosh në pjesën e poshtme;

2.3 të shtojë në kutinë e marrësit vija guidë me ngjyrë portokalli të lexueshme nga makineritë për të shkruar dhe të zgjerojë zonat e "Marrësit të artikullit" dhe "Të kthehet tek";

2.4 të përfshijë një version anglisht të informacionit të detyrueshëm për tu plotësuar në destinacion.

2bis Pavarësisht nga neni RL 266.2, Italia mund të bëjë ndryshimet vijuese në formularin CN 07:

2bis.1 ngjyrë të bardhë të kutisë së marrësit dhe shtimin e vijave guidë për të shkruar;

2bis.2 ngjyrë të bardhë të zonës bosh në pjesën e poshtme;

2bis.3 në kutinë "Lloji i artikullit ", të fshijë produktet për të cilat nuk ofrohet shërbimi i njoftimit të dërgimit;

2bis.4 të spostojë nga cepi i poshtëm majtas në cepin e postëm djathtas informacionin në lidhje me nënshkrimin e formularit.

Ky protokoll do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri sikur dispozitat e tij të ishin të përfshira në tekstin aktual të Rregullores së cilës i referohet.

E përpiluar në Bernë, më 11 nëntor 2008

Në emër të Këshillit të Operacioneve Postare

Presidenti

Sekretari i përgjithshëm

Firma

Firma

Dr. Andreas TAPRANTZIS

Edouard DAYAN

BASHKIMI POSTAR UNIVERSAL
RREGULLORE E MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË PAGESAVE ME POSTË

Protokoll përfundimtar

Bernë 2008

Rregullore e marrëveshjes së shërbimit të pagesave me postë

Pasqyra e lëndës

Pjesa I

Parime të përgjithshme të aplikueshme për shërbimet e pagesës me postë

KAPITULLI 1

Dispozita të përgjithshme

Neni

RP 201	Përkufizime
RP 501	Funksione operacionale
RP 502	Informacioni që duhet të jepet nga operatorët e caktuar
RP 503	Publikimet e Byrosë Ndërkombëtare
RP 504	Përmbledhje e shërbimeve elektronike të Pagesave me Postë
RP 701	Programi për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, dhe krimit financiar
RP 702	Detyrimi për tu identifikuar
RP 703	Të dhënat e identifikimit
RP 704	Detyra e marrjes së informacionit
RP 705	Detyra e monitorimit, zbulimit dhe raportimit
RP 706	Arkivimi
RP 707	Zbatimi i shërbimeve të pagesave me postë
RP 801	Konfidencialiteti i të dhënave
RP 901	Kombinimi i teknologjive

KAPITULLI 2

Parime të përgjithshme



RP 1001	Ndarja e fondeve
RP 1002	Kufizimi i fondeve të përdoruesve
RP 1003	Monedha e lëshimit dhe pagesa
RP 1004	Vendosja e tarifave
RP 1005	Përrjashtimi nga tarifat
RP 1006	Përrjashtimi nga tarifat postare për artikujt e shërbimit të pagesave me postë
RP 1007	Përrjashtimi nga tarifat postare për pengjet e luftës dhe të internuarit civilë
RP 1008	Zbatimi i përrjashtimit nga tarifat postare për institucionet që kanë të bëjnë me pengjet e luftës dhe të internuarit civilë
RP 1009	Shënimi i artikujve të dërguara pa tarifë postare
RP 1010	Procedurat për shpërblim ndërmjet operatorëve të caktuar
RP 1011	Informacioni i përdoruesit
RP 1101	Cilësia e shërbimit për urdhër-pagesat postare të dërguara me mjete elektronike
RP 1102	Marka kolektive

KAPITULLI 3

Parimet për shkëmbimin e të dhënave elektronike

RP 1201	Kushtet për ndërveprimin dhe rregullimi i centralizuar
RP 1301	Siguria e rrjetit
RP 1302	Siguria e shkëmbimeve elektronike
RP 1303	Rregullat e veprimit dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike
RP 1304	Siguria e të dhënave
RP 1305	Sistemi rezervë i të dhënave
RP 1306	E drejta e hyrjes në të dhënat e arkivuara
RP 140 1	Gjurmimi dhe gjetja

PJESA II

Rregullat që disiplinojnë shërbimet e pagesave me postë

KAPITULLI 1

Përpunimi i urdhër-pagesës postare

RP 1501	Formularët
RP 1502	Informacioni i përbashkët për format e ekzekutimit
RP 1503	Statusi i urdhër-pagesës postare ose kërkesës
RP 1504	Kërkesa e urdhër-pagesës postare
RP 1505	Kontrolli i kërkesës së urdhër-pagesës postare nga operatori i caktuar lëshues
RP 1506	Hyrja e urdhër-pagesave postare
RP 1507	Frekuenca e lidhjeve me sistemin e informacionit
RP 1508	Pranimi i urdhër-pagesës postare
RP 1509	Lëshimi i urdhër-pagesës me postë
RP 1510	Kërkesa për revokim
RP 1511	Periudha e vlefshmërisë së urdhër-xhirimeve
RP 1512	Këshillimi i pagesës ose i kreditimit në llogarinë e destinatarit
RP 1513	Indikacione të shumave
RP 1514	Dërgimi i urdhër-pagesave postare
RP 1515	Rregulla specifike të transferimeve
RP 1601	Trajtimi i urdhër-pagesave postare nga operatori i caktuar pages
RP 1602	Trajtimi specifik për urdhër-xhirimet
RP 1603	Nënshkrimi dhe dërgimi i urdhër-xhirimeve
RP 1604	Trajtimi i kërkesave për revokim

RP 1605	Zëvendësimi i urdhër-xhirimeve të humbura, zhdukura ose shkatërruara para pagesës
RP 1606	Kontrolli nga operatori i caktuar pagues për qëllimet e pagesës ose kreditimit në llogarinë e destinatarit
RP 1607	Trajtimi specifik për transfertën
RP 1608	Urdhrat e parregullt të pagesave postare
RP 1609	Trajtimi i urdhër-pagesave postare të parregullta
RP 1610	Trajtimi i urdhër-pagesave të parregullta të postës së letrave
RP 1611	Trajtimi i transfertave të parregullta të postës së letrave
RP 1612	Rregullimi i urdhër-pagesave postare të parregullta
RP 1613	Pagesa e urdhrave tek destinatarit dhe gjurmimi
RP 1614	Procedurat për zëvendësimin e urdhër-pagesave me postën e letrave të humbura, zhdukura ose shkatërruara pas pagesës
RP 1801	Motivet e rimbursimit
RP 1802	Metoda e rimbursimit
RP 1803	Rimbursimi për shkak të përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së urdhër-pagesës
RP 1804	Trajtimi i rimbursimit
RP 1805	Urdhër pagesa të mbetura

KAPITULLI 2

Kërkesat për të dhëna dhe përgjegjësia

RP 1901	Kërkesat për të dhëna
RP 1902	Kufijtë kohorë për përpunimin
RP 1903	Shtrirja e përgjegjësisë për operatorin e caktuar lëshues ndaj përdoruesit
RP 2001	Përcaktimi i përgjegjësisë
RP 2002	Pagesa e shumave të detyruara në lidhje me dëmshpërblimin
RP 2003	Rimbursimi i operatorit të caktuar të përfshirë

KAPITULLI 3

Marrëdhëniet financiare ndërmjet operatorëve të caktuar

RP 2301	Rregullat e kontabilitetit
RP 2302	Lista ditore e përgatitur automatikisht nga sistemi informatik
RP 2303	Përgatitja e listës përmbledhëse të urdhër-pagesave postare
RP 2304	Përgatitja e llogarive periodike të urdhër-pagesave postare
RP 2305	Përgatitja e llogarive periodike të dëmshpërblimeve
RP 2306	Përgatitja e llogarive të përgjithshme
RP 2307	Llogaria e përgjithshme e urdhër-pagesave postare
RP 2308	Përgatitja e llogarive të përgjithshme të dëmshpërblimeve
RP 2309	Kësti
RP 2310	Procedurat në lidhje me përqendrimin e llogarive të fondeve dhe kështet
RP 2311	Depozita e sigurisë
RP 2401	Shlyerja e centralizuar
RP 2402	Shlyerja bilaterale

PJESA III

Dispozita të përkohshme dhe përfundimtare

RP 2501	Zbatimi i Rregulloreve të Konventës
---------	-------------------------------------



DRAFT RREGULLORJA E SHËRBIMEVE TË PAGESËS POSTARE

Duke pasur në konsideratë nenin 22.5, paragrafi 5 të Kushtetutës së Unionit të Përgjithshëm Postar, të përfunduar në Vjenë më 10 korrik 1964, Këshilli i Operacioneve Postare ka përpiluar masat e mëposhtme për të siguruar zbatimin e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesës Postare.

Këto masa do të zbatohen për urdhër-pagesat me postë të dërguara postën e letrave si edhe për ato të dërguara me anë të mjeteve elektronike ose ndonjë mjet tjetër teknologjik.

PJESA I

PARIME TË PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR SHËRBIMET E PAGESAVE POSTARE

KAPITULLI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni RP 201

Përkufizime

1. Fushë: zona e rezervuar për të dhënat që do të vendosen në formula ose në sistem informatik.
2. Llogaria pasqyrë: llogaria teknike e mbajtur nga një operator e cila reflekton transaksionet financiare në llogarinë e saj ndërlidhëse.
3. Kushtet e shërbimit: kushte standard apo kushte kontraktuale të rregullores sipas të cilave operatori i caktuar ofron shërbimet e pagesave postare për klientët e saj.
4. Marrëveshje shërbimi: marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet operatorëve të caktuar, në përputhje me Marrëveshjen dhe Rregulloret, duke vendosur masat operative për shkëmbime ndërmjet operatorëve të caktuar dhe që mundëson realizimin e shërbimeve të pagesave postare.
5. Data: tregues i ditës në të cilën ndodh një operacion në lidhje me ekzekutimin e një urdhër pagese, i zbatuar për formularin me anë të një procesi manual nga operatori të caktuar, ose të krijuara me datë nga ana e sistemit të informacionit në rastin e shkëmbimit me mjete elektronike.
6. E Drejta Speciale e Tërheqjes (SDR): Njësia kontabël e Fondit Monetar Ndërkombëtar e përdorur si njësi monetare e UPU.
7. Lëshimi i urdhër pagesës postare: pranimi i kërkesës së urdhër pagesës postare të dërguesit nga zyrtari i akredituar i operatorit të caktuar emetues.
8. Statusi i urdhër pagesës postare ose kërkesë: tregon statusin e ekzekutimit të urdhër pagesës postare, ose një kërkesë për informacion / kërkesë për hetim ose revokim në lidhje me këtë urdhër pagese postare.
9. Formulari: Dokumenti model i cili përmban të dhënat e nevojshme për ekzekutimin e urdhër pagesës postare, një kërkesë dhe / ose menaxhimin e marrëdhënieve financiare mes operatorëve të caktuar, në përputhje me Marrëveshjen dhe Rregulloret.
10. Formular i përdoruesit: Dokument i operatorit të caktuar, të printuara në formën e kopjes së shtypur ose në gjendje të shkarkohet nga faqja e saj e internetit, në përputhje me format e parashikuara në Rregullore, i projektuar për tu plotësuar nga përdoruesit i shërbimeve të pagesave postare me informata plotësuese të shtuara nga operatori të caktuar nëse është e nevojshme.
11. Data e printimit: procedurë e sigurt elektronike që tregon datën dhe kohën e operacionit.
12. Identifikues i urdhër pagesës postare: numri specifik i lëshimit të urdhrit.
13. Mesazhi EDI: file që përmban të dhëna elektronike në lidhje me urdhër pagesat postare të dërguara nga një operator i caktuar tek një tjetër.
14. Monedhë e pa-konvertueshme: çdo monedhë që përdoret kryesisht për transaksionet e brendshme dhe jo e shkëmbyeshme lirisht në një treg zyrtar të shkëmbimit (forex market).
15. Faturë elektronike: përditësimi i bazës së të dhënave të vendit pagues nga marrja e urdhër pagesës postare.
16. Nënshkrim elektronik: çelës unik, i përbashkët për operatorët e caktuar që shkëmbejnë të dhëna, i

dhënë nga një ofrues i përbashkët, publik, i akredituar nga UPU i infrastrukturës, e cila mundëson kodimin dhe firmën, dhe pastaj dekriptimin dhe verifikimin e nënshkrimeve.

17. Sistem: sistem telematik i përdorur për të krijuar, dërguar, marrë dhe menaxhuar mesazhe të dhënash.

18. Shtyp: aplikimi i një pike hyrjeje dhe date shërbimi, e cila konfirmon korrektësinë dhe autenticitetin e një operacioni për ekzekutimin e një urdhër pagese postare.

Neni RP 501 Funksione operacionale

1. Operatorët e caktuar të vendeve anëtare nënshkruese do të bien dakord për shërbimet e pagesave postare, të autorizuara nga vendet anëtare, të cilat ata dëshirojnë të shkëmbejnë.

2. Një operator i caktuar nuk është i detyruar të bëjë shkëmbime me një operator tjetër të caktuar i cili nuk ka zbatuar këto Rregullore.

3. Operatorët e caktuar do të përcaktojnë masat operative për postën e tyre të letrave apo shkëmbimet elektronike me anë të një marrëveshjeje shërbimi të përputhshme me modelin e miratuar nga Këshilli Postar i Operacioneve.

Neni RP 502 Informacioni që do të jepet nga operatorët e caktuar

1. Operatorët e caktuar do ti japin Zyrës Ndërkombëtare informacionet e mëposhtme operacionale:
 - 1.1 shërbimet e pagesave postare të dhëna nga operatori i caktuar në territorin e tij;
 - 1.2 tarifat ndërkombëtare dhe kombëtare të zbatuara për shërbimet e pagesave postare të dhëna;
 - 1.4 tarifat për shërbimet plotësuese;
 - 1.5 orët e punës për shërbimin;
 - 1.6 monedha kombëtare dhe monedha e autorizuar nga shteti për pagesat në territorin e tij;
 - 1.7 ofruesi i sistemit të informacionit;
 - 1.8 lloji i sistemit të përdorur (në linjë ose jashtë linje);
 - 1.9 cilësia kombëtare e objektivave të shërbimit;
 - 1.10 tregues të sistemit të centralizuar të vendosjes ose tipin e sistemit të vendosjes të përdorur;
 - 1.11 monedhën e shlyerjes;
 - 1.12 adresën e faqes së internetit të operatorit të caktuar;
 - 1.13 adresën e e-mail të shërbimeve ndërkombëtare të operatorit të caktuar.
2. Ata duhet të japin gjithashtu informacionin e kërkuar nga Rregullorja e Postës së Letrave në lidhje me urdhrat me postë letrash.
3. Çdo ndryshim në të informacionin e kërkuar do ti transmetohet menjëherë të Zyrës Ndërkombëtare.

Neni RP 503 Publikimet e Zyrës Ndërkombëtare

1. Zyra Ndërkombëtare do të publikojë, mbi bazën e informacionit të dhënë nga vendet anëtare nënshkruese dhe operatorët e caktuar, një përmbledhje zyrtare të informacionit me interes të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes dhe Rregullores në çdo vend anëtar.

2. Dispozitat e Rregullores në lidhje me publikimet do të zbatohen edhe për shërbimet e pagesave me postë.

Neni RP 504 Përmbledhja Elektronike e Shërbimeve të Pagesave Postare

1. Zyra Ndërkombëtare do të përgatisë dhe ruajë Përmbledhjen Elektronike të Shërbimeve të Pagesave Postare.

2. Përmbledhja Elektronike e Shërbimeve të Pagesave Postare do të përfshijë informacionin operacional që do të jepet nga operatorët e caktuar në përputhje me Rregulloren dhe çdo të dhënë tjetër



operacionale që i kërkohet operatorëve të caktuar për ekzekutimin e urdhër pagesave postare.

3. Operatorët e caktuar do të emetojnë të dhënat për Përmbledhjen Elektronike të Shërbimeve të Pagesave Postare.

4. Operatorët e caktuar do të përditësojnë informacionin e përfshirë në Përmbledhjen Elektronike të Shërbimit të Pagesave Postare në kohën e duhur, dhe jo më vonë se dita e hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga Zyra Ndërkombëtare.

Neni RP 701

Programi për luftën kundër pastrimit të parave, financimin e terroristëve dhe krimit ekonomik

1. Operatorët e caktuar do të krijojnë dhe zbatojnë një program për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terroristëve dhe krimit ekonomik, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Ky program do të përfshijë parimet e përshtatshme dhe të shkruara, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të kufizuar rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar, si dhe trajnimin e vazhdueshëm në këtë fushë për personelin operacional të përfshirë.

Neni RP 702

Detyrimi për tu identifikuar

1. Operatorët e caktuar do të kontrollojnë identitetin e dërguesve, në përputhje me detyrimin e tyre të kujdesit të duhur në lidhje me përdoruesit, mbi bazën e dokumenteve ose të dhënave të besueshme ose informacionit të njohur dhe të pranuar nga autoriteti kombëtar për qëllimet e identifikimit në territorin kombëtar.

2. Nëse llogaritë janë mbajtur nga operatorët e caktuar, këto mund të jenë vetëm llogari personale për të cilat operatorët e caktuar kontrollojnë identitetin e mbajtësit të llogarisë, pavarësisht nga kufijtë e shumës së urdhër pagesave postare.

3. Operatorët e caktuar, sipas legjislacionit të tyre kombëtar, bien dakord mes tyre për të vendosur shuma minimale nën të cilat operatori emetues i caktuar nuk do të jetë i detyruar të marrë të dhënat e dokumentit të identitetit të dërguesit. Ky prag nuk do të tejkalojë 600 SDR në ditë për urdhër pagesa.

Neni RP 703

Të dhënat e identifikimit

1. Çdo urdhër-pagesë postare duhet të përmbajë emrin dhe adresën e dërguesit dhe marrësit të pagesës. Megjithatë, për urdhër-pagesat postare të transmetuara me mjete elektronike, adresa mund të zëvendësohet nga një numër unik i identitetit.

2. Nëse urdhër-pagesat postare janë transmetuar nëpërmjet mjeteve elektronike, numri i llogarisë duhet të përfshihet për transfertat postare dhe urdhra pagese të jashtëm.

3. Nëse urdhër-pagesat postare janë transmetuar me anë të mjeteve elektronike, duhet të përfshihet, për urdhër pagesat me para në dorë (kesh) dhe urdhër pagesat e brendshme, një numër unik reference që lejon gjurmimin e dërguesit.

4. Informacioni i specifikuar në këtë nen do të mbetet me urdhër-pagesën postare përmes gjithë procesit të transmetimit deri në pagesë ose rimbursim.

5. Shqyrtimi i kujdesshëm dhe monitorimi për aktivitet të dyshimtë do të kryhet për urdhër-pagesat postare të cilat nuk përmbajnë informacion të plotë për dërguesin ose personin që do të paguhet, siç përcaktohet në këtë nen.

Neni RP 704

Detyrimi për të marrë informacion

1. Operatori i caktuar emetues duhet të marrë informacion në lidhje me qëllimin e urdhër-pagesës postare ose kërkesës për rimbursim para ekzekutimit, në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.

2. Operatorët e caktuar duhet të verifikojnë identitetin e personit që paguhet aktualisht, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni RP 705

Detyra e monitorimit, zbulimit dhe raportimit

1. Operatorët e caktuar do të përmbushin detyrën e tyre të monitorimit dhe të zbulimit, në përputhje me direktivat e autoritetit kompetent.
2. Operatorët e caktuar do të monitorojë transaksionet dhe burimin e fondeve dhe do të kontrollojnë se ato korrespondojnë me profilin e riskut të përdoruesit.
3. Operatorët e caktuar do të kontrollojnë rregullisht se dokumentet, të dhënat dhe informacioni në lidhje me përdoruesit janë të përditësuar.
4. Ata do të monitorojnë, veçanërisht dhe nga afër, përdoruesit, transaksionet dhe / ose zonat gjeografike me risk të lartë.
5. Operatorët e caktuar do të përmbushin kërkesat e kujdesit të duhur në lidhje me urdhrat e përdoruesve.
6. Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, pavarësisht nga shuma e përfshirë, operatori i caktuar duhet ta raportojë atë tek autoriteti kompetent.
7. Nëse dyshohet se urdhër-pagesa postare është e lidhur me transaksione të dyshimta, operatori i caktuar duhet ta trajtojë atë në përputhje me legjislacionin kombëtar në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit.

Neni RP 706

Arkivimi

1. Operatorët e caktuar do të arkivojnë informacionet në lidhje me ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare, duke përfshirë të dhënat dhe monitorimin e zbatimit të urdhër-pagesave postare, për një periudhë minimale prej pesë vjetësh, ose më gjatë, siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar.
2. Informacioni i arkivuar do të jetë i tillë që të mundësojë rindërtimin e secilit transaksion (duke përfshirë shumat dhe monedhat).

Neni RP 707

Zbatimi i shërbimeve të pagesave postare

1. Çdo operator i caktuar mund të refuzojë të hapë shërbime të pagesës postare me një operator tjetër të caktuar, ose të pezullojë këto shërbime, nëse:
 - 1.1. ky operator i fundit nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij ligjore për të luftuar pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit;
 - 1.2. në mungesë të detyrimeve ligjore, operatori i fundit nuk ka marrë masat e kërkuara nga Rregullorja me iniciativën e tij;
 - 1.3. një zbatim i tillë është në kundërshtim me legjislacionin e tij kombëtar;
 - 1.3bis një zbatim i tillë është, sipas gjykimit të operatorit të caktuar, i papranueshëm
2. Në rast të sanksioneve ndërkombëtare të vendosura për një vend anëtar të UPU me qëllim për të luftuar pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, operatorët e caktuar mund të refuzojë të përfundojnë një marrëveshje me operatorin e caktuar të këtij vendi anëtar ose pezullojë shkëmbimet me të deri në heqjen e sanksioneve

Neni RP 801

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Operatorët e caktuar do të marrin masat e parashikuara nga legjislacioni i tyre kombëtar dhe këto Rregullore për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave ndaj palëve të treta.
2. Operatorët e caktuar do të transmetojnë Byrosë Ndërkombëtare të dhënat e nevojshme për statistikat e shërbimit të pagesave postare.
3. Byroja Ndërkombëtare do të publikojë statistikat e shërbimeve të pagesave postare në statistikat e UPU. Të dhënat e transmetuara do të përdoren vetëm për të llogaritur totalët e nevojshme për analizën e



situatës botërore dhe rajonale, me përjashtim të rastit kur shteti anëtar i përfshirë bie dakord ndryshe.

4. Kërkesat për akses në të dhënat e arkivuara duhet të justifikohen.

Neni RP 901
Kombinimi i teknologjive

1. Operatorët e caktuar do të përcaktojnë në marrëveshjen e tyre të shërbimit marrëveshje operacionale për ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare të lidhura me kombinimin e teknologjive të ndryshme për ekzekutimin e urdhër-pagesave postare. Ata duhet, si minimum, të respektojnë rregullat e zbatueshme për shërbimet e pagesave postare me anë të letrës postare.

KAPITULLI 2
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni RP 1001
Ndarja e fondeve

1. Fondet e përdoruesve do të ndahen, në terma të kontabilitetit dhe financiare, nga fondet operatorit të caktuar lëshues dhe atij të destinacionit.

Neni RP 1002
Kufizimi i fondeve të përdoruesve

1. Shumat e dërguara nga përdoruesit ose të debituar nga llogaria e tyre do të jenë të kufizuara dhe të rezervuara për shlyerjen e urdhër-pagesave postare midis operatorëve të caktuar dhe për rimbursim.

2. Fondet e përdoruesve do të menaxhohen në përputhje me parimet kujdesit të zbatueshme për menaxhimin e fondeve të palëve të treta.

Neni RP 1003
Monedha e lëshimit dhe pagesa

1. Në rast se monedha e destinacionit është konvertueshme, shuma e urdhër-pagesës postare duhet të shprehet në monedhën e operatorit të caktuar pages.

2. Kur një apo më shumë nga dy monedhat nuk është e konvertueshme, operatorët e caktuar do të bien dakord për të shprehur shumën e urdhrit në një monedhë të tretë të autorizuar nga vendi i destinacionit.

3. Kurset e këmbimit të përdorura për të shprehur shumën e urdhër-pagesës postare do të jenë ato që zbatohen në kohën e lëshimit të urdhër-pagesës postare. Kur operatori i caktuar lëshues nuk ka mjetet teknike për të shprehur urdhër-pagesën postare në monedhën e operatorit të caktuar pages, konvertimi në monedhën e pagesës do të bëhet nga operatori i caktuar të destinacionit me kursin e këmbimit që aplikohet në kohën e marrjes së urdhër-pagesës postare.

4. Pas këshillimit të operatorëve të caktuar në fjalë, operatori i caktuar pages, nëse kërkohet nga legjislacioni i tij, mund të injorohet fraksionet e njësive të monedhës ose të rrumbullakosë shumën në njësinë më të afërt të monedhës apo me një të dhjetën e saj, gjithmonë në favor destinatarit.

Neni RP 1004
Vendosja e tarifave

1. Tarifat do të caktohen nga operatorët e caktuar të lëshimit në mënyrë që të nxisin aksesueshmërinë ndaj shërbimeve.

2. Të gjitha detyrimet do të paguhën tërësisht nga dërguesi.

Neni RP 1005
Përrjashtimi nga tarifaf

1. Përrjashtimet nga detyrimet postare për artikujt që lidhen me shërbimin postar, dhe për artikujt e shërbimit të pagesave postare drejtuar apo të dërguara nga të burgosurit e luftës (përfshirë palët ndërluftuese të arrestuar dhe internuara në një vend neutral), ose të internuarit civilë, do të disiplinohen nga Konventa Universale Postare rregulloret e Postës së letrave.

Neni RP 1006
Përrjashtimi nga tarifaf postare për artikujt e shërbimit të pagesave me postë

1. Artikujt e postës së letrave do të përrjashtohen nga tarifaf, në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores së Postës së Letrave.

Neni RP 1007
Përrjashtimi nga tarifaf postare për pengjet e luftës dhe të internuarit civilë

1. Pikat e aksesit të shërbimit të pagesave postare do të përfitojnë nga përrjashtimi për tarifaf postare të artikujt e shërbimit të pagesave postare të personave të parashikuara në Konventën Postare Universale.

Neni RP 1008
Zbatimi i përrjashtimit nga tarifaf postare për institucionet që kanë të bëjnë me pengjet e luftë dhe të internuarit civilë

1. Institucionet që kanë të bëjnë me të pengjet e luftës dhe të internuarit civilë për të cilët është parashikuar përrjashtimi nga tarifaf postare janë të renditura në Rregulloren e Postës së Letrave.

Neni RP 1009
Shënimi i artikujve të dërguara pa tarifë postare

1. Informacioni i kërkuar për dërgimin e urdhër-pagesave do të jetë siç parashikuar në Rregulloren e Postës së Letrave.

Neni RP 1010
Procedurat për shpërrblim ndërmjet operatorëve të caktuar

1. Shpërrblimi do të përcaktohet në mënyrë të barabartë në bazë të tarifave të operatorit të caktuar lëshues. Ai mund të marrë parasysh cilësinë masës së shërbimit për urdhrat e dërguara në mënyrë elektronike.

2. Shuma totale e shpërrblimit do të shprehet në SDR bazuar në mesataren vjetore të SDR publikuar nga Byroja Ndërkombëtare e UPU-t.

3. Shpërrblimi do të përcaktohet në marrëveshjen e shërbimit, në përputhje me Marrëveshjen dhe Rregulloren.

Neni RP 1011
Informacioni i përdoruesit

1. Operatorët e caktuar do të paraqesin tarifaf e tyre dhe shpenzimet shtesë në pikat e tyre të shërbimit dhe, nëse aplikohet, në faqen e tyre të internetit.

Neni RP 1101
Cilësia e shërbimit për urdhër-pagesat postare të dërguara me mjete elektronike

1 Elementet minimale të cilësisë së shërbimit për urdhër-pagesat postare të dërguara në mënyrë elektronike do të jenë si më poshtë:

1.1 përrditesimi i bazës së të dhënave të Byrosë Ndërkombëtare;

1.2 përrpunimi në kohë i urdhër-pagesave postare;



- 1.3 anulimi në kohë;
- 1.4 përqindja e kërkesave që trajtohen në kohë;
- 1.5 përqindja e kërkesave.
2. Këshilli i Operacioneve Postare do të caktojë objektivat e cilësisë së shërbimit për këto elemente të ndryshme.
3. Operatorët e caktuar do të transmetojë të dhënat postare të kërkuara për matjen e cilësisë së shërbimit Byrosë Ndërkombëtare të UPU-t.
4. Byroja Ndërkombëtare do të menaxhojë të dhënat postare në lidhje me matjen e cilësisë së shërbimit postar në mënyrë konfidenciale. Aksesit në raportet të matjes së cilësisë së shërbimit të përgatitura duke përdorur këto të dhëna do të jenë të kufizuara për vendet anëtare që janë nënshkruese të Marrëveshjes, për operatorët e tyre të caktuar dhe Byronë Ndërkombëtare.

Neni RP 1102
Marka kolektive

1. Një markë kolektive mund të shoqërojë përdorimin e teknologjive të reja të veçanta për dërgimin e urdhër-pagesave postare.
2. Përdorimi i markës kolektive nga operatorët e caktuar do të jetë subjekt i përputhjes me objektivat e cilësisë të lidhura me këtë markë të vendosura nga përdoruesit e markës, në përputhje me objektivat e cilësisë së shërbimit të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare.

KAPITULLI 3
PARIMET PËR SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

Neni RP 1201
Kushtet për ndërveprimin dhe rregullimi i centralizuar

1. Rrjetet e përdorura nga operatorët e caktuar do të jenë të ndërlidhura për të mundësuar shkëmbimin e të dhënave elektronike në lidhje me urdhër-pagesat postare.
2. Operatorët e caktuar do të konfigurjnë fushat për të dhënat e pagesës postare në sistemin e tyre të informacionit, në përputhje me formularët e parashikuar në Rregullore, në mënyrë të tillë që të lejojnë ndërveprimin e sistemeve.
3. Operatorët e caktuar do të zbatojnë procedurat për trajtimin e urdhër-pagesave postare të parashikuara në Rregullore për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve të pagesave postare.
4. Operatorët e caktuar do të zbatojnë procedurat për vendosjen dhe pastrimin të parashikuara në Rregullore në mënyrë që të lejojnë vendosjen e centralizuar midis operatorëve të caktuar.

Neni RP 1301
Siguria e rrjetit

1. Çdo ndërlidhje e rrjeteve elektronike për transmetimin e urdhër-pagesave postare do të jetë subjekt i përputhjes me nivelin e sigurisë së rrjetit të ndërlidhur të përdorur nga operatorët e caktuar.
2. Operatorët e caktuar do të sigurojnë vlefshmërinë e certifikatës së nënshkrimit elektronik dhe kodimin e çdo mesazhi të të dhënave.
3. Sistemet e operatorëve të caktuar do të përdorin një sistem të përbashkët të sigurisë, në përputhje me standardet e sigurisë, që pajtohen me standardet ISO të pranuar nga UPU për të siguruar përpunimin dhe transmetimin e urdhër-pagesave postare.
- 3bis Çdo vështirësi në aplikimin dhe zbatimin e sistemit të përbashkët të sigurisë së UPUt në një shtet për shkak të legjislacionit të tij kombëtar do ti bëhet i njohur dhe përshkruhet Byrosë Ndërkombëtare.

Neni RP 1302
Siguria e shkëmbimeve elektronike

1. Operatorët e caktuar do të garantojnë sigurinë fizike dhe elektronike të pajisjeve të tyre, sigurinë e

të dhënave vazhdimësinë e shërbimit, në përputhje me standardet e ISO të pranuar nga UPU.

Neni RP 1303

Rregullat e punës dhe mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike

1. Të gjithë operatorët e caktuar do të kemi sisteme të veçanta prodhimi dhe testimi. Sistemi i prodhimit do të përdoret vetëm për përpunimin dhe transmetimin e të dhënave reale. Të gjitha testet bazë të komunikimit do të kryhen duke përdorur sistemin e testimit. Të gjithë operatorët e caktuar do të ketë një sistem rezervë.

2. Të gjithë operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemeve të tyre të prodhimit, sistemeve rezervë dhe testimit të infrastrukturës (harduer, softuer dhe rrjetit) të nevojshme për përpunimin dhe transmetimin e të dhënave, pavarësisht nëse këto infrastruktura ndodhen pranë operatorit të caktuar apo një pale të tretë.

Neni RP 1304

Siguria e të dhënave

1. Mesazhet e të dhënave në lidhje me urdhër-pagesat postare do të nënshkruhet në mënyrë digjitale. Të dhënat personale do të jenë të koduara.

2. Në rast se përdoret një sistem online, baza e të dhënave do të jetë e sigurt.

3. Të dhënat e transmetuara me nënshkrim elektronik të operatorit të caktuar do të gjykojnë autentike, të plota dhe të pakundërshtueshme.

4. E drejta e hyrjes tek të dhënat do të jetë rreptësisht e kufizuar për personelin e autorizuar nga operatori i caktuar.

Neni RP 1305

Sistemi rezervë i të dhënave

1. Baza e të dhënave e përdorur nga operatorët do të ruhet në një mënyrë të sigurt. Ajo do të ketë një sistem rezervë dhe procedura të cilat do të jenë të mjaftueshme për të mundësuar rifillimin e veprimtarive në raste emergjence.

2. Të gjithë operatorët e caktuar do të informojnë operatorët e tjerë të caktuar për çdo ndërprerje të planifikuar të shërbimit. Në rast të një ndërprerje të paplanifikuar, operatori i caktuar në fjalë do të ngrejë një njësi të emergjencës dhe do të informojë operatorët e tjerë të caktuar sa më shpejt të jetë e mundur nga arsyet e ndërprerjes dhe masat e marra për të zgjidhur problemin dhe për të parandaluar përsëritjen e tij.

3. Në rast të një alarmi serioz të sigurisë, operatori i caktuar duhet të informojë operatorët e tjerë të caktuar sa më shpejt të jetë e mundur për pezullimin e shërbimit, kohëzgjatjen e mundshme të ndërprerjes, dhe të rifillimit të shërbimit.

Neni RP 1306

E drejta e hyrjes në të dhënat e arkivuara

1. Subjekt i legjislacionit kombëtar, të dhënat e arkivuara do të jenë të aksesueshme dhe të disponueshme brenda tri ditëve të punës pas kërkesës, për urdhër-pagesat postare të shkëmbyera në mënyrë elektronike, dhe brenda një muaji nga kërkesa, për urdhrat me postë letrash.

Neni RP 1401

Gjurmimi dhe gjetja

1. Çdo sistem informacioni i përdorur nga operatorët e caktuar do të përmbajë njohuri funksionale për të siguruar gjurmimin dhe gjetjen e informacionit për urdhër-pagesat postare.

2. Çdo ndryshim në statusin e urdhër-pagesës postare duhet të shkaktojë për dërgimin e një mesazhi EDI.

3. Operatorët e caktuar do të dërgojnë një konfirmim për marrjen ose njoftim për refuzim për çdo mesazh EDI të marrë.

4. Dërguesi mund të kërkojë të marrë një këshillë për pagesën, transferimin ose rimbursimin.



5. Statusi i urdhër-pagesës postare ose një kërkesë në lidhje me ekzekutimin e urdhër-pagesës postare do të jenë në dispozicion të operatorëve të caktuar të përfshirë në zbatimin e kësaj urdhër-pagese postare.

6. Të dhënat do të ruhen online për të paktën gjashtë muaj.

PJESA II

RREGULLAT QË DISIPLINOJNË SHËRBIMET E PAGESAVE ME POSTË

Kapitulli 1

Përpunimi i urdhër-pagesës postare

Neni RP 1501

Formularët

1. Formularët duhet të gjenerohen nga sistemi i informacionit të përdorur nga operatori i caktuar ose të përgatitet në formë të printuar.

2. Formularët e gjeneruar nga sistemi i informacionit duhet të përmbajnë fusha të ngjashme me ato të parashikuara në formularët e bashkëlidhur me Rregulloren.

3. Formularët do të ofrojnë seksione shtesë të kërkuara nga operatorët e caktuar brenda kuadrit të marrëveshjeve të tyre të shërbimit.

Neni RP 1502

Informacioni i përbashkët për format e ekzekutimit

1. Informacioni i detyruar

1.1 Formularët e lidhur me ekzekutimin e urdhër-pagesave postare të përdoruesit duhet të përmbajnë referencat e pikës së shërbimit të operatorit të caktuar

2. Informacion jo i detyrueshëm

2.1 Mund të përdoret një seksion i “mesazhit personal” në formularët për marrëdhëniet me përdoruesit.

Neni RP 1503

Statusi i urdhër-pagesës postare ose një kërkesë

1. Operatorët e përcaktuar, me mjetet më të përshtatshme, do të informojnë njëra - tjetrën për çdo ndryshim në statusin e urdhër-pagesës postare ose kërkesës.

2. Në qoftë se ndryshimi i statusit nuk është gjeneruar automatikisht nga sistemi i informacionit të operatorit të caktuar, ky i fundit të fusë menjëherë të dhënat e ndryshimit të statusit për shkëmbime me mjete elektronike.

3. Statuset e ekzekutimit të urdhër-pagesës postare i futur nga operatori i caktuar lëshues ose pages duhet të përfshijë të paktën këto elemente:

3.1 përpunimi paraprak i urdhër-pagesës postare – operatori i caktuar lëshues;

3.2 urdhër-pagesa postare e përpunuar – operatori i caktuar lëshues;

3.3 përpunimi paraprak i urdhër-pagesës postare – operatori i caktuar pages;

3.4 urdhër-pagesa postare e paraqitur për pagesë pas përpunimit paraprak – operatori i caktuar pages;

3.5 njoftimi se pagesa është e pamundur ose informacion për vonesë – operatori i caktuar pages;

3.6 pagesa për destinatarin – operatori i caktuar pages;

3.7 këshilla e pagesës ose kreditimit në llogarinë e destinatarit (opsionale) – operatori i caktuar pages;

3.8 anulimi i pagesës për destinatarin (nëse gabimi në të dhëna vihet re brenda kohës së rënë dakord) – operatori i caktuar pages;

3.9 pagesa e re pas anulimit – operatori i caktuar pages;

3.10 lëshimi i kërkesës për revokim, ndryshim ose korrigjim të adresës – operatori i caktuar lëshues;

3.11 njoftimi për pranim ose jot ë kërkesës për revokim, ndryshim ose korrigjim të adresës –

operatori i caktuar pages;

3.12 njoftimi nëse rimbursimi është i mundur ose jo – operatori i caktuar pages;

3.13 njoftimi i rimbursimit për dërguesin (opsional) – operatori i caktuar lëshues;

3.14 njoftimi i rimbursimit për shkak të përfundimit të vlefshmërisë – operatori i caktuar pages;

3.15 rimbursimi – operatori i caktuar lëshues;

3.16 anulimi i rimbursimit të destinatarit (nëse gabimi i të dhënave vihet re brenda kohës së rënë dakord në marrëveshjen e shërbimit) – operatori i caktuar lëshues;

3.17 pagesa e re pas anulimit – operatori i caktuar lëshues;

3.18 njoftimi se rimbursimi është i pamundur dhe finalizimi – operatori i caktuar lëshues;

3.19 porosia e urdhër-pagesës postare – operatori i caktuar lëshues;

3.20 lëshimi i llogarisë mujore ose periodike – operator i caktuar pages;

3.21 finalizimi i urdhër-pagesave postare të përfshira në llogarinë mujore – operator i caktuar pages.

4. Statuset e ekzekutimit të një kërkesë për informacion / hetim do të përfshijë të paktën sa në vijim:

4.1 regjistrimin e kërkesës;

4.2 informacionin në lidhje me kërkesën për operatorin tjetër të caktuar, me përjashtim të rastit kur operator i caktuar i kontaktuar nga përdoruesi mund t'i përgjigjet kërkesës dhe të marrë masat e nevojshme pa u konsultuar me operatorin tjetër të caktuar;

4.3 përgjigjen e kërkesës;

4.4 informimin e përdoruesit – operator i caktuar lëshues.

Neni RP 1504

Kërkesa e urdhër-pagesës postare

1. Operatori i caktuar lëshues duhet të mbledhë të dhënat e kërkuara për ekzekutimin e urdhër-pagesës postare.

2. Dërguesi duhet të plotësojnë formularin e kërkesës së urdhër-pagesës postare dhe t'ia kalojë atë të operatorit të caktuar lëshues. Kushtet e shërbimit të operatorit të caktuar lëshues do të bashkëlidhen në formularin e kërkesës së pagesës postare të përdoruesit.

3. Kërkesat për urdhër-pagesës postare për urdhër-xhirimin me postë të letrave do të hartohen në formularin e përdoruesin në përputhje me modelin MP 1, ose ndonjë mjet të përshtatshëm për transfertat elektronike.

4. Kërkesat për urdhër-pagesë postare për transfertat do të hartohen në formularin e përdoruesit në përputhje me modelin VP 1, ose ndonjë mjet të përshtatshëm për transfertat elektronike.

5. Informacionet e dhëna për ekzekutimin e urdhër-pagesës postare duhet të jenë të sakta dhe të plota. Adresat e shkurtuara nuk do të jenë të pranueshme.

6. Përjashtimisht, kërkesat e urdhër-pagesave postare mund të futen në sistem nga dërguesi, subjekt i përmbushjes së kushteve që kanë të bëjnë me:

6.1 parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimit financiar;

6.2 sigurinë;

6.3 gjurmimin dhe gjetjen;

6.4 konfidencialitetin.

7. Shënimet në urdhër-pagesat postare me postë të letrave duhet të jenë mundësisht të shtypura në makinë. Ato mund të jenë të shkruara me dorë, me gërma të mëdha shtypi nëse është e mundur. Informacionet e dhëna për ekzekutimin e urdhër-pagesës postare me postën e letrave duhet të jenë të lexueshme. Nuk do të pranohen shënimet me stilolaps. Urdhër-pagesat postare nuk duhet të kenë fshirje ose ndryshime, edhe në qoftë se këto janë të certifikuara.

8. Në përgjithësi, urdhër-pagesa postare duhet të shkruhet me shkronja romake dhe numra arabe. Informacione të tilla si emrat dhe adresat sidoqoftë, mund të shkruhen me gërma të një gjuhe të rënë dakord midis operatorëve të caktuar.



Neni RP 1505

Kontrolli i kërkesës së urdhër-pagesës postare nga operatori i caktuar lëshues

1. Para pranimit të kërkesës për urdhër-pagesë postare nga dërguesi, dhe subjekt i dispozitave të hartuara për të luftuar pastrimin e parave, nëpunësi i operatorit të caktuar lëshues duhet të kontrollojë nëse:

1.1 urdhër-pagesa postare është në përputhje me kushtet e parashikuara në Marrëveshje, në Rregullore dhe legjislacionin kombëtar;

1.2 urdhër-pagesa postare është e ekzekutueshme në përputhje me marrëveshjen e shërbimit midis operatorëve të caktuar;

1.3 urdhër-pagesa postare është shoqëruar me dërgimin e fondeve nga dërguesi ose nga një urdhër për të debituar llogarinë e tij;

1.4 nëse aplikohet, llogaria e dërguesit përmban fonde të mjaftueshme.

Neni RP 1506

Hyrja e urdhër-pagesave postare

1. Në parim, të dhënat duhet të futen në sistemin e informacionit të operatorit të caktuar lëshues nga titullari i pikës së aksesit të akredituar të shërbimit. Në këtë rast, operatorët e caktuar lëshues do të kontrollojnë që të dhënat e futura të jenë në përputhje me informacionet e dhëna në kërkesën e urdhër-pagesës postare.

Neni RP 1507

Frekuenca e lidhjeve me sistemin e informacionit

1. Në rastet kur përdoret një sistem informacioni, operatori të caktuar do të lidhet me të sa më shpesh të jetë e mundur.

1.1 Në rastet kur përdoret një sistem informacioni i patentuar, operatori i caktuar do të lidhet me të të paktën dy herë në ditë.

1.2 Në qoftë se përdoret një sistem online, operatori i caktuar do të lidhet me këtë sistem të paktën një herë në ditë për të pasur akses në raportin ditor të aktivitetit.

Neni RP 1508

Pranimi i urdhër-pagesës postare

1. Aplikimi i vulës tek kërkesa për urdhër-pagesë postare ose në faturën e saj do të tregojë pranimin e urdhër-pagesës postare nga operatori i caktuar lëshues.

Neni RP 1509

Lëshimi i urdhër-pagesës postare

1. Urdhër-pagesa postare duhet të lëshohet në formularin MP 1 ose VP 1, ose ndonjë formular tjetër të përshtatshëm.

1bis Do të jetë e ndaluar të bëhen, në urdhër-pagesa postare, shënime të ndryshme nga ato të lejuara në përmbajtjen e formularëve, me përjashtim për udhëzimeve të shërbimit.

2. Pas lëshimit të urdhër-pagesës postare, do ti jepet falas dërguesit, një kopje e urdhër-pagesës postare elektronike ose një kupon i shërbimit të postës së letrave, si faturë.

3. Sistemi i informacionit i përdorur nga operatori i caktuar lëshues do të nxjerrë automatikisht formularin e kohës së printimit.

3bis Për dërguesin lëshohet pa tarifë një faturë. Ajo do të përmbajë informacion në lidhje me urdhër-pagesën postare të vërtetuar nga ana e dërguesit, tarifat dhe pagesat në lidhje me urdhër-pagesën postare, kursin e këmbimit të aplikuar, nëse është e nevojshme, si dhe kushtet e shërbimit.

Neni RP 1510
Kërkesa për revokim

1. Dërguesi mund të kërkojë tërheqjen e urdhër-pagesës postare.

Neni RP 1511
Periudha e vlefshmërisë së urdhër-xhirimeve

1. Periudha e vlefshmërisë e urdhër-xhirimeve të dërguara me mjete elektronike do të jetë 30 ditë kalendarike nga data e lëshimit të tyre.
2. Periudha e vlefshmërisë së urdhër-xhirimeve me postë të letrave do të zgjatet deri në përfundimin e muajit të dytë nga data e lëshimit.
- 2bis Operatori i caktuar lëshues dhe operatori i caktuar pages mund të bien dakord mbi një periudhë të ndryshme nga ato të përmendura më sipër.

Neni RP 1512
Këshillimi i pagesës ose i kreditimit në llogarinë e destinatarit

1. Në qoftë se marrëveshja e shërbimit të operatorëve të caktuar lejon, dërguesi mund të kërkojë të këshillohet në lidhje me pagesën për destinatarin ose kreditimin në llogarinë e tij.
2. Këshilla do të përgatitet në një formularin CN 07, në përputhje me Rregulloren e Postës së Letrave. Ajo do të përgatitet nga operatori i caktuar pages, ku urdhër-pagesat postare janë dërguar me mjete elektronike. Në rastin e urdhër-pagesave postare me postë të letrave, formulari CN 07 do të bashkëlidhet me formularin MP 1 ose VP 1 nga operatori i caktuar lëshues.
3. Të dhënat për këshillat do të futen elektronikisht për urdhër-pagesat postare të dërguara me anë të mjeteve elektronike dhe është vendosur një fushë në formularët MP 1 dhe VP 1 për futjen e referencës së këshillës. Operatori i caktuar pages duhet të plotësojë këtë fushë pas regjistrimit të urdhër-pagesës postare. Këshilla e pagesës do të përgatitet në përputhje me formularin CN 07 dhe i adresohet dërguesit nga operatori i caktuar lëshues.

Neni RP 1513
Indikacione të shumave

1. Shumat e urdhër-pagesave postare dhe shpërblimet do të jepet në shifra, me shkurtim i emrit të njësisë së monedhës. Fraksionet e njësisë së monedhës duhet të shprehen duke përdorur dy (ose tre) shifra, duke përfshirë edhe zeron, që korrespondon përkatësisht me të dhjeta, të qindta (dhe të mijta).
2. Për urdhër-pagesat postare që kanë të bëjnë me urdhër-xhirimet me postën e letrave, sasia dhe emri i njësisë monedhës duhet të jenë të shkruara të plota në gjuhën e rënë dakord midis operatorëve të caktuar. Shuma mund të jetë e shprehur gjithashtu në fjalë të shkruar shifër pas shifrës veç e veç. Në shumën e shkruar me fjalë, nëse përsëritja e fraksioneve nuk është e detyrueshme, ato mund të jenë të shprehura në shifra pas treguesit të numrit të njësisë të monedhës.

Neni RP 1514
Dërgimi i urdhër-pagesave postare

1. Urdhër-pagesat postare duhet të dërgohen tek operatori i caktuar pages me mjetet më të shpejta.
 - 1.1 Në rast se është përdorur një sistem informacioni, urdhër-pagesat postare me para në dorë (kesh) duhet të adresohen drejtpërsëdrejti në pikën e aksesit të shërbimit të pagesave, dhe ato që do të futen në llogarinë e destinatarit do të adresohen drejtpërsëdrejti në qendrën postare.
 - 1.2 Urdhërat- me postën e letrave do të adresohen tek operatori i caktuar pages dhe do të ketë të shkruar "Service des postes" (në shërbimin postar) ose diçka të ngjashme.
2. Dërgimi i urdhër-pagesave postare me anë të mjeteve elektronike do të bëhet në datën e lëshimit të urdhrit ose brenda dy ditëve të punës nëse urdhri është lëshuar nga një pikë shërbimi që nuk është e lidhur me rrjetin elektronik. Ato do të dërgohen me mesazh elektronik.
3. Në parim, frekuenca e transmetimit të artikujve me anë të mjeteve elektronike nuk duhet të jetë më



i ulët se dy herë në ditë gjatë orarit të punës. Megjithatë, operatorët e caktuar mund të bien dakord për një frekuencë më të madhe.

4. Urdhër-pagesat postare të lëshuara pas kohës së mbylljes zyrtare të pikës së aksesit të shërbimit do të dërgohen me mjete elektronike në ditën pasardhëse të punës.

5. Urdhër-pagesat postare me postën e letrave do të dërgohen me postë prioritare dhe, në mungesë të marrëveshjes së posaçme, à découvert.

5.1 Urdhër-pagesa postare me postën e letrave do të vendoset në postë në përputhje me Rregulloren e Postës së Letrave. Urdhër-pagesa postare duhet të largohet nga territori e shtetit të lëshimit me postë prioritare jo më vonë se gjashtë ditë pune pas depozitimit të saj në pikën e aksesit të shërbimit.

5.2 Me marrëveshje midis operatorëve të caktuar, urdhër-xhirimet me postën e letrave mund të përfitojnë nga shërbimi i regjistrimit suplementar të parashikuar në Konventën Postare Universale.

5.3 Rregullorja e Postës së Letrave do të zbatohet për dërgimin e mesazheve të urdhër-pagesave xhirimeve postare sipas sigurimit të regjistruar.

Neni RP 1515

Rregulla specifike për transfertat

1. Shuma e përgjithshme e urdhrave të transfertave të treguara në listat (formulari VP 4) dhe të destinuara për të njëjtën qendër do të kryhet mbi dërgimin e përditshëm të transfertave (formulari VP 5) të përgatitur në dy kopje.

2. Totali i përgjithshëm i urdhrave të transferimit do të jepet në fjalë ose i shtypur në shifra.

3. Numri i hyrjes në formularin VP 5 do të bartet në të gjitha listat VP 4.

4. Formularët VP 5 duhet të përmbajnë të paktën numrin serial, seria e të cilit do të rinovohet për çdo periudhë të re vendosje për çdo qendër postare ose pikë të shërbimit të operatorit të caktuar pagues.

Neni RP 1601

Trajtimi i urdhër-pagesave postare nga operatori i caktuar pagues

1. Fatura e urdhër-pagesës postare me anë të mjeteve elektronike do të konsiderohet të jetë i njëjtë me datën e mbërritjes së urdhër-pagesës postare në pikën e aksesit të shërbimit të pagesave të operatorit të caktuar pagues.

2. Data e faturës së urdhër-pagesave postare me postën e letrave nga operatori i caktuar pagues do të konsiderohet të jetë i njëjtë me datën e mbërritjes së këtyre urdhër-pagesave postare.

Neni RP 1602

Trajtimi specifik për urdhër-xhirimet

1. Urdhër-xhirimet hyrëse me postën e letrave duhet të dërgohen menjëherë në pikën e aksesit të shërbimit nëse nuk kanë nevojë për përpunim ndërmjetës.

2. Urdhër-xhirimet, subjekt i kontroleve të nevojshme, do të jenë të pagueshme pas arritjes së tyre në pikën e aksesit të operatorit të caktuar pagues.

Neni RP 1603

Nënshkrimi dhe dërgimi i urdhër-xhirimeve

1. Nëse legjislacioni i vendit të destinacionit e lejon, dhe nëse operatorët e caktuar kanë një marrëveshje shërbimi për këtë qëllim, pronësia e urdhër-xhirimeve postare mund të transferohet me anë të nënshkrimit.

2. Ridërgimi i një urdhër-xhirimi në një shtet tjetër nuk lejohet.

Neni RP 1604
Trajtimi i kërkesës për revokim

1. Pas pranimit të kërkesës, operatori i caktuar pagues duhet të plotësojë formularin e MP 2 ose VP 2, pasi ka mbledhur informacionin e nevojshëm.
2. Operatori i caktuar pagues do të dërgojë formularin MP 2 ose VP 2 të plotësuar si duhet, tek operatori i caktuar lëshues me anë të mjeteve të shpejta, duke bashkëlidhur formularin përkatës MP 1 në rastin e një urdhri me postë të letrave.
3. Në rastin kur fondet nuk janë derdhur tek destinatarit ose llogaria e tij ende nuk është kredituar, operatori i caktuar pagues do të veprojë në lidhje me kërkesën. Përndryshe, kërkesa do të refuzohet.

Neni RP 1605
Zëvendësimi i urdhër-xhirimeve të humbura, zhdukura ose shkatërruara para pagesës

1. Çdo urdhër-xhirim MP 1 i humbur, zhdukur apo shkatërruar para pagesës mund të zëvendësohet, me kërkesë të dërguesit ose destinatarit, me anë të një urdhër-xhirimi të ri të lëshuar nga operatori i caktuar lëshues.
2. Para zëvendësimit të një urdhër-xhirimi të supozuar i humbur, zhdukur ose shkatërruar para pagesës, operatorët e caktuar do të konsultohen me njëri-tjetrin dhe do të binden se urdhër-xhirimi origjinal nuk është paguar ose rimbursuar. Do të merren të gjitha masat paraprake shmangur që një urdhër-xhirim i cili supozohet humbur, zhdukur apo shkatërruar të paguhet me vonë.
3. Kur operatori i caktuar pagues deklaron se një urdhër-xhirim me postë të letrave nuk ka mbërritur, operatori i caktuar lëshues mund ta zëvendësojë atë me një të re, nëse urdhër-xhirimi në fjalë nuk shfaqet në asnjë nga llogaritë mujore që mbulon periudhën e vlefshmërisë së urdhër-xhirit.
4. Nëse nuk merret përgjigje nga operatori i caktuar pagues brenda një periudhe prej një muaji nga dita pas datës së kërkesës për të dhëna dhe në qoftë se instrumenti nuk shfaqet në asnjë nga llogaritë mujore të marra deri në fund të kësaj periudhe, operatori i caktuar lëshues do të autorizohet të rimbursojë fondet, në përputhje me Rregulloren e Postës së Letrave në rastin e një urdhër-xhirimi me postën e letrave.
5. Njoftimi i dëmshpërblimit të ankuesit do të dërgohet me kapak të regjistruar për operatorin e caktuar pagues dhe urdhër-xhirit me postën e letrave, do të konsiderohet në vijim i humbur përfundimisht, në mënyrë që të mos shënohet në llogari më vonë.

Neni RP 1606
Kontrolli nga operatori i caktuar pagues për qëllimet e pagesës ose kreditimit në llogarinë e destinatarit

1. Për transfertat dhe urdhrat e pagesës, operatori i caktuar pagues do të kontrollojë, pas paraqitjes së faturës, se urdhrat me postën e letrave të marra ose të renditura në bazën e të dhënave në pritje të kreditimit në llogarinë e destinatarit nuk kanë parregullsi.
2. Për pagesat me para në dorë (kesh) të urdhër-pagesave postare në pikën e aksesit të shërbimit, nëpunësi i akredituar duhet të kontrollojë se urdhër-pagesat postare nuk kanë parregullsi. Para se të paguajë destinatarin, nëpunësi i akredituar do të kontrollojë identitetin e destinatarit dhe do të konfirmojë se kërkesa e pagesës korrespondon me urdhër-pagesën postare të marrë.

Neni RP 1607
Trajtimi specifik i transfertave

1. Transfertat hyrëse do të kreditohen në llogarinë e destinatarit menjëherë ose jo më vonë se dita e punës pas mbërritjes së tyre.
2. Pasi totali i listave VP 5 është kontrolluar, shuma e përgjithshme e urdhrave të transferimit do të debitohet menjëherë në llogarinë e përqendrimit për këstet ose një llogari të ndërlidhjes të hapur në emër të operatorit të caktuar lëshues.
3. Një kopje e mesazhit ditor VP 5 printuar me datë printimi të operatorit të caktuar do t'i bashkëlidhet me deklaratën e përditshme të llogarisë, të dërguar të njëjtën ditë me transaksionin e operatorit të caktuar që mban llogarinë e përqendrimit për këstet ose llogarinë rrjedhëse të ndërlidhjes të debituar.



Neni RP 1608
Urdhër-pagesat postare të parregullta

1. Urdhër-pagesat postare do të konsiderohen të parregullta në qoftë se ata kanë një nga parregullsitë e mëposhtme:

1.1 të pasakta, të paplota, të paqarta ose tregim të gabuar të emrit ose adresës së destinatarit, ose të dhënat e llogarisë rrjedhëse postare;

1.2 referenca të urdhër-pagesave postare të paplota ose qartësisht të pasakta, sipas legjislacionit kombëtar;

1.3 mospërputhje ose lënie jashtë të shumave;

1.4 shuma e tejkalon shumën maksimale ose është më e ulët se shuma minimale e autorizuar;

1.5 fshirje ose ndryshime të të dhënave në urdhrat me postën e letrave;

1.6 gabim i dukshëm në konvertimin e monedhës ose kursin e këmbimit të përdorur;

1.7 mungesa e vulës;

1.8 tregimi i shumës që do të paguhet në monedhë të ndryshme nga ajo e rënë dakord;

1.9 përdorimi i një formulari të parregullt;

1.10 arsye të tjera që rrjedhin veçanërisht nga marrëveshja e shërbimit.

Neni RP 1609
Trajtimi i urdhër-pagesave postare të parregullta

1. Çdo mesazh EDI që ka të bëjë me urdhër-pagesat postare do të refuzohet nëse të dhënat e futura nuk përbushin kushtet e nevojshme për ekzekutimin e urdhër-pagesës postare, një kërkesë për të dhëna ose një kërkesë për revokim.

2. Operatori i caktuar që ka dërguar mesazhin do të njoftohet për refuzimin sapo arsyetja për të të jetë përcaktuar. Të dhënat duhet të korrigjohen ose plotësohen nga operatori i caktuar që ka dërguar mesazhin dhe ti ridërgohet operatorit tjetër të caktuar në ditën e parë të punës pas refuzimit. Kur përdoret një kombinim i teknologjive, afati kohor në fjalë do të përcaktohet në marrëveshjen e shërbimit dhe nuk mund të kalojë tre ditë pune.

3. Refuzimi do të gjenerohet automatikisht nga sistemi i informacionit i operatorit të caktuar në rastet e mëposhtme:

3.1 mospërputhje me marrëveshjen e shërbimit;

3.2 gabim në personalizimin e mesazhit;

3.3 gabim në bazën e të dhënave;

3.4 gabim në titullin e mesazhit;

3.5 urdhër-pagesa postare që i korrespondon mesazhit nuk gjendet;

3.6 mungesë e elementëve thelbësorë;

3.7 sekuencë e pasaktë operacionale;

3.8 version i pasaktë i mesazhit;

3.9 pezullim i shërbimit.

4. Parregullsitë e zbuluara nga agjenti i akredituar i secilit prej operatorëve të caktuar në lidhje me urdhër-pagesën postare do t'i raportohet menjëherë tek operatori tjetër i caktuar me mjetet më të shpejta.

Neni RP 1610
Trajtimi i urdhër-xhirimeve të parregullta të postës së letrave

1. Si një përjashtim për kthimin e urdhrit tek operatori i caktuar lëshues, operatori i caktuar pages, në përgjegjësinë e vet, mund të korrigjojë automatikisht ndonjë gabim të vogël. Korrigjim të tilla do të shënohet me të kuqe dhe do të nënshkruhen nga agjenti i akredituar.

2. Nëse është bërë një kërkesë për të ndrequr një parregullsi, urdhër-xhirimi në fjalë do të mbahet nga operatori i caktuar pages, i cili do të procedojë për të ndrequr parregullsinë pas marrjes së përgjigjes. Përgjigja e kërkesës për korrigjimin do të shoqërojë urdhër-xhirimin.

Neni RP 1611

Trajtimi i transfertave të parregullta të postës së letrave

1. Në rast të parregullsive ose mosveprimeve që kanë të bëjnë me listat përmbledhëse, listat apo këshillat e transfertave, operatori i caktuar pages do ta raportojë këtë në njoftimin e operatorit të caktuar lëshues me anë të mjeteve më të shpejta. Ky i fundit do t'i përgjigjet me të njëjtat mjete dhe, nëse është e nevojshme, do të dërgojë një kopje të dokumenteve që mungojnë. Rregullimi me postë do të kryhet me anë të një formulari VP 3.

2. Nëse parregullsia ka të bëjë me një mospërputhje midis shumave në informacionin e transferimit dhe në listën e transfertës, operatori i caktuar pages do të kryejë transfertën për shumën më të ulët midis tyre; nëse kjo është bërë, informacioni i transfertës ose listës së transfertës dhe mesazhit të përditshëm, sipas rastit, do të ndryshohet sipas kësaj me bojë të kuqe në një listë të rregullimit në formularin VP 3.

Neni RP 1612

Rregullimi i urdhër-pagesave të parregullta postare

1. Nëse janë zbuluar parregullsi nga ana e agjentit të akredituar të operatorit të caktuar, ky i fundit, me mjetet më të shpejta, do të njoftojë operatorin tjetër për çdo vonesë ose do të hyjë ose do të dërgojë një kërkesë rregullimi me anë të një formulari MP 3 ose VP 3.

Neni RP 1613

Pagesat për destinatarin dhe gjurmimi

1. Për urdhër-xhirime të jashtme dhe me para në dorë (kesh), destinatari do të nënshkruajë faturën në përputhje me formularin MP 1.

2. Nëse urdhër-pagesa postare është i shoqëruar me një këshillë për pagesë apo hyrje e kryer nga destinatari, dërguesi duhet të njoftohet me anë të mjeteve më të shpejta pas ekzekutimit të urdhër-pagesës postare.

Neni RP 1614

Procedurat për zëvendësimin e urdhër-pagesave me postën e letrave të humbura, zhdukura ose shkatërruara pas pagesës

1. Operatori i caktuar pages mund të zëvendësojë çdo urdhër-xhirim MP 1 të humbur, zhdukur apo shkatërruar pas pagesës me një instrument të ri të përgatitur në formularin e MP 1. Formulari duhet të ketë të gjithë treguesit e nevojshëm të instrumentit fillestar, si dhe fjalët "Titre établi en remplacement d'un mandat égaré (perdu ou détruit) après paiement" (Instrument i përgatitur për të zëvendësuar një urdhër-xhirim të humbur (zhdukur apo shkatërruar) pas pagesës), si dhe vulën e operatorit të caktuar dhe datën.

2. Duhet të jepet një deklaratë nga destinatari për marrjen e fondeve, mundësisht në anën e pasme të vetë instrumentit të zëvendësimit. Përfundimisht, kjo deklaratë mund të merret në një letër bashkangjitur me këtë të fundit si një dokument mbështetës; një deklaratë e tillë do të zëvendësojë faturën origjinale.

3. Nëse kjo deklaratë nuk mund ti kërkohej destinatarit, duhet të bëhet një shënim zyrtar në pjesën e prapme të instrumentit të zëvendësimit ose në një dokument të veçantë mbështetës, duke deklaruar se shuma e urdhër-xhirit është paguar realisht.

Neni RP 1801

Motivet e rimbursimit

1. Do të jepet rimbursim:

1.1 për motive që lidhen me destinatarin (mos-pranimi, destinatar i panjohur panjohur ose vdekur ose adresa aktuale e panjohur, duke përfshirë rastet në të cilat kreditimi në llogarinë e destinatarit është i pamundur;

1.2 për motive që lidhen me dërguesin (të dhënat jo të plota ose të pasakta ose revokimi i urdhër-pagesës postare para përfundimit të periudhës për vlefshmërinë e urdhër-xhirit dhe pagesës për destinatarin);



1.3 për motive që lidhen me operatorët e caktuar (parregullsi të urdhër-pagesës postare);

1.4 nëse periudha e vlefshmërisë së urdhër-xhimit ka përfunduar.

Neni RP 1802
Metoda e rimbursimit

1. Shuma e ridërguar nga dërguesi në monedhën e vendit të çështjes do ti rimburohet dërguesit ose do të kreditohet në llogarinë e tij.

2. Shuma do të kthehet falas.

3. Operatori i caktuar pages do të kthejë urdhrin e papaguar tek operatori i caktuar lëshues, pa ndryshim të shumave dhe të monedhave të lëshimit të urdhrit.

Neni RP 1803
Rimbursimi për shkak të përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së urdhër-pagesës

1. Pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së urdhër-xhimit me postën e letrave, operatori i caktuar pages do të dërgojë menjëherë formularin MP 1 ose MP 2 për operatorin e caktuar dërgues për rimbursim. Në rastet kur është përdorur një sistem informacioni, urdhër-pagesa postare do të kthehet automatikisht tek operatori i caktuar lëshues për rimbursimin e dërguesit.

Neni RP 1804
Trajtimi i rimbursimeve

1. Pasi kushtet e rimbursimit janë përmbushur, operatori i caktuar pages duhet të plotësojë një formular CN 15, duke treguar motivet e kthimit, në përputhje me Rregulloren e Postës së Letrave. Njëkohësisht duhet të plotësohet një formular MP 3 ose formular VP 3.

2. Formularët MP 3 të plotësuar sipas rregullave, të shoqëruar nga urdhër-pagesat MP 1, do të dërgohen me mjetet më të shpejta tek operatori i caktuar lëshues.

3. Transfertat e refuzuara do të regjistrohen në formularin VP 3 në shumën e debituar, në monedhën e shtetit lëshues.

4. Shuma totale e formularit VP 3 do të kreditohet në llogarinë e përqendruar për këstet ose një llogari rrjedhëse të hapur në emrin e operatorit të caktuar lëshues të transfertave të refuzuara.

5. Formulari VP 3 dhe njoftimi i transfertës bashkëlidhur me të do të bashkëlidhen me deklaratën ditore të llogarisë që shoqëron formularin VP 5, i cili do të dërgohet në të njëjtën ditë me transaksionin tek operatori i caktuar llogaria rrjedhëse e të cilit është debituar.

Neni RP 1805
Urdhër pagesa të mbetura

1. Shumat e paguara të urdhër-xhimit ndërkombëtare të cilat nuk janë kërkuar brenda afatit të parashkrimit do të përpunohen nga operatorët e caktuar lëshues në përputhje me legjislacionin e tij tyre kombëtar.

KAPITULLI 2
KËRKESAT PËR TË DHËNA DHE PËRGJEGJËSIA

Neni RP 1901
Kërkesat për të dhëna

1. Dërguesi ose destinatari mund të paraqesë një kërkesë për të dhëna tek operatori i tij i caktuar.

2. Kërkesat për të dhëna do të përgatiten nga përdoruesi në një formular në përputhje me formularët MP 2 ose VP 2.

3. Kërkesat për të dhëna priten brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga dita në të cilën është

lëshuar urdhër-pagesa postare.

4. Kërkesa për të dhëna do të regjistrohen sapo formulari të vuloset me vulën e operatorit të caktuar.

5. Operatorët e caktuar do të lëshojnë një faturë e përdoruesit që paraqet kërkesën për të dhëna duke vërtetuar regjistrimin e kërkesës për të dhëna.

5bis Nëse një kërkesë për të dhëna shkaktohet nga një gabim të operatorëve të caktuar, ankuesit do t'i rimbursohen të gjitha pagesat e mbledhura për kërkesën për të dhëna.

5ter Çdo kërkesë për të dhëna për transfertat me postën e letrave do të dërgohet në qendrën postare që mban llogarinë që do të kreditohet.

Neni RP 1902

Afatet kohore për përpunimin

1. Kërkesa për të dhëna do të përpunohet menjëherë nga operatori i caktuar që e merr atë. Nëse çështja nuk mund të zgjidhet nga ai operator i caktuar, operatori tjetër i caktuar që ka të bëjë me çështjen do të informohet menjëherë, të paktën brenda ditës së tretë të punës pas marrjes së kështillës. Operatori i caktuar që ka të bëjë me çështjen do të përgatisë një përgjigje paraprake (ose përfundimtare) brenda tre ditëve të punës për urdhër-pagesat postare elektronike, dhe brenda 10 ditëve të punës për urdhër-pagesat postare me postën e letrave.

2. Nëse pika e aksesit të shërbimit e operatorit të caktuar është në pozitën që mund të japë një informacion përfundimtar mbi statusin e instrumentit, ajo do të kthejë formularin MP 2, ose ekuivalentin e tij elektronik, të plotësuar sipas rregullave, tek pika e aksesit të operatorit të caktuar. Në rast të hetimeve të pafrytshme ose pagesave të kundërshtuara, një deklaratë e destinatarit që vërteton se ai nuk e ka marrë shumën e urdhër-xhirimit, e cila do të merret në formularin MP 2, ose ndryshe do t'i bashkëlidhet me formularin.

3. Përgjigja përfundimtare për kërkesën për të dhëna do të jepet jo më vonë se:

3.1 10 ditë pune pas mbërritjes së kërkesës për të dhëna në lidhje me urdhër-pagesë postare të dërguar me mjete elektronike në shtetin e destinacionit;

3.2 një muaj pas mbërritjes së kërkesës për të dhëna në lidhje me urdhrin me postën e letrave në shtetin e destinacionit.

4. Dërguesi mund të rimbursohet ose llogaria e tij të kreditohet nga operatori i caktuar lëshues. Rimbursimi ose kreditimi do të bëhen të pagueshme pasi të jepet përgjigja përfundimtare.

Neni RP 1903

Shtirja e përgjegjësisë të operatorit të caktuar lëshues ndaj përdoruesit

1. Përgjegjësia e operatorit të caktuar lëshues ndaj përdoruesit do të kufizohet në ekzekutimin e saktë të urdhër-pagesës postare.

Neni RP 2001

Përcaktimi i përgjegjësisë

1. Subjekt i paragrafëve 2 deri në 5 të mëposhtëm, përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar lëshues.

2. Përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar pagues në qoftë se nuk mund të vërtetohet se pagesa është bërë sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e tij, dhe në veçanti, nëse, pas njoftimit të rregullt të rimbursimit të urdhër-pagesës postare nga ana e operatorit të caktuar lëshues për operatorin e caktuar pagues, ky i fundit i paguan urdhër-pagesën postare destinatarit.

3. Përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar të shtetit në të cilin ndodh gabimi:

3.1 nëse është një gabim shërbimi, duke përfshirë gabimin në konvertim;

3.2 nëse është një gabim i kapjes ose transmetimit të të dhënave.

4. Përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar lëshues dhe operatorit të caktuar pagues në mënyrë të barabartë:

4.1 nëse gabimi ka ardhur nga të dy operatorët e caktuar ose nëse nuk është e mundur të përcaktohet në cilin shtet ka ndodhur gabimi;

4.2 nëse ka ndodhur një gabim në transmetimin e një shteti ndërmjetës;

4.3 nëse nuk është e mundur të vendoset shteti në të cilin ka ndodhur gabimi I transmetimit.



5. Përgjegjësia do të jetë:

5.1 e operatorit të caktuar lëshues ose e operatorit të caktuar pagues në qoftë se nuk mund të përcaktohet nëse pagesa është bërë sipas kushteve të përshkruara në rregulloren e tij, në rastin e pagesës së një urdhri të rremë;

5.2 në rastin e pagesës së një urdhri, shuma e të cilit është rritur me mashtrim, e operatorit të caktuar të vendit në të cilin urdhri është falsifikuar; megjithatë, humbja do të mbulohet në mënyrë të barabartë nga operatori i caktuar lëshues dhe atij pagues nëse nuk është e mundur të vendoset shteti në të cilin ka ndodhur falsifikimi ose kur nuk është e mundur të merret kompensim për falsifikimin e kryer në një vend të ndërmjetëm që nuk merr pjesë në shërbimin e transferimit të fondeve në bazë të Marrëveshjes.

6. Operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës për veprimet, gabimet dhe mosveprimet për nënkontraktorët.

Neni RP 2002

Pagesa e shumave të detyruara në lidhje me dëmshpërblimin

1. Do të jetë detyrim i operatorit të caktuar lëshues për të dëmshpërblyer ankuesin.
2. Operatori i caktuar që dëmshpërblen ankuesin do të ketë të drejtën e rekursit kundër operatorit të caktuar që është përgjegjës.
3. Operatori i caktuar, i cili në fund të fundit përball humbjen do të ketë të drejtën për rekurs, deri në shumën e paguar, kundër personit që përfiton nga gabimi.
4. Pagesa e shumave për shkak të ankuesit do të bëhet sapo të jetë përcaktuar përgjegjësia dhe jo më vonë se dy muaj nga dita pas ditës së kërkesës.
5. Nëse operatori i caktuar që prezumohet të jetë përgjegjës, edhe pse është informuar siç duhet, ka lejuar të kalojë një muaj pa zgjidhur përfundimisht një kërkesë, operatori i caktuar për të cilin është bërë kërkesa do të jetë i autorizuar të dëmshpërblejë ankuesin në emër të operatorit tjetër të caktuar.

Neni RP 2003

Rimbursimi i operatorit të caktuar të përfshirë

1. Operatori i caktuar, i cili ishte përgjegjës do të jetë i detyruar të paguajë operatorin e caktuar lëshues, i cili dëmshpërblen ankuesin, brenda një muaji nga dërgimi i kështillës për pagesë.
2. Në fund të kësaj periudhe, shuma që operatori i caktuar lëshues që rimbursohen kërkesin detyrohet do të paguhet me interes për pagesat e vonuara në një normë të bazuar në:
 - 2.1 legjislacionin e tij kombëtar;
 - 2.2 interesin e rënë dakord në marrëveshjen e shërbimit të operatorit;
 - 2.3 praktikat tregtare kombëtare të operatorit të caktuar pagues.

KAPITULLI 3

MARRËDHËNIE FINANCIARE NDËRMJET OPERATORËVE TË CAKTUAR

Neni RP 2301

Rregulla të kontabilitetit

1. Të gjitha operacionet debitit dhe të kreditit të lidhura me ekzekutimin e urdhër-pagesave postare sjellin kontabilizimin e bonove dhe zërave.
 - 1bis Çdo zë i kontabilitetit në lidhje me ekzekutimin, rimbursimin dhe shlyerjen e një urdhër-pagese postare do të ketë një identifikues që korrespondon me atë urdhër-pagesë postare.
 2. Secili operator i caktuar do të hartojë një listë të urdhër-pagesave postare të pa ekzekutuara:
 - 2.1 duke kontrolluar listat e urdhër-pagesave postare të ekzekutuara në llogarinë periodike (formulari PP 1) kundrejt listave përmblendhëse të urdhër-pagesave postare (formulari MP 7, VP 4 dhe VP 5);
 - 2.2 duke koordinuar lëvizjet në llogarinë e përqendrimit ose transaksionet në llogarinë pasqyrë të listave të urdhër-pagesave postare të lëshuara, rimbursuara dhe paguara.

3. Në parim, do të ketë intervale mujore për llogaritë që lidhen me fondet apo pagesat. Operatorët e caktuar mund të vendosin në marrëveshjet e tyre të shërbimit mbylljen e llogarive në intervale të shkurtra.

Neni RP 2302

Listat ditore të përgatitura automatikisht nga sistemi i informacionit

1. Për qëllim të menaxhimit të mirë të parave në dorë (kesh) për shërbimet e pagesave postare dhe llogaritë e përqendrimit, sistemi i informacionit i përdorur nga një operator i caktuar për ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare do të gjenerojë automatikisht listat e përditshme dhe listat përmbledhëse të urdhër-pagesave postare të lësuara, rimbursuara apo ekzekutuara. Këto lista do të përditësohen automatikisht çdo ditë nga sistemi i informacionit i atij operatori të caktuar.

2. Shuma e urdhër-pagesave postare të lësuara ose rimbursuara duhet të shprehet në monedhën vendase dhe në monedhën e lëshimit. Shuma e urdhër-pagesave postare të paguara apo të kredituara në llogarinë e destinatarit do të shprehet në monedhën e pagesës. Shuma e shpërblimeve do të shprehet në SDR. Mund të vendosen mënyra të tjera të shprehjes së shpërblimit me anë të marrëveshjes dypalëshe.

3. Listat e urdhër-xhirimeve të lësuara dhe urdhër-xhirimeve të rimbursuara dërguesve në monedhën vendase do të hartohen nga operatori i caktuar lëshues përkatësisht në formularët MP 4 dhe 5 MP.

4. Lista e urdhër-xhirimeve të paguara marrësit të pagesës do të tërhiqen nga operatori i caktuar pages me formular MP 6

5. Lista ditore e transfertave të debituar ose rimbursuara në llogaritë e dërguesve do të hartohet nga operatori i caktuar lëshues në formularët VP 6 ose VP 7.

6. Lista ditore e transfertave të kredituara tek destinatarët do të hartohet nga operatori i caktuar pages në formularin VP 8.

Neni RP 2303

Përgatitja e listave përmbledhëse të urdhër-pagesave postare

1. Listat përmbledhëse MP 7 dhe VP 4, dhe VP 5, kur është e përshtatshme, do të gjenerohen nga sistemi i informacionit, ose do të përgatiten manualisht përkatësisht nga operatori i caktuar pages dhe lëshues.

2. Listat MP 7 do të përgatiten nga secila prej pikave të aksesit të shërbimit në rend kronologjik.

3. Listat VP 4 do të përgatiten nga zyra postare qendrore në rend kronologjik.

Neni RP 2304

Përgatitja e llogarive periodike për urdhër-pagesat postare

1. Llogaritë periodike për urdhër-pagesat postare do të përgatiten në formular të veçantë për shërbimin e ofruar PPM (urdhër-xhirimet), ose PPV (transfertat) ose do të përgatiten direkt në formularin PP1 në fund të periudhës së kontabilitetit dhe sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshjen e shërbimit nga për operatorin e caktuar pages. Ky formular do të gjenerohet automatikisht nga sistemi i informacionit i përdorur nga operatori i caktuar pages, me përjashtim të kryerjes së korrigjimeve në llogaritë e mëparshme ose do të përgatiten plotësisht manualisht nga operatori i caktuar në bazë të listave përmbledhëse MP 7 dhe VP 8.

2. Llogaritë periodike do të përmbledhin urdhër-pagesat postare të paguara, duke përfshirë ndonjë korrigjim në lidhje me llogaritë e mëparshme dhe sasinë e shumave të paguara si dëmshpërblim dhe interes për pagesat e vonuara, sipas:

2.1 rendit kronologjik të muajve të lëshimit;

2.2 rendit alfabetik ose numëror të pikës së aksesit të shërbimit lëshues dhe rendit numerik të secilës pikë;

2.3 rendit kronologjik të transfertave.

3. Llogaritë periodike të urdhrave elektronike dhe urdhrave me postën e letrave do të dërgohen nga operatori i caktuar pages për operatorin e caktuar lëshues me anë të mjeteve të shpejta jo më vonë se një javë pas përfundimit të periudhës kontabël për urdhrat e transmetuara në mënyrë elektronike, dhe jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës kontabël për urdhrat e transmetuara me postën e letrave. Urdhrat me postën e letrave do të shoqërohen me instrumente mbështetëse (urdhër-xhirime të faturuara ose kopje të dixhitalizuara të bëra në përputhje me legjislacionin kombëtar), të rregulluara në të njëjtën mënyrë si në listën MP 7. Për



monitorimin e cilësisë së shërbimit, çdo vonesë në dërgimin e këtyre llogarive, do ti njoftohet operatori të caktuar lëshues, së bashku me një shpjegim.

4. Operatori i caktuar lëshues do të rregullojë llogaritë e urdhrave brenda një muaji për urdhrat e transmetuara në mënyrë elektronike, dhe brenda dy muajve për urdhrat e transmetuara me anë të postës së letrave, përveç rasteve kur, brenda kuadrit të marrëveshjes së shërbimit, rregullimi është e bazuar në llogarinë e përgjithshme.

5. Nëse nuk ka instrumente të paguara dhe asnjë marrëveshje të tjera të shërbimit, operatorit të caktuar lëshues do t'i dërgohet një llogari periodike "Nil", me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar bien dakord ndryshe.

6. Mospërputhjet në lidhje me totalin e urdhër-pagesave postare të shënuara në llogaritë periodike nga operatori i caktuar lëshues do të regjistrohet në llogarinë e ardhshme periodike. Mospërputhjet do të injorohen nëse shuma nuk tejkalon 3 SDR.

Neni RP 2305

Përgatitja e llogarive periodike të shpërblimeve

1. Llogaritë periodike të shpërblimeve do të gjenerohen automatikisht nga sistemi i informacionit të përdorur nga operatori i caktuar pages ose do të përgatiten manualisht nga ai operator në formularin PP 2 në bazë të llogarisë periodike PP 1.

2. Në parim, shpërblimi do të shprehet në SDR dhe do të konvertohet në monedhën e pagesës së urdhër-pagesave postare në bazë të vlerës mesatare vjetore të SDR të publikuar nga Byroja Ndërkombëtare e UPU-t. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për një monedhë tjetër me anë të një marrëveshje shërbimi.

Neni RP 2306

Përgatitja e llogarive të përgjithshme

1. Me kusht që një llogari e përgjithshme të përgatitet në përputhje me legjislacionin kombëtar të operatorit të caktuar, llogaritë periodike do të përfshihen, në intervale të njëjta, në një llogari të përgjithshme nga operatori paguar caktuar.

2. Llogaria e përgjithshme i dërgohet operatorit të caktuar lëshues me anë të mjeteve më të shpejta jo më vonë se dy javë pas përfundimit të periudhës së cilës ajo i përket. Ajo duhet të rezultojë në një bilanc neto.

3. Operatorët e caktuar të secilit prej shteteve kontraktuese do të përgatisin llogaritë e përgjithshme.

4. Llogaria e përgjithshme do të realizohet nga operatori i caktuar lëshues brenda gjashtë javëve pas përfundimit të muajit të cilit ajo i përket.

Neni RP 2307

Llogaria e përgjithshme e urdhër-pagesave postare

1. Llogaria e përgjithshme e urdhër-pagesave postare do të përgatitet në formularin PP 3 nga operatori i caktuar pages.

2. Llogaria e përgjithshme e urdhër-pagesave postare do të përfshijë paradhëniet.

3. Ajo do të rezultojë në bilancin neto të urdhër-pagesave postare në favor të kreditorëve, në parim të shprehur në monedhën e shtetit kreditor.

Neni RP 2308

Përgatitja e llogarive të përgjithshme për shpërblimet

1. Llogaria e përgjithshme për shpërblimet do të përgatitet në formularin PP 4.

2. Ajo do të rezultojë në një bilanc neto të shpërblimeve në favor të kreditorëve, në parim të shprehur në monedhën e shtetit kreditor.

Neni RP 2309

Kësti

1. Pagesa e një paradhënie kësti automatik mund të kërkohej nga operatori i caktuar pages menjëherë pas rregullimit.
2. Operatori i caktuar lëshues duhet të bjerë dakord për të paguar një këst automatik:
 - 2.1 kur ç'ekuilibri i këmbimeve kalon kufirin prej 6,000 SDR për muaj;
 - 2.2 kur operatori i caktuar pages nuk është një operator lëshues;
 - 2.3 kur është vendosur një marrëdhënie e re shkëmbimi midis operatorëve dhe janë përmbushur kushtet për këstet.
3. Shuma e këstit do të vendoset në marrëveshjen e shërbimit dhe mund të shpërndahet në kohë.
 - 3.1 Në rast të një çekuilibri të shkëmbimeve dhe pas zbritjes së shumës limit prej 6000 SDR, shuma e këstit do të llogaritet mbi bazën e shumës mesatare për tre periudhat e fundit kontabël: Për urdhër-pagesat postare të transmetuara elektronikisht, listat ditore të urdhër-xhirimeve/transfertat e lëshuara, rimbursuara dhe paguara, përkatësisht formularët MP 4, MP 5, MP 6, VP 6, VP 7 dhe VP 8, mund të përdoren gjithashtu si një bazë për llogaritjen e shumës këstit.
 - 3.2 Në rast se operatori i caktuar nuk është një operator lëshues, kufiri mund të vendoset në marrëveshjen e shërbimit në një shifër më të ulët se 6,000 SDR.
4. Në rastin e një marrëdhënie të re shkëmbimi, do të vlerësohet shuma mesatare e llogarisë periodike për periudhën e parë, dhe pastaj do të llogaritet në bazë të mesatares për periudhat e mëparshme.
5. Nëse një këst nuk paguhet, operatori i caktuar pages do të ketë të drejtë të ngarkojë interes mbi pagesën e vonuar në një përqindje në përputhje me:
 - 5.1 legjislacionin e tij kombëtar;
 - 5.2 përqindjen e rënë dakord në marrëveshjen e shërbimit të operatorëve;
 - 5.3 praktikatat kombëtare tregtare.
6. Nëse një këst nuk paguhet dhe marrëveshja e shërbimit e lejon, operatori i caktuar pages gjithashtu mund të pezullojë shërbimin.
7. Kur pagesa totale e këstit tejkalon shumën e detyruar për operatorin e caktuar pages për periudhën në fjalë, diferenca do të përfshihet në një llogari të ardhshme.

Neni RP 2310

Procedurat në lidhje me llogaritë e fondeve dhe këstet

1. Listat ditore MP 4, MP 5 dhe MP 6, ose VP 6, VP 7 dhe VP 8, të gjeneruara nga sistemi informatik i operatorit të caktuar, do të centralizohet nga ai operator menjëherë pas mbylljes së shërbimit të pagesës me postë.
2. Fondet e përdoruesve do të derdhen tek llogaria e përqendruar e operatorit të caktuar lëshues jo më vonë se një ditë pas lëshimit të urdhër-pagesës postare në fjalë.
3. Në përputhje me parimin e kujdesit të zbatuar për menaxhimin e fondeve të palës së tretë, operatorët e caktuar do të krahasojmë çdo ditë listat ditore MP 4, MP 5 dhe MP 6, ose VP 6, VP 7 dhe VP 8 të gjeneruara nga sistemi informatik dhe mospërputhjet në aktivët e llogarive të përqendruara.

Neni RP 2311

Depozita e sigurisë

1. Në rast të mos ekzekutimit ose ekzekutimit të dobët të pagesave ndërmjet operatorëve të caktuar, operatori në gabim do t'i japë operatorit kreditor, me kërkesën e këtij të fundit, një depozitë sigurie.
2. Shuma e depozitës së sigurisë do të bihet dakord midis operatorëve në përputhje me bilancin neto të shumave të detyruara në momentin kur kërkohej depozita e sigurisë.

Neni RP 2401

Shlyerje e centralizuar



1. Në parim, operatorët e caktuar do të marrin pjesë në sistemin e centralizuar për shlyerjen e debive dhe kredive reciproke që rezultojnë nga ekzekutimi i urdhër-pagesave postare dhe shpërblimet e tyre reciproke.

2. Shlyerjet multilaterale ndërmjet operatorëve të caktuar do të kryhen nëpërmjet zyrës qendrore dhe një ose më shumë banka të shlyerjes, në përputhje me frekuencën e përbashkët të shlyerjes.

3. Zyra qendrore do të llogarisë bilancin përfundimtar për urdhër-pagesat postare për secilin operator të caktuar në bazë të formularëve PP 1 dhe PP 3 të parashikuara nga operatorët e caktuar pages.

4. Zyra qendrore do të llogarisë bilancin përfundimtar për shpërblimet për secilin operator të caktuar në bazë të formularëve PP 2 dhe PP 4 të parashikuara nga operatorët e caktuar pages.

5. Secili prej operatorëve të caktuar do të shlyejnë bilancin përfundimtar të urdhër-pagesave postare dhe shpërblimeve të përgatitura nga zyra e centralizuar qendrore në një ose më shumë banka të shlyerjes, në përputhje me rregullat e zyrës qendrore.

6. Data e shlyerjes do të vendoset në rregullat e zyrës qendrore në mënyrë që shlyerja e të gjithë operatorëve të caktuar kreditorë të mund të kryhet në të njëjtën kohë, pavarësisht nga banka e shlyerjes.

7. Rregullat e zyrës qendrore të centralizuar do të miratohen nga operatorët e caktuar për sa i përket:

7.1 menaxhimit të riskut në bazë të procedurave të zyrës qendrore për pranimin, pezullimin dhe heqjen e operatorëve të caktuar;

7.2 Rekomandimet e Këshillit të Operacioneve Postare dhe Këshillit Drejtues për luftën kundër pastrimit të parave;

7.3 një ndarje e qartë e përgjegjësisë ndërmjet zyrës qendrore të centralizuar dhe operatorit të caktuar;

7.4 konfidencialiteti i të dhënave;

7.5 mbrojtja e të dhënave;

7.6 transmetimi i sigurt i të dhënave (Internet);

7.7 thjeshtësia e sistemit;

7.8 aksesueshmëria financiare e operatorëve të caktuar në sistem;

7.9 zbatimi i procedurës për shlyerjen e llogarive të kundërshtuara.

Neni RP 2402 Shlyerje bilaterale

1. Operatori i caktuar mund të vendosë të shlyejë në mënyrë të dyanshme llogaritë.

2. Metodat e shlyerjes

2.1 Si pjesë e një marrëveshjeje dypalëshe dhe duke iu nënshtruar legjislacionit kombëtar të operatorit të caktuar pages, shlyerja do të kryhet në bazë të llogarive të përgjithshme PP 3 dhe PP 4; në të gjitha rastet tjera, ajo do të kryhet në bazë të shumave totale të llogarive periodike PP 1 dhe PP 2, ose nëpërmjet një llogarie ndërlidhëse.

2.2 Shpenzimet që rrjedhin nga ekzekutimin i shërbimit të pagesave postare të ndodhura në shtetin e operatorit të caktuar lëshues, në vendet e treta dhe nën llogarinë e ndërlidhjes (përveç tarifave të kontabilitetit) do të paguhet nga operatori lëshues.

2.3 Shpenzimet e ndodhura në shtetin e operatorit të caktuar pages, si edhe tarifat e kontabilitetit për llogarinë e ndërlidhjes, do të paguhet nga ky operator.

3. Shlyerja në bazë të llogarisë së përgjithshme ose të llogarive mujore ose periodike

3.1 Shlyerja do të kryhet nga operatori i caktuar debitor brenda një muaji pas përfundimit të muajit në fjalë, kur janë shlyer llogaritë periodike, dhe brenda gjashtë javësh, kur janë shlyer llogaritë e përgjithshme.

3.2 Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve të caktuar për shumën që duhet paguar, vetëm shlyerja e pjesës së kontestuar mund të shtyhet; operatori i caktuar lëshues duhet të njoftojë operatorin e caktuar pages për arsyet e mosmarrëveshjes brenda periudhës së parashikuar për shlyerjen.

3.3 Në rast të mospagimit brenda afatit të parashikuar për shlyerjen, shumat e detyruara do të ngarkohen me interesa. Norma e aplikuar do të bazohet në rregullat kombëtare, ose, nëse nuk ka rregulla të tilla, në praktikat tregtare në vendin e operatorit të caktuar apo marrëveshjet midis operatorëve të caktuar.

4. Llogaritë ndërlidhëse

4.1 Brenda kuadrit të marrëdhënieve dypalëshe, operatorët e caktuar mund të hapin reciprokisht

Ilogari ndërlidhëse në vend të llogarive të përqendruara të kështit. Nëse operatorët e caktuar nuk kanë një sistem xhiro postare, llogaria ndërlidhëse mund të hapet me një tjetër institucion financiar.

4.2 Çdo operator i caktuar do të mbajë kredi të mjaftueshme në llogarinë e ndërlidhjes të hapur në emër të tij me operatorin e caktuar pagues për të lejuar debitimin e shumave që i detyrohet këtij të fundit. Operatorët e caktuar do të informojnë njëri-tjetrin në mënyrë të dyanshme për procedurën për marrjen e informacionit mbi debitë dhe kreditë.

4.3 Operatori i caktuar kreditor do të ketë të drejtë në çdo kohë të kërkojë pagesën e shumës të detyruara; ai mund të vendosë datën në të cilën duhet të kryhet pagesa, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për transferimin.

4.4 Nëse në llogarinë ndërlidhëse gjendet një bilanc i pambuluar, operatori i caktuar kreditor do të ketë të drejtë të ngarkojë me interes overdraft në përputhje me praktikën e biznesit të operatorit të caktuar ose të institutit financiar që mban llogarinë. Llogaritja dhe politikat e ngarkimit me interesa do të bihen dakord nga të dyja palët.

4.5 Shumat e transferuara për krijimin e bilancit të kredisë dhe urdhër-pagesat postare të cilat nuk ka qenë e mundur të ekzekutohen do të kreditohen në llogarinë ndërlidhëse.

PJESA E III DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni RP 2501 Zbatimi i Rregullores së Konventës

1. Në të gjitha rastet e parregulluara shprehimisht në këtë Rregullore për shërbimin e pagesave postare do të zbatohen dispozitat e Rregullores së Konventës.

Neni RP 2502 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores

1. Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi në datën në të cilën hyn në veprim Marrëveshja e Shërbimeve të Pagesës Postare.

2. Ajo do të ketë të njëjtën kohëzgjatje me Marrëveshjen, me përjashtim të rastit kur vendoset ndryshe nga Këshilli i Operacioneve Postare.

Realizuar në Bernë, më 11 nëntor 2008.

Për Këshillin e Operacioneve Postare:

Dr. Andreas TAPRANTZIS
Kryetar

Edouard DAYAN
Sekretar i Përgjithshëm

PROTOKOLL PËRFUNDIMTAR I RREGULLORES SË MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË PAGESAVE POSTARE

Në momentin e procedimit me miratimin e Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimit të Pagesës Postare, të përfunduar në këtë ditë, Këshilli i Operacioneve Postare ka rënë dakord për sa në vijim:

Neni RP I (rezervë ekzistuese) Kështet

1. Në mënyrë që të sigurohet pagesa normale për destinatarin në vendin e tij, Vietnam, u kërkon të gjitha vendeve që shkëmbejnë urdhër-xhirime me të, që të paguajnë automatikisht me një kësht, pa qenë e nevojshme të presin përdorimin e procedurave të përcaktuara në nenin RP 2309.2.



Neni RP II (rezervë ekzistuese)
Dërgimi i urdhër-pagesave postare

Tailanda do të jetë e autorizuar të mos zbatojë dispozitat e nenit RP 1517.2 duke respektuar detyrimet e operatorit postar dërgues.

Ky protokoll do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri sikur dispozitat e tij të ishin përfshirë në tekstin aktual të Rregullores të cilës i referohet.

Realizuar në Bernë, më 11 nëntor 2008.

Për Këshillin e Operacioneve Postare:

Dr. Andreas TAPRANTZIS
Kryetar

Edouard DAYAN
Sekretar i Përgjithshëm

BASHKIMI POSTAR UNIVERSAL
RREGULLORJA E KOLIPOSTËS

Protokoll përfundimtar

Bernë 2008

Rregullore e Kolipostës

Pasqyra e lëndës

KAPITULLI 1
Dispozita të Përgjithshme

Neni

RC 101	Përdorimi i termit "koli"
RC 102	Zbatimi i lirisë së transitit
RC 103	Dështimi për të ofruar lirinë e transitit
RC 104	Njësia monetare
RC 105	Siguria postare
RC 106	Kryerja e shërbimit nga shoqëritë e transportit

KAPITULLI 2

Kushtet për pranimin dhe postimin. Tarifat. Përgjashtimi nga tarifat.
Procedura e dërgimit

RC 107	Përgjashtimi nga tarifat postare mbi shërbimin postar të kolive
RC 108	Zbatimi i përgjashtimit nga tarifat postare për institucionet që kanë të bëjnë me pengjet e luftë dhe të internuarit civilë
RC 109	Parapagimi
RC 110	Llogaritja e shpenzimeve për transport ajror
RC 111	Tarifa të posaçme
RC 112	Shënimi i kolive të dërguara pa tarifë postare
RC 113	Sistemi i peshës. Sistemi anglez i peshës Pound
RC 114	Kushte të posaçme në lidhje me limitet e peshës
RC 115	Limite të përmasave

RC 116	Procedura e shpërndarjes
RC 117	Kushtet për pranimin e kolive. Përgatitja dhe paketimi. Adresimi.
RC 118	Paketimi i posaçëm
RC 119	Kushtet e pranimin dhe shënimi i artikujve që përmbajnë materiale radioaktive
RC 119bis	Kushtet e pranimin dhe shënimi i artikujve që përmbajnë substanca të infektuara
RC 120	Tregimi i metodës së dërgimit
RC 121	Formalitetet për tu plotësuar nga dërguesi
RC 122	Udhëzime të dërguesit në momentin e postimit
RC 123	Formalitetet për tu plotësuar nga zyra e origjinës

KAPITULLI 3

Shërbime të posaçme

RC 124	Koli të siguruara
RC 125	Koli me pagesë nga marrësi
RC 126	Koli ekspres
RC 127	Koli me lajmërim-marrje
RC 128	Koli për tu dërguar pa pagesë dhe tarifë
RC 129	Koli delikate. Koli të rënda
RC 130	Shërbimi i dërgesave
RC 131	Shërbim i integruar logjistik

KAPITULLI 4

Ndalimi i futjes së substancave të rrezikshme në kolitë postare.

Përfshirja nga ndalimi. Koli të pranuar gabim. Ri-adresimi.

Kthimi tek dërguesi. Tërheqja nga posta. Kërkesat

RC 132	Ndalimi i futjes së substancave të rrezikshme në kolitë postare
RC 133	Përfshirja nga ndalimi
RC 134	Trajtimi i kolive të pranuar gabim
RC 135	Kushtet e ri-adresimit të kolisë
RC 136	Periudha e mbajtjes
RC 137	Koli të mbajtura automatikisht
RC 138	Kthimi i kolive të padërguara tek dërguesi
RC 139	Kthimi i kolive të pranuar gabim tek dërguesi
RC 140	Kthimi tek dërguesi për shkak të ndërprerjes së shërbimit
RC 141	Mos përmbushja e udhëzimeve të dhëna nga operatori i caktuar
RC 142	Koli që përmbajnë artikuj për të cilat dyshohet se prishen ose kalben shpejt
RC 143	Trajtimi i kërkesave për tërheqjen e kolive nga posta ose për ndryshimin apo korrigjimin e adresës
RC 144	Reklamime

KAPITULLI 5

Çështje doganore

RC 145	Deklaratat doganore dhe zhdoganimi i kolive
RC 146	Tarifa e paraqitjes në Doganë
RC 147	Fshirja e detyrimit doganor dhe tarifa të tjera

KAPITULLI 6

Përgjegjësia e shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar

RC 148	Zbatimi i përgjegjësisë së shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar
RC 149	Dërgimi i kolive të vjedhura ose dëmtuara



RC 150	Caktimi i përgjegjësisë së dërguesit
RC 151	Pagesa e dëmshpërblimit
RC 152	Periudha për pagesën e dëmshpërblimit
RC 153	Pagesa automatike e dëmshpërblimit
RC 154	Përcaktimi i përgjegjësisë ndërmjet operatorëve të caktuar
RC 155	Procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë të operatorëve të caktuar
RC 156	Kompensimi i dëmshpërblimeve të paguara nga transportuesit ajrorë
RC 157	Rimbursimi i dëmshpërblimeve për operatorët e caktuar pages
RC 158	Shlyerja e dëmshpërblimeve ndërmjet operatorëve të caktuar
RC 159	Kontabilizimi i shumave të detyruara në lidhje me dëmshpërblimin e kolive

Procedurat në lidhje me transmetimin, itinerarin dhe marrjen e kolive

RC 160	Parime të përgjithshme të shkëmbimit të kolive
RC 161	Zbatimi i barkodit dhe specifikimet
RC 161bis	Gjurmimi dhe gjetja – Specifikime të artikujve dhe njoftimit
RC 161ter	Gjurmimi dhe gjetja – Objektivat treguese për kohët e transmetimit
RC 161quater	Gjurmimi dhe gjetja – Objektivat treguese të performancës për transmetimin e të dhënave
RC 162	Hapa që do të ndërmerren në rast të pezullimit të përkohshëm dhe rifillimi i shërbimeve
RC 163	Metoda të ndryshme të transmetimit
RC 164	Transmetimi me postë të mbyllur
RC 165	Përdorimi i barkodeve
RC 166	Faturat e kolive
RC 167	Hartimi i faturave të kolive CP 87
RC 168	Dërgimi i dokumenteve që shoqërojnë kolutë
RC 169	Itinerari i dërgesave
RC 170	Transporti i kolive me rrugë ajrore dhe kolive të transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)
RC 171	Hapat që do të ndërmerren kur transferimi i drejtpërdrejtë i kolive me rrugë ajrore nuk mund të realizohet sipas planit
RC 172	Përgatitja dhe kontrolli i faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41
RC 173	Mungesa e faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41
RC 174	Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një aksidenti
RC 175	Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një fluturimi të ndërprerë, ose devijimi ose dërgimi të gabuar të kolive me rrugë ajrore
RC 176	Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një fluturimi të ndërprerë, ose devijimi ose dërgimi të gabuar të kolive të transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)
RC 177	Përgatitja e njoftimeve të provës
RC 178	Transferimi i postës
RC 179	Verifikimi i dërgesave
RC 180	Zbulimi i parregullsive dhe përpunimi i njoftimeve të verifikimit
RC 181	Mospërputhje të peshës ose përmasave të kolisë
RC 182	Marrja e një kolie të dëmtuar ose të pa paketuar mirë nga zyra e shkëmbimit
RC 183	Njoftimi i parregullsive për të cilat operatorët e caktuar mund të jenë përgjegjës
RC 184	Kontrolli i postës së kolive të dërguara në sasi të mëdha
RC 185	Ri-dërgimi i kolisë së mbërritur në vendin e gabuar
RC 186	Kthimi i kutive bosh

KAPITULLI 8

Objektivat e cilësisë së shërbimit

RC 187 Objektivat e cilësisë së shërbimit

KAPITULLI 9

Çmimet dhe detyrimet e transportimit ajror

- RC 188 Çmimet e rrugës së dërgimit për shërbimin e dhënë
- RC 189 Ndryshimi i çmimeve të rrugës së dërgimit
- RC 190 Çmimet e transitit në tokë
- RC 191 Zbatimi i çmimeve të transitit në tokë
- RC 192 Çmimi për transportin detar
- RC 193 Zbatimi i çmimit për transportin detar
- RC 194 Zbatimi i çmimeve të reja në vijim të ndryshimeve të paparashikuara në itinerar
- RC 195 Pësja e dërgesave e përdorur për shpërblimin e operatorëve të caktuar
- RC 196 Caktimi i çmimeve
- RC 197 Çmimet dhe detyrimet e kredituara operatorëve të tjerë të caktuar nga operatori i caktuar i vendit të origjinës së dërgesës
- RC 198 Caktimi dhe rimbursimi i çmimeve, pagesave dhe tarifave, në rast të kthimit tek dërguesi ose ri-adresimit
- RC 199 Llogaritja e detyrimeve të transportit ajror
- RC 200 Detyrime të transportit ajror për koli të humbura ose shkatërruara
- RC 201 Detyrime të transportit ajror për dërgesat ose thasët e devijuar ose të dërguar gabim
- RC 202 Pagesa e detyrimeve të transportit ajror për transportit e thasëve bosh

KAPITULLI 10

Përgatitja dhe shlyerja e llogarive

- RC 203 Përgatitja e llogarive
- RC 204 Shlyerja e llogarive
- RC 205 Shlyerja e llogarive nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare
- RC 206 Rregullimi i debive të papaguara që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare
- RC 207 Pagesa e debive të shprehura në SDR. Dispozita të përgjithshme
- RC 208 Rregullat e pagesës së llogarive të pashlyera nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare

KAPITULLI 11

Dispozita të ndryshme

- RC 209 Informacioni që do të jepet nga operatorët e caktuar
- RC 210 Publikimet e Byrosë Ndërkombëtare
- RC 211 Adresat telegrafike
- RC 212 Periudha e mbajtjes së dokumenteve
- RC 213 Formularët
- RC 214 Zbatimi i standardeve

KAPITULLI 12

Dispozita të përkohshme dhe përfundimtare

- RC 215 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores

Protokolli përfundimtar për Rregulloren e Kolipostës

Neni

- RC I Dispozita të shërbimit të kolipostës
- RC II Kushte specifike në lidhje me limitet e peshës së kolive



RC III	Procedura e dërgimit
RC IV	Limitet maksimale për artikujt e siguruar
RC V	Trajtimi i kolive të pranuar gabimisht
RC VI	Koli të mbajtura automatikisht
RC VII	Trajtimi i reklamimeve
RC VIII	(i fshirë)
RC IX	(i fshirë)
RC X	Zbatimi i përgjegjësisë të operatorëve të caktuar
RC XI	Transmetimi në postë të mbyllur
RC XII	Itinerari i postës
RC XIII	Përcaktimi i çmimeve mesatare
RC XIV	Çmime të transitit të jashtëzakonshëm në tokë
RC XV	Çmimet e transportit detar
RC XVI	Tarifa shtesë
RC XVII	Përgatitja e llogarive
RC XVIII	(i fshirë)
RC XIX	Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi para 1 janarit 2001
RC XX	Formularë
LISTA E FORMULARËVE	

Nr	Titulli ose lloji i formularit	Referenca
CP 71	Njoftimi i dërgimit	RC 121.1
CP 72	Set i shumëfishtë. Deklarata doganore/Njoftimi i dërgimit	RC 121.1
CP 73	Etiketa e kolisë me numrin e kolisë dhe emrin e zyrës së origjinës	RC 123.1
CP 74	Etiketa "V" për kolitë e siguruar	RC 124.6.1
CP 75	Llogari e përmbledhur. Deklaratat CP 93 dhe CP 94	RC 128.8.3
CP 77	Deklarata e detyrimeve	RC 138.10
CP 78	Njoftimi i verifikimit	RC 137.1
CP 81	Tabelë. Sipërfaqja e kolive	RC 160.5
CP 82	Tabelë. Koli me rrugë ajrore	RC 160.5
CP 83	Etiketa për postën e kolive me rrugë tokësore	RC 164.3.1
CP 84	Etiketa për postën e kolive me rrugë ajrore	RC 164.3.1
CP 85	Etiketa për postën e kolive S.A.L.	RC 164.3.1
CP 87	Fatura e kolive me rrugë ajrore. Kolitë me rrugë tokësore, S.A.L. dhe ajrore	RC 166.1
CP 88	Fatura për kolitë speciale. Pagesa e çmimeve për transitin e kolive	RC 166.11
CP 91	Zarfi për transmetimin e dokumentet e njoftimit të dërgimit, doganën, etj.,	RC 168.3
CP 92	Zarfi për transmetimin e dokumentet e njoftimit të dërgimit, doganën, etj.,	RC 168.3
CP 94	Deklarata e shumave të detyruara. Kolitë me rrugë tokësore, S.A.L. ajrore	RC 203.1.2
CP 95	Etiketa COD	RC 125.3.2.1

FORMULARË TË PËRDORUR PËR POSTËN E LETRAVE DHE POSTËN E KOLIVE

Nr	Titulli ose lloji i formularit	Referenca
CN 07	Njoftimi i marrjes /dërgimit /pagesës /hyrjes	RC 127.2.2
CN 08	Kërkesa	RC 127.4.2
	143.4.1	

CN 11	Njoftimi i postimit pa pagesë	RC 128.5.2
CN 12	Llogaria mujore e detajuar. Dogana, etj., detyrimet	RC 128.8.1
CN 13	Raporti. Informacioni për artikullin postar të konfiskuar	RC 134.6
CN 15	Etiketa "Kthim"	RC 138.5
CN 17	Kërkesa për tërheqjen nga posta /ndryshim ose korrigjim të adresës / fshirje ose ndryshim të shumës COD	RC 143.3.1
CN 21	Njoftimi. Ri-adresimi i formularit CN 08	RC 144.5.6
CN 23	Deklarata doganore	RC 121.2
CN 24	Raporti (parregullsitë në lidhje me artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të siguruara	RC 137.4
CN 29	Etiketa "COD"	RC 125.3.2.1
CN 29bis	Etiketa për artikujt "COD"	RC 125.3.2.1
CN 37	Fatura e dërgesës. Posta tokësore	RC 169.3
CN 38	Fatura e dërgesës. Posta ajrore	RC 169.3
CN 41	Fatura e dërgesës. Posta e transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)	RC 169.3
CN 42	Etiketa e transferimit të drejtpërdrejtë	RC 170.6
CN 44	Njoftimi i provës	RC 177.1
CN 46	Fatura zëvendësuese e dërgimit	RC 173.3
CN 47	Fatura e dërgimit. Posta e kutive bosh	RC 186.2
CN 48	Deklarata. Shumat e detyruara për dëshmipërblimet	RC 159.1
CN 51	Llogaria e detajuar. Posta ajrore	RC 128.8.5
CN 52	Llogaria e përgjithshme	RC 203.8

RREGULLORJA E KOLIPOSTËS

Duke pasur në konsideratë nenin 22.5 e Kushtetutës së Bashkimit Postar të Përbotshëm të përfunduar në Vjenë, më 10 korrik 1964, Këshilli i Operacioneve Postare ka hartuar masat e mëposhtme për sigurimin e zbatimit të shërbimit të KoliPostës.

KAPITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni RC 101 Përdorimi i termit "koli"

1. Në këtë Rregullore dhe në Protokollin Përfundimtar të saj, termi "koli" do të përdoret për të gjitha kolitë.
2. Kolitë e dërguara me rrugë ajrore me prioritet do të quhen "koli ajrore".

Neni RC 102 Zbatimi i lirisë së transitit

1. Vendet anëtare të cilat nuk ofrojnë shërbimin e kolive të siguruara ose që nuk pranojnë përgjegjësi për kolitë e siguruara të transportuara nga shërbimet e tyre detare ose ajrore do të jenë gjithsesi të detyruara të dërgojnë, me rrugën e shpejtë dhe mjetet më të sigurta, postën e mbyllur që i është kaluar nga vendet e tjera anëtare.

Neni RC 103 Dështimi për të ofruar lirinë e transitit

1. Ndërprerja e shërbimit postar me një vend anëtar që nuk respekton lirinë e transitit duhet t'i njoftohet paraprakisht vendeve anëtare dhe operatorëve të caktuar përkatës me anë të e-mailit ose ndonjë



formë tjetër telekomunikimi. Byroja Ndërkombëtare do të jetë e informuar për faktin.

Neni RC 104
Njësia monetare

1. Njësia monetare e përcaktuar në nenin 7 të Kushtetutës dhe të përdorura në Konventë dhe në Aktet tjera të Bashkimit do të jetë E Drejta Speciale e Tërheqjes (SDR).

2. Operatorët e caktuar të vendeve anëtare mund të zgjedhin, me marrëveshje të përbashkët, një njësi monetare të ndryshme nga SDR ose një nga monedhat e tyre kombëtare për përgatitjen dhe shlyerjen e llogarive.

Neni RC 105
Siguria postare

1. Strategjia e sigurisë postare e zbatuar nga vendet anëtare dhe operatorët e caktuar do të synojë:
 - 1.1 rritjen e cilësisë së shërbimit si të tërë;
 - 1.2 rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve për rëndësinë e sigurisë;
 - 1.3 krijimin ose përforcimin e njësive të sigurisë;
 - 1.4 ndarjen e informacionit operacional, të sigurisë dhe hetimit herë pas here; dhe
 - 1.5 propozimin për legjislaturën, kurdoherë qoftë e nevojshme, të ligjeve specifike, rregulloreve dhe masave për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve postare në të gjithë botën.

Neni RC 106
Kryerja e shërbimit nga shoqëritë e transportit

1. Operatori i caktuar shërbimi i të cilit kryhet nga shoqëritë e transportit do të bëjë marrëveshje me ta për të siguruar zbatimin e plotë të të gjitha dispozitave të Konventës dhe Rregullores së Kolipostës prej tyre, me referencë të veçantë për marrëveshjet për shkëmbimin e kolive. Operatori i caktuar do të jetë përgjegjës për të gjitha marrëdhëniet e tyre me operatorët e caktuar të vendeve të tjera kontraktuese dhe me Byronë Ndërkombëtare.

KAPITULLI 2
KUSHTET PËR PRANIMIN DHE POSTIMIN. TARIFAT. PËRJASHTIMI NGA TARIFAT.
PROCEDURA E DËRGIMIT

Neni RC 107
Përfashtimi nga tarifat postare mbi shërbimin postar të kolive

1. Kollitë e lidhura me shërbimin postar do të përfashtohen nga pagesat postare nëse shkëmbehen midis sa më poshtë:
 - 1.1 operatorët e caktuar;
 - 1.2 shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar dhe Byroja Ndërkombëtare;
 - 1.3 zyrat postare të operatorëve të caktuar të shteteve anëtare;
 - 1.4 zyrat postare dhe operatorët e caktuar.
2. Kollitë ajrore, me përfashtimin e atyre që vijnë nga Byroja Ndërkombëtare do të përfashtohen nga tarifa shtesë për transport ajror.

Neni RC 108
Zbatimi i përfashtimit nga tarifat postare për institucionet që kanë të bëjnë me pengjet e luftë dhe të internuarit civilë

1. Subjektet e mëposhtme do të përfitojnë përfashtimin nga tarifat postare brenda kuptimit të nenit 7.2 të Konventës:

1.1 Byroja e Informacionit siç parashikuar në nenin 122 të Konventës së Gjenevës datë 12 Gusht 1949 në lidhje me trajtimin e pengjeve të luftës;

- 1.2 Agjencia Qendrore e Informacionit të Pengjeve të Luftës sipas nenit 123 të së njëjtës Konventë;
- 1.3 Byroja e Informacionit sipas nenit 136 të Konventës së Gjenevës datë 12 Gusht 1949 në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte;
- 1.4 Agjencia Qendrore e Informacionit sipas nenit 140 të së njëjtës Konventë.

Neni RC 109
Parapagimi

1. Kollitë do të parapaguhën me anë të pullave postare ose me ndonjë metodë tjetër të autorizuar nga rregulloret e miratuara nga vendi i origjinës ose nga operatorët e saj të caktuar.

Neni RC 110
Llogaritja e shpenzimeve për transport ajror

1. Shtetet Anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të përcaktojnë shpenzimet e transportit ajror që do të mbledhen për kollitë për transport ajror.
2. Shpenzimet do të jetë të lidhura me detyrimet e transportit ajror dhe do të jetë uniforme për të paktën në të gjithë territorin e secilit vend të destinacionit, pavarësisht nga rruga e përdorur.
3. Shtetet anëtare apo operatorët e tyre të caktuar do të jetë të autorizuar të zbatojnë, për llogaritjen shpenzimeve për transport ajror, masa peshe më të vogla se sa një kilogram.

Neni RC 111
Tarifa të posaçme

1. Operatorët e caktuar do të jenë të autorizuar të mbledhin të njëjtat tarifa si për shërbim të brendshëm në rastet e përmendura më poshtë:
 - 1.1 Tarifat për artikujt e postuar jashtë orarit normal të punës, mbledhen nga dërguesi.
 - 1.2 Tarifat për gjetjen e adresës së dërguesit mbledhen nga dërguesi.
 - 1.3 Tarifat e postës restante të mbledhura nga marrësit; në rastin e kthimit tek dërguesi ose ri-adresimit të një kolie të shënuar si "postë restante", shuma maksimale e udhëzuesit do të jetë 0.49 SDR në përputhje me nenin 13.6 të Konventës.
 - 1.4 Tarifat e magazinimit për çdo koli, e cila nuk është marrë nga marrësi brenda afatit të caktuar. Kjo tarifë do të mbledhet nga operatori i caktuar që kryen dorëzimin, në emër të operatorit të caktuar në shërbimin e të cilit është mbajtur kolia përtej afatit të caktuar. Në rast të kthimit tek dërguesi ose ri-adresimit i kolisë për të cilën është mbledhur një tarifë magazinimi, shuma maksimale e udhëzuesit do të jetë 6.53 SDR në përputhje me nenin 13.6 të Konventës.
 - 1.5 Operatorët e caktuar të përgatitur për të mbuluar rrezikun e forcës madhore do të jenë të autorizuar që të mbledhin një pagesë mbuluar kundër rrezikut të forcave madhore. Në lidhje me kollitë e pasiguruar, pagesa maksimale e udhëzuesit do të jetë 0.20 SDR për koli, në përputhje me nenin 13.6.9 të Konventës. Në lidhje me kollitë e siguruara, shuma maksimale e udhëzuesit është caktuar në nenin RC 124.
 - 1.6 Kur një koli është dorëzuar normalisht në adresën e marrësit, nuk do të mbledhet asnjë pagesë për dërgimin nga marrësi. Kur dërgesa në adresën e marrësit nuk është kryer normalisht, lajmërim marrja duhet të dorëzohet pa pagesë. Në këtë rast, nëse dorëzimi tek adresa e marrësit është ofruar si një alternativë në përgjigje të lajmërim marrjes, mund të mbledhet një tarifë dorëzimi nga marrësi. Tarifa duhet të jetë e njëjtë si për shërbimin e brendshëm.

Neni RC 112
Shënimi i kolive të dërguara pa tarifë postare

1. Çdo shërbim për koli dhe njoftimi i dërgimit të saj do të kenë, pranë adresës, treguesin "Service des postes" (Shërbimi Postar) ose një tregues të ngjashëm; ky tregues mund të pasohet nga një përkthim në një gjuhë tjetër.
2. Çdo koli e pengjeve të luftës dhe të internuarit civil dhe njoftimi për dërgimin e saj do të mbajnë, pranë adresës, treguesin "Service des prisonniers de guerre" (Shërbimi i pengjeve të luftës) ose "Service des



internés civils" (Shërbimi e të internuarve civilë); ky tregues mund të pasohet nga një përkthim në një gjuhë tjetër.

Neni RC 113

Sistemi i peshës. Sistemi anglez i peshës Pound

1. Pesha e kolive duhet të shprehet në kilogramë.
2. Operatorët e caktuar të shteteve të cilat për shkak të rregulloreve të tyre të brendshme nuk janë në gjendje të përdorin një sistem metrik – decimal të peshës mund të zëvendësojnë peshën e shprehur në kilogramë me ekuivalentin në pound të sistemit anglez.

Neni RC 114

Kushte të posaçme në lidhje me limitet e peshës

1. Shkëmbimi i kolive, pesha e secilës prej të cilave e tejkalon 20 kilogram do të jetë fakultativ, me një maksimum të peshës së secilës prej 50 kilogramësh.
2. Operatorët e caktuar të shteteve të cilët vendosin një limit më të ulët se 50 kilogramë, megjithatë, duhet të kenë të drejtën e pranimi të kolive në transit, në çanta ose kuti të tjera të mbyllura me peshë ndërmjet 20 dhe 50 kilogramë.
3. Kollitë në lidhje me shërbimin postar sipas përcaktimeve të nenit RC 107.1 dhe 2 mund të peshojnë deri në 20 kilogramë. Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve operatorëve të caktuar të cilët kanë vendosur një limit më të lartë, kollitë e shërbimit postar mund të peshojnë më shumë se 20 kilogramë dhe deri në 50 kilogramë.

Neni RC 115

Limite të përmasave

1. Kollitë nuk duhet të kalojnë dy metra në secilën prej përmasave apo tre metra për shumën e gjatësisë dhe perimetrit më të madh të matur në një drejtim të ndryshëm nga gjatësia.
2. Operatorët e caktuar të cilët nuk mund të pranojnë, për çdo koli ose vetëm për kollitë ajrore, përmasat e përshkruara në pikën 1, mund të përdorë në vend të tyre një nga përmasat e mëposhtme:
 - 2.1 1.50 metra për secilën prej përmasave ose tre metra për shumën e gjatësisë dhe perimetrit më të madh të matur në një drejtim të ndryshëm nga gjatësia.
 - 2.2 1.05 metra për secilën prej përmasave ose dy metra për shumën e gjatësisë dhe perimetrit më të madh të matur në një drejtim të ndryshëm nga gjatësia.
3. Kollitë nuk mund të jenë më të vogla se përmasa minimale e përshkruar për letrat.

Neni RC 116

Procedura e shpërndarjes

1. Si rregull i përgjithshëm, kollitë do të dorëzohen tek marrësi sa më shpejt të jetë e mundur dhe në përputhje me dispozitat në fuqi në vendin e destinacionit. Kur kollitë nuk janë dorëzuar në adresën e marrësit ai, përveç kur kjo është e pamundur, do të njoftohet prej ardhjen e tyre pa vonesë.
2. Kur shpërndan ose dorëzon një koli të zakonshme, operatori i caktuar duhet të marrë nga pranuesi një nënshkrim të pranimi, ose të regjistrojë të dhënat e marra nga një kartë identiteti, ose të marrë prova të pranimi në ndonjë formë tjetër që është ligjërish e detyrueshme sipas legjislacionit të vendit të destinacionit për të konfirmuar pranimin.

Neni RC 117

Kushtet për pranimin e kolive. Përgatitja dhe paketimi. Adresimi.

1. Kushte të përgjithshme të paketimit
 - 1.1 Çdo koli do të jetë e paketuar dhe mbyllur në një mënyrë të përshtatshme për peshën, formën dhe natyrën e përmbajtjes, si dhe mënyrën dhe kohëzgjatjen e transportit. Paketimi dhe mbyllja do të mbrojnë përmbajtjen ndaj shkatërrimit apo dëmeve nga prekjet të përsëritura dhe gjithashtu do të jetë e tillë që të mos

jetë e mundur të ngacmohet përmbajtja pa lënë gjurmë të qarta të kësaj.

1.2 Çdo koli duhet të jetë veçanërisht e sigurt nëse ajo duhet:

1.2.1 të udhëtojë për distance të largëta;

1.2.2 të transferohet dhe preket shume herë;

1.2.3 të mbrohet ndaj ndryshimeve të mëdha klimaterike, të temperaturës ose në rastin e udhëtimit me avion, nga ndryshimet e presionit atmosferik.

1.3 Ajo do të jetë e paketuar dhe mbyllur në mënyrë të tillë që të mos rrezikojë shëndetin e nëpunësve dhe në mënyrë që të mos paraqesë ndonjë rrezik në qoftë se ajo përmban artikuj të një lloji të tillë që mund të dëmtojë nëpunësit në detyrë për trajtimin e saj apo të njollosë ose dëmtojë kolitë e tjera ose pajisjet postare.

1.4 Ajo do të ketë, në paketim ose mbështjellëse, hapësirë të mjaftueshme për udhëzime të shërbimit dhe për vendosjen e pullave dhe etiketave.

1.5 Sa në vijim do të pranohet pa paketim, dhe me adresën e marrësit të shënuar mbi vetë artikullin:

1.5.1 artikuj të cilët mund të përputhen bashkë ose të vendosen dhe mbahen së bashku me një litar i fortë me plumb apo vula tjera, në mënyrë që të formojnë një koli të vetme e cila nuk mund të ndahet;

1.5.2 koli në një copë, si copa prej druri, metali, etj, çka nuk është zakoni i konfeksionimit të tregtisë.

2. Adresat e dërguesit dhe marrësit

2.1 Për t'u pranuar në Postë, çdo koli duhet të ketë, adresën e plotë të marrësit dhe dërguesit, të shkruar me shkronja romake dhe në shifra arabike në vetë kolinë ose në një etiketë të ngjitur fort me të. Në qoftë se në vendin e destinacionit përdoren shkronja dhe numra të tjerë, do të rekomandohet që adresa të jepet edhe në këto shkronja dhe numra. Nuk do të lejohen adresat e shkruara me laps, megjithatë, do të pranohen kolitë adresat e të cilave janë shkruar me laps që nuk fshihet në një sipërfaqe të lagur me parë.

2.2 Vetëm një person ose një organ i shoqërisë mund të përcaktohet si marrës. Megjithatë, mund të pranohet adresa të tilla si "z. A në ... për z. Z në ..." ose "Banka A në ... për z. Z në ...", duke u kuptuar se vetëm personi i treguar nën A do të konsiderohet si marrës nga operatorët e caktuar. Përveç kësaj, adresa e A dhe Z do të jetë në të njëjtin shtet.

2.3 Zyra e postimit do të këshillojë gjithashtu dërguesin për të vendosur në koli një kopje të adresës së tij dhe të marrësit.

3. Certifikimi i postimit

3.1 Dërguesit do ti jepet pa pagesë në momentin e postimit një certifikatë postimi.

Neni RC 118 Paketimi i posaçëm

1. Artikujt prej qelqi apo objekte të tjera të brishta do të jenë të paketuara në një kuti të fortë të mbushur me një material të përshtatshëm mbrojtës. Duhet të parandalohet çdo fërkim ose goditje gjatë transportit edhe midis vetë objekteve apo midis objekteve dhe anëve të kutisë.

2. Lëngjet dhe substancat të cilat lëngëzohen lehtësisht duhet të mbyllën në enë me mbyllje perfekte. Çdo enë do të vendoset në një kuti të veçantë të fortë që përmban një material të përshtatshëm mbrojtës për të absorbuar lëngjet në rast të thyerjes së enës. Kapaku i kutisë së do të vendoset në mënyrë që të mos jetë i lirshëm.

3. Substancat yndyrore të cilat nuk lëngëzohen lehtësisht, të tilla si kremrat, sapunët, rrëshirat, etj, transporti i të cilave paraqet pak vështirësi, duhet të mbyllën në një paketim të parë (kuti, çantë prej cope, plastike, etj), e cila në vetvete është vendosur në një kuti mjaftueshëm të fortë për të parandaluar rrjedhjen e përmbajtjes.

4. Pluhurat e thata për ngjyrosje, si anilina blu, etj., do të pranohen vetëm në kuti metali me mbyllje perfekte kundër rrjedhjes, të vendosura në radhë në kuti të forta me një material të përshtatshëm absorbent dhe mbrojtës midis dy kutive.

5. Pluhurat e thata jo për ngjyrosje do të vendosen në enë të forta (kuti, çantë). Këto enë do të mbyllën në kuti të forta.

6. Bletë, shushunja dhe parazitë të gjallë do të mbyllën në kuti të ndërtuara në mënyrë të tillë që të evitojnë të gjitha rreziqet.

7. (i fshirë.)

8. Paketimi nuk do të kërkohet për artikujt me një copë, si copat e drurit, metali etj., çka nuk është zakoni i konfeksionimit të tregtisë. Në këtë rast, adresa e marrësit duhet të shkruhet mbi vetë artikullin.



9. Për më tepër, duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme:

9.1 Metalet e çmuara duhet të jenë të paketuara në një kuti metali të fortë apo një kuti prej druri. Ky i fundit do të ketë një trashësi minimale prej 1 cm për koli deri në 10 kilogram dhe 1.5 cm për kolitë më shumë se 10 kilogramë. Paketimi mund të përbëhet gjithashtu nga dy çanta pa qepje që të formojnë një ambalazh të dyfishtë. Kur janë përdorur kuti prej kompensate, trashësia e tyre mund të jetë i kufizuar në 5 mm me kusht që skajet e kutive të jenë të përforcuara me shirita metalike.

9.2 Ambalazhi i kolisë që përmban kafshë të gjalla, si dhe njoftimi i dërgimit do të shoqërohen me një etiketë ku të jenë shkruar me shkronja të theksuara fjalët "Animaux vivants" (Kafshë të gjalla).

Neni RC 119

Kushtet e pranimi dhe shënimi i artikujve që përmbajnë materiale radioaktive

1. Artikujt që përmbajnë materiale radioaktive do të pranohen për transportim me postë subjekt i pëlqimit paraprak nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe me kusht që veprimtaria nuk i kalon një të dhjetën e lejimit nga Tabela 3 - Kufijtë e Veprimtarisë për Koli të Pranuar, sipas listës në botimin aktual të IAEATS R_1.

2. Paketimin i jashtëm i artikujve që përmbajnë materiale radioaktive duhet të jetë shënuar nga dërguesi me një etiketë me numrin e UN të zbatueshëm të treguar më poshtë. Ajo gjithashtu do të ketë, përveç emrit dhe adresës së dërguesit, një kërkesë me shkronja të theksuara për kthimin e artikujve në rast të mos-dorëzimit.



2bis Dërguesi duhet të tregojë emrin e tij dhe adresën dhe përmbajtjen e artikullit në mbështjelljen e brendshme.

2ter Etiketa duhet të shënohet qartë me kryq në rast se koli bosh kthehet në vendin e origjinës.

3. (i fshirë.)

Neni RC 119bis

Kushtet për pranimin dhe shënimin e artikujve që përmbajnë substanca të infektuara

1. Substancat të cilat janë të infektuara apo të dyshuara në mënyrë të arsyeshme që të jetë infektive për njerëzit apo kafshët dhe që plotësojnë kriteret e substancave infektive të kategorisë B (UN 3373) do të deklarohen si "Substance biologjike, kategoria B".

2. Dërguesit e substancave infektive të caktuara të UN 3373 do të sigurohen se dërgesat janë përgatitur në mënyrë të tillë që ato të arrijnë në destinacionin e tyre në gjendje të mirë dhe se substancat janë të paketuara sipas udhëzimit të Paketimi 650, siç tregohet në botimin aktual të Udhëzimeve Teknike për

Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme nga Ajri (Udhëzimet teknike) të publikuar nga Organizata Civile Ndërkombëtare e Aviacionit (ICAO), ose në botimin e fundit të Rregullores së Mallrave të Rrezikshme (DGR) të publikuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA). Për më shumë informacion, teksti i Udhëzimit të Paketimit 650, siç tregohet në botimin 2007/2008 të udhëzimeve të Teknike ICAO, është dhënë më poshtë. Dërguesit duhet të konsultojnë botimin më të fundit të Udhëzimeve Teknike ICAO për verifikimin e tekstit aktual të Udhëzimit të Paketimit 650 para përdorimit.

3. Paketimi duhet të jetë me cilësi të mirë, i fortë mjaftueshëm për t'i bërë ballë goditjeve dhe ngarkesave të ndeshura normalisht gjatë transportit, duke përfshirë edhe transferimin ndërmjet njësive të transportit dhe magazinave, si dhe çdo heqje nga një paletë ose mbi-paketim për trajtim manual ose mekanik të mëposhëm. Paketimi duhet të ndërtohet dhe të mbyllet për të parandaluar çdo humbje të përmbajtjes që mund të shkaktohen në kushtet normale të transportit nga dridhjet ose nga ndryshimet e temperaturës, lagështisë apo presionit.

4. Paketimi do të përbëhet nga tre elementë:

4.1 një enë parësore;

4.2 një paketim dytësor;

4.3 një paketim të jashtëm të sertë.

5. Enët parësore do të jenë të paketuara në paketimin dytësor në një mënyrë të tillë që, në kushte normale të transportit, ato nuk do të mund të thyhen, shpohen apo rrjedhin përmbajtjen e tyre në paketimin dytësor. Paketimi dytësor do të sigurohet me një paketimin të jashtëm me material amortizues të përshtatshëm. Çdo rrjedhje e përmbajtjes nuk do të cenojë integritetin e materialit amortizues ose paketimin e jashtëm.

6. Për transportin, marka e ilustruar më poshtë do të shfaqet në sipërfaqen e jashtme të paketimit të jashtëm në një sfond të një ngjyrë të kundërt dhe do të jenë qartësisht e dukshme dhe të lexueshme. Shenja do të jetë në formën e një katrori të vendosur në një kënd prej 45% (formë diamanti) çdo anë me një gjatësi prej të paktën 50 mm, gjerësia e vijës do të jetë të paktën 2 mm, dhe shkronjat dhe numrat do të jetë të paktën 6 mm të larta. Në paketimin e jashtëm, ngjitur me shenjën në formë diamanti, do të shënohet emri i duhur i transportit "Substancë biologjike, kategoria B", "Kampion diagnostikues" ose "Model Klinike" me shkronja të paktën 6 mm të larta.



7. Të paktën një nga sipërfaqet e paketimit të jashtëm duhet të ketë përmasa minimale 100 mm x 100 mm.

8. Paketimi i kompletuar do të jetë në gjendje të kalojë suksesshëm testin e rënies, siç përcaktohet në Udhëzimet Teknike të ICAO, me kusht që lartësia e rënies nuk do të jetë më pak se 1.2 m.

9. Për substanca të lëngshme:

9.1 Ena (enët) parësore do të jetë kundër rrjedhjes dhe nuk duhet të mbajnë më shumë se një litër substancë të lëngshme.

9.2 Ena dytësore do të jetë kundër rrjedhjes.

9.3 Nëse në paketimin dytësor janë vendosur disa enë parësore delikate, ata ose do të mbështillen secila më vete ose do të ndahen për të parandaluar kontaktin mes tyre.

9.4 Midis enës (enëve) parësore dhe paketimit dytësor do të vendoset material absorbues. Materiali absorbues do të jetë në sasi të mjaftueshme për të thithur të gjithë përmbajtjen e enës parësore në mënyrë që çdo lëshim i substancave të lëngëta nuk do të rrezikojë integritetin e materialit amortizues ose paketimin e jashtëm.

9.5 Ena parësore ose paketimi dytësor do të jenë në gjendje të qëndrojnë pa u derdhur një presioni të brendshëm prej 95 kPa.



9.6 Paketimi i jashtëm nuk duhet të përmbajë më shumë se katër litra të substancës së lëngshme. Kjo sasi përjashton akullin ose akullin e thatë kur përdoret për të mbajtur kampionët të ftohtë.

10 . Për substancat e ngurta:

10.1 Ena (enët) kryesore duhet të kalojë provën e shqyrtimit dhe nuk duhet të tejkalojnë limitin e masës së paketimit të jashtëm.

10.2 Paketimi dytësor duhet të kalojë provën e shqyrtimit.

10.3 Nëse në paketimin dytësor janë vendosur disa enë parësore delikate, ata ose do të mbështillen secila më vete ose do të ndahen për të parandaluar kontaktin mes tyre.

10.4 Me përjashtim të kolive që përmbajnë pjesë të trupit, organe ose trupa, paketimi i jashtëm nuk duhet të përmbajë më shumë se katër kilogramë substanca të ngurta. Nga kjo sasi përjashtohet akull ose akulli i thatë që përdoret për të mbajtur kapmpionët e ftohtë.

10.5 Nëse ka ndonjë dyshim se nëse mbetjeje të lëngshme mund të jenë të pranishme apo jo në ambalazhin parësor gjatë transportit, atëherë duhet të përdoret një paketim i përshtatshëm për lëngje, duke përfshirë materialet absorbues.

11 . Për kampionet e ngrira ose të ruajtura në frigorifer (akull, akull i thatë dhe azot i lëngshëm):

11.1 Në rastet kur është përdorur akull i thatë ose azoti i lëngshëm për të mbajtur kampionë të ftohtë, do të përmbushen të gjitha kërkesat e zbatueshme të Udhëzimeve teknike të ICAO. Kur përdoret, akulli ose akull i thatë do të vendoset jashtë paketimit dytësor ose në paketimin e jashtëm ose ambalazhin shtesë. Pasi vendoset akulli ose akulli i thatë do të jepet mbështetje e brendshme për të siguruar paketimin dytësor në pozicionin fillestar. Nëse është përdorur akulli, jashtë paketimit ose në ambalazhin shtesë do duhet të jenë kundër rrjedhjes. Në qoftë se është përdorur dioksidi i karbonit (akull i thatë), paketimi duhet të projektohet dhe ndërtohet për të lejuar lirimin e gazit të dioksidit të karbonit për të parandaluar një rritje të presionit që mund të prishë paketimin.

11.2 Ena parësore dhe paketimi dytësor duhet të jenë në gjendje të ruajnë integritetin e tyre në temperaturën e ftohjes përdoret si dhe temperaturës dhe presionit që mund të rezultojë në qoftë se humbet ftohja.

12. Kur kolitë vendosen në një ambalazh shtesë, shënjat e kolisë të kërkuara nga ky udhëzim për paketimin do të jenë qartësisht të dukshme ose do të riprodhohen në pjesën e jashtme të ambalazhit shtesë.

13. Substancat infektive të caktuar në UN 3373 të cilat janë paketuar dhe shënuar në përputhje me këtë udhëzim për paketimin nuk janë subjekt i kërkesave të tjera sipas këtij neni, përveç sa më poshtë:

13.1 Duhet të jepen në një dokument me shkrim (si fatura e dërgimit 38 CN), ose në paketë, emri i duhur i transportit, numri UN dhe emri dhe adresa dhe numri i telefonit të një personi përgjegjës;

13.2 Klasifikimi duhet të jetë në përputhje me dispozitat 2; 6.3.2 e Udhëzimeve Teknike të ICAO-s;

13.3 duhet të plotësohen kërkesat e raportimit të incidentit të dispozitës 7; 4.4 të Udhëzimeve Teknike të ICAO; dhe

13.4 duhet të zbatohen kërkesat për inspektimin e dëmit ose kërkesat e rrjedhjes të dispozitave 7;3.1.3 dhe 7;3.1.4 të Udhëzimeve Teknike të ICAO-s.

14. Prodhuesit e paketimit dhe distributorët e mëvonshëm për dërguesit ose personi i cili përgatit kolinë (p.sh. pacienti) do të sigurojnë udhëzime të qarta për mbushjen dhe mbylljen e këtyre kolive për të mundësuar që çdo koli e vetme të përgatitet si duhet për transport.

15. Mallrat e tjera të rrezikshme nuk duhet të jenë të paketuara në të njëjtën koli me Sektorin 6.2 Substanca infektive, me përjashtim të rastit kur ato janë të nevojshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë, stabilizimin ose parandalimin e degradimit ose neutralizimin e rreziqeve të substancave infektive. Një sasi prej 30 ml ose më pak e mallrave të rrezikshme të përfshira në klasat 3, 8 ose 9 mund të paketohen në secilën prej enëve parësore që përmban substanca infektive. Kur këto sasi të vogla të mallrave të rrezikshme janë të paketuara me substancat infektive, në përputhje me këtë udhëzim të paketimit, nuk duhet të plotësohen kërkesat e tjera të këtij neni.

16 . Dioksidi i ngurtë i karbonit (akulli i thatë) i përdorur si ftohës

16.1 Në qoftë se dioksidi i ngurtë i karbonit (akulli i thatë), është përdorur si ftohës, duhet të plotësohen kërkesat e paketimit të Udhëzimit të Paketimit 904 siç është përcaktuar në edicionin aktual të Udhëzimeve Teknike të ICAO-s ose të Rregullores së Mallrave të Rrezikshme IATA. Përveç kërkesave që janë të zbatueshme për Udhëzimin e Paketimit 650, dërguesi duhet gjithashtu të përmbushë kërkesat e shënimit dhe etiketimit të zbatueshme për kolitë që përmbajnë dioksid të ngurtë karboni (akull i thatë).

16.2 Për transportin ajror, duhet të paraqitet një dokument transporti në pajtim me Udhëzimet Teknike të ICAO-s ose Rregullores së Mallrave të Rrezikshme IATA. Përveç kësaj, fatura e dërgimit CN 38 që mbulon këtë dërgesë duhet të përmbajë deklaratën e mëposhtme: "Mallra të rrezikshme sipas deklaratës së transportuesit bashkangjitur".

16.3 Çantat që përmbajnë vetëm substanca infektive dhe të identikuara nga etiketat speciale "UN 3373" dihet të dorëzohen nga autoritetet postare tek linjat ajrore në çanta poste të pavulosura.

Neni RC 120

Tregimi i metodës së dërgimit

1. Çdo koli ajrore do të ketë në kohën e dërgimit një etiketë të posaçme blu me shkrimin "Par Avion" (me postë ajrore), të shoqëruar, nëse dëshirohet, me një përkthim në gjuhën e vendit të origjinës. Metoda e dërgimit duhet të tregohet qartë në njoftimin e dërgimit në lidhje me kolinë, qoftë me anë të etiketës së posaçme blu të postës ajrore qoftë nga një tregues përkatës në kutinë e duhur.

2. Nëse njoftimi i dërgimit është përfshirë në një dokument me auto-adeziv të ngjitur mirë në koli dhe me një kuti të shënuar me blu, etiketa e përmendur në 1 nuk do të jetë e detyrueshme, as në dokumentin e njoftimit të dërgimit të pakos, as në koli.

Neni RC 121

Formalitetet për tu plotësuar nga dërguesi

1. Çdo koli duhet të shoqërohet nga një njoftim i dërgimit CP 71, si pjesë e setit të shumëfishtë CP 72 ose si formular i vetëm CP 71.

2. Çdo kolie do t'i bashkëngjitet një deklaratë doganore CN 23, ose si një formular i vetëm ose si pjesë e një seti të shumëfishtë CP 72. Përmbajtja e kolisë do të tregohet me hollësi në deklaratën doganore dhe nuk do të pranohen shënime të përgjithshme. Deklarata doganore CN 23 do të jetë e vendosur në pjesën e jashtme të kolisë, në mënyrë të tillë që të parandalohet humbja e saj.

2bis Kur operatorët e caktuar bien dakord paraprakisht, të dhënat doganore, të dhëna në përputhje me udhëzimet mbi deklaratën doganore CN 23, duke përfshirë emrat dhe adresat e dërguesit dhe marrësit, mund të transmetohen elektronikisht tek operatori i caktuar postar i shtetit të destinacionit. Operatori i caktuar i origjinës mund të ndajë të gjitha ose një pjesë të këtyre të dhënave me administratën doganore në vendin e origjinës për qëllime të eksportit, dhe operatori i caktuar i destinacionit mund të ndajë të gjitha ose një pjesë të të dhënave të përmendura të mësipërme me administratën doganore në vendin e destinacionit për qëllime doganore të importit.

2ter Përdorimi i të dhënave nga dokumenti: Deklaratë doganore CN 23 i parashikuar në paragrafin e mësipërm 2bis do të kufizohet në proceset që lidhen me shkëmbimin e postës dhe formalitetet doganore në lidhje me eksportimin ose importimin e artikujve postarë dhe nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër.

2quater Të gjitha dispozitat e nenit RC 145 do të zbatohen edhe për të dhënat nga dokumenti: Deklaratë doganore CN 23, i parashikuar në paragrafin e mësipërm 2bis. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet të dhënave për deklaratën doganore CN 23 dhe të dhënave elektronike të dhëna në përputhje me paragrafin e mësipërm 2bis, deklarata doganore CN 23 do të përbëjë deklaratën doganore.

3. Dërguesi, gjithashtu, mund të bashkëlidhë me njoftimin e dërgimit ndonjë dokument (faturë, leje për eksport, licencë importi, certifikatë të origjinës, certifikatë të shëndetit, etj) të nevojshme për trajtimin doganor në shtetin dërgues dhe në shtetin e destinacionit.

4. Adresat e dërguesit dhe marrësit, dhe të gjitha të dhënat e tjera që do të jepen nga dërguesi, duhet të jenë identike në koli dhe njoftimin e dërgimit. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, do të konsiderohen si të vlefshme të dhënat që paraqiten në koli.

Neni RC 122

Udhëzime të dërguesit në momentin e postimit

1. Në kohën e postimit të një kolie, dërguesit do ti kërkohet të tregojë trajtimin që do të jepet në rast të mos-dorëzimit. Për këtë qëllim ai duhet të shënojë një kryq në kutinë përkatëse të njoftimit të dërgimit.

2. Ai mund të japë vetëm një nga udhëzimet e mëposhtme:

2.1 kthim të menjëhershëm tek dërguesi me anë të rrugës më ekonomike apo me rrugë ajrore;



2.2 Kthim tek dërguesi me anë të rrugës më ekonomike apo me rrugë ajrore në fund të një periudhe kohore, e cila nuk mund të kalojë periudhën e rregullores për mbajtjen në vendin e destinacionit;

2.3 ri-adresimin e kolisë me anë të rrugës më ekonomike ose me rrugë ajrore, për dorëzim tek marrësi;

2.4 braktisjen e kolisë nga dërguesi.

3. Operatorët e caktuar të origjinës do të kenë mundësinë të mos lejojnë të gjitha udhëzimet e përmendura në pikën 2. Numri i kutive në njoftimin e dërgimit do të kufizohet në përputhje me rrethanat. Megjithatë, operatorët e caktuar do të lejojnë gjithmonë udhëzimet 2.1 dhe 2.4. Dërguesi mund të riprodhojë ose të printojë vetëm një prej udhëzimeve të lejuara në njoftimin e dërgimit. Udhëzimi i shënuar në njoftimin e dërgimit do të riprodhohet në koli, ose ngjitur një kopje të CP 71 ose CP 72 "Etiketa e adresës" në koli, ose duke riprodhuar në ndonjë mënyrë tjetër udhëzimet e dhëna në këtë formular. Ajo do të jetë në frëngjisht ose në një gjuhë tjetër të njohur në vendin e destinacionit.

4. Nëse dërguesi dëshiron të ndalojë çdo ri-adresim, kolia dhe njoftimi i dërgimit duhet të ketë të shkruar "Ne pas réexpédier" (Mos ri-dërgo) në frëngjisht ose në një gjuhë tjetër të njohur në vendin e destinacionit.

5. Kollitë do të kthehen pa njoftim nëse dërguesi nuk ka dhënë udhëzime ose ato janë kontradiktore.

Neni RC 123

Formalitetet për tu plotësuar nga zyra e origjinës

1. Zyra e origjinës apo zyra dërguese e shkëmbimit do të jetë përgjegjëse për vendosjen e një etikete CP 73 në koli pranë adresës dhe në njoftimin e dërgimit. Kjo etiketë do të tregojë qartë numrin serial të kolisë dhe emrin e zyrës së origjinës. Nëse operatori i caktuar i origjinës e lejon, pjesa e etiketës CP 73 e cila duhet të vendoset në njoftimin e dërgimit mund të zëvendësohet nga një tregues i printuar më parë që ka të njëjtën pamje me pjesën përkatëse të etiketës.

2. Pesha e kolisë në kilogram dhe të qindtat e gramëve do të jepet në koli dhe në njoftimin e dërgimit. Çdo pjesë prej njëqind gramësh do të rumbullakoset deri në njëqindëshen e ardhshme.

3. Një vulë me datën e printimit do të vendoset vetëm në njoftimin e dërgimit.

4. Në koli ose në njoftimin e dërgimit duhet të vendosen vulat postare ose ndonjë metodë tjetër për të treguar parapagim sipas autorizimeve nga rregulloret e miratuara nga shteti i origjinës ose nga operatori i tij i caktuar.

5. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për të përjashtuar formalitetet e përmendura në pikat 1 deri në 4.

6. E njëjta zyrë e origjinës ose e njëjta zyrë dërguese e shkëmbimit nuk mund të përdorë dy ose më shumë seri të etiketave në të njëjtën kohë, me përjashtim të rastit kur seritë dallohen nga një shenjë dalluese.

KAPITULLI 3 SHËRBIME TË POSAÇME

Neni RC 124

Koli të siguruara

1. Kollitë mund të shkëmbehen me sigurim të përmbajtjes për vlerën e deklaruar nga dërguesi. Ky shkëmbim do të jetë e kufizuar në marrëdhëniet midis operatorëve të caktuar të cilët kanë deklaruar gatishmërinë e tyre për të pranuar këta artikuj, reciprokisht apo vetëm në një drejtim.

2. Vlerat e siguruara

2.1 Në parim, shuma e vlerës së siguruar do të jetë e pakufizuar. Çdo shtet anëtar ose operator i caktuar mund të kufizojë vlerën e siguruar, për sa i përket, në një shumë jo më të ulët se 4,000 SDR ose për një shumë të paktën të barabartë me atë të miratuar në shërbimin e saj të brendshëm në qoftë se ajo shumë është më e ulët se 4,000 SDR. Megjithatë, kufiri i vlerës së siguruar të miratuar në shërbimin e brendshëm do të jetë i zbatueshëm vetëm nëse ai është i barabartë me ose më i lartë se shuma e dëmshpërblimit të përcaktuar për kolinë me peshë një kilogram. Shuma maksimale do të njoftohet shteteve anëtare të Bashkimit në SDR.

2.2 Në shërbimin ndërmjet shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar të cilët kanë miratuar vlera të

ndryshme maksimale, të gjitha palët duhet të respektojnë limitin më të ulët.

2.3 Vlera e siguruar nuk mund të kalojë vlerën aktuale të përmbajtjes së kolisë, por lejohet të sigurohet vetëm një pjesë e asaj vlere.

2.4 Çdo sigurim i rremë për një vlerë më të madhe se vlera aktuale e përmbajtjes së një kolie do të sjellë përgjegjësi sipas procedurave ligjore të parashikuara nga legjislacioni i shtetit të origjinës.

2.5 Vlera e siguruar duhet të shprehet në monedhën e shtetit të origjinës dhe të shkruhet nga dërguesi në koli dhe njoftimin e dërgimit. Këto shënime do të bëhen me shkronja romake dhe numra arabë, pa fshirje ose ndryshime, as të vërtetuara. Shuma e vlerës së siguruar nuk do të shënohet me laps ose laps që nuk fshihet.

2.6 Shuma e vlerës së siguruar do të konvertohet në SDR nga dërguesi ose nga zyra e origjinës. Rezultati i konvertimit, i rrumbullakosur, nëse është e përshtatshme, në SDR-në më të afërt, do të tregohet në shifra në anë ose poshtë shifrave që përfaqësojnë vlerën në monedhën e shtetit të origjinës. Konvertimi nuk do të kryhet në shërbimet e drejtpërdrejta midis shteteve të cilat kanë të njëjtën monedhë.

2.7 Operatori i caktuar i origjinës duhet të njoftohet sa më shpejt të jetë e mundur në rast se rrethanat e çfarëdo lloji zbulojnë një sigurim të rremë për një vlerë më të madhe se vlera aktuale e përmbajtjes së kolisë. Kur është e përshtatshme, dokumentet që lidhen me hetimin, do të dërgohen tek ai operator i caktuar. Nëse kolia nuk është dorëzuar ende tek marrësi, operatori i caktuar i origjinës mund të kërkojë kthimin e saj.

3. Tarifat

3.1 Tarifa për kolitë e siguruara duhet të paguhet paraprakisht.

3.2 Ajo do të jetë e përbërë nga tarifa kryesore, një tarifë fakultative për njoftimin dhe një tarifë e zakonshme e sigurimit; të gjitha shpenzimet shtesë për transportin ajror dhe tarifën për shërbimet e veçanta do të shtohen tarifës kryesore; tarifa maksimale e udhëzuar për njoftimin do të jetë e njëjtë me tarifën e regjistrimit për artikujt e postës së letrave, pra 1.31 SDR ose me tarifën përkatëse të shërbimit të brendshëm në qoftë se kjo është më e lartë ose përjashtimisht, një tarifë maksimale të udhëzuesit prej 3.27 SDR.

3.3 Tarifa maksimale e udhëzuesit sigurimin e zakonshëm do të jetë 0.33 SDR për çdo 65.34 SDR të vlerës së siguruar ose pjesë të saj, ose 0.5% të shkallës së vlerës së siguruar.

3.4 Çdo tarifë për mbulimin kundër rrezikut të forcës madhore do të përcaktohet në mënyrë që suma e kësaj tarife dhe ajo e tarifës së sigurimit të zakonshëm të mos e kalojnë shumën maksimale të tarifës së sigurimit.

3.5 Në rastet kur janë të nevojshme masa të jashtëzakonshme të sigurisë, operatorët e caktuar mund të marrin nga dërguesi ose nga marrësi, përveç tarifave të përmendura në pikat 3.2 deri në 4, tarifa të veçanta të parashikuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm.

4. Operatorët e caktuar do të kenë të drejtën ti ofrojnë klientëve të tyre një shërbim të artikujve të siguruar në përputhje me specifikime të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë nen.

5. Pranimi

5.1 Çdo koli e siguruar do të jetë subjekt i rregullave të mëposhtme të posaçme në lidhje me përgatitjen.

5.1.1 Kolitë e siguruara do të përgatiten në mënyrë të tillë që përmbajtja të mos mund të preket pa dëme të dukshme në zarf, paketim apo vula dhe do të mbyllen me anë të mjeteve efektive si shiriti i hollë ngjitës me një dizajn uniform të veçantë ose shënim të dërguesit. Operatorët e caktuar, megjithatë, mund të bien dakord të mos kërkojë një dizajn apo shenjë të tillë.

5.1.2 Pavarësisht nga pika 5.1.1, operatorët e caktuar mund të kërkojnë që kolitë e siguruara të jenë të vulosura me vula dylli identike, vula plumbi ose mjete të tjera në fuqi, me një dizajn uniform të veçantë ose të shënohen nga dërguesi.

5.1.3 Dylli, vulat, etiketat e çdo lloji dhe pullat postare, nëse ka të tilla, të vendosura në këto koli do të vihen në distancë në mënyrë që ato të mos mund të fshehin ndonjë dëm në koli.

5.1.4 Etiketat dhe pullat postare nuk do të palosen në dy anët e paketimit në mënyrë që të mbulojnë një skaj.

5.1.5 Në koli mund të ngjitet një etiketë e adresës.

5.2 Çdo operator i caktuar do të kenë mundësinë e përcaktimit të një shume maksimale për vlerën e siguruar deri në të cilën ajo do të heqë dorë nga zbatimi i dispozitave të pikave 5.1.1 dhe 5.1.2. Në marrëdhëniet midis shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar që kanë vendosur vlera të ndryshme maksimale do të zbatohet shumën më të ulët në lidhje me këtë.

5.3 Çdo dërguesi të një kolie të siguruar do të jepet një faturë pa pagesë në momentin e postimit.



6. Shënimi dhe trajtimi i kolive

6.1 Çdo koli e siguruar dhe njoftimi për dërgimin e saj do të pajisen me një etiketë rozë CP 74. Kjo etiketë do të ketë të shkruar me shkronja romake shkronjën V, emrin e zyrës së origjinës dhe numrin serial të kolisë. Ajo duhet të ngjitet tek kolia, në të njëjtën anë, dhe në afërsi të adresës.

6.2 Operatorët e caktuar, megjithatë, mund të përdorin në të njëjtën kohë etiketën CP 73 të përshkruar në nenin RC 123.1 dhe një etiketë të vogël rozë, ku të jenë të shkruara me shkronja të theksuara fjalët "Valeur déclarée" (e siguruar).

6.3 Pesha e kolisë në kilogram dhe të dhjetat e gramëve do të jepet në koli pranë adresës dhe në njoftimin e dërgimit në hapësirën e posaçme. Çdo pjesë prej dhjetë gramësh do të rumbullakoset deri në dhjetëshen e ardhshme.

6.4 Operatorët e caktuar ndërmjetës nuk do të vendosin numër serial në krye të kolive të siguruara.

7. Procedura e dërgimit

7.1 Roli i zyrës së destinacionit.

7.1.1 Kur dërgohet ose dorëzohet e një koli e siguruar, operatori i caktuar duhet të marrë nga pranuesi një nënshkrim të pranimit, ose të regjistrojë të dhënat e marra nga një kartë identiteti, ose të marrë një formë tjetër të provave të pranimit që është ligjërishit e detyrueshme sipas legjislacionit të shtetit të destinacionit për të konfirmuar pranimin.

Neni RC 125

Kolitë me pagesë nga marrësi

1. Kolitë mund të dërgohen me pagesë nga marrësi. Shkëmbimi i kolive me pagesë nga marrësi do të kërkojnë marrëveshje paraprake midis operatorëve të caktuar të origjinës dhe atyre të destinacionit.

2. Kolitë e pranuar dhe pagesat

2.1 Në bazë të marrëveshjeve dypalëshe, mund të dërgohen kolitë të cilat plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë Rregullore.

2.2 Operatori i caktuar i origjinës së artikullit duhet të vendosë lirisht pagesën që duhet të kryhet nga dërguesi, përveç tarifave postare të pagueshme për kategorinë në të cilën bën pjesë kolia.

3. Roli i zyrës së postimit

3.1 Tregues që duhet të jepen në koli dhe në njoftimin e dërgimit.

3.1.1 Kolitë për të cilat është e pagueshme tarifa COD dhe njoftimet përkatëse të dërgimit do të kenë të shënuar dukshëm, në anën e adresave në kutinë e kolisë, shënimin "Remboursement" ("Rimbursim") (COD) të ndjekur nga shuma e COD në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet RF 201.2 dhe RF 303 të Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimit të Pagesave Postare.

3.1.2 Dërguesi do të shkruajë emrin dhe adresën e tij me shkronja romake në anën e adresës të kolisë dhe në pjesën e përparme njoftimit të dërgimit.

3.2 Etiketa.

3.2.1 Njoftimi i dërgimit të kolive COD do të ketë një etiketë portokalli në formën e modelit CN 29. Nëse shënimi i dërgimit është përfshirë në dokument auto-adeziv me një tregues të duhur të shumës së COD, etiketa CN 29 nuk do të jetë e detyrueshme. Për më tepër, kolitë COD do të kenë, në anën e adresave, edhe dy etiketa të tjera në formën e modelit CN 29 bis dhe modelit CP 95.

3.3 Formulari që i bashkëngjitet kolive.

3.3.1 Çdo koli COD do të shoqërohet nga një formular i urdhër-pagesës në përputhje me dispozitat e nenit RF 201.2 të Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare.

4. Roli i zyrës së destinacionit

4.1 Kolitë, për të cilat është e pagueshme tarifa COD, do të dorëzohen tek marrësi sipas kushteve të përcaktuara nga operatori i caktuar i destinacionit. Shumat e mbledhura do të trajtohen në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin RF 701 të Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare.

5. Ri-adresimi

5.1 Çdo koli për të cilën është e pagueshme një tarifë COD mund të ri-adresohet nëse shteti i ri i destinacionit ofron shërbim për artikujt e këtij lloji në marrëdhëniet e tij me shtetin e origjinës.

6. Dëmshpërblimet

6.1 Nëse një koli COD është dorëzuar pa marrë shumën COD, operatori i caktuar i destinacionit do t'i paguajë operatorit të caktuar dërgues një dëmshpërblim që i korrespondon shumës COD.

6.2 Nëse artikulli është plaçkitur pjesërisht, dëmshpërblimi do të vendoset në vlerën aktuale të vjedhjes, mbi bazën e shumës COD.

6.3 Në rast të humbjes, dëmshpërblimi do të kufizohet në shumën totale të COD.

Neni RC 126

Koli ekspres

1. Shënimi i kolive

1.1 Çdo koli ekspres dhe njoftimi i dërgimit do të pajisen me një etiketë të kuqe të lehtë, duke pasur të shtypur shumë dukshëm treguesin "Exprès" (ekspres). Kjo tabelë, kur është e mundur, do të vendoset pranë emrit të vendit të destinacionit.

2. Tarifat

2.1 Tarifa maksimale shtesë e udhëzuesit, subjekt i të cilave do të jenë kolutë do të jetë 1.63 SDR. Kjo tarifë duhet të parapaguhet plotësisht. Ajo paguhet edhe nëse kolia nuk mund të dorëzohet me anë të korrierit të posaçëm, por vetëm me njoftim të mbërritjes.

2.2 Mund të merret një pagesë shtesë në përputhje me dispozitat që lidhen me artikujt e të njëjtit lloj në shërbimin e brendshëm, kur dorëzimi ekspres përfshin kërkesa të veçanta. Kjo pagesë do të paguhet edhe nëse kolia është kthyer tek dërguesi ose ri-adresuar, megjithatë, në një rast të tillë, tarifa maksimale shtesë e udhëzuesit e parashikuar në 2.1 do të jetë 1.63 SDR.

2.3 Marrësit mund ti kërkojnë zyrës së destinacionit, subjekt i përcaktimeve të pikës 2.1, dërgimin ekspres të artikujve të destinuar për ta, nëse rregulloret e operatorit të caktuar të destinacionit e lejojnë këtë. Në këtë rast, operatori i caktuar të destinacionit do të jetë i autorizuar për të marrë, pas dorëzimit, tarifën që zbatohet në shërbimin e tij të brendshëm.

3. Trajtimi i kolive

3.1 Në shtetet, operatori i caktuar i të cilave nuk siguron dorëzimin në vendin e adresës, kolutë ekspres do të dorëzohen me njoftim të mbërritjes nga i korrieri i posaçëm. Njoftimi mund të dërgohet edhe me anë të telekomunikacioneve.

3.2 Nëse adresa e marrësit ndodhet jashtë zonës lokale të dorëzimit të zyrës së destinacionit, dorëzimi i kulisë ekspres apo njoftimit të mbërritjes nga korrieri i posaçëm nuk do të jetë i detyrueshëm.

3.3 Dorëzimi i një kolie ekspres ose njoftimit të dorëzimit nga korrieri i posaçëm do të tentohet të paktën një herë. Nëse përpjekja e parë është e pasuksesshme, çdo tentativë e mëvonshme për të dorëzuar kolinë ose njoftimin e dorëzimit nga korrieri i posaçëm nuk do të jetë domosdoshmërisht i detyrueshëm.

3.4 Operatorët e caktuar të cilët marrin pjesë në shkëmbimin e kolive ekspres do të ndërmarrin të gjitha hapat për të përshpejtuar zhdoganimin.

Neni RC 127

Kolutë me lajmërim-marrje

1. Në rastin e operatorëve të caktuar që ofrojnë shërbimin e lajmërim marrjes për klientët, dërguesi i një kolie mund të aplikojë për një lajmërim marrje në kohën e postimit duke paguar një tarifë, shuma maksimale sipas udhëzuesit e të cilës është vendosur në 3.1. Ky lajmërim marrje do t'i kthehet atij me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore). Operatorët e caktuar mund të kufizojnë këtë shërbim për kolutë e siguruara nëse ky kufizim është parashikuar në shërbimin e tyre të brendshëm.

2. Shënimi i kolive

2.1 Çdo koli për të cilën dërguesi kërkon një lajmërim marrje do të ketë një vulë shumë të dukshme me shprehjen AR. I njëjti tregues gjithashtu do të bëhet në njoftimin e dërgimit.

2.2 Kolutë me lajmërim marrje do të shoqërohet nga një kopje të formularit CN 07 të plotësuar sipas rregullave. Ky formular duhet t'i bashkëngjitet njoftimit të dërgimit. Nëse formulari CN 07 nuk arrin në zyrën e destinacionit, kjo zyrë duhet të bëjë automatikisht një njoftim të ri të dërgimit.

3. Tarifa

3.1 Shuma maksimale e udhëzuesit për tarifën e lajmërim marrjes të përshkruar në pikën 1 do të jetë 0.98 SDR.

4. Trajtimi i lajmërim marrjes

4.1 Si një çështje prioritare, lajmërim marrja duhet të nënshkruhet nga marrësi ose, në qoftë se nuk është e mundur, nga një person tjetër i autorizuar në bazë të rregulloreve të vendit të destinacionit. Nëse këto



rregulla e lejojnë, lajmërimi mund të nënshkruhet nga zyrtari i zyrës së destinacionit. Përveç nënshkrimit duhet të merret edhe emri me shkronja kapitale apo ndonjë indikacion tjetër i qartë dhe i lexueshëm që mundëson identifikimin e qartë të personit që nënshkruan.

4.2 Menjëherë pasi kolia është dorëzuar, zyra e destinacionit do të kthejë formularin CN 07, të plotësuar sipas rregullave, në adresën e treguar nga dërguesi. Ky formular duhet të dërgohet menjëherë dhe të postohet falas me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore). Nëse lajmërim marrja është kthyer pa u plotësuar sipas rregullave, parregullsia do të njoftohet me anë të formularit hetimor CN të parashikuar në nenin RC 144, me të cilin duhet të jetë bashkangjitur lajmërim marrja përkatëse.

4.3 Kur dërguesi kërkon informacion në lidhje me një lajmërim marrje të cilin ai nuk e ka marrë brenda një periudhe normale, ky lajmërim marrje do të kërkohet falas me anë të formularit CN 08. Një kopje e lajmërim marrjes, që do të ketë të shkruar me shkronja të zeza "Duplicata" (Dublikatë), do ti bashkëngjitet formularit hetimor CN 08. Ky i fundit do të trajtohet në përputhje me nenin RC 144.

Neni RC 128

Kolitë për tu dërguar pa pagesë dhe tarifë

1. Në shërbim midis operatorëve të caktuar të cilat kanë njoftuar marrëveshjen e tyre për këtë qëllim, dërguesit, me anë të një deklarate paraprake në zyrën e origjinës, mund të marrin përsipër të paguajnë tërësisht tarifat dhe çmimet subjekt i të cilave janë kolitë pas dorëzimit.

2. Dërguesit mund të marrin përsipër të paguajnë shumat të cilat mund të kërkojnë nga zyra e destinacionit. Nëse është e nevojshme, ata mund të bëjnë një pagesë të përkohshme.

3. Operatori i caktuar i origjinës do të marrë nga dërguesi një tarifë, shuma maksimale e udhëzimit për të cilën është vendosur në pikën 6.1, të cilën do ta mbajë si pagesë për shërbimet e kryera në vendin e origjinës.

4. Operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i autorizuar të marrë një tarifë komisioni, shuma maksimale e udhëzimit për të cilën është vendosur në pikën 6.2. Kjo pagesë do të jetë e pavarur nga tarifa e paraqitjes në doganë. Ajo do të merret nga dërguesi në emër të operatorit të caktuar të destinacionit.

5. Shënimi dhe trajtimi i kolive

5.1 Çdo koli për tu dërguar tek marrësi pa tarifa dhe çmime dhe njoftimi i dërgimit të saj do të mbajnë, me shkronja të zeza, titullin "Franc de taxes et de droits" (Pa pagesë të tarifave dhe çmimeve) ose ndonjë shprehje tjetër ekuivalente në gjuhën e vendit të origjinës. Kolia dhe njoftimi i dërgimit do të kenë një etiketë të verdhë me shënimin, gjithashtu me shkronja të zeza, "Franc de taxes et de droits".

5.2 Çdo koli për tu dërguar pa tarifa dhe çmime duhet të shoqërohet me një shënim e vendosjes së pullave CN 11 në letër të verdhë. Dërguesi i kolisë duhet të plotësojë tekstin e anën e djathtë në krye të pjesëve të A dhe B të shënimit të tarifës postare. Zyra e shpërndarjes do të plotësojë shenjat e shërbimit postar në të. Të dhënat e dërguesit mund të bëhen me përdorimin e letres karbon. Teksti do të përfshijë angazhimin e përshkruar në pikën 2. Njoftimi i dërgimit, deklaratat doganore dhe shënim i vendosjes së pullave do të jenë të lidhura mirë së bashku.

6. Tarifat

6.1 Shuma maksimale e udhëzuesit për tarifën e referuar në pikën 3 do të jetë 0.98 SDR për koli.

6.2 Shuma maksimale e udhëzuesit për tarifën e komisionit të referuar në pikën 4 do të jetë 0.98 SDR për koli.

7. Kthimi i shënimeve të vendosjes së pullave (Pjesa A). Kompensimi i tarifave dhe çmimeve

7.1 Do të zbatohen dispozitat e Rregullores së Postës së Letrave.

7.2 Kur dërguesi konteston shumën e tarifave të treguar në pjesën A të shënimit të vendosjes së pullave, operatori i caktuar i destinacionit do të verifikojë shumën e totalit të paguar. Nëse është e nevojshme, ai duhet ti drejtohet shërbimit kombëtar doganor të tij. Pas kryerjes së ndonjë korrigjimi të nevojshëm, ai do të dërgojë pjesën A të shënimit në fjalë tek operatori i caktuar i origjinës. Gjithashtu, nëse operatori i caktuar i destinacionit gjen një gabim ose lënie jashtë në lidhje me tarifat që i përkasin një kolie pa tarifë dhe çmim për të cilat pjesa A e shënimit të vendosjes së pullave është kthyer tek operatori i caktuar i origjinës, ai do të lëshojë një duplikatë të korrigjuar. Ai do të dërgojë pjesën A tek operatori i caktuar i origjinës për të rregulluar çështjen.

8 Llogaria me operatorin e caktuar të postimit

8.1 Llogaria në lidhje me tarifat, detyrimet doganore dhe tarifat e tjera të paguara nga çdo operator i caktuar në emër të një tjetri do të kryhet me anë të llogarive të detajuara CN 12, të hartuara në bazë tremujore nga operatori i caktuar kreditor. Të dhënat e pjesëve të B të shënimeve të vendosjes së pullave që ai ka mbajtur do të regjistrohen sipas rendit alfabetik të zyrave që kanë parapaguar tarifat dhe në rendit numerik që i është dhënë atyre. Nuk do të përgatiten llogaritë "Nul".

8.2 Llogaria e detajuar, e shoqëruar nga pjesët e B të shënimeve të vendosjes së pullave, do t'i dërgohen operatorit të caktuar debitor jo më vonë se fundi i muajit të dytë pas tremujorit me të cilin ka të bëjë.

8.3 Kontabiliteti do të realizohet me anë të llogarisë CP 75 të përmendur në nenin RC 203.

8.4 Me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar në fjalë kanë rënë dakord ndryshe, shumat në reshtin e fundit të llogarisë CN 12 do të përfshihen nga operatori i caktuar kreditor në CP 75 e ardhshëm të dërguar nga ky operator i caktuar, me motivin e dhënë në kolonën "Vërejtje".

8.5 Në rastet kur operatori i caktuar nuk e përdor CP 75 në marrëdhëniet e tij me operatorin e caktuar debitor, përjashtimisht, mund të përdoret llogaria CN 51.

Neni RC 129

Koli delikate. Koli të rënda

1. Çdo koli që përmban artikuj të cilët mund të thyhen lehtë dhe të cilat duhet të trajtohen me kujdes të veçantë do të quhet një "koli delikate".

2. Sa në vijim do të quhen "koli të rënda"; kolutë:

2.1 përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë e përcaktuara në Rregulloren për Kolutë postare ose ato të cilat operatorët e caktuar do të vendosin midis tyre;

2.2 të cilat, për shkak të formës ose strukturës së tyre, nuk jepen të gatshme për ngarkim me kolutë e tjera ose që kërkojnë masa të veçanta.

3. Kolutë delikate dhe kolutë e rënda do të jetë subjekt i një pagese shtesë, shumat maksimale e udhëzuesit për të cilën është ajo e vendosur në 6.1. Nëse kolia është edhe delikate dhe e rëndë pagesa shtesë do të merret vetëm një herë. Megjithatë, shpenzimet shtesë të transportit ajror për këto koli nuk do të rriten.

4. Shkëmbimi i kolive delikate dhe kolive të rënda duhet të kufizohet për ata operatorë të caktuar të cilët pranojnë sendet e tilla.

5. Shënimi i kolive delikate dhe i kolive të rënda

5.1 Pa cenuar përputhjen me rregullat e përgjithshme në lidhje me përgatitjen dhe paketimin, çdo koli delikate do të pajiset, nga dërguesi ose nga zyra e origjinës, me një emërtim që të përmbajë një pamje të një gote të stampuar me të kuqe në një sfond të bardhë.

5.2 Shënimi përkatës i dërgimit do të ketë treguesin shumë dukshëm në krye "Colis fragile" (koli delikate) ose në dorëshkrim apo të shtypura në një etiketë.

5.3 Çdo koli, natyra delikate e përmbajtjes së të cilës është treguar nga ndonjë shenjë e jashtme çfarëdo të vënë nga dërguesi, do të pajiset nga zyra e origjinës me etiketën e parashikuar në pikën 5.1. Do të merret tarifa përkatëse shtesë. Në qoftë se dërguesi nuk dëshiron që kolia të trajtohet si delikate, zyra e origjinës do të shënojë me kryq shenjën e bërë nga dërguesi.

5.4 Çdo koli e rëndë dhe pjesa e përparme e njoftimit të dërgimit të saj do të kenë etiketën që tregon me shkronja të zeza fjalën "Encombrant" (E rëndë).

5.5 Operatorët e caktuar të cilët pranojnë kufijtë e përmasave të përcaktuara në nenin RC 115.1 mund tarifojnë si të rëndë çdo koli, përmasat e së cilës tejkalojë kufijtë e përcaktuara në nenin RC 115.2, por që peshon më pak se 10 kilogramë. Në një rast të tillë, fjala "Encombrant" do të shoqërohet në njoftimin e dërgimit vetëm me fjalët "en vertu de l'article RC 129.5.5" (në bazë të nenit RC 129.5.5).

6. Tarifat

6.1 Shuma maksimale e udhëzuesit për tarifën shtesë të referuar në pikën 3 është 50% e tarifës kryesore.

Neni RC 130

Shërbimi i dërgesave

1. Operatorët e caktuar mund të bien dakord midis tyre për të marrë pjesë në një shërbim fakultativ "Dërgesash" për artikujt kolektivë të dërguara nga një dërgues jashtë vendit.



2. Kurdo që është e mundur ky shërbim do të identifikohet nga logo e përcaktuar në pikën 4.
3. Detajet e këtij shërbimi do të përcaktohen në mënyrë të dyanshme ndërmjet operatorit të caktuar të origjinës dhe operatorit të caktuar të destinacionit në bazë të dispozitave të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare.
4. Identifikimi i shërbimit të "Dërgesave"
- 4.1 Logo e dizenuar për të identifikuar shërbimin e "Dërgesave" do të konsistojë në elementët e mëposhtëm:
 - fjalën "DËRGESË" me ngjyrë blu;
 - tre shirita horizontale (i kuq, blu dhe i gjelbër).

==CONSIGNMENT==

Neni RC 131 Shërbimi i integruar logjistik

1. Në marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të caktuar të cilët kanë rënë dakord për të siguruar këtë shërbim, shërbimi i integruar i logjistikës mund të përfshijë mbledhjen, pranimin, përpunimin, ruajtjen, trajtimin, shpërndarjen, transferimin, transportin dhe dorëzimin fizik të dokumenteve të veçanta ose të kombinuara ose të mallrave.
2. Të dhënat për një shërbim të integruar të logjistikës që përfshin dy ose më shumë operatorë të caktuar do të bazohet në marrëveshjet dypalëshe. Aspektet që nuk rregullohen shprehimisht nga këto të fundit do të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të Akteve të Bashkimit.
3. Tarifat për shërbimin do të përcaktohen nga operatori i caktuar i origjinës duke konsideruar kostot dhe kërkesat e tregut.

KAPITULLI 4 NDALIMI I FUTJES SË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME NË KOLITË POSTARE. PËRJASHTIMI NGA NDALIMI. KOLI TË PRANUARA GABIM. RI-ADRESIMI. KTHIMI TEK DËRGUESI. TËRHEQJA NGA POSTA. KËRKESAT

Neni RC 132 Ndalimi i futjes së substancave të rrezikshme në kolitë postare

1. Nenet e mbuluara nga "Rekomandimet për Transportin e Mallrave të Rrezikshme" të hartuara nga Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mallrave të caktuara të rrezikshme dhe materialeve radioaktive të parashikuara në këto rregullore, si dhe nga Udhëzimet Teknike të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe Rregulloret e Mallrave të rrezikshme të Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) do të konsiderohen si substanca të rrezikshme, në përputhje me dispozitat e nenit 15.3 të Konventës dhe të ndaluara për tu futur në kolitë postare.

Neni RC 133 Përjashtimi nga ndalimi

1. Ndalimi lidhur me narkotikët dhe substancat psikotrope nuk do të zbatohet për ngarkesat e dërguara për qëllime mjekësore ose shkencore në vendet të cilat i pranojnë ato me këtë kusht.
2. Nëse rregulloret e brendshme të vendeve anëtare që kanë të bëjnë me këtë e lejojnë, kolitë mund të përmbajnë gjithashtu çdo dokument që shkëmbehet midis dërguesit dhe marrësit të kolisë apo personave që

jetojnë me ta.

3. Neni 15.6.1.3 i Konventës nuk do të zbatohet kur shkëmbimi i kolive ndërmjet dy shteteve anëtare që pranojnë koli të siguruara mund të kryhet vetëm në transit nëpërmjet ndërmjetësimit të një shteti anëtar që nuk i pranon ato.

Neni RC 134

Trajtimi i kolive të pranura gabim

1. Kolitë që përmbajnë artikujt e përmendur në nenin 15.2, të 15.4.3 dhe 15.5 të Konventës, dhe të pranura gabimisht në Postë do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e vendit të operatorit të caktuar duke vërtetuar praninë e tyre.

2. Në rastin e futjes së një artikulli të vetëm të korrespondencës të ndaluar sipas kuptimit të nenit 15.5 të Konventës, kjo do të trajtohet si një artikull i papaguar i postës së letrave. Kolia nuk do të kthehet tek dërguesi për këtë arsye.

3. Operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i autorizuar të dorëzojë tek marrësi një koli të pasiguruar me origjinë nga një vend që pranon sigurim dhe përmban artikujt e renditur në nenin 15.6.1.2 dhe 15.6.1.3 të Konventës, sipas kushteve të parashikuara nga rregulloret e saj. Nëse dorëzimi nuk lejohet, kolia do të kthehet dërguesit.

4. Dispozitat e pikës 3 do të jenë të zbatueshme për kolitë, pesha apo përmasat e të cilave i tejkalojnë dukshëm kufijtë e lejueshëm. Megjithatë, këto koli, kur është e përshtatshme, mund do të dërgohen tek marrësi, nëse ai paguan çdo detyrim që mund të jetë për i detyrueshëm.

5. Nëse një koli e pranuar gabimisht apo një pjesë e përmbajtjes së saj nuk është dorëzuar tek marrësi dhe as kthyer tek dërguesi, operatori i caktuar i origjinës do të njoftohet pa vonesë për mënyrën si është trajtuar kolia. Ky njoftim duhet të tregojë qartë ndalimin në të cilin bën pjesë kolia apo artikujt që kanë shkaktuar sekuestrimin e saj.

6. Në rastin e sekuestrimit të një kolie të pranuar gabimisht, operatori i caktuar i destinacionit ose transimit duhet të njoftojë operatorin e caktuar të origjinës me anë të dërgimit të një formulari CN 13 ose, nëse është rënë dakord reciprokisht, duke përdorur mesazhin standard UPU EDI artikull - nivel.

Neni RC 135

Kushtet e ri-adresimit të kolisë

1. Një koli mund të ri-adresohet brenda shtetit të destinacionit me kërkesë të dërguesit, me kërkesë të marrësit, ose automatikisht nëse rregullat e atij shteti e lejojnë këtë.

2. Një koli mund të ri-adresohet jashtë shtetit të destinacionit vetëm me kërkesë të dërguesit ose marrësit. Në këtë rast kolia duhet të përmbushë kërkesat për transmetim progresiv.

3. Një koli mund të ri-adresohet me rrugë ajrore me kërkesë të dërguesit ose marrësit. Duhet të garantohet pagesa e tarifës ajrore shtesë në lidhje me transmetimin progresiv.

4. Për ri-adresimin e parë dhe ato të mëpasshme të secilës koli, mund të merren sa në vijim:

4.1 çmimi i autorizuar nga rregulloret e brendshme të operatorit të caktuar përkatës për këtë ri-adresim, në rastin e ri-adresimit brenda vendit të destinacionit;

4.2 tarifa dhe shpenzimet shtesë të transportit ajror të shkaktuara në transmetimin progresiv, në rastin e ri-adresimit jashtë vendit të destinacionit;

4.3 Çmimet dhe tarifat për të cilat operatorët e caktuar e mëparshëm të destinacionit nuk bien dakord të anulojnë.

5. Çmimet, pagesat dhe tarifat e përmendura në pikën 4 do të merren nga marrësi.

6. Në qoftë se çmimet, pagesat dhe tarifat e përmendura në pikën 4 janë paguar në kohën e ri-adresimit kolia do të trajtohet sikur të ishte nisur nga vendi i ri-adresimit dhe e adresuar për në vendin e ri të destinacionit.

7. Nëse një koli ekspres që ri-adresohet ka qenë subjekt i një përpjekjeje të pasuksesshme të dorëzimit në vendin e adresës me anë të korrierit të posaçëm, zyra ri-adresuese do të vendosë në etiketën apo shënimin "Exprès" (Ekspres) dy vija të trasha horizontale.



Neni RC 136 Periudha e mbajtjes

1. Kur një marrës është njoftuar për ardhjen e një kolie, ajo do të mbahet në dispozicion të tij për dy javë ose, më së shumti, për një muaj nga dita pas asaj në të cilën është dërguar njoftimi. Përkashtimisht, kjo periudhë mund të rritet në dy muaj, nëse rregulloret e shtetit të destinacionit e lejojnë këtë.

2. Kur nuk ka qenë e mundur të njoftohet një marrës për mbërritjen e një kolie, do të zbatohet periudha e mbajtjes e parashikuar nga rregulloret e shtetit të destinacionit. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për kolitë të adresuara "postë restante". Kjo periudhë do të fillojë nga dita pas ditës në të cilën kolia mbahet në dispozicion të marrësit. Ajo nuk duhet të kalojë dy muaj. Kolia do të kthehet brenda një periudhe të shkurtër, nëse dërguesi e ka kërkuar këtë në një gjuhë tjetër të njohur në shtetin e destinacionit.

3. Në rastin e ri-adresimit për kolitë e dorëzuara nga zyra e re e destinacionit do të zbatohen periudhat e mbajtjes të përshkruara në pikat 1 dhe 2.

4. Nëse, në përfundim të kontrollit doganor të një kolie, ka kaluar një periudhë prej më shumë se tre muaj, operatori i caktuar i destinacionit do të kërkojë udhëzime nga operatori i caktuar i origjinës në lidhje me këtë koli.

5. Nëse operatori i caktuar i destinacionit nuk përmbush dispozitat nga 1 deri 4 më sipër, do të paguajnë tarifat dhe pagesat e detyruara për kthim në origjinë.

Neni RC 137 Koli të mbajtura automatikisht

1. Për çdo koli të mbajtur automatikisht ose pezull për shkak të vjedhjes ose dëmtimit ose për ndonjë shkak tjetër të këtij lloji, operatori i caktuar i destinacionit do të përgatisë një njoftim verifikimi CP 78. Megjithatë, kjo procedurë nuk do të jetë e detyrueshme në rastet e forcave madhore ose kur numri i kolive të mbajtura automatikisht është i tillë realizimi i dërgimit të njoftimit është fizikisht i pamundur.

2. Njoftimi i verifikimit CP 78 do të përgatitet nga operatori i caktuar ndërmjetës i interesuar për çdo koli të ruajtur automatikisht në kohën e transmetimit ose me anë të shërbimit postar (ndërpërje e rastësishme e trafikut) ose me anë të Doganës. Rezerva sipas pikës 1 do të zbatohet edhe në këto raste.

3. Njoftimi i verifikimit CP 78 do të përfshijë të gjitha të dhënat e paraqitura në etiketat CP 74 dhe CP 73 dhe datën e postimit të kolisë. Njoftimi i verifikimit CP 78 do të dërgohet me anë të rrugës më të shpejtë tek operatori i caktuar i shtetit të rezidencës së dërguesit.

4. Njoftimi i verifikimit CP 78 do të shoqërohet nga një kopje të njoftimit të dërgimit. Në rastet e përmendura në pikat 1 dhe 2, CP 78 do të shënohen me shkronja të zeza "Colis retenu d'office" (koli të mbajtura automatikisht). Nëse kolia është pezull për shkak të vjedhjes ose dëmtimit, duhet të përgatitet një raport CN 24. Një kopje e raportit që jep informacion për masën e dëmit do të shoqërojë CP 78.

5. Disa koli të postuara në të njëjtën kohë nga ana e të njëjtit dërgues dhe të adresuara tek i njëjti marrës mund të jetë subjekt i një njoftimi të verifikimit CP 78, edhe nëse këto koli janë të shoqëruara me njoftime të ndryshme dërgimi. Në një rast të tillë, të gjitha këto shënime do t'i bashkëngjiten CP 78.

6. Si rregull i përgjithshëm, një CP 78 do të shkëmbehet ndërmjet zyrës së destinacionit dhe zyrës së shkëmbimit të origjinës. Megjithatë, çdo operator i caktuar mund të kërkojë që CP 78 e lidhur me shërbimin e saj të dërgohet në administratën e tij qendrore ose në një zyrë të caktuar posaçërisht. Emri i kësaj zyre do t'i njoftohet operatorëve të caktuar nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare. Operatori i caktuar i vendit të rezidencës së dërguesit do të jetë përgjegjës për njoftimin e dërguesit. Shkëmbimi i njoftimeve CP 78 do të përshpejtohet sa më shumë të jetë e mundur nga të gjitha zyrat e interesuara.

Neni RC 138 Kthimi i kolive të padërguara tek dërguesi

1. Nëse një koli nuk mund të dërgohet ose në qoftë se është mbajtur zyrtarisht, ajo do të trajtohet në përputhje me udhëzimet e dhëna nga ana e dërguesit brenda limiteve të përcaktuara në nenin 122 RC.

2. Kur dorëzimi i një kolie nuk ka qenë i mundur, ajo duhet të kthehet menjëherë nëse;

2.1 dërguesi ka kërkuar kthimin e saj të menjëhershëm;

- 2.2 dërguesi ka bërë një kërkesë të pa autorizuar;
- 2.3 udhëzimet e dërguesit në kohën e postimit nuk e kanë arritur rezultatin e dëshiruar.
3. Kur dërgimi i një kolie nuk ka qenë i mundur, ajo duhet të kthehet menjëherë pas përfundimit:
 - 3.1 të periudhës, nëse ka një të tillë, të caktuar nga dërguesi;
 - 3.2 të periudhave të mbajtjes të përcaktuara në nenin RC 136, nëse dërguesi nuk ka vepruar në përputhje me nenin RC 122. Në këtë rast, megjithatë, dërguesit mund ti kërkojnë udhëzime me çdo mënyrë e përshtatshme;
 - 3.3 e një periudhe korresponduese me periudhën e mbajtjes të aplikuar në shërbimin e brendshëm në qoftë se një koli COD nuk është paguar brenda këtij afati limit.
4. Çdo koli do të kthehet nga rruga e përdorur normalisht për të dërguar e postën pa prioritet. Kjo do të kthehet nga ajri, vetëm nëse dërguesi ka garantuar pagesën e tarifave shtesë të transportit ajror. Megjithatë, kur operatori i caktuar që kthen artikullin nuk përdor më transportin tokësor, ai do të kthejë artikujt e padorëzueshëm me anë të mjeteve më të përshtatshme në përdorim.
5. Një zyrë e cila kthen një koli do të japë arsyet për mos dorëzimin e kolisë dhe në njoftimin e dërgimit. Ai duhet të përdorë për këtë qëllim një pullë ose një etiketë CN 15. Nëse nuk ka ndonjë njoftim dërgimi, arsyeja e kthimit do të paraqitet në faturën e kolisë. Njoftimi do të bëhen në gjuhën frënge. Çdo operator i caktuar ka mundësi të shtojë një përkthim në gjuhën e tij dhe çdo karakteristikë tjerë të përshtatshme.
6. Zyra e destinacionit do të fshijë të dhënat e adresës me të cilat ajo është e lidhur dhe shkruan "Retour" (Kthim) në faqen e përparme të kolisë dhe në njoftimin e dërgimit. Pranë këtij treguesi do të vendosë edhe vulën e saj datare.
7. Kollitë do ti kthehen dërguesit në paketimin e tyre origjinal. Ato do të shoqërohen me njoftimin e dërgimit të përgatitur nga dërguesi. Nëse një koli duhet të ripaketohet ose njoftimi origjinal i dërgimit zëvendësohet, emri i zyrës së origjinës së kolisë, numri serial origjinal dhe, nëse është e mundur, data e postimit do të paraqiten në paketimin e ri dhe në njoftimin e dërgimit.
8. Nëse një koli e postës ajrore është kthyer dërguesit me rrugë tokësore, etiketa "Par avion" (me postë ajrore) dhe çdo shënim që lidhet me transportin nga ajri do të fshihet automatikisht.
9. Një koli e kthyer të dërguesit do t'i nënshtrohet tarifave të transportit progresiv. Ajo gjithashtu do të jetë subjekt i tarifave dhe pagesave të pa fshira për të cilat i detyrohet operatorit të caktuar të destinacionit në kohën e kthimit të dërguesi. Kjo koli do të trajtohet nga operatori i caktuar në përputhje me legjislacionin të tij. Megjithatë, nëse dërguesi ka braktisur një koli dorëzimi i të cilës të marrësi ka qenë i pamundur, as dërguesit, as operatorëve të caktuar të tjerë nuk do ti kërkojë të mbulojë ndonjë tarifë postare, detyrim doganor ose taksa të tjera të cilat mund të kenë lindur për këtë koli.
10. Vendosja dhe mbledhja e tarifave, çmimeve dhe pagesave për kolinë do të bëhen siç është përmendur në nenin RC 198. Ato do të tregohen me hollësi në një deklaratë të tarifave CP 77. Kjo deklaratë do të vendoset në një cep të shënimit të dërgesës.
11. Tarifat, pagesat dhe detyrimet e parashikuara në pikën 9 do të merren nga dërguesi. Operatorët e caktuar megjithatë mund të tërhiqen nga llogaritja e saktë e shumës së këtyre tarifave dhe në vend të tyre të përdorin pagesa standarde për koli që do të kthehen të dërguesi.
12. Kollitë e kthyera dërguesit dhe të pa dorëzuara atij do të trajtohen nga operatori i caktuar në fjalë, në përputhje me legjislacionin e tij.

Neni RC 139

Kthimi i kolive të pranuar gabim tek dërguesi

1. Çdo koli e pranuar gabimisht dhe e kthyer tek dërguesi do të jetë objekt i tarifave, detyrimeve dhe pagesave të përcaktuara në nenin RC 138.9.
2. Këto çmime, tarifa dhe pagesa do të paguhën nga dërguesi, nëse kolia është pranuar gabimisht si pasojë e gabimit të dërguesit ose në qoftë se ajo i takon ndalimeve të përcaktuara në nenin 15 të Konventës.
3. Ato do të paguhën nga operatori i caktuar përgjegjës për gabimin, nëse kolia është pranuar gabimisht si pasojë e një gabimi që i takon shërbimit postar. Në këtë rast dërguesi do të ketë të drejtën e një kompensimi të tarifave të paguara.
4. Nëse tarifatat të cilat janë vendosur për operatorin e caktuar që kthen kolinë janë të pamjaftueshme për të mbuluar tarifatat, detyrimet dhe taksat e përmendura në pikën 1, tarifatat e papaguara do të mbulohen nga



operatori i caktuar i shtetit të rezidencës së dërguesit.

5. Nëse ka teprica, operatori i caktuar që kthen kolinë do t'i kthejë tepricën e tarifave operatorëve të caktuar të shtetit të rezidencës së dërguesit për kompensim të dërguesit.

Neni RC 140

Kthimi tek dërguesi për shkak të ndërprerjes së shërbimit

1. Kthimi i një kolie të dërguesi për shkak të pezullimit të shërbimeve do të jetë falas. Tarifat e pa mbledhura për udhëtimin do të kreditohen operatorit të caktuar të shtetit të rezidencës së dërguesit për rimbursimin e tij.

Neni RC 141

Mos përmbushja e udhëzimeve të dhëna nga operator i caktuar

1. Kur operatori i caktuar i destinacionit ose një operator i caktuar ndërmjetës nuk është pajtuar ende me udhëzimet e dhëna në kohën e postimit ose më pas, ajo do të përballë tarifën e transportit (vajtje dhe kthim) dhe ndonjë tarifë ose detyrim tjetër të pa mbledhur. Megjithatë, tarifën e paguar për udhëtimin e vajtjes do të mbeten përgjegjësi e dërguesit, nëse ai deklaron, në kohën e postimit ose më pas, që në rast të mos-dorëzimit, ai do të braktisë kolinë.

2. Operatori i caktuar i shtetit të rezidencës së dërguesit do të jetë i autorizuar automatikisht t'i faturojë detyrimet e referuara në pikën 1 operatorit të caktuar, i cili nuk ka plotësuar udhëzimet e dhëna dhe i cili, edhe pse është i informuar rregullisht, ka lejuar të kalojë periudha prej tre muajsh pa zgjidhur përfundimisht rastin. Afati fillon nga data në të cilën operatori i caktuar është informuar për rastin.

3. Dispozita në 2 do të zbatohet gjithashtu nëse operatori i caktuar i shtetit të rezidencës së dërguesit nuk ka qenë i informuar se mospërmbushja duket të jetë për shkak të forcës madhore ose se kolia ishte mbajtur, sekuestruar apo konfiskuar në përputhje me rregulloret e brendshme të shtetit të destinacionit.

Neni RC 142

Koli që përmbajnë artikuj për të cilat dyshohet se prishen ose kalben shpejt

1. Artikujt e përfshirë në një koli për të cilën dyshohet përkeqësimi apo shkatërrimi i parakohshëm, do të ndahen nga kolutë e të tjera me qëllim për të shmangur përkeqësimin në kolutë e tjera. në rrugën e vajtjes ose të kthimit. Kjo dispozitë do të zbatohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit anëtar.

2. Kur një koli është shkatërruar në përputhje me pikën 1, do të hartohet një raport formal i asgjësimit. Një kopje e raportit të shoqëruar me njoftimin e dërgimit do të dërgohet në zyrën e origjinës.

Neni RC 143

Trajtimi i kërkesave për tërheqjen e kolive nga posta ose për ndryshimin apo korrigjimin e adresës

1. Dërguesi i një kolie mund të kërkojë që ajo të kthehet apo që adresa e saj të ndryshohet. Ai duhet të garantojë pagesën e shumave të detyruara për çdo transmetim progresiv.

2. Megjithatë, operatorët e caktuar do të kenë mundësinë për të mos pranuar kërkesat e përmendura në pikën 1 kur ata nuk i pranojnë ato në shërbimin e tyre të brendshme.

3. Përgatitja e kërkesës

3.1 Çdo kërkesë për tërheqjen e artikujve nga posta ose për ndryshimin ose korrigjimin e adresës do të përfshijë plotësimin nga dërguesi të një formulari CN 17. Një formular mund të përdoret për disa artikujt të postuar në të njëjtën kohë, në të njëjtën zyrë, nga ana e të njëjtit dërgues, për tek të njëjti marrës.

3.2 Në përpunimin e kërkesës në zyrën postare, dërguesi duhet të dëshmojë identitetin e tij dhe të paraqesë certifikatën e postimit, nëse ka. Operatori i caktuar i shtetit të origjinës do të marrë përgjegjësinë për provën e identitetit.

3.3 Kërkesa për korrigjim të thjeshtë të adresës (pa ndryshimin e emrit ose statusit të marrësit) mund të bëhet direkt në zyrën e destinacionit nga ana e dërguesit. Tarifa e përshkruar në pikën 4 nuk do të mbledhet

në një rast të tillë.

3.4 Nëpërmjet njoftimit të Byrosë Ndërkombëtare, çdo operator i caktuar mund të parashikojë për kërkesat CK 17 në lidhje që do të shkëmbehet administratës qendrore, ose nëpërmjet një zyrë të caktuar posaçërisht. Ky njoftim duhet të përfshijë emrin e kësaj zyre.

3.5 Operatorët e caktuar që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes të parashikuar sipas 3.4 do të paguajë çdo tarifë që mund të rezultojë nga transmetimi në shërbimin e tyre të brendshëm me postë ose me telekomunikacion të komunikimit për t'u shkëmbyer me zyrën e destinacionit. Përdorimi i telekomunikacionin apo shërbim tjetër të ngjashëm do të jetë i detyrueshëm kur dërguesi ka përdorur vetë mjete të tilla dhe zyra e destinacionit nuk mund të njoftohet në kohë me anë të postës.

3.6 Nëse artikulli është ende në shtetin e origjinës, kërkesa do të trajtohet sipas legjislacionit të atij shteti.

4. Tarifat

4.1 Dërguesi do të paguajë, për çdo kërkesë, një tarifë të veçantë shuma maksimale e udhëzuesi për të cilën do të jetë 1.31 SDR.

4.2 Kërkesa duhet të përcillet me postë ose me telekomunikacion me shpenzimet e dërguesit. Kushtet e dërgimit dhe dispozitat që lidhen me përdorimin e telekomunikacionit janë përcaktuar në pikën 6 më poshtë.

4.3 Tarifat e përkrahura sipas pikave 4.1 dhe 4.2 do të vendosen vetëm një herë për çdo kërkesë për tërheqje nga posta apo ndryshimin apo korrigjim të adresës që përfshin disa artikuj të postuar në të njëjtën kohë, në të njëjtën zyrë, nga ana e dërguesit të njëjtë ndaj marrësit të njëjtë.

5. Transmetimi i kërkesës me postë

5.1 Nëse kërkesa duhet të dërgohet me postë, formulari CN 17, i shoqëruar, nëse është e mundur, nga një faksimile i përsosur i zarfit ose adresës së artikullit, do të dërgohet direkt në zyrën e destinacionit me rekomandë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

5.2 Nëse kërkesat janë shkëmbyer nëpërmjet administratës qendrore, një kopje e kërkesës, në raste emergjente, mund të dërgohet direkt nga zyra e origjinës në zyrën e destinacionit. Do të vepohet menjëherë për kërkesat e dërguara direkt. Artikujt në fjalë nuk do të dorëzohen deri në mbërritjen e kërkesës nga administrata qendrore.

5.3 Me marrjen e formularit CN 17, zyra e destinacionit duhet të kërkojë për artikullin në fjalë dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

5.4 Veprimi i ndërmarrë nga zyra e destinacionit për çdo kërkesë për tërheqje nga posta apo ndryshim apo korrigjim të adresës do të komunikohet menjëherë në zyrën e origjinës me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore), duke përdorur një kopje të formularit CN17 me pjesën "Përgjigje e zyrës së destinacionit" të plotësuar siç duhet. Zyra e origjinës do të informojë aplikuesin. E njëjta do të zbatohet në rrethanat e mëposhtme:

5.4.1 Kërkime të pafrytshme;

5.4.2 artikuj të dorëzuar të marrësi;

5.4.3 artikujt e konfiskuar, të shkatërruar ose të sekuestruar.

5.5 Një artikull jo-me prioritet apo me rrugë tokësore do të kthehet në origjinë me prioritet apo me rrugë ajrore pas një kërkesë për tërheqje nga posta, kur dërguesi merr përsipër të paguajë diferencën përkatëse postare. Kur një artikull është ri-dërguar me prioritet ose me rrugë ajrore, pas një kërkesë për ndryshim apo korrigjim të adresës, diferenca e postimit që i korrespondon rrugës së re do të merret nga marrësit dhe mbahen nga operatori i caktuar dorëzues.

6. Transmetimi i kërkesës me telekomunikacion

6.1 Në qoftë se kërkesa duhet të bëhet me telekomunikacion, formulari CN 17 duhet të dorëzohet në shërbimin përkatës për transmetimin e të dhënave në zyrën postare të destinacionit. Dërguesi do të paguajë tarifën përkatëse për këtë shërbim.

6.2 Me marrjen e mesazhit me mjete të telekomunikacionit, zyra e destinacionit duhet të kërkojë për artikullin në fjalë dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

6.3 Çdo kërkesë për ndryshim ose korrigjim në adresë që ka të bëjë me një artikull të siguruar e bërë me anë të telekomunikacionit do të konfirmohet me postë, me dërgesën e parë, siç përshkruhet në formularin CN 5.1. Formulari CN17 do të ketë në krye, me shkronja të theksuara, shënimin "Confirmation de la demande transmise par voie des télécommunications du ..." (Konfirmimi i kërkesës së bërë me telekomunikacion në datë ...); në pritje të këtij konfirmimi, zyra e destinacionit duhet thjeshtë të mbajë artikullin. Megjithatë, operatori i caktuar i destinacionit, në përgjegjësinë e tij, mund të veprojë me kërkesën e



bërë me telekomunikacion pa prituri për konfirmim me postë.

6.4 Në marrëdhëniet midis dy operatorëve të caktuar të shteteve që pranojnë këtë procedurë, dërguesi mund të kërkojë të informohet me mjete të telekomunikacionit për veprimet e ndërmarra nga zyra e destinacionit me kërkesën e tij. Ai do të paguajë tarifën përkatëse. Nëse janë përdorur telegrame, ai duhet të paguajë tarifën për një telegram, të llogaritur mbi një bazë prej pesëmbëdhjetë-fjalësh. Kur është përdorur teleksi, tarifat në ngarkim të dërguesit normalisht duhet të jenë në shumë të njëjtë me atë të tarifës për paraqitjen e kërkesës me anë të teleksit.

6.5 Nëse dërguesi i një kërkesë të dërguar me anë të telekomunikacionit ka kërkuar të njoftohet me mënyra të ngjashme, përgjigja do të dërgohet me këtë mjet në zyrën e origjinës. Ajo do të informojë aplikuesin sa më shpejt të jetë e mundur. E njëjta procedurë do të zbatohet nëse një kërkesë me anë të telekomunikacionit nuk është mjaftueshëm e qartë për të identifikuar me siguri artikujt.

Neni RC 144 Reklamime

1. Për koltë e pa siguruara dhe të siguruara do të bëhen reklamime të veçanta.

2. (Fshirë.)

3. Parime

3.1 Brenda periudhës kohore të përcaktuar në nenin 17 të Konventës, reklamimet do të pranohen sapa të jetë raportuar problemi nga ana e dërguesit ose marrësit. Megjithatë, kur një reklamim i dërguesit ka të bëjë me një koltë të pa dorëzuar dhe koha e parashikuar e transmetimit nuk ka përfunduar, dërguesi duhet të informohet për këtë kohë të transmetimit.

4. Përgatitja e kërkesës

4.1 Çdo reklamim do të përfshijë përgatitjen e formularit CN 08.

4.2 Formulari CN 08 duhet të shoqërohet, kur është e mundur, me një faksimile të adresës së artikullit. Formulari i reklamimit do të plotësohet me të gjitha detajet e kërkuara, duke përfshirë informacionin e detyrueshëm për tarifat e paguara, dhe në mënyrë shumë të lexueshme, mundësisht në shkronja të mëdha romake dhe shifra arabe, ose edhe më mirë, me karaktere të printuara.

4.3 Nëse reklamimi ka të bëjë me një artikull të paguar nga marrësi, do të shoqërohet gjithashtu me një dublikat të urdhër-pagesës TFP 3 të Rregullores së Marrëveshjes së Shërbimit të Pagesave Postare.

4.4 Një formular mund të përdoret për disa artikuj të postuar në të njëjtën kohë, në të njëjtën zyrë, nga ana e të njëjtit dërgues dhe të dërguar me të njëjtën rrugë tek i njëjti marrës.

4.5 Çdo operator i caktuar, duke njoftuar Byronë Ndërkombëtare, mund të kërkojë që reklamimet CN 08 në lidhje me shërbimin e tij ti përcillen administratës qendrore ose një ose më shumë zyrave posaçërisht të caktuara.

4.6 Operatori i caktuar i parë që merr formularin CN 08 dhe dokumentet shoqëruese nga një klient do të përfundojë në mënyrë të padiskutueshme reklamimet e tij brenda dhjetë ditëve dhe do t'i dërgojë formularin CN 08 dhe dokumentet shoqëruese operatorit të caktuar përkatës. Formulari dhe dokumentet do të kthehen tek operatori i caktuar që ka filluar hetimin sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se brenda dy muajve nga data e reklamimit fillestar ose, nëse rasti është raportuar me faks ose me mjete të tjera elektronike, brenda 30 ditëve nga data e reklamimit fillestar. Nëse kërkohet nga dërguesi, ato do të shoqërohen me deklaratën e marrësit të realizuar me një formular CN 18 dhe që vërteton mos marrjen e sendit të reklamuar. Pasi ka kaluar periudha përkatëse, operatorit të caktuar të origjinës duhet ti dërgohet një përgjigje me faks, e-mail ose ndonjë mjet tjetër të telekomunikacionit, me shpenzime të operatorit të caktuar të destinacionit.

4.7 Përgjigjet për reklamimet e dërguara me faks ose e-mail, kurdo që të jetë e mundur, duhet të dërgohen me të njëjtat mjete.

4.7bis Nëse dërguesi pohon se, pavarësisht nga vërtetimi i dorëzimit i operatorit të caktuar të destinacionit, marrësi pretendon se nuk e ka marrë artikullin e reklamuar, do të ndiqet procedura e mëposhtme. Me kërkesën e shprehur të operatorit të caktuar të origjinës, operatori i caktuar i destinacionit do të jetë i detyruar ti sigurojë dërguesit sa më shpejt të jetë e mundur dhe, jo më vonë se një periudhë prej 30 ditësh nga data e dërgimit të kësaj kërkesë, nëpërmjet operatorit të caktuar të origjinës, konfirmimin e dorëzimit me letër të njoftimit të dërgimit CN 07 apo ndonjë mjet tjetër, të nënshkruar në përputhje me nenin

RC 127.4.1, ose një kopje të nënshkrimit të pranimit apo ndonjë formë tjetër të provave të marrjes nga ana e pranuesit, në përputhje me nenin RC 116.2 ose RC 124.7.1.1.

5. Reklamime për koltë e zakonshme dhe të siguruara

5.1 Kur një reklamim ka të bëjë me koltë të zakonshme të shkëmbyera sipas sistemit të njoftimeve për sasi të mëdha, numri dhe data e dërgimit të postës do të regjistrohen në formularin e reklamimit CN 08. Formulari, kur është e mundur, duhet të dërgohet me faks ose e-mail, pa kosto shtesë për klientin, përndryshe reklamimi do të dërgohet me postë rekomande. Në rastin e fundit, formulari do t'i dërgohet automatikisht, pa një letër shoqëruese dhe gjithmonë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

5.2 Nëse kërkohet nga operatori i caktuar i origjinës ose operatori i caktuar i destinacionit, reklamimi do të përcillet direkt nga zyra e origjinës në zyrën e destinacionit.

5.3 Nëse, pas marrjes së reklamimit, administrata qendrore e shtetit të destinacionit ose zyra e caktuar posaçërisht të interesuara janë në gjendje të thonë se çfarë i ka ndodhur artikullit, ajo do të përfundojë pjesën të formularit CN 08 "Hollësi për t'u plotësuar nga shërbimi i destinacionit". Në rastet e dorëzimit të vonuar, arsyeja e mbajtjes ose kthimit në origjinë do të tregohen shkurtimisht në formularin CN 08.

5.4 Një operator i caktuar i cili nuk është në gjendje të përcaktojë as dorëzimin të marrësi as transmetimin korrekt tek një operator tjetër i caktuar, do të urdhërojë menjëherë hetimin e nevojshëm. Ajo do të shënojë në pjesën "Përgjigje përfundimtare" të formularit CN 08 vendimin e saj për përgjegjësinë.

5.5 Formulari CN 08, i plotësuar sipas rregullave të pikave 5.3 dhe 5.4, kur është e mundur, duhet të kthehet me faks ose e-mail ose me rrugën e shpejtë (ajrore ose tokësore) në adresën e zyrës e cilat e ka përgatitur atë.

5.6 Operatori i caktuar i origjinës do të dërgojë reklamimet për koltë e dërguara në transit à découvert në të njëjtën kohë edhe tek operatori i caktuar ndërmjetës dhe tek operatori i caktuar e destinacionit. Reklamimet rreth artikujve që përfshihen në dërgesa të mbyllura, të cilat kanë kaluar transit nëpërmjet një ose më shumë operatorëve të caktuar ndërmjetës, duhet në parim të trajtohen direkt midis shtetit të origjinës dhe shtetit të destinacionit përfundimtar. Megjithatë, operatori i caktuar i origjinës, në mënyrë që të përshpejtojë procesin e hetimit, mund ti kërkojë ndonjë operatori të caktuar ndërmjetës ti sigurojë informacionin e duhur të dërgimit.

5.6.1 Reklamimet e dërguara operatorëve të caktuar ndërmjetës siç tregohen në Përmbledhjen e Kolve Postare duhet të shoqërohen me një CN 37, CN 38 ose CN 41, sipas rastit. Kopjet mund të jenë elektronike ose fizike, sipas parimeve të përcaktuara në nenin RC 144.4.6.

5.6.2 Çdo operator i caktuar ndërmjetës i konsultuar do ti dërgojë formularin CN 08 operatorit të caktuar të radhës, dhe formularin CN 21 operatorit të caktuar të origjinës, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më larg se brenda një periudhe prej 10 ditësh.

5.7 (Fshirë.)

6. Reklamime rreth mos kthimit të njoftimit të dërgimit tek dërguesi

6.1 Në rastin e parashikuar në nenin RC 127.4.3 dhe në qoftë se një artikull është dorëzuar, operatori i caktuar i shtetit të destinacionit duhet të marrë nënshkrimin e personit që ka marrë artikullin në njoftimin e dërgimit CN 07 me fjalën "Dublikatë". Në bazë të dispozitave ligjore të shtetit të operatorit të caktuar që dërgon një njoftim dërgimi, në vend të marrjes së nënshkrimit në dublikatin të njoftimit të dërgimit, do të jetë gjithashtu i autorizuar të bashkëlidhë me formularin CN 07 një kopje të një dokumenti të përdorur në shërbimin e brendshëm me nënshkrimin e personit që ka marrë artikullin ose një kopje të nënshkrimit elektronik të vendosur pas dorëzimit të artikullit. Formulari CN 07 do të mbetet i bashkëlidhur me formularin e reklamimit CN 08 për dërgimin pasues të kërkuar.

7. Kërkesa për tu dorëzuar me telegram, me teleks ose me EMS

7.1 Nëse është bërë një kërkesë për transmetimin e një reklamimi me telegraf, në vend të formularit CN 08, do ti dërgohet një telegram operatorit të caktuar qendror të shtetit të destinacionit ose zyrës së caktuar posaçërisht të interesuar. Tarifat e telegrafit do të merren nga reklamuesi.

7.2 Nëse është bërë një kërkesë për transmetimin me EMS, tarifata e mbledhura normalisht për këtë shërbim mund të merren nga reklamuesi.

7.3 Në marrëdhëniet midis dy operatorëve të caktuar të shteteve që pranojnë këtë procedurë, dërguesi mund të kërkojë të njoftohet me telegram për veprimin e ndërmarrë në lidhje me reklamimin e tij. Në këtë rast, ai duhet të paguajnë tarifën për një telegram, të llogaritur mbi një bazë pesëmbëdhjetë-fjalëshe. Kur është përdorur teleksi, tarifa e marrë nga dërguesi do të jetë zakonisht një shumë e njëjtë me atë të tarifës për transmetim të reklamimit me teleks. Kostoja e përgjigjes të dërguar me mjete të tjera të telekomunikimit ose



me EMS, do të hiqet në mënyrë reciproke.

7.4 Nëse reklamim me telegram ose me teleks nuk përcakton se çfarë ka ndodhur me një artikull, reklamimi do të bëhet sërish me postë para se të konsiderohet dëmshpërblimi. Më pas do të përgatitet një formular CN 08 për trajtimin në pajtim me pikat 5.1 deri 5.7.

8. Nëse reklamimi ka të bëjë me një koli të postuar në një shtet tjetër, formulari CN 08 duhet t'i dërgohet operatorit të caktuar qendror apo zyrës së caktuar posaçërisht të operatorit të caktuar të origjinës së artikullit. Ai duhet të arrijë atje brenda periudhës së parashikuar për mbajtjen e dokumenteve. Certifikata e postimit duhet të prodhohet, por nuk do t'i bashkëngjitet formularit CN 08. Ky i fundit do të shënohet "Vu réceptionné de dépôt No le par le bureau de ". (vërtetuar, certifikata e postimit n , lëshuar më nga zyra e).

8bis Si alternativë për dërgimin e formularit të reklamimeve CN 08, operatorët e caktuar mund të zgjedhin të përdorin sistemin e përbashkët të reklamimit të bazuar në sistemin e reklamimit në Internet, ku në rastet e përfshirjes së artikujve me barkode, do të përdoren standardet e mëposhtme

8bis.1 Kërkesa e reklamimit: një kërkesë fillestare nga operatori i caktuar dërgues për operatorin e caktuar të destinacionit duke kërkuar për të dhëna nga sistemi i gjurmimit. Kjo do të kthehet brenda 12 orëve të punës kur është përdorur sistem i hetimit të përbashkët i bazuar në Internet ose komunikim me e-mail.

8bis.2 Kërkim i veçantë: në qoftë se kërkesa për reklamim është e pasuksesshme, operatori i caktuar dërgues mund të kërkojë kryerjen e një kontrolli nga operatori i caktuar i destinacionit, qendrat e shpërndarjes dhe zyrat në të cilat duhet të ketë kaluar artikulli për në destinacionin e tij. Kjo do të kthehet brenda 24 orëve të punës, kur është përdorur sistem i hetimit të përbashkët i bazuar në Internet ose komunikim me e-mail.

8bis.3 Hetim i plotë: nëse kërkimi i veçantë nuk arrin të lokalizojë artikullin, atëherë do të realizohet një kërkim më i mëtejshëm brenda 160 orëve të punës, pas së cilës operatori i caktuar i dërgimit të mund të dëmshpërblejë reklamuesin në të drejtë në emër të operatorit të caktuar të destinacionit. Operatori i caktuar përgjegjës duhet të japë elektronikisht një kod të përshtatshëm autorizimi. Nëse operatori i caktuar i destinacionit nuk kthehen kodin e autorizimit brenda kohës së përcaktuar ose në qoftë se informacioni i marrë nuk mund të konsiderohet si një përgjigje përfundimtare sipas kuptimit të nenit RC 151.1, operatori i caktuar dërgues do të dëmshpërblejë automatikisht reklamuesin në emër të operatorit të caktuar të destinacionit.

8ter Operatorët e caktuar do të nxiten të respektojnë objektivat e mëposhtme treguese në lidhje me përgjigjen në kohë për hetimet duke përdorur sistemin e përbashkët të hetimit të bazuar në Internet me operatorët e caktuar partnerë:

8ter.1 Nëse operatori vepron me sistem të gjurmimit dhe gjetjes, 95% mbi kohën e përgjigjes për hetimet në bazë të standardeve të përcaktuara në paragrafin 8bis të këtij neni; ose

8ter.2 Nëse nuk ka sistem të gjurmimit dhe gjetjes, 85% mbi kohën e përgjigjes në bazë të standardeve të përcaktuara në paragrafin 8bis të këtij neni.

8quater Këtij neni nuk mund ti bëhen rezervime në lidhje me periudhat e trajtimit dhe zgjidhjen e hetimeve të ndryshme nga kuadri i një marrëveshje dypalëshe.

KAPITULLI 5 ÇËSHTJE DOGANORE

Neni RC 145

Deklaratat doganore dhe zhdoganimi i kolive

1. Operatorët e caktuar nuk do të pranojnë asnjë përgjegjësi për deklaratat doganore. Plotësimi i deklaratave doganore do të jetë vetëm përgjegjësi e dërguesit. Megjithatë, operatorët e caktuar duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të informuar klientët e tyre se si të përmbushin formalitetet doganore, dhe në mënyrë specifike, për tu siguruar që deklaratat doganore CN 23 janë plotësuar në mënyrë të plotë në mënyrë për të lehtësuar zhdoganimin e shpejtë të artikujve.

2. Operatorët e caktuar do të ndërmarrin të gjitha hapat për të shpejtuar sa më shumë të jetë e mundur zhdoganimin e kolive të postës ajrore.

Neni RC 146

Tarifa e paraqitjes në Doganë

1. Shuma maksimale udhëzuesit për tarifën e paraqitjes në doganë referuar në nenin 18.2 të Konventës e cila mund të merret për kolitë e paraqitura për kontrollin doganor në vendin e origjinës do të jetë 0.65 SDR për koli.

2. Kolitë që i nënshtrohen kontrollit doganor në vendin e destinacionit do të jenë subjekt i pagesës maksimale të udhëzimit prej 3.27 SDR për koli në përputhje me nenin 18.2 të Konventës.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë, tarifat do të merren në kohën e dorëzimit të kolisë tek marrësi. Megjithatë, në rastin e kolive për dorëzim pa tarifa dhe pagesa, tarifa e paraqitjes në doganë do të merret nga operatori i caktuar i origjinës në emër të operatorit të caktuar të destinacionit.

Neni RC 147

Fshirja e detyrimit doganor dhe tarifa të tjera

1 Operatorët e caktuar do të angazhohen të kërkojnë nga autoritetet kompetente në shtetet e tyre anulimin e taksave (duke përfshirë detyrimet doganore) në rastin e një kolie:

1.1 të kthyer te dërguesi;

1.2 të ri – dërguar në një shtet i tretë;

1.3 të braktisur nga dërguesi;

1.4 të humbur në shërbimin e tyre ose shkatërruar për arsye të dëmtimit të plotë të përmbajtjes;

1.5 të vjedhur ose dëmtuar në shërbimin e tyre.

2. Në rastet e kolive të vjedhura ose të dëmtuara, anulimi i taksave do të kërkohej vetëm deri në vlerën e përmbajtjes të zhdukur apo të zhvlerësimit që i shkaktohet përmbajtjes.

KAPITULLI 6

PËRGJEGJËSIA E SHTETEVE ANËTARE OSE OPERATORËVE TË KAKTUAR

Neni RC 148

Zbatimi i përgjegjësisë së shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar

1. Parime

1.1 Përgjegjësia e operatorëve të caktuar do të jetë po aq e detyrueshme për kolitë e transportuara à découvert sa edhe për ato të dërguara me postë të mbyllur ose ato që kthehen pa paraqitur në koli asnjë arsye për mos-dorëzimin.

1.2 Operatorët e caktuar të cilët angazhohen të mbulojnë rreziqet që rrjedhin nga një rast i forcës madhore do të jenë përgjegjës ndaj dërguesit të kolive të postuara në shtetin e tyre për çdo humbje, vjedhje apo dëmtim për shkak të një rasti të forcave madhore që ndodh në çdo kohë gjatë transportit të kolive. Ky angazhim do të mbulojë çdo ri – dërgim ose të kthim te dërguesi.

1.3 Operatori i caktuar në shërbimin e të cilit ka ndodhur vjedhja, humbja, dëmtimi ose kthimi i pashpjegueshëm do të vendosë, në përputhje me ligjet e shtetit të tij, nëse humbja, vjedhja, dëmtimi ose kthimi i pashpjegueshëm ka ndodhur për shkak të rrethanave që të forcës madhore. Këto rrethana do t'i komunikohen operatorit të caktuar të shtetit të origjinës, nëse ky operator i caktuar e kërkon këtë.

1.4 Operatorët e caktuar që marrin pjesë në shkëmbimin e kolive COD do të jenë përgjegjës, deri në shumën e COD, për dërgimin e kolive COD pa mbledhjen e fondeve ose për mbledhjen e një shume më të ulët se shuma e COD. Operatorët e caktuar nuk marrin do të marrin asnjë përgjegjësi për vonesat që mund të ndodhin në mbledhjen dhe dërgimin e fondeve.

1.5 Me efekt nga 1 Marsi 2006, të gjitha pretendimet e përgjegjësisë do të kufizohen në koli të identifikuar nga një identifikues unik i artikujve në përputhje me standardet S10d (identifikimi i dërgesave postare me: Pjesa D: identifikuesi me 13-karakte për kolitë), botuar në Standardet Teknike të UPU-t.

2. Dëshmipërblime

2.1 Dëshmipërblimi i referuar në nenin 21.4.1 të Konventës nuk do të kalojë shumat e llogaritura duke kombinuar normën prej 40 SDR për kolitë e zakonshme dhe normën prej 4.50 SDR për kilogram. Do të shtohen taksat dhe tarifat e paguara për të postuar këtë artikull.

2.2 Operatorët e caktuar mund të bien dakord të aplikojnë, në marrëdhëniet e tyre reciproke, shumën prej 130 SDR për koli pavarësisht nga pesha.



2.2bis Shuma e dëmshpërblimit e referuar në nenin 21.4.2 të Konventës për një koli të zakonshme që është e shkatërruar pjesërisht ose e dëmtuar pjesërisht nuk duhet të kalojë shumat përkatëse të përmendura në paragrafin 2.1 ose në paragrafin 2.2, përkatësisht për koltë që janë humbur, plaçkitura tërësisht ose dëmtuar tërësisht.

2.3 Dëmshpërblimi për kthimin e pashpjeguar të një kolie postare duhet të jetë proporcional me tarifat e paguar nga dërguesi për të postuar kolinë në vendin e origjinës dhe tarifat që rrjedhin për kthimin e kolisë nga vendi i destinacionit.

Neni RC 149

Dërgimi i kolive të vjedhura ose dëmtuara

1. Zyra që realizon shpërndarjen e një kolie të vjedhur ose të dëmtuar do të përgatisë një raport CN 24 pas inspektimit të përbashkët dhe, kur është e mundur, do të marrë kundërfirmën nga marrësi. Një kopje duhet t'i dorëzohet marrësit ose, nëse kolia është refuzuar ose ri dërguar, do të bashkëlidhet asaj. Një kopje do të mbahet nga operatori i caktuar i cili ka përgatitur raportin.

2. Kur rregulloret e brendshme e kërkojnë këtë, një koli e trajtuar në përputhje me pikën 1, do t'i kthehet dërguesit, nëse marrësi refuzon të kundërfirmosë raportin CN 24.

3. Nëse kolia është dorëzuar, kopja raportit e CN 24 e përgatitur nga zyra e shkëmbimit, në përputhje me nenin RC 182.2 do të trajtohet në përputhje me rregullat e shtetit të destinacionit. Nëse kolia është refuzuar, kjo kopje do të mbetet bashkëlidhur me kolinë.

4. Nëse përgjegjësia e marrë sipas nenit 22.1 të Konventës duhet të ndahen me një operator tjetër të caktuar, kërkesa për këtë qëllim do të dërgohet atij me letër të shoqëruar nga një kopje ose një përkthim i raportit CN 24. Kur është e përshtatshme, një kopje e shënimit të verifikimit CP 78 të përmendur në nenin RC 179.4 do të bashkëlidhet në letër.

Neni RC 150

Caktimi i përgjegjësisë së dërguesit

1. Një operator i caktuar i cili konstaton dëm që është për faj të dërguesit, do të njoftojë operatorin e caktuar të origjinës, përgjegjësia e të cilit është ndërmarrja e veprimeve kundrejt dërguesit, nëse është rasti.

Neni RC 151

Pagesa e dëmshpërblimit

1. Operatori i caktuar i origjinës ose i destinacionit, sipas rastit, do të autorizohet të dëmshpërblejë reklamuesin në emër të operatorit të caktuar e cila, ka marrë pjesë në transport dhe ka qenë i informuar rregullisht, ka lejuar të kalojnë dy muaj dhe, nëse rasti është raportuar me faks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik me të cilin mund të konfirmohet marrja e reklamimit, 30 ditë, pa përfunduar zgjidhjen e çështjes, ose pa raportuar:

1.1 se dëmtimi duket të jetë shkaktuar nga një rast i forcës madhore;

1.2 se kolia është mbajtur, konfiskuar ose shkatërruar nga autoriteti kompetent për shkak të përmbajtjes së saj apo sekuestruar në bazë të legjislacionit të shtetit të destinacionit.

1bis Periudhat prej dy muajsh dhe tridhjetë ditësh të përcaktuara në pikën 1 do të fillojnë nga data në të cilën është plotësuar rregullisht nga operatori i të caktuar i origjinës formulari CN 08, duke përfshirë informacionin e nevojshëm në lidhje me transmetimin e dërgesave.

1ter Kjo klauzolë do të jetë e vlefshme vetëm nëse operatori i caktuar dërgon formularin CN 08 në adresën e saktë të operatorit të caktuar marrës si është shënuar në Përmbledhjen e Postës së Kolive apo përditësuar nga një Qarkore e Byrosë Ndërkombëtare.

1quater Operatori i caktuar i origjinës do të jetë i autorizuar të dëmshpërblejë reklamuesin në emër të operatorit të caktuar të destinacionit i cili, duke qenë i informuar sipas rregullave në lidhje me kërkesën e operatorit të caktuar të origjinës për të dhënë konfirmimin e dorëzimit të artikullin të reklamuar, të përmendura në nenin RC 144.4.7bis, ka lejuar të kalojnë 30 ditë, nga data e dërgimit të kësaj kërkesë nga operatori i caktuar i origjinës, pa iu përgjigjur një hetimi të dytë në lidhje me kryerjen e papërshtatshme të shërbimit.

2. Operatori i caktuar i origjinës ose i destinacionit, sipas rastit, do të autorizohet të shtyjë dëmshpërblimin e reklamuesit në rastet kur formulari i hetimit nuk është plotësuar si duhet, ose është i pasaktë dhe duhet të kthehet për informacione shtesë apo korrigjim, duke shkaktuar tejkalimin e afatit kohor të vendosur në pikën 1. Dëmshpërblimi mund të paguhet deri në fund të një periudhë shtesë prej dy muajsh nga data e plotësimit ose korrigjimit të formularit CN 08. Pa këtë informacion shtesë ose korrigjim, operatori i caktuar përkatës do të autorizohet që të mos dëmshpërblejë reklamuesin e ligjshëm.

3. Në rastin e një hetimi në lidhje me një artikull COD, operatori i caktuar i origjinës do të jetë i autorizuar të dëmshpërblejë reklamuesin deri në shumën e COD në emër të operatorit të caktuar të destinacionit e cila, pasi është informuar siç duhet, ka lejuar të kalojnë dy muaj pa zgjidhur përfundimisht çështje.

3bis Nuk mund të ketë rezerva të këtij neni në lidhje me periudhat për trajtimin dhe zgjidhjen e reklamimeve dhe periudhën dhe kushtet e pagesës së dëmshpërblimit dhe kompensimin e operatorëve të caktuar pagues, përveç se në kuadër të një marrëveshje dypalëshe.

Neni RC 152

Periudha për pagesën e dëmshpërblimit

1. Pagesa e dëmshpërblimit do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe, më së voni brenda një periudhe prej tre muajsh nga dita që pason ditën e reklamimit.

1bis Nuk do të ketë rezerva të këtij neni në lidhje me periudhën për pagesën e dëmshpërblimit, përveç se në kuadër të një marrëveshje dypalëshe.

2. (Fshirë.)

Neni RC 153

Pagesa automatike e dëmshpërblimit

1. Kthimi i një formulari CN 08 në të cilin seksionet "Të dhënat që do të jepen nga shërbimet ndërmjetëse ose nga shërbimet e destinacionit", "Të dhënat që do të jepen nga shërbimi i destinacionit" dhe "Përgjigja Përfundimtare" nuk i janë plotësuar nuk do të konsiderohet si një përgjigje përfundimtare sipas kuptimit të nenit RC 151.1.

2. (Fshirë.)

Neni RC 154

Përcaktimi i përgjegjësisë ndërmjet operatorëve të caktuar

1. Derisa provohet e kundërta, përgjegjësia do të jetë e operatorit të caktuar i cili ka marrë artikuj pa raportuar një mospërputhje me anë të një shënimi të verifikimit CN 43 dhe / ose një shënimi të verifikimit CP 78, ose një fature të dorëzimit CN 37, CN 38 ose CN 41, në kohën e marrjes së dërgesës, me të cilën është dërguar artikulli, dhe që duke pasur të gjitha mjetet e caktuara të reklamimit, nuk mund të provojë nëse dorëzimi tek marrësi ose, sipas rastit, transferimin korrekt tek një operator tjetër i caktuar.

2. Nëse humbja, vjedhja ose dëmtimi ndodh në kohën e transportit pa qenë e mundur të vendoset në territorin e cilit shtet ose shërbim ka ndodhur kjo gjë, operatorët e caktuar të interesuar do të mbartin humbjen në mënyrë të barabartë. Megjithatë, në rastin e një kolie të pasiguar, kur shuma e dëmshpërblimit nuk e kalon shumën e llogaritur në nenin 21.4.1 të Konventës për një koli prej një kilogrami, kjo shumë do të përballohet në mënyrë të barabartë nga operatori i caktuar i origjinës dhe operatorët e caktuar të destinacionit, ndërsa operatorët e caktuar ndërmjetës do të përjashtohen.

3. Për sa i përket artikujve të siguar, përgjegjësia e një operatori të caktuar ndaj operatorëve të tjerë të caktuar në asnjë rast nuk do të kalojë vlerën maksimale të siguar që ajo ka miratuar.

4. Operatorët e caktuar që nuk ofrojnë shërbimin e artikujve të siguar do të marrin, në lidhje me këta artikuj të transportuar me postë të mbyllur, përgjegjësinë e përcaktuar për artikujt rekomandë dhe/ose për kolitë e pasiguar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur operatorët e caktuar nuk pranojnë përgjegjësi për artikujt e siguar të transportuar në bordin e anijeve ose avionëve të përdorur prej tyre.

5. Nëse humbja, vjedhja ose dëmtimi i artikullit të siguar ndodh në territorin apo shërbimin e një operatori të caktuar ndërmjetës i cili nuk siguron shërbimin e artikujve të siguar, operatori i caktuar i origjinës do të përballë ketë humbje që nuk mbulohet nga operatori i caktuar ndërmjetës. I njëjti rregull



zbatohet në qoftë se shuma e dëmit është më e lartë se vlera maksimale e siguruar e miratuar nga operatori i caktuar ndërmjetës.

6. Taksa doganore dhe detyrime të tjera për të cilat nuk është mundur të sigurohet anulimi do të përballohen nga operatori i caktuar përgjegjës për humbjen, vjedhjen apo dëmtimin.

7. Një operator i caktuar i cili ka paguar dëmshpërblim duhet të marrë të drejtat e personit i cili e ka marrë atë, deri në shumën e dëmshpërblimit, në çdo veprim që mund të merret kundër marrësit, dërguesit ose palëve të treta.

Neni RC 155

Procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë të operatorëve të caktuar

1. Derisa të provohet e kundërta dhe subjekt i nenit RC 154.2, një operator i caktuar ndërmjetës apo operator i caktuar i destinacionit do të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë:

1.1 kur ai ka respektuar dispozitat për inspektimin e artikujve dhe kolive dhe përcaktimin e parregullsisë;

1.2 kur ai mund të provojë se ai u informua për reklamimin pas shkatërrimit të dhënave zyrtare që lidhen me kolinë në fjalë dhe periudha e mbajtjes ka përfunduar. Kjo rezervë nuk do të cenohet të drejtat e reklamuesit.

2. Nëse vjedhja ose dëmtimi është kryer në shtetin e destinacionit ose, në rastin e kthimit të dërguesit, në shtetin e rezidencës, operatori i caktuar i atij shteti duhet të provojë:

2.1 se as ambalazhimi as mbërthimi i kolisë nuk ka ndonjë gjurmë të dukshme të vjedhjes ose dëmtimit;

2.2 në rastin e një kolie të siguruar, se pesha e caktuar në kohën e postimit nuk ka ndryshuar;

2.3 në rastin e kolive të dërguara në kontenier të mbyllur se, edhe kontenieri edhe paketimi janë të pa prekura.

3. Kur është dhënë prova e përmendur në pikën 2, asnjë nga operatorët e tjerë të caktuar të interesuar nuk mund të hedhin poshtë pjesën e tyre të përgjegjësisë për arsye se kolia është dorëzuar pa asnjë kundërshtim nga operatori tjetër i caktuar.

4. Në rastin e kolive të dërguara në sasi të mëdha, asnjë nga operatorët e caktuar të interesuar nuk mund të hedhin poshtë pjesën e tyre të përgjegjësisë, duke treguar se numri i kolive të gjetura në postë ndryshon nga ai i njoftuar në faturën e kolisë.

5. Në rastin e transmetimit në sasi të mëdha, operatorët e caktuara në fjalë mund të bien dakord që përgjegjësia të ndahet në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtim të kategorive të caktuara të kolive, të përcaktuara me marrëveshje të përbashkët.

6. Kur një koli ka humbur, është vjedhur apo dëmtuar si rezultat i forcës madhore, operatori i caktuar në shërbimin ose territorin juridik të të cilëve ka ndodhur dëmi nuk do të jetë përgjegjës ndaj operatorit të caktuar të origjinës nëse dy operatorët e caktuar angazhohen të mbulojnë rreziqet e forcës madhore.

Neni RC 156

Rikuperimi i dëmshpërblimeve të paguara nga transportuesit ajrorë

1. Kur humbja, vjedhja apo dëmtimi ndodhin në shërbimin e një transportuesi ajror, operatori i caktuar i shtetit i cili mbledh detyrimet e transportit do të rimbursojë operatorin e caktuar të origjinës për dëmshpërblimin e paguar dërguesit. Operatori i caktuar i mëparshëm duhet të kompensojë këtë shumë nga transportuesi ajror në fjalë. Kur operatori i caktuar i origjinës shlyen detyrimet e transportit të drejtpërdrejtë me transport ajror, do të kërkojë vetë rimbursimin e dëmshpërblimit nga transportuesi ajror.

Neni RC 157

Rimbursimi i dëmshpërblimeve për operatorët e caktuar pagues

1. Operatori i caktuar i cili është përgjegjës ose për llogari të të cilit është bërë pagesa duhet ti rimbursojë operatorin e caktuar pagues shumën e dëmshpërblimit, detyrimet dhe tarifat e paguara për

reklamuesit sipas informacionit të detyrueshëm të dhënë në formularin CN 08. Rimbursimi do të bëhet brenda dy muajve nga data e dërgimit të njoftimit të pagesës.

2. Në qoftë se dëmshpërblimi, tarifat dhe taksat e paguara që u rimbursohen reklamuesve janë shkaktuar nga disa operatorë të caktuar, i gjithë dëmshpërblimi, pagesat dhe tarifat e paguara të cilat u rimbursohen reklamuesve do ti paguhen operatorit të caktuar pages, brenda periudhës së përmendur në pikën 1, nga operatori i caktuar i parë, i cili pasi ka marrë siç duhet kolinë e reklamuar, nuk është në gjendje të provojë transferimin e tij korrekt në shërbimin pasardhës. Operatori i caktuar duhet të kompensojë nga operatorët e caktuar të tjerë të cilët janë përgjegjës, secilit pjesën e tij të dëmshpërblimit të paguar reklamuesit.

3. Operatori i caktuar përgjegjësia e të cilit është caktuar në mënyrë të rregullt dhe që në fillim nuk ka pranuar të paguajë dëmshpërblim do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet shtesë që rezultojnë nga vonesa të pajustificuara në pagesë.

Neni RC 158

Shlyerja e dëmshpërblimeve ndërmjet operatorëve të caktuar

1. Në qoftë se, një vit pas datës së dërgimit të autorizimit për të paguar dëmshpërblimin, operatori i caktuar pages nuk ka debituar llogarinë e operatorit të caktuar përgjegjës, autorizimi do të konsiderohet pa forcë ligjore. Operatori i caktuar i cili e ka marrë, nuk do të ketë më të drejtë të kërkojë rimbursimin e çfarëdo dëmshpërblimi të paguar.

2. Kur është pranuar detyrimi, si edhe në rastin e parashikuar në nenin RC 151.1, shuma e dëmshpërblimit mund të mbulohet automatikisht nga operatori i caktuar përgjegjës. Kjo do të bëhet nëpërmjet një llogarie të likuidimit, ose direkt ose nëpërmjet ndërmjetësimit të një operatori të caktuar i cili tërheq rregullisht llogaritë e likuidimit me operatorin e caktuar përgjegjës.

4. Nëse dërguesi apo marrësi marrin në dorëzimin artikullin që gjendet pas pagimit të shumës së dëmshpërblimit, kjo shumë do ti kthehet operatorit të caktuar ose, sipas rastit, operatorëve të caktuar që mbartin humbjen. Ky rimbursim do të bëhet brenda një viti nga data e kësaj shlyerje.

5. Operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit mund të bien dakord që e gjithë humbja të përballohet nga operatori i caktuar që do ti bëjë pagesën reklamuesit.

6. Operatori i caktuar kreditor do të rimbursohet në përputhje me rregullat për pagesën e përcaktuar në nenet RC 207 dhe RC 208.

Neni RC 159

Kontabilizimi i shumave të detyruara në lidhje me dëmshpërblimin e kolive

1. Kur është e nevojshme të rimerret pagesa nga operatorët e caktuar përgjegjës dhe janë të përfshira disa shuma, ato do të përmbledhen në një formular CN 48. Shuma totale do të bartet në llogarinë CP 75 të përmendur në nenin 203.3 RC.

1bis Në rastin e mosmarrëveshjeve për kërkesat e kompensimit që nuk lidhen me nenin RC 151, të marra nëpërmjet formularit CN 48, operatori i caktuar dërgues, me kërkesë, do të japë prova për të mbështetur pretendimin e tij, duke përfshirë një kopje të të dy anëve të formularëve të duhur CN 08 kur nuk është përdorur Sistemi i Hetimit i bazuar në Internet

KAPITULLI 7

PROCEDURAT NË LIDHJE ME TRANSMETIMIN, ITINERARIN DHE MARRJEN E KOLIVE

Neni RC 160

Parime të përgjithshme të shkëmbimit të kolive

1. Operatorët e caktuar mund të shkëmbejnë, midis një ose më shumë prej tyre, dërgesa të mbyllura, si dhe koli à découvert sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimit.

2. Kur rrethanat e jashtëzakonshme e detyrojnë një operator të caktuar të pezullojë përkohësisht shërbimet e tij, tërësisht ose pjesërisht, ajo menjëherë do të informojë operatorët e caktuar të interesuara.

3. Kur transportimi i kolive në transit përmes një vendi bëhet pa pjesëmarrjen e operatorit të caktuar atij vendi. Kjo formë e transit nuk do të përfshijë përgjegjësinë e shtetit anëtar ose operatorit të caktuar të shtetit transit.

4. Operatorët e caktuar mund të dërgojnë koli të transportit tokësor me rrugë ajrore, me prioritet të



reduktuar. Operatori i caktuar i destinacionit do të tregojë, duke siguruar një regjistrim të përshtatshëm në Përmbledhjen e Informacionit të Postës së Kolive, detajet e zyrës së shkëmbimit ose aeroportin e destinacionit që do të pranojë koli të tilla.

5. Çdo operator i caktuar duhet të deklarojë në çfarë kushtesh ai pranon koli në transit për shtetet për të cilat ai mund të veprojë si ndërmjetës. Për këtë qëllim, ai do të përdorë tabelat CP 81 dhe CP 82. Këto do të tregojnë, në veçanti, tarifat që do të caktohen për këtë.

6. Përmbledhja zyrtare e Informacionit me interes të përgjithshëm në lidhje me realizimin e shërbimit postar të kolive, jep detaje mbi shkëmbimin e kolive.

7. Mbi bazën e këtij informacioni dhe tabelave CP 81 dhe CP 82 të operatorëve të caktuar ndërmjetës, çdo operator i caktuar do të vendosë për rrugët që do të përdoren për transmetim e kolive të saj. Këto të dhëna gjithashtu mundësojnë që ai të caktojë tarifat që do të mblidhen nga dërguesi.

8. Operatorët e caktuar do të dërgojnë tabelat CP 81 dhe CP 82 drejtpërdrejtë për njëri-tjetrin, të paktën një muaj para hyrjes në fuqi të tyre. Ata do të dërgojnë kopje të tyre për Byronë Ndërkombëtare. Ndryshimet e mëvonshme të këtyre tabelave do të shpallen në të njëjtën mënyrë. Afati i njoftimit nuk do të zbatohet për rastet e përmendura në nenin RC 194.1.

9. Çdo operator i caktuar do të dërgojë kolitë që i janë transferuar atij nga një operator tjetër i caktuar për transit nëpër territorin e tij nga rrugët dhe mjetet që ai përdor për kolitë e veta.

10. Në rastin e ndërprerjes të një rruge të përshkruar, kolitë në transit do të dërgohen me anë të rrugës më të mirë të disponueshme.

11. Nëse përdorimi i rrugëve të reja të dërgimit ka kosto më të mëdha (tarifa shtesë tokësore dhe detare), operatorët e caktuar të transitit do të veprojnë në përputhje me nenin RC 194.1

12. Transit i do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara nga kjo Rregullore, edhe kur operatori i caktuar i origjinës ose i destinacionit të kolive nuk merr pjesë në shërbimin postar të kolive.

13. Në marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të caktuar të shteteve të ndara nga një ose më shumë territore ndërmjetës, kolitë do të ndjekin rrugët për të cilat kanë rënë dakord operatorët e caktuar të interesuar.

14. Çdo operator i caktuar që ofron shërbimin e kolive me transport ajror do të dërgojë me rrugët ajrore që përdor për artikujt e tij të këtij lloji, kolitë me transport ajror që i janë dërguar atij nga një operator tjetër i caktuar. Nëse dërgimi i kolive me transport ajror nga një rrugë tjetër ofron avantazhe mbi rrugët ajrore ekzistuese, kolitë me transport ajror do të dërgohen me atë rrugë.

15. Operatorët e caktuar të cilët nuk marrin pjesë në shërbimin e kolive me transport ajror do të dërgojnë këto koli nga itineraret ajrore që ata përdorin për transportin e korrespondencës së postës të tyre ajrore. Në mungesë të një linjë ajrore, kolitë me transport ajror do të dërgohen nga këta operatorë të caktuar me anë të rrugës tokësore që përdoret zakonisht për kolitë e tjera.

16. Shkëmbimi i dërgesave të kolipostës do të bëhet nga zyrat e quajtura "zyra të shkëmbimit". Sa herë që një zyrë e shkëmbimit duhet të specifikohet në një formular të postës, kjo do të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Standardet Teknike të UPU-t S34 (Regjistrimi i Qendrave Ndërkombëtare të Përpunimit të Postës). Kjo përfshin:

16.1 emri i zyrës së shkëmbimit;

16.2 emri i operatorit të caktuar përgjegjës për zyrën e shkëmbimit;

16.3 në identifikuesit e barkodeve: kodi S34 do të identifikojë zyrën e shkëmbimit.

17. Operatorët e caktuar që të dërgojnë më shumë se 100 ton koli në vit, dhe të gjitha operatorët e caktuar të tjerë duhet që të nxiten të:

17.1 identifikojnë kontenierët duke përdorur identifikuesin e përmbajtjes së kontenierëve S9 të standardeve të UPU-t;

17.2 të përfshijnë identifikuesin S9 në etiketën e kontenierit në përputhje me S29;

17.3 të paralajmërojnë me mënyrë elektronike të gjitha dërgesat e jashtme duke përdorur mesazhe në përputhje me standardet e UPU-t që specifikojnë përdorimin e identifikuesit të përmbajtjes së kontenierëve S9 në çdo dërgesë;

17.4 të konfirmojnë në mënyrë elektronike marrjen e kontenierëve të brendshëm, që është paralajmëruar, duke përdorur përgjigjen në përputhje me standardet e UPU-t dhe / ose mesazhet e raportimi të ngjarjeve.

17bis Kërkesat e vëllimit do të kenë reduktime progresive vjetore për të lejuar të gjithë operatorët e

caktuar të përmbushin këto standarde. Vëllimi do të reduktohet në 75 ton të kolive në fillim të vitit në 2011, 50 ton të kolive që nga viti 2012, dhe 25 ton të kolive që nga viti 2013.

18. Të gjitha zyrat e shkëmbimit do të regjistrohen në listën e kodeve të Qendrës së Përpunimit Ndërkombëtar të Postës nga operatori i caktuar përgjegjës për atë zyrë. Kjo listë publikohet në faqen e internetit të UPU-t.

19. Në çdo formular, një zyrë e shkëmbimit do të identifikohet me emrin e saj, së bashku me emrin e operatorit të caktuar përgjegjës, siç publikohet në listën e sipërpërmendur të kodeve.

20. Në identifikuesit e barkodeve, Kodi S34 do të përdoret për të identifikuar një zyrë të veçantë të shkëmbimit. Operatorët e caktuar duhet të mbajnë një listë të operatorëve përgjegjës për çdo kod në bazën e tyre të dhënave.

Neni RC 161

Zbatimi i barkodit dhe specifikimet

1. Të gjithë operatorët e caktuar do të aplikojnë barkodet në të gjitha koltë postare ndërkombëtare të jashtme (p.sh. ajrore, S.A.L, tokësore). Specifikimet do të jetë si më poshtë:

1.1 Çdo koli duhet të identifikohet me një identifikues unik të artikullit në përputhje me standardet S10d (identifikimi i dërgesave postare: Pjesa D: identifikues me 13-karakte për koltë), siç publikohet në Standardet Teknike të UPU-t.

1.2 Identifikuesi i artikullit gjithashtu duhet të përfaqësohet nga një barkod në përputhje me standardet S10d (identifikimi i dërgesave postare me: Pjesa D: identifikues me 13-karakte për koltë), siç publikohet në Standardet Teknike të UPU-t.

1.2bis Operatorët e caktuar të origjinës do të aplikojnë vetëm një barkod standard S10d të UPU-t (identifikimi i dërgesave postare - Pjesa D: identifikues me 13-karakte për koltë) për koltë e dërguara në shtete të tjera.

1.2ter Në rastet kur operatorët e caktuar ndërmjetës dhe të destinacionit etiketojnë përsëri koltë me një etiketë të barkodit, ata do të kenë mundësi të:

1.2ter.1 të vendosë një etiketë tjetër të barkodit S10d e cila do të kopjojë identifikuesin unik origjinal të artikullit të operatorit të caktuar; ose

1.2ter.2 të vendosë një etiketë tjetër të barkodit e cila nuk do të mbulojë barkodin origjinal të operatorit të caktuar.

1.2quater Në rastet kur një koli nuk mund të dorëzohet dhe duhet të kthehet tek operatori i caktuar i origjinës, çdo barkod S10d i vendosur që nuk është identik me identifikuesin unik të operatorit të caktuar të origjinës për artikullin do të hiqet ose fshihet. Operatori i caktuar që kthen do të sigurohet se adresa e dërguesit nuk është mbuluar nga ndonjë etiketë e mbivendosur.

1.3 Operatorët e caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme për përdorimin e identifikuesit unik dhe barkode të artikujve të cilët janë tashmë në përdorim në koltë ndërkombëtare.

1.4 Operatorët caktuar mund të bien dakord në mënyrë të dyanshme për përdorimin e targave të cilat përputhen me Standardin S26 (Targat për koltë), siç botuar në Standardet Teknike të UPU-t.

2. (Fshirë.)

Neni RC 161bis

Gjurmimi dhe gjetja – Specifikime të artikujve dhe njoftimit

1. Operatorët e caktuar që përdorin një sistem të gjurmimit dhe gjetjes duhet të angazhohen të japin informacioni për gjurmimin dhe gjetjen duke përdorur mesazhin e standardeve M17 të UPU-t – versioni EMSEVT 1.0 për koltë në dalje dhe në hyrje në territorin e tyre kombëtar dhe do të sigurojë që të dhënat janë shkëmbyer me të gjithë operatorët e caktuar partnerë për ndjekjen e ngjarjeve të mëposhtme të gjurmimit dhe elementët e të dhënave të lidhura me të:

1.1 Ngjarje të gjurmimit të detyruara:

Ngjarja

1.1.1 EMC

Përshkrimi

Nisje nga jashtë
zyrës së shkëmbimit

Elementet e të dhënave

Identifikimi i artikullit
Shteti i destinacionit
Data e ngjarjes



			Koha e ngjarjes Zyra e shkëmbimit
1.1.2	EMD	Mbërritja në një zyrë të	Identifikuesi i artikullit brendshme të shkëmbimit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e shkëmbimit
1.1.3	EMH	Tentuar/Identifikuesi i artikullit Dorëzime të pasuksesshme	Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra (Dërgimi) Kodi i dorëzimit të pasuksesshëm
1.1.4	Dhe/ ose EMI	Dorëzimi Përfundimtar	Identifikimi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra (Dërgimi)
1.2		Gjurmimi fakultativ i ngjarjes	
Ngjarja		Përshkrimi	Elementet e të dhënave
1.2.1	EMA	Postimi/Mbledhja	Identifikimi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e origjinës
1.2.2	EMB	Mbërritja në Zyrën e jashtme të shkëmbimit	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e Shkëmbimit
1.2.3	EME	Mbajtur nga Doganat	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e Shkëmbimit Kodi i mbajtjes
1.2.4	EMF	Nisur nga zyra e brendshme e shkëmbimit	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e Shkëmbimit
1.2.5	EMG	Mbërritja në zyrë e dorëzimit	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e dorëzimit

1.2.6	EMJ	Mbërritja në zyrën e shkëmbimit të transitit	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e shkëmbimit (transit)
1.2.7	EMK	Nisja nga zyra e shkëmbimit transit	Identifikuesi i artikullit Shteti i destinacionit Data e ngjarjes Koha e ngjarjes Zyra e shkëmbimit (transit)

1.2.8 Kapja dhe transmetimin i ngjarjeve EMF do të jetë i detyrueshëm kur është kapur dhe transmetuar ngjarja EME, me përjashtim të rastit kur dispozitat qeveritare dhe dispozitat ligjore të detyrueshme e parandalojnë këtë.

2. Të gjithë operatorët e caktuar do të kapin dhe shkëmbejnë informacionet e faturës së dërgimit në përputhje me mesazhet të standardit M14 të UPU-t - PREDES versioni 2.0 dhe M13 - RESDES version 1.1 duke përfshirë elementet e të dhënave të mëposhtme:

2.1 Kërkesat e elementeve të të dhënave PREDES versioni 2.0

Përshkrimi

2.1.1 Identifikimi i dërgesës

Të dhënat e elementeve

Zyra e origjinës
Zyra e destinacionit
Kategoria e dërgesës
Klasa e dërgesës
Viti i dërgesës
Numri serial i dërgesës
Data e mbylljes së dërgesës
Koha e mbylljes së dërgesës
Kodi i agjencisë së transportit
Lloji i kontenierit
ID i kontenierit
Numri i kontenierit në dërgesë
ID e artikullit

2.2 Kërkesa të elementeve të të dhënave RESDES versioni 1.1

Përshkrimi

2.2.1 Identifikimi i dërgesës

Të dhënat e elementeve

Zyra e origjinës
Zyra e destinacionit
Kategoria e dërgesës
Klasa e dërgesës
Viti i dërgesës
Numri serial i dërgesës
Kodi i agjencisë së transportimit
Lloji i kontenierit
ID i kontenierit
Njehsimi i kontenierit të artikullit

2.2.2 Informacion i Transportit

2.2.3 Informacione të kontenierit



2.2.4 Informacione të ngjarjes

Kodi i kontenierit të ngjarjes
Data e Kontenierit të ngjarjes
Koha e kontenierit të ngjarjes

2.3 Operatorët e caktuar mund të bien dakord reciprokisht për të përdorur mesazhet e UPU-t M36b PREDES versioni 3 për transmetimin e informacionit të para-dërgimit.

RC 161ter

Gjurmimi dhe gjetja – Objektivat treguese për kohët e transmetimit

1. Operatorët e caktuar do të përpiqen të respektojnë objektivat e mëposhtme që lidhen me transmetimin e informacionit ngjarjes së artikullit nga koha e ngjarjes aktuale në transmetimin e këtij informacioni tek operatorët e caktuar partnerë:

1.1	EMC	Nisja nga zyra e shkëmbimit për jashtë	Brenda kalimit të 48 orëve
1.2	EMJ	Mbërritja në zyrën e shkëmbimit transit	Brenda kalimit të 48 orëve
1.3	EMK	Largimi nga zyra e shkëmbimit transit	Brenda kalimit të 48 orëve
1.4	EMD	Mbërritja në zyrën e shkëmbimit të brendshme	Brenda kalimit të 48 orëve
1.5	EME	Mbajtja nga Doganat	Brenda kalimit të 48 orëve
1.6	EMF	Largimi nga zyra e brendshme e shkëmbimit	Brenda kalimit të 48 orëve
1.7	EMH	Dorëzimi jo i suksesshëm	Brenda kalimit të 120 orëve
1.8	EMI	Dorëzimi Përfundimtar	Brenda kalimit të 120 orëve

2. Operatorët e caktuar në shkëmbimin e këtij informacioni me operatorët e caktuar partnerë do të përpiqen të respektojnë objektivat e mëposhtme në lidhje me transmetimin e informacionit të dërguar:

2.1	PREDES	Para-lajmërimi i dërgimit të informacionit	Brenda kalimit të 24 orëve
2.2	RESDES	Njoftimi i informacionit të faturës së dërgimit	Brenda kalimit të 48 orëve

RC 161quater

Gjurmimi dhe gjetja – Objektivat treguese të përfundimit të përfundimit të dhënave

1. Operatorët e caktuar nxiten të respektojnë objektivat e mëposhtme treguese në lidhje me transmetimin e informacionit të ngjarjeve të artikujve në shkëmbimin e këtij informacioni me operatorët e caktuar partnerë:

1.1 Nëntëdhjetë për qind e kolive që marrin një ngjarje EMC (nisje nga zyra e shkëmbimit) duhet të ketë një ngjarje EMD që transmetohet brenda 48 orëve nga koha dhe data e ngjarjes.

1.2 Nëntëdhjetë për qind e kolive që marrin një ngjarje EMD duhet të ketë një ngjarje EMH dhe / ose një ngjarje EMI që transmetohet brenda 120 orëve nga koha dhe data e ngjarjes.

Neni RC 162

Hapa që do të ndërmerren në rast të pezullimit të përkohshëm dhe rifillimi i shërbimeve

1. Nëse shërbimet janë pezulluar përkohësisht, operatori i caktuar ose operatorët e caktuar të interesuar duhet të njoftohen për faktin me anë të telekomunikacionit, duke treguar nëse është e mundur, kohëzgjatjen e mundshme të pezullimit të shërbimeve. E njëjta procedurë do të zbatohet kur shërbimet e pezulluara rifillojnë.

2. Byroja Ndërkombëtare duhet të njoftohet për pezullimin ose rinisjen e shërbimeve nëse konsiderohet i nevojshëm një njoftim i përgjithshëm. Nëse është e nevojshme, Byroja Ndërkombëtare do të njoftojë operatorët e caktuar me anë të telekomunikacionit.

3. Operatori i caktuar i origjinës do të ketë mundësinë e kthimit të tarifave postare, tarifave të veçanta dhe pagesave shtesë të transportit ajror për dërguesit në qoftë se, për shkak të pezullimit të shërbimeve, përfitimi që vjen nga transporti i artikullit në fjalë është marrë vetëm pjesërisht ose nuk është marrë.

Neni RC 163

Metoda të ndryshme të transmetimit

1. Shkëmbimi i dërgesave të kolive do të bëhet, si rregull i përgjithshëm, me anë të kontenierëve. Operatorët e caktuar fqinjë mund të bien dakord për dorëzimin e kategorive të caktuara të kolive të pambyllura.

2. Në shërbim në midis operatorëve të caktuar të shteteve jo-fqinje, shkëmbimi, si rregull i përgjithshëm, duhet të kryhet në postë të mbyllur.

3. Operatorët e caktuar mund të bien dakord të realizojnë shkëmbime në transit à découvert. Megjithatë, përgatitja e postave të mbyllura do të jetë e detyrueshme në qoftë se një operator i caktuar ndërmjetës deklaron se kolidet në transit à découvert, si të tilla, vështirësojnë punën e tyre.

4. Kolidet e transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.) do të shkëmbehen në kushtet e rëna dakord ndërmjet operatorëve të caktuar të interesuar.

Neni RC 164

Transmetimi me postë të mbyllur

1. Në rrethana normale të transmetimit në dërgesa të mbyllura, kontenierët (thasët, shporta, arka, etj) do të shënohen, mbyllen dhe etiketohen në mënyrën e përcaktuar më poshtë.

2. Përgatitja e thasëve

2.1 Dërgesat, duke përfshirë edhe ato të përbëra vetëm prej thasëve bosh, do të përfshihen në thasë, numri i të cilëve do të mbahet në minimum të rreptë. Thasët do të jetë në gjendje të mirë për të mbrojtur përmbajtjen e tyre. Çdo thes duhet të etiketohet.

2.2 Thasët do të mbyllen dhe vulosen, mundësisht me plumb. Vulat mund të jenë gjithashtu prej metali të lehtë apo plastike. Mbyllja do të bëhet në mënyrë që ata të mos mund të trajtohen ose ngacmohen pa lënë shenja të kësaj. Vendosijt e vulave do të kenë të shkruar, me shkronja shumë të lexueshme romake, emrin e zyrës së origjinës ose një tregues të mjaftueshëm për të identifikuar këtë zyrë. Megjithatë, nëse operatori i caktuar i origjinës dëshiron kështu, vendosjet e vulave mund të riprodhojnë vetëm një tregues të emrit të operatorit të caktuar të origjinës.

2.3 Për përgatitjen e kolive të transportit ajror, do të përdoren thasët tërësisht blu, ose me vija të trasha blu të hapur. Për të përgatitur postat tokësore ose postat e transportit brenda vendit me rrugë ajrore, do të përdoren thasët e transportit tokësor me një ngjyrë të ndryshme nga ajo e thasëve të postës ajrore (p.sh. ngjyrë bezhë, kafe, e bardhë, etj). Operatorët e caktuar të destinacionit megjithatë, duhet të kontrollojnë të gjitha etiketat e thasëve për të siguruar përpunimin korrekt.

2.4 Thasët do të tregojnë në mënyrë të lexueshme me shkronja romake zyrën ose vendin e origjinës dhe të kenë të shkruar fjalën "Postes" (Dërgesa) ose ndonjë shprehje tjetër të ngjashme që i dallon ato si dërgesa postare.

3. Etiketimi i dërgesave

3.1 Etiketat e thasëve do të përbëhen prej cope të sertë, plastike, kartoni të fortë, pergamene, ose prej letre të ngjitur në dru. Ato do të pajisen me një vrimë. Do të përdoren etiketat CP 83, CP 84 dhe CP 85 me ngjyrë të verdhë okër. Paraqitja e tyre dhe teksti do të përputhet me modelin e bashkëlidhur në këtë dokument. Pesha bruto e çdo thesi apo kontenieri pjesë të dërgesës do të tregohet në çdo etiketë përkatëse. Pesha do të rrumbullakoset deri në hektogramin më të afërt, ku fraksion i hektogramit është i barabartë ose më i madh se 50 gram dhe do të rrumbullakosen më pak deri në hektogramin më të afërt.

3.2 Etiketat ose adresat e kontenierëve të mbyllur që përmbajnë kolidet e transportit ajror do të kenë të shkruar treguesin apo etiketën "Par Avion" (me postë ajrore).

3.3 Përveç kësaj, mund të përdoret një mbyllje e veçantë për kolidet të ndryshme nga thasët, me kusht



që përmbajtja të jetë e mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme.

4. Zyrat ndërmjetëse nuk do të vendosin numër serial në etiketat e thasëve ose kolive të postës së mbyllur në transit .

5. Kolitë e siguruara do të dërgohen në kontenierë të veçantë. Në rast të dërgimit në thasë të njëjtë me kolitë e pasiguruara, kolitë e siguruara do të vendosen në një kontenier të brendshëm të vulosur me qiri apo plumb. Thasët e jashtëm që përmbajnë kolitë e siguruara duhet të jenë në gjendje të mirë. Nëse është e mundur, do të pajiset në skajin e fillimit të saj me tub duke e bërë të pamundur hapjen e thesit në mënyrë të paligjshme pa lënë gjurmë të dukshme. Kontenierët që përmbajnë kolitë e siguruara, vetëm ose së bashku me kolitë e pasiguruara, do të shënohen me shkronjën V.

6. Kolitë delikate gjithashtu duhet të dërgohen në kontenierë të veçantë. Ato do të pajiset me etiketën e referuar në nenin RC 129.5.1.

7. Kolitë ekspres do të dërgohen në kontenier të veçantë, nëse numri i tyre e justifikon këtë. Kontenierët që përmbajnë vetëm një ose disa koli të tilla do të mbajë etiketën ose treguesin "Exprès" (Ekspres).

8. Kolitë COD do të dërgohen në kontenierë të veçantë, nëse numri i tyre e justifikon këtë. Kontenierët që përmbajnë vetëm koli COD do të mbajnë etiketën ose treguesin "Remboursement" (COD).

9. Etiketa e kontenierit që përmban faturën e kolisë gjithmonë do të shënohet me një shënim shumë të qartë F. Me marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, mund të shënohen me numrin e thasëve që përbëjnë atë dërgesë dhe, nëse është e zbatueshme, numrin e kolive të dërguara à découvert.

10. Kolitë e rënda, kolitë e brishta, apo natyra e të cilave kërkon ajo mund të dërgohet e pa mbyllur; me qëllim për të përcaktuar dërgesën pjesë e të cilës ato janë, këto koli do të pajisen me një etiketë CP 83 ose CP 84. Etiketat e kolive të pa mbyllura të siguruara do të shënohen me shkronjën V. Gjithsesi, kolitë e dërguara me rrugë detare, me përjashtim të kolive të rënda, do të dërgohen në kontenierë.

11. Si rregull i përgjithshëm, thasët dhe kontenierët e tjerë nuk duhet të peshojnë më shumë se 32 kilogram.

12. Për qëllime të transportit, thasët e kolive dhe të kolive të pa mbyllura mund të vendosen në kontenierë. Metodot e përdorimit të konteneirëve do të jenë subjekt i marrëveshjeve të veçanta midis operatorëve të caktuar të interesuar.

Neni RC 165 Përdorimi i barkodeve

1. Operatorët e caktuar mund të përdorin barkodet e gjeneruara nga kompjuteri dhe një sistem unik të identifikimit në shërbimet postare ndërkombëtare për qëllime të tilla si sistemet e gjurmim / gjetjes dhe qëllime të tjera të identifikimit. Specifikimet do të përcaktohen nga Këshilli i Operacioneve Postare.

2. Operatorët e caktuar që zgjedhin të përdorin barkodet në shërbimet ndërkombëtare duhet të përmbushin specifikimet teknike të parashtruara nga Këshilli i Operacioneve Postare.

Neni RC 166 Faturat e kolisë

1. Të gjitha kolitë që dërgohen me rrugë tokësore, S.A.L apo ajrore do të regjistrohen nga zyra dërguese e shkëmbimit në një faturë CP 87. Peshë bruto e dërgimit do të vendoset gjithmonë në CP 87.

2. Fatura e kolisë do të futet në një nga kontenierët që përbëjnë dërgesën. Kur është e përshtatshme, ajo do të futet në një thes që përmban koli të siguruara ose koli ekspres.

3. Faturat e kolive që lidhen me dërgesa që përmbajnë koli siguruara do të futen në një zarf rozë. Nëse kolitë e siguruara janë vendosur në një kontenier të brendshëm të mbyllur me qiri, zarfi rozë që përmban faturën e kolisë do të bashkëlidhet në pjesën e jashtme të këtij kontenieri.

4. Fatura e kolisë do të plotësohet me të gjitha detajet.

4bis Operatorët e caktuar mund të bien dakord, në mënyrë dypalëshe ose shumëpalëshe, për të shkëmbyer faturat e kolive apo të dhënat e faturave të kolive nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këtë rast, ata mund të vendosin që dërgesat që ata shkëmbejnë nuk kanë nevojë të shoqërohen me një faturë të kolisë CP 87.

5. Për sa i përket shërbimit të kolive dhe të kolive të të burgosurve të luftës dhe të internuarve civilë

të dërguara me rrugë ajrore, detyrimet e transportit ajror do ti kreditohen operatorëve të caktuar të interesuar.

6. Në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë, faturat e kolive të transportit tokësor dhe S.A.L do të numërtohen veçmas sipas një serie vjetore për çdo zyrë dërguese të shkëmbimit dhe çdo zyre të shkëmbimit të destinacionit. Numërtimi do të jetë i ndryshëm për çdo rrugë në qoftë se është përdorur më shumë se një rrugë. Numri i fundit i vitit do të tregohet në faturën e kolisë së parë të vitit të ardhshëm. Nëse një dërgesë është anuluar, zyra e dërguese do të vendosë në faturën e kolisë pranë numrit të postës shënimin "Dernière depeche" (dërgesa e fundit). Në rastin e shërbimeve detare dhe ajrore, në faturat e kolive do të tregohet, kur është e mundur, emri i anijes që transporton postën ose, sipas rastit, shërbimi ajror i përdorur.

7. Nëse kolitë e transportit ajror janë dërguar nga një shtet në një tjetër me anë të rrugëve tokësore së bashku me kolitë e tjera, prania e tyre do të tregohet nga një shënim i përshtatshëm në faturën e kolisë CP 87.

8. Çdo koli e siguar do të regjistrohet në faturën e dorëzimit me shkronjën "V" në kolonën "Vërejtje".

9. Çdo koli e ri-adresuar ose e kthyer tek dërguesi, do të regjistrohet në faturën e kolisë me shënimin "Réexpédié" (Ri-adresuar) ose "Retour" (Kthyer) në kolonën "Vërejtje".

10. Numri i kontenierëve që përmbajnë dërgesat, me përjashtim të rastit kur bihet dakord ndryshe ndërmjet operatorëve të caktuar të interesuar, dhe numri i kontenierëve që do të kthehen, do të regjistrohet në faturën e kolisë. Në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë, operatorët e caktuar do të numërojnë kontenierët e së njëjtës dërgesë. Numri serial i çdo kontenieri do të shkruhet në etiketat CP 83 dhe CP 84.

11. Ku midis operatorëve të caktuar të shteteve që nuk janë fqinjë, shkëmbehen dërgesa të mbyllura, zyra dërguese e shkëmbimit do të përgatisë për secilin prej operatorëve të caktuar ndërmjetës një faturë të veçantë CP 88. Kjo zyrë do të përfshijë në to numrin e kolive dhe peshën bruto të dërgesës. Faturat CP 88 të kolive do të numërtohen në një seri vjetore për çdo zyrë dërguese të shkëmbimit dhe për çdo operator të caktuar ndërmjetës. Përveç kësaj, ajo do të mbajë numrin serial të dërgesës përkatëse. Numri i fundit i vitit do të tregohet në faturën e kolisë së parë të vitit të ardhshëm. Në rastin e shërbimeve detare, emri i anijes që do të transportojë postën do të vendoset në faturën CP 88 të kolisë, sa herë që kjo është e mundur.

12. Kur kolitë e transportit ajror janë dërguar me postë tokësore, zyra dërguese e shkëmbimit duhet të përgatisë një faturë të veçantë CP 88 për operatorët e caktuar transit të interesuar.

13. Fatura e veçantë e kolisë CP 88 do të dërgohet e pa mbyllur ose në ndonjë mënyrë tjetër të rënë dakord ndërmjet operatorëve të caktuar të interesuar, e shoqëruar, sipas rastit, me dokumentet e kërkuara nga shtetet ndërmjetëse.

Neni RC 167

Hartimi i faturave të kolive CP 87

1. Me përjashtim të atyre kategorive të kolive të përmendura në pikat 2 deri në 6 më poshtë, të gjitha kolitë e dërguara operatorëve të caktuar të destinacionit do të regjistrohen në total në faturën e kolive CP 87. Numri dhe pesha e përgjithshme e këtyre kolive, duke përfshirë edhe peshën e thasëve, do të tregohet në seksionin "Regjistrim në sasi të mëdha" të faturës së kolisë.

2. Kolitë që janë ri-adresuar, kolitë e kthyera tek dërguesit apo kolitë e dërguara në transit à découvert gjithmonë do të regjistrohen individualisht, me shumën e detyrimeve të paguara apo normën përkatëse të përmendur. Numri dhe pesha e këtyre kolive nuk do të përfshihet në numrin dhe peshën bruto të kolive të treguara në seksionin "Regjistrim në sasi të mëdha" të faturës së kolive. Numri dhe pesha bruto e kolive të përcaktuara në seksionin "Regjistrim në sasi të mëdha" të faturës së kolisë gjithmonë duhet të përfshijë të gjitha kolitë e tjera përveç atyre të ri-adresuara, të kthyera dërguesit, ose të dërguara në transit à découvert.

3. Kolitë e siguruara do të regjistrohen gjithashtu në mënyrë individuale, por pa përmendur tarifat përkatëse. Numri dhe pesha e tyre do të përfshihen në numrin dhe peshën totale të kolive të treguar në seksionin "Regjistrim në sasi të mëdha" të faturës së kolive.

4. Kur operatorët e caktuar të interesuar kanë rënë dakord për regjistrimin e detajuar të faturave të kolive, të gjitha kolitë e zakonshme të dërguara tek operatorët e caktuar të destinacionit do të regjistrohen në mënyrë individuale në faturën e kolisë, por pa normën përkatëse të hyrjes. Në përputhje me paragrafin 2, numri dhe pesha e tyre, duke përfshirë edhe peshën e thasëve, do të përfshihen në numrin dhe peshën totale të kolive të treguara në seksionin "Regjistrim në sasi të mëdha" të faturës së kolisë.



5. Prania e kolive COD do të shënohet në sektorin e hyrjes në sasi të mëdha të formularit.
6. Shërbimi i kolive dhe kolitë e të burgosurve e luftës dhe të të internuarve civilë për të cilat, sipas nenit 7.1 dhe 2 të Konventës, nuk do të vendoset asnjë nga tarifat, nuk do të përfshihen në numrin e peshës totale të kolive të treguar në faturën e kolisë. Neni RC 166.5 do të jetë i zbatueshëm për dërgimin e kolive të tilla me rrugë ajrore.

Neni RC 168

Dërgimi i dokumenteve që shoqërojnë kolitë

1. Dokumentet shoqëruese që i referohen Neni RC 121.1 dhe 2 do të bashkëlidhen kolis përkatëse.
2. Seti i kopjeve CP 72 do të ngjitet në koli.
3. Nëse seti i kopjeve CP 72 nuk mund të ngjitet në koli ose nëse kolia do të shoqërohet me dokumente të tjera që nuk janë të përfshira në set, dokumentet shoqëruese do të vendosen në një zarf transparent adeziv CP 91 ose CP 92. Ky do të vendoset në koli.
4. Kur është e aplikueshme, formularët e urdhër pagesës COD, shënimi i postimit pa pagesë dhe njoftimi i dorëzimit do të vendosen në të njëjtën mënyrë.
5. Operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit mund të bien dakord të bashkëngjitin dokumentet shoqëruese me faturën e kolisë.
6. Në rastin e parashikuar në pikën 5, operatorët e caktuar të interesuar mund të bien dakord të dërgojnë faturën e kolisë dhe dokumentet shoqëruese të kolisë në zyrën e shkëmbimit të destinacionit me anë të rrugës ajrore.
7. Në rastin e kolive në të cilat seti i kopjeve CP 72 nuk mund të ngjitet, ose për të cilat zarfi transparent adeziv nuk mund të vendoset për shkak të madhësisë apo natyrës së ambalazhit të kolive, dokumentet shoqëruese duhet të bashkëlidhen mirë me kolinë.
8. Operatorët e caktuar të cilët janë në gjendje të përdorin zarfin transparent adeziv do të kenë mundësinë e dërgimit të dokumenteve shoqëruese duke ia bashkëlidhur mirë kolive.
9. Operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit mund të bien dakord se dokumentet shoqëruese të kolive të shkëmbyera në dërgesa të drejtpërdrejta do të vendosen në përputhje me ndonjë sistem tjetër të përshtatshëm për ta.

Neni RC 169

Itinerari i dërgesave

1. Dërgesat e mbyllura do të dërgohen me anë të rrugës më të drejtpërdrejtë të mundshme.
2. Kur një dërgesë konsiston në disa thasë, këta, për sa është e mundur, do të rrinë së bashku dhe do të dërgohen me të njëjtën dërgesë.
3. Operatorët e caktuar të shtetit të origjinës mund të përshkruajnë rrugën që do të ndiqet nga dërgesat e mbyllura që ajo dërgon, me kusht që përdorimi i kësaj rruge të mos sjellë shpenzime të veçanta për një operator të caktuar ndërmjetës. Informacioni rreth itinerarit do të vendoset në faturat CN 37, CN 38 ose CN 41 dhe në etiketat CP 83, CP 84 ose CP 85.
4. Dërgesat e mbyllura për transport ajror do të dërgohen me fluturimin e kërkuar nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me kusht që ajo të përdoret nga operatori i caktuar i shtetit të transitit për transmetimin e postave të veta. Në qoftë se nuk është ky rast, ose nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për transportin, do të informohet operatori i caktuar i shtetit të origjinës.
5. Në rast të një ndryshimi në një shërbim për shkëmbimin e dërgesave të mbyllura të vendosura midis dy operatorëve të caktuar nëpërmjet një ose më shumë shteteve, palë të treta, operatori i caktuar i origjinës së dërgesës do të informojë operatorët e caktuar e këtyre shteteve për faktin.
6. Në qoftë se ka një çështje të një ndryshimi në dërgimin e postës, rruga e re që duhet të ndiqet do të raportohet operatorit të caktuar i cili ka ofruar transitin më parë. Rruga e vjetër duhet të raportohet, për informacion, tek operatorët e caktuar të cilët do të sigurojnë kalimin transit në të ardhmen.

Neni RC 170

Transporti i kolive me rrugë ajrore dhe kolive të transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)

1. Në parim, transporti në të njëjtin aeroport i dërgesave të kolive gjatë transmetimit do të kryhet nga operatori i caktuar i shtetit në të cilin kryhet transferimi.

2. Kjo nuk zbatohet kur transferimi bëhet midis avionëve të së linjë që kryejnë faza të njëpasnjëshme të udhëtimit.

3. Në rastin e përmendur në pikën 2 dhe kur operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit dhe linja ajrore të interesuara bien dakord paraprakisht, linja ajrore që bënë transferimin mund të përgatisë, nëse është e nevojshme, një faturë të veçantë të dorëzimit që të të zëvendësojë faturën origjinale CN 38 ose CN 41. Palët e interesuara do të bien dakord reciprokisht për procedurat përkatëse dhe formularin në përputhje me nenin RC 172.

4. Nëse operatori i caktuar i shtetit të origjinës dëshiron kështu, dërgesat e tij do të dërgohet direkt në aeroportin transit, me anë të dy linjave ajrore të ndryshme. Megjithatë, shoqëritë e fluturimit në fjalë, duhet të bien dakord për të bërë transferimin dhe operatori i caktuar i shtetit transit duhet të jetë informuar paraprakisht për këtë.

5. Në rastin e përmendur në pikën 4 dhe kur operatorët e caktuar të origjinës dhe të destinacionit dhe linjat ajrore të interesuara bien dakord paraprakisht, linja ajrore që bënë transportimin mund të përgatisin në qoftë se është e nevojshme një faturë të veçantë të dorëzimit për të zëvendësuar faturën origjinale CN 38 ose CN 41. Palët e interesuara do të bien dakord reciprokisht për procedurat përkatëse dhe formularin në përputhje me nenin RC 172.

6. Në rastet e përmendura në pikat 2 dhe 4, thasët e dërgesave mund të pajisen me një etiketë CN 42, përveç etiketave të parashikuara për transportin e postës ajrore.

7. Kur dërgesat tokësore të një operatori të caktuar janë ri-dërguar me rrugë ajrore nga një operator i caktuar tjetër, kushtet e këtij një ri-dërgimi do të mbulohen nga një marrëveshje e veçantë midis operatorëve të caktuar.

Neni RC 171

Hapat që do të ndërmerren kur transferimi i drejtpërdrejtë i kolive me rrugë ajrore nuk mund të realizohet sipas planit

1. Nëse dërgesat e dokumentuara për transferim të drejtpërdrejtë nuk arrin të lidhet me fluturimin e planifikuar në aeroportin e transferimit, linjat ajrore do t'ia dorëzojnë ato menjëherë zyrtarëve postare të aeroportit të transferimit për ri-dërgim me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

2. kjo nuk do të aplikohet kur:

2.1 operatori i caktuar që dërgon postën ka rënë dakord për dërgimin e saj me një fluturim të mëvonshëm;

2.2 Në mungesë të marrëveshjeve të referuara në pikën 2.1, linja ajrore përgjegjëse për postën mund të organizojë për ta ri-dërguar atë brenda 24 orëve nga mbërritja e saj në aeroportin e transferimit.

3. Në rastin e referuar në pikën 1, zyra e cila realizon ri-dërgimin do të informojë zyrën e origjinës së secilës dërgesë me anë të një shënimi verifikimi CP 78, duke treguar në mënyrë të veçantë në shënimin e verifikimi shërbimin ajror nga i cila është marrë dërgesa dhe shërbimet e përdorura (ajrore apo tokësore) për transmetimin e mëtejshëm në destinacionin e vet.

Neni RC 172

Përgatitja dhe kontrolli i faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41

1. Faturat e dërgimit do të plotësohen, në përputhje me formatin e tyre, mbi bazën e veçorive në etiketat e thasëve ose në adresë. Numri i përgjithshëm dhe pesha totale e thasëve dhe artikujve në çdo postë, do të regjistrohen në masë sipas kategorisë. Operatorët e caktuar të origjinës mund të zgjedhin të regjistrojnë çdo thes individualisht nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Megjithatë, çdo shtet ndërmjetës apo transit i duhet të listojë çdo kontenier transit në mënyrë individuale, duke ruajtur operatorin e caktuar të origjinës, zyrën e



destinacionit, të dërgimit dhe numrin kontenierëve të treguar nga operatori i caktuar i origjinës. Kodi identifikues IMPC me gjashtë-karakte të origjinës dhe destinacionit të kontenierit do të regjistrohet përkatësisht në kolonat 2 dhe 3.

2. Çdo zyrë ndërmjetëse apo zyrë e destinacionit që vëren gabime në shënimet e faturës së dërgimit CN 38 ose CN 41 duhet ti korrigjojë menjëherë ato. Ai do t'i raportojë ato me një shënim verifikimi CP 78 në zyrën fundit dërguese të shkëmbimit dhe në zyrën e shkëmbimit që përgatiti dërgesën. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për përdorimin sistematik të postës elektronike ose çdo mjet tjetër të përshtatshëm të telekomunikacionit për të raportuar parregullsitë.

3. Kur dërgesat të dërguara janë futur në kontenirë të vulosur nga shërbimi postar, numri serial dhe numri i vulës të çdo kontenieri do të regjistrohet në kolonën e rezervuar për këtë qëllim në faturën CN 37, CN 38 ose CN 41.

Neni RC 173

Mungesa e faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41

1. Në mungesë të faturës CN 37, zyra e pranimit duhet të përgatisë një të tillë në tri kopje, në përputhje me ngarkesën e pranuar. Dy kopje të shoqëruara nga një shënim verifikimi CP 78 do të dërgohen në zyrën dërguese, e cila do të kthejë një kopje pas shqyrtimit dhe nënshkrimit.

2. Kur një dërgesë arrin në aeroportin e destinacionit - ose një aeroport ndërmjetës, përgjegjës për ta përcjellë atë me një tjetër transportues - pa faturën CN 38 ose CN 41, operatori i caktuar nën juridiksionin e të cilit është aeroporti do të përgatisë automatikisht një të tillë. Kjo e fundit do të kundërfirmoset rregullisht nga transportuesi prej të cilit është marrë dërgesa. Ky fakt do të raportohet në zyrën përgjegjëse për ngarkimin e postës me anë të shënimit të verifikimit CP 78, së bashku me dy kopje të CN 38 të përgatitur në këtë mënyrë. Kësaj të fundit do ti kërkohej që të kthejë një kopje të vërtetuar në mënyrë të rregullt.

3. Nëse fatura origjinale CN 38 ose CN 41 mungon, operatori i caktuar që merr postën do të pranojë faturën zëvendësuese CN 46 të përgatitur nga linja ajrore. Ky fakt do të raportohet në zyrën e origjinës me anë të një shënimi të verifikimit CP 78, të shoqëruar nga dy kopje të faturës së zëvendësuese CP 46.

4. Operatorët e caktuar mund të bien dakord për të përdorur sistematikisht postës elektronike ose çdo mjet tjetër të përshtatshëm të telekomunikacionit për zgjidhjen e rasteve kur mungon fatura CN 38 ose CN 41.

5. Zyra e shkëmbimit në aeroportin e destinacionit - ose një aeroport ndërmjetës përgjegjës për dërgimin e postës me një mjet transporti - mund të pranojë, pa përgatitjen e një shënimi verifikimi CP 78, një faturë CN 38 ose CN 41 të dhënë nga transportuesi fillestar, e cila është transmetuar në mënyrë elektronike nga zyra e tij në aeroportin e nisjes dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i tij në aeroportin ku është shkarkuar dërgesa.

6. Nëse aeroporti i ngarkimit nuk mund të përcaktohet, shënimi i verifikimit do të dërgohet direkt në zyrën e dërgimit të dërgesës që ajo të dërgojë shënimin në zyrën përmes të cilës transitohej dërgesa.

Neni RC 174

Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një aksidenti

1. Kur, si pasojë e një aksidenti gjatë transportit, një anije, tren, avion apo ndonjë strukturë tjetër e transportit nuk është në gjendje të vazhdojë udhëtimin e saj dhe të dorëzojë dërgesat në portet apo stacionet e planifikuara, ekuipazhi do të dorëzojë dërgesat në zyrën postare më të afërt me vendin e aksidentit apo në zyrën më të afër për të ri-dërguar postën. Nëse ekuipazhi nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ajo zyrë, e informuar për aksidentin, do të marrë masa të menjëhershme, duke marrë në dorëzim dërgesat dhe duke e ri-dërguar atë në destinacion me rrugën më të shpejtë, pasi gjendja e tij është kontrolluar dhe të gjitha sendet e dëmtuara janë rregulluar.

2. Operatori i caktuar e shtetit ku ka ndodhur aksidenti duhet të njoftojë me anë të telekomunikacionit të gjithë operatorët e caktuar të porteve apo stacioneve të mëparshme për gjendjen e dërgesave. Këto duhet të lajmërojnë më pas me të njëjtën rrugë të gjithë operatorët e caktuar të interesuar.

3. Operatori i caktuar i origjinës i cili ka dërgesa në mjetin e transportit të përfshirë në aksident, duhet t'i dorëzojë një kopje të faturave të dërgimit CN 37, CN 38 ose CN 41, operatorit të caktuar të shtetit ku ka ndodhur aksidenti.

4. Zyra e kualifikuar do të njoftojë zyrat e destinacionit të dërgesave të përfshira në aksident me anë të shënimit të verifikimit CN 43 duke dhënë detajet e rrethanave të aksidentit dhe rezultatet e kontrollit të dërgesave. Një kopje e shënimit të verifikimit do të dërgohet në zyrat e origjinës së dërgesave përkatëse dhe një tjetër për operatorin e caktuar të shtetit të cilit i përket shoqëria e transportit. Këto dokumente do të dërgohen me anë të rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

Neni RC 175

Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një fluturimi të ndërprerë, ose devijimi ose dërgimi të gabuar të kolive me rrugë ajrore

1. Kur një avion ndërpret fluturim e tij për një periudhë kohe që do të vonojë dërgesat ose kur, për çfarëdo arsye, dërgesat janë shkarkuar në një aeroport të ndryshëm nga ai i dhënë në faturat e dërgimit CN 38, shoqëria e fluturimit do të dorëzojë menjëherë këto dërgesa tek nëpunësit e operatorit të caktuar të shtetit ku është bërë ndalesa. Këta të fundit do të ridërgojnë ato me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

2. Operatori i caktuar i cili merr dërgesat e postës ajrore ose thasët e dërguar gabim për shkak të një gabimi në etiketë duhet të bashkëlidhin një etiketë të re të dërgesës ose thesit, me një tregues të zyrës së origjinës, dhe do ta ri-dërgojë atë në destinacionin e tij të saktë.

3. Në çdo rast, zyra që ka bërë ri-dërgimin do të informojë zyrën e origjinës të secilës dërgese ose thes me anë të një shënimi verifikimi CN 43, duke shënuar në mënyrë të veçantë në shënimin e verifikimit shërbimin ajror nga i cili është marr dërgesa, shërbimin e përdorur (ajror ose tokësor) për transportim të mëtejshëm në destinacionin e tij dhe arsyen e dërgimit të gabuar, të tillë si gabimi në transport ose etiketë.

Neni RC 176

Hapa që duhet të ndërmerren në rast të një fluturimi të ndërprerë, ose devijimi ose dërgimi të gabuar të kolive të transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)

1. Kur dërgesat e përfshira në një dërgesë ajrore brenda shtetit (SAL) janë në një fluturim që është ndërprerë ose janë shkarkuar në një aeroport të ndryshëm nga ai i treguar në faturën e dërgimit CN 41, procedura do të jetë si më poshtë:

1.1 Nëpunësit e operatorit të caktuar të shtetit ku dërgesat janë në transit do të marrin në ngarkim dhe do të ridërgojnë ato me rrugë tokësore nëse kushtet janë të tilla që dërgesa të mund të dërgohen menjëherë në shtetin e destinacionit. Operatori i caktuar i origjinës do të informohet me e-mail ose me ndonjë mjet tjetër të telekomunikacionit.

1.2 Nëse në shtetin e destinacionit nuk mund të sigurohet dërgesa e shpejtë me rrugë tokësore, operatori i caktuar i shtetit të transitit do të kontaktojë, me mjete të telekomunikacionit, me operatorin e caktuar të origjinës të dërgesës për të përcaktuar si do të ridërgohen këto në destinacionin e tyre dhe si do të llogaritet dhe shlyhet kompensimi për ridërgimin.

1.3 Operatori i caktuar i origjinës së shtetit të transitit do të bëjë një faturë të re të dorëzimit (CN 37, CN 38 ose CN 41, sipas kërkesës) dhe ridërgojë postën si është udhëzuar nga operatori i caktuar i origjinës.

Neni RC 177

Përgatitja e njoftimeve të provës

1. Për të përcaktuar rrugën më të favorshme të dërgimit të kolive, zyra e shkëmbimit e origjinës mund t'i dërgojë zyrës së destinacionit të kësaj dërgese, një njoftim prove në formularin e modelit CN 44 . Ky njoftim duhet të jetë përfshirë në dërgesë dhe bashkëlidhur me faturën e kolisë në të cilën shënohet prania e tij. Nëse gjatë formulari CN 44 mungon në mbërritjen e dërgesës, zyra e destinacionit duhet të hartojë një dublikatë. Njoftimi i provës, i plotësuar rregullisht nga zyra e destinacionit, kthehet me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore) në adresën e specifikuar, ose nëse nuk është dhënë një adresë, në zyrën në të cilën është përgatitur.

Neni RC 178

Transferimi i postës

1. Kolitë me rrugë tokësore

1.1 Në mungesë të marrëveshjes së veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, transferimi i pakove të postës me rrugë tokësore do të kryhet me anë të faturës së dorëzimit CN 37.



1.2 Do të përgatiten dy kopje të faturës. E para i drejtohet zyrës marrëse dhe e dyta zyrës dërguese. Zyra marrëse do të pranojë marrjen e kopjes së dytë dhe do ta kthejë atë menjëherë me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

1.3 Fatura e dorëzimit CN 37 mund të përgatitet në tre kopje kur transferimi i dërgesave midis dy zyrave korrespondente bëhet nëpërmjet një shërbimi transporti. Në këtë rast, kopja e parë i dërgohet zyrës marrëse dhe do të shoqërojë dërgesat. E dyta do të pranohet nga shërbimi i transportit dhe do ti jepet zyrës dërguese. E treta do të mbahet nga shërbimi i transportit pas nënshkrimit nga zyra marrëse.

1.4 Fatura e dorëzimit CN 37 mund të përgatitet në tre kopje kur transmetimi i dërgesave kryhet me mjete transporti pa personel shoqërues. Dy kopjet e para do të dërgohen me dërgesat dhe e treta mbahet nga zyra dërguese. E para i dërgohet zyrës marrëse dhe e dyta, e firmosur rregullisht nga ky i fundit, do të kthehet me rrugën më të shpejtë në zyrën e dërgimit.

1.5 Për arsye të organizimit të tyre të brendshëm, disa operatorë të caktuar mund të kërkojnë që të përgatiten fatura CN 37 të veçanta për dërgesat e postës së letrave nga njëra anë, dhe për kolitë postare nga ana tjetër.

1.6 Kur transferimi i dërgesave midis dy zyrave korrespondente përfshin një shërbim detar, zyra e shkëmbimeve dërguese mund të përpilojë një kopje të katërt të faturës së dorëzimit CN 37 të cilën zyra e shkëmbimeve marrëse do ta kthejë pasi ta ketë vërtetuar. Në këtë rast, kopja e tretë dhe e katërt do të shoqërojnë dërgesat. Një kopje e faturës CN 37 duhet të dërgohet paraprakisht me avion ose me postë elektronike ose me çdo mjet tjetër telekomunikacioni, zyrës së shkëmbimeve marrëse ose portit të shkarkimit ose administratës së tij qendrore.

2. Kolitë e postës ajrore dhe të transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)

2.1 Dërgesat e kolive me rrugë ajrore që do të dorëzohen në aeroport do të shoqërohen me pesë kopje të faturës së dorëzimit CN 38.

2.2 Dërgesat që do të dorëzohen në aeroport do të shoqërohen nga pesë kopje të faturës së dorëzimit CN 38, për çdo ndalesë në rastin e kolive të postës ajrore ose një CN 41, në rastin e transportit brenda vendit me rrugë ajrore (S.A.L.)

2.3 Një kopje e faturës CN 38 ose CN 41 e nënshkruar si mandat për kolitë nga shoqëria e fluturimit ose autoritetet përgjegjëse të shërbimit tokësor, do të mbahet nga zyra dërguese.

2.4 Dy kopje të faturave CN 38 ose CN 41 do të mbahen në aeroportin e ngarkimit nga shoqëria e fluturimit transportuese e kolive.

2.5 Dy kopje të faturave CN 38 dhe CN 41 do të futen në zarfin CN 45. Këto do të transportohen në portofolin e bordit të avionit ose në një vend tjetër të veçantë ku mbahen dokumentet e bordit. Pas mbërritjes në aeroportin e shkarkimit të kolive kopja e parë rregullisht e nënshkruar si mandat për kolitë, do të mbahet nga shoqëria e fluturimit që i ka transportuar ato. Kopja e dytë do të shoqërojë kolitë në zyrën e postës në të cilën janë adresuar faturat CN 38 dhe CN 41.

2.6 Faturat CN 38 dhe CN 41 të dërguara elektronikisht nga transportuesi ajror mund të pranohen në zyrën e shkëmbimeve të mbërritjes, kur dy kopjet e parashikuara në pikat 2, 4 nuk janë të përdorshme. Në këtë rast dy kopjet e faturave CN 38 dhe CN 41 duhet të nënshkruhen nga përfaqësuesi i shoqërisë së fluturimit në aeroportin e destinacionit para paraqitjes tek operatori i caktuar marrës. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2.6.1 ose 2.6.2, një kopje nënshkruhet nga operatori i caktuar marrës si mandat për kolitë dhe do të mbahet nga transportuesi ajror. Kopja e dytë në të gjitha rastet shoqëron kolitë deri në zyrën e postës të cilës i është adresuar fatura CN 38 ose CN 41.

2.6.1 Operatorët e caktuar që kanë vendosur një sistem regjistrimi elektronik të dërgesave që ata marrin nëpërmjet transportuesve ajrorë mund të përdorin të dhënat e sistemit në vend që të ndjekin procedurat që përfshijnë faturat CN 38 ose CN 41 të përshkruara në pikën 2.6. Në vend të kopjes së nënshkruar të formularit CN 38 ose CN 41, Operatori i caktuar marrës mund ti japë transportuesit ajror një kopje të të dhënave elektronike për atë dërgesë.

2.6.2 Në mënyrë alternative, operatorët e caktuar që këmbëjnë mesazhe EDI në dërgimin e dërgesave mund të përdorin mandatat e mesazheve EDI në vend që të procesit të formularëve CN 38 ose CN 41 të përshkruara në pikën 2.6. Në vend të kopjes së nënshkruar të formularit CN 38 ose CN 41, operatori i caktuar marrës mund të transmetojë mandatin e mesazhit EDI.

2.7 Operatorët e caktuar mund të bien dakort ndërmjet tyre për përdorimin sistematik të postës elektronike ose të çdo lloji tjetër mjeti të telekomunikacionit për transmetimin e faturave CN 38 ose CN 41

ndërmjet zyrës që përgatit dokumentin dhe zyrës që e merr atë.

2.8 Kur kolidet e dërguara me rrugë tokësore një operatori të caktuar ndërmjetës për t'u ridërguar me rrugë ajrore, ato do të shoqërohen nga faturat CN 38 ose CN 41, për zyrën ndërmjetëse. Një faturë CN 38 ose CN 48 do të përgatitet për operatorin e caktuar të shtetit të destinacionit për në lidhje me postën ajrore të ridërguar me rrugë tokësore.

3. Në rast se faturat e dërgimit CN 37, CN 38 dhe CN 41 prodhohen me mjete elektronike dhe transmetohen online tek shërbimi i transportit ose tek një agjent bashkëpunëtor pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të personelit të operatorit të caktuar, dhe, nëse këto fatura janë stampuar atje, operatorët e caktuar të përfshirë në veprimet e transportit mund të bien dakord që faturat e dërgimit të mos nënshkruhen.

4. Operatorët e caktuar marrës do të sigurohen se transportuesit mund të dorëzojnë kolidet në një shërbim kompetent.

5. Dërgesat duhet të dorëzohen në gjendje të mirë. Megjithatë, një dërgesë nuk mund të refuzohet për shkak të dëmtimeve apo vjedhjeve.

6. Pesha e thasëve ose kontenierëve të tjerë që përmbajnë kolidet siguruara ajrore do të tregohen veçmas në faturën e dërgimit CN 38. Shkronja V gjithashtu do të shkruhet në kolonën "Vëzhgime" në krah të kundërt me këtë term.

Neni RC 179 Verifikimi i dërgesave

1. Çdo zyrë e shkëmbimit që merr një dërgesë do të kontrollojë menjëherë kontenierin dhe paketimin e tyre. Ajo gjithashtu do të kontrollojë origjinën dhe destinacionin e thasëve që përbëjnë dërgesën dhe të paraqitura në faturën e dërgimit, dhe më pas kolidet dhe dokumentet e ndryshme që i shoqërojnë ato. Këto kontrole do të bëhen në prani të palëve tjera të interesuara sa herë që kjo është e mundur.

2. Zyra e destinacionit do të mbajë një kontroll të fortë nëse dërgesat vijnë në sekuencën në të cilën janë dërguar, veçanërisht në rastin e dërgesave që përmbajnë kolidet të siguruara.

3. Kur kontenierët janë të hapur, pjesët përbërëse të lidhjes (spango, vulë plumbi, etiketë) do të mbahen së bashku, për të arritur këtë spangoja do të pritët në një vend të vetëm.

4. Çdo parregullsi e evidentuar duhet të raportohet pa vonesë me anë të një shënimi të verifikimit CP 78. Kur zyra e shkëmbimit të destinacionit nuk ka dërguar një shënim CP 78 me postën e parë të disponueshme, do të konsiderohet, derisa të provohet e kundërta, se i ka marrë të gjithë thasët dhe kolidet në gjendje të mirë.

5. Kur konstatimet e një zyre të këmbimit janë të tilla që mund të përfshijnë përgjegjësinë e një shoqërie të transportit, kur është e mundur, ato duhet të kundërfirmosen nga përfaqësuesi i kësaj shoqërie si dhe nga operatori të caktuar i transitit ose i destinacionit që merr në dorëzim dërgesat, të cilët do të konfirmojnë se nuk ka parregullsi. Kjo firmë mund të vendoset edhe në shënimin e verifikimit CP 78, një kopje e të cilit do t'i dorëzohet shoqërisë ose në faturën e dërgimit CN 37, CN 41 ose CN 38 që shoqëron dërgesën, sipas rastit. Nëse ka ndonjë rezervim në lidhje me shërbimin e transportit, kopjet CN 37, CN 38 ose CN 41 të faturës së dërgimit duhet të tregojnë këto rezerva.

6. Zbulimi i çfarëdolloj parregullsie gjatë verifikimit nuk do të shkaktojë në asnjë rast kthimin të një kolie tek dërguesi, me përjashtim të sa është parashikuar në nenin RC 134.3 dhe 4.

Neni RC 180 Zbulimi i parregullsive dhe përpunimi i njoftimeve të verifikimit

1. Kur një zyrë ndërmjetëse merr një dërgesë në gjendje të keqe, duhet të verifikojë përmbajtjen nëse gjykon se kjo nuk është e paprekur, ajo do ta vendosë atë në një ambalazhim të ri ashtu siç është. Kjo zyrë duhet të kopjojë detajet e etiketës origjinale në një etiketë të re dhe të vendosë tek kjo e fundit vulën datare, të paraprirë nga shënimi "Remballé à ..." (e ambalazhuar në.....). Fakti do të raportohet me anë të një shënimi verifikimi CP 78, i cili do të përgatitet në katër ose pesë kopje, sipas rastit. Një kopje do të mbahet nga zyra e cila e ka përgatitur atë, dhe të tjerat do të dërgohen tek:

1.1 zyra e shkëmbimit nga e cila është marrë dërgesa (dy kopje);

1.2 Zyra dërguese e shkëmbimit (në qoftë se kjo nuk është zyra e përmendur më sipër) dhe

1.3 Zyra e destinacionit (vendosur në dërgesën e ripaketuar).

2. Në rast të mungesës së një dërgese ose një ose më shumë nga thasët që e përbëjnë atë, apo të çdo



parregullsi tjetër, fakti do të njoftohet siç përshkruhet në pikën 1. Megjithatë, zyrat ndërmjetëse të shkëmbimit nuk do të jenë të detyruara të kontrollojnë dokumentet që shoqërojnë faturën e kolisë.

3. Nëse zyra e shkëmbimit të destinacionit zbulon gabime ose lëshime në faturën e kolisë ajo do të bëjë menjëherë korrigjimet e nevojshme. Ajo do të kujdeset për të shënojë me kryq shënimet e pasakta në mënyrë të tillë që të dhënat fillestare të mbeten të lexueshme. Këto korrigjime do të bëhen në prani të dy zyrtarëve; me përjashtim të rastit kur ka një gabim të qartë, do të preferohet që korrigjimet të pranohen në deklaratën origjinale. Zyra e shkëmbimit do të kryejë edhe kontrole rutinë kur kontenieri apo lidhja e tij i jep arsye për të supozuar që përmbajtja nuk ka mbetur e paprekur ose që kanë ndodhur disa parregullsi të tjera. Parregullsitë të cilat janë përcaktuar duhet të njoftohen pa vonesë në zyrën dërguese të shkëmbimit me anë të një shënimi të verifikimit CP 78, i cili do të përgatitet në tri ose katër kopje sipas rastit. Një kopje do të mbahet nga zyra e shkëmbimit që e ka përgatitur atë dhe të tjerët do të dërgohen në:

3.1 Zyra dërguese të shkëmbimit (dy kopje); dhe

3.2 Zyra ndërmjetëse të shkëmbimit nga e cila u mor dërgesa (nëse dërgesa nuk është marrë drejtpërdrejtë).

4. Mungesa e një dërgese ose e një apo më shumë thasëve që e përbëjnë atë, apo e faturës së kolisë, duhet të njoftohet siç përshkruhet në pikën 3. Nëse fatura e kolisë mungon, zyra e shkëmbimit të destinacionit duhet të përgatisë një faturë zëvendësuese të kolisë.

5. Mungesa e një kolie të postës tokësore ose kolie të postës ajrore do të njoftohet maksimumi pas marrjes së dërgesës së parë pas asaj të humbur. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e një ose më shumë thasëve ose kolive të dërguara të pa mbyllura në një dërgesë tokësore ose ajrore të kolive do të njoftohet maksimumi me marrjen e dërgesës së parë pas asaj në fjalë.

6. Zyra e shkëmbimit të destinacionit do të ketë të drejtën të mos bëjë korrigjime dhe të mos përgatisë një shënim të verifikimit CP 78 nëse gabimet ose lëshimet në lidhje me normat e detyruara nuk kalojnë 10 SDR për faturë.

7. Shënimet e verifikimit do të dërgohen mundësisht me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit ose, nëse është dërguar me postë, me rrugën më të shpejtë, në një zarf të veçantë të shënuar me shkronja të zeza "Bulletin de verification" (Shënim Verifikimi). Këto zarfe mund të jenë të parapërgatitur ose të dallohen nga një pullë që paraqet në mënyrë të qartë shënimet. Parregullsitë në lidhje me koltitë të siguruara të cilat përfshijnë detyrimin e shteteve anëtare ose operatorëve të caktuar do të njoftohen, gjithmonë, menjëherë, nëse është e mundur, me mjete elektronike.

8. Zyrat në të cilat dërgohen shënimet e verifikimit CP 78 do të kthejnë ato sa më shpejt të jetë e mundur, pasi i kanë shqyrtuar dhe kanë shprehur qartë vërejtjet e tyre, nëse ka të tilla; ato do të mbajnë një kopje. Shënimet e verifikimit të kthyer do të bashkëngjiten faturave të kolive me të cilat ato lidhen. Nuk do të konsiderohen të vlefshme korrigjimet e bëra në një faturë kolie të cilat janë të pambështetura me dëshmi të dokumentuara. Megjithatë, nëse këto shënime verifikimi nuk janë kthyer në zyrën e shkëmbimit që i kanë lëshuar ato brenda një periudhe prej një muaji nga data e dërgimit të tyre, ato do të konsiderohen si të pranuar në mënyrë të rregullt, derisa provohet e kundërta.

Neni RC 181

Mospërputhje të peshës ose përmasave të kolisë

1. Me përjashtim të rastit kur ka një gabim të qartë, pikëpamja e zyrës së origjinës do të ketë përparësi për sa i përket caktimit të peshës apo madhësisë.

2. Në lidhje me koltitë e zakonshme, mospërputhjet në peshë më të vogla se një kilogram nuk mund të bëhet subjekt i shënimit të verifikimit apo shkak për kthimin e kolive.

3. Mospërputhjet në peshën e kolive të siguruara deri në dhjetë gram mbi ose nën peshën e deklaruar nuk do të reklamohen nga operatori i caktuar ndërmjetës ose operatori i caktuar i destinacionit me përjashtim të rastit kur kushtet e jashtme të kolisë e bëjnë këtë të nevojshme.

Neni RC 182

Marrja e një kolie të dëmtuar ose të pa paketuar mirë nga zyra e shkëmbimit

1. Çdo zyrë e shkëmbimit e cila merr një koli të dëmtuar ose të paketuar në mënyrë të

pamjaftueshme, do ta dërgojë atë, pasi ta ketë ripaketuar nëse është e nevojshme. Paketim original, adresa dhe etiketat duhet të ruhen sa më shumë të jetë e mundur. Pësia e kolisë para dhe pas ripaketimit do të tregohet në paketimin aktual të kolisë. Ky tregues do të ndiqet nga shënimi "Remballé à...." (Ripaketuar në ...) vëlosur me një vulë datare dhe nënshkruar nga nëpunësit të cilët kryejnë ripaketimin.

2. Nëse gjendja e kolisë është e tillë që përmbajtja mund të jetë hequr apo dëmtuar, ky fakt do të raportohet në zyrën dërguese të shkëmbimit me anë të një shënimi mjaft të saktë në shënimin e verifikimit CP 78. Kolia do të hapet automatikisht dhe përmbajtja e saj do të kontrollohet. Rezultatet e këtij kontrolli do të jepen në një raport CN 24. Ky do të përgatitet në dy kopje, një kopje do të mbahet nga zyra e shkëmbimit që e ka përgatitur atë dhe tjetra do ti bashkëlidhet kolisë.

3. Procedura e përshkruar në pikën 2 do të zbatohet edhe në rastin kur kolia tregon një mospërputhje në peshë të tillë që sjell dyshime për heqjen e plotë ose të një pjese të përmbajtjes.

Neni RC 183

Njoftimi i parregullsive për të cilat operatorët e caktuar mund të jenë përgjegjës

1. Çdo zyrë e shkëmbimit e cila, në ardhjen e një postë, zbulon mungesën vjedhjen ose dëmtimin e një apo më shumë kolive do të procedojë si më poshtë:

1.1 Ajo duhet të tregojë me sa më shumë detaje në shënimin e verifikimit CP 78 apo në raportin 24 CN gjendjen në të cilën ai e gjeti paketimin e jashtëm të dërgesës. Me përjashtim të rastit kur kjo është e pamundur për një arsye të deklaruar, kolia, spangoja, vula e plumbit ose vula të tjera dhe etiketa duhet të mbahen të paprekura për një periudhë prej gjashtë javësh nga data e verifikimit. Ato do t'i dërgohen operatorit të caktuar të origjinës, nëse ai e kërkon.

1.2 Ai do t'i dërgojë një dublikatë të shënit të verifikimit në zyrën fundit ndërmjetëse të shkëmbimit, nëse ka, në të njëjtën kohë edhe zyrës dërguese të shkëmbimit.

2. Nëse e sheh të nevojshme, zyra e shkëmbimit të destinacionit, me shpenzim të operatorit të caktuar të saj, do të informojë zyrën dërguese të shkëmbimit për konstatimet e saj me anë të telekomunikacionit.

3. Kur zyrat e shkëmbimit në kontakt të drejtpërdrejtë janë të interesuara, operatorët e caktuar të tyre mund të bien dakord për mënyrën e procedurës në rastin e parregullsive për të cilat ata mund të jenë përgjegjës.

Neni RC 184

Kontrolli i postës së kolive të dërguara në sasi të mëdha

1. Nenet RC 179 deri 183 RC do të jenë të zbatueshëm vetëm për koli të vjedhura dhe të dëmtuara si dhe të kolive të regjistruara individualisht në faturat e kolive. Kollitë e tjera do të kontrollohen thjesht në masë.

2. Operatori i caktuar i origjinës mund të bien dakord me operatorin e caktuar të destinacionit për të kufizuar kontrollin e hollësishëm dhe përgatitjen e shënimeve të verifikimit CP 78 dhe raporteve CN 24 për kategori të caktuara të kolive. E njëjta gjë mund të bihet dakord me operatorët e caktuar ndërmjetës.

3. Nëse numri i kolive të gjetura në dërgesë ndryshon nga numri i dhënë në faturën e kolisë, shënimi i verifikimit do të korrigjojë vetëm numrin total të kolive.

4. Nëse pesha bruto e dërgesës e dhënë në faturën e kolisë nuk korrespondon me peshën bruto të gjetur, shënimi i verifikimit do të korrigjojë vetëm peshën bruto të dërgesës.

Neni RC 185

Ri-dërgimi i kolisë së mbërritur në vendin e gabuar

1. Çdo koli që vjen në vendin e gabuar do të ri - dërgohet në destinacionin e duhur me rrugën më të shpejtë (ajrore ose tokësore).

2. Çdo koli e ridërguar në zbatim e këtij neni do të jetë subjekt i tarifave të ri-dërgimit për në destinacionin e duhur dhe tarifave dhe pagesave të përmendura në nenin RC 135.4.3.

3. Operatori i caktuar i ri-dërgimit do të raportojë operatorit të caktuar nga i cili është pranuar kolia çështjen me anë të një shënimi të verifikimit CP 78.



4. Ai do të trajtojë kolinë e mbërritur në vendin e gabuar si ajo të kishte mbërritur në transit à découvert. Nëse çmimet të cilat janë të mbledhur për të janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e ri-dërgimit, ai do të kreditojë operatorin e caktuar të destinacionit real dhe, sipas rastit, operatorët caktuar ndërmjetës me çmimet përkatëse të transportit. Më pas do të kreditojë veten, nëpërmjet një kërkesë për operatorin e caktuar përgjegjës për zyrën e shkëmbimit e cila ka dërguar gabim kolinë, për shumën e shpenzimit që i është shkaktuar. Ky operator i caktuar do ti marrë këto nga dërguesi, nëse gabimi i është atribuuar atij. Kërkesa dhe shkaku i saj do të njoftohen me anë të një shënimi të verifikimit.

5. Si një alternativë për çmimet dhe shpenzimet e përshkruara në pikën 4, operatorët e caktuar marrës mund të zgjedhin të faturojnë operatorin e caktuar përgjegjës për kolinë e dërguar gabim vetëm për kostot e ri-dërgimit të kolisë në vendin e duhur të destinacionit.

Neni RC 186 Kthimi i kutive bosh

1. Në mungesë të një marrëveshje të veçantë midis operatorëve të caktuar të interesuar, thasët duhet të kthehen bosh me anë të dërgesës pasardhëse në shtetin të cilit i takojnë dhe nëse është e mundur përmes rrugës normale të ndjekur nga udhëtimi i kthimit. Numri i thasëve të kthyer nga çdo postë do të shënohet në faturën e kolisë CP 87.

2. Operatorët caktuar të origjinës mund të përgatisin dërgesa të veçanta për kthimin e thasëve bosh. Megjithatë, përgatitja e dërgesave të veçanta do të jetë e detyrueshme kur operatorët caktuar të transit it apo të destinacionit e kërkojnë një gjë të tillë. Përgatitja e dërgesave të veçanta do të jetë e detyrueshme për thasët që kthehen me postë ajrore. Dërgesat e veçanta do të përshkruhen në faturat CN 47. Nëse dërgesat e veçanta për thasët bosh që kthehen me rrugë tokësore nuk janë përgatitur, numri dhe pesha e thasëve bosh do të regjistrohet në kolonën përkatëse të faturës CN 37.

3. Kthimi do të kryhet me anë të zyrave të shkëmbimit të caktuara për këtë qëllim. Operatorët e caktuar të interesuar mund të bien dakord mes tyre për sa i përket procedurës për kthimin. Në shërbime të distancave të gjata, si rregull i përgjithshëm, ato do të emërojnë vetëm një zyrë përgjegjëse për marrjen e thasëve bosh të kthyer.

4. Thasët bosh do të ambalazhohen në pako të përshtatshme. Kur është e përshtatshme, blloqet e etiketave, etiketat prej cope, pergamenat ose materiale të tjera të forta do të vendosen brenda thasëve.

5. Nëse nuk ka shumë prej tyre, thasët bosh që do të kthehen mund të vendosen në thasët që përmbajnë koltë postare. Në të gjitha rastet e tjera, duke përfshirë rastin kur thasët bosh do të kthehen me rrugë ajrore, ato do të vendosen në thasë të veçantë të etiketuar me emrin e zyrave të shkëmbimit. Këta thasë, me marrëveshje midis operatorëve të caktuar të interesuar, mund të vulosen. Etiketat duhet të kenë të shkruar "Sacs vides" (thasë bosh).

6. Nëse kontrolli i kryer nga një operator i caktuar përcakton se thasët që i përkasin atij nuk janë kthyer në shërbimin e tij brenda një periudhe më të gjatë se ajo që kërkohet për transmetimin e tyre (vajtje-ardhje), do të ketë të drejtë të kërkojë rimbursimin e vlerës së thasëve siç parashikohet në pikën 7. Operatori i caktuar i interesuar mund të refuzojë këtë rimbursim vetëm nëse ai mund të provojë që thasët që mungonin janë kthyer.

7. Çdo operator i caktuar do të caktojë, në mënyrë periodike dhe të njëtrajtshme për çdo lloj thesi të përdorur nga zyrat e saj të shkëmbimit, një vlerë në SDR dhe t'ia komunikojë atë operatorëve të caktuar përkatës me anë të Byrosë Ndërkombëtare. Në rast të rimbursimit, do të merret parasysh kostoja e zëvendësimit të thasëve.

8. Me marrëveshje paraprake, një operator i caktuar mund të përdorë thasë që i përkasin operatorit të caktuar të destinacionit për të përgatitur dërgesat e tij. Nuk mund të përdoren thasët e palëve të treta.

9. Dërgesat e thasëve bosh do të trajtohen si artikuj të postës së letrave të cilat nuk kanë pagesë të tarifave përfundimtare, por janë subjekt i pagesës prej 30 % të tarifave të transit it të zbatueshme për artikujt e postës së letrave.

10. Një operator i caktuar dërgues mund të tregojë nëse ai do të donte ose jo ti ktheheshin kontenierët e përdorur për një dërgesë të veçantë. Kjo e dhënë do të shënohet në faturën e kolisë që përdoret për dërgimin.

KAPITULLI 8 OBJEKTIVAT E CILËSISË SË SHËRBIMIT

Neni RC 187
Objektivat e cilësisë së shërbimit

1. Shtetet Anëtare ose operatorët e caktuar do të monitorojnë përmbushjen aktuale për objektivat e shërbimeve të vendosura prej tyre

KAPITULLI 9 ÇMIMET DHE DETYRIMET E TRANSPORTIMIT AJROR

Neni RC 188
Çmimet e rrugës së dërgimit për shërbimin e dhënë

1. Niveli i tarifave bazë të çmimeve të dërgimit tokësor

1.1 Për vitet 2010 deri në 2013, niveli i çmimeve të dërgimit tokësor i referohet nenit 34.1 të Konventës që është paraqitur më poshtë:

1.1.1 Norma bazë do të jetë një tarifa maksimale specifike e shtetit për dërgimin tokësor për koli dhe për kilogram. Këto çmime do të llogariten duke caktuar çmimin në 71.4% të normës së vendosur nga një operator i caktuar individual për vitin 2004, plus çdo rregullim të inflacionit të kërkuar sipas nenit RC189.

1.1.2 Megjithatë, nëse norma e re bazë e dërgimit tokësor është më e ulët se 2.85 SDR për koli dhe 0.28 SDR për kilogram, në varësi të tavanit të përcaktuar në pikën 1.1.3, çmimi i dërgimit tokësor i zbatueshme për një operator të caktuar do të jetë niveli minimal global i normës së dërgimit tokësor prej 2.85 SDR për koli dhe 0.28 SDR për kilogram.

1.1.3 Kur një operator i caktuar i veçantë aplikon çmimin minimal të dërgimit tokësor siç është përcaktuar në pikën 1.1.2, zbatimi real do të jetë subjekt i një çmimi tavan të pagesës së kombinuar për koli dhe për kilogram prej 4.25 SDR për një koli prej 5 kilogram. Në qoftë se 71.4% e shumës së pagesës të vitit 2004 për koli dhe për kilogram është nën 4.25 SDR, çmimi minimal do të përbëhet në përputhje me pikën 1.1.2.

1.1.4 Për qëllime të përcaktimit të çmimeve të transportit tokësor, termi "operator i caktuar" do të konsiderohet për t'iu referuar çdo shteti ose territori që operon një shërbim të pavarur të kolipostës. Kur shërbimet e kolipostës të një shteti ose territori kryhen nga operatori i caktuar i një shteti apo territori tjetër, në përputhje me nenin 12 të Konventës, ato do të konsiderohen të jenë pjesë e këtij operatori të caktuar, si për qëllimin e përcaktimit të karakteristikave të shërbimit të dhënë, si dhe për llogaritjen e çmimeve të dërgimit tokësor sipas karakteristikave të shërbimeve të ofruara.

2. Pagesat e shpërblimeve

2.1 Me kusht që një operator i caktuar të përputhet me pranimin e detyruar të përgjegjësisë për kolidet e humbura, vjedhura dhe dëmtuara në bazë të nenit 21 të Konventës dhe në përputhje me përdorimin e detyrueshëm të barkodeve standarde UPU S10d sipas nenit RC 161.1, ky operator i caktuar do të ketë të drejtën të rrisë tarifat bazë të përmendura në pikën 1 duke ofruar "karakteristikave të shërbimit" një dhe katër të përcaktuara qartë (të përshkruara më poshtë), të cilat, nga ana tjetër, do ta mundësojnë atë që të kualifikohet për pagesat e shpërblimeve deri në 40 % të tarifës së tij bazë. Mundësia e kualifikimit për pagesat e shpërblimeve do të jetë e hapur për çdo operator të caktuar, pavarësisht nëse është dhënë një tarifë bazë specifike për shtetin ose globale.

3. Përkufizimi i karakteristika të shërbimeve dhe pagesat e shpërblimeve

3.1 Karakteristikat e shërbimit 1: gjurmimi dhe gjetja

3.1.1 Nëse një operator i caktuar i jep informacione për gjurmimin e kolive që kanë një barkod të standardeve UPU S10 dhe është i pajisur teknologjikisht për të transmetuar të dhëna për të gjitha ngjarjet e detyrueshme të gjurmimit dhe në mënyrë aktive transmeton këto të dhëna në përputhje me elementet e të dhënave shoqëruese të përcaktuara në nenin RC 161bis.1.1 për të gjithë operatorët e caktuar partnerë, në përputhje me objektivat treguese të përmbushjes për kohët e transmetimit të përcaktuara në RC 161ter, ai ka të drejtë të marrë, përveç kësaj, një shpërblim prej 10 % të çmimeve bazë të referuara në pikën 1

3.1.1.1 (I fshirë)



3.1.1.2 (I fshirë)

3.1.1bis Nëse një operator i caktuar jep të dhëna për pista dhe gjurmë rreth kolive të dërguara që kanë një barkod standard UPU S10d dhe është i pajisur teknologjikisht për të transmetuar të dhëna për ngjarjet EME dhe EMF dhe transmeton në mënyrë aktive këto të dhëna në përputhje me elementet e të dhënave shoqëruese të përcaktuara në nenin RC 161bis.1.2 dhe në përputhje me objektivat treguese të përmbushjes për kohët e transmetimit të përcaktuara në RC 161ter, ai do të ketë të drejtë të marrë, përveç kësaj, një shpërblim prej 5 % të çmimeve bazë të referuara në pikën 1.

3.1.1ter Nëse një operator i caktuar jep informacionet gjurmimit dhe gjetjes rreth dërgimit të kolive që kanë një barkod standard UPU S10d dhe është i pajisur teknologjikisht për të transmetuar të dhëna të nivelit të informacionit duke përdorur mesazhet e versionit 2 PREDES dhe versionit 1.1 RESDES, dhe transmeton në mënyrë aktive të dhëna të tilla në përputhje me përcaktimin dhe elementet shoqëruese të dhënave të përcaktuara në nenin RC 161bis.2 dhe me objektivat treguese të përmbushjes për kohët e transmetimit të përcaktuara në RC 161ter, ai do të ketë të drejtë të marrë, përveç kësaj, një shpërblim prej 5 % të çmimeve bazë të referuara në pikën 1.

3.1.1 quater Nëse një operator të caktuar plotëson objektivin e caktuar në nenin RC 161quater 1.2, ai do të ketë të drejtë të marrë, përveç sa më sipër, një shpërblim prej 5 % për qind të çmimeve bazë të përmendura në pikën 1.

3.2 Karakteristika e Shërbimit 2: dorëzimet në shtëpi

3.2.1 Përveç klientëve me kuti postare vullnetare P.O, në qoftë se një operator i caktuar bën një përpjekje fillestare për shpërndarjen fizike në adresën e marrësit dhe, nëse marrësi ose çdo person tjetër në adresë mungon, lë një kartelë dhe për artikujt e tatueshëm dhe me taksë doganore, në qoftë se një operator i caktuar i ofron marrësit mundësinë e pagimit të tatimit apo detyrimin doganor edhe angazhimit të shpërndarjes fizike të sendit, ai do të marrë, përveç kësaj, një shpërblim prej 5 % të çmimeve bazë të përmendura në pikën 1.

3.3 (Fshirë.)

3.4 (Fshirë.)

3.5 Karakteristikat e Shërbimeve 3: standardet e dorëzimit

3.5.1 Në përputhje me nenin 20.1 dhe 20.2 të Konventës, nëse operatorët e caktuar i sigurojnë të gjithë informacionin e mëposhtëm të kërkuar për hyrjen në Përmbledhjen e Postës së kolive, ai ka të drejtë të marrë, përveç kësaj, një shpërblim prej 5% nga normat bazë të përmendura në pikën 1.

3.5.1.1 Standardet e dorëzimit për koolitë e postës ajrore dhe tokësore, siç është përcaktuar nga matrica dhe titujt në këtë Përmbledhje të Postës së kolive.

3.5.1.2 Një shënim i kohës mesatare të zhdoganimit për koolitë e transportit ajror ose dhe tokësor.

3.5bis Karakteristikat e shërbimit 4: përdorimi i Sistemit të përbashkët të Reklamimeve UPU bazuar në Internet

3.5bis.1 Një operator i caktuar do të ketë të drejtë të marrë, shtesë, një shpërblim prej 5 % të çmimit bazë të referuar në paragrafin 1 në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme kumulative:

3.5bis.1.1 ai përdor Sistemin e përbashkët të Reklamimeve UPU bazuar në Internet për të trajtuar të gjitha reklamimet me operatorët e caktuar duke përdorur këtë sistem të përbashkët në bazë të nenit RC 144.8bis, dhe arrin objektivin e caktuar në nenin RC 144.8ter

4. Me kusht që të përmbushen kërkesat minimale të pikës 2.1, matja e karakteristikave të shërbimit do të bazohet në performancën e secilit prej operatorëve të caktuar. Në rastet kur raportet e njohura e UPU nuk japin informacionin e nevojshëm, Byroja Ndërkombëtare do të kërkojë konfirmimin nga operatori i caktuar për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e karakteristikave të shërbimit dhe ka të drejtë për shpërblimin përkatës.

4.1 Karakteristikat e shërbimeve 1: gjurmimi dhe gjetja

4.1.1 (Fshirë.)

4.1.1bis Nëse operatori i caktuar transmeton ngjarje EMC, EMD, EMH dhe IKE për koolitë në hyrje për partnerët e tij, dhe transmetimi është në funksion dhe vazhdimisht operativ, ai do të marrë një shpërblim prej 10% duke filluar më 1 janar të vitit vijues.

4.1.1ter Nëse operatori i caktuar transmeton ngjarje EMF për artikuj për të cilat ai ofron një ngjarje EME (me përjashtim të rastit kur qeveritë dhe ligjet detyruese e parandalojnë këtë), dhe transmetimit në funksion dhe vazhdimisht operativ, ai do të marrë një shpërblim prej 5 %.

4.1.1quater Nëse operatori i caktuar transmeton mesazhe PREDES V2 te partnerët e tij, dhe transmeton mesazhe RESDES për mesazhet PREDES që ai merr, dhe transmetimi në funksion dhe vazhdimisht operativ, ai do të marrë një shpërblim prej 5 %.

4.1.1quinques Nëse operatori i caktuar transmeton ngjarjet EMH dhe / ose EMI te partnerët e saj për 90 % të kolive në hyrje për të cilat është transmetuar një ngjarje EMD, do të marrë një shpërblim prej 5 %.

4.2 Karakteristikat e dorëzimit 2: dorëzimi në shtëpi

4.2.1 Byroja Ndërkombëtare do të kërkojë informacion nëse një operator i caktuar zbaton dispozitat e përcaktuara në përkufizimin e karakteristikave të shërbimit 2, të përcaktuara në pikën 3.2.1, ose jo. Nëse operatori i caktuar, tregon që ai ofron karakteristikën e shërbimit, atëherë, kur është i përshtatshëm, do të marrë një shpërblim prej 5%. Pavarësisht përgjigjes së operatorit të caktuar, në bazë të informacionit të dhënë në një raport nga Byroja Ndërkombëtare për një vendim mbi përshtatshmërinë, POC, mund të vendosë se një operator i caktuar nuk ka të drejtën për shpërblim. Nëse operatori i caktuar nuk arrin të japë asnjë informacion, nuk do të kualifikohet për shpërblimin prej 5 %.

4.2.1.1 Nëse kufizime qeveritare ose ligjore të detyrueshme nënkuptojnë se një operator i caktuar përballet me kufizime të caktuara në zbatimin e karakteristikës së shërbimit 2, ai mund të jetë në gjendje të kualifikohet për shpërblimin me 5% në qoftë se publikon informacion mbi llojin e kufizimit në regjistrimin e përshtatshëm në Përmbledhjen e Kolive postare. Saktësia e të dhënave të regjistruara nga operatorët e caktuar në Përmbledhjen e Kolive Postare mund të jetë objekt i shqyrtimit nga Byroja Ndërkombëtare në rastet kur kanë lindur dyshime nga operatorët e caktuar partnerë. Në këto raste, e drejta për shpërblimin prej 5 % mund të rishikohet.

4.3 (Fshirë.)

4.4 (Fshirë.)

4.5 Karakteristikat e dorëzimit 3: Standardet e dorëzimit

4.5.1 Nëse një operator i caktuar jep të gjithë informacionin e përcaktuar në nenin 20.1 dhe 20.2 të Konventës dhe siç përshkruhet në përkufizimin e karakteristikave të shërbimit 3, duke përfshirë të dhënat ose shënimin e një kohe mesatare për zhdoganimin, dhe për këtë arsye ka një regjistrim të plotë në Përmbledhjen e Kolive të Postës dhe përveç kësaj, ofron një përditësim ose konfirmim vjetor të këtij informacioni duke përfshirë të dhënat ose shënimin e kohës për zhdoganimin, që nga 31 gushti i vitit të mëparshëm, ai do të marrë një shpërblim prej 5%. Një operator i caktuar që nuk ka një regjistrim të plotë në Përmbledhje nuk do të kualifikohet për shpërblimin.

4.5bis Karakteristika të shërbimit 4: përdorimi Sistemit të përbashkët të reklamimit të bazuar në Internet

4.5bis.1 Nëse një operator i caktuar 4 përdor Sistemin e përbashkët të Reklamimit të bazuar në Internet në përputhje me RC 144.8bis dhe arrin objektivat e performancës të përcaktuar në RC 144.8ter, do të marrë një shpërblim prej 5%.

5. (fshirë.)

Neni RC 189

Ndryshimi i çmimeve të rrugës së dërgimit

1. Rritja e tarifave bazë të çmimeve të rrugës së dërgimit për shkak të rregullimeve të lidhura me inflacionin, do të hyjë në fuqi vetëm më 1 janar. Operatorëve të caktuar, të cilët dëshirojnë të kërkojnë një rritje të lidhur me inflacionin në çmimin e tyre bazë për rrugën e dërgimit, do tu kërkohej ti japin Byrosë, brenda 31 Gushtit të vitit para kësaj date, dëshmi të dokumentuara në bazë të Indeksit zyrtar të përgjithshëm të çmimit të konsumatorit në mbështetje të këtij pretendimi. Në asnjë rast rritja e lidhur me inflacionin nuk do të jetë mbi 5% për çdo vit mbi të cilin është llogaritur norma e inflacionit. Operatori i caktuar do t'i japë burimin zyrtar dhe emrin e organizatës përgjegjëse për indeksin e publikuar dhe periudhën e marrë në konsideratë. Nëse ky afat nuk është respektuar, ky modifikim nuk do të hyjë në fuqi deri më 1 janar të vitit pasardhës. Rritjet e çmimeve bazë të rrugës së dërgimit për shkak të rregullimeve të lidhura me inflacionin mund të hyjë në fuqi më 1 janar.

1bis Pagesa e shpërblimit e lidhur me rritjen në çmimet bazë të rrugës së dërgimit bazuar në



karakteristikat e shërbimeve të ofruara mund të zbatohet dy herë në vit, më 1 janar dhe më 1 korrik. Operatorët e caktuar duhet të tregojnë Byrosë Ndërkombëtare karakteristikat e shërbimit që ata do të ofrojnë prej 1 janarit dhe 1 korrikut, më 31 gusht të vitit para kësaj date. Nëse operatorët e caktuar nuk e kanë bërë të ditur ofertën e tyre ekzistuese ose qëllimin e tyre për të zbatuar këto karakteristika të shërbimit në pyetësin vjetor, këto modifikime të mundshme nuk do të hyjnë në fuqi përpara datës 1 janar të vitit të ardhshëm, pavarësisht se kur zbatohen karakteristikat e shërbimit nga operatori i caktuar.

1bis.1 Për rritjen e çmimeve bazë të rrugës së dërgimit në fuqi nga 1 janari për karakteristikat e shërbimeve të ofruara, karakteristikat përkatëse të shërbimit duhet të jenë në funksion dhe vazhdimisht operativ që nga 1 korriku i vitit të mëparshëm dhe në vazhdim.

1bis.2 Për rritjen e çmimeve bazë të rrugës së dërgimit të zbatueshme nga data 1 korrik për karakteristikat e shërbimeve të ofruara, karakteristikat përkatëse të shërbimit duhet të jenë në funksion dhe vazhdimisht operative të paktën që nga 1 janari i atij viti dhe në vazhdim.

1bis.3 Një operator i caktuar që kërkon një rritje në çmimet bazë të rrugës së dërgimit bazuar në futjen e karakteristikave të shërbimeve të reja, i cili dështon në zbatimin e karakteristikës të shërbimit deri në datën e treguar, do të informojë menjëherë Byronë Ndërkombëtare. Në një rast të tillë, rritja tarifës bazë të rrugës së dërgimit nuk do të zbatohet.

1bis.4 Byroja Ndërkombëtare do të monitorojë nëse karakteristikat e shërbimeve janë në funksion dhe operatorët e caktuar plotësojnë kërkesat sipas këtij neni, para kryerjes së modifikimeve të mundshme.

1ter Ndryshimet në pagesën e shpërblimit të çmimit të rrugës së dërgimit, bazuar në rezultatin e karakteristikave të shërbimit të ofruar mund të zbatohen dy herë në vit, më 1 janar dhe 1 korrik. Byroja Ndërkombëtare do të njoftojë çmimet e aplikueshme të rrugës së dërgimit për të gjitha operatorët e caktuar deri më 30 shtator të vitit para atij në të cilin ato hyjnë në fuqi, duke përfshirë çdo ndryshim të qëllimshëm të çmimeve të rrugës së dërgimit që do të zbatohen nga 1 korriku për shkak të kualifikimit të operatorëve të caktuar për pagesat shtesë të shpërblimit. Byroja Ndërkombëtare do të konfirmojë për të gjithë operatorët e caktuar deri më 31 mars çdo ndryshim në ILR që do të zbatohet nga data 1 korrik.

2. Me iniciativën e operatorëve të caktuar, uljet e çmimeve të rrugës së dërgimit mund të hyjnë në fuqi më 1 janar, 1 prill, 1 korrik ose 1 tetor. Ato do të njoftohen pa vonesë operatorëve të caktuar nga Byroja Ndërkombëtare.

Neni RC 190 Çmimet e transitit në tokë

1. Çmimet e aplikuar për llogaritjen e transitit në tokë në përputhje me nenin 34.2 të konventës janë paraqitur në vijim:

1.1 0.200 mijë të SDR për kilogram dhe për kilometër deri në 1,500 kilometra;

1.2 0.140 të mijtat e SDR për kilogram dhe për kilometër shtesë deri në 5,000 kilometra;

1.3 0.100 të mijtat e SDR për kilogram dhe për kilometra shtesë;

1.4 tarifa e distancës do të llogaritet për 100-kilometra distancë për hap të distancës, të bazuara në vlerën mesatare në çdo hap.

2. Për koltë në transit à découvert, operatorët e caktuar ndërmjetës do të jenë të autorizuar të kërkojnë një normë të vetme prej 0.40 SDR për artikull.

Neni RC 191 Zbatimi i çmimeve të transitit në tokë

1. Nuk do të aplikohen çmime të transitit në tokë për:

1.1 transportin e dërgesave ajrore midis dy aeroporteve që shërbejnë në të njëjtin qytet;

1.2 transporti i dërgesave të tilla mes një aeroporti që shërben në një qytet dhe një magazine që gjendet në të njëjtin qytet dhe kthimin e të njëjtave dërgesa për ri-dërgim.

2. Secili prej operatorëve të caktuar që merr pjesë në transport do të jetë i autorizuar të mbledhë, për çdo koli, çmimin e transitit të tokës të zbatueshme për distancën përkatëse. Nëse nuk ka një rrugë tokësore, do të zbatohet vetëm çmimi i përmendur në nenin RC 190.2.

3. Ri-dërgimi, kur është i aplikueshëm pas magazinimit, nga operatorët e caktuar të një shteti

ndërmjetës të dërgesave në transit à découvert që hyjnë dhe dalin nga i njëjti port ose aeroport (transit që nuk përfshin një rrugë tokësore) do t'i nënshtrohen çmimit unik për koli të përmendur në nenin 190.2 RC, por jo me çmimet e transimit të tokës.

4. Kur një shërbim i huaj i transportit kalon në territorin e një shteti pa pjesëmarrjen e shërbimeve të këtij të fundit në përputhje me nenin RC 160.3, kolitë e transportuara në këtë mënyrë nuk do t'i nënshtrohen çmimit të transimit të tokës.

Neni RC 192

Çmimi për transportin detar

1. Çmimet e aplikuara për të llogaritur tarifën e transportit detar në përputhje me nenin 34.3 të Konventës janë paraqitur më poshtë:

- 1.1 0.070 të mijtat e SDR për kilogram dhe milje detare (1.852 km) deri në 1,000 milje detare;
- 1.2 0.040 të mijtat e SDR për kilogram dhe milje detare shtesë deri 2,000 milje detare;
- 1.3 0.034 të mijtat e SDR për kilogram dhe milje detare shtesë deri 4,000 milje detare;
- 1.4 0.022 të mijtat e SDR për kilogram dhe milje detare shtesë deri 10,000 milje detare;
- 1.5 0.015 të mijtat e SDR për kilogram dhe milje detare shtesë ;
- 1.6 tarifa e distancës do të llogaritet deri në 100 milje detare për hap të distancës, bazuar në vlerën mesatare në çdo hap.

Neni RC 193

Zbatimi i çmimit për transportin detar

1. Nëse është e nevojshme, hapat e distancës të përdorur për të përcaktuar shumën e tarifës detare në fuqi në mes të dy shteteve anëtare do të llogariten në bazë të një distance të mesatare së ponderuar. Kjo do të përcaktohet në lidhje me tonazhin të dërgesës së kryer midis porteve përkatëse të dy shteteve anëtare

2. Transporti detar mes dy porteve të të njëjtit shtet anëtar nuk do të sjellë marrjen e çmimit të transportit detar kur operatori i caktuar i atij shteti merr, për të njëjtat koli, pagesa në lidhje me transportin tokësor.

3. Çmimi i transportit detar për operatorët e caktuar ose shërbimet ndërmjetëse do të jetë i zbatueshëm për kolitë ajrore vetëm kur kolia është transportuar nga një shërbim detar ndërmjetës. Për këtë qëllim çdo shërbim detar i ofruar nga operatori i caktuar i origjinës ose i destinacionit do të konsiderohet si shërbim i ndërmjetëm.

4. Në rastin e një rritje, kjo gjithashtu do të aplikohet për kolitë me origjinë në shtetin anëtar në të cilin i përkasin shërbimet që ofrojnë transportin detar. Megjithatë, ky detyrim nuk zbatohet as në marrëdhëniet midis një shteti anëtar dhe territoreve për të cilat janë përgjegjëse marrëdhëniet ndërkombëtare, as në marrëdhëniet në midis këtyre territoreve.

5. Në rastin e modifikimit të çmimeve të transportit detar do të zbatohet neni RC 189.

Neni RC 194

Zbatimi i çmimeve të reja në vijim të ndryshimeve të paparashikuara në itinerar

1. Arsytet e forcës madhore ose ndonjë ngjarje tjetër e paparashikuar mund të detyrojë një operator të caktuar të përdorur për transportin e kolive të saj, një rrugë të re dërgimi, e cila shkakton shtesa të koston e transportit detar ose tokësor. Në një rast të tillë, operatorit të caktuar do ti kërkohej që të njoftojë menjëherë me anë të telekomunikacioneve të gjithë operatorët e caktuar, posta ose kolitë në transit à découvert të të cilëve janë dërguar përmes shtetit të tij. Nga dita e pestë pas dërgimit të këtij informacioni, operatori i caktuar ndërmjetës do të jetë i autorizuar për t'i ngarkuar operatorit të caktuar të origjinës çmimin e transportit tokësor ose detar që i korrespondon rrugës së re.

Neni RC 195

Pesha e dërgesave e përdorur për shpërblimin e operatorëve të caktuar

1. Për qëllimet e shpërblimit të operatorëve të caktuar të destinacionit ose transimit, pesha bruto e



dërgesës do të përfshijë peshën e kontenierëve (shporta, thasë postar, etj), por nuk do të përfshijë atë të kontenierëve të ngarkimit ose të linjës ajrore. Operatorët caktuar të origjinës dhe të destinacionit, megjithatë, mund të bien dakord reciprokisht për të përdorur peshat neto, pavarësisht nga metoda e regjistrimit e përdorur për plotësimin e faturave të kolive CP 87 ose CP 88.

Neni RC 196
Caktimi i çmimeve

1. Caktimi i çmimeve për operatorët të caktuar të interesuar, në parim, do të bëhet në lidhje me çdo koli.

Neni RC 197

Çmimet dhe detyrimet e kredituara operatorëve të tjerë të caktuar nga operatori i caktuar i origjinës së dërgesës

1. Në rastin e shkëmbimit të dërgesave të mbyllura, operatori i caktuar i origjinës së dërgesës do kreditojë operatorin e caktuar e destinacionit dhe çdo operator të caktuar ndërmjetës me tarifat e tij detare dhe tokësore, duke përfshirë edhe tarifat e veçanta të autorizuar nga Konventa ose Protokollit i saj Përfundimtar.

2. Në rastin e shkëmbimit në transit à découvert operatori i caktuar i origjinës së dërgesës do të kreditojë:

2.1 Operatorin e caktuar të destinacionit të dërgesës me çmimet e renditura në pikën 1, si dhe tarifat e detyruara operatorëve të caktuar ndërmjetës të njëpasnjëshëm dhe operatorit të caktuar të destinacionit të kolisë.

2.2 Operatorit të caktuar të destinacionit të dërgesës me shumat në lidhje me tarifat e transportit ajror për të cilat ai ka të drejtë për ri-dërgimin me rrugë ajrore të kolisë.

2.3 Operatorëve të caktuar ndërmjetës që paraprijnë operatorin e caktuar të destinacionit të dërgesës me çmimet e renditura në pikën 1.

3. Tarifat për trajtimin e dërgesave të mbyllura të transitit do të paguhet nga operatori i caktuar i origjinës. Çmimi i aplikuar do të jetë 0.195 SDR për kilogram për postat ajrore dhe S.A.L., dhe 0.170 SDR për kilogram për vitin 2006, 0.180 SDR për kilogram për vitin 2007, 0.190 SDR për kilogram për vitin 2008 dhe 0.195 SDR për kilogram për vitin 2009 për postën tokësore.

4. Transportet në të njëjtin aeroport, gjatë transmetimit, të kolive të postës ajrore të transportuar me sukses nga disa shërbime ajrore të veçanta do të kryhet pa shpërbim.

Neni RC 198

Caktimi dhe kompensimi i çmimeve, pagesave dhe tarifave, në rast të kthimit tek dërguesi ose ri-adresimit

1. Kur çmimet, pagesat dhe tarifat nuk janë paguar në kohën e kthimit tek dërguesi ose të ri-adresimit, operatori i caktuar që kthen ose ri-adreson do të procedojë siç tregohet më poshtë:

2. Në rastin e shkëmbimit të postës së drejtpërdrejtë, operatori i caktuar që kthen ose ri-adreson do të rekuperojë nga operatori i caktuar tek i cili është adresuar dërgesa:

2.1 çmimet që i takojnë atij dhe operatorit të caktuar ndërmjetës;

2.2 tarifat dhe pagesat që i takojnë atij dhe që ai ka paguar.

3. Operatori i caktuar që kthen ose ri-adreson kolinë në një dërgesë të mbyllur do të kreditojë administratat operatorët e caktuar ndërmjetës me çmimet që i takojnë për ato.

4. Në rastin e transmetimit në transit à découvert, operatori i caktuar ndërmjetës duhet të debitohet nga operatori i caktuar i cili kthen ose ri-adreson kolinë me shumat e përmendura në pikën 2. Ai do të kreditojë veten duke debituar operatorin e caktuar të cilit i dorëzon kolinë, me shumën që i përket atij dhe operatorit të caktuar që kthen ose ri-adreson. Kjo procedurë do të përsëritet, nëse është nevoja, nga çdo operator i caktuar ndërmjetës.

5. Detyrimet e transportit ajror për koltë e kthyer tek dërguesit ose ri-adresuar me anë të transportit ajror do të rekuperohen, sipas rastit, nga operatori i caktuar i shteteve nga ku ka ardhur kërkesa për kthim apo ri-adresim.

6. Vendosi dhe rikuperimi i çmimeve, pagesave dhe tarifave në rastin e ri-adresimit të kolive të

dërguara gabimi do të bëhet në përputhje me nenin RC 185.4.

7. Detyrimet për transportin ajror për dërgimin e kolive të postës ajrore të devijuara gjatë transportit do të caktohen në përputhje me nenet RC 199 dhe RC 201.

Neni RC 199

Llogaritja e detyrimeve të transportit ajror

1. Detyrimet e transportit ajror në lidhje me koltë e postës ajrore do të llogariten në përputhje, në njërin anë, me çmimet aktuale bazë dhe distancat kilometrike të dhëna në "Listën e distancave të Postës ajrore" dhe, nga ana tjetër, me peshën bruto të dërgesës. Çmimi aktual bazë mund të jetë më e vogël dhe maksimumi i barabartë me çmimin e përmendur në nenin 33.1 të Konventës.

2. Detyrimet e transportit ajror të pagueshme operatorit të caktuar ndërmjetës për koltë e transportit ajror à découvert do të jenë fikse në parim siç tregohet në pikën 1, por për gjysmë kilogrami për çdo shtet të destinacionit. Megjithatë, kur territori i shtetit të destinacionit të këtyre kolive shërbehet me një ose më shumë linja me disa ndalesa në atë territor, detyrimet do të llogariten në bazë të një çmimi mesatar të ponderuar. Kjo do të përcaktohet në bazë të peshës së kolive të shkarkuara në çdo ndalesë. Detyrimet për t'u paguar do të llogariten për çdo koli individuale, pesha e secilës e rrumbullakosur në gjysmën më të afërt të kilogramit.

Neni RC 200

Detyrime të transportit ajror për koli të humbura ose shkatërruara

1. Operatori i caktuar i origjinës do të përjashtohet nga çdo pagesë në lidhje me transportin ajror të kolive të transportit ajror të humbura apo të shkatërruara si pasojë e një aksidenti të ndodhur në avion ose ndonjë shkak tjetër që përfshin përgjegjësinë e transportuesit ajror. Ky përjashtim zbatohet për çdo pjesë të fluturimit të linjës së përdorur.

Neni RC 201

Detyrime të transportit ajror për dërgesat ose thasët e devijuar ose të dërguar gabim

1. Operatori i caktuar i origjinës së një dërgese e cila ka shkuar jashtë rrugës së saj gjatë transportit duhet t'i paguajë detyrimet e transportit për dërgesën në lidhje me sektorët e mbuluar.

2. Ai do ta caktojë detyrimet e transportit deri në aeroportin e shkarkimit të caktuara fillimisht për faturën e dërgimit CN 38 kur:

2.1 rruga aktuale e dërgimit aktual nuk njihet;

2.2 detyrimet për sektorët aktualisht të mbuluar nuk janë kërkuar; ose

2.3 devijimi mund ti atribuohet linjës ajrore e cila realizon transportin

3. Detyrimet shtesë në lidhje me sektorët aktualisht të mbuluar nga ana e dërgesa e devijuar do të rimbursohen si më poshtë:

3.1 nga operatori i caktuar që ka kryer gabim në rastin e dërgimit të gabuar.

3.2 nga operatori i caktuar i cili ka mbledhur detyrimet e transportit të paguara linjës ajrore, kur kjo e fundit ka shkarkuar në një vend të ndryshëm nga ai i treguar në faturën e dërgimit CN 38.

4. Dispozitat e përcaktuara në pikat 1 deri në 3 do të zbatohen për analogji, kur vetëm një pjesë e një dërgese është shkarkuar në një aeroport të ndryshëm nga ai që tregohet në faturën e dërgimit CN 38.

5. Operatori i caktuar i origjinës së një dërgese ose thesi të dërguar gabim për arsye të një gabimi të etiketimit duhet të paguajë detyrimet e transportit në lidhje me të gjithë distancën e mbuluar në përputhje me nenin 33.3.1 të Konventës.

Neni RC 202

Pagesa e detyrimeve të transportit ajror për transportit e thasëve bosh

1. Detyrimet për transportin e thasëve bosh do të paguhet nga operatori i caktuar që zotëron thasët.

2. Shkalla maksimale e zbatueshme në lidhje me transportin ajror të njoftimeve të thasëve bosh do të korrespondojë me 30 % të çmimit bazë të vendosur në përputhje me dispozitat e nenit 33.1 të Konventës.



KAPITULLI 10 PËRGATITJA DHE SHLYERJA E LLOGARIVE

Neni RC 203 Përgatitja e llogarive

1. Zyrat e shkëmbimit të çdo operatori të caktuar do të përgatisin menjëherë, në fund të çdo muaji ose të një tremujori, një situacion CP 94 për të gjithë artikujt e marrë nga një operator i caktuar sipas zyrës dërguese dhe sipas dërgesave.

2. Në rast të ndryshimit të faturave të kolive CP 88 ose CP 87, numri dhe data e shënimit të verifikimit CP 78 të përgatitur nga zyra e shkëmbimit transferuese ose zyra e shkëmbimit tek e cila është bërë transferimi do të tregohen në kolonën "Vëzhgime" të situacionit CP 94

3. Situacioni CP 94 do të përmbledhet në një llogari CP 75.

4. Operatorët e caktuar që kanë qenë kreditorë neto në vitin paraardhës do të kenë të drejtën e zgjedhjes për të marrë pagesën me baza mujore, tremujore, gjashtëmujore ose vjetore. E drejta e zgjedhjes e ushtruar do të mbetet në fuqi për një periudhë prej një viti kalendarik duke filluar nga 1 janari.

5. Operatorët e caktuar mund të përdorin sistemin e faturimit të drejtpërdrejtë ose sistemin e dyanshëm të kompensimit.

6. Sipas sistemit të faturimit të drejtpërdrejtë, llogaritë CP 75 do të shërbejnë si faturat për të shlyerjen e drejtpërdrejtë Llogaritë CP 75 të shoqëruara nga situacioni CP 94, por pa faturat e kolive, do të dërgohen me anë të rrugës më të shpejtë të operatorit të caktuar të interesuar për pranimin dhe pagesën në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore ose vjetore. Kjo shpërndarje duhet të bëhet gjatë dy muajve pas mbërritjes së faturës së fundit të periudhës me të cilën ajo lidhet.

7. Operatori i caktuar debitor do të paguajë shumën e faturuar brenda një periudhe prej dy muajsh. Nëse operatori i caktuar i cili ka dërguar llogarinë nuk merr ndonjë njoftim të ndryshimit brenda dy muajve, do ti konsiderojë llogaritë si plotësisht të pranuar. Kur ka ndonjë ndryshim më të lartë se 9.80 SDR, situacioni CP 94 duhet të korrigjohet dhe të bashkëlidhet me llogarinë e ndryshuar CP 75 si dëshmi. Operatorët e caktuar debitorë mund të refuzojnë të kontrollojnë dhe pranojnë llogaritë CP 75 të cilat nuk janë paraqitur nga operatorët e caktuar kreditorë brenda gjashtë muajve nga periudha të cilës ato i referohen.

8. Sipas sistemit dypalësh të kompensimi, operatori i caktuar kreditor do të përgatisë të dyja llogaritë CP 75 dhe CN 52 dhe do ti paraqesë të dyja njëkohësisht dhe me anë të rrugës më të shpejtë tek operatori i caktuar debitor në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore ose vjetore. Megjithatë, sapo llogaritë CP 75 midis dy operatorëve të caktuar të jenë pranuar apo konsideruar si plotësisht të pranuar, ato mund të përmbledhen në një llogari të përgjithshme CN 52 të përgatitur në një nga frekuencat e sipërpërmendura.

9. Operatori i caktuar debitor do të pranojë ose do të ndryshojë llogaritë CP 75 dhe CN 52 dhe do të paraqesin pagesën tek operatori i caktuar kreditor brenda dy muajve. Nëse operatori i caktuar i cili ka dërguar llogaritë nuk ka marrë ndonjë njoftim të ndryshimit brenda dy muajve, llogaritë do të konsiderohen si plotësisht të pranuar.

10. Kur operatori i caktuar debitor konstaton një ndryshim më të lartë se 9.80 SDR, situacionet CP 94 do të korrigjohet dhe do të bashkëlidhen me llogarinë e ndryshuar CP 75, si dëshmi.

11. Kur bilanci i një llogarie CP 75 ose CN 52 nuk kalon 163.35 SDR, ajo do të mbartet në llogarinë e ardhshme CP 75 apo CN 52 kur operatorët e caktuar të interesuar marrin pjesë në sistemin e kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare.

Neni RC 204 Shlyerja e llogarive

1. Shlyerjet e llogarive ndërkombëtare që rrjedhin nga trafiku postar ndërmjet operatorëve të caktuar mund të konsiderohen si transaksionet aktuale dhe të realizohen në përputhje me detyrimet aktuale ndërkombëtare të shteteve anëtare të interesuara, kur ka marrëveshje për këtë qëllim. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve, llogaritë do të shlyhen në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

2. Çdo operator i caktuar do të hartojë llogaritë e tij dhe do t'ia paraqesë ato në dy kopje të interesuarve të tjerë. Nëse është e nevojshme të ndryshohet ose të shoqërohet nga një deklaratë e mospërputhjes, një kopje e pranuar do të kthehet tek operatori i caktuar kreditor. Kjo llogari do të shërbejë si

bazë për përgatitjen, nëse është e nevojshme, llogarisë përfundimtare të likuidimit midis dy operatorëve të caktuar.

3. Operatorët e caktuar mund të shlyejnë llogaritë e tyre në mënyrë të dyanshme, ose me anë të sistemit universal të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare, apo me ndonjë sistem tjetër të shlyerjes së llogarive. Pjesëmarrja në sistemin e kompensimit universal të Byrosë Ndërkombëtare do të jetë e hapur vetëm për operatorët e caktuar që kanë nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit që ka të bëjë me sistemin.

4. Operatori i caktuar kreditor do të zgjidhë metodën e shlyerjes së llogarisë pas konsultimit me operatorin e caktuar debitor. Nëse ka mosmarrëveshje, zgjedhja operatorit të caktuar kreditor do të mbizotërojë në të gjitha rastet. Në rastin e shlyerjes me anë të sistemit të kompensimit universal të Byrosë Ndërkombëtare të dy, kreditori dhe debitori, duhet të jetë nënshkruar të marrëveshjes përkatëse të anëtarësimit dhe reciprokisht dakord për të përfshirë llogarinë përkatëse në sistem.

5. Bilanci i çdo llogarie CP 75 të përgatitur nga operatori i caktuar kreditor do ti paguhet atij nga operatori i caktuar debitor në përputhje me dispozitat e neneve RC 205 deri në 208.

6. Në mungesë të një kompensimi të dyanshëm dhe të faturimit të bazuar mbi mos balancimin:

6.1 përgatitja dhe dërgimi i një llogarie të përgjithshme mund të kryhet, pa prituri ndryshim të mundshëm të llogarisë CP 75, sapo një operator i caktuar i cili i ka të gjitha llogaritë e periudhës në fjalë konstaton se është kreditor. Kontrolli i llogarive CN 52 nga operatori i caktuar debitor dhe pagesa e bilancit do të kryhet brenda një periudhe prej dy muajsh pas marrjes së llogarisë së përgjithshme; operatori i caktuar debitor nuk do të jetë i detyruar të pranojë llogaritë të cilat nuk i janë transmetuar brenda gjashtë muajve nga fundi i vitit të cilit ato i referohen;

6.2 çdo operator i caktuar të cilit vazhdimisht, çdo muaj, një operator tjetër i caktuar i mbetet debitor për një shumë më të madhe se 9,800.72 SDR do të ketë të drejtë të kërkojë një pagesë mujore në llogari prej deri në tre të katërtat e shumës së borxhit; kërkesa e tij do të plotësohet brenda një periudhe prej dy muajsh.

Neni RC 205

Shlyerja e llogarive nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare

1. Shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare do të realizohet sipas dispozitave të mëposhtme:

1.1 Pjesëmarrja në sistemin e kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare është e hapur për operatorët e caktuar ose shërbimet e tyre që kanë nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit që i detyron ato të veprojnë në përputhje me kushtet e kartës së sistemit.

1.2 Byroja Ndërkombëtare do të publikojë me anë të një qarkoreje një listë të përditësuar të pjesëmarrësve në intervale të përshtatshme

1.3 Një kreditor që ka ndërmend të shlyejë një llogari me anë të Byrosë Ndërkombëtare do t'i dërgojë një kopje të llogarisë në fjalë debitorit me shënimin "Proposé pour inclusion dans UPU*Clearing" (Propozuar për përfshirje në kompensimin e UPU). Në qoftë se debitori nuk do të propozojë modifikime, llogaria do ti dërgohet Byrosë Ndërkombëtare dhe kreditorit me shënimin "Accepté pour inclusion dans UPU*Clearing" (Pranuar përshirja në kompensimin e UPU). Në rast se debitori ka ndonjë propozim për ndryshim, llogaria do të kthehet te kreditori, i cili do i dërgojë llogarinë Byrosë Ndërkombëtare, në rast të pranimit të ndryshimit. Llogaritë do të dërgohen në Byrosë Ndërkombëtare vetëm kur ka një marrëveshje të plotë midis të dyve, debitorit dhe kreditorit.

1.4 Pagesa do të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kartën e sistemit.

1.5 Në rast të mos-pajtueshmërisë ose mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në kartën e sistemit nga një pjesëmarrës, Byroja Ndërkombëtare do të marrë masat e duhura dhe do të informojë të gjithë pjesëmarrësit për masave të marra.

Neni RC 206

Rregullimi i debive të papaguara që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare

1. Debitë e pagueshme si rezultat i shlyerjes së llogarive me anë të sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare nga çdo operator i caktuar të cilët janë vonuar mund të rregullohen ndaj kredive që i takojnë debitorit nga çdo operator tjetër i caktuar. Para se të ndërmarrë një hap të tillë, Byroja Ndërkombëtare do të



konsultohet me kreditorin në fjalë dhe për ti dërguar debitorit një kujtesë. Nëse pagesa nuk bëhet brenda një periudhe prej një muaji nga data e kësaj kujtesë, Byroja Ndërkombëtare do të jetë kompetente në mënyrë të njëanshme për të bërë rregullimet e nevojshme të kontabilitetit pasi informimit të të gjitha palëve të interesuara. Nuk është i nevojshëm pëlqimi i debitorit që nuk ka paguar në kohë.

2. Kur bën këto rregullime të kontabilitetit, Byroja Ndërkombëtare do të kompensojë vetëm llogaritë që janë të pranura nga të dy, nga debitori që nuk ka paguar në kohë dhe nga operatori i caktuar që i ka dhënë hua debitorit që në vonesë.

3. Debitori në vonesë nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj operatorit të caktuar që i ka dhënë hua për kreditë e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare kreditorit në përputhje me procedurën e përshkruar në paragrafin 1.

Neni RC 207

Pagesa e debive të shprehura në SDR. Dispozita të përgjithshme

1. Rregullat e përcaktuar në vijim për pagesën do të zbatohen për të gjitha borxhet që rrjedhin nga një transaksion postar dhe janë të shprehura në SDR. Këto borxhe mund të rezultojnë nga llogaritë e përgjithshme apo deklaratat e hartuara nga Byroja Ndërkombëtare ose nga llogaritë e likuidimit apo deklaratat që nuk janë hartuar nga Byroja. Këto rregullat do të lidhen me zgjidhjen e mospërputhjeve, me interes ose, sipas rastit, të pagesave në llogari.

2. Çdo operator i caktuar mund të shlyejë detyrimet e tij me anë të pagesave në llogari, nga e cila do të zbriten borxhet e saj kur ato janë vërtetuar.

3. Me kusht që të jenë respektuar periudhat për pagesën, çdo operator i caktuar mund të shlyejë borxhet postare të shprehura në SDR nga kreditë kompensuese ose debitë në marrëdhëniet e saj me një tjetër operator të caktuar. Kompensimi mund të zgjatet me marrëveshje të ndërsjellë për debitë që lindin nga shërbimet e telekomunikacionit kur të dy operatorët të caktuar kryejnë shërbimet postare dhe të telekomunikacionit. Kompensimi nuk mund të kryhet mbi debitë që kanë të bëjnë me transaksionet e kontraktuara nga një organizatë apo shoqëri nën kontrollin e një operatori të caktuar në qoftë se ai operator i caktuar e kundërshton këtë.

4. Përfshirja e një llogarie të postës ajrore në një llogari të përgjithshme që përmban debi të ndryshme nuk do të sjellë në shtyrjen e pagesës së tarifave të transportit ajror që i përkasin linjës ajrore në fjalë.

Neni RC 208

Rregullat e pagesës së llogarive të pashlyera nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare

1. Debitë do të paguhen në monedhën e zgjedhur nga operatori i caktuar kreditor pas konsultimit me operatorin e caktuar debitor. Nëse ka mosmarrëveshje, zgjedhja e operatorit të caktuar kreditor do të mbizotërojë në të gjitha rastet. Nëse operatori i caktuar kreditor nuk specifikon një monedhë, zgjedhja do të takojë operatorit të caktuar debitor.

2. Shuma e pagesës, siç përcaktohet në monedhën e përzgjedhur, do të jetë ekuivalente në vlerë me bilancin e llogarisë të shprehur në SDR.

3. Subjekt i dispozitave të përcaktuara në pikën 4, shuma që duhet të paguhet në monedhën e zgjedhur do të përcaktohet nga konvertimi në SDR në monedhat e pagesës në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

3.1 Në rastin e monedhave për të cilën kursi i këmbimit të SDR-së është publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), do të përdoret kursi i këmbimit në fuqi në ditën para pagesës ose kursi më i fundit e publikuar.

3.2 Në rastin e monedhave të tjera të pagesës, si një fazë e parë, shuma në SDR do të konvertohet në një monedhë të ndërmjetme për të cilën vlera ndaj SDR-së publikohet çdo ditë nga FMN-ja, duke përdorur kursin e këmbimit më të fundit të publikuar. Si fazë e dytë, rezultati i marrë në këtë mënyrë do të konvertohet në monedhën e pagesës, duke aplikuar kursin e fundit të këmbimit të kuotuar në tregun e këmbimit të shtetit anëtar debitor.

4. Nëse, me marrëveshje të ndërsjellë, operatori i caktuar kreditor dhe operatori i caktuar debitor

kanë zgjedhur monedhën e një vendi që nuk është anëtar i FMN-së dhe ligjet e të cilit nuk lejojnë zbatimin e dispozitave të përcaktuara sipas pikës 3, operatorët e caktuar në fjalë do të bien dakord mbi marrëdhëniet midis SDR dhe vlerës së monedhës së zgjedhur.

5. Për qëllimin e përcaktimit të ekuivalentit të një monedhe, kursi i përmendur do të jetë kursi i mbylljes për valutën që mund të përdoret në shumicën e transaksioneve të tregtisë në tregun e huaj zyrtar të këmbimit.

6. Operatori i caktuar debitor duhet të paguajë, në datën e pagesës, shumën në monedhën e zgjedhur me anë të xhirimit postar apo ndonjë mjet tjetër të pranueshëm për të dyja operatorët e caktuar.

7. Operatorët e caktuar kreditorë do të publikojnë, me anë të një qarkoreje të lëshuar nga Byroja Ndërkombëtare, çdo ndryshim në adresat në të cilat do të dërgohen çeqet ose transfertat përcjellëse.

8. Tarifat e pagesës (komisionet bankare, detyrimet e kompensimit, depozitat, komisionet, etj) të mbledhura në shtetin debitor do të përballohen nga operatori i caktuar debitor. Tarifat e mbledhura në shtetin kreditor, duke përfshirë pagesën e tarifave të mbledhura nga bankat në shtetet ndërmjetëse, do të përballohen nga operatori i caktuar kreditor. Kur është përdorur, sistemi i transfertave me xhirim postar me përjashtimin nga tarifatat, përjashtimi do të jepet nga zyra e shkëmbimit në shtetin e tretë ose në shtetet që veprojnë si ndërmjetës midis operatorit të caktuar debitor dhe operatorit të caktuar kreditor, kur nuk ka shkëmbime të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre

9. Në qoftë se, midis dërgimit të urdhër transfertës ose pagesës me mjete të tjera dhe marrjes së saj nga ana e operatorit të caktuar kreditor ndodh një ndryshim në vlerën ekuivalente të monedhës së shtetit të zgjedhur, të llogaritur siç përshkruhet në pikat 3, 4 ose 5, dhe nëse diferenca që rezulton nga ky ndryshim e tejkalon 5% të shumës së detyrimit (ndryshimi llogaritet si vijon), diferenca e përgjithshme do të ndahet në mënyrë të barabartë mes dy operatorëve të caktuar.

10. Paga do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi brenda gjashtë muajve nga data e pranimi ose njoftimit të pranimi zyrtar të llogarive të likuidimit dhe llogarive që tregojnë shumën ose bilancin që duhet shlyer. Pas kësaj periudhe shumën e detyrimeve do të ngarkohen me interes prej 6% në vit të llogaritur nga dita pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur. Me pagë kuptohet dërgimi i fondeve ose të instrumentit të pagesës (çek, urdhër-pagesë, etj) ose nënshkrimin e urdhër transfertave ose depozitimit nga organizata përgjegjëse për transferimin në shtetin anëtar debitor.

11. Kur është bërë paga, dokumenti i transfertës (çeku, urdhër-paga, etj), do të shoqërohet nga veçoritë e titullit, periudha dhe shumën në SDR, kursi i konvertimit të përdorur dhe data e zbatueshme e këtij kursi për çdo sasi të përfshirë në shumën totale të dërguar. Në qoftë se nuk është e mundur që detajet të shoqërojnë transfertën ose dërgesën e parave, do të jepet një letër shpjeguese me anë të mjeteve elektronike ose me postë dhe përmes rrugës më të shpejtë (ajrore ose tokësore) në ditën kur është realizuar paga. Shpjegimi i detajuar do të jetë në frëngjisht ose në një gjuhë që kuptohet nga operatori i caktuar të cilit i është bërë paga.

KAPITULLI 11 DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni RC 209

Informacioni që do të jepet nga operatorët e caktuar

1. Operatorët e caktuar do t'i komunikojnë Byrosë Ndërkombëtare, në format e dërguara nga kjo e fundit, informacionin e nevojshëm lidhur me funksionimin e shërbimit të kolipostës. Ky informacion do të mbulojë vendimet e marra për zbatimin fakultativ të disa dispozitave të përgjithshme të Konventës dhe të Rregulloreve të saj.

2. Çdo operator i caktuar do të njoftojë operatorët e tjerë të caktuar, me ndërmjetësimin e Byrosë Ndërkombëtare, për:

2.1 çmimet e transportit të brendshëm dhe, sipas rastit, çmimet e transitit tokësor dhe çmimet e transportit detar që ai mbledh;

2.2 informacionin përkatës në lidhje me shërbimet fakultative, kushtet e pranimi, kufijtë e peshave, limitet e përmasave dhe karakteristikat të tjera të veçanta.

3. Çdo amendim në informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 duhet të njoftohet pa vonesë me të



njëjtat mjete.

Neni RC 210
Publikimet e Byrosë Ndërkombëtare

1. Byroja Ndërkombëtare, në bazë të informacioneve të dhëna nga shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar, do të publikojë një përmbledhje zyrtare të informacionit me interes të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e Konventës dhe Rregulloreve të saj në çdo shtet anëtar. Ajo gjithashtu do të publikojë një përmbledhje të ngjashme në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare dhe Rregullores së saj, në bazë të informatave të dhëna nga shtetet anëtare dhe / ose operatorët e caktuar në fjalë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores së kësaj Marrëveshjeje.

2. Ajo gjithashtu do të publikojë, nga informacioni i dhënë nga operatorët e caktuar dhe, sipas rastit, nga Sindikatat e Kufizuara për sa i përket pikës 2.1, ose Kombeve të Bashkuara për sa i përket pikës 2.5:

2.1 një listë të adresave, të drejtuesve dhe zyrtarëve më të lartë të çështjeve postare të shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar dhe Sindikatave të Kufizuara;

2.2 një listë ndërkombëtare të zyrave postare;

2.3 një përmbledhje të informacionit të transitit duke përfshirë:

2.3.1 një listë të distancave kilometrike që lidhet me sektorët tokësor të postës në transit ;

2.3.2 një listë të shërbimeve të transitit të ofruar për postën tokësore (duke përfshirë postën S.A.L.);

2.4 një listë të ekuivalentëve;

2.5 një listë të artikujve të ndaluara e cila do të përfshijë edhe narkotikët e ndaluar sipas traktateve shumëpalëshe për narkotikët dhe përkufizimet e mallrave të rrezikshme të ndaluara për transport me postë të hartuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

2.6 një përmbledhje të tarifave të brendshme të operatorëve të caktuar;

2.7 të dhëna statistikore që lidhen me shërbimin postar (të brendshëm dhe ndërkombëtar);

2.8 studime, opinione, raporte dhe deklarata të tjera që lidhen me shërbimin postar;

2.9 tre katalogët e mëposhtëm:

2.9.1 Katalogu i bibliotekës i Byrosë Ndërkombëtare (duke renditur punimet të siguruar nga biblioteka);

2.9.2 Katalogu periodik i Byrosë Ndërkombëtare (liston periodikët e marra nga Byroja Ndërkombëtare);

2.9.3 Katalogu i librarisë filmike të Byrosë Ndërkombëtare (rendit filma të disponueshëm për tu dhënë hua nga Byroja Ndërkombëtare shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar);

2.10 një katalog të pajisjeve postare;

2.11 një listë të përgjithshme të shërbimeve të postës ajrore (të njohur si "Lista CN 68"), e cila do të përditësohet çdo vit. Operatorët e caktuar do t'i komunikojë përditësimet Byrosë Ndërkombëtare me 1 Tetor të çdo viti, dhe Byroja Ndërkombëtare do të publikojë CN 68 të përditësuar para fundit të atij viti. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi më 1 janar të vitit pasardhës;

2.12 një listë të distancave të postës ajrore (Listë e Distancave të postës Ajrore) të hartuar në bashkëpunim me transportuesit ajror.

3. Ajo gjithashtu do të publikojë:

3.1 Manualin e Konventës dhe të Marrëveshjes të Shërbimit të Pagesave Postare;

3.2 Akte të tjera të UPU me shënime nga Byroja Ndërkombëtare;

3.3 Fjalorin shumë gjuhësh të shërbimit Postar Ndërkombëtar.

4. Ndryshimet në botimet e ndryshme të renditura sipas pikave 1 deri në 3 do të njoftohen me anë të qarkores, buletinit, shtojcave ose mjeteve të tjera të përshtatshme. Megjithatë, çdo ndryshim i publikimeve të renditura sipas paragrafëve 2.11 dhe 2.12 dhe data në të cilën amendamentet hyjnë në fuqi do t'i njoftohen shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar me anë të mënyrës më të shpejtë (ajrore apo tokësore), me minimumin e vonës dhe në mënyrën më të përshtatshme.

5. Botimet e publikuara nga Byroja Ndërkombëtare do t'i shpërndahen operatorët e caktuar në përputhje me rregullat e mëposhtme:

5.1 Të gjitha botimet, me përjashtim të atij të specifikuar sipas pikës 5.2, do të shpërndahen në tri

kopje, njëra nga të cilat do të jetë në gjuhën zyrtare. Dy të tjerët do të jepen ose në gjuhën zyrtare ose në gjuhën e kërkuar në përputhje me nenin 110 të Rregullores së Përgjithshme.

5.2 Botimi periodik Union Postale do të shpërndahet në përpjesëtim me numrin e njësive të kontributeve të caktuara për secilin shtet anëtar dhe operator të caktuar sipas nenit 130 të Rregullores së Përgjithshme.

5.3 Përveç numrit të kopjeve të shpërndara falas në bazë të rregullave të përcaktuara sipas pikës 5.1, shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar mund të blejnë botimet e Byrosë Ndërkombëtare me çmimin e koston.

6. Botimet e publikuara nga Byroja Ndërkombëtare do të dërgohen edhe Sindikatave të Kufizuara.

Neni RC 211 Adresat telegrafike

1. Për komunikimet telegrafike të shkëmbyera midis tyre, operatorët e caktuar do të përdorin adresat telegrafike të mëposhtme:

- 1.1 "Postgen" për telegramet drejtuar administratave qendrore;
- 1.2 "Postbur" për telegrame drejtuar zyrave postare;
- 1.3 "Postex" për telegrame drejtuar zyrave të shkëmbimit.

2. Këto adresa telegrafike do të pasohen nga përcaktimi i shtetit të destinacionit dhe, sipas rastit, nga çdo detaj tjetër që konsiderohet i nevojshëm.

3. Adresa telegrafike e Byrosë Ndërkombëtare do të jetë "UPU Berne".

4. Adresat telegrafike të treguara në pikat 1 dhe 3, të plotësuara sipas nevojës me tregues të zyrës dërguese, do të shërbejnë gjithashtu edhe si nënshkrim i komunikimeve telegrafike.

Neni RC 212 Periudha e mbajtjes së dokumenteve

1. Dokumentet e shërbimit ndërkombëtar do të mbahen për një periudhë minimale prej 18 muajsh nga dita që pason datën së cilës ato i referohen. Megjithatë, nëse dokumentet janë riprodhuar në mikrofilm, mikrofishtë, ose mjete të ngjashme, ato mund të shkatërrohen sapo të vërtetohet se riprodhimi është i kënaqshëm.

2. Dokumentet në lidhje me një mosmarrëveshje apo reklamim do të mbahen deri sa të zgjidhet çështja. Nëse operatori i caktuar, i informuar rregullisht mbi rezultatet e reklamimit, i lejon të kalojnë gjashtë muaj nga data e komunikimit pa ngritur ndonjë kundërshtim, çështja do të konsiderohet si e mbyllur.

Neni RC 213 Formularët

1. Formularët do të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur.

2. Tekstet, ngjyrat dhe përmasat e formularëve si dhe karakteristika të tjera të tilla si pozicioni i rezervuar për vendosjen e barkodit do të jenë ato të përshkruara në këto Rregullore. Sa herë që një zyrë e këmbimit duhet të specifikohet në një formular postar, do të zbatohen rregullat e vendosura në nenin RC 160.16.

3. Formularët për përdorimin e publikut do të kenë një përkthim interlinear në frëngjisht kur ato nuk janë të stampuara në këtë gjuhë.

4. Formularët për përdorimin e operatorëve të caktuar në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin do të hartohen në frëngjisht, me ose pa përkthim interlinear, me përjashtim të rastit kur operatorët e caktuar të interesuar bien dakord ndryshe me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

5. Formularët si dhe çdo kopje e tyre do të plotësohen në një mënyrë të tillë që të dhënat e regjistruara të jenë të lexueshme. Formulari origjinal do t'i dërgohet operatorit të caktuar të duhur ose të palës më të interesuar.

6. Formularët e mëposhtëm do të konsiderohen si formularë për përdorimin e publikut:

- CN 07 (Lajmërim marrja/i dorëzimit /i pagesës /i regjistrimit);
- CN 08 (Reklamimi);
- CN 11 (Shënim i vendosjes së pullave);



- CN 17 (Kërkesë për tërheqjen nga posta, ndryshim ose korrigjim të adresës, anulim ose ndryshim i shumës COD);
CN 23 (Deklarata Doganore)
CN 29 (Etiketa COD);
CN 30 (Etiketa R e kombinuar me emrin e zyrës së origjinës numrin e artikullit dhe trekëndëshin me fjalën "Remboursement" (rimbursim) (pagesë nga marrësi);
CP 71 (Njoftimi i dërgimit);
CP 72 (Seti i kopjeve) (Njoftimi i dërgimit/Deklarata doganore);
CP 95 (etiketa "COD").

Neni RC 214
Zbatimi i standardeve

1. Ekzekutimi i disa Rregulloreve mund të përfshijë zbatimin e standardeve të caktuara. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar duhet t'i referohen botimeve përkatëse të standardeve UPU, të cilat përmbajnë standardet e miratuara nga UPU.

2. Me përjashtim të rasteve kur zbatimi i një standardi të UPU kërkohet shprehimisht nga një referencë në Rregullore, aplikimi i standardeve të UPU do të jetë vullnetar. Megjithatë, shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar janë të këshilluar ti përmbahen standardeve që janë të rëndësishme për veprimet e tyre të brendshme dhe ndërkombëtare, me qëllim për të rritur efikasitetin e përpunimit dhe ndërveprueshmërisë së sistemeve të tyre dhe proceseve me shtetet anëtare dhe operatorët e tjerë caktuar.

3. Një standard i UPU duhet të miratohet në tërësinë e tij. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar do të sigurohen që përdorimi i një standardi të UPU është plotësisht në përputhje me kërkesat e specifikuar në të. Ata mund të devijojnë nga rekomandimet vetëm në masën e lejuar nga standardi në fjalë.

KAPITULLI 12
DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni RC 215
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Rregullores

1. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Konventa hyn në veprim.
2. Ato do të kenë të njëjtën kohëzgjatje si Konventa, me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe nga Këshilli i Operacioneve Postare.

Hartuar në Bernë, më 11 nëntor 2008.

Për Këshillin e Operacioneve Postare:

Dr. Andreas TAPRANTZIS
Kryetar

Edouard DAYAN
Sekretar i përgjithshëm

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I RREGULLORES SË KOLIPOSTËS

Në momentin e procedimit të miratimit të Rregullores së Kolipostës, Këshilli i Operacioneve Postare ka rënë dakord për sa në vijim:

Neni RC I
Dispozita të shërbimit të kolipostës

1. Australia, Letonia dhe Norvegjia rezervojnë të drejtën për të ofruar shërbimin postar të kolive siç

është paraqitur në Konventë ose, në rastin e kolive të dërguar dhe pas marrëveshjes dypalëshe, sipas çdo mjeti tjetër që është më i favorshëm për klientët e tyre.

Neni RC II

Kushte specifike në lidhje me limitet e peshës së kolive

1. Pavarësisht neni RC 114, administrata postare e Kanadasë do të jetë e autorizuar për të kufizuar në 30 kilogram peshën maksimale të kolive të marra dhe të dërguara.

Neni RC III

Procedura e dërgimit

1. Pavarësisht neni RC 124.7.1.1, operatorët e caktuar të Australisë, Kanadasë dhe Zelandës së Re janë të autorizuar të mos marrin një nënshkrim të pranimi ose ndonjë formë tjetër të dëshmisë së marrjes nga marrësi kur dërgohet ose dorëzohet një koli e siguruar pa një barkod në përputhje me të gjitha standardet e zbatueshme të UPU-t.

2. Pavarësisht neni RC 116.2, operatorët e caktuar të Australisë, Kanadasë dhe Zelandës së Re janë të autorizuar të mos marrin një nënshkrim të pranimi ose ndonjë formë tjetër të dëshmisë së marrjes nga marrësi kur dërgohet ose dorëzohet një koli të zakonshme pa një barkod në përputhje me të gjitha standardet e zbatueshme të UPU-t.

Neni RC IV

Limitet maksimale për artikujt e siguruar

1. Pavarësisht neni RC 124.2.1, Suedia rezervon të drejtën për të kufizuar vlerën e përmbajtjes së kolive të zakonshme dhe të siguruara për Suedinë, sipas kufijve maksimale të mëposhtëm:

Koli të dërguara	Vlera Maksimale tregtare e përmbajtjes	Vlera maksimale e siguruar	Dëmshpërblimi maksimal
Kolitë e pasiguruara	1,000 SDR	– +	40 SDR për koli 4.50 SDR për kilogram
Kolitë e siguruara	1,000 SDR	1,000 SDR	1,000 SDR

Kufizimi nuk mund të anashkalohet me sigurim të pjesshëm të vlerës më të lartë se 1.000 SDR. Nuk ka kufizime të reja për llojin e përmbajtjes së sendeve të siguruara. Artikujt me një vlerë më të lartë se këto kufizime do të kthehen në origjinë.

2. Pavarësisht neni RC 124.2.1, Danimarka rezervon të drejtën për të kufizuar vlerën e përmbajtjes së kolive siguruara postare të dërguara që përmbajnë të para ose letra me vlerë të çdo lloji të pagueshëm për sjellësin, sipas kufijve maksimal të mëposhtëm:

Artikujt të siguruar që përmbajnë para ose letra me vlerë të pagueshme sjellësit	Vlera Maksimale tregtare e përmbajtjes	Vlera maksimale e siguruar	Dëmshpërblimi maksimal
Kolitë e siguruara postare	4,000 SDR	4,000 SDR	4,000 SDR

Këto kufizime nuk mund të anashkalohen duke kryer sigurim të pjesshëm në shuma më të larta se 4.000 SDR.



Neni RC V

Trajtimi i kolive të pranuar gabimisht

1. Australia, Azerbajxhani, Kanadaja, Rep. Dem. Popullore e Koresë, Gjeorgjia, Kazakistani, Kirxhikistani, Zelanda e Re, Taxhikistani, Ukraina, Uzbekistani dhe Vietnami rezervojnë të drejtën të japin informacion në lidhje me sekuestrimin e një kolie postare ose një pjesë të përmbajtjes së saj vetëm brenda kufijve të informacionit të dhënë nga autoritetet doganore dhe në përputhshmëri me legjislacionin të tyre të brendshëm.

1bis Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën për të trajtuar si të pranuar gabimisht, dhe të trajtimit në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe praktikës doganore, çdo koli që përmban substanca të kontrolluara, siç përcaktuar në nenin 1308 të kapitullit 21 të Kodit të Rregulloreve Federale të SHBA.

Neni RC VI

Koli të mbajtura automatikisht

1. Pavarësisht nenit RC 137, operatori i caktuar i Kanadasë nuk është i detyruar të përgatisë një shënim verifikimi CP 78 në lidhje me kolutë e pashpërndara mbajtura automatikisht në shërbimin e saj.

Neni RC VII

Trajtimi i reklamimeve

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur veprojnë si një operator i caktuar ndërmjetës, do të jenë të autorizuar që të mos dëmshpërblejnë operatorët e caktuar të tjerë, të cilët dërgojnë gabimisht në transit à découvert koli të siguruara ose të zakonshme në shkellje të kërkesës për pranimin vetëm të artikujve të mbyllur të transitit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën për të mos pranuar reklamime CN 08 nga operatori i caktuar i origjinës për kolutë e siguruara ose të zakonshme të dërguara në transit a découvert dhe refuzon të pranojë përgjegjësi për këto lloj të artikujve të ndaluara.

Neni RC VIII

Pagesa e dëmshpërblimeve

(I fshirë.)

Neni RC IX

Periudha për pagesën e dëmshpërblimeve

(I fshirë.)

Neni RC X

Zbatimi i përgjegjësisë të operatorëve të caktuar

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit RC 148.2.3, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, në të gjitha rastet e një kolie që pretendohet e kthyer tek dërguesi pa dhënë arsye për kthimin, rezervojnë të drejtën për një proces të reklamimit CN 08 vetëm nëse ambalazhi origjinal dhe / ose konteneri i postës është bashkëlidhet për ekzaminim.

Neni RC XI

Transmetimi në postë të mbyllur

1. Pavarësisht nenit RC 164.11, Bahamas, Barbados dhe Kanadaja do të jenë të autorizuar të kufizojnë në 30 kilogramë peshën maksimale të thasëve të marra dhe të dërguara dhe kontenerëve të tjerë që përmbajnë koli.

Neni RC XII
Itinerari i dërgesave

1. Duke konsideruar dispozitat e nenit RC 169.1, operatorët e caktuar të Francës, Greqisë, Italisë, Senegalit, Tajlandës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të përcjellin dërgesa të mbyllura vetëm sipas kushteve të përcaktuara në nenin RC 169.4.

Neni RC XIII
Përcaktimi i çmimeve mesatare

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jenë të autorizuar të vendosin çmime mesatare të transportit tokësor dhe detar të bazuar në shpërndarjen e peshës së kolive të marra nga të gjithë operatorët e caktuar.

Neni RC XIV
Çmime të jashtëzakonshme të transitit tokësor

1. Për momentin, shtetet e renditura në tabelën e mëposhtme do të jenë të autorizuar të marrin çmimet e jashtëzakonshme të transitit tokësor të treguara, përveç çmimeve të transitit të përmendura në nenin RC 190.1.

Nr.	Shtetet e autorizuar Tarifa për koli	Shuma e çmimit të jashtëzakonshëm të transitit tokësor	
		Tarifa për kg të peshës bruto të dërgesës	
1	23 SDR	4 SDR	
1	Afganistan	0.48	0.45
2	Bahrain	0.85	0.55
3	Kili		0.21
4	Egjipt		0.40
5	Francë	1.00	0.20
6	Greqi	1.16	0.29
7	Hong Kong, Kinë		0.12
8	Indi	0.40	0.51
9	Malajzi	0.39	0.05
10	Federata Ruse	0.77	Dyfishi i shumës për kg të paraqitur në kolonën 3 të tabelës në nenin RC 190.1 për distanca të caktuara
11	Singapor	0.39	0.05
12	Sudan	1.61	0.65
13	Rep. Arab. e Sirisë		0.65
14	Tailandë		0.27
15	SHBA		në përputhje me hapat e distancës:
		Deri 600 km	0.10
		Më shumë se 600 deri 1,000 km	0.18
		Më shumë se 1,000 deri 2,000 km	0.25
		Më shumë 2,000 km për cdo 1,000 km shtesë	



2. Danimarka dhe Finlanda rezervojmë të drejtën për të rritur me 50% çmimet e transitit tokësor të parashikuara në nenin RC 190.

Neni RC XV
Çmimet e transportit detar

1. Shtetet në vijim rezervojnë të drejtën për të rritur me maksimumi 5% çmimet e transportit detar të dhëna në nenin RC 192: Antigua dhe Barbuda, Argjentina, Australia, Bahamas, Bahrain, Bangladesh, Barbados, Belgjikë, Belize, Brazil, Brunei Darusalam, Kanada, Kili, Kolumbi, Komoros, (Rep.) Kongo, Qipro, Danimarka, Xhibuti, Dominika, Finlanda, Franca, Gaboni, Gambia, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, Territoret e varura jashtë Mbretërisë së Bashkuar, Greqia, Grenada, Guajana, India, Italia, Xhamajka, Japonia, Kenia, Kiribati, Madagaskari, Malajzia, Malta, Mauricius, Holanda, Nigeria, Norvegjia, Oman, Pakistan, Papua Guineja e Re, Portugali, Katar, Federata Shën Kits dhe Nevis, Shën Lucia, Shën Vincenti dhe Grenadinet, Sejshel, Sierra Leone, Singapor, Ishujt Solomon, Spanja, Suedia, Tanzania (Rep e Bashkuar.), Tailandë, Trinidad dhe Tobago, Tuvalu, Uganda, Ukraina, Emiratet e Bashkuara Arabe, SHBA, Vanuatu, Jemen dhe Zambia.

Neni RC XVI
Çmime suplementare

1. Çdo koli e dërguar me transport tokësor ose ajror drejtuar Departamenteve Franceze të jashtme, Territoreve Franceze jashtë shtetit dhe Komuniteteve të Majote dhe Shën Piere dhe Mikelon do t'i nënshtrohen një tarife të brendshme tokësore që nuk e kalon tarifën përkatëse për Francën. Kur këto koli kalojnë transit në Francë, përveç kësaj, do të sjellë mbledhjen e çmimeve dhe të detyrimeve suplementare vijuese:

1.1 Koli "tokësore"

1.1.1 çmimin Francez të transitit tokësor;

1.1.2 çmimi detar francez korrespondon me hapin e distancës midis Francës dhe secilit prej Departamenteve, Territoreve dhe Komuniteteve në fjalë;

1.2 kolitë ajrore

1.2.1 çmimi i transitit tokësor të Francës për kolitë e transitit à découvert;

1.2.2 Çmimi i detyrimeve të transportit ajror që i korrespondon distancës me postë ajrore midis Francës dhe secilit prej Departamenteve, Territoreve dhe Komuniteteve në fjalë.

2. Operatorët e caktuar të Egjiptit dhe Sudanit do të jenë të autorizuar të marrin një tarifë shtesë prej 1SDR përveç çmimit të transitit tokësor të përcaktuar në nenin RC 190 për çdo koli në transit nëpërmjet Liqenit Naser midis El Shallal (Egjipt) dhe Wadi Halfa (Sudan).

3. Çdo koli e dërguar në transit midis Danimarkës dhe Ishujve Faroe ose ndërmjet Danimarkës dhe Grenlandës do të shkaktojë mbledhjen tarifave plotësuese në vijim:

3.1 koli "tokësore"

3.1.1 çmimi unik për artikull i përcaktuar për kolitë në transit à découvert në nenin RC 190.2;

3.1.2 Tarifa Daneze e transitit tokësor;

3.1.3 tarifa detare Daneze i korrespondon përkatësisht hapit të distancës midis Danimarkës dhe Ishujve Faroe ose midis Danimarkës dhe Grenlandës;

3.2 kolitë ajrore dhe kolitë S.A.L.

3.2.1 çmimi unik për artikull i përcaktuar për kolitë në transit à découvert në nenin 190.2 RC;

3.2.2 tarifat për trajtimin e postës ajrore në transit ;

3.2.3 detyrimet e transportit ajror që korrespondojnë përkatësisht me distancën midis Danimarkës dhe Ishujve Faroe ose midis Danimarkës dhe Grenlandës.

4. Kili do të autorizohet të marrë një çmim suplementar maksimumi prej 2.61 SDR për kilogram për transportimin e kolive të Islandës lindore.

5. Çdo koli e dërguar me transport tokësor ose ajror, në transit midis Portugalisë dhe rajoneve autonome të Madeiras dhe Azores, do të sjellin marrjen e çmimeve suplementare në vijim:

5.1 koli "tokësore"

5.1.1 çmimi portugez i transitit tokësor

5.1.2 çmimi portugez i transportit detar korrespondon me hapin e distancës midis Portugalisë dhe secilit prej rajoneve autonome në fjalë;

- 5.2 kolitë ajrore
 - 5.2.1 çmimi portugez i transitit tokësor
 - 5.2.2 detyrimet e transportit ajror që i korrespondojnë distancës me postë ajrore midis Portugalisë dhe secilit prej rajoneve autonome në fjalë.
- 6. Çdo koli e adresuar në Ishujt Aland përveç tarifës së pandryshueshme tokësore për Finlandën, do të jenë subjekt i tarifave të mëposhtme suplementare:
 - 6.1 Koli tokësor
 - 6.1.1 Çmimi unik për koli i përcaktuar për kolitë à découvert në nenin RC 190;
 - 6.1.2 Çmimi finlandez i transitit tokësor;
 - 6.1.3 Çmimi finlandez i transportit detar i korrespondon me hapit të distancës nga zyra e këmbimit në Finlandë deri në Ishujt Aland;
 - 6.2 Kolitë e postës ajrore
 - 6.2.1 çmimi unik për kolitë e paraqitura në nenin RC 190;
 - 6.2.2 detyrimet e transportit ajror i korrespondojnë hapin të distancës nga Zyra e shkëmbimit në Finlandë deri në Ishujt Aland.
- 7. Përveç rritjes së lejuar nga neni 34.3.2 i Konventës, Tajlanda do të autorizohet që të marrë një tarifë suplementare detare prej 0.28 SDR për kilogram dhe për hap të distancës.

Neni RC XVII
Përgatitja e llogarive

1. Pavarësisht nenit RC 203, llogaritë e paraqitura operatorëve të caktuar të Kanadasë, Republikës Popullore të Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk do të konsiderohen të pranuar, dhe asnjë pagesë nuk do të jetë e detyrueshme, deri në dy muaj pas pranimit të këtyre llogarive, me përjashtim të rastit kur llogaritë janë pranuar brenda shtatë ditëve nga data që ato janë dërguar nga operatori i caktuar kreditor.
2. Pavarësisht nenit RC 203, llogaritë e dorëzuara operatorit të caktuar të Arabisë Saudite do të konsiderohen si të pranuar nëse operatori i caktuar kreditor nuk merr asnjë njoftim të ndryshimit brenda tre muajve. Në mënyrë të ngjashme, operatorët e caktuar të Arabisë Saudite nuk do të jenë të detyruar të dërgojnë pagesat e tyre operatorit të caktuar kreditor në përputhje me paragrafin 7 brenda një periudhe prej dy muajsh, por brenda një periudhe prej tre muajsh.

Neni RC XVIII
Detyrimet e transportit ajror

(I fshirë.)

Neni RC XIX
Rregullimi i debive që rrjedhin nga shlyerja e llogarive nëpërmjet sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi para 1 Janarit 2001

1. Debitë e pagueshme si rezultat i shlyerjes së llogarive me anë të sistemit të kompensimit të Byrosë Ndërkombëtare në fuqi përpara datës 1 Janar 2001 nga çdo operator i caktuar të cilët janë vonuar pas afatit të fundit për shlyerjen e deklaratave përfundimtare të sistemit të kompensimit nga tremujori i fundit i vitit 2000 mund të rregullohen me anë të kredive që i takojnë debitorit nga çdo operator tjetër i caktuar. Para se të ndërmarrë një hap të tillë, Byroja Ndërkombëtare do të konsultohet me kreditorin në fjalë dhe do të dërgojë debitorit një kujtesë. Nëse pagesa nuk bëhet brenda një periudhe prej një muaji nga data e kësaj kujtesë, Byroja Ndërkombëtare do të jetë kompetente në mënyrë të njëanshme për të bërë rregullimet e nevojshme të kontabilitetit pasi informimit të të gjitha palëve të interesuara.
2. Kur bën këto rregullime të kontabilitetit, Byroja Ndërkombëtare do të kompensojë vetëm llogaritë që janë të pranuar nga të dy, nga debitori që nuk ka paguar në kohë dhe nga operatori i caktuar që i ka dhënë hua debitorit që në vonesë.
3. Debitori në vonesë nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj operatorit të caktuar që i ka dhënë hua për kreditë e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare kreditorit në përputhje me procedurën e përshtetur në paragrafin 1.



Neni RC XX
Formularë

1. Pavarësisht neni RC 213.2, operatorët e caktuar të Brazilit, Gjermanisë, Rep. Hungareze, Luksemburgut dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mund të ndryshojnë përmasat dhe formën e formularit CN 07.

Hartuar në Bernë, më 11 nëntor 2008.

Për Këshillin Operacional Postar:

Dr. Andreas TAPRANTZIS
Kryetar

Edouard DAYAN
Sekretar i përgjithshëm

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.8.2012
Doli nga shtypi më 27.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja “Gurten”
Tiranë, 2012

Çmimi 420 lekë

